

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**67**




**PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISE SE PUNËS TË  
SHQIPËRISE**



**ENVER HOXHA**



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**VELLIMI**

**67**

**QERSHOR 1978 – GUSHT 1978**

**SHTËPIA BOTUESE •8 NËNTORI•  
TIRANË, 1989**

## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 67 - TE

Vëllimi i 67-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban fjalime, diskutime, biseda, shënime e shkrimetë tjetra që i përkasin periudhës qershor-gusht 1978, pjesa më e madhe e të cilave betohen për herë të parë.

Edhe në këto materiale vëmendje e posaçme i kushtohet forcimit të punës së Partisë për ndërgjegjësimin e masave punonjëse, për realizimin e detyrave të ndërtimit socialist në luftë me vështirësitë e pengesat që shkaktonin rrëthimi kapitalisto-revisionist dhe kushtet jo të favorshme të natyrës. Por, në periudhën së cilës i përkasin materialet e këtij vëllimi, Partia dhe vendi ynë u ndodhën përpëra një momenti tjetër që i shtonte edhe më shumë këto vështirësi: udhëheqja revisioniste kineze ndërpren menjëherë, në mënyrë arbitrale, të gjitha kreditë e ndihmat ekonomike e ushtarake për Shqipërinë dhe vendosi të tërhiqte nga vendi ynë të gjithë specialistët.

Në këto kushte, para Partisë sonë dilte detyra e ngutshme të sqaronte, në radhë të parë opinionin e brendshëm, por edhe atë të jashtëm për shkaqet e vërteta të këtij qëndrimi armiqësor e antishqiptar të udhëheqjes kineze. Shoku Enver Hoxha i kthehet e i

rikthet disa herë këtij problemi, duke argumentuar bindshëm se shkaqet e vërteta të prerjes së kredive e ndihmave Shqipërisë nga ana e Kinës nuk ishin të karakterit teknik, siç e paraqiste në notën e saj udhëheqja kineze, por të karakterit politik e ideologjik. Ky akt brutal ishte rrjetohim logjik i kursit që ndiqte cjo për zhvillimin kapitalist dhe për shndërrimin e Kinës në supersuqi socialimperialiste.

Pas këtij veprimi antishqiptar të revisionistëve kinezë, në vendin tonë krijohej një situatë e re e cila, siç porosiste shoku Enver Hoxha, duhej përballuar me seriozitet e me mobilizim të gjithanshëm të masave punonjëse, për të realizuar e tejkaluar detyrat dhe jo me eufori e sloganë.

Partia jonë e kishte përgatitur me kohë veten e popullin, nga çdo pikëpamje, për të mos u zënë në befasi e për t'i bërë ballë çdo situate për ndërtimin dhe mbrojtjen e vendit. Përvoja e punës së madhe për ndërtimin e socializmit në luftë me armiqëtë e brendshëm e të jashtëm e kishte mësuar popullin tonë të ndiqte me vëmendje situatat e të mprekte vazhdëmisht vigjilencën. Vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, pjekuria më e madhe e komunistëve dhe e masave punonjëse, uniteti i çeliktë i popullit rreth Partisë ishin faktorë të rëndësishëm që do të bënin të dështonin synimet e revisionistëve kinezë ndaj vendit tonë. Megjithatë, siç theksonte shoku Enver Hoxha, kjo nuk do të thoshte se rështirësitë e reja mund të përballohen lehtë. Ato do të kërkonin sforcim e sakrifica të reja, optimizëm të bazuar revolucionar.

Siç vihet në dukje në vëllim, demaskimi i aktit

armiqësor të udhëheqjes kineze dhe sqarimi i rrugës së drejtë që do të ndiqte vendi ynë për të ndërtuar socializmin me forcat e veta, pa kredi e ndihma nga jashtë, kishte rëndësi vendimtare jo vetëm për ruajtjen dhe forcimin e lirisë e të pavarësisë së vendit tonë, por edhe për të bërë të qartë në opinionin botëror e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare se Shqipëria do të vazhdonte pa u ndalur në rrugën e socializmit e të revolucionit. Kjo do të ishte një grusht tjetër i rëndë për superfuqitë, për imperialistët dhe revisionistët që situatën e re të krijuar nga veprimi antishqiptar i udhëheqjes kineze kërkonin ta shfrytëzonin për qëllimet e tyre ekspansioniste e agresive. Të mos harrojmë për asnje çast, thekson shoku Enver Hoxha, se çdo fitore e arritje jona kanë rëndësi jo vetëm për ne, por edhe për marksistë-leninistët në botë, se u forcon bindjen te socializmi e te ndërtimi i tij me forcat e veta.

Duke u njohur me materialet e këtij vëllimi të përforcohet edhe më tej bindja se sa më mirë të plotësohen planet ekonomike, sa më i shëndoshë të jetë rendi shoqëror socialist, sa më të fortë të jenë diktatura e proletariatit dhe uniteti Parti-popull, sa më të përgatitur të jenë njerëzit nga pikëpamja politiko-ideologjike, kulturore, arsimore e teknike, aq më e fortë është edhe mbrojtja e vendit. Pra, lufta për realizimin e planit e të detyrave duhet kuptuar nga të gjithë në tërë kompleksitctin e vet, si një luftë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, dhe për shpartallimin e blokadës e të planeve agresive të imperialistëve e të revisionistëve modernë.

Realizimi me sukses i detyrave të rëndësishme në ekonomi e në mbrojtje, në situatën e re që u krijua në atë kohë, siç theksohet në vëllim, kërkonte rritjen e rolit udhëheqës e pararojë të organizatave të Partisë e të komunistëve, që ata të jenë kurdokerë në ballë të punëve, të jenë frysma zuesit dhe motori drejtues i kolektivit dhe i punonjësve.

Duke u ndalur në probleme të situatës ndërkombëtare, autorë demaskon me forcë politikën agresive të dy superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, si edhe të Kinës socialimperialiste, që doli me synimin për t'u bërë superfuqi. Në disa materiale u cirret maska teorive të «botës së paangazhuar» e të «tri botëve», të cilat, siç e vë në dukje autorë, janë në unitet për mbrojtjen e statukuoses imperialiste.

Në shënimet nga «Ditari për çështje ndërkombëtare» e në materiale të tjera, ndriçohen anë të reja të strategjisë e të veprimtarisë së revizionistëve kinezë e jugosllavë, evidencohet se ç'i ndan e ç'i bashkon taktilkat e strategjité e tyre. Analiza e thellë shkençore dhe demaskimi i argumentuar që u bëhet politikës dhe strategjisë së socialimperializmit kinez kishin vlera të pallogaritshme edhe për lëvizjen komuniste botërore. Ajo u hapte sytë elementeve të shëndoshë marksistë-leninistë që të shihnin më qartë e t'u shpërndante mjegullën që kishte përhapur maocedunideja, teori që ndihmohej edhe nga imperializmi e kapitalizmi botëror, të cilët shihnin te Kina jo një kundërshtare, por një aleate të mundshme. Aq më i mprehtë bëhej ky problem kur te shumë shokë të partive mar-

ksiste-leniniste kishte paqartësi e keqkuptime për Partinë Komuniste të Kinës e për Mao Ce Dunin.

Me argumente bindëse, duke iu referuar teorisë e praktikës, demaskohen edhe revizionistët jugosllavë, demagogjia e tyre. Në vëllim theksohet se nën maskën e të paangazhuarve ata janë të lidhur fort me imperializmin e socialimperializmin dhe u shërbejnë atyre sipas interesave që kanë. Ata hiqen sikur i zë meraku për të drejtat e popujve, në një kohë kur me teoritë e praktikat e tyre gjoja socialiste, kombeve të veta në Jugosllavi nuk ua kanë siguruar ato, ndaj edhe ky pretendim i tyre nuk është gjë tjetër veçse një blof, konkludon autor. Me shifra e fakte konkrete tregohet se ku i ka çuar ekonominë dhe shoqërinë e këtij vendi i ashtuquajturi socializëm specifik dhe vetadministrimi jugosllav.

Siq shihet, materialet e këtij vëllimi lidhen me një periudhë tepër të rëndësishme të luftës së popullit tonë për ndërtimin socialist të vendit, kur atij iu desh të kapërcejë veç të tjerash edhe vështirësitë e shumta që i krijuan revizionistët kinezë. Ishte mobilizimi i tij i gjithanshiëm, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, që e bënë të mundur kapërcimin me sukses të këtyre vështirësive. Por, mësimet e çmuara të udhëheqësit tonë të paharruar, që i përkasin asaj periudhe, e ruajnë vlerën e tyre edhe për sot e për të ardhmen. Ato, së bashku me gjithë shkrimet e tjera të përfshira në këtë vëllim, e pasurojnë më tej thesarin e madh të trashëgimisë së tij teorike e praktike.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



# **TEJKALIMI I NORMËS NË MINIERË DO TË THOTE TEJKALIM I NXJERRJES SË QYMYRIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**17 qershor 1978**

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Duke analizuar shifrat e realizimit të normave në Minierën e Memaliajt konstatuam se ato në përgjithësi tejkaloreshin. Konkrektisht, për vitin 1977, realizimi mesatar i normave në gjithë minierën dilte 117 për qind, kurse realizimi i planit të prodhimit 100 për qind. Pra, punëtori, nga ana morale, justifikohej, se e kishte realizuar normën, pavarësisht se plani i ndërmarrjes realizohej me vështirësi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pse ndodhi kështu që plani të realizohet 100 për qind, kurse normat 117 për qind? Kur tejkalojen normat, atëherë edhe plani duhet të tejkalohet. E them këtë se tejkalim i normës në minierë do të thotë tejkalim i nxjerrjes së qymyrit. Planin mesatar të nxjerrjes së qymyrit, për shembull, ne mund ta kemi të ulët ose të lartë. Por realizimi ose tejkalimi i këtij plani duhet të korrespondojë me

realizimin ose tejkalimin e normave. Supozojmë se normat janë të drejta dhe në realizimin e tyre nuk ka hile. Atëherë, në qoftë se plani do të jetë nën realizim ose mbi të, kjo do të thotë se duhet të bëhet rishikimi i normave. Mos janë caktuar ato të ulëta, meqenëse ato po tejkalohen në masën 117 për qind nga të gjithë? Në rast se realizimi i planit na del i ulët, në një kohë kur normat tejkalohen, kjo do të thotë që edhe këto janë të ulëta. Osc, mund të jetë edhe e kundërta: në qoftë se normat janë efektive dhe të studiuara, atëherë planin mund ta kemi hartuar të madh.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Ose mund të ndodhë që plani të jetë përgatitur mirë, por në fakt, për zbatimin e tij atje punojnë më pak punëtorë nga sa parashikohej, prandaj ai nuk realizohet, megjithëse normat tejkalohen.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Nëse mungon fuqia punëtore ose ka më tepër punëtorë nga sa nevojiten, kjo pastaj është një gjë tjetër.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Mendoj se duhen parë një për një të gjithë treguesit që të arrish në konkluzione të drejta. Për të marrë sasinë e duhur të qymyrit sipas planit, kërkohet, në radhë të parë, të punohet për të nxjerrë qymyr e jo të kryhen punë ndihmëse e përgatitore, për shembull, duke hapur galeri. Këtu, në fakt, tejkalohet norma, por ky tejkalim nuk korrespondon me realizimin e planit të prodhit të kjo duhet argumentuar.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Atëherë duhet të rezultojë që tejkalimi i normave është bërë në sektorët ndih-

mës dhe jo në sektorin e prodhimit. Kështu duhet të shpjegohet ky fenomen.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Tejkalimi i normave ka ndodhur edhe në sektorët kryesorë, edhe në ata ndihmës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po varet se kush i kontrollon dhe si i kontrollon këto norma? Që të realizosh dhe ta tejkalosh normën në minierë, duhet jo vetëm të punosh 8 orë po e po, por të bësh edhe një sforco të madhe brenda këtyre 8 orëve, bile nganjëherë, kur është e domosdoshme, të punosh edhe jashtë 8 orëve. Ndërsa të punosh me rendiment të ulët dhe ta tejkalosh normën me lehtësi, kjo do të thotë që ajo nuk është reale, pra nuk kontrollohet me punën efektive që bëhet.

Po atëherë, ku është puna e mirë që kanë bërë në Memaliaj, kur kanë tejkaluar normat dhe nuk kanë realizuar planin?!

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Këtë fenomen komiteti i Partisë i Memaliajt e shtroi për diskutim në konferencën e Partisë, që u zhvillua në mars të këtij viti.

Komiteti i Partisë i minierës ngarkoi drejtorinë e ndërmarrjes që të bëheshin kronometrimet e fotografimet e, në bazë të tyre, për këtë çështje të kryheshin studime e të nxirreshin edhe konkluzionet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, ja, u bënë të tëra këto, po çfarë doli prej tyre?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Doli që koha e punës nuk shfrytëzohej, punëtorët futeshin në minierë me vonesë, gjatë kohës së punës kishte sorollatje dhe, me gjithatë, norma tejkalohet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Le të qëndrojmë këtu, në shembullin e Minierës së Memaliajt dhe ta shohim si duhet këtë problem. Meqë u kronometrua koha e punës, atëherë, kemi të drejtë të pyesim: sa doli rendimenti i punës i këtyre punëtorëve? Nga kronometrimi që u bë, duke marrë parasysh kohën efektive të punës dhe jo vonesat e sorollatjet, duhej të dilte nëse norma ishte reale apo qe e pabazuar e që mund të tejkalohet me lehtësi. Puna është të dalë mirë dhe qartë rezultati i këtyre kronometrimeve e fotografimeve që bëhen. Mua më duket se realizimi i normave mesatarisht 117 për qind është fiktiv, jo i llogaritur mirë.

Nuk është hera e parë që ne flasim për këtë problem. Ngritja e normave ka qenë gjithnjë në rendin e ditës të punës së Partisë. Ne vazhdimisht kemi kërkuar të dimë përsë normat kanë qenë të ulëta. Propozimet për ngritjen e tyre i kanë mirëpritur e i kanë pranuar punëtorët. Por, ka dhe nga ata që bëjnë lëshime, duke filluar që nga drejtori e kryeinxhinieri e deri te brigadieri e punëtori, që mendojnë si e si të marrin sa më shumë para duke punuar sa më pak. Pra, veprohet fare pa përgjegjësi: të vëmë norma sa më të ulëta e t'i tejkalojmë ato sa më tepër, pa u realizua plani apo nuk u realizua, punë e madhe; ose mendohet prej tyre se mjafton që u realizua globali dhe as që e vrashin mendjen se nuk u realizuan zërat.

Prandaj, kronometrimet, fotografimet etj. duhet të shërbejnë pikërisht për të eliminuar gjithë këto të meta të vazhdueshme e serioze. Nuk kuptohen, nuk kontrollohen dhe nuk zbatohen me rrëptësi të gjitha të dhënat që sigurojnë realizimin e planit, si normat,

rendimenti i punës, treguesit ekonomikë, shfrytëzimi i kohës së punës etj.

Si shfrytëzohet mirë koha e punës? Së pari, duke u paraqitur në kohën e caktuar në minierë. Aty duhet të ketë një organizim të brendshëm rigoroz, në mënyrë që minatori, me të vajtur te balli i galerisë, ta ketë gati pistoletën, domethënë të fillojë menjëherë nga puna. Që të arrihet kjo duhet të ketë një kontroll punëtor të rreptë në çdo hallkë të punës, bile edhe kontroll individual, domethënë punëtori të kontrollojë punëtorin. T'i jepet fund asaj praktike kur bëhet një propagandë e përciptë që mjaftohet vetëm duke folur për shfrytëzimin e kohës së punës etj. dhe nuk merren masa për ta kontrolluar atë. Të tërë punëtorët mund të thonë në mbledhje se jemi dakord, kurse pastaj, kur futen në minierë, e harxhojnë kohën duke pirë duhan, shtrihen në shesh duke bërë pushime të gjata etj. Kontrolli duhet bërë duke pasur parasysh gjithmonë realizimin e planit çdo ditë. Për shembull, një sektor për të plotësuar planin ditor duhet të nxjerrë kaq vagonë. Kur në fund të ditës kontrollohet kjo dhe rezulton se nuk janë nxjerrë aq, kjo do të thotë se nuk është shfrytëzuar si duhet koha e punës, se punëtorët kanë ardhur me vonesë ose kanë ikur para kohe nga puna, pushimi është bërë një orë e gjysmë, apo dy orë, vagonët nuk janë mbushur plot dhe, me gjithë këto, norma qenka tejkaluar. Jo, kjo gjë nuk pranohet. Dhe këto të gjitha t'i thuhen përgjegjësit të sektorit, i cili realizimin e normës ta matë me sasinë e prodhimit që jep.

Prandaj thashë se kërkohet një organizim rigoroz

i punës dhe një kontroll i rreptë i realizimit të planit: jo vetëm në fund të muajit a të tremujorit, sepse punëtori atëherë i ka marrë paratë, por çdo ditë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po të marrim vetëm këto dy shifra që norma realizohet 117 për qind, kurse plani 100 për qind, menjëherë të bie në sy së pari, që fondi i pagave është tejkaluar, kurse prodhimi jo, së dyti, se kostoja e prodhimit është ngritur, dhe, së treti, se edhe rendimenti është ulur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në bazë të këtyre treguesve duhej të ishte ndjekur edhe rendimenti i prodhimit. Ai është ulur se është ulur vetë koha efektive e punës.

Mendoj se çështja është këtu: si duhet ta bëjmë sa më shkencor planifikimin për nxjerrjen e qymyrqurit. Për këtë qëllim duhet të marrim për bazë planin e vitit të kaluar, duke mbajtur parasysh të gjitha të dhënrat që lidhen me të, për shembull, sa herë janë ngritur normat dhe shkaqet përsë ka ardhur kjo ngritje e normave, të shohim mangësitë që janë vërtetuar gjatë realizimit dhe se çfarë humbjesh ekonomike kemi pasur etj., etj. Atëherë do të dalë përsë është realizuar plani deri në këtë masë me këta punëtorë. Duke i parë konkretisht këto mund të rezultojë që plani i vitit të kaluar ka qenë i ulët, kurse lekë janë dhënë më shumë, me një fjalë, punëtorët kanë marrë më tepër nga ç'kanë dhënë. Atëherë, në këto kushte, çfarë duhet bërë? Në bazë të mundësive që kemi dhe të nevojave të shtetit, këtë plan do ta ngremë apo do ta ulim? A nuk mund të themi se me këtë fuqi punëtore që disponohet dhe me këtë eksperiencë që është

fituar, plani i ri duhet të jetë edhe më i lartë? Do t'i mbajmë të gjithë këta punëtorë apo një pjesë të tyre mund t'i çojmë në fronte të tjera pune? Po normën dhe rendimentin do t'i lëmë në nivelin që i kishim? Natyrisht jo. Atëherë duhet që edhe plani i ardhshëm të jetë më i madh. Kështu ne përgalitim një plan tjetër që nuk do të ketë tejkalime aq të mëdha mbi mesataren. Por tejkalime graduale, natyrisht, edhe duhet të ketë, sepse ka edhe njerëz të fortë e të disiplinuar, që mobilizohen plotësisht, që e kontrollojnë mirë punën etj.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Në Minierën e Rubikut, kur bënë inventarin e sasisë së mineralit që ishte nxjerrë, rezultoi se kishte diferenca në krahasim me sasinë që ishte raportuar. Kjo tregon se normat nuk janë kontrolluar mirë gjatë realizimit të tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duket qartë që atje kundodhin të tilla gjëra, s'ka disiplinë të fortë dhe organizim të mirë dhe zgjidhja e çështjeve i lihet spontanitetit. Në to spikat akoma mentaliteti i vjetër. Nga disa njerëz mendohet: «E mo, punë e madhe, mall shteti është». Kjo është një sëmundje e thellë që manifestohet veçanërisht te nëpunësit e zyrave. Unë nuk e ekskludoj që të jenë prekur nga një sëmundje e tillë edhe disa punëtorë, por më duket se më tepër janë prekur nëpunësit si ata që kritikon Stalini, sepse ata punojnë pa norma dhe nuk u bën asnjë përshtypje kur punëtori nuk e realizon normën ose e tejkalon atë jashtë mase. «Punë e madhe, — thonë ata, — minator je ti». Kurse shteti i ka caktuar minatorit një rrogë nga më të lartat, kështu që edhe rendimenti i tij në

punë duhet të jetë i lartë. Prandaj nuk i lejohet askujt që nën maskën e klasës punëtore të bëjë lëshime të tilla për sa i përket disiplinës së planit. Të gjitha këto janë shtruar edhe më parë, por nuk është e thënë që për to të mos diskutohet përsëri. Rëndësi ka që këto orientime të shtrohen drejt e të luftohet për t'i vënë ato në jetë si duhet.

Ne mund dhë duhet të presim më tepër nga punonjësit. Drejtuesit duhet të jenë të rreptë në kërkimin e llogarisë, pse kjo i shërben forcimit të ekonomisë, por edhe forcimit të vetë Partisë. Kur del një problem, këtë ta shohim edhe si problem partie, por të kemi parasysh edhe specifikën e tij. Për shembull, çështja e normave është një çikë speciale, po, kur futemi, për shembull, në problemin e koncepteve të prapambetura e të konservatorizmit, atëherë del se duhet të punojë e të ndikojë më tepër propaganda e Partisë. Pra, kur vemi në bazë, çështjet t'i shikojmë të tëra në një platformë të përbashkët, por krahas kësaj të kemi parasysh edhe anën specifike të tyre, siç e shpjeguam.

*Pastaj, në takim, u bisedua për probleme të shkollës, për punën e pavatur, për leximet jashtë klase të nxënësve që ato t'i shërbejnë më mirë formimit të tyre etj. Duke folur për këto çështje, shoku Enver Hoxha tha:*

Duhet treguar kujdes i madh me të rinjtë. Në punën me ta lypset, në radhë të parë, edukim. Trajtimi i tyre të jetë me partishmëri. Me këtë dua të them që të shikohet mirë se në ç'prizëm i sheh i riu proble-

met që trajtohen në librat që lexon. Domethënë, kur konstatohet, për shembull, që një i ri ose e re, nga leximi i një vepre të Hygoit ka nxjerrë diçka, por që shihet se nuk është kjo pozitivja, atij mund t'i shpjetohet e t'i thuhet: «Ti e ke lexuar Viktor Hygoin, ky është një shkrimtar romantik. Ai vërtet ka shkruar romane e poczi të bucura, por duhet të dish që ka shkruar edhe vepra, idetë e të cilave stonojnë në realitetin tonë të sotëm. Prandaj, po të them unë se çfarë të lexosh nga ky autor. Lexo, për shembull, se çfarë ka shkruar ai për komunarët ose kur sultan Napoleonin e tretë; apo kur qan vajzën dhe nënën, që u mbytën, e të tjera shkrime të kësaj natyre». Do bërë një punë e kujdeshme me të rintjtë e të rejat dhe jo t'u flitet me vrazhdësi: «Ç'ju duhen e ç'ju hyjnë juve në punë këto që lexoni?!» etj.

Ose të marrim Omar Khajamin, që është përkthyer edhe në shqip. Të rintjtë tanë mund ta lexojnë këtë poet, por varct se si e kuptojnë këtë autor pantësht dhe ç'qëndrim mbajnë ndaj filozofisë së tij.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Të rintje duhet t'u tregohet pikërisht boshllëku i kötyre shkrimeve.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Natyrisht, boshillëkun e kotojisë, por t'u flitet edhe për kohën kur janë shkruar ato etj. Janë të shumta veprat e autorëve të ndryshum romantikë e realistë, reaksionarë e përparrimtarë, që ekzistojnë të përkthyera edhe në shqip. Bile, ka vepra nga autorët më të shquar të epokës romantike gjermiane, të cilat, për nga forma qëndrojnë shumë lart artistikisht, ndërsa duke u thelluar në

to, sheh boshllëkun e madh të përmbajtjes së tyre. Prandaj të rinjve u duhen shpjeguar mirë këto gjëra.

*Botohet për herë të parë si-  
pas tekstit të nxjerrë nga  
biseda e incizuar që gjendet  
në AQP*

# TE BEJME STUDIME PER MJSHTRIT E SHQUAR TE SE KALUARES SONË

Shënimë

18 qershor 1973

Sot fola me shokët për rëndësinë e dokumenteve që dolën nga shtypi në lidhje me tri figurat e shquara, vëllezërit Frashëri. Këto ishin një album i madh me fotografji, që i shihnim për herë të parë, si edhe 4-5 vëllime të tjera me dokumente osmane mbi luftërat shqiptare të shekullit të 19-të.

Eshtë një punë shumë e lavdërueshme e kryer nga ana e Akademisë së Shkencave, që i grumbulloj, i radhit i dhe i nxori në dritë këto dokumente me vlerë të madhe historiografike, që do t'u shërbejnë studiuesve shqiptarë për t'u thelluar akoma më tej në historinë e popullit tonë. Këto dokumente janë shtypur në tri gjuhë: shqip, frëngjisht dhe turqisht. Kështu, këto vëllime ne duhet t'i dërgojmë edhe në bibliotekat e shteteve të tjera, si edhe në akademitë e shkencave të këtyre shteteve, me qëllim që edhe të huajt ta njojin më mirë historinë e lavdishme të popullit tonë, bile të shkruar nga vetë ata që na kishin okupuar.

Bëra një bisedë një çikë të gjatë e të gjerë me shokët, për disa probleme që i kam në zemër, por që nuk shoh të thellohen në to, për të nxjerrë në dritë vlerat e mëdha të të parëve tanë. E kisha fjalën pikërisht për ndërtuesit e talentuar të popullit tonë. Këta ndërtues kanë qenë mjeshtër të rrallë e të zotë. Për disa prej tyre kanë folur me respekt e me admirim edhe të huajt. Ne nuk përmendim veçse arkitekt Sinanin me origjinë shqiptare, i cili është cilësuar nga Perandoria Osmane dhe nga të huajt si një arkitekt i madh. Ai ka ngritur një sërë veprash arkitekturore, veçanërisht xhamitë e Stambollit, që i afrohen në mos ia kalojnë edhe kishës së shën Sofisë. Përveç xhamive ai ka ndërtuar edhe vepra të tjera monumentale.

Pashë sot një libër që ka botuar Dhimitër Shuteriqi, ku flet për krycarkitektin e Ali pashë Tepelenës, Petro Korçarin. Ky ka qenë krycarkitekt i Ali Pashës dhe cilësohet nga Pukëvili, i cili nuk para e hopenste, si Vobani<sup>1</sup> shqiptar, pse, nën drejtimin e Petro Korçarit, Aliu ndërtoi të gjitha kështjellat në pashallëkun e tij. Bile, jo vetëm kështjellat, por edhe pallatet e ndryshme në kështjella dhe jashtë tyre.

Dhimitër Shuteriqi ka kryer një punë të nderuar, të mirë, sepse ka shfletuar të gjithë ata shkrimitarë francezë që kanë qenë rreth Ali Pashës dhe kanë vëzhguar jo vetëm veprimitarinë e tij politike, por edhe

---

1. Sebastian Ië Prestrë dë Voban (1633-1707), mareshal i Francës, i njohur për fortifikimet e shumta kufitare që u bënë nën drejtimin e tij.

ndërtimet që ka bërë ai. Disa e kanë dashur Petro Korçarin, disa, si Pukëvili, nuk e donin, por të vërtetën për të ishin të detyruar ta thoshin. Kështu, Dhimitër Shuteriqi, në këtë libër të shoqëruar edhe me disa fotografi interesante që tregojnë këto vepra të ndryshme, nga të cilat disa ekzistojnë, disa janë rrënuar, vë në dukje jo vetëm veprën e kryearkitkët të Ali Pashës, por përpinqet gjithashtu të thellohet në jetën e këtij ndërtuesi, që, në fakt, nuk ishte një kuadër me diplomë, por një ndërtues i talentuar i dalë nga gjiri i popullit.

Duke marrë shkas nga kjo çështje, vura në dukje se nc, kur shkojmë në qytetet tona të bucura, ndërtimet e vjetra të të cilave i kemi konservuar, qëndrojmë të mahnitur; habitemi për bukurinë e tyre e të kështjellave tona, të urave, të xhamive, të kishave e të manastireve dhe themi: ç'duar të arta kanë pasur mjeshtrit e vendit tonë!

Por përnjëherë unë vë pyetjen: Kush janë këta mjeshtër, nga janë, kush ka shkruar për ta? Me keqardhje nuk po shoh një interesim të veçantë për të vënë në dukje vlerat e këtyre njerëzve të talentuar, që kanë ndërtuar këto vepra të pavdekshme, vepra që përbëjnë kulturën shekulllore nga më të bukurat në fushën e ndërtimeve të vendit tonë. Këta kanë qenë njerëz të zgjuar, vërtet pa shkollë, por të atillë që mjeshtërinë e tyre të ndërtimit, me një gusto të rrallë, e kanë trashëguar brez pas brezi dhe kanë punuar me pasion, megjithëse kanë qenë në gjendje ekonomike të vështirë e janë trajtuar rëndë, sidomos nga ata agallaro-feudalë që i pajtonin për t'u bërë planet

e shtëpive ose të sarajeve të tyre. Këta ishin një-kohësish edhe arkitektë, edhe ekzekutues të projekteve që bënин.

Për fat të keq inxhinierët tanë nuk kanë menduar për këtë çështje, bile as sot e kësaj dite. «Tani është vonë», më tha shoku Spiro Koleka. Por, më mirë vonë sesa kurrë, i theksova unë.

I kam dashur dhe i dua shumë veçanërisht ndërtuesit e vendit tonë, pse në vegjelinë time jam rritur me muratorë dhe kam përshtypjet më të mira për këta njerëz të popullit, për këta proletarë, për këta ndërtues të talentuar me shpirt të madh, me horizont të gjerë dhe me shije të hollë. Prandaj, u thashë shokëve se është gjë e mirë që ne intereso hemi për arkeologjinë. Dhe në këtë fushë, ç'është e vërteta, kemi bërë mjaft zbulime, të cilat i kemi vënë në dukje dhë kemi botuar edhe libra me gravura për këto zbulime. Kështu, për shembull, kemi shkruar e kemi bërë zbulime për kulturën ilire, dhe ato që kemi zbuluar i mbajmë mirë. Kjo është një punë e lavdërueshme për ne. Edhe në të ardhmen të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Por të mos kufizohemi vetëm me arkeologjinë cili rrëve, megjithëse kemi vënë në dukje edhe zbulimet arkeologjike të kulturës greke e romake. Në muzetë tona ndodhen shumë eksponate me vlera të mëdha historike dhe kjo është gjithashtu një gjë e mirë, që duhet ta vazhdojmë e ta thellojmë më tej.

Por për objektet me vlerë arkitekturore të së kaluarës arkitektët tanë janë të interesuar të zbulojnë karakterin kombëtar të ndërtimeve tona, të gjajnë tiparet e veçanta të tyre. Për këto vlera ata edhe kanë

shkruar e kanë përgatitur edhe albume të bukura, që i kam në shtëpi e i shfletoj herë pas here. I shikoj ato me kujdesin më të madh dhe mendoj se këto janë bërë nga njerëz kompetentë, jo vetëm nga ana e përgatitjes së tyre shkencore, por edhe për nga paraqitja artistike. Kjo tregon se ne kemi aktualisht shumë njerëz të mësuar e të kulturuar, të cilët e duan të bukurën, përpiken të njohin të kaluarën e ndritur të ndërtimeve e të arkitekturës shqiptare të së kaluarës dhe të vënë në dukje tek ato karakteristikat kombëtare të tyre. Ata përpiken gjithashtu t'i përtërijnë ato në ndërtimet e reja të epokës socialiste që po jetojnë e t'i zhvillojnë dhe t'i pasurojnë më tej.

Por, sipas mendimit tim, në këtë punë vihen re edhe mungesa. Të marrim, për shembull, qytetin e Gjirokastrës, që ne i kemi dhënë titullin «qytet-muze» dhe ai e meriton këtë titull. Tani bëhen të gjitha përpjekjet nga Partia dhe nga pushteti që ky qytet të ruajë sisionominë e bukur të ndërtimeve të vjetra. Atje, siç dihet, ka shtëpi private jo një, po me qindra, që janë me të vërtetë të bukura e tipike dhe me vlera muzeale. Bëhen përpjekje që ato të mbahen e të restaurohen, vetëm se në to mungon kryesorja: nuk dihet kush i ka ndërtuar këto shtëpi dhe kur janë ndërtuar? Asnjë shkrim nuk ka për to, lidhur me këtë çështje. Pra, bëhen pak ose aspak përpjekje që të studiohet origjina e ndërtimit të tyre, historiku dhe, në radhë të parë, arkitektët popullorë, ndërtuesit e talentuar të këtyre shtëpive monumentale e me vlera muzcale.

Kush i ka ndërtuar, fjala vjen, shtëpitë e Zekatë? Kush e ka ndërtuar sarajin e Kabilit? Kush e ka ndërt-

tuar kalanë e Gjirokastrës? Kush i ka ndërtuar xhamitë atje? Po një sërë shtëpish aq të bukura, me ato qoshe harmonike, me ato pate brenda e me ato monopate, rrugë e rrugica jashtë, të cilat i japin qytetit një hijeshi të papërshkrueshme, kush i ka ndërtuar? Këto akoma nuk dihen.

A duhet vallë të vazhdojmë kështu në këtë rrugë? Një gjë e tillë nuk duhet lënë pas dore. Po nuk e bëmë tani sa janë gjallë, aq më vështirë do jelë nesër kur të vdesin këta mjeshtër të mëdhenj. Prandaj, ash-tu siç bëjmë përpjekje për të gjetur shkrimet e Pukëvilit e të të tjerëve për të mësuar kush ishte krye-arkitekti i Ali Pashës, ne duhet të bëjmë përpjekje, të kërkojmë, të zbulojmë e të shkruajmë edhe për ndërtuesit e Gjirokastrës, për shembull. Tani rrojnë akoma një sërë ndërluesish të shquar si Mihali, usta Lekoja, Koçollari, se usta Dhoska ka vdekur, babai i Qirjako Mihalit që është plak etj. Të gjithë këta unë i kam njobur. Por këta njojin baballarët e gjyshërit e tyre dhe janë në gjendje që të flasin për ta. Po të interesoohen inxhinierët tanë, ata mund t'u tregojnë historikun e ndërtimit, shtëpi më shtëpi, se i kanë bërë vetë ose baballarët dhe gjyshërit e tyre, të ardhur nga të gjitha krahinat e vendit. Emrat që përmenda janë të gjithë korçarë. Ata ishin mjeshtër muratorë të ardhur nga Opari, Orgocka, Panariti e nga vende të tjera. Por njerëz të tillë të shquar ka pasur në Gjirokastër edhe nga Lunxhëria e nga Përmjeti e nga të katër anët e Shqipërisë.

Nuk është vetëm Gjirokastra, për të cilën duhet të interesohemi. Le të marrim Beratin. Edhe ky është

një qytet-muze me shumë ndërtime të bukura; me mëhallë të tëra karakteristike, si Mangalemë. Atje ndodhet edhe kështjella e famshme e këtij qyteti, për të cilën duhet të ketë një histori të madhe, sikurse edhe për gjithë Mangalemin e mëhallët e tjera. Po kështu mund të flasim për Krujën, për Shkodrën e për plot qytete të tjera të Shqipërisë. Të mos dimë kush i ka ndërtuar këto qytete, kjo s'lejohet. Është një humbje e madhe për kulturën tonë në rast se nuk i vihem i seriozisht punës për të shkruar libra e studime për jetën dhe veprat e këtyre mjeshtërve të mëdhenj, për të bërë historikun e këtyre ndërtimeve, me qëllim që brezave të ardhshëm të Shqipërisë t'u shfohet krenaria e ligjshme për duart e arta të mjeshtërve tanë.

Ne i përmendim këlo vlera, por lëmë në harresë mjeshtrit tanë të talentuar. Jo, nuk duhet të harrojmë lavdinë e këtyre bijve të shquar të popullit me kaq talent, që na kanë lënë shumë vepra të pavdekshme. Kjo është e pasalshme pür ne, prandaj duhet të interesohemi që ta plotësojmë këtë mungesë të madhe.

Të marrim kështjellat e vendit tonë. Edhe këto janë të shumta. Kur lexojmë literaturën e vendeve të huaja, shohim se janë shkruar me qindra libra të vëçantë për kështjellat e tyre, për vlerat e tyre arkitekturore e për ndërtuesit, për historinë e kështjellave dhe për vetë të zotët e tyre brez pas brezi. Edhe për ne kjo ka një rëndësi shumë të madhe, për arsyen e është një ilustrim i fuqishëm i potencialit ushtarak, mbrojtës dhe sulmues i popullit tonë kundër invadoreve.

Prandaj, derisa gërmojmë dhe zbulojmë dokumente të rëndësishme historike, për të vënë në dukje vlerat e mëdha të luftërave çlirimtare të popullit tonë, (natyrisht, kur nuk e njohim mirë zhvillimin e luftimeve), të paktën të vëmë mirë në dukje një nga armët më të fuqishme të stërgjyshërve tanë kundër invadoreve, kështjellat. Këto kështjella, në përgjithësi, janë fotografuar, po edhe kjo punë nuk është bërë me kriterë të shëndosha studimi dhe artistikisht. Krahas fotografimit dhe studimit arkitekturor, ne duhet të shkruajmë edhe historikun e kështjellave. Historiku i çdo kështjelle të çon tek ai që e ka ndërtuar, të kryezotti i kështjellës, si dhe të vetë ndërtuesit e saj. Kur të trajtojmë kryezotin e kështjellës, jemi të detyruar të bëjmë zbulime për personalitetin e atij udhëheqësi, të popullit ose të fisit, që e ka ndërtuar kështjellën dhe kështu kompletohen edhe shumë boshllëqe që ekzistojnë në historiografinë tonë.

Çështja e kështjellave është çështje e luftërave që ka bërë populli ynë, po luftërat bëheshin për ta mbrojtur këtë truall nga pushtuesit. Në këtë vend ka pasur dhe ka lumenj që kanë shërbyer edhe për transport. Njerëzit duhej t'i kapërcenin ata, prandaj për këtë janë ndërtuar ura. Ne kemi akoma tani një varg urash të vjetra në vendin tonë, historinë e të cilave nuk e dimë. Të paktën nuk shohim të shkruhet diçka për to, që t'i njohim. Këto ne i kemi parë vetëm nga disa fotografi me diçitura të thjeshta.

Kush e ka ndërtuar urën e Beratit, fjala vjen, e ç'kohe është kjo dhe cilët janë mjeshtrit që e kanë ndërtuar? Kush e ka ngritur Urën e Mesit? Po urën e

Drinos etj., etj., kush i ka bërë? Urat e vjetra janë monumente historike që ne i kemi quajtur monumente kulture dhe i ruajmë si të tilla, vetëm se historikun e tyre nuk e shkruajmë e nuk bëjmë përpjekje që ta shkruajmë Kjo nuk na lejohet, prandaj këtë neglizhencë ta riparojmë. Këto që qëndrojnë aktualisht në këmbë janë monumente të së kaluarës. Ne rrojmi në këto shtëpi, i gëzojmë dhe na bëhet zemra mal kur i shikojmë. Bile, me to çuditen edhe të huajt kur vijnë e i vizitojnë. Ne vetë kalojmë, në këto ura e kështjella, admirojmë harqet e tyre që janë ndërtuar nga mjeshtër që vërtet s'kishin mbaruar universitet, por që në shumë drejtime ua kalojnë edhe atyre që i kanë mbaruar ato. Këtu nuk është çështja e një patriotizmi të sëmurë, por e një të vërtete të madhe. Është fakt se në të hyrë të tunelit të Semeringut ekziston një pllakë, në të cilën thuhet që ky tunel i Alpeve, nga më të mëdhenjtë në botë, në qofslë se s'gabohem, është ndërtuar nga Karl Gega, një inxhinier shqiptar, që kishte mësuar në universitetin e Vjenës.

Pra, në këto drejtime duhet punuar. Këtë unë e kam theksuar edhe herë të tjera. Aktualisht, në kohën e Partisë, ne ndërtojmë socializmin dhe ndërtimi i socializmit është i shumanshëm. Le të marrim si shembull vetëm ndërtimet. Ne ndërtojmë kudo fabrika, hidrocentrale, ura, pallate e shtëpi të bukura; kemi tharë dhe vazhdojmë të thajmë këneta etj. Po kush i ka bërë të gjitha këto? Kush i ka ndërtuar tërë këto hidrocentrale, kush i ka projektuar, kush i ka drejtuar punimet, kush e ka bërë bonifikimin e kësaj kënete etj., etj. Shumë pak gjëra gjen të shkruara për to.

Ja pra që edhe për këto që janë ndërtuar në kohën tonë, në kohën e Partisë, ne vazhdojmë të kemi mungesa të palejueshme.

U kam thënë shokëve, por nuk e di se sa po zbatohet kjo porosi që, për çdo vepër që ndërtohet, duhet të shkruhet edhe historiku i saj. Me këtë kam parasysh jo vetëm përgatitjen e skicave, dhënien e fondeve, rentabilitetin, rendimentin e punës etj., etj., por edhe të dhëna për njerëzit kryesorë që e kanë projektuar dhe ndërtuar këtë vepër edhe në qoftë se nuk vihen emri ose emrat e arkitektëve. Megjithatë kam thënë se për veprat e mëdha duhet të vihen edhe emri ose emrat e arkitektëve, por këtë gjë s'e bëjnë. Mendoj se në një uzinë, fjala vjen, edhe po të mos vihet ndonjë pllakë apo monument, në historikun e saj (i cili të mbahet dhe të pasurohet me çdo ndryshim që ndodh atje) duhet të përmenden figurat kryesore të ndërtuesve. Kjo është një gjë shumë e nevojshme, bille e domosdoshme do të thosha, jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhmen. Brezat që do të vijnë, po t'i kenë këto dokumente, me siguri që do të ndiejnë kënaqësi kur të njihen me to e do të krenohen me paraardhësit e tyre, do të ndiejnë atë krenari që ndiemë aktualisht ne, kur shfletojmë historinë e kohëve të kaluara dhe shikojmë se si në to, përmes dokumenteve vihen në dukje luftërat e përpjekjet e gjyshërvëtanë, ndjenjat, mendimet dhe fjalët e tyre.

Ne entuziazmohemi nga këngët populllore që përshkruajnë aq bukur aksionet, luftërat, mendimet e popullit. Por edhe këta për të cilët po flas janë njerëz të popullit, që ne i shohim me sy, që krijojnë dhe që

ndërtojnë socializmin, prandaj nuk lejohet që të mos vihen në dukje meritat e tyre, në masën e caktuar dhe në mënyrë sistematike. Revolucionin e ka bërë populli. Për Shqipërinë punojnë të gjithë. Ndërtimi i socializmit është vepër e masave dhe në këtë vepër të pavdekshme ka njerëz që dallohen dhe këta nuk janë një, dy, tre apo pesë, por me qindra e me mijëra dhe në çdo sektor punc.

Që të materializohen këto mendime në të gjitha drejtimet, është e domosdoshme të vëmë në dukje historinë e të gjitha atyre veprave që janë krijuar e do të krijohen te ne, e sidomos, historinë e njerëzve të popullit që i kanë ndërtuar ato. Veprat e tyre janë të gjalla. Ashtu siç janë ato të gjalla dhe që do të rrojnë në shekuj, duhet të rrojnë në shekuj edhe emrat e atyre që i kanë ndërtuar, qoftë edhe një mjeshtër i vogël, që ka bërë diçka të bukur e të mrekullueshme.

Ne i admirojmë veprat e Benvenuto Çelinit<sup>1</sup> e të artistëve të tjera të mëdhenj të popujve të ndryshëm, për të cilët janë shkruar libra nga gjithë bota. Po ne, atëherë, përsë të mos shkruajmë libra për njerëzit tanë të talentuar dhe për veprat e tyre? Një qëndrim i tillë nuk duhet të lejohet më në të ardhmen.

Kjo bisedë që bëra me shokët ishte spontane. Disa njerëz me kulturë te ne, kanë pasion dhe punojnë në këtë drejtim, si për shembull, mjeku Fejzi Hoxha, i cili ka përgatitur një libër dhe ka vënë në dukje të gjithë doktorët e krahinës së Gjirokastrës, që kanë jetuar e punuar këtu e 100 vjet më parë. Kjo është

---

1. Benvenuto Çelini (1500-1571), skulptor italian.

një gjë e mirë. «Ai ka punuar me kohë për këtë punë», tha Spiro Kolcka. Jo, me sa di unë, ai nuk ka punuar me kohë, por, natyrisht është interesuar qysh përpara e ka pyetur edhe të tjerë për ata që nuk i ka njohur vctë. Ne u bëmë nga 70 vjeç dhe kemi njohur vetëm dy breza mjekësh. Por, me të pyetur mund të arrijmë në katër breza, siç ka arritur edhe Fejzi Hoxha dhe kështu ne do të jemi në gjendje të njohim mjekët që i kanë shërbyer popullit këtu e 120 vjet më parë.

Një gjë të tillë ne duhet ta bëjmë në të gjithë sektorët. Kudo të ndërmerrret aksion për ta kryer këtë punë me vlerë dhe kjo nuk është diçka e tepruar, por e domosdoshme, më duket mua, bilë është absolutisht e domosdoshme për historiografinë e përgjithshme të vendit tonë të të gjithë sektorëve, duke filluar që nga poezia, folklori e deri tek artet, si muzika e piklura, pra, që nga njëri tek tjetri, të tëra duhen përshkruar. Tani ne jemi në gjendje të specializojmë njerëz përkëtë qëllim. Shkollat tona të larta e të mesme nuk duhet të kufizojnë aktivizimin e njerëzve të mësuar në këto drejtime vctëm për shkak të mungesës së disa organikave. Organikat ne duhet t'i kemi të ngushhta, por këto të jenë të tillë për ata që bëjnë një punë të rëndomtë e të panevojshme dhe jo për ata që do të shkruajnë historiografinë e vendit tonë. Kur themi që të ringjallim artin tonë popullor, këtë ta kuptojmë në mënyrë të shumanshme dhe jo vetëm përkëngët e popullit, por edhe për qëndismat e ndryshme, përveshjet aq të larmishme dhe aq të bukura që na çuditin jo vctëm ne, shqiptarët; por që habisin

edhe të huajt. Të gjitha këto duhet të përshkruhen, të përshkruhet edhe evolucioni që ato kanë bërë gjatë kohëve. Siç e kam thënë edhe një herë tjetër, edhe qëndisma është art, bile një art i veçantë që gjetkë, në vendet e tjera, vihet në dukje në mënyrë të shkëlqyeshme. Prandaj ka ardhur koha që ne ta ndërmarrim një veprim të tillë dhe në shkallë të gjerë për të gjithë sektorët.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkitivin Qendror të Partisë*

# **LIGJET TE NE SHPREHIN VIJËN E PARTISE, PRANDAJ KA RËNDËSI ZBATIMI I DREJTË I TYRE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**19 qershor 1978**

E lexova me kujdes materialin që ju mendoni ta punoni me punonjësit e drejtësisë dhe me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve. Nuk them që ai të mos punohet, sepse orientimet herë pas here ne duhet t'i përsëritim dhe këtë punë ne e bëjmë. Por duhet të kuptohet që këto përsëritje të mos bëhen në mënyrë shabllone; ato të pasqyrojnë zhvillimin e jetës në kushtet e reja. Natyrisht, ka orientime që ne i vlerësojmë si të domosdoshme për t'i përsëritur. Por, ka çështje që duhet t'i plotësojmë me të dhëna të reja në kushtet e krijuara.

Në këtë material bëhet një klasifikim i krimave të kategorive të ndryshme, i gjykimit të fajtorëve dhe i veprimeve të organeve të hetuesisë dhe të gjykatave. Natyrisht, nëpër të ka edhe kritika, edhe këshillime,

por konstatoj se këtij materiali i mungon platforma ose trajtimi politik dhe ideologjik I çështjeve.

Trajtimi politik e ideologjik i problemit ka shumë rëndësi për kuadrot tanë. Me këtë që them nuk e kam fjalën për një trajtim juridik formal, as për një trajtim të rëndomtë politik, duke inkadruar në material disa fraza stereotipe, si: «rrethimi imperialisto-revizionist», «lufta e klasave» e të tjera, e të tjera. Një problem i tillë i rëndësishëm, siç është problemi i krimeve, mendoj se duhet trajtuar si nga ana ekonomiko-shoqërore ashtu dhe nga ana politiko-ideologjike. Krimet duhen analizuar gjithashtu edhe në prizmin teoriko-juridik të Kushtetutës, të Kodit tonë Penal, si dhe të ligjeve të tjera në fuqi. Mua më duket se kjo është kryesorja që ne duhet të shtrojmë në Komitetin Qendror përpëra kuadrove. Këtë bazë studimi kuadrot duhet ta kenë përherë parasysh në zbatimin e funksioneve të tyre dhe ta ilustrojnë me shembuj nga jeta. Dhe shembuj ka sa të duash. Bile, numri i tyre mund të të impresionojë, por nuk mjaf-ton vetëm kjo. Rëndësi ka të kuptohen thellë rrethanat politike, ideologjike, ekonomike, juridike dhe ato të ambientit që i krijon këto krim. Çdo krim që kryhet ka shkaqet dhe rrethanat e veta, të cilat duhen njohur.

Përveç këtyre e rëndësishme është edhe njohja e pikëpamjeve të atij që kryen krimin. Në këtë drejtim duhet bërë shumë kujdes sepse ndeshemi me një varietet të madh pikëpamjesh që mund t'i hutojnë njerëzit që hetojnë dhe gjykojnë një rast të caktuar, në qoftë se Partia nuk ua shtron shokëve në fjalë

domosdoshmërinë e thellimit në çështjet që përmenda më lart dhe të trajtimit politik e ideologjik të tyre: Një gjë e tillë, të paktën në këtë material që lexova unë, mungon.

Në material bëhet fjalë për çështje që janë shtruar ngaherë, por mendoj se një punë e mirë duhet bërë edhe në drejtim të këshillimeve për faje pak a shumë të njëjta. Kjo mund t'u rekomandohet shokëve për ta pasur parasysh, por të mos harrohet se kjo punë është dhe do të jetë kurdoherë relative, për arsyen e shkaqeve e rrethanave të ndryshme në të cilat kryhet krimi, shkaqe që mund të janë objektive dhe subjektive. Orientimet për «këshillime» janë të arsyeshme, por kurdoherë kjo çështje duhet të konsiderohet nga ana filozofike dhe praktike si thikë me dy presa. Prandaj, çiftë e domosdoshme të kuptohet që shokët e organeve të drejtësisë në këto veprime, pra në zbatimin e ligjeve, të mos tregohen liberalë, por as edhe sektarë, sepse si në njërin rast, ashtu edhe në tjetrin dëmtohet Partia, vija e saj.

Në materialin për të cilin po diskutojmë, problemet duhet të trajtohen më shumë nga ana teoriko-filozofike, sesa nga ana praktike. Pra, të rekomandohet përdorimi i këshillimeve, po më parë të bëhet e qartë rëndësia e madhe ideopolitike e tyre, sepse një gjë e tillë i shërben edukimit të njerëzve, pakëson radhët e keqbërësve e për pasojë zvogëlon edhe numrin e të dënuarve.

Jo vetëm akti i këshillimit të fajtorëve nga ana e punonjësve të drejtësisë, por dhe puna bindëse, squalucese dhe edukuese, që duhet të bëjë shoqëria jonë

me të tillë njerëz, luan një rol të rëndësishëm. Kjo është arsyja, mendoj unë, që ju propozoni të thërriten në mbledhje edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve.

Këshillimi duhet bërë kurdoherë me kujdes, i matur, i argumentuar dhe bindës, me qëllim që të bëjë efekt e të mos ndodhë që po ai njeri që u këshilla një herë, të gabojë përsëri, të bëhet recidivist. Të tilla raste kemi pasur e kemi, bile, ka ndodhur që një njeri është dënuar disa herë.

Në radhë të parë akti i pushimit të gjykimit, arrestimet jo në përputhje me ligjin etj., duhet të theillohen nga platforma ideopolitike, të flitet për pasojat e rrezikshme që sjellin veprimet e nxituara e të pamatura, të pamenduara e të pastuduara mirë, për shqetësimet që sjellin këto veprime te njerëzit që nuk kanë faj, te familjet dhe rrethi i tyre etj. E them këtë se ka pasur raste që ndaj disa njerëzve janë bërë ndjekje penale pa baza. Në këtë çështje duhet ndalur, të shikohet pse marrin punonjësit e hetuesisë, të prokurorisë dhe të gjykatave vendime të pastuduara, të papjekura ideologjikisht dhe politikisht dhe pa pasur në dorë prova të plota dhe të sakta?! A ka këtu subjektivizëm? A ka shfaqje të mendjemadhësisë nga këta punonjës të organeve që përmenda, duke menduar: «Unë jam grushti i diktaturës.»? Praktika tregon se ka.

Për mua kjo çështje ka rëndësi të madhe politike dhe ideologjike. Nuk mjafton të renditësh njëra pas tjetrës disa veprime konkrete, por, duke u nisur nga një veprim konkret, problemi të trajtohet drejt teorikisht dhe politikisht. Nuk duhet menduar dhe as nuk

duhet konsideruar si veprim revolucionar, se gjoja mbrohet republika, kur arrestohet një person pa provë dhe i pafajshëm. Përkundrazi, të arrestohet një njeri i pafajshëm do të thotë të shkelet ligji i shtetit dhe vija e Partisë nga ana e punonjësit të drejtësisë, pra, të diskreditohet shteti i diktaturës së proletariatit para punonjësve. Por, edhe të lihen jashtë, pa i gjykuar armiqtë, çshtë krim. Me këtë gjuhë duhet të flasim ne për të tilla veprime të palejueshme.

Ligjet shprehin vijën e Partisë, prandaj ka rëndësi të madhe zbatimi i drejtë i tyre. Ato te ne kanë më parë karakter politik e ideologjik dhe pastaj karakter juridik e praktik. Këto aspekte të kuptohen thellë e në unitet me njëra-tjetrën. Po të kihet kjo parasysh, atëherë pa dyshim që do të veprohet gjithmonë drejt. Prandaj them që ky raport të thellohet në këto drejtime, duke dhënë shembuj konkretë, negativë e pozitivë. Në të shumtën e rasteve nga ne bëhet një luftë klase e shëndoshë. Megjithatë ka edhe veprime jo të mira. Të gjitha këlo, në kompleks, duhen shpjeguar teorikisht, politikisht e juridikisht.

Kurdoherë e në çdo punë, sa të jetë e mundur, të kemi parasysh eksperiencën e Partisë. Nuk them të bëjmë të pamundurën, por në këtë drejtim të bëjmë më shumë përpjekje, sepse eksperienca e Partisë sonë nuk është vetëm një eksperiencë praktike. Këtë ta kuptojmë mirë. Ajo është në radhë të parë një eksperiencë politiko-ideologjike, që udhëheq edhe veprimet praktike të Partisë.

Rezultatet e arritura deri më sot te ne janë fryshtës së politikës dhe i ideologjisë së Partisë, domethënë së

punës së njerëzve që i kuptojnë dhe i zbatojnë drejt problemet e direktivat që shtrohen. Por, të tëra problemet e direktivat nuk kuptohen dhe nuk zbatohen njëloj e si duhet nga të gjithë njerëzit. Prandaj, ne që na ka ngarkuar Partia për këtë punë e kemi për detyrë që, duke u nisur nga të dhënrat e praktikës, nga raslet pozitive e negative, të bëjmë analiza dhe të vëmë në dukje që këlo apo ato orientime e direktiva janë zbatuar mirë apo keq. Për këtë të japim edhe shpjegime se për ç'arsye kjo apo ajo direktivë nuk është zbatuar. Mirëpo mosbatimi i një direktive ka anën e vet teorike, politike, organizative si dhe vjen nga shumë faktorë.

Natyrisht, ne nuk kemi si t'i futemi në hollësi një problemi, por, në bazë të të dhënave që disponojmë, të bëjmë sintezën. Kjo sintezë duhet të jetë teoriko-politike dhe e ilustruar me shembuj konkretë që t'u bëjmë sa më të qarë problemin shokëve. Në qoftë se do të kuptohen mirë politikisht dhe ideologjikisht këto probleme, atëherë do të kemi edhe më shumë suksese në punën tonë. Do të kemi edhe vështirësi. Nuk mund të themi se pas kësaj që do të bëjmë, nuk do të kelë më gabime dhe veprime të pamatura në të ardhmen. Sigurisht, edhe të tilla do të ketë, por në rast se do të bëjmë një punë të mirë bindëse e sqarruesc, politike e ideologjike, do të ketë më pak veprime negative. Kështu do të shkojmë gjithmonë përpëra.

Kurdoherë, në këtë drejtim, thelbin e problemet duhet ta shkojmë jo vetëm nga ana politiko-ideologjike, por edhe teknike, sepse, si të gjitha problemet

edhe ato tekniket kanë anën e tyre filozofike dhe organizative. Edhe ana organizative është pjesë përbërëse e vijës politike dhe ideologjike. Në qoftë se nuk e organizon mirë vijën politike, thotë Stalini, atëherë kjo vijë mbaroi, nuk do të zbatohet. Këto gjëra janë që të gjitha të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Kështu që, kur bëjmë një mbledhje të tillë, si ajo që do të organizohet tani, atje duhet të nxjerrim në pah pikërisht ato çështje kryesore që përbëjnë thelbin e të dhënavë dhe të problemeve që na kanë dalë përrpara dhe që e gjelëm të arsyeshme t'i trajtojmë. Për shembull, për rastin konkret duhen pasur parasysh ato gjëra që u konstatuan nga analiza e punës që u bë në mbledhjen vjetore të Hetuesisë dhe të Gjykatës së Lartë.

Ne vërtet rekomandojmë që për disa faje të përdoret metoda e këshillimit dhe me këtë jemi dakord të gjithë, por konstatojmë se në disa rrethe nuk shqetësohen sa duhet për këto probleme. Dhe kur them kështu nuk e kam fjalën vetëm për komitelet e Partisë, por për të gjitha organizatat-bazë dhe organizatat e masave në rrethe.

Ne konstatojmë se Dega e Punëve të Brendshme e rrethit të Elbasanit, për shembull, ka këshilluar një numër njerëzish që kanë bërë faje. Ky problem të bëhet përnjëherë objekt studimi në komitetin e Partisë, ku të analizohet nga të gjitha anët për të nxjerrë mësimë se ku duhet forcuar puna politiko-ideologjike e Partisë; të dalë qartë jo vetëm se ç'kanë bërë këta njerëz, por edhe se ç'i ka detyruar të bëjnë faje apo gabime; ç'kategori njerëzish janë këta: punëtorë, koo-

perativistë etj., dhe nga janë, nga Shpati apo nga Dumreja etj., etj. Pastaj të shihet se çfarë lloj gabimësh kanë bërë: kanë dëmtuar pronën shoqërore, apo kanë shkelur normat e moralit tonë etj. Pas gjithë kësaj analize, komiteti i Partisë të ndërtojë një punë politike të përshtatshme, të organizojë një mbledhje, ku të thérresë posaçërisht sekretarët e organizatave-bazë të atyre kooperativave, për shembull, ku janë vënë re fenomene negative dhe t'ua shtrojë problemin në mënyrë teoriko-praktike. Në mbledhje mund të përmenden edhe emrat e disa njerëzve që kanë gabuar, por qëllimi kryesor të jctë që shokët sekretarë ose anëtarë të byrosë të komitetit të Partisë të orientohen se si duhet të punojnë me këta njerëz. Mund t'u thuhet punëtorëve të Partisë, për shembull, se këta njerëz kanë nevojë për një edukim më nga afër, edukim ky që duhet të bëhet nëpërmjet punës politike dhe pjesëmarrjes së rregullt të tyre në punë. E them këtë se në përgjithësi, ata që bëjnë faje janë nga ata që i bëjnë bisht punës, gjë që i ka çuar në rrugë të gabuar sa të dëmtojnë pronën e përbashkët ose të merren me thashetheme, me intrigatë vogla etj. Prandaj, me këta njerëz duhet bërë kujdes, të punohet me durim e pa u lodhur derisa të vijnë me të vërtetë në vele. Me ta të mos përdoret një metodë pune zyrtare, e ngurtë, e rreptë e ofenduese, por një metodë pune shoqërore, miqësore, e ngrrohtë. Bile po të ketë mundësi, asnjëri të mos e marrë vesh që këta njerëz janë thirrur edhe nga Organet e Punëve të Brendshme ose nga Partia, ku janë këshilluar. Në mbledhje më shumë të flitet në mënyrë të përgjithshme, por

nuk përjashtohet edhe përmendja e ndonjë rasti konkret. Sidoqoftë, ne duhet të gjejmë metodën më të përshtatshme që ta kthejmë në rrugë të mirë njeriun tonë që ka gabuar.

Puna e Partisë të kuptohet drejt, se nuk është e mjastueshme që punëtori i Partisë të vejë të mbajë me këta elementë një fjalim stereotip, ku të flitet në përgjithësi për luftën e klasave, ose të thuhet që ky ose ai të hidhet në gjyq dhe të dënohet, ose tjetë të lirohet etj. Një metodë pune e tillë duhet medomes të tërheqë vëmendjen e komiteteve të Partisë dhe të organeve të drejtësisë. Nga jeta jonë e përditshme e kemi të qartë që edhe kur është thënë për iksin, qoftë edhe këtu e dhjetë vjet përpara, një gjë e padrejtë, menjëherë atij i ka rënduar një gjë e tillë në ndërgjegje e jo më po të arrestohet e të dilte edhe në hetuesi dhe pastaj të nxirrej i pafajshëm. Këto veprime e vrashin shumë njeriun e rrëthin e tij familjar dhe janë të dënueshme. Ka raste që njerëzit janë shumë sensibël e mund të arrijnë edhe në veprime tepër të rënda. Prandaj themi dhe e përsëritim se veprimet që kryhen nga organet e drejtësisë të janë të kujdeshshme, të matura e të bazuara mirë në fakte, që të mos ndodhin të tilla gjëra.

Kjo është arsyaja, mendoj unë, që ju duhet ta trajtonit një çikë më thellë këtë problem në materialin që keni përgatitur.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# **PLANI I SHTETIT ESIITË LIGJ, KUSII E SIHKEL ATE TË JAPË LLOGARI DERI NË NJË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 qershor 1978**

Raportin e kemi marrë të gjithë, e kemi studiuar dhe, në vija të përgjithshme e në drejtimet kryesore, kemi arritur të krijojmë një ide për realizimin e planit të gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Prandaj, mendoj që shokët e ministrisë dhe zëvendëskryeministrat, kur të diskutojnë, të mos futen në ato çështje që trajtohen në raport, duke na bërë kështu, secili, nga një raportim të dytë e të gjatë tërkuzë për sektorin që mbulon. Të mos harrojmë se kur morëm vendimin për ta rishikuar planin në fund të gjashtëmujorit të parë të këtij viti, kishim për qëllim të shikonim realizimin e tij: edhe anët e mira, por sidomos të metat e boshillëqet, me synimin që mbasi të gjejmë

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për realizimin e planit të gjashtëmujorit të parë dhe për masat për realizimin e planit për vitin 1978.

shkaqet e vërteta objektive dhe subjektive që i kanë krijuar ato, të marrim masa për t'i ndrequr e për t'i plotësuar, në mënyrë që në fund të vitit plani, në përgjithësi, të realizohet. Them në përgjithësi, se mund të ndodhë që ndonjë gjë e vogël edhe mund të mos realizohet, sepse është fakt që ne gjendemi në një situatë me vështirësi objektive të shkaktuara edhe nga qëndrimi antimarksist kinez. Prandaj, masat që do të marrim duhet të sjellin si rezultat plotësimin e deficiteve që po na vërtetohen gjatë këtij gjashtëmujori. Kemi përpala një kohë prej 6 muajsh që gjithë punonjësit të mobilizojnë forcat e tyre për të realizuar planin plotësisht. Këtu është mirë të na evidencohen edhe shembujt pozitivë, se kështu dalin më qartë edhe të metat në degë e në sektorë të tjërë.

Për këto arsyе propozoj që shokët ministra, në diskutimet e tyre, të na thonë edhe përsë nuk u realizuan të gjitha detyrat dhe ç'masa do të merren për t'i realizuar. Pikërisht kjo, mendoj unë, ka rëndësi të trajtohet në këtë mbledhje. Nuk duhet të mjaftohemi me konstatime, që «gjendja është kështu e ashtu», por të ndalemi e të shpjegojmë konkretisht se për ç'arsye ka mosrealizime. Dhe këtu ka shumë gjëra që duhen shpjeguar, pasi mosrealizimet e këtij gjashtëmujori nuk janë diçka e rastit. Shumë nga shkaqet që bëhen pengesë në realizimin e detyrave janë të përkohshme, por ka edhe të atilla që janë konstatuar edhe më parë. Me gjithë punën e mirë që bëhet kudo, përsëri vihen re shfaqje të dënueshme që e dëmtojnë realizimin e

planit. Pikërisht këto gjëra të shtrohen dhe të diskutohen këtu, në mbledhjen e Byrosë Politike.

Zakonisht ne procedojmë duke bërë pyetje. Por, duke vepruar kështu, ndodh që ai që do të diskutojë, të kapet pas pyetjeve të bëra, në vend që të parashtrojë mendimet e tij për të na e bërë të qartë çështjen se përse nuk u realizuan zërat ose detyrat e planit. Pastaj, pyetjet mund t'i bëjmë edhe në mes, edhe në fund të diskutimeve. Rëndësi ka që problemi të analizohet ashtu siç duhet.

*Pasi folën shokët e tjera të pranishëm në këtë mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

Raporti i paraqitur për plotësimin e pritshëm të planit të gjashtëmujorit të parë të zhvillimit ekonomik e kulturor, si dhe masat që janë marrë e duhet të merren për të mbyllur me sukses planin e vitit 1973, dëshmojnë përlustën dhe përpjekjet e mëdha që bëhen, nën udhëheqjen e Partisë, nga i gjithë populli ynë, nga organet e Partisë dhe organet shtetërore, nga ministritë dhe nga Qeveria për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 7-të dhe të plenumeve të 3-të e të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë. Edhe eksperienca e këtij gjashtëmujori vërteton se atje ku puna e Partisë, e organave shtetërore dhe ekonomike, si dhe e organizatave të masave u është përgjigjur situatave në të cilat punon dhe lufton populli ynë për ndërtimin dhe përmbrojtjen e socializmit, plani jo vetëm që është realizuar, por ka pasur edhe një tejkalim të mirë të shifrave të tij. E kundërtë ndodh në ato rrethe, ndërmarrje e kooperativa bujqësore ku kjo punë çalon dhe nuk u përgjigjet

ashtu si duhet problemeve që nxjerr jeta, si dhe vështirësive e pengesave që na krijojnë bllokada e rrethimi i egër imperialisto-revisionist.

Periudha për të cilën na raportohet tregon qartë se ekonomia jonë është një ekonomi e shëndoshë. Ajo është e tillë pse vija e përgjithshme e Partisë dhe politika ekonomike e saj kanë qenë e janë kurdoherë të drejta, të bazuara në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në kushtet tona konkrete. Kur themi se ekonomia jonë është e tillë, e fuqishme dhe e stabilizuar, që nuk njeh kriza e anarki, ngritje çmimesh e papunësi, ne shprehim një realitet objektiv, sepse shohim ç'po ndodh kudo në botë, në vendet kapitaliste apo revisioniste, ku veprojnë me tërë forcën e tyre ligjet shkatërrimtare kapitaliste të konkurrencës e të anarkisë, kriza dhe inflacioni galopant në kurriz të masave të gjera punonjëse. Por, duke theksuar faktin që ne kemi një ekonomi të fortë e të qëndrueshme, veçanërisht në situatë që kalojmë, nuk ka vend aspak për vetëkënaqësi dhe eufori. Këto nuk i lejohen askujt, aq më tepër, sepse, siç e shohim edhe nga raporti që na është paraqitur, në realizimin e planit vihen re disa shfaqje negative, boshllëqe e të meta, që, po të mos mierren masa të fortë e të likuidohen në kohë, e dobësojnë dhe e dëmtojnë ekonominë tonë, stabilitetin dhe vitalitetin e saj, i cili është mbajtur dhe mbahet i tillë vetëm me punë, me djersë dhe me sakrifica nga i gjithë populli.

Partia ka theksuar vazhdimisht se lufta për realizimin e planit të shtetit është luftë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, për ngritjen e mirëqenics së popullit dhe për shpartallimin e bllo-

kadës së egër imperialisto-revisioniste. Të gjitha këto gjejnë materializimin e tyre konkret në shifrat e planit, në detyrat për rritjen e prodhimit dhe të ndërtimit, të transportit dhe të tregtisë, në treguesit ekonomikë dhe në ata financiarë. Mirëpo a kuptohet kudo dhe nga të gjithë me këtë seriozitet kjo çështje?

Nga materiali që na paraqitet dhe nga sa shohim në praktikë del se jo tek të gjithë drejtuesit, në qendër e në bazë, jo tek të gjithë punëtorët ose kooperativistët, ka një kuptim e seriozitet të tillë për planet dhe për luftën e përpjekjet që duhen bërë për realizimin e tyre me çdo kusht dhe frontalisht, në të gjithë zërat e treguesit. Në praktikë, krahas arritjeve pozitive, luftës dhe përpjekjeve të mjaft kolektivave punonjës, vihen re edhe mosrealizime të planit.

Sic del në raport, edhe kur plani në tërësi parashikohet të realizohet, për shembull, për prodhimin e përgjithshëm industrial, në disa zëra detyrat nuk realizohen. Kështu ndodh edhe për degë të tjera. Bile për këto jepet edhe shpjegimi se «zërat e parcalizuar nuk lidhen me mungesa objektive». Kur është kështu, dhe kështu është e vërteta, atëherë përsë lejohet mosrealizimi i detyrave të planit? Pse shkelen vendimet që kemi marrë?

Efektiviteti në prodhim në disa sektorë nuk është i kënaqshëm dhe në raportin që na është paraqitur numrohen shkaqet që nijhen: -zvarritjet administrativo-organizative, avaritë, se disa kuadro e specialistë pajtohen me justifikimet dhe mbajnë qëndrime liberale- etj., etj. Ndonjë faktor të ri që të pengojë për realizimin e planit nuk ka. Atëherë pse nuk po realizohen

detyrat? Pse lejohen avaritë, pse disa automjete na rrinë pa punë? Pothuaj në çdo raport që na jepet në bazë tremujori apo viti po dëgjojmë të njëjtën këngë! Pse nuk likuidohen zvarritjet administrative, pse nuk forcohet organizimi, shokë? Disa herë nuk realizohen planet, sepse nuk merren masa të efektshme, sidomos nga disa organe e organizata partie, apo edhe shtetërore dhe ekonomike, por vetëm «na kënaqin» duke na thënë se punojnë. Ne jemi të sigurt se ata të gjithë punojnë, por problemi është a u venë deri në fund çështjeve, a e organizojnë mirë punën?

Me gjithë punën e madhe që ka bërë e bën Partia, këtu ka nevojë të rrënjoset thellë dhe një herë e mirë tek të gjithë mendimi se plani i shtetit üshtë ligj dhe kush e shkel atë duhet të japë llogari deri në një e jo të hedhë lumin me disa justifikime bajate të përsëritura kushedi sa herë si: «arsye objektive e subjektive» etj. Populli as ha, as vishet dhe as mbathet me të tilla «arsye» objektive dhe subjektive, ashtu sikurse nuk çahen me to as rrethimi e as blokada. Kështu nuk mund të ecet përpara. Qeveria duhet të forcojë kontrollin e të vëré njerëzit mirë përpara përgjegjësisë. Komiteti Qendror dhe aparati i tij duhet të vënë përpara përgjegjësisë komitetet e Partisë dhe organizatat-bazë për detyrat e tyre ideopolitike dhe teknike, pse ky është një problem i përbashkët. Planet e aprovuara, vendimet që marrim, urdhëresat e porositë që jepen, duhet të zbatohen pa hezitim. Ato nuk janë fakultative. Kush i merr si të tilla, dëmton punën, prandaj edhe duhet të përgjigjet. Këtë çështje na e bënë të qartë

edhe plenumet e kohëve të fundit të Komitetit Qendror të Partisë.

Situatat që kalojmë, shokë, dhe realizimi i detyrave në fushën e ekonomisë kërkojnë të kuptohet mirë e të formohen bindje të thella se pa zhvilluar frontalist një luftë të ashpër klasore kundër shfaqjeve të liberalizmit dhe të indiferentizmit, si dhe kundër shfaqjeve burokratike, që vihen re në disa dikastere e komiteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, në disa hallka drejtuese të ekonomisë, si dhe në një pjesë të organeve, hallkave dhe organizatave-bazë të Partisë, që pengojnë zbatimin një për një e në kohë të detyrave të planit, nuk mund të arrihen rezultatet e dëshiruara.

Themelore këtu mbeten kuptimi i thellë dhe zbatimi me rreptësi i disiplinës proletare në kuptimin e gjerrë të saj, zbatimi me përpikëri i disiplinës së planit dhe i disiplinës tekniko-shkencore. Si mund të flitet për një disiplinë të tillë në disa degë që nuk realizojnë planin, kur disa nga zérat e grumbullimit nga ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore si plan pesëmujor nuk janë realizuar plotësisht, kur treguesit kryesorë të planit pesëmujor përf rrethet (sipas tabclüs së fundit që i bashkëngjitet raportit) paraqesin një mozaik të atillë, ku, krahas realizimeve ose tejkalimeve, ka edhe mosplotësim të detyrave?

Me gjithë përmirësimet që vihen re, «globali» vahdon të bëjë punën e vet dhe të na dëmtojë. Ai i kundërvihet planifikimit, duke u lënë shteg fenomeneve të spontaneitetit dhe shfaqjeve të huaja subjektiviste e voluntariste. Në çdo ndërmarrje ku shfaqet ai, bën që

një pjesë e punës së saj të devijojë nga plani unik shtetëror. Kur ky fenomen shfaqet në disa ndërmarrje, degë e sektorë, bëhet edhe më i rrezikshëm e i dëmshëm, sepse, në kushtet e socializmit, kërkon të ruajë, me aq sa i lihet mundësi, veprimin e ligjit të spontanitetit në vend të ligjit të zhvillimit të planifikuar e proporcional. Prandaj lufta kundër shfaqjeve decentralizuese në ekonominë socialiste nuk duhet parë vetëm në format e organizimit e të drejtimit, por edhe në ato shfaqje e prirje për t'iu shhangur detyrave të planit unik shtetëror.

Për shkelje të disiplinës së planit flasin edhe disa raste që vërtetohen në ndërmarrjet tona ekonomike, kur, për shembull, në dyjavorin e parë të çdo muaji realizojnë një prodhim të vogël, kurse në dyjavorin e dytë ia «shkelin gazit» dhe mbulojnë deficitet. Po kështu ndodh edhe në tremujorin e parë dhe në të katërtin. Mirëpo duhet mbajtur mirë parasysh se aritmia, ashtu si në zemër, edhe në ndërmarrjet tona ekonomike, është një sëmundje e rrezikshme. Pasojat negative të saj bien mbi cilësinë, mbi shfrytëzimin e keq të makinave, mbi sforcimin dhe shëndetin e punonjësve tanë, mbi shpërdorimin e lëndëve të para e të materialeve në furnizimin me hope të tregut dhe të një sërë fenomenesh të tjera negative.

Në qoftë se themi se disiplina e planit shprehet te sasia dhe te cilësia, tek assortimenti dhe te realizimi i kontratave etj., po ashtu ajo ka të bëjë me anët ekonomike e financiare të këtij plani. Në qoftë se ndodh që plani i prodhimit realizohet, kurse treguesit ekonomikë e finansiarë nuk realizohen në një numër ndër-

marrjesh ekonomike të vendit, ose shkelen raportet midis fondit të akumulimit dhe atij të konsumit. në favor të këtij të fundit, tejkalohet fondi i pagave në një ko-hë që rendimenti i punës nuk realizohet etj. Lidhur me këto çështje u diskutua edhe në një nga mbledhjet e mëparshme të Byrosë Politike. Por, kështu po ndodh edhe në këtë gjashtëmujor. Dihet se plani është një unitet, në raporte e proporcione të caktuara të prodhit, të shpërndarjes, të shpenzimeve dhe të të ardhurave. Realizimi i tij jo në të gjitha këto drejtime është një realizim plani në global. Kurse, po t'i kushtohet kujdes gjithë raporteve e treguesve, edhe drejtimet themelore të planit me siguri që do të përfshohen.

Këtu është rasti të theksoj se në punën e përditshme duhet të luftohen disa koncepte e praktika të gabuara lidhur me kuptimin dhe me vlerësimin e efektivitetit të shpenzimeve që bëhen në prodhim. Ka aty-këtu njerëz që mendojnë se të kërkojnë rritje të efektivitetit të shpenzimeve në ekonominë socialistë, e veçanërisht në situatat në të cilat ndërtojmë ne socializmin, na qenka pikëpamje jo e drejtë, bile dhe revisioniste. Kurse Partia këtë çështje e ka bërë të qartë prej kohësh. Kur rritja e efektivitetit ekonomik shkon në harmoni me qëllimin e prodhimit socialist dhe sa kohë që akumulimi i brendshëm përdoret në dobi të shoqërisë, ai përbën një domosdoshmëri objektive dhe i shërben vëries në jetë të parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Stalini i ka kritikuar ashpër disa qëndrime e koncepte të tillë të gabuara.

«Eshtë fakt, — shkruante ai, — se në shumë ndërmarrje dhe organizata ekonomike... nacionet: «regjim ekonomie», «shkurtim i shpenzimeve joproduktive», «racionalizim i prodhit» — ka kohë që kanë dalë nga moda. Si duket ato mendojnë, — vazhdonte Stalini, — se Banka e Shtetit «prapëseprapë do të na i japë shumat e nevojshme»»<sup>1</sup>.

Prandaj del detyrë që të luftohen të gjitha ato koncepte e qëndrime nënveftësuese për anët ekonomike e financiare që ndeshen në praktikën tonë.

Mendoj se duke i parë çështjet me këtë sy, tanish që në të ardhmen, duhet të intensifikohen akoma më shumë lufta dhe përpjekjet për realizimin e planit të gjashtëmujorit të dytë dhe të krejt vitit 1978. Ky është një vit vendimtar për mbylljen me sukses edhe të gjithë pesëvjeçarit. Partia ka theksuar se nafta është si dhe buka. Prandaj të merren të gjitha masat që të realizohet plani i prodhiimit dhe i zbulimit të vendbureve të reja nafte e gazmbajtëse.

Një luftë e vendosur duhet bërë për të eliminuar avaritë në nxjerrjen e naftës. Këtu kërkohet një punë shumë e kujdeshshme e të kërkohet fort llogari nga Partia dhe nga organet shtetërore për pusin dhe kur ky bie në avari, të analizohet pse ndodh kjo, të zbulohen shkaqet, duke e trajtuar çështjen ideologjikisht dhe politikisht, nga pikëpamja teknike dhe shkencore. Në

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vell. 13, f. 72.

qoftë se çështja nuk analizohet në këtë mënyrë, po vazhdojmë të flasim me ca sloganë dhe të renditim disa faktorë të përgjithshëm, atëherë nuk ka asnjë garanci se avaritë nuk do të na përsëriten. Për këtë kërkohet të forcohet disiplina e punës dhe ajo tekniko-shkencore dhe të punohet për të përmirësuar shembullin pozitiv të brigadave pararojë.

E kemi thënë edhe më parë se një arsyё tjetër që ndodhin avari në sektorin e naftës, çështë se jo të gjithë kuadrot e specialistët që punojnë atje janë të lidhur sa duhet me prodhimin blic janë propozuar dhe rrugë konkrete për ta ndrequr këtë gjë. Po çfarë çështë bërë në këtë drejtim? Domethënë, ai që bën avari dhe të tjerët që janë rreth e rrotull tij, çfarë përgjegjësie morale dhe materiale kanë? E them këtë se edhe kur plani i naftës nuk realizohet, punonjësit paguhen, bile ka raste që dalin me realizime të larta normash. Pra, ndodh ashtu, siç më raportuan për minatorët e Memaliajt, që, megjithëse normat i tejkalojnë deri 120 për qind, në fakt, planin nuk po e realizojnë. Por ama rrogat këta njerëz i marrin në bazë të normave të tejkaluara.

Pra, a çështë vënë uji në zjarr për këtë problem, apo nuk çështë vënë? Do të vazhdojmë ne kështu? Punonjësit e sektorëve të ndryshëm të industrisë janë më të lidhur me prodhimin, kurse këta të naftës akoma jo sa duhet, sidomos ata të kërkimit. Mirëpo që të gjesh naftë duhet të kërkosh.

Mendimet që shprehen këtu për çështjet që shtrohen për diskutim mund të jenë të drejta, por edhe mund të mos jenë. Veçse, kur jepen mendime me vlerë

apo bëhen propozime të drejta për problemin që diskutohet, atëherë duhet të gjendet mënyra e metoda e përshtatshme që ato të zbatohen, ndryshe bëjmë fjalë kot, si mulliri pa kokrra, siç thotë populli. Edhe për punonjësit e sektorit të naftës është dhënë njëherë mendimi që këta duhet të lidhen sa më ngushtë me prodhimin, por, me sa po shohim, kjo porosi nuk është vënë plotësisht në zbatim, prandaj edhe punët në këtë sektor akoma nuk po na shkojnë mirë.

Një mobilizim më i madh duhet për të realizuar me çdo kusht edhe sasinë e parashikuar të qymyrgurit. Për sa i përket energjisë elektrike, në periudhat kur ujërat janë të bollshme në hidrocentrale, në vend që t'i lëmë ato të na derdhen kot, t'i kthejmë në energji elektrike, duke e përdorur atë brenda vendit, ose ta eksportojmë. Në këto raste energjia elektrike të përdoret më gjerësisht si në industri e në shërbime, ashtu edhe në konsumin familjar, ose, për shembull, për serrat e perimeve, nëse mund të gjenden mënyra përdorimi, sepse sot ne harxhojmë naftë brut. Po kështu duhet menduar e duhet punuar në fushën e mineraleteve të tjera, në Kombinatin Metalurgjik, në industrinë mekanike e gjetkë.

Siç jemi informuar, Ministria e Mbrojtjes Popullore po bën një punë të mirë për organizimin e rigjenerimit të pjesëve të ndërrimit, për autogomat, për kursimin e karburanteve etj.

Mbase kjo punë, që duket mjaft e frytshme dhe me leverdi, duhet të shërbejë si një shembull i mirë edhe për rrethet e për dikasteret e tjera. Në kushtet që po punojmë, ndërtojmë e luftojmë, si mund të le-

johet e të qëndrojmë indiferentë, kur me dhjetëra mijë goma lihen të na kalben në shi e në diell dhe nuk bëhen sa më parë përpjekje për ripërlëritjen e tyre? Me çmimet e tanishme, në mos gabohem, ne duhet të shesim afro dy tonë krom që të blejmë një gomë automjeti. Kur rigjenerimin e gomave e bëjmë për sasi të vogla, qysh prej disa vjetësh më parë, unë nuk e kuptoj pse të mos e bëjmë në sasi më të mëdha dhe jo në mënyrë artizanale sot, kur kemi shumë më tepër mundësi dhe nevojat e ekonomisë popullore janë shumë më të mëdha?

Në ndërtim duhet të merren masa më të fortë pune e mobilizimi që plani të realizohet, t'u pritet rruga të gjitha neglizhimeve, punëve rutinë, t'u jepet fund justifikimeve. Në ndonjë rast, në veprat e mëdha që po ndërlojmë, si në Fierzë apo në ndonjë vend tjeter, disa specialistë, që i kemi të rrallë dhe frontet e punës janë të ngushta, kur kërkojnë vetë të punojnë diçka më shumë se 8 orë, kjo mund të studiohet dhe të lejohen për një kohë të punojnë mbi 8-orëshin.

Aktualisht, në situatat që kalojmë, bujqësia ka rëndësi të jashtëzakonshme, si ekonomike, ashtu edhe politike e strategjike. Prandaj kujdesi për këtë sektor jetik duhet të vijë në rritje nga organet e Partisë e të pushtetit dhe mobilizimi i punonjësve të fshatit dhe të qytetit duhet të jetë më i madh. Pa realizuar deri në një detyrat në bujqësi, nuk mund të përballohen me sukses nevojat që kemi dhe të kapërcehen vështirësitë që na kanë krijuar armiqjtë tanë. Gradualisht duhet të pakësojmë importin e pambukut, të sheqerit, të orizit, të vajit, derisa edhe këto t'i prodhojmë vetë në të

gjitha sasitë e nevojshme. Në raport thuhet se «për disa nga bimët pranverore, duke qenë se u sposhtuan afatet e mbjelljeve, është ngushtuar periudha e shërbimeve». S'ka justifikime, shokë. Të organizohet puna e të merren masa të jashtëzakonshme për të futur pa siro në hambar prodhimin e ri dhe t'u kryhen bimëve bujqësore të gjitha shërbimet që kanë nevojë t'u bëhen. Të luftohet që të realizohen, gjithashtu, edhe prodhimet blegtoriale. Përse nuk po u bëhen shërbimet bimëve foragjere? Sa herë është folur për intensifikimin dhe për rritjen e rendimentit të tyre? Prandaj, t'i vihemë mirë punës dhe asnje sektor të mos lihet pas dore.

Në diskutimin për çështjen e bujqësisë nuk më zuri veshi disa probleme nga më kryesoret e shumë të rëndësishme për bujqësinë tonë, siç është, për shembull, problemi i sistemimit të tokave, i nivelimit të tyre etj. Për këtë problem kemi një plan dhe një program të madh pune. Po nuk punuam mirë me tokën, nuk mund të arrihen rezultata që priten nga bujqësia jonë socialiste. Prandaj është e domosdoshme që ky problem të ndiqet jo në përgjithësi, po konkretisht, në mënyrë që të na thuhet, për shembull, se në rrethin e Shkodrës sistemimi i tokave është bërë deri në këtë osc në atë shkallë dhe pas dy vjetësh do të arrijë në këtë nivel; në rrethin e Fierit apo në atë të Vlorës janë zbatuar këto masa dhe janë arritur këto rezultate e kështu me radhë për të gjitha rrethet e tjera. Për këto çështje duhet të ketë një grafik; të ndiqen ato me kujdes dhe të kërkohet llogari deri në një përzbatimin e detyrave që vihen.

Çështja tjetër që doja të theksoja është nëse keni bërë ju në ministri, në rrethe apo në bazë, studime lidhur me ndikimin që kanë faktorët materialë, agro-teknikë dhe të punës së njerëzve për rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore. Kështu, për shembull, duke pasur në dispozicion këtë apo atë sasi plehu kimik e organik, këtë nivel mekanizimi e kapacitet ujiljeje, duhet llogaritur me saktësi se rritja e rendimenteve në këto apo në ato lloje tokash duhet të arrijë në këtë apo atë nivel. Kjo do të thotë që në një kooperativë, fjala vjen, kur bëhet plani, duke u mbështetur në mesataren e përparuar, ne do t'i themi brigadës se, me këto kushte materiale që i krijojmë, ajo duhet të japë një sasi të caktuar prodhimi. Aty do të diskutohet për anën subjektive për punën që duhet të bëjnë njerëzit. Në këtë mënyrë edhe propaganda do të bëhet më konkrete, edhe Partia do të punojë më mirë për t'i bërë njerëzit të ndërgjegjshëm. Kjo do t'u thotë punonjësve të bujqësisë se derisa i kemi këto «armë», këta faktorë, atëherë duhet të bëjmë të ndërgjegjshëm edhe luftëtarët që këto armë t'i përdorin mirë.

Në, pra, duke ditur ndikimin e faktorëve materialë, të tokës, të farës, të plehut, të mekanizimit, të ujijes, anën ekonomike dhe fuqinë krijuese të tyre, atëherë do të flasim më me kompetencë edhe për rolin e punës së njerëzve, për shkallën e mobilizimit të tyre, për nivelin e kualifikimit dhe për punën ideopolitike që duhet bërë me ta.

Pas kësaj duhet të fillojë puna frontalisht për të realizuar detyrat, duke kontrolluar, për shembull, si

përdoret plechu, si bëhet ujitja, si bëhet prashitja, si kryhen shërbimet agroteknike etj. Këto përbëjnë ato hallka kyç që përcaktojnë rritjen e prodhimit, që duhen ndjekur gjer në fund dhe duhen bërë probleme të Partisë e të organizatave të masave, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë. Në këtë mënyrë do të forcohet disiplina tekniko-shkencore dhe ajo e punës në bujqësi. Kudo të ketë disiplinë e kërkesë llogarie. Por, në bujqësi, disiplina e Partisë dhe disiplina teknike duhet të janë shumë më të forta. Ndërsa në industri është një çikë më lehtë të vihet një disiplinë e tillë, në bujqësi, kjo kërkon më shumë punë.

Kur për këto çështje preokupohet udhëheqja e Partisë, aq më tepër duhet të preokupohen ministria, rrethet dhe baza. Se mund të na thuhet që janë marrë gjithë ato masa për bazën ushqimore të bagëtisë, për përmirësim racor të saj etj., etj., mirëpo kur vjen fundi, shohim se plani i foragjereve ka deficite, prodhimi blegjoral gjithashtu e të gjitha të tjerat me radhë. Natyrisht, ka edhe pluse, por ka edhe minuse, ka shembuj shumë të mirë, por ka edhe shembuj shumë të këqij.

Por, a bëhen objekte studimi në Ministrinë e Bujqësisë këto probleme? A është bërë ndonjë studim shkencor, i cili para se të vihet në jetë, të zbërthehet e të diskutohet në çdo rreth sipas kushteve specifike që ka secili dhe pastaj të fillojë frontalisht puna. Sigurisht, ato që janë për të kontrolluar, të kontrollohen, për shembull, si përdoret plechu, si bëhet ujitja, punimi i tokës etj., etj., se të tëra kanë rëndësinë e tyre. Bujqësia është një shkencë e tërë që kërkon studime

të thella e të vazhdueshme. Edhe një herë po e theksoj se do të qe mirë të na thuhej nëse ekziston një preokupim serioz në Ministrinë e Bujqësisë apo vazhdon akoma ajo punë rutinë që ka qenë më parë përkëto probleme të rëndësishme, që përbëjnë hallkën kryesore të rritjes së prodhimit në bujqësi.

Më lart theksova se si duhet konceptuar në stadin aktual të zhvillimit të vendit dhe në situatat që kalojmë lufta për plotësimin e planit, si dhe disa masa që duhen marrë në degë e në sektorë të ndryshëm të ekonomisë për mbylljen e tij me sukses. Çdo degë e sektor në ekonominë tonë janë të lidhur me njëri-tjetrin, janë pjesë e atij uniteti të ekonomisë sonë socialiste në tërësi dhe influencojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ose në frenimin e së tavrës. Plotësimi i detyrave të planit nga çdo degë bën që ekonomia jonë të zhvillohet drejt e të mos lejohen krijimi i shpërpjesëtimeve dhe lindja e fenomeneve negative.

Të dhënat që na paraqiten në raport, për disa simptoma e shfaqje jo të mira, duhet të na bëjnë të mendojmë më thellë dhe të marrim kudo masa të shpejta dhe të vazhdueshme për mënjanimin e tyre. A nuk duhet të na shqetësojë seriozisht fakti që rendimenti i punës nuk po realizohet? Kaq herë kemi diskutuar për shkallën e ulët të mekanizimit, për mos-shfrytëzimin e mirë të kohës së punës, për thyerjen e disiplinës shkencore e teknike, për dobësitë në organizimin e madh e të vogël të vendit të punës, osc përrastet kur në ndërmarrje mbahen punëtorë të tepërt, dhe forcat e reja, që merren në punë, jo kurdoherë justifikohen me shtimin e prodhimit etj., etj. Me këto

çështje jemi dakord që duhet të merren një për një organizatat e Partisë në bazë dhe organet ekonomike, por, ashtu siç u diskutua në mbledhjen e Qeverisë, kur u mor në shqyrtim problemi i forcimit të disiplinës proletare në punë, këtu kërkohet një kthesë rrënjosore nga të gjithë, në rrethe, në dikastere dhe kudo. Për këto kërkohet të thonë fjalën e tyre e të hidhen në aksione konkrete vetë punëtorët e kooperativistët, por më shumë duhet «t'u dhembë koka» edhe speciaлистëve e administratave të ndërmarrjeve. Sot kemi mijasht kuadro e specialistë të kualifikuar, mirëpo s'ndihmojnë këta për përsosjen e organizimit të prodhimit dhe për t'u krijuar punëtorëve e kooperativistëve kushtet e nevojshme dhe optimale për punët? Apo e matin punën e tyre me shkresat që bëjnë? Rendiment pune i duhet kërkuar punëtorit, por rendiment dhe punë me nerva të tendosur i duhet kërkuar edhe në-punësit, i cili nuk duhet të fshihet pas asaj se e ka punën të panormuar.

Rritja e rendimentit të punës dhe e prodhimit, lufta për forcimin e regjimit të kursimit duhet të zbatohen kudo e në çdo gjë.

Siç e theksova edhe më sipër, në Byronë Politike për këto probleme është diskutuar në mënyrë të posaçme. Është marrë edhe një vendim që po punohet kudo në rrethe e në qendër lidhur edhe me masat që duhet të merren në këtë fushë. Prandaj dobësitet që vihen re në realizimin e planit të këtij gjashtëmuajorit të likuidohen patjetër dhe shpejt në të ardhmen, ndryshe shpërpjesëtimi i vërtetuar do të thellohet, gjë që nuk duhet ta lejojmë në asnje mënyrë. Po të the-

llohet ai më tej, u hapet rrugë inflacionit dhe një sërë të këqijave të tjera. Vëmendja të përqendrohet në realizimin me çdo kusht dhe në tejkalimin e detyrave të planit të prodhimit, në rritjen e rendimentit të punës, në uljen e shpenzimeve të prodhimit, në realizimin e planit të eksportit dhe të importit, në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, në plotësimin e treguesve ekonomikë e finansiarë. Duke i parë të gjitha këto që numërova në unitet me problemet e zhvillimit të prodhimit, të pakësohet në maksimum numri i ndërmarrjeve me humbje, të merren masa urgjente dhe të forta që të mbyllin të gjitha kanalet që lejojnë rritjen e fondit të pagave, pa e shoqëruar këtë me shtimin e prodhimit dhe me pakësimin e shpenzimeve joproductive etj.

Të gjitha këto na nxjerrin tek ajo që ka theksuar vazhdimisht Partia, te nevoja e përmirësimit të mëtejshëm të drejtimit dhe të organizimit, te forcimi i kontrollit dhe i disiplinës proletare në punë, në bazë dhe në qendër. Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të Partisë kritikoi dikasteret qendrore dhe organizatat e Partisë që militojnë në to, sepse kanë pasur ngathtësi e zvarritje në zgjidhjen e disa problemeve që janë ngritur nga baza. Ç'do të thotë ajo që një rrëthi t'i rritet plani i ndërtimeve, por ky të mos shoqërohet edhe me kuotë transporti? Atëherë si mund të realizohen planet në këtë mënyrë? Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore në mënyrë të veçantë nuk u jep rrugëzgjidhje disa problemeve të tillë që ngrenë rrëthet.

Qcveria nuk duhet t'i lejojë më dikasteret që të

justifikohen dhe të bëjnë autokritika po për të njëjtat gjëra. Dikasteret prandaj janë, që, nën udhëheqjen e drejtimin e organizatave të Partisë dhe të Qeverisë, t'u japin rrugëzgjidhje problemeve të ndryshme dhe të kapercejnë vështirësitë dhe pengesat që u dalin përpara.

Dikasteri nuk është thjesht një organ grumbullues të dhënash, qoftë për hartimin e planit, qoftë për realizimin e tij. Për pjesën që i takon, ai duhet të ndiejë përgjegjësi të plotë për krijimin e të gjitha atyre kushteve që nevojiten për realizimin e planit. Kontrolli që ushtrohet dhe ndihma e kualifikuar ndaj bazës, që kërkohet të jepet nga ministria, janë çështje me rëndësi të madhe. Mirëpo, që të bëhen këto, kërkohet njohje e gjithanshme, ndjekje e vazhdueshme e detyrave dhe e jetës në bazë, kërkohen përgjithësimë dhe konkluzione mbi përvojën pozitive dhe përhapjen e saj në mënyrë të organizuar.

Komisioni i Planit të Shtetit duhet të karakterizohet, veç të tjerash, nga një operativitet në mbësh-tetje të studimeve konkrete, për të marrë masa të shpcjta dhe për t'u dalë përpara punëve. Ai të mbajë lidhje të ngushta me seksionet e planit në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe këta me degët dhe me seksionet e planit në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore, të bëjë kontolle dhe koordininie të koncentruara e të centralizuara me dikasteret përkatëse. Asgjë nuk duhet të jetë në pritje. Të mos pritet derisa të vijnë formularët, sepse atëherë - e ka marrë ferra uratën», siç thotë populli. Komisioni i Planit të Shtetit duhet të dijë dhe të kërkojë se ku të ndihmojë, të vëré në lëvizje të gjithë dhe jo të re-

gjistrojë çdo pengesë «objektive» që del. Më shpejt t'u japë ai zgjidhje problemeve. Të vendosë disiplinë më të fortë për vete dhe po kështu të kërkojë për punët e planit edhe nga të tjerët. Komisioni i Planit të Shtetit ka përgjegjësi të madhe përparrë Partisë dhe Qeverisë për kryerjen e mirë të detyrave që ka.

Edhe nga rrethet mendoj se duhet të mbahen më mirë parasysh dy çështje:

Disa herë ndodh që rrethet, apo hasin një vështirësi apo një pengesë për një problem ose për një tjetër, në vend që të vrasin mendjen si ta zgjidhin vetë, ua përplasin atë dikastereve.

Çështja tjetër është se detyrat që shtrohen nga Komiteti Qendror i Partisë apo nga Qeveria, urdhrrat e porositë që jepen në rrugë të rregullt zyrtare nga dikasteret për probleme të caktuara, duhet të zbatohen pa një pa dy në rrethe dhe në bazë. E theksoj këtë se na kanë informuar që nganjëherë komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve i marrin si fakultative detyrat dhe porositë e ndryshme që jepen nga dikasteret. Ndodh që edhe drejtues ndërmarrjesh, pasi marrin detyrat nga dikasteret, për t'i zbatuar ato ose jo, fjalën e fundit e kërkojnë nga rrethi. Doemos rrethi, si pas rastit e problemit, duhet vënë në dijeni, por, kur detyrat e dhëna janë brenda planeve dhe i shërbejnë zbatimit sa më të mirë të tyre, së bashku dhe me ndihmën e rrethit, ato duhet të vihen në jetë pa ngurrim e pa vonesë. Të vepruarit në këtë mënyrë ka të bëjë me zbatimin e parimit të centralizmit demokratik. Kur se e kundërta jo. Ne duhet të luftojmë çdo shfaqje të huaj, sado e vogël që të jetë, të centralizmit burokra-

tik, ashtu sikurse duhet të luftojmë kundër shpirtit të ngushtë të repartit dhe të interesave të ngushtë lokalë apo dikasterialë, kundër thyerjeve të disiplinës shtetërore.

Urdhrat e dikastereve janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga organet përkatëse të rretheve dhe Partia duhet t'i mbëshitetë këla me forcë në këtë drejtim. Ndryshe s'ka disiplinë, po shthurje. Kur këto organe konstatojnë se një urdhër është në kundërshtim me direktivat e Partisë dhe me vendimet e Qeverisë, atëherë t'u drejtohen menjëherë organeve më të larla, por nuk lejohet që çështjet të sorollaten për javë e muaj të tërë dhe të mbeten pa u zgjidhur.

Këtu një rol i veçantë i del aparatit të Këshillit të Ministrave, i cili duhet të qëndrojë më afër e të lidhet më mirë me rrethet, të njihet me problemet dhe me vështirësitet që hasen në bazë dhe të ndërhyjë ku duhet që çështjet të zgjidhen me çdo kusht e sa më shpejt.

Partia dhe Qeveria i kanë caktuar kompetencat për të realizuar planin dhe të gjitha detyrat e jo për të penguar. Nuk duhet lejuar as t'u marrësh kompetencat të tjerëve, as t'i lësh ato të t'i marrin të tjerët dhe, ca më keq akoma, t'i lësh punët në mes të rrugëve.

Unë mendoj se arsyet e mosbatimit të kompetencave dhe lënia e stafetës njëri-tjetrit lidhen me një kompleks të tërë shkaqesh, që kanë të bëjnë me astësimin ideopolitik e profesional të kuadrove tanë, me ndërgjegjen e tyre, me interesat dhe me lloj-lloj arsyesh të tjera subjektive. Partia me guxim ka ngritur mjast kuadro të rinj në përgjegjësi. Dhe shumica dërr-

muese e tyre, me punë dhe me djersë, përpinqen dhe lusfojnë për të zbatuar detyrat që ajo u ka ngarkuar. Por nuk duhet të mbyllim sytë e të mos shohim edhe dobësitë. Shkallën e përpjekjeve që bën e duhet të bëjë secili për të justifikuar plotësisht detyrën dhe vendin që i është ngarkuar. Është e qartë se po u vure në një vend, po u caktovë ministër apo zëvendës i tij, drejtës apo shef i një sektorë, kryetar i komitetit ekzekutiv, kryetar kooperative ose sekretar partie etj., kjo nuk do të thotë se u bëre përnjëherë dhe plotësisht i astë për një funksion të tillë. Duhet shumë punë dhe përpjekje këmbëngulëse të vazhdueshme për të mësuar me zell nga librat, për ngritjen ideopolitike e profesionale. Ashtu siç duhet thellim në problemet dhe këmbëngulje për të fituar ekspericencë për të ecur kurdoherë përpëra.

Neve na kujtohet ajo pyetje dhe përgjigje që i jepte Stalini çështjes se

“Ç’do të thotë të drejtosh prodhimin? Ndër ne nuk e kuptojnë kurdoherë në mënyrë bolshevikë çështjen e drejtimit të ndërmarrjeve. Shpesh herë te ne mendojnë se të drejtosh — do të thotë të nënshkruash shkresa, urdhra. Kjo është për të ardhur keq, por është fakt. Nganjëherë pa dashur të kujlohen pompadurët e Shadrinit. Sillni ndër mend se si pompadurja e mësonte pompadurin e ri: mos e vra mendjen me shkencë, mos u thello në punë, le të merren të tjerët me këtë, kjo s’është punajote, — puna jote është të nënshkruash shkres-

*sat. Duhet të pranojmë, për turpin tonë, — vazhdonin ai, — se edhe midis nesh, bolshevikëve, ka mjast njerëz të tillë, të cilët drejtojnë duke nënshkruar shkresa. Kurse për t'u thelluar në punë, për të përvetësuar teknikën, për t'u bërë zot i punës, — për këtë s'bëhen fort merak..!.*

Dhe Stalini më poshtë vazhdonte:

*«...të mësosh është më vështirë sesa të nënshkruash shkresa...»<sup>2</sup>.*

Mirëpo ai theksonin:

*«Shkruani rezolucionë sa të doni, bëni be e rrufe sa të doni, por po nuk zotëruat teknikën, ekonominë dhe financat e uzinës, të fabrikës, të minierës — s'do të keni gjë në vijë...»<sup>3</sup>.*

Po kështu ai këshillonte:

*«Të mendosh se mund të drejtosh tanë nga zura. duke ndenjur në tryezë, larg uzinave, — do të thotë të vihesh në një rruaqë të gabuar. Për të drejtuar sot uzinat, duhet të takohesh*

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 13, f. 35.

2. Po aty, f. 36.

3. Po aty, f. 37.

*më shpesh me njerëzit e ndërmarrjeve, duhet të mbash lidhje të ngushta me ta»<sup>1</sup>.*

Këto mësime të çmuara për të gjithë, Partia jonë nuk ua ka vënë sot masave punonjëse në dorë, por që nga dita e parë e Çlirimt dhe në këtë drejtim kemi pasur shumë suksese. Këto janë mësime me vlerë, që Partia i ka zbatuar me konsekuencë gjatë gjithë periudhës së ndërtimit socialist të vendit tonë. Por ato janë aktuale dhe me vlerë të madhe për çdo kohë, të cilave ne duhet vazhdirmisht t'u referohemi, të mësojmë prej tyre dhe të punojmë sipas tyre, në qoftë se duam së largohemi nga ai prakticizëm i ngushtë dhe shterp, që i jep disa herë drejtimin një karakter thjesht administrativ, pa mbajtur mirë dhe kurdoherë parasysh vijën e Partisë dhe politikën ekonomike të saj, pa njojur në themel dhe jo në mënyrë shkollareske ligjet ekonomike objektive të socializmit që veprojnë te ne e në bazë të të cilave drejtohet gjithëjeta jonë ekonomike. Njohja e thellë e tyre do të bëjë që problemeve t'u jepet zgjidhja e drejtë që kërkohet dhe me këtë mënyrë do të shmangen shumë nga shfaqja e subjektivizmit.

Detyrat e mëdha që kemi përpara, situatat në të cilat punojmë e luftojmë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, kërkojnë mobilizimin e përgjithshëm të masave të gjera punonjëse, të organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë, të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë dhe për këtë jemi të gji-

thë dakord dhe kemi vënë të gjitha forcat. Fatin e realizimit të planit e vendosin klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, mbarë punonjësit e vendit tonë, kurdoherë nën udhëheqjen e drejtë të Partisë.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtim, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1978-1979», f. 94*

*Botohet i plotë sipas tekstit të  
nxjerrë nga procesverbali i  
mbledhjes së Byrosë Politike  
të KQ të PPSH që gjendet  
në AQP*

# PËR NGRITJEN E LINJAVE E TË FABRIKAVE TË REJA, TË SIIFRYTEZOJME MË MIRE REZERVAT E BRENDSHIME

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 qershor 1978

Problemi që po diskutojmë në këtë mbledhje është i rëndësishëm, por, sipas mendimit tim, raporti që na u paraqit, është tepër informativ. Në qostë se shokët, që kanë ardhur këtu, do të na bëjnë diskutime të gjalla, mirë, ndryshë, më duket mua, përsintimet do të jenë të pakta.

Megjithëse para dy ditësh, në mbledhjen e Byrosë Politike ne patëm për diskutim problemin e realizimit të planit përgjashtëmujorin e parë të këtij viti, ku përfshiheshin edhe këto masa, ne po i marrim në

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit: «Mbi masat që janë marrë e do të merren për projektimin dhe prodhimin e fabrikave, reparteve e linjave të reja si dhe për sigurimin e pjesëve të ndërrinit në vend», paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minicrave dhe nga Komisioni i Planit të Shtetit.

analizë ato edhe sot, në këtë mbledhje, sepse problemi, siç thashë, ka rëndësi.

Unë desha të di këtë gjë: këto objekte e linja, të cilat ju të Ministrisë së Industrisë e të Minicrave, në tabelat i keni bashkëngjitur materialit që na keni dhënë, shënoni se janë realizuar, a janë vënë në shfrytëzim apo jo? Këtu, në tabelat që keni përgatitur, caktimi i afateve duhet të ishte bërë me muaj dhe jo me vite. Thuhet, për shembull, që këto apo ato objekte do të përfundojnë në vitin 1978. Mirëpo, viti 1978 fillon që nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor, pra janë 12 muaj. Prandaj, mendoj se është mirë që të caktohet se në çmuaj do të hyjë në shfrytëzim linja ose reparti.

Që ka afate në përgjithësi dihet, por sjala është që ato të caktohen më saktë dhe të respektohen. Konkrektisht, dua të di nëse kjo linjë, ky repart apo kjo fabrikë do të mbarojë në muajin maj të 1978-s apo jo? Se nuk janë të rralla rastet kur afatet nuk respektohen. Por nga kjo ne kemi humbje ekonomike. Çështja shtrohet që afatet duhet të zbatohen. Por a kontrollohet apo nuk kontrollohet respektimi i tyre? «Po ka disa arsy, kështu e ashtu... thonë, prandaj, objektin do ta vëmë në shfrytëzim pas pesë muajsh». Jo, kjo nuk duhet lejuar! Të bëhen të gjitha përpjekjet, siç vura në dukje më lart, që objekti të ndërtohet dhe të fulet në prodhim brenda afatit.

Kam edhe një pyetje tjetër: Për këto reparte, linja e fabrika që janë parashikuar të mbarojnë në vitet 1978, 1979, 1980 apo 1981, a është menduar ndonjëherë që të mbarojnë edhe më parë po të ketë

mundësi? Këtë gjë ju duhet ta keni parasysh e t'ua shtroni dhe atyre në bazë, për arsyen e pesëvjeçari tjetër do të jetë i vështirë e, për realizimin e tij do të kërkohet një mobilizim i madh i forcave. Pra, në qoftë se i zvarritim punimet këtu e atje dhe slemë mendjen, duke menduar se do t'i dorëzojmë në ato asate që kemi caktuar dhe s'mendojmë më tej, atëherë planin e ardhshëm pesëvjeçar do ta kemi më të ngjeshur e, si rrjedhim, patjetër që do të duhen më shumë përpjekje e sakrifisica për ta realizuar. Por çështja është që këto sakrifisica e këto përpjekje t'i zvogëlojmë një çikë dhc, që t'i zvogëlojme, duhet të shpejtojmë punimet në objektet e ndryshme të këtij plani. Është fakt që për shpejtimin e këtyre punimeve, ne kemi shumë rezerva. Por vetëm duke thënë se kemi rezerva, nuk dalim asgjëkundi në vah. Mirëpo, po të punohet si duhet, po të shfrytëzoni mirë të gji-tha këto rezerva, atëherë përsitimi do të jetë i madh.

Ja, këtu me të drejtë u bë pyetja: «Përse makinat metalprerëse të oficinave, të bazave mekanike dhe të uzinave në Tiranë të harxhojnë 20-25 për qind të kohës së punës për bulona dhe përsë nuk përqendrohet prodhimi i tyre? Në Kavajë është Uzina e Gozhdë-bulonave, por ajo prodhon kryesisht bulona përndërtim, u tha këtu. Për ta zgjidhur këtë problem, është menduar që atje të ngrihet një repart i ri. Kjo, më duket mua, nuk është gjë kaq e vështirë, se atje nuk kemi të bëjmë me një linjë, por me një uzinë të madhe, ku punojnë tërë ata punëtorë e specialistë me eksperiencë të gjatë pune. Atëherë, pse zvarritet ngri-tja e këtij reparti me atë uzinë kur ai mund të ngrihet

për një kohë shumë të shkurtër? «Po kam planin unë», mund të thotë drejtori i uzinës. Por, le të dërgojmë atje një grup kontrolli punëtor e një grup inxhinierësh nga më të mirët për të parë sa shfrytëzohet tectorëshi. Të shohim gjithashtu se sa specialistë e sa inxhinierë ka e me se merren. Pasi t'i bëjmë mirë llogaritë me laps në dorë, atëherë, duke u mbështetur në këto të dhëna, u themi atyre të uzinës: «Ju mund ta realizoni planin me kaq punëtorë e specialistë. Këta të tjerët t'i futen punës për ngrijtjen e linjës së bulonave e ta ngrenë atë sa më parë. Dhe, kur të vihet në punë ajo, menjëherë, të tëra ato uzina të tjera të mos prodhojnë më bulona.»

Kështu, them unë, duhet bërë, ndryshe nuk dilet në breg. Kjo është tamam si në luftë. Në qoftë se bën një lëshim sado të vogël në kohën e luftës, të kushton shumë rëndë. Edhe në këto punë, është e njëjta gjë: po e zvarrite zgjidhjen e problemeve, po nuk more masa që secila prej tyre të mbarojë jo vetëm në afatin e caktuar, por sa më parë që të jetë e mundur, atëherë do të ketë dhe pasoja në ekonomi. Sot i kemi të gjitha mundësitë për projektimin dhe ndërtimin e fabrikave e të linjave të reja, se kemi jo vetëm fuqi punëtore, por edhe inxhinierë e specialistë, bile, nganjëherë, na thonë që inxhinierë mekanikë ka shumë. Aq më mirë, atëherë, ne gëzohemi për këtë, por ama edhe punët duhet të na ecin më mirë.

Por që të arrihet kjo, tërë këta punëtorë, inxhinierë e specialistë duhen vënë mirë në punë. Krahas kësaj, edhe t'u kërkosh llogari për punçn e ngarkuar.

E them këtë se disa nisen nga mendimi që kjo fabrikë apo linjë është caktuar të përfundojë në këtë apo në atë kohë dhe punojnë për ngritjen e saj qetë-qetë, pa u thelluar për avancimin e asfatit. Por Komiteti Qendror bën thirrje që këto afate e këto plane të tejkalohen. Mirëpo, ç'ngjet në realitet shpeshherë? Objektet jo vetëm që nuk vihen në shfrytëzim para asfatit të caktuar, po kalohet edhe ai i parashikuari në plan dhe jo me një muaj e dy, por me nga 8 e nga 9 muaj, bile edhe një vit. Kjo është e keqja. Këto ndodhin për arsy se ata që janë caktuar të punojnë për këtë linjë apo fabrikë punojnë, fjala vjen, nga 5 apo nga 6 orë ditën dhe dy-tri orët e tjera pinë cigare e bëjnë muhabet, dhc, jo rastësisht, vëmë re se veprimtarinë e përditshme, në shumë ndërmarrje e institucionë e karakterizon një punë e fjetur, rutinë që i ka të gjitha sëmundjet. Pse? Sepse nuk ka nxitje për veprime të avancuara revolucionare. Prandaj edhe ka ngjarë që diku të ngrihet një drejtues i ndërmarrjes e të tholë: «Nuk e realizova planin për arsy se më mungonte kjo apo ajo, se lënda e parë nuk më erdhi në kohë» etj., etj. Mirë, po ti, si drejtues i ndërmarrjes, ç'bëre? Ti duhet të përpinqeshe në maksimum që puna të mos pengohc, të çaje murin me kokë, siç i thonë një fjale.

Pra, të mos mjaftohemi me punën që bëjmë në fillim të pesëvjeçarit për hartimin e planit e për caktimin e objekteve që do të ndërtohen gjatë kësaj kohe. Pas kësaj, rëndësi të madhe ka ndjekja e realizimit të tyre. Por, që kjo gjë të bëhet mirë, duhet

të vërtetojmë me studime e me vëzhgime se këto afate që kemi caktuar, mund të kapërcehen. Një gjë e tillë është e mundur të bëhet, po të mobilizohen më shumë njerëzit, të përdoren më me nikoqirillëk materialet që disponohen e të ngrihet më lart rendimenti i punës. Pasi të bëhen të gjitha këto, mund të arrihet në disa konkluzione krejt të ndryshme, më të avancuara nga ato që kemi caktuar në fillim të vitit apo të pesëvjeçarit.

Këto probleme që po diskutojmë duhet të bëhen objekt studimi për shokët e Komisionit të Planit të Shtetit e të Ministrisë së Industrisë e të Minierave, prandaj të thellohem në to, duke lënë mënjanë cikërrimat. Ja konkretisht: kur do të arrijë pularia e Elbasanit të japë sipas kapacitetit që ka? «Ka disa defekte» u tha këtu. Po pse, xhanëm, duhet të ketë defekte, ose pse nuk merren masa me kohë për ndreçjen e tyre. Kërkesat për vezë vijnë në rritje. Populli do vezë. Prandaj defektet të ndraqen sa më parë që pularia të vihet në funksionim dhe të japë prodhim aq sa ka kapacitetin, bile edhe ta tejkalojë, sepse eksperiencë në këtë drejtim kemi.

Unë nuk them që të gjithë shokët të merren përditë vetëm me këtë çështje, por që interesimi i tyre të jetë i vazhdueshëm e me probleme të caktuara. Kështu, për shembull, studimi i një problemi mund t'i ngarkohet këtij komisioni apo këtij sektori dhe ky duhet t'i vejë punës deri në fund.

Të kuptohet thellë nga të gjithë se është e domosdoshme që punimet për ngritjen e linjave e të

fabrikave të reja, të shpejtohen kudo, në mënyrë që  
të gjitha ato të futen sa më parë në prodhim.

*Botohet për herë të parë si-  
pas tekstit të nxjerrë nga  
procesverbali i mbledhjes së  
Sekretariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# **DISA MENDIME PËR KONGRESIN E 11-TË TË LIDHJES SË KOMUNISTËVE TË JUGOSLLAVISË**

**Shënim**

**22 qershor 1978**

Kongresi i 11-të i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i filloi punimet e tij më 20 qershor. Në këtë kongres, në qoftë se nuk gabohem, merrnin pjesë 2 000 e ca delegatë. Përveç delegatëve, në kongres merrnin pjesë 1 000 gazetarë, të ftuar të tjerë sa të duash dhe gjithë përsaqësuesit diplomatikë të akredituar në Beograd me përjashtim të përsaqësuesve shqiptarë, vietnamezë, kubanë dhe kinezë. Megjithatë Komite-i Qendror i Partisë Komuniste të Kinës i kishte dërguar këtij kongresi një telegram të zjarrtë pëershëndetjeje.

Me fjalë të tjera, ky kongres ishte një «panair», një panair i madh, që nuk u ngjan panaireve të zakonshme, që bëhen në qytete të ndryshme të botës, panaireve të veglave bujqësore, panaireve ekonomike, tregtare etj. Jo, ky ishte një panair i veçantë që u përngjet atyre panaireve, që në gjuhën frëngje quhen foire, ku kushdo, me para apo pa para, mund të hyjë. Këto lloj panairesh bëhen nëpër sheshe dhe

esplanade ku shiten çfarëdolloj plaçkash, që francezët i quajnë *camelote*, domethënë plaçka pa vlerë. Aty, që të shiten këto vjeturina e mbeturina të ndryshme, del ndonjë njeri që mban «fjalime», mburr mallin e tij të vjetër, të krimbur e bën pazarllqe. Të tjerë më tutje bëjnë fokuse, ca luajnë kumar me letra, disa të tjerë qëllojnë me pushkë në stande, e rrëzojnë ato që u thonë «kokë turku» dhe marrin nga një shishe verë, që është treçerek ujë dhe një çerek bojë e kuqe, ose nga një kukull, osc ndonjë stilolaps. Të tilla janë këto panaire. Pastaj, në to ka një zhurmë shurdhuese që shkaktohet jo vetëm nga reklama boshe, pa kripë e shitësve llafazanë që duan të shesin vjetërsirat e tyre, por edhe nga disqet muzikore që dëgjohen nga standa e cilitdo që ka paguar vendin dhe ka ngritur një barakë në sheshin ku bëhet ky panair.

Me një panair të tillë mund ta krahasojmë këtë kongres të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Natyrisht, kasneci kryesor i këtij «panairi» ishte Josip Broz Titoja, i cili filloi t'i shesë *les camelotes*, plaçkat e tij të ndyra, me fjalë të tjera, «teoritë» e tij antimarksiste dhe kapitaliste të falimentuara. Por kasneci i këtij «panairi» ka edhe një meritë dhe kjo konsiston në atë që ai ka mundur të rrojë mirë për vete, të hajë e të pijë në pallatet që ka ndërtuar dhe të arrijë moshën 86 vjeç. Kështu që këtij kasneci të këtyre teorive false, të veshur me rroba të shkëlqyeshme të bardha, i mungonin vetëm dekoratat se, po të fillonte t'i vinte, ato jo vetëm që do t'ia mbulonin krejtësisht gjoksin, por ca prej tyre do t'i duhej t'i varte edhe në pantallona.

Edhe muzika nuk mungoi. Në hapjen e këtij «panairi», me keqardhje duhet thënë se u këndua edhe himni i lavdishëm i klasës punëtore, i proletariatit botëror, «Internacionalja», megjithëse titistët e kanë flakur atë tej. Internacionizmi i titistëve konsiston në kozmopolitizmin, në përhapjen e ideve tradhtare që kanë për qëllim robërimin e popujve nën sundimin e kapitalizmit.

Ajo që të binte në sy e të bënte përshtypje përnjëherë në këtë «panair» ishte se përrallat e Titos dëgjoheshin me mërzi, se ato ishin përralla të njohura e të përsëritura kushedi sa herë. Kur lexon raportin e mbajtur nga Titoja përgjithësish të krijohet me të vërtetë një përshtypje mizerabël, por një gjë e tillë vihej re dhe në emisionet e televizionit jugosllav, në fytyrat e atyre që e dëgjonin këtë gjel të rrjepur, të cilit i merrej goja dhe thoshte banalitetë që i ka përsëritur për vite me radhë. Të gjitha ishin gjëra të përgjithshme, asgjë të re nuk kishte, gjëra me dy-tri kuptime, me të cilat mund të qëndrosh në të njëjtën kohë jo në dy, por në dhjetë karrige.

Në fytyrat e diplomatëve, kur sliste Josip Broz Titoja në këtë të ashtuquajtur kongres të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, dukej një indiferentizëm i madh, kurse delegacionet, që janë 160 gjithsej dhe që përfaqësojnë lloj-lloj partish, disa dëgjonin me vërejtje, disa të tjerë bënин muhabet e s'çanin kokën fare për ato që përralliste Titoja. Edhe duartrokositje nga pjesëmarrësit në kongres kishte pak. E për çfarë të duartrokitin? Asgjë të re s'kishte në raportin e

Titos, atje nuk ekziston as unitet mendimi, as unitet veprimi, pavarësisht se Titoja e theksoi një gjë të tillë. Duartrokositje frenetike pati në sallën e kongresit, kur Titoja tha se nuk do ta lexonte të tërë raportin, vëçse një shkurtim, disa pjesë të tij. Atëherë, po, me të vërtetë pati duartrokositje. Me këtë spektatorët e «panairit» donin t'i thoshin: «Mirë ke menduar, sepse do të na mërzitësh, nuk të dëgjojmë dot».

Kjo ishte karakteristika e përgjithshme e këtij kongresi panair, për të cilin propaganda jugosllave, duke dashur t'i bëjë bujë të madhe, fitoi të kundërtën, domethënë fitoi pikërisht atë që ky kongres ishte me të vërtetë një panair, me shumë lloj njerëzish, me lloj-lloj mendimesh e lloj-lloj ngjyra fytyrash, me lloj-lloj veshjesh, me fjalë të tjera, ishte një kariaturë mendimesh, njerëzish dhe qëndrimesh.

Një kongres të tillë, ose një panair të tillë, natyrisht, jugosllavët nuk mund ta bënin në një vend sidokudo, por në Beograd, dhe për t'i dhënë famë atij, si dhe herët e tjera, e bënë në pallatin «Sava». Në atë ndërtesë janë bërë mbledhjet e konferencës për «sigurimin evropian», mbledhjet e «vendeve të paangazhuara» që i udhëheq vëlë Titoja dhe Jugosllavia. Kongresi, pra, u vendos të mbahej atje ku janë bërë mbledhje të tillë ku blihen e shiten vende dhe popuj. Këto lloj mbledhjesh, domosdo, duhet të bëhen edhe në një pallat madhështor. Ky është pallati «Sava» që, sipas Radio Beogradit, u ka kushtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës 16 e ca milionë dollarë e, sipas TANJUG-ut, është nga më modernët në Evropë.

Kështu të gjitha masat ishin marrë që ky kongres të ishte kongresi i hedhjes hi syve popujve, që nuk flenë. Ai u bë me një pompozitet banal dhe me një përbajtje qesharake pa ideologji realiste, pale marksiste-leniniste që as mund të bëhet fjalë, pa një politikë të përcaktuar. E tërë përbajtja e raportit ishte një përrallë e shthurur, tamam siç janë në realitet mendimet e veprimet anarkosindikaliste të Titos, të titizmit dhe të shtetit pseudosocialist jugosllav.

Në bazë të të dhënave të agjencisë jugosllave të lajmeve, TANJUG, Titoja, siç thashë më sipër, nuk e lexoi të gjithë raportin, por pjesërisht dhe për këtë ai u duartrokit nga ata që merrnin pjesë në këtë kongres. Kështu, mërzia që do të shkaktohej, po të lexohet i tërë raporti, si të thuash, u zvogëluar. Por, të marra nga ana konkrete, ato që tha Titoja janë kuintesanca e gjithë mendimit dhe veprimit titist. Me fjalë të tjera, ato shprehin gjithë vijën e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Pra, pjesët e raportit që lexoi Titoja dha që i transmetoi agjencia TANJUG janë konsideruar kryesoret, të tjerat, pjesët e lëna jashtë, janë anësore, të parëndësishme ose fletë fiku. Natyrisht, ky koment i shkurtër e i shpejtë që unë po u bëj thënieve të Titos, të këtij renegati të marksizëm-leninizmit, është i bazuar në atë çka thashë më lart, në versionin e shkurtër të raportit, por kur të kem kohë, gjatë pushimeve, mund t'i hedh një sy edhe tërë fjalimit të tij. Sido që e di që do të më hajë kohë, megjithatë, mendoj se ia vlen barra qiranë ta lexoj të tcrë ra-

portin e Titos për të parë si i shtron ai edhe çështjet sekondare.

Në këtë kongres, të cilit tilistët jugosllavë i dhanë bujë kaq të madhe, u mbajt vetëm një raport, domethënë nuk reportoi njeri tjetër veç Titos. Ai u vendos në këtë kongres si shpirtalla e gjithë veprimtarisë së keqe të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ose, po të përdorim fjalë adaptë për jugosllavët, Titoja, në pragun e vdekjes së tij, donte të asfromohej si një udhëheqës legjendar i Jugosllavisë, i cili ka bërë atje ligjin. E çfarë ligji ka bërë Titoja për 40 e ca vjet me radhë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që tash quhet Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, pra në këtë parti, që törë jetën e saj nuk ka qenë një parti komuniste e vërtetë, por një parti me plot rryma deviacioniste, që më vonë u shndërrua në një aneks të sigurimit të shtetit jugosllav, UDB-së? Ç'rol ka luajtur Titoja në këtë parti që në një moment u fsheh dhe ia la vendin Frontit Popullor të Jugosllavisë, i cili përbniblidhte të gjitha shtresat e të gjitha botëkuptimet politike dhe ideologjike që përplaseshin në Jugosllavi? Më vonë, pas njësafë eksperience të keqë, Titoja dhe shokët e tij ia kthyen plotësisht turirin 180 gradë kësaj partie dhe në fakt e likuiduan krejtësisht duke i lënë një rol fare të parëndësishëm, pa asnjë efekt në realitet. Më vonë akoma, pavarësisht se Partia Komuniste e Jugosllavisë formalisht ekzistonte, ajo ishte si një organizatë amorfë, jovepruese, jolustarake. Por, kur në këtë parti, që po kthehej në një grup inekzistues, përsëri u paraqit rreziku nga serbomëdhenjtë dhe nga mbeturinat ran-

koviçiane, atëherë Titoja bëri prapë një kthesë, si të thuash, liberalo-dogmatike, liberale në brendi, dogmatike në sipërsaqe, derisa të likuidonte kundërshëtarët e tij.

Titoja, pra, dha vijën në këtë kongres para vdekjes së tij. Po çfarë vije? Pikërisht këtë duhet të analizojmë ne, natyrisht, në bazë të raportit të tij të shkurtuar. Por kjo s'ka rëndësi, se njësoj është si të analizosh raportin e plotë, apo versionin e shkurtuar, bile ky i fundit është më i qartë për të gjithë, se drurët e shtrembër, kur nuk ekzistojnë fletët e degëve të tyre, duken më mirë. Edhe «druri» atje është shtrembëruar dhe është tharë, edhe fletët i kanë rënë, ashtu siç do të bien një ditë edhe Titoja dhe titizmi.

Në përgjithësi, e theksoj, raporti i Titos, mbajtur në Kongresin e 11-të, pra vija e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, nuk ka asnje bazë teorike të qartë e të përcaktuar. Ky raport është pasqyrimi më ekzakt i bisedimeve të përditshme që bën Titoja me lloj-lloj njerëzish, natyrisht me njerëz të kalibrit «të madh», të cilët ia kanë rritur mendjen aq tepër, saqë ai vetë ka arritur në konkluzionin se muhabetet e llogjet për politikën e përgjithshme dhe për koniunkturat në botë përbëjnë një thesar të madh, që ky goxha njeri, «me kokë të madhe», na e përpuno ka dhe na nxjerrka një «gjellë», të cilën, në mënyrën e vet, përpinqet që t'ua servirë gjithë atyre që kanë oreks ta hanë dhe t'i këndojnë hosanara pa baza këtij kuzhinieri të falimentuar.

Por, në fakt, psedokonkluzionet ose formulimet, që gjoja Titoja nxjerr nga evenimentet që ngjasin në

botë, nuk janë veçse fragmentare, të paqëndrueshme, pa kurrfarë baze teorike dhe vazhdimisht të ndryshueshme si njyra e kameleonit.

Në se konsistonjë vijat kryesore të ideologjisë titiste? Ç'të lexosh në raportin e Titos! Çdo gjë është për të vënë duart në kokë. Titoja, në vija të përgjithshme, thotë se ekzistojnë bloqe, ose grupime ushtarake shtetesh, nga njëra anë NATO-ja, nga ana tjetër Traktati i Varshavës. Ky është një realitet, por pse ekzistojnë këto dy grupime ushtarake? Pikërisht kësaj çështjeje as nuk i futet Titoja, se, po t'i futej, atëherë do të dilnin në shesh qëndrimet e vërteta të tij. Mirëpo Titoja qëndron në dy karrige, ose, siç pretendon ai, në një karrige «asnjanëse», gjoja në kundërshtim me njërin dhe me tjetrin. Dhe ky qëndrim na quhet «qëndrim i paangazhuar». Ky është «deduksion i madh teorik» i këtij mburraveci, ose i një *discoureur dans une foire aux puces!*

Pra si konkluzion «i thellë» del që, nëse ekzistonjë vende të angazhuara me pakte ushtarake, ekzistojnë edhe «vende të paangazhuara», të cilat janë të organizuara dhe udhëhiqen nga Beograd, nga Titoja, që e ka vënë veten në krye të tyre.

Tash unë nuk do të analizoju se ç'brendi ideologjike, politike dhe organizative ka kjo farë bote e paangazhuar, por dua të theksoj se kjo është ajo pseudoteori, ku mbështetet dhe me të cilën reklamohet ky renegat.

---

1. Frëngjisht — ai që mburr mallin e vet me zë të lartë në një pazar plaçkurinash.

Çështja tjetër që ngre Titoja në raportin e tij është se pasuritë e botës nuk janë ndarë mirë. Prandaj, vë në dukje ai, shtetet e pasura duhet të ndihmojnë ato më të varfrat ekonomikisht, se, sa për vole të tij, Titoja ka marrë ndihma kolosale nga kapitalizmi botëror për shërbimin e madh që i ka bërë dhe vazhdon t'i bëjë për kaq dekada me radhë. Kjo është njëra *dada* e Titos që do të thotë shumë gjëra, por që s'thotë asgjë. Le të grijë ai sa të dojë për ndihmën që shtetet e pasura duhet t'u japid vendeve të varfra. Kapitalizmi dhe imperializmi botëror nuk u japid asgjë popujve që vuajnë e shteteve të varfra, përvçese kërbaçit, robërisë, luftës dhe shtypjes së egër barbare.

Dadaja tjetër, ose kënga e përhershme e imperializmit, e shteteve të mëdha kapitaliste dhe e Titos së toku, është problemi i çarmatimit. Titoja bën thirrje «për çarmatim të plotë e të përgjithshëm». Të tërë, kapitalistë, imperialistë e revizionistë, duke e konsideruar këtë si një nga problemet më të rëndësishme që është i lidhur ngushtë me çështjet e paqes e të sigurimit ndërkombëtar, cirren për çarmatim, kurse, në fakt, të tërë po armatosen. Të gjitha këto shtete që gjoja janë për çarmatim, janë bërë tregtarë të arinëve dhe Jugosllavia titiste është bërë një nga blerësit kryesorë të këtyre armëve të ndryshme, natyrisht, me kredi, por edhe falas. Pra, ky kasnec i imperializmit amerikan, i revizionizmit sovjetik dhe i gjithë kapitalizmit botëror, flet «për çarmatin», por flet me një «seriozitet» që s'bind njeri.

Titoja, gjithashtu, nuk harron t'u bëjë thirrje të

dyja superfuqive që të bien në bisedime, të merren vesh me njëra-tjetrën. Kuptohet qartë se sa pa themel janë të gjitha këto thirrje, ose më mirë të themi muhabete që Josip Broz Titoja i bën nga të katër anët e botës, ku ka bredhur, ku ka marrë dekorata, ku ka ngrënë e ka marrë kredi. Prej këtej ky renegat ka arritur në një mendim të tillë se bota vjen rrrotull Kërthizës së tij dhe këto sloganë, që ai lëshon si patë keq, janë mendime të thella teorike e politike që vërtitin shoqërinë njerëzore. Sipas këtij renegati bota ecën në rrugën e socializmit, të gjitha «vendet e pa-angazhuara» janë futur në socializëm. «Teoria» e Titos «shpjegon» që vajtja në socializëm nuk mund të realizohet në bazë të teorisë së Marksit dhe të Leninit, të teorisë e të veprimit revolucionar, por në përmjet reformave. Dhe reformat për Titon janë muhabetet boshe, janë muhabetet që e largojnë revolucionin apo që duan ta fikin atë, që bëjnë të gënjehen popujt se gjoja me diskure, me votime, ose me një lëmoshë që mund t'u hedhin, të arrijnë në konkluzionin se kanë fituar të drejtën e vëlvendosjes, të mosangazhimit, se gjoja këta popuj e këto shtete po ngjitin me sukses njëra pas tjetrës shkallët drejt socializmit, duke pasur në krye Mobutun dhe gjithë kapitalistët e tjerrë reaksionarë.

Po përsë duhet të mendojë ndryshe Titoja në Jugosllavi? Ai nën këtë fasadë po ndërloton kapitalizmin, po krijon një shtresë kapitaliste të fortë dhe një pushtet kapitalist të drejtuar nga një klikë të borgje-zuarish nga koka e nga xhepi. Prandaj ky sharlatan, ky antimarksist, ky antidemokrat, regjimin dhe pl-

këpamjet e tij kërkon t'i shesë tek të tjerët, që janë si edhe ai, si një ecje drejt socializmit. «Vendet e pa-angazhuara», vendet e «botës së tretë» të miqve të tyre kinezë ose të «botës në zhvillim», të mikut të Titos, Çauheskut, të gjitha së toku, sipas tij, përbëjnë atë forcë kolosale revolucionare që do të përmbyshë kapitalizmin dhe do ta çojë botën në socializëm dhe në komunizëm.

Këto edhe një varg çështjesh të tjera të tilla përbëjnë atë pseudoteori që Titoja zhvilloi në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ai foli edhe për partinë, zuri në gojë edhe internacionalismin. Por për çfarë partie foli ai, mos vallë për një parti marksiste-leniniste e revolucionare? Jo, ai theksoi se duhet demokratizuar në shkallë të gjerë partia. Por, pavarësisht se tha që në gjirin e kësaj pseudopartie marksiste jugosllave ekziston centralizmi demokratik, domethënë që pakica i nënshtronhet shumicës, pavarësisht se me fraza ai u shpreh se brenda në partinë e tij lejohen të shfaqen mendimet hapur për ato probleme që diskutohet, se lejohen të ekzistojnë edhe pakica, të gjitha këto janë parulla boshe, sepse kundërshtarët po të flasin hapur futen në burg, internohen e pushkatohen. Këtë gjë Titoja po e bën çdo ditë në Jugosllavi. Ndaj kjo që thotë tash Titoja është një fasadë e rreme që ai përpinqet t'ia veshë Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Por Titos i duhet të flasë në këtë mënyrë për arsy se ai do që të shkëputet një herë e mirë nga teoria marksiste-leniniste. Për të Marks, Engelsi dhe Lenini kanë vdekur, megjithëse në raportin e tij në

këtë kongres nuk harroi të theksonte «domosdoshmërinë për të studiuar intensivisht krijimtarinë revolucionare dhe mendimin teorik të Marksit, Engelsit dhe Leninit, për të ndjekur studimet marksiste të kohës në botë». Teoria dhe praktika e revolucionit dhe ndërtimi i socializmit, sipas marksizëm-leninizmit, nuk kanë qenë dhe nuk janë kurrë të pranueshme nga Titoja, ato nuk mund të pranohen kurrë nga revizionizmi modern dhe nga socialdemokracia.

Të gjitha rrymat antimarksiste, që janë ose nuk janë në fuqi, teorinë dhe praktikën e revolucionit sipas mësimave të Marksit dhe të Leninit, i luftojnë me të gjitha mjetet, prandaj Titoja në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u paraqit si përkrahës i të gjitha rrymave pseudomarksiste, si përkrahës i eurokomunizmit e i çfarëdolloj rryme e partie që ka në programin e vet, qoftë edhe formal, disa shenja që të çojnë në të ashtuquajturën demokraci ose përparim. Pra Titoja s'doli si përkrahës i pluralizmit në vendin e tij, por kudo në vendet e tjera. Ai predikoi pluralizmin dhe ngriti kapelën përra para këtyre varianteve të ndryshme të ndërtimit të socializmit ose pikëpamjeve të ndryshme të pseudokomunistëve, të cilët e shikojnë dhe duhet ta shikojnë, sipas Titos, zhvillimin në kushtet konkrete të vendit të tyre. Me një fjalë, ata duhet t'u adaptohen kapitalizmit dhe reformizmit borgjez anarkosindikalist, fashist të maskuar etj.

Është pikërisht për këtë vijë e për këto pikëpamje që predikoi Titoja që Kongresi i 11-të i tij mori tamam pamjen dhe përbajtjen e një panairi, ku ki-

shin ardhur delegacione të partive të ndryshme nga të katër anët e globit tokësor. Të kuptohemi, kishte edhe ndonjë vend që nuk përsaqësohej në kongres nga një parti e veçme, por nga 4-5 parti dhe të katër apo të pesë partitë janë ideologjikisht dhe politikisht të pranueshme për Titon, për këtë pseudomarksist. Me këtë vijë që ndjek Titoja kërkon t'i tregojë botës se Jugosllavia po bëhet qendra e një socializmi të vërtetë me sytyrë demokratike dhe është një vend ku konvergojnë të gjitha rrymat progresive. Pavarësisht se Titoja flet «për mundësinë e çdo përvoje specifike historike pér të pasur një vlerë të përgjithshme», pra. se nuk duhet të ketë një qendër të vetme të drejtimit pér lëvizjen punëtore, ai, në fakt, e konsideron Jugosllavinë si një qendër të lëvizjes punëtore botërore, qendër që ia kalon edhe Mosküs. Prandaj agjencitë e lajmeve njostojnë se, kur fliste Titoja në këtë kongres, Kulakovi, anëtar i byrosë politike dhe sekretar i KQ që kryesonte delegacionin e Partisë Komuniste revolucioniste të Bashkimit Sovjetik, shfryntë dhe i binte bankës i nevrikosur me kalemin e tij.

Tash t'i shikojmë një çikë më konkretisht këto probleme që trajtohen në raportin e Titos, që, në mënyrë të përgjithshme, i theksova më lart, por t'i marrim një nga një, ashtu siç i ka lexuar Titoja dhe siç i ka paraqitur agjencia shtetërore jugosllave TANJUG.

Titoja tha: «Jugosllavia socialiste, e vëtadministruar dhe e paangazhuar, qëndron në baza të forta dhe të shëndosha, të cilat janë shtyllat e sigurta të së ardhmes së saj». Në fakt realiteti qëndron ndryshe.

Jugosllavia është një mozaik popujsh dhe, përvçë kësaj, në këta popuj është e zhvilluar ndjenja e nacionallizmit dhe e shovinizmit. Këto tendenca në Federatën Jugosllave janë jo vetëm në disharmoni, por edhe në kundërshtim të ashpër njëra me tjetrën, prandaj, pas vdekjes së Titos, gjithsej cilë prej tyre do të përpinqet të dominojë mbi të tjerët. Serbomëdhenjtë, për shembull, do të luftojnë të dominojnë jo vetëm mbi shqiptarët, mbi malazostë, mbi maqedonasit, mbi bosnjakët, por edhe mbi sllovenët, mbi kroatët etj.

Në mënyrë të vetvetishme, i ashtuquajturi regjim socialist vetadministrues e ka krijuar një situatë të tillë të lëkundshme dhe aspak të qëndrueshme në Jugosllavi. Aktualisht, edhe tash që Titoja jeton, këto tendenca ekzistojnë të theksuara në Federatën Jugosllave, për arsy se Jugosllavia nuk është një vend socialist, por një vend kapitalist, që gjoja është i vet-administruar. Me fjalë të tjera, njeriu, të cilin jugosllavët e «kanë ngritur në piedestal», në fakt, është skllav i një shoqërie të re kapitaliste, e cila ekziston në shumë qendra jugosllave. Ekzistencë e këtyre qendrave me tendenca centrifugale e bën Jugosllavinë pseudosocialiste një vend jo të sigurt dhe aspak të qëndrueshëm.

Këto nuk mund të janë spekulime, siç pretendon Titoja, por janë fakte të vërtetuar nga zhvillimi ekonomiko-politik dhe organizativ i Jugosllavisë. Këtë e shpjegon vetë gjendja aktuale jugosllave nga çdo pikëpamje. Në qoftë se shikohet në Jugosllavi njëfarë uniteti në Federatë, ky unitet është fiktiv, i mbajtur në këmbë për interesat imediatë. Por në të

ardhmen në Jugosllavi do të ketë friksione dhe fraksione të thella, pavarësisht se diku në këtë raport Titoja pretendon se në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë ka dhe duhet të ketë centralizëm demokratik, përndryshe i hapet rrugë fraksionizmit. Në Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që aktualisht quhet Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, fraksionizmi ka mbretëruar kurdohçrë dhe fraksioni që ka pasur fuqinë në dorë ka marrë masa të rrepta dhe të egra kundër fraksioneve të tjera. Me një fjalë, fraksioni i kryesuar nga Titoja ka qenë dhe është më i fortë; ai ka eliminuar ose i ka tulatur fraksionet e tjera. Pra këto fraksione, që kanë ekzistuar dhc ekzistojnë edhe sot, i jepin trajtën Jugosllavisë aktuale dhe asaj të ardhshme.

Tiloja, në reportin e tij prej 30 000 fjalësh, sipas TANJUG-ut, nënvízoi se «parimi i shumëlojshmërisë së formave të reja në rrugën e ndërtimit të socializmit, është një proces që po fuqizohet dhe që po i kalon kufijtë frenues të shteteve, rajoneve apo bloqeve». Kjo nuk është e vërtetë. Imperializmi dhe kapitalizmi botëror i çdo tipi, qoftë ai amerikan, qoftë socialimperializmi sovjetik, qoftë ai kinez, të gjithë e luftojnë socializmin shkencor, socializmin e vërtetë të ndërtuar në bazë të teorisë marksiste-leniniste, kurse socializmin ala titist ose socializmin që predikojnë eurokomunistët, ata në asnjë mënyrë nuk e kundërshtojnë, përkundrazi bëjnë përpjekje që si e si ta fuitin edhe më shumë nën diktatin e tyre.

Vetëvendosja e popujve të Jugosllavisë, që ngrihet gjoja prej Titos si një parim i madh, është një

blof, sepse popujt nuk mund të vetëvendosin në një vend kapitalist. Është fakt se edhe pas çlirimit të Jugosllavisë popujt e ndryshëm, që luftuan për lirinë e tyre, nuk u lejuan të vetëvendosnin, të vepronin siç dëshironin, por ata u bashkuan me forcë në një Federatë, që u quajt Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë.

Një nga këta popuj, që nuk u la dhe nuk lihet në asnje mënyrë edhe sot e kësaj dite që të vetëvendosë, është popullsia shqiptare prej afro dy milionë banorësh që rron në truallin e vet. Popullsia shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi nga numri e kapërcen popullsinë e Maqedonisë së bashku me atë të Malit të Zi. Prandaj, të pretendosh dhe të luftosh gjoja për vetëvendosjen e popujve të tjerë, kur në vendin tënd dhe me teorinë tënde, gjoja socialiste, nuk e ke krijuar mundësinë dhe nuk e ke lejuar një gjë të tillë, ky, e theksoj përsëri, është një blof.

Titoja, siç e vura në dukje më lart, nuk i trajton problemet teorikisht, vçse konstaton se ekziston, për shembull, shfrytëzimi, duke marrë parasysh shpërndarjen e pasurive botërore nga disa blloqe shtetesh ose shtete të fuqishme. Prandaj ai bën thirrje që kjo shpërndarje të marrë një formë më të mirë. Por se si do ta marrë kjo shpërndarje këtë formë, me ç'forma e me ç'mënyra, ai nuk shprchet për këtë. Po të shprehet, atëherë ai do të dalë në rrugë të kundëri me atë që predikon. Prandaj Titoja vejëm konstaton dhe lulet që diçka të bëhet në këtë drejtim. Kjo që thotë ai për shpërndarjen e pasurive është një tezë e

njohur e Titos, tezë të cilën ai vazhdon ta llojetitë nga të katër anët, kudo që bërdh.

«Marrëdhëniet në lëvizjen punëtore dhe në atë përparimitare në përgjithësi janë të pandashme nga rrymat e sotme botërore», tha presidenti Tito. Edhe për këtë problem duket sikur ka thënë një gjë të madhe, por, në fakt, ai vëtëm konstaton një realitet dhe nuk thotë asnjë fjalë se çfarë duhet të bëjë kjo lëvizje punëtore dhe përparimitare. Natyrisht, ky renegat i marksizmit nuk shprehet, se s'ka se si ta thotë një të vërtetë të domosdoshme, reale, që është revolucioni. Por Titoja shprehu kënaqësinë «për zbatimin gjithnjë e më të madh në praktikë të parimit të bazarisë midis partive dhe lëvizjeve, të pavarësisë së secilës dhe të përgjegjësisë së saj ndaj klasës punëtore, kombit dhe respektimit të parimeve të pavarësisë, mosndërhyrjes dhe marrjes parasysh të ndryshimeve».

C'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që Titoja aprovon gjendjen aktuale në botë, rrymat dhe tendencat e ndryshme, sipas të cilave që të gjithë, edhe fashistët, edhe Pinoçeti, edhe Frankoja dhe regjimet e tyre paraqiten si demokratike dhe përparimitare. Pra të gjitha këto rryma Titoja i fut në një kanal: në kanalin e përparimit dhe ky kanal, sipas tij, lufton për pavarësinë e kombeve, lufton për socializmin. Ky është një absurditet i madh, është një aprovim në realitet i përpjekjeve politike dhe demagogjike të kapitalit botëror. Në këtë mënyrë Titoja përpinqet të mbrojë dhe mbron partitë e ndryshme të borgjezisë, të cilat i shërbjnë kapitalit të çdo vendi. Pra ai pu-

non që ky kapital të riforcohet, të mund të mbajë nën zgjedhë punëtorët dhe të luftojë kundër rivendikimeve politike dhe ekonomike të klasës punëtore për ndryshimin e regjimit kapitalist. Domethënë Titoja është për statukuonë dhe ndihet mjaft i kënaqur që Jugosllavia titiste ka arritur në një gjendje që me të gjitha partitë, të çfarëdolloji që të jenë ato, të mbajë lidhje, të shkëmbejë mendime, të miqësohet, e gjoja të diskutojë për problemet e lëvizjes punëtore përparimtare, por në realitet preokupimi i tij është që puna të ecë mbarë për kapitalizmin nën një formë pseudodemokratike.

Në një paragraf të raportit të mbajtur në kongres gjen një mendim shumë karakteristik të rene-gatit Josip Broz Tito. Ai, vë në dukje TANJUG-u, vlerëson përpjekjet për të imponuar konceptet politike dhe ideologjike për partitë dhe lëvizjet brenda «vendeve të paangazhuara» dhe atyre «në zhvillim» si të tilla që bien në kundërshtim me «interesat jetikë të këtyre vendeve dhe të së drejtës së tyre për të vendosur lirisht rrugën e zhvillimit të tyre». Ma fjalë të tjera, kjo do të thotë që teoria marksiste-le-niniste, që është një armë e fuqishme për shkatërrimin e borgjezisë dhe për ndërtimin e socializmit, është një ideologji ose, si të thuash, një botëkuptimi i papranueshmë nga ana e Titos për t'iu imponuar «vendeve të paangazhuara», dhe atyre «në zhvillim», për t'u treguar rrugën e vërtetë të zhvillimit të tyre. Pra, sipas Titos, del që këto «vende të pazhvilluara» ose duhet të zhvillohen në mënyrë spontane, nën influencën e atyre shteteve të mëdha e të fuqishme

që i kanë të dyja duart brenda këtyre vendeve, ose duhet të qëndrojnë në situatat aktuale pseudodemokratike, të rrojnë me këtë farë pavarësie dhe sovraniteti të rremë që u kanë dhënë kolonialistët e rinj edhe të vjetër. Kështu Titoja ndien një kënaqësi të madhe që këto vende në zhvillim të kullosin në ato ngastra të vogla që u kanë caktuar fuqitë imperialiste dhe kolonialiste.

Sigurisht, në raportin që i paraqitej Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, presidenti «i famshëm» jugosllav nuk mund të mos fliste gjerë e gjatë mbi situatën ndërkombëtare, por trajtimi i këtyre problemeve nga ana e tij ishte më tëpër një numërim i thjeshtë faktesh dhe jo nxjerrja në shesh e faktorëve që i shkaktojnë krizat sot në botë.

Titoja foli për krizën e Lindjes së Mesme, duke thënë se politika e Izraelit na qenka një politikë aggressive dhe ekspansioniste. Ai tha se kriza e Lindjes së Mesme duhet zgjidhur dhe se një gjë e tillë duhet të arrihet me pjesëmarrjen në bisedime edhe të Organizatës për Çlirimin e Palestinës, e cila duhet të sigurojë të drejtat kombëtare të popullit palestinez.

Çfarë tregojnë këto që grin Titoja në këtë të ashtuquajtur kongres? Këto tregojnë dhe vërtetojnë atë që ai është një njeri i shitur tek imperialistët amerikanë, tek ata që Izraelin e kanë bërë veglën e tyre. As që u prishet punë Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo ndonjë fuqie tjeter imperialiste, në rast se bëhen konstatime të tillë të sipërsaqshme, pa u futur në shkaqet e vërteta të këtyre krizave të miëdha, pse Titoja nuk mungoi të fliste edhe për krizën e për-

gjithshme që ka përfshirë tërë botën kapitaliste.

Edhe gjendjes në Afrikë presidenti Tito i dha një «zgjidhje». Siç pretendohet, në raportin që mbajti ai përcakton si «zgjidhje të vetme» të vatrave të rrezikshme zhdukjen e plotë të mbeturinave të fundit të kolonializmit e të racizmit, dhënien e pavarësisë Namibisë e Zimbabvesë dhe zhdukjen e aparteudit në Republikën e Afrikës së Jugut.

Të gjitha këto janë thënë me qindra mijëra herë, prandaj as me një fjalim të Titos në Kongresin e 11-të të partisë së tij nuk shpjegohen dhe nuk zhduken neokolonializmi dhe shtypja e popujve në Afrikë e kudo gjetkë ku sundon kapitali. Por që t'i hyjë këtij problemi e ta analizojë atë nga ana teoriko-politike dhe organizative, këtë gjë nuk e bën Titoja, jo sepse nuk e kupton, por se është e rrezikshme ta bëjë një gjë të tillë, se, fundi i fundit, ai nuk është për një zgjidhje me të vërtetë radikale dhe marksiste-leniniste të kolonializmit. Vetë Jugosllavia e tij është një koloni e kapitalit amerikan dhe e gjithë kapitalit botëror, përderisa në këtë vend janë investuar me miliarda dollarë, e përderisa tri të katërtat e pasurive jugosllave gjenden në duart e bankave dhe të koncerneve të huaja imperialiste.

Titoja hiqet si organizatori dhe udhëheqësi i të ashtuquajturave vende të paangazhuara, prandaj Organizatës së Unitetit Afrikan ai i jep «rëndësi të madhe» dhe rekomandon që parimet e saj të kihen parasysh, të mierren si bazë për zgjidhjen e problemeve në Bririn e Afrikës. Organizata e Unitetit Afrikan i leverdis Titos, kurse organizatat e tjera, të cilat nuk

I përshtaten drejtimit jugosllav, Titoja i quan si faktorë që përcajnjë «lëvizjen e mosangazhimit». Kjo gjë u vu re edhe në fjalën që mbajti në këtë kongres Miniçi, ministri i Jashtëm i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ai atakoi, pa e zënë në gojë, edhe Kirën, e cila predikon teorinë e «botës së tretë». Me teorinë e tyre të «botës së tretë», tha Miniçi, suq të mëdha kërkojnë të imponojnë vullnetin e tyre dhe të përcajnjë «botën e paangazhuar».

Pra, Titoja e mbron tezën e tij skllavëruese për popujt, por nën drejtimin e imperializmit amerikan, jo nën drejtimin e një suqie tjeter imperialiste. Presidenti Tito tregohet shumë i bindur ndaj politikës agresive ekspansioniste dhe neokolonialiste të imperializmit amerikan, se nga ky imperializëm ai ka pasur dhe vazhdon t'i ketë të gjitha ndihmat, qofshin këto ndihma morale, materiale edhe ushtarake në rast nevoje.

Teorisë së tij të «lëvizjes së mosangazhimit» Titoja kërkon t'i japë një konsistencë, një fond të qëndrueshëm, që kjo nuk e ka dhe nuk mund ta ketë kurrë. Ai hiqet sikur lufton të gjithë ata të ashtuquajtur interesa të huaj dhe politikën e blloqeve, të cilat duan që problemet ndërkombëtare, në përgjithësi, si dhe marrëdhëniet midis blloqeve dhe fuqive të mëdha, të influencojnë në kombet e ashtuquajtura të paangazhuara dhe ta përcajnjë këtë lëvizje. Në fakt Titoja dëshiron të lihet i lirë, që ta drejtojë ky këtë farë lëvizjeje në interesin e kapitalit amerikan dhe të atij botëror.

Titoja mendon se «vendet e paangazhuara» kanë

një vitalitet të madh dhe mund të përballojnë të gjitha rreziqet për të mbrojtur unitetin e tyre. Kështu ato mund të realizojnë aspiratat e përbashkëta dhe, sipas tij, të arrihet që gjithsej i tjetri të mbësë një shtet i pavarur revolucionar. Ai nuk mungoi të përmendë konferencën ministrale të «vendeve të paangazhuarë» Beograd, e cila duhet të japë frytë të veçanta gjoja për të kapërcyer vështirësitë e tanishme brenda lëvizjes. Ky është një blos. Asnjë vështirësi nuk po kapërcëhet. E kundërta ngjet në realitet. Në këtë botë të ashtuquajtur të paangazhuar jo vetëm që ka kontradikta të thella midis vetë këtyre vendeve dhe midis tyre e imperializmit, por ka edhe luftëra të armatosura, ka gjakderdhje.

Për sa i përket gjendjes në Evropë, Titoja, vuri në dukje se ekzistojnë situata të paqëndrueshme dhe se problemi i «sigurimit evropian» është një problem me rëndësi të madhe që e duan popujt etj., etj. Që popujt e të gjitha vendeve të këtij kontinenti duan një Evropë pa luftëra, kjo është një e vërtetë, por këtë nuk e dëshirojnë ata që sundojnë mbi popujt. Pastaj që të arrihet ky «sigurimi evropian», natyrisht, duhet të kalojë shumë ujë nën urë, domethënë duhet të zhvillohen mië parë një sërë procesesh revolucionare kundër atyre shteteve evropiane që janë inkuduar në blloqe dhe nuk e lejojnë këtë «sigurimi evropian». Gjithashtu, duhet likuiduar kapitalizmi në përgjithësi në shtetet evropiane që nuk janë në blloqe dhe të vendoset shteti i diktaturës së proletariatit. Vetëm në këto rrethana mund të flitet për një sigurim të vërtetë evropian. Për një sigurim evropian ala

Tito nuk mund të flitet, një gjë e tillë nuk mund të arrihet. Këto që thotë ai janë fjalë boshe sa për të bërë njëfarë pasqyre të përgjithshme të situatës në Evropë.

Por, me gjithë mossuksesin e saj, Titoja tha se është arritur një rezultat i rëndësishëm në procesin e detantës dhe këtë ai e lidh me personin e tij. Natyrisht, Titoja nuk flet për personin e vet, por për Beogradin që ka qenë një nga qendrat ku u bënë të famshmet mbledhje në erë të «sigurimit evropian», ose më saktë të mossigurimit evropian që nuk dhanë asgjë. Si shembull të bashkëpunimit të mirë që duhet ta ndjekë gjithë Evropa, ai përmend Jugosllavinë, e cila është bërë «model i përsosur» i zbatimit me konsekuençë në praktikë të dispozitave të Konferencës së Helsinkit.

C'tregon në realitet kjo që vetë Titoja pohon me gojën e tij? Kjo tregon se regjimi i tij është në bashkëpunim të plotë me të dy blloqet, si me NATO-n ashtu edhe me Traktatin e Varshavës. Nga të dy këto blloqe Titoja përfiton, prandaj Jugosllavia ka marrëdhënie të mira me secilin prej tyre. Atëherë kujt ia rekomandon ai një gjë të tillë? Natyrisht, ua rekomandon dy blloqeve dhe atyre vendeve evropiane që nuk janë futur në to.

Pra, sipas Titos, të dy blloqet duhet të ndjekin atë rrugë që ka ndjekur dhe po ndjek Jugosllavia ndaj tyre. Dhe, për sa i përket mbledhjes së Beogradit, domethënë vazhdimit të Mbledhjes së Helsinkit për «sigurimin evropian», Titoja u bën elozhe të mëdha «vendeve të paangazhuara» për qëndrimin e tyre lidhur

me këtë çështje të rëndësishme. Në fakt ato nuk luajtën asnjë rol në këtë maskaradë, por, që t'i japë një vlerë të madhe Jugosllavisë, që gjoja e udhëheq këtë lëvizje të «vendeve të paangazhuara», Titoja preten don se një qëndrim i tillë ndaj çështjes së sigurimit dhe të bashkëpunimit evropian nuk është vetëm në interesin e shteteve, por edhe në interesin e popujve.

Pra Titoja na del se gjoja interesohet jo për çështjet e shteteve të atyre vendeve të Evropës që bëjnë pjesë në bloqe, por më shumë për çështjet e popujve të Evropës dhe të botës. Domethënë, në një mënyrë false ai ngrë autoritetin e paqenë të mbledhjeve të Helsinkit dhe të Beogradit, si dhe atë të «vendeve të paangazhuara», edhe pse këto shtete nuk përsaqësojnë aspak vullnetin e atyre popujve për të cilët flet Titoja.

Kasneci i Beogradit flet në emër të shtetit të tij dhe u drejtohet shteteve të tjera. Kështu ai njeh plot-fuqishmërinë e shteteve kapitaliste që dominojnë botën. Konkretilisht në vend që ky t'u thotë popujve se çfarë rruge duhet të ndjekin që këto shtete kapitaliste të dobësohen dhe të shkatërrohen për të arritur në një unitet, në një sigurim jo vetëm evropian, por edhe botëror, ai u drejtohet shteteve kapitaliste të Evropës për një bashkëpunim dhe vëllazërim të ngushtë me njëri-tjetrin. Se çfarë është kjo, për të gjithë ne është e qartë. Kjo është një thirrje socialdemokratë, një thirrje e një elementi që i shërben me zell të madh kapitalit botëror.

Nga çështjet e Evropës presidenti jugosllav në raportin e tij hidhet e flet për turbullirat në botë dhe

i numëron ato një e nga një. Ai përmend çështjen e Lindjes së Mesme dhe thotë se Izraeli ndjek një politikë agresive dhe ekspansioniste. Po përcë Izraeli ndjek një politikë të tillë dhe kush është prapa këtij shteti agresiv dhe ekspansionist, këtë Titoja nuk e vë në dukje. Por ai thekson se kjo politikë e Izraelit përcan vendet arabe dhe nuk lejon një zgjidhje të qëndrueshme dhe të drejtë që në fakt kërkohet nga gjithë komuniteti ndërkombëtar.

Sipas Titos, zgjidhja e krizës së Lindjes së Mesme është në dorë të vendeve arabe. Po çfarë duhet të bëjnë këto vende? Të jenë në unitet, thotë Titoja. Por në ç'baza duhet të jetë ky unitet? Kush e krijon unitetin e vërtetë midis vendeve arabe dhe kush e përcan këtë? Në këtë analizë është e zorshme të futet një renegat i marksizëm-leninizmit, sepse ai nuk mund të bëjë një analizë të drejtë klasore të gjendjes shoqërore, politike dhe ekonomike në vendet arabe dhe nuk mund të gjejë kyçin e këtij uniteti.

Titoja, gjithashtu, foli dhe për dy vatrat e turbullta në Afrikën e Jugut. Sipas tij, problemi në këto vende zgjidhet me eliminimin e bastioneve të fundit të kolonializmit dhe të racizmit, domethënë me sigurimin e pavarësisë së Namibisë dhe të Zimbabvesë dhe dhënien fund të apartheidit në Republikën e Afrikës së Jugut. Është fakt që regjimi i Republikës së Afrikës së Jugut është një regjim me të vërtetë reaksionar, por kolonializmi nuk mbaron, siç thotë Titoja, me dhënien e lirisë namibianëve dhe zimbabweve. Kolonializmi është futur thelli në Afrikë, prandaj, për ta zhdukur atë, për të zhdukur shtypjen dhe koncessionet e imperia-

listëve dhe të kapitalistëve të botës duhet të bëhet një qilizinë e thellë në këto vende. Në qostë se duhet bërë një analizë e situatës së vendeve të Afrikës dhe të kolonializmit në këto vende, atëherë kjo duhet të jetë një analizë shkencore, një analizë klasore, ku të preken, kuptohet, të gjitha ato klika që janë të lidhura ngushtë me kolonizatorët e ndryshëm dhe që vazhdojnë të shtypin popujt afrikanë. Mirëpo një tradhtar i marksizëmi-lenismit nuk mund t'i hyjë një analize të tillë.

Titoja i përmend të gjitha ngjarjet që ndodhin në botë, në Evropë, në Azi, në Afrikë etj., etj., për të treguar se është në korent të tyre dhc jep nga një mendim të përgjithshëm se si duhet të jenë këta popuj dhe si duhet të përmirësohet kjo gjendje. Ai nuk e gjen të arsyeshme të futet thellë në trajtimin e këtyre problemeve, për arsyec se gjoja për 40 vjet me radhë ka folur për to.

Po çfarë tha presidenti jugosllav për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për Bashkimin Sovjetik? Asgjë. Ai u bëri thirrje atyre të kapërccjnë gjendjen e tanishme të pakënaqshme në marrëdhëniet midis tyre, domethënë i këshilloi të miqësohen. Kjo gjë, vuri në dukje ai, nuk është vetëm në interesin e tyre, por edhe të të gjithë botës. Pra, Titoja u bën thirrje dashamirësisë dhe zemërgjerësisë së imperializmit amerikan dhc të socialimperializmit sovjetik, që të ulen në bankë dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin më qetë, miqësishët dhe t'i zgjidhin në paqe mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis tyre. Por cilat janë këto mosmarrëveshje, pse ekzistojnë ato, që kërkojnë të bëjnë këto fuqi të mëdha imperialiste? Jo, këto çështje Titoja

nuk mund t'i prekë dhe nuk i prek. Bile ai mundi të theksonte se gjendja e marrëdhënieve midis dy fuqive nuk është si në vitin 1961, kur konferenca e Beogradit e «vendeve të paangazhuara» u bëri thirrje fuqive të mëdha të fillonin bisedimet midis tyre dhe të dobësohej lufta e ftohtë. Kurse në realitet ishte politika oportuniste revizioniste e hrushovianëve që drejttohej drejt miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një miqësi kjo që Bashkimi Sovjetik ua servirte Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të fituar hegemoninë, për të rifituar tregje në botë, për të krijuar perandorinë e tij. Natyrisht, Titoja e ndihmoi Bashkinin Sovjetik të ecët në rrugën që kishte hyrë. Ai ndihmoi gjithashtu edhe imperializmin amerikan të ruante koncesionet që kishte në botë. Pra krijimin e një gjendjeje të tillë Titoja e konsideron si një akt të madh diplomatik që ka bërë ai për ujdinë e këtyre dy supershteteve imperialiste, për pazarllëqet e tyre në kurrizin e popujve.

Përsëri edhe në këtë raport, që i paraqitej Kongresit të 11-të, renegati Tito nuk mungoi të fliste për takimin e nivelit të lartë të «vendeve të paangazhuara» në Kolombo ku gjoja u bënë përpjekje për uljen e tensionit. Në fakt, që prej asaj kohe tensioni në vend që të jetë ulur, është ngritur, veçse Titoja këtë ngritje tensioni e konsideron «ulje» jo vetëm në Evropë, por në të gjithë botën.

Rruga për të dalë nga vështirësitë e tanishme duhet të gjendet, vë në dukje Titoja, por nuk thotë asgjë se si mund të dilet nga këto vështirësi. Titoja thekson besimin e tij në shfrytëzimin, siç pretendon ai, të bi-

sedimeve midis qeverive dhe personaliteteve të larta të shtetit si dypalëshe, ashtu edhe shumëpalëshe. Pra, për Titon, zgjidhja e problemeve ndërkomëtare varet nga personat kryesorë, nga klikat që sundojnë mbi vendet dhe mbi popujt. Me këtë, në fakt, ai e hedh poshtë të gjithë pseudoteorinë e tij të vetadministrit, të ngritjes së rolit të njeriut, të rolit të klasës punëtore etj. Domethënë, Titoja, duke dashur të shpjegojë një problem, rrëzon tezat e falsifikuara që mbron më poshtë. Ekzistojnë, natyrisht, kontradikta të mëdha në thënie gjenerike të tij, për arsyen se këto thënie nuk kanë asnjë bazë të shëndoshë teorike. Tek Titoja nuk mund të gjesh asnjë ide konsekuente të një udhëheqësi borgjez me mendime të qarta e të përcaktuara. Tipike tek Titoja është pikëpamja e një anarkosindikalisti të pafiksuar si duhet në mendimet e tij të ngatërruara dhe të sipërsaqshme.

Duke folur për çështjet ndërkomëtare, presidenti Tito ngre lart rolin e Jugosllavisë dhe politikën e saj të jashtme, këtë politikë ai e cilëson jo vetëm shumë aktive, por edhe konsekuente, të bazuar në parimet e pavarësisë, të sovranitetit, të integritetit territorial, të mosndërhyrjes dhe të së drejtës së çdo vendi e kombi për një zhvillim të pavarur e të tjera, e të tjera profka të tilla.

Politika e Jugosllavisë në realitet është një politikë e varur, një politikë mashtruese, joparimore, një politikë që i çon ata që i besojnë asaj në skllavërim dhe në shfrytëzim nga fuqitë e huaja; është një politikë që kërkon të nxjerrë fitime të majme për Jugosllavinë dhe veçanërisht për klasën sunduese të saj.

E tillë është kjo Jugosllavi e Titos dhe politika që ka ndjekur ajo.

Jugosllavia me politikën e saj nuk ka krijuar besim te popujt. Asnjeri nuk e dëgjon dhe asnjeri nuk ia var asaj. Jugosllavia e Titos dhe personalisht Titoja është vetëm një proksenet, që shkon andej e këtej, që flet e llomotit, që bën llogje pa bukë dhe ndërmjetëson te njëri e tek tjetri, duke çuar llafet e njërit tek tjetri dhe duke kërkuar lëmoshë nga fuqitë e mëdha për veten e tij, në radhë të parë, por edhe për të tjerët. Me fjalë të tjera; Titoja me politikën e tij është një transmetues i vullnetit të atyre që e paguajnë.

Titoja vuri në dukje shkëmbimet e mendimeve që po zgjerohen vazhdimisht midis Jugosllavisë dhe personalitetev kryesore shtetërore (dhe këtu qëndron gjithë politika e Jugosllavisë: në marrëdhëniet me personalitetet kryesore shtetërore dhe qeveritare) dhe marrjen shpeshherë parasysh të mendimit të Jugosllavisë. Pse, pyet Titoja, merret parasysh mendimi i Jugosllavisë? Për arsyen, thotë ai, se ata kanë «respekt për përvojën e madhe» të këtij vendi lidhur me trajtimin e çështjeve kryesore; në vend që të thotë se kanë një respekt të madh për shërbimet që shërbëtori i bën zojnisi.

Me vendet «socialiste» ai tha se Jugosllavia ka marrëdhënie të mira dhe të frytshme. Kurdoherë Jugosllavia ka pasur marrëdhënie të mira me këto vende, sido që Titoja, si agjent i amerikanëve dhe i anglezëve, është përpjekur dhe përpinqet që këto vende t'i futë në suazën e dy padronëve ose të shumë padro-

nëve të tij kapitalistë dhe t'i shkëputë nga tutela dhe shfrytëzimi i socialimperializmit sovjetik. Në këtë rrugë, natyrisht, Titoja nxjerr fitime për veten e tij, qoftë nga imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, qoftë edhe nga vetë këto vende të ashtuquajtura socialiste, të cilat duan të dalin nga zgjedha e socialimperializmit rus dhe të futen më shpejt në lidhje më të ngushëta me imperializmin amerikan apo kapitalistë të tjerë.

Titoja foli, gjithashtu, dhe për marrëdhëniet jugosllave me fqinjët e saj. Si i paraqiti këto marrëdhënie ai në këtë raport? Të mira dhe dashamirëse nga ana e Jugosllavisë. Por fakt është që jo vetëm me Shqipërinë por as me Bullgarinë, as me Greqinë, as me Hungarinë këto marrëdhënie nuk janë ashtu siç thotë Titoja. Midis Jugosllavisë dhe këtyre shteteve, ka mosmarrëvshje, bile të mëdha. Për sa u përket marrëdhënieve me Shqipërinë, natyrisht, këto nuk mund të jenë të mira, për gjithë ato të këqija që ka bërë dhe po bën Jugosllavia titiste ndaj Shqipërisë dhe popullsisë shqiptare që jeton në tokat e veta në Jugosllavi.

Presidenti jugosllav theksoi më poshtë se çështjet nacionale në Jugosllavi i kanë zgjidhur më së miri. Ai nuk mungoi të kërkonte që edhe fqinjët e saj të sillen po në atë mënyrë me pakicat kombëtare jugosllave siç po sillet Jugosllavia me pakicat kombëtare në republikën e saj. Mirëpo, po të shikojmë historinë e qëndrimeve të mbajtura ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi, jo vetëm në kohën e kralëve serbë, por edhe në kohën e Titos deri tash, do të konstatojmë se ato janë qëndrime shoviniste të një shteti ka-

pitalist, shfrytëzues. Vetë titistët kanë pohuar me gjën e tyre se Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë. Lëndët e para të Kosovës kalojnë në republikat e tjera. Asnjë investim me rëndësi e që duhet bërë atje nuk bëhet. Kosovës po ia rrjepin pasuritë e saj dhe kosovarët po i lënë në varfëri. Fakt është se shqiptarët e Kosovës nuk kanë akoma atë liri dhe nuk gjëzojnë akoma ato të drejta demokratike që pretendohet se ua kanë dhënë titizmi dhe socializmi veladministrues. Këto janë një blof.

Një titist tjetër, njësarë Vidiçi, që pak ditë më përpara foli në Kongresin e 8-të të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, e përmendi këtë qëndrim «demokratik socialist të Federatës dhe të Serbisë» ndaj shqiptarëve të Kosovës, veçse ai nuk mund ta mbulojë diellin me shoshë. Ky titist foli, gjithashtu, edhe për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, të cilën e quajti «ngjarje historike me rëndësi të madhe në luftën e popullit shqiptar kundër osmanëve». Por Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ka pasur vetëm këtë qëllim që përcakton ky, pra vetëm lustën kundër osmanëve. Qëllim kryesor ajo ka pasur ruajtjen e unitetit të kombit shqiptar, të trojeve shqiptare dhe pikërisht sepse ato u ndanë dhe iu dhanë Serbisë e Malit të Zi. Këto gjëra për të janë të shkuara, prandaj thotë se duhet të harrohen dhe kërkon që të pranohet realiteti ekzistues. Domethënë, sipas tij, shqiptarët të pranojnë të qëndrojnë nën thundrën e serbit dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë të mbyllë gojën për këtë realitet «të bukur».

Për sa u përket atyre kosovarëve, të cilët nga

tribuna e Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e akuzuan Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë si një vend etatist dogmatik, si një shtet nationalist irredentist etj., dua të theksoj se të gjitha këto që thanë ata janë pikëpamjet e qëndrimit e regjimit titist ndaj popullsisë shqiptare që banon në tokat e veta në Jugosllavi dhe ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Pra nuk shërben shumë maska që përdor Titoja, sepse njerëzit e tij po i thonë haptazi ato që ai i thotë tërthorazi.

Si për Kosovën, ashtu edhe për gjithë Jugosllavinë, është një blof ajo që thotë Titoja se «veprimtaria jugosllave në çështjet e jashtme ka një bazë të gjerë sociale dhe pikërisht këtu masat tona punonjëse thonë fjalën e tyre vendimtare». Kjo nuk është e vërtetë. Njerëzit e thjeshtë, punonjësit në Jugosllavi, nuk thonë asnjë fjalë vendimtare; fjalën vendimtare atje e thonë ushtria që drejton Lubiçiçi dhe sigurimi i shtetit jugosllav. Të tjerët punojnë dhe të tjerët fitojnë: punojnë masat e robëruara dhe fiton shtresa e kapitalistëve të rinj.

Në këtë raport Titoja bëri fjalë edhe për çarmatimin, por tashmë tezat e tij për këtë problem janë të njohura, janë tezat e gjithë kasnecëve në botë, të të gjithë atyre që janë të lidhur pas qerres së fuqive të mëdha, nga të cilat marrin armë, kredi e teknologji, por që janë të lejuar të flasin fraza të përgjithshme për çarmatimin. Zaten edhe vetë fabrikantët e armëve flasin për çarmatimin, por të tjera thonë e të tjera bëjnë. Edhe Titoja po këtë gjë ka bërë dhe po bën. Pa ato që thotë ai se «në botë po forcohet

besimi, se paqja dhe sigurimi ndërkombëtar nuk mund të ruhen përgjithmonë mbi një ekuilibër forca-s ushtarake dhe ndarjes në blloqe», janë fjalë boshë. Këto blloqe, si blloku i NATO-s, blloku i Traktatit të Varshavës e blloqe të tjera që mund të kriohen në të ardhmen, do të ekzistojnë.

Kina është një nga këto fuqi të mëdha që shkon drejt krijimit të blloqeve, të cilat nuk mund t'i zhdukë fryma e shenjtë ose pallavrat e njëfarë antimarksisti, siç është Titoja. Këto do t'i zhdukë vetëm forca e popujve përmes revolucionit. Vetëm proletariati i frymëzuar nga ideologjia marksiste-leniniste mund t'i shkatërrojë blloqet, t'i prishë planet e imperialistëve dhe të marrë fuqinë në duart e tij, mund të lejojë një zhvillim përparimtar të njerëzimit pa u mbësh-tetur në forcat ushtarake të blloqeve, të cilat nuk zhduken kështu siç veprojnë revizionistët kinezë, jugosllavë, italianë e të tjerë.

«I gjithë komuniteti ndërkombëtar dëshiron të shohë dhënien fund të garës së armatimeve...», thotë Titoja. Po, po, komuniteti ndërkombëtar e kërkon një gjë të tillë, sepse armatimet gllabërojnë pasuri të mëdha materiale dhe ekonomike dhe gozhdojnë njerëz, që i përgatitin ato pér gjakderdhje. Por zhdukja e këtyre situatave nuk mund të bëhet pa luftë dhe pa revolucion.

Ne i përkrahim luftërat çlirimtare. Edhe Titoja flet pér to dhe arrin deri atje sa të thotë që luftërat nacionalçlirimtare kanë shkaktuar likuidimin e plotë të kolonializmit dhe arritjen e së drejtës së popujve pér vetëvendosje. Në fakt, nuk është kështu, siç pre-

tendon ky kasnec i kapitalizmit. Këta popuj janë përsëri në skllavëri, të shtypur e të shfrytëzuar nga ana e kapitalit, por në forma të ndryshme, jo më në format e vjetra të kolonizimit, por në ato të neokolonizimit. Kurse Titoja, në vend që të predikojë se si popujt mund ta shkundin zgjedhën (dhe këtë konkretisht ai s'mund ta bëjë), flet se kjo zgjedhë gjoja mbahet nga disa «dogmatikë», «sektarë», ose «pseudorevolucionarë», prandaj duhet vepruar kundër tyre dhe pretdimeve monopolizuese, ngado që të vijnë këto. Me fjalë të tjera, ky renegat dëshiron të ruhet statukoja e soime e botës. Këtu ai bashkohet plotësisht me kinezët: Që të ruhet kjo statuko duhet të luftohen «dogmatikët», «sektarët», «pseudorevolucionarët», domethënë të gjithë ata që ndjekin dhe zbatojnë, në praktikë, teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Titoja të gjithë ne na quan pseudorevolucionarë.

Më poshtë në raport, duke folur për këtë problem, Titoja del me konkluzionin se premisë e përparimit për të arritur në sigurimin e paqes është vetëm pavarësia e vendeve e fituar në këto forma e mënyra, pavarësia e arritur me pasivitet ose në një aktivitet muhabeti midis krerësh kapitalistë, siç bëjnë Titoja dhe partnerët e tij, me fjalë të tjera, pavarësia «e dhënë» nga imperialistët në format që njihen e që në realitet nuk japid as lirinë, as pavarësinë, as sovranitetin, përkundrazi, lejojnë shfrytëzimin e popujve.

Pra teoria e Titos është e pleksur në një mënyrë të tillë saqë ai arrin të thotë se «në zhvillimin e komunitetit ndërkombëtar mbi bazën e avancimit të pashembullt të forcave prodhuçse, nuk ka ekzistuar

asnjëherë një ndërvartësi dhe lidhje kaq e madhe midis vendeve». Domethënë, ky «përparim» teknik i zhvilluar nga kapitalizmi botëror për interesat e tij dhe jo për interesat e popullit, është në favorin e komunitetit ndërkombëtar dhe kjo gjë i ka lidhur vendet njëri me tjetrin. Pra, këto vende, sipas Titos, duhet të jenë të kënaqura nga ky zhvillim. Por, në fakt, çfarë zhvillimi është dhe kush përfiton nga ky zhvillim i shkencës ose i teknikës? Natyrisht, siç e thashë, nuk fitojnë masat punonjëse, proletariati e fshatarësia. Teorizime të tillë të përgjithshme nuk e shërojnë plagën e madhe të shoqërisë që ka përmësuar fjalën e urryer kapitalizëm.

Titoja vuri në dukje se kjo situatë është e tillë, por ka edhe kontradikta të thella që shkaktohen, sepse pasuria e akumuluar në botë është në duart e disave. Kjo çështje, sipas tij, nuk është e drejtë, «këto kushte nuk janë të barabarta, janë thellësish të padrejta dhe të papranueshme». Domethënë kini mëshirë, ju, imperialistë amerikanë ose socialimperialistë sovjetikë, ose ju vende të tjera kapitaliste që keni akaparuar pasuritë e botës dhe skllavëroni vendet, lëshoni disa thërrime që të rrojnë edhe popujt e vendeve të tjera! Titoja për veten e tij nuk ka pse të qahet, për arsyen se ai ia ka hipur kalit. Cilit kalë? Kalit imperialist. Domethënë ai e ka shitur mirë vendin e tij te kapitalistët e huaj. Dhe që ky Tito dhe titizmi si teori të fshihen nën maskat demokratike, socialistë vetadministruese, kjo s'u prish shumë punë këtyre vendeve të huaja kapitaliste, përkundrazi u ndreq, sepse teori të tillë, sipas tij, mund të gënjejnë njerëz dhe popuj.

«Aspiratat e popujve, thotë Titoja, po hasin në kundërshtimin e atyre, të cilët kërkojnë të ruajnë pabarazinë dhe pozitat e veta monopoliste». Por imperializmi, kolonializmi ose neokolonializmi, që i rezistojnë me forcë përparimit janë aleatë të Titos. Ky nuk u thotë popujve çfarë duhet të bëjnë dhe, natyrisht, nuk mund t'u thotë, sepse nuk pranon tezat leniniste, nuk pranon teorinë e Marksit. Si të gjithë revisionistët, Titoja është një reformist, një anarkosindikalist, një agjent i borgjezisë, i asaj shoqërie me klasa ku mund të rrojnë të lumtur dhe të kënaqur vetëm ata që ruajnë pabarazinë dhe pozitat e tyre monopoliste.

Kështu duhen kupluar mendimi gjoja filozofik i Titos ose pikëpamjet e tij gjoja revolucionare. Fraza bajate gjen sa të duash në 80 faqet e raportit të Titos. «Paqja duhet të ruhet, sepse është kusht vendimtar për ekzistencën e gjithë njerëzimit...», thotë ai. Por, si të ruhet kjo paqe? Kush e prish këtë, dhe cilët janë shkaktarët e luftërave? Për këto s'ndihet fare Titoja, ai vetëm thekson se «bashkekzistenca paqësore është e vëtmja alternativë ndaj katastrofës bërthamore». E zbuloi gjithë të vërletën! Dhe, si konkluzion renegati Tito deklaroi: «Një përgjegjësi e madhe historike bie mbi këdo që luan me paqen... në furriz të lirisë e të pavarësisë së popujve të tjerë». Pra, nga ky konkluzion «i madh» Titoja nënizon se «socializmi, që prej kohësh ka dalë jashtë kuadrit të shteteve, rajoneve apo blloqeve dhe është bërë i përvitueshëm në zhvillimin shoqëror dhe në përgjithësi i pranueshëm, është evident në praktikë në një shkallë të lartë».

Domethënë, sipas Titos, shoqëria socialiste, ku më e plotë e ku më pak e plotë, jo vetëm është zhvilluar, por është vendosur në të gjithë rruzullin botëror, për arsyen e dëshirës për paqe. Por ai nuk tregon në këtë raport të tij as si është vendosur ky socializëm, as se ç'lufthëra janë bërë dhe q'duhet bërë për këtë socializëm, vetëm thotë se «çdo lëvizje përparimitare, nëpërmjet ideve dhe veprimeve të veta, jep kontribut në këtë luftë dhe, ndërsa bashkohen në rrymën kryesore botërore të luftës për një pamje socialiste të njerëzimit, këto tipare të ndryshme përbëjnë substancën, kuptimin dhe karakterin e socializmit si një proces botëror».

Këto janë fraza boshe tamam tipike revisioniste, reformiste dhe aspak revolucionare, që tingëllojnë si ajo kambana e prishur që nuk dëmonizon kurrënd dhe nuk mobilizon njeri. Krejt ndryshe mendojnë popujt që vuajnë. Aspiratat e tyre konkretizohen në luftëra të përgjakshme kundër shtypësve, kurse Titoja lufton me fraza. Lufta e Titos i përrëngjan luftës që thoshin francezët «en dentelles» (me pambuk) dhe jo luftës revolucionare.

Titoja nuk tregon atë rrugë që duhet, rrugën e shfrytëzimit të kontradiktave që ekzistojnë, por të kundërtën. Ai vetëm konstaton se këto kontradikta ekzistojnë në periudhën e zhvillimit të socializmit. Ç'bëjnë këto kontradikta? «Këto kontradikta sjellin si rezultat, — thotë ai, — arritjen e shpejtë të synimeve historike për emancipimin e punës dhe të njeriut në vendin e tij dhe afirmimin e atyre korrenteve dhe rrymave demokratike në marrëdhëni etj ndërko-

mbëtare, të cilat lejojnë e nxitin transformimet përparimtare të shoqërisë dhe forcimin e pavarësisë, b razisë dhe bashkëpunimin e gjithanshëm».

Eshtë i kuptueshëm absurditeti i këtyre frazave pa brendi, rrështhimi i disa ideve banale pa kurrfarë shpirti revolucionar. Nuk mund të gjesh shpirt revolucionar, nuk mund të gjesh shkaqet e vërteta ekonomike të ekzistencës së kontradiktave në ato që thotë Titoja, sepse ai nuk mund të mendojë duke u mbështetur në materializmin dialektik dhe historik për t'i shpjeguar këto kontradikta, pse lindin, kush i shkakton dhe si duhen shfrytëzuar këto që të mund të sjellin atë çka predikon Titoja. Pra ai nuk bën gjë tjetër vetëm se llomotit.

Në këtë raport Titoja prek edhe problemin e marrëdhënieve ekonomike ndërkomëtare, se këto e kanë mbajtur gjallë Jugosllavinë. Mirëpo këto marrëdhënie të Jugosllavisë me shtetet kapitaliste kanë qenë specifike. Titoja ua ka shitur Jugosllavinë kapitalistëve të huaj. Tri të katërtat e pasurive të këtij vendi mund të thuhet me siguri se janë në duart e të huajve.

Si konkluzion Titoja thotë se «vetëm me anë të një ndryshimi radikal në këto marrëdhënie do të ishte e mundur të koordinoheshin interesat e gjithë faktorëve të ekonomisë botërore dhe do të krijuosheshin bazat për një sigurim, paqe dhe begati të përgjithshme». Pastaj ai ankohet, duke thënë se «vendet e zhvilluara si një e tërë, nuk kanë treguar vullnet politik... në zgjidhjen e problemeve ekonomike të botës...» Për Titon vendet e zhvilluara kapitaliste janë një e tërë, nuk janë vende të shkëputura ku gjithsecili sipas ligjit

kapitalist të xhunglës lufton kush e kush t'ia hedhë tjetrit, t'i imponohet tjetrit, të përsitojë nga tjetri me pak mundime e të shfrytëzojë masat e gjera të popujve. Prandaj Titoja ka shpresë dhe predikon që këto vende në unitet të tregojnë një vullnet politik e një gatishmëri të mjaftueshme për t'u angazhuar në masën e duhur për zgjidhjen e problemeve ekonomike të botës. Dhe më poshtë, duke folur për këtë problem, ky «burrë i madh» nuk mungon të tregojë «madhërinë e tij», duke thënë se «në kontaklet që ka pasur me udhëheqës të shteteve të tjera, pala jugosllave ka theksuar kurdoherë rëndësinë e krijimit të një rendi të ri ekonomik ndërkontëtar më të drejtë, duke theksuar se kjo është në interes të të gjithëve».

Pra, kasneci jugosllav, që shkon në të gjitha kryeqytetet e vendeve kapitaliste e revisioniste, takohet e bisedon me njerëz të shquar të kapitalit dhe u thotë atyre që krijimi i një rendi të ri ekonomik botëror do të jetë në interes të të gjithëve. Domethënë Titoja i ka këshilluar ata të shkarkohen ca nga pasuritë e mëdha që kanë dhe t'ua japid të tjerëve. Mirëpo ata nuk e kanë dëgjuar këtë profet të një «bote të re», së cilës nuk i vë emr, edhe pse e quan «socialiste». Në realitet ky socializëm nuk vlen për kurrikënd, për popujt jo e jo, por as për miqtë e tij. Këta miq i japid Titos me shokë disa lëmosha për t'i mbajtur në fre njerëz të tillë që propagandojnë ndyrësira, por që t'u japid nga pasuritë e tyre popujve të varfër, të cilët i krijojnë këto pasuri, kjo është gjë që s'bëhet. Ajo nuk mund të fitohet ndryshtë, përvçëse me luftë dhe me armë.

Por për këtë problem ky kasnec tjerr fraza dhë predikon se, po të zbatohen këto teori të tij, do të ketë një qëndrueshmëri ekonomike ndërkombëtare me pasoja të favorshme për «vendet në zhvillim». «Këto marrëdhënie të drejta do të hapnin tregje me mundësi të mëdha për shitjen e mallrave dhe shërbimet nga vendet industrialisht të zhvilluara. Shkurt do të krijuhet marrëdhënie të reja tregtare, të cilat do të ishin cdhe në përfitim të vendeve të zhvilluara», vë në dukje Titoja. Presidenti jugosllav u mëson kështu tregtarëve të mëdhenj të armëve dhe pasani këvë miliarderë se si duhet të zgjerohet tregtia dhe të zhvillohet ekonomia! Ata e dinë fare mirë këtë rrugë dhe e ndjekin atë, por në interes të tyre dhe jo të popujve. Pikërisht nga fitimet e këtyre tregtarëve e miliarderëve të mëdhenj përsiton Titoja, veç atij i duhet t'i thotë këto fraza, sepse duhet të fshihen lakkmia, shtypja, shfrytëzimi i egër i kapitalizmit, miliardat që fitohen mbi kurrizin e popujve.

Dhe dadaja mbi dadatë e tjera të Titos është «lëvizja e mosangazhimit». Kjo jo vetëm që e prrokupon Titon, por prej kësaj lëvizjeje ai ka përfitime të mëdha, se i shërben ruajtjes së statukuosë imperialiste në kurri të popujve; ajo i sjell të ardhura të majme Jugosllavisë nëpërmjet kredive dhe shitjes së pasurive të saj të mbitokës dhe të nëntokës shteteve të huaja kapitaliste.

Ka vështirësi, thotë Titoja, në «vendet e paangazhuara», por këto do t'i kalojnë të gjilha. Ka rreziqe, por edhe këto do t'i kalojnë të gjitha dhe do të ruajnë unitetin e tyre. Në realitet rreziqet jo vetëm nuk po

kalohen, por po vështirësohen dhe lëvizja nuk është aspak e paangazhuar, por është thellësisht e angazhuar me imperialistët e ndryshëm.

**Por ç'duhet të bëjmë thotë Titoja?**

Ky revisionist u bën thirrje «vendeve të paangazhuara» të mos përdorin forcën, të mos përdorin agresionin në marrëdhëniet reciproke midis tyre, sepse «qëndrime të tilla përbëjnë një kërcënim shumë të madh për marrëdhëniet ndërkombëtare». Pra, Titoja këtyre popujve, që ai i quan «të paangazhuar», u predikon bashkekzistencë paqësore revizioniste, që ato të nënshtrohen dhe të mjaftohen duke kërkuar vetëm me fjalë të drejtat e tyre.

«Ne duhet të bashkohemi në përpjekje të reja për të gjetur rrugën e drejtë për zgjidhjen paqësore të konflikteve, për çdo rast konkret», thotë ai. Fjalë e madhe! Sikur këto zgjidhje nuk po bëhen! Por çështja shtrohet se kush i bën dhe si qëndrohet përpara këtyre zgjidhjeve, pse ekzistojnë konflikte, kush i nxit dhe si likuidohen ato?! Këto duhen shpjeguar, por pikërisht këto nuk i shpjegon Titoja e sigurisht, të tilla gjëra s'mund t'i shpjegojnë dot teoritë e tij false reaksionare. Ato i shpjegon vetëm marksizëm-leninizmi.

Titoja mendon se këto probleme do t'i zgjidhë konferanca e ardhshme ministriale e «vendeve të paangazhuara» që do të bëhet në Beograd, e cila «duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë gjetjes së zgjidhjeve të situatës së tanishme», sepse deri tashti s'është gjetur zgjidhja. Mirëpo kjo «lëvizje e mosangazhimit» nuk është një lëvizje e sotme. Ka dhjetëra vjet që Titoja e ka predikuar atë së toku me Nehrunë, me

Sukarnon e me të tjerë dhe asgjë nuk ka zgjidhur; përkundrazi, ajo i vështirësoi dhë vazhdon të vështirësojë të gjitha situatat. Dhe kjo është e kuptucshme për arsyen se shërimi i vetëm, dalja e shpejtë e popujve nga një situatë e tillë, nuk realizohet me frazat boshe, me mbledhjet e famishme pa bukë të Beogradit e të Kolombos, por me luftë të përditshme të armatosur kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist.

«Lëvizja e mosangazhimit» nuk luan asnje rol në marrëdhëniet ndërkombëtare, siç pretendon presidenti i Jugosllavisë. Përkundrazi, është rezistenca e çdo populli dhe e grupe-popujsh të bashkuar për të mbrojtur të drejtat e tyre nga kolonizatorët ose neokolonizatorët, ajo që mund të japë fryte dhe të luajë një rol në marrëdhëniet ndërkombëtare. Tjetër rrugë nuk ka, rruga e Titos është një rrugë e gënjeshtërt. Asnjë problem ndërkombëtar nuk ka zgjidhur «lëvizja e të paangazhuarve». Përkundrazi, problemet ndërkombëtare po acarohen vazhdimisht dhe Titoja me shokët e tij bëjnë vetëm llafe, llogje, sa herë që u jepet rasti.

«Vendet e paangazhuara» nuk veprojnë asnjëherë të bashkuara; ato janë të pérçara. Pretendimi i Titos se veprimitaria e tyre e përbashkët ka pasur pasoja në zhvillimin e në zgjidhjen e problemeve të vërteta thelbësore është një blof. Asnjë problem thelbësor nuk mund të zgjidhej nga një «front» ose nga një «lëvizje» e tillë me baza teorike antimarksiste dhe me qëllime të caktuara reaksionare, nuk mund të zgjidhet pa një luftë të ashpër të popujve e të proletariatit kundër klikave borgjeze në fuqi dhe kundër imperializmit e reaksiqit botëror. Pastaj, ata që bashkon

Titoja në këtë lëvizje, dhe që ai i ka shokë lufte, janë të tërë të angazhuar me fuqitë imperialiste dhe bëjnë lojën e tyre. Ata, pra, llafe mund të bëjnë sa të duan, por asgjë nuk kanë në torbë.

Pasi i thotë të gjitha këto, zoti Tito thekson se «lëvizja e mosangazhimit» ka hasur në «vështirësi». Kjo po, është e drejtë. Ai thotë, gjithashtu, se «kundërshtarët e saj përpinqen ta përcajnë dhe ta dobësojnë». Edhe kjo, gjithashtu, është e vërtetë, për arsy se «lëvizja e mosangazhimit» është një mashtrim jo vetëm për popujt, për revolucionarët, por edhe për imperialistët e ndryshëm. Disave kjo lëvizje u intereson, disa të tjera ejo. Imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik kjo lëvizje u intereson. Megjithatë, ata kanë të angazhuarit e tyre që i tërheqin nga hunda, prandaj njëri përpinqet të kundërshtojë tjetrin, kurse marksistë-leninistët e luftojnë atë si një lëvizje antimarksiste, si një lëvizje në shërbim të superfuqive. Kështu duhet konsideruar ajo e të luftohet konkretisht kundër saj, jo me fjalë, jo në sipërfaqe, jo me parulla, por me luftë që të dalin me të vërtetë në dritë problemet thelbësore, për të cilat bën fjalë Titoja. Pra lufta kundër atyre që i manipulojnë popujt me frazeologji dhe me të tilla grupime fals, që nuk sjellin asnje fitim për popujt, është pikërisht në interes të popujve.

Armiqtë e «politikës së mosangazhimit» janë marksistët e revolucionarët e vërtetë. Por kundër saj janë edhe superfuqitë. Këto në aparençë duket sikur janë për mosangazhimin, por në realitet janë për angazhimin e të gjithëve, mundësisht ndaj tyre. Titoja predi-

kon «mosangazhimin», por në realitet nxit angazhimin, kurse ne, marksistët, revolucionarët, e luftojmë «mosangazhimin», se e dimë ç'fshihet pas kësaj parulle. Nën maskën e «lëvizjes së mosangazhimit» fshihet nënshtrimi ndaj klikave kapitaliste, të cilat bëjnë llafe dhe shkëmbejnë pasuritë e vendeve të tyre velëm në fitim të klasës që përfaqësojnë, të klasës së të pasurve.

«Lëvizja e mosangazhimit» nuk është aspak «faktor shumë i fuqishëm në balancën dhe në stabilitetin e tanishëm botëror...», siç pretendon Titoja. Një pretendim i tillë nuk ka baza. Vetëm një lëvizje e vërtetë marksiste-leniniste ka unitet. Nuk mund të flitet për unitet në një lëvizje të tillë siç është ajo e mosangazhimit, ku bashkohen klika borgjeze e reaksionare, parti revizioniste, socialdemokrate, demokristiane apo republikane. Jo. Në të tillë klika e parti ka fraksione të ndryshme, të cilat bashkohen me njërat-tjetër për disa interesa të përbashkët që i lidhin. Në kundërshtim me tendencat e partive të tjera, por brendaperbrenda tyre nuk ka kurrfarë uniteti.

Ekziston unitet në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë? Pretendohet se po, por ky konsiston në unitetin e asaj klase borgjeze kapitaliste që është krijuar në vend dhe që është lidhur me kapitalin e huaj për të luftuar tendencat e ndryshme centrifugale, tendencat e shkëputjes së republikave nga Federata, e cila lufton kundër tendencave shoviniste nacionaliste, që janë nxitur dhe po nxiten nga një regjim i tillë shfrytëzues kapitalist, siç është regjimi aktual jugosllav. Ekziston unitet në Lidhjen e Komu-

nistëve të Jugosllavisë, por midis shtresave që janë të favorizuara dhe që duke bashkëpunuar me kapitalin e jashtëm përsitojnë nga grabitja e popullit jugosllav. Ne mund të themi se ky lloj uniteti ekziston në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë; unitet tjetër atje nuk ka dhe nuk mund të ketë. Përkundrazi, Partia Komuniste e Jugosllavisë asnjëherë nuk ka qenë një parti marksiste-leniniste. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, kur mendohet se Partia Konuniste e Jugosllavisë ishte me të vërtetë një parti që do të ndiqte rrugën marksiste-leniniste dhe do të ndërtonte socializmin në shembullin e praktikës leniniste, praktikës revolucionare të Bashkimit Sovjetik, e kundërtat u vërtetua në jetë.

Në Jugosllavi pseudokomunistët, që kishin ardhur në fuqi me Titon në krye, që në fillim iu futën luftës kundër qenies së partisë një parti legale, një parti në udhëheqje, një parti që frysmezohet nga teoria e Marksit dhe e Leninit dhe nga praktika revolucionare e shembulli i Bashkimit Sovjetik. Sigurisht ata përdorën disa terma «autentikë», por kjo bëhej jo se jugosllavët dëshironin të ishin origjinalë ose specifikë në ndërtimin e socializmit nü vendin e tyre. Jo. Këta janë terma që ata i kanë përdorur vetëm për t'u maskuar. Jugosllavia e Titos shkeli dëshirat, interesat dhe gjakun e popullit jugosllav dhe nuk dëshironte të ndërtonte në Jugosllavi socializmin, por të restauronte kapitalizmin e shkatërruar gjatë luftës kundër hitlerianëve, të ndërtonte një kapitalizëm nën drejtimin e një klase të re kapitaliste dhe jo nën drejtimin e Karagjorgjëve ose të kralëve të tjerë. Për këtë u përpoq

që në fillim dhe ia arriti. Pra, revisionistët jugosllavë, me Titon në krye, që në fillim i kishin sylë nga Perëndimi, nga fuqitë perëndimore. Ata dëshironin, u përpoqën dhe e krijuan një parti të tillë, e cila do t'i shërbente veprimitarisë së tyre të djallëzuar për të vendosur në Jugosllavi një regjim të ri kapitalist, i cili do të ishte në unitet me kapitalizmin botëror dhe në luftë me Lashkimin Sovjetik socialist, revolucionar, me atdheun e Leninit dhë të Stalinit.

Këtë çështje ne e kemi analizuar dhe herë të tjera. Nuk ishte e rastit që, në kohën kur Jugosllavia fitoi luftën, Titoja dhe grapi i tij në fakt u përpoqën të mbanin pér një kohë në ilegalitet Parlinë Komunistë të Jugosllavisë, ose t'i jepnin rëndësi të jashtë-zakonshme organizimit të kësaj partie në format specifike. Për sa i përket punës politike dhe ideologjike, këtë partia e zhvillonte nëpërmjet Frontit Popullor, frontit të gjerë të masave të popullit. Titizmi, pra, u përpoq dhe e fshahu partinë nën maskën e Frontit qysh në fillim. Përse bëhej kjo? Kjo bëhej që të mos dukej përnjëherësh që kjo parti nuk ndiqte rrugën e Marksit, Leninit dhe Stalinit. Me rrugën që kishte nisur kjo parti do të bëhej (dhe, në fakt, u bë) një vegël, një organ në duart e në shërbim të sigurimit 'ë shtetit. Kjo ishte e organizuar gjoja si një parti, por Rankoviçi dhe Titoja e bënë atë konkretisht një vegël të tyre pér të forcuar diktaturën fashiste, diktaturën kapitaliste që ata po vendosnin në Jugosllavi. Kjo mënyrë e të kuptuarit të rolit të partisë, të organizimit dhe të vijës së saj, e realitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, bëri që të mos ndërtohej so-

cializmi dhe zhvillimi i vendit të merrte rrugën e bashkëpunimit të ngushtë me shtetet kapitaliste perëndimore, drejt një shkëputjeje progresive dhe më në fund radikale me Bashkimin Sovjetik, sepse gjoja ky ndërhynte në punët e brendshme të saj.

Jo, nuk ishte kjo arsyje. Arsyja ishte se e astuquajtura Parti Komuniste e Jugosllavisë, me Titon në krye, ishte kundër socializmit, kundër kolektivizimit të bujqësisë. Ai bëri që fshati jugosllav të qëndronte në pozitat e mëparshme për sa u përket pronësisë, drejtimit dhe organizimit. Titoja shtetëzoi pasuritë e disa tradhtarëve të kohës së luftës dhe me këto krijoi fermat. Teoria që udhëhiqte Titon me shokë ishte teoria e Buharinit, e populistëve dhe e integrimit të kapitalizmit në «socializëm», gjë që do të thoshte të kundërtën, që socializmin ta integronte në kapitalizëm. Këtë do ta bënte pikërisht Partia Komuniste e Jugosllavisë që në të vërtetë s'ishte parti komuniste, por një parti antimarksiste.

Pra, në Jugosllavi nuk udhëhiqte Partia Komuniste me një ideologji të vërtetë marksiste-leniniste. Atje as nuk ekzistonte dhe as nuk u vendos diktatura e proletariatit. Jugoslavia u quajt një Federatë Demokratike Popullore, por në realitet ajo ishte një shtet borgjez kapitalist dhe e cte drejt vendosjes së një diktature fashiste. Kjo shkoi aq larg në këtë rrugë saqë, kur u vendos atje totalisht sistemi kapitalist, diktatura e UDB-së së Rankoviçit u bë shumë e rrezikshme. E gjithë kjo ngjau jo thjesht nga pikëpamja e titizmit, por sepse midis grupeve ekzistonin kontradikta. Grupi serbomadh, duke pasur në dorë sigurimin e shtetit

dhe ushtrinë, donte që të vendosë hegjemoninë e vet në gjithë Jugosllavinë. Titoja është kroat. Ai donte që të mbante ekuilibrin kapitalist, gjë që natyrisht ishte e pamundur të arrihej, midis këtyre tendencave shoviniste, të cilat mund të zhdukeshin vetëm po të kishin në krye një parti marksiste-leniniste. Përderisa kjo parti marksiste-leniniste nuk ekzistonte në drejtimin e Jugosllavisë, këto tendenca shoviniste jo vetëm që nuk u zhdukën, por u acaruan edhe më shumë, saqë grupei i Rankoviçit u bë i rrezikshëm për grupin tjetër, kroat, i cili nga ana e vet u bë i rrezikshëm për grupin slloven. Natyrisht, pas tyre do të vinin edhe malazezë, edhe maqedonasit. Për ta ruajtur këtë unitet kapitalist për një kohë sa më të gjatë, që nga çlirimi i Jugosllavisë, edhe nga shkëputja prej Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera socialistë, Titoja u detyrua të merrte masa deri te likuidimi i grupit serb shovinist të Řankoviçit.

E çfarë bëri në këtë mës Titoja? Ai vuri njerëzit e tij të drejtonin. Ç'do të thotë vuri njerëzit e tij? Domethënë Titoja vuri ata njerëz që ishin për regjimin kapitalist dhe për eliminimin e atyre forcave ultra-shoviniste të partisë jugosllave në shërbim të UDB-së fashiste. Grupi i Titos, që fitoi kundër grupit serb, e reduktoi partinë në një organizatë amorse. Nëpërmjet kongresesh fiktive u bënë ndryshime për rolin e partisë. Këto ndryshime konsistonin në atë që partia të mos ishte më një vegël e ministrisë së brendshme, por kjo ministri të vazhdonte të dominonte në jetën jugosllave, grushti i saj të ndihej kudo e, për këtë, të merreshin masa të rrepta dhe partia të bëhej kështu

një gjë e paqenë. Me fjalë të tjera, ajo të ruante vetëm emrin, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, një emërtim gjoja marksist, por që në fakt ajo nuk e drejtonte më jetën në Jugosllavi, qoftë edhe në mënyrë fiktive. Asaj iu dhanë atributet e një grupimi pa konsistencë për edukimin e komunistëve dhe të masave. Rëndësi kryesore iu dha Frontit (ideja e vjetër). Partinë titistët nuk mund ta likuidonin; atë duhej ta mbanin sa për formë; por në realitet roli i saj u zhduk, mori fund.

Lidhjet e ngushta të Jugosllavisë me kapitalin botëror kërkonin, natyrisht, që Jugosllavia të krijonte njësarë drejtimi shtetëror dhe një administrim e zhvillim të ekonomisë së brendshme në rrugën josocialiste, adaptë për interesat e kapitalizmit të huaj, por, ama, duke u quajtur socialiste. Dhe kjo u bë: U mor vendimi i krijimit të vëtadministrimit jugosllav. Kjo është gjoja teoria e madhe marksiste-leniniste, modeli i fundit i socializmit specifik titist, që, sipas tyre, i ka bazat në teorinë marksiste-leniniste. Gjithë kjo është një blof.

Të gjitha këto ndryshime e teorizime bëheshin që kapitalistët e huaj të siguroheshin jo vetëm ligjërisht, por edhe konkretisht, që kreditë dhe pasuritë e tyre të shfrytëzoheshin dhe të mos rrezikoheshin nga kryengritjet e masave punonjëse. Për këtë arsyë u zhdukën edhe formalisht organet e pushtetit të diktaturës së proletariatit, u shkatërruan këshillat popullorë, baza e pushtetit të kësaj diktature, u decentralizuan ekonomia e planifikimi dhe u ruajt administrata burokratike në gjithë Jugosllavinë. Në duart e Federatës u kon-

servuan drejtimi ushtarak, forca shtypëse, sigurimi i shtetit dhe e gjithë administrata, tregtia e jashtme e deri në njëfarë shkalle edhe arsimi e kultura. Por edhe këto të fundit u decentralizuan në një masë të madhe.

Federata mbajti grushtin kryesor të diktaturës dhe me këtë ruajti administratën, së cilës i dha një forcë të madhe. Njerëzit e administratës, qoftë në qendër, qoftë nëpër republikë, do të ishin dhe u bënë shtresa e re kapitaliste e Jugosllavisë.

Për sa i përket ekonomisë, bazës së shoqërisë, ajo u decentralizua dhe u quajt vetadministruese. Për këtë doli edhe teoria pseudomarksiste, sipas së cilës gjoja janë vetë punëtorët që administrojnë pasuritë e tyre dhe nëpërmjet të deleguarve ata planifikojnë në ndërmarrjet e veta: investimet, shpenzimet, bile edhe të ardhurat, të cilat i ndajnë, pasi i jepin një kuotë Federatës, që kjo të mbajë forcën goditëse dhe të ruajë pseudounitetin e Jugosllavisë.

Pra, çdo republikë punonte për hesap të vct. Secila nga ato udhëhiqej nga vetadministrimi «socialist». Të gjilha ndërmarrjet, brendaperbrenda republikës, qofshin të mëdha, qofshin të vogla, kishin këshillat e veta të punëtorëve, që gjoja bënин ligjin dhe prodhonin sipas interesave të tyre të veçantë, pa marrë parasysh nevojat e republikës. Shkurt këto ishin «vetë zot, vctë shkop». Po kush ishte zot këtu? Ishin këshillat e punëtorëve, ishin punëtorët? Jo, në asnje mënyrë. Gjithë kjo që thuhej ishte një blof. Zot në ndërmarrje ishin drejtuesit e tyre, të cilët bënë si të donin dhe i ndanin si të donin të ardhurat. Një administrim i tillë anarkist krijonte mundësi për spekulime të më-

dha, lejonte shfrytëzimin e krahut të punës dhe të mendjes së punonjësve në favor të drejtuesve të ndërmarrjeve që majmeshin në kurriz të punëtorëve.

Kjo teori titiste u përngjan atyre teorive dhe metodave që zhvillohen në vendet kapitaliste perëndimore të Evropës, ku edhe punëtorët kanë në ndërmarrje nga një aksion të vogël, por në realitet aksionet e mëdha të ndërmarrjeve janë në duart e kapitalistëve, të cilët bëjnë ligjin atje, kurse punëtorët vetëm sa quhen sikur marrin pjesë në administrim.

Pra në këshillin e administrit të një ndërmarrjeje të madhe kapitaliste në Perëndim ka edhe ndonjë punëtor si përfaqësues të aksioneve. Po kështu edhe në këshillat ose në të deleguarit, siç i quajnë titistët, të sistemit vetadministruar futet ndonjë punëtor. Por ç'kanë ata në dorë? Kanë hapëset e kashtës, se pushtetin e mbajnë të tjerë në duar: ata që bëjnë tregtinë me jashtë, që caktojnë çmimet në treg, që planifikojnë se ku duhen e ku nuk duhen bërë investime, ku nuk janë ato rentabël për ndërmarrjen, por janë rentabël për xhepin e tyre etj., etj. Këtej rezulton se një numër i madh njerëzish, që udhëheqin këto të ashtuquajtura ekonomi vetadministruese e që përbëjnë në tërësi socializmin vetadministruar jugosllav, janë pasuruar aq, saqë edhe vetë titistët u alarmuan. Ata u alarmuan edhe për arsyen se kishte lëvizje, kishte kontradikta të mëdha midis punëtorëve e drejtuesve të ndërmarrjeve dhe midis republikave. Disa republika ishin më të zonjat për të siguruar kredi nga kapitalet e huaja disa jo, dhe kapitalistët e huaj kishin interesa të veçantë. Nga njëra anë, Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës dhe vendet e zhvilluara përëndimore kishin interesat e investonin dhe të akaparonin pasuritë e Jugosllavisë, por kishin preferenca të mëdha në Kroaci e në Slloveni, më pak në Mal të Zi, fare pak në Kosovë dhe hiç fare në Maqedoni. Nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik, i cili ka prirjet e tij për dominim në Jugosllavi, preferonte më tepër Srbinë dhe Malin e Zi, bastionet e vjetra të pansllavizmit.

Kështu që edhe në mës republikave ky farë vetaadministrimi i «socializmit specifik» krijoj turbullira të mëdha, por krijoj njëkohësisht edhe atë shtresë kapitalistësh që u duhej regjimit të Titos dhe kapitalisteve të huaj të mëdhenj, që kishin investuar dhe që bënин nëpërmjet grupit të fuqishëm të Titos politikën në Jugosllavi, atë politikë që përmendëm më lart, gjoja ndërkombëtare.

Në jetën ekonomike të Jugosllavisë ky vetaadministrim solli të këqijat më të mëdha, për arsy se regjimi i ri ishte një regjim kapitalist i pastabilizuar, domethënë klasa sunduese nuk ishte e formuar si duhet dhe nuk kishte në dorë, sidomos, frenat e ekonomisë dhe të pasurive të vendit. Përqindja më e madhe e kësaj pasurie ishte në duart e koncerneve dhe të kapitaleve të huaja, të cilat ishin futur thellë dhe i kishin aq të koklavitura punët në këtë rrjetë merimange, saqë këta njerëz, domethënë kjo shtresë e madhe kapitalistësh në Jugosllavi që po formohej, nuk kishte përvëçse një synim: të mbushte xhepat e saj, pra të vidhëte sa të mundte dhe si të mundte më mirë. Kështu që sot ne shohim një krizë të thellë në Ju-

gosllavi në kuadrin e krizës së madhe të shteteve kapitaliste.

Jugosllavia është një shtet vasal i këtyre shteteve kapitaliste, prandaj kриза në këtë vend do të ndihej akoma më shumë. Ajo do të ishte akoma më e madhe te padronët e saj se në vendet kapitaliste. Sot kostoja e jetesës në Jugosllavi është ngritur pa masë dhe buxheti jugosllav ka një deficit të madh tregtar me miliarda, me gjithë miliardat që ajo ka marrë nga kapitali i huaj. Pra ekonomia jugosllave është krimbur, ajo është në duart e të huajve. Në Jugosllavi nuk ndërtohet socializmi, përkundrazi atje ekziston një kapitalizëm nën drejtimin e një shteti anarkosindikaliste, ku shtresa kapitaliste vepron sipas parimit vidh të vjedhim, siç i thonë një fiale. Diktatura që ekziston në këtë vend, bën çmos që ta mbajë këtë situatë dhe të sigurojë kapitalin e huaj dhe klasën borgjeze kapitaliste që është në zhvillim. Kjo bëhet në kurriz të punonjësve të Jugosllavisë, në kurriz të unitetit të Federatës Jugosllave dhe krijon e acaron kontradiktat midis klasave që u formuan në këtë vend, si dhe republikave të ndryshme jugosllave.

Prandaj nuk është i vërtetë, por i gënjeshtërt pretendimi i Titos se «Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë ka pasur dhe ka unitet për të gjitha problemet kryesore të ndërtimit socialist e të politikës së jashtme jugosllave». Sigurisht, Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë është kryesisht një komitet kapitalist që mbron interesat e klasës kapitaliste që sundon atje, ose më mirë të klasës që grabit. Por Lidhja e Komunistëve të Ju-

gosllavisë nuk ka asnjë forcë se në të nuk ekziston një platformë marksiste-leniniste, kështu që nuk mund të ketë unitet në radhët e saj.

Titoja kërkoi të ketë unilet mendimi dhe veprimi në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. Por, siç thashë, përderisa ajo nuk udhëhiqet nga një ideologji marksiste-leniniste, nuk mund të ketë në të unitet mendimi e veprimi. Këtë e di mirë Titoja dhe prej kësaj vuan, por nuk mund ta vendosë dot një gjë të tillë, se është një antimarksist, çshtë kapitalist, socialdemokrat, element parazitar.

Tash, në Kongresin e 11-të Titoja bëri thirrje për çështjen e centralizmit demokratik në parti. Por ky parim në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asnjë kuptim marksist-leninist. Duke folur për centralizmin demokratik, Titoja kërkon të thotë që komunistët duhet t'i binden diktaturës borgjeze të shtetit jugosllav, të administratës shtetërore kapitaliste jugosllave. Ky çshtë thelbi i centralizmit gjoja demokratik në partinë titiste, të cilin Titoja e reklamon për t'i dhënë njëfarë konsistence, njëfarë qëndrueshmërie socializmit vetadministrues jugosllav.

Vetëm centralizmi demokratik, thotë Titoja, «garanton demokracinë më të gjerë e më të mundshme në formulimin e politikës, në aprovimin e vendimeve dhe në unitetin e fortë për zbatimin e tyrc». Kjo, si dhe shumë të tjera, është një thënie boshe, se partia ose Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë është një front ku përplasen rryma të ndryshme e interesa të ndryshëm vetjakë. Nuk bëhet pa qëllim ajo që Titoja vë theksin në rolin kryesor të njeriut në shoqërinë

socialiste vetadministruese, domethënë «në mbrojtjen e të drejtave të njeriut», siç thotë Karteri. Në fakt, qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë në Jugosllavi, të drejtat e njeriut janë reduktuar në zero. Njeriu në Jugosllavi është i shtypur nën peshën e grushtit të diktaturës borgjeze, nën peshën e dyfishtë të kapitalizmit të huaj dhe të kapitalizmit shtetëror jugosllav.

Duke parë që nuk mund të ketë as unitet mendimi dhe as unitet veprimi në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja tha që mund të ekzistojnë edhe pakica në parti dhe në fakt ato ekzistojnë. Prandaj në një parti të tillë, në një shtet të tillë pseudosocialist, nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet mendimi dhe veprimi. Titoja cikzistencën e pakicave dhe të mendimeve të ndryshme, e lejoi, si të thuash, por shtoi se çdo komunist duhet t'i bindet shumicës dhe shumica, që ka parasysh ai, është grushti i diktaturës fa-shiste.

«Pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e popullit punonjës dhe e qytetarëve në zgjidhjen e të gjitha problemeve të shoqërisë së tyre...» është një blof, sepse mbledhje mund të bëhen sa të duash në Jugosllavi, mund të merren dhe vendime në këto mbledhje, por vendimet zbatohen sipas interesit të klasës, sipas interesit të atyre që janë vënë në krye të punëve, në krye të ndërmarrjeve vetadministruese. Ata bëjnë ligjin dhe thonë fjalën e fundit në shtetin vetadministruesh jugosllav.

Sistemit të delegatëve, që përmenda më lart, Titoja i vë një rëndësi të madhe, se gjoja krijon mun-

dësinë që iniciativat e miliona vetave të gjejnë shprehje. Ky është një mashtrim. Këta delegatë, edhe sikur të jenë një unitet i zgjedhur, nuk kanë asnë influcncë dhe asnë kompëtencë në drejtimin e ndërmarrjes. Këta mund të blihen e të shiten kur të duash nga bosët e ndërmarrjes dhe nga vetë Titoja e Kardeli, me shokë. Në librin «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist», që Kardeli botoi para këtij kongresi, thuhet se ky sistem vetadministrues ka edhe anët e tij të këqija, të cilat duhet të luftohen dhe të shërohen vetë, duke e ngritur në një lartësi të madhe ndërgjegjen e punonjësve, ndërgjegjen e njeriut. Në qoftë se ngrihet ndërgjegjja e njeriut, vazhdon Kardeli, atëherë ne do t'i zhdukim këto të meta. Po si mund të formohet ndërgjegjja e njeriut me një parti pseudomarksiste, me një parti që nuk ka një bazë teorike të shëndoshë dhe shkencore, siç është marksizëm-leninizmi? Si mund të flitet për një shkallë të lartë të ndërgjegjes së njeriut në një shoqëri me një zhvillim kaotik të ekonomisë ku grabitet, vidhet pasuria dhe ku çmimet ngrihen dila me ditë në interesin e klasës kapitaliste vendëse dhe të kapitalistëve të huaj që kanë investuar miliarda në këtë ekonomi të çoroditur? Dhe këtë realitet e njeh Titoja, sepse thotë që «ne nuk pretendojmë se çdo gjë në sistemin tonë funksionon në rregull, osc se të gjitha çështjet e paraqitura në kushtetutë janë zgjidhur praktikisht».

Ka akoma vështirësi, thçkson pastaj Titoja, lidhur me bazën materiale të shoqërisë.

Jo ka akoma, por ka shumë. E tërë shoqëria ju-

gosllave është e kalbur dhe Jugosllavia titiste është shndërruar në një shesh shfrytëzimi, grabitjeje dhe mjerimi për popujt që jetojnë në këtë vend. Vetadministrimi nuk ka sjellë asnjë zhvillim ekonomik dhe shoqëror në Jugosllavi. Atje janë ngritur ndërmarrje e prodhohen mallra, por të tëra këto, sikundër edhe në vendet kapitaliste, siç e vura në dukje dhe më lart, nuk shkojnë në interes të masave punonjëse, por të kapitalistëve.

Por me Jugosllavinë ku sundojnë revizionistët titistë ngjet edhe një gjë tjetër: dominojnë dumpingu dhe tregjet ndërkombëtare kapitaliste, që nuk e lejojnë këtë vend të eksportojë mallrat që prodhon pikërisht në këto ndërmarrje të përbashkëta me kapitalin e huaj. Për këtë arsyе tregtia jugosllave ka një disbalance të jashtëzakonshme, me rreth afro 3 miliardë dollarë, në mos më shumë, sepse kapitalistët kurdoherë i fshehin si të ardhurat e tyre, ashtu edhe disfatat që pësojnë. Edhe një vend i krimbur në mënyrë të veçantë, si Jugosllavia, që rrezikohet të rrëzohet si një kala prej karte, përpinqet ta fshehë kalbëzimin e saj.

Përparim ekonomik nuk duket në Jugosllavi; vetadministrimi nuk ka sjellë asgjë në këtë drejtim, as demokraci dhe as zgjidhje të problemeve të ndryshme të klasave që janë krijuar në shoqërinë jugosllave, të cilat janë në antagonizëm njëra me tjetrën.

I tillë është vetadministrimi jugosllav, e tillë është Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, i tillë është rendi ekonomik jugosllav, që kanë krijuar socializmi vetadministruar dhe gjoja politika e paangazhuar e Jugosllavisë. I gjithë ky mjerim, që ka mbuluar Ju-

gosllavinë, fshihet nën këto parulla e teori. Për të gjithë njerëzit me mend në kokë, që dinë të analizojnë ngjarjet e faktet dhe që dinë t'i konfrontojnë ato, është e qartë se sistemi socialist vetadministruesh është një formë rudimentare e një kapitalizmi kaotik anarkik, që ka siguruar pasurimin e një klase dhe u garanton të ardhura të mëdha investitorëve kapitalistë të huaj.

Sistemi socialist vetadministruesh jugosllav i shërbën kapitalizmit botëror, veçanërisht atij amerikan dhe kinez, që të mashtrojë popujt, t'i tërheqë këta nga rruga e socializmit dhe e revolucionit dhe t'u japë iluzionin ose t'u krijojë atë fokus që lëvizjet dhe përpjekjet e tyre për qëllim, për demokracinë e vërtetë dhe për vetëvendosje, t'i kanalizojnë në rrugën jugosllave. Prandaj kapitalizmi botëror investon në Jugosllavi dhe këtë e bën për dy arsyen: Së pari, për shfrytëzimin e pasurive të Jugosllavisë dhe të krahut të lirë të punës të jugosllavëve dhe, së dyti, për të mbajtur gjallë një sistem të tillë pseudosocialist që t'u shërbejë kapitalizmit botëror dhe revizionizmit modern si zjarrfikës i revolucionit në të gjilha vendet ku këta kanë hedhur ktherat e tyre.

Ky vetadministrim, kjo shoqëri vetadministruese, ka krijuar një papunësi të madhe në Jugosllavi dhe ka bërë që me qindra mijë njerëz të emigrojnë si në kohët e para në vende të tjera kapitaliste, ku bëjnë punë të rëndomta për të fituar bukën e gojës. Ata janë të detyruar të emigrojnë, sepse në këtë vend, të ashtuquajtur socialist, nuk kanë punë, «as punë krahu, as punë truri», pse, në qoftë se ekzistojnë në Jugosllavi vlera që krijohen si rezultat i punës mendore, këto blihen

nga kapitalistët e jashtëm, ashtu siç blihet edhe forca e krahut. Forca e krahut të punës në Jugosllavi emigrant jashtë dhe shpërblehet fare pak. Po edhe brenda në vend ajo shfrytëzohet me mëditje, me të ardhura të pakta dhe rron si mos më keq, duke qenë kurdoherë nën thikën e ngritjes së çmimeve e të uljes së nivelit të jetesës.

Për sa u përket njeriut dhe shoqërisë në Jugosllavi socializmi vetadministrues u ka sjellë këtyre degjenerimin, imoralitetin. Jeta perëndimore e shthurur, drogat dhe shtëpitë publike janë përhapur kudo. Vetë Titoja pohoi në raportin që i paraqiti Kongresit të 11-të se Jugoslavia është një shtet me kufij të hapur, kush dëshiron mund të hyjë atje, ashtu siç mund të dalë kur të dojë, kushdo është i lirë të bëjë kontrabandë, nga jashtë ose nga brenda.

Atëherë mund të kuptohet fare lehtë se çfarë politikë moralizuese bëjnë kjo farë Lidhje e Komunistëve të Jugoslavisë dhe ky Front Politik Jugosllav. Asgjë të mirë nuk sjell kjo politikë, përkundrazi i shtyn më tej njerëzit dhe shoqërinë jugosllave që po shkon drejt greminës. Në qoftë se në Jugosllavi ekziston një fond i ndershëm, atë do ta gjejmë te shqiptarët, deri diku te malazctë dhe në disa zona të luftës nacionalçlirimtare të malësive të Serbisë, Bosnjës e Kroacisë, kurse në qytete është përhapur degjenerimi politik, ekonomik e moral. Klubet e natës, sallat e vallëzimit janë bërë qendra drogimi e shthurjeje morale ku përpunohet degjenerimi i qytetarëve e veçanërisht i të rinjve.

Kjo është e gjithë shoqëria vëladministruese socialiste e Jugosllavisë.

Pavarësisht se ne jemi kundërshtarë të rrëptë të revizionizmit titist, të regjimit të tij kapitalist, raportin e Titos unë e lexova me vëmendje dhe përshtypja ime reale është se ky raport është si një kofin me plëchra. Plehrat janë ato fraza të përgjithshme, fraza gjoja moralizuese, fraza që u përngjasin kryekëput gënjeshtreve të atyre diplomatëve kapitalistë borgjezë që, për të të futur në thes, të thonë fjalë të mira, të cilave as vetë nuk u besojnë dhe që kanë për qëllim të të vënë në gjumë. Kështu është edhe ky raport: një raport frazash, pa brendi, pa moral, pa teori, i ndërtuar apostafat në një mënyrë të atillë pér të gënjyer. Por se sa do t'i gënjejë popujt e Jugosllavisë edhe ky është një problem që shtrohet.

Popujt e Jugosllavisë nuk janë budallenj që mund të hanë çfarëdo bari që u servir Titoja. Ata janë të zgjuar dhe kanë luftuar. Në qoftë se aprovojnë me kokë çka thotë ky kasnec i imperializmit amerikan. aprovimi është një blof, se popujt e Jugosllavisë, në përgjithësi, e shikojnë realitetin e hidhur që ka sjellë ky regjim në vendin e tyre dhe kjo i bën ata të mendojnë pér të ardhmen. Jo vetëm popujt e Jugosllavisë i shqetëson e ardhmjë, por edhe kapitalistët që kanë investuar në Jugosllavi nuk e kanë keq kur mendojnë se ç'do të bëhet pas Titos.

Realiteti i sotëm të bën të mendosh se pas vdekjes së Titos në Jugosllavi do të ngjasin ndryshime, se duhet thënë që në mashtrime Titoja ka pasur autoritet dhe mashtrimet e tij kanë zënë vend, pér arsyen

të grushtit të fortë që rëndonte mbi popujt në Jugosllavi. Ky grusht do të ekzistojë edhe në të ardhmen. Por, me vdekjen e Titos, acarimet midis shovinistëve serbë, kroatë dhe kontradiktat midis republikave të ndryshme do të thellohen më shumë dhe, qoftë «informbyroistët», siç i quan Titoja kundërshtarët e tij, qoftë rrymat e tjera me tendenca ruse, bullgare, apo properëndimore, amerikane, franceze etj., etj., do të dalin më në pah, do të shfaqen, do të përplasen me njëri-tjetrin dhe nuk do të ekzistojë më ai pseudo-autoritet moral që kishte Titoja për t'i qetësuar disi ato. Është fakt që Titoja, përveç mashtrimeve që përdorte, diti ta ngrejë personin e tij, kultin e tij në një nivel të lartë dhe ta personifikojë veten me «strategun e shquar që krijoi Jugosllavinë e re socialiste vetadministruese», pavarësisht se ky simbol e ky autoritet është i kalbur, i degjeneruar. Fakt është, gjithashtu, që ky autoritet, i ndihmuar nga klikat e brendshme, por edhe nga kapitalizmi i huaj, të cilit i ka shërbyer dhe i shërben, e krijoi këtë kult të Titos. Prandaj sa është gjallë Titoja, Jugosllavia disi po mbahet në këmbë, disi frenohen kontradiktat atje. A do të mundin Dolanci, Kardeli, Lubiçiçi të bëjnë presione ose të dominojnë mbi rrymat e kundërtë që janë gjallë e të forta në Jugosllavi? Kjo do të duket në vonë, pas vdekjes së Titos, pse edhe aktualisht tendenca, rryma e presione ekzistojnë dhe këtë e vërtetojnë raporti i kongresit, fjalimet që u mbajtën atje, si edhe masat e tjera që u morën para kongresit për të shuar këtë rezistencë që shfaqej, që zhvillohej në forma të ndry-

shme, bile nganjëherë edhe të acaruara, si për shembull, në Kroaci, në Serbi dhe në Kosovë.

Me pak fjalë, Titoja bëri testamentin e tij politik, siç thonë agjencitë e lajmeve, por ky testament ishte testamenti i një politikani të falimentuar, testamenti i falimentimit të Jugosllavisë, i falimentimit të kapitalizmit në Jugosllavi, i degjenerimit dhe i shitjes së Jugosllavisë.

Në këto drejtime mund të afirmojmë, pra, se raporti i Titos në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë ishte me të vërtetë një testament i përshtatshëm për personin e tij revisionist, antimarksist, për këtë renegat të marksizëm-leninizmit.

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 575*

## JASHTË DUART E IMPERIALISTËVE NGA VIETNAMI

*Artikull i botuar në gazeten «Zëri i Popullit»*

**24 qershor 1978**

Kanë kaluar tre vjet që kur populli i Vietnamit korri fitoren e tij të madhe mbi agresorët imperialistë amerikanë dhe shërbëtorët e tyre të urryer. Kjo hapi rrugën për realizimin e aspiratave të larta kombëtare të mbarë popullit, si në Veri ashtu dhe në Jug. Vietnam i bashkuar iu përvesh punës për ndërtimin paqësor të vendit.

Imperialistët amerikanë bënë të gjitha përpjekjet që Vietnamin ta thyenin, që këtë vend ta vinin nën sundimin e tyre neokolonialist dhe ta kthenin në një plasdarm të avancuar për agresione kundër popujve të tjerë të Azisë. I tërë potenciali ushtarak, ekonomik e politik i imperializmit amerikan u përdor për të gjunjëzuar e për të nënshtruar popullin heroik vietnamez. Mbi 6 milionë amerikanë morën pjesë drejt-përdrejt ose indirekt në këtë ndërmarrje barbare të pashëmbullt. Shtetet e Bashkuara të Amerikës shpenzuan mbi 145 miliardë dollarë, dërguan në Vietnam

gjencralët më «të shquar» të Pentagonit, ushtarët më të stërvitur, armët më moderne dhe helmet më vdekjeprurëse. Presidentët amerikanë, njëri pas tjetrit, Ajzenhaueri e Kenedi, Xhonsoni e Niksoni, shpikën e përdorën të gjitha strategjitet e «doktrinat», zbatuan politikën e «amerikanizimit» e të «vietnamizimit», taklikën e «lokës së djegur» dhe kurhet diplomatike. Por të gjitha këto dështuan me turp.

Egërsive, barbarizmave e djallëzive të imperializmit amerikan populli vietnamez u kundërvuri patriotizmin e tij të zjarrtë, vendosmërinë e patundur për të luftuar, vullnetin e çeliktë për të fituar. Sakrificat që bëri dhe heroizmi që tregoi populli i Vietnamit në luftën që iu imponua nga imperialistët, janë të pashoqe. Në altarin e fitores ai sakrifikoi jelën e miliona bijve të tij më të mirë, shkru gjithë forcat e tij materiale e shpirtërore, vendi u dogj e u përvëluar nga hekuri e zjarri i luftës së përgjakshme.

Për të gjitha këto sakrifica e heroizma, për këtë kontribut të madh e të lavdishëm të popullit vietnamez në luftën e të gjithë popujve të tjerë liridashës që janë ngritur kundër politikës agresive të imperialistëve, ai gjzon admirimin, nderimin, resppektin e simpatinë e të gjithë popujve të botës.

Kush nuk ka respekt dhe mirënjojje për këto sakrifica mbinjerëzore, ai duhet dënuar.

Populli shqiptar, i edukuar nga Partia e tij e Punes, ka përkrahur singrisht e ka mbështetur plotësisht luftën çlirimtare të popullit vietnamez kundër imperialistëve amerikanë e shërbëtorëve të tyre, ka pëershëndetur me gjithë zemër fitoret e tij heroike dhe

ka shprehur besimin e patundur në triumfin e çësh-tjes së tij të drejtë. Populli ynë, ashtu si gjithë popujt e tjerë, që kanë qenë solidarë me luftën antiimperia-liste e çlirimtare të popullit vietnamcz, ka uruar që ai t'i gjëzojë e t'i konsolidojë fitoret e arritura me gjak e sakrifica, të jetojë i lirë dhe të ndërtojë në paqe atdheun e tij socialist.

Por konfliktet e krijuara dhe përleshjet e armatosura në kufirin vietnamezo-kamboxhian, të nxitura nga të huajt, të cilat deri më sot kanë sjellë mjaft viktima, e turbulluan punën paqësore ndërtimitare të sapofilluar në Indokinë. Të gjithë miqtë e Vietnamit, midis tyre edhe populli shqiptar, me keqardhje konstatuan se mosmarrëveshjet vietnamezo-kamboxhiane, në vend që të zgjidheshin në fryshtë e miqësisë, të mirëkuptimit e të interesit reciprok, për shkak të ndërhyrjeve të huaja, u komplikuau edhe më tepër.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka shprehur qartë pikëpamjen dhe qëndrimin e saj lidhur me këtë konflikt. Në artikullin redaktorial të «Zërit të popullit» të 5 janarit të këtij viti kushtuar ngjarjeve në kufirin midis Kamboxhias e Vietnamit, thuhej se populli shqiptar ka qenë dhe është për atë që midis dy vendeve e dy popujve fqinj të cilët kanë luftuar së bashku kundër imperializmit dhe të njëjtëve armiq, të ndërpritet çdo veprim që cenon interesat e lartë të të dy kombeve, të revolucionit e të lirisë së tyre dhe ata t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në rrugën e bisedimeve miqësore. Bindja jonë ka qenë dhe është se në këtë mund të arrihet me përpjekje të përbashkëta e vullnet të mirë.

Por në vend që situata në këtë zonë të qetësohej, për shkak të intrigave e komploteve të reja imperiale të superfuqive, ajo po acarohet e keqësohet përherë e më shumië. Rreth Vietnamit është kriuar një atmosferë që nuk premton për mirë. Popujt liridashës të botës janë të shqetësuar nga ngjarjet e reja që po ndodhin, por ata kanë bindjen se populli vietnamez, që ka tradita të shkëlqyera luftarake dhe një shpirt të pamposhtur, do t'i përballojë e do t'i kapërcejë edhe rreziqet e vështirësítë e reja që i janë kriuar.

Të pengohet sot Vietnamese që të ecë në rrugën e tij të zhvillimit të pavarur e të ndërtimit paqësor, cenohet e ofendohet ndërgjegjja e gjithë popujve, e gjithë atyre që duan e respektojnë lirinë e pavarësinë e kombeve, të drejtën e çdo vendi për të vendosur vetë për punët e tij.

Midis vendeve fqinje për çështje të ndryshme mund të ekzistojnë edhe pikëpamje të kundërta. Por ne mendojmë se kjo nuk mund të jetë shkak për të kriuar e për të nxitur konflikte, se rruga e drejtë e korekte për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ajo e biscedimeve. Të kërkohet që çështjet të zgjidhen duke imponuar pikëpamjet e njërsë palë me anë të presioneve politike, ekonomike etj., kjo është e dënueshme. Kjo është një praktikë që popujt e kanë hedhur prej kohësh poshtë.

Vietnam ka pikëpamjet e veta politike e ideologjike. Kjo është çështje e tij. Por ne mbrojmë të drejtat e popullit të Vietnamese, parimin që çdo popull vendos vetë për sajet e vendit, pa ndërhyrje nga jashtë.

Askush nuk ka tē drejtē tē ushtrojë presionc e kërcë-nime ndaj tij.

Ata që zgjedhin tē tilla metoda dhe nuk pranojnë tē ulen në tryczën e bisedimeve pér zgjidhjen e mos-marrëveshjeve që mund tē lindin midis vendeve fqinje, nuk janë me tē drejtën, janë më tē dobëtit në argumente, janë fajtorët. Prandaj kushdo që mendon se mund tē imponojë pikëpamjet e qëllimot e tij me anën e rrugës së presioneve e tē shantazheve, ai duhet tē jetë i sigurt se këtë as populli vietnamez nuk e pranon dhe asnjë popull i lirë nuk e aprovon.

Pas fitores kundër imperializmit amerikan e ribashkimit tē vendit pér popullin vietnamez filloi një periudhë e re, ajo e përpjekjeve pér shërimin e plagëve tē shumta e tē rënda tē luftës, periudha e rindërtimit dhe e transformimeve socialiste. Tani askush nuk ka tē drejtë t'i ndërhyjë atij në punët e brendshme, tē pengojë zgjidhjen e këtyre detyrave dhe t'i krijojë vështirësi. Askush nuk duhet tē përzihet në çështjet se si Vietnamit i zgjidh problemet e veta, se si i trajton ai çështjet pér tē cilat është sovran.

Kur ndaj Vietnamit bëhen presione e përpjekje nga jashtë pér t'i diktuar atij si tē veprojë e çfarë të bëjë në vendin e vet, kushdo e kuption se ç'fshihet prapa parullave e fjalëve tē bukura, — «përkrahim lirinë e pavarësinë e popujve», «japim ndihma pa interes», «respektojmë tē drejtat e kombeve» etj., tē cilat imperialistët i përdorin pa kursim e pa peshim.

Tani përpara popullit vietnamez kanë dalë vësh-tirësi tē reja e tē mëdha. Por ai kurrë nuk është trembur e përkulur përpara vështirësive e presioneve. Ai,

është mësuar t'u rezistojë e t'i kapërcejë ato me vendosmëri, sado të mëdha qofshin dhe ngado që vijnë. Si në të kaluarën, edhe tani ai gjzon solidaritetin e simpatinë e gjithë popujve liridashës, të të gjitha forcave përparimtare. Ata që i qëndrojnë besnikë internacionalismit proletar, e quajnë për detyrë ta ndihmojnë e ta përkrahin popullin vietnamez kundër intrigave të fuqive të mëdha dhe të gjithë atyre që, me dashje ose pa dashje, i ndihmojnë këta.

Botuar për herë të parë  
në gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 151 (9324), 24 qershor  
1978

Botohet sipas gazetës «Zëri i  
popullit», nr. 151 (9324),  
24 qershor 1978

## RËNDËSI KA TË ZBATOHEN DETYRAT QE SHTROHEN

*Nga biseda në pushimin midis seancave  
të Plenomit të 5-të të KQ të PPSH*

27 qershor 1978

*Shoku Enver Hoxha takohet me anëtarë plenumi,  
ushtarakë dhe civilë të ftuar në Plenum.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni ju, shokë ushtarakë? Çështja që po diskutojmë në këtë Plenum është e rëndësishme. Diskutimet e shokëve qenë të mira. Mirë, shoku [Kiço] Mustaqi<sup>1</sup>, më pëlqeu diskutimi yt. Si jeni ju shokët e tjerë? Ju kemi të gjithë kuadro të përgatitur të ushtrisë sonë. Ne, të brezit të luftës, vërtet se na kanë dalë leshrat e bardha dhe nuk jemi më të shpejtë si sorkadhet, por, ama, jemi të fortë.

**SHOKU HAJRULLA MUHAMETAJ<sup>2</sup>:** Sa t'ju kemi ju dhe Partinë, gjithmonë të fortë do të jemi!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Diskutimet e shokëve

- 
1. Në atë kohë komendant njësle.
  2. Në atë kohë kuadër drejtues në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore.

qenë të mira dhe kjo është një ndihmë e madhe për të gjithë ne. Është e domosdoshme për të gjithë që t'i hyjmë studimit të materialeve të Partisë për këto çështje, sepse, siç u shtrua këtu, ushtria jonë duhet të jetë e përgatitur në mënyrë të tillë që armiku të mos na gjejë kurrë në befasi.

*Si jeni shoqe, si je ti, shoqja Emine<sup>1</sup>? Kemi dëgjuar fjalë të mira për ju andej, nga Berati.*

*SHÓQJA EMINE GURI:* Ja, po punojmë si të gjithë, ashtu siç na mëson Partia dhe ju, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë, mirë, por të mos ju rritet mendja, se, ja këta të Fierit janë një çikë më prapa. Si jeni ju, shoqja Sila<sup>2</sup> mirë?

*SHOQJA EMINE GURI:* Ata do të na arrijnë ne patjetër, se janë me sedür.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Patjetër që do t'ju arrijnë!

Si je shoku Petro<sup>3</sup>? Nuk na ke sjellë ndonjë sihariq? Presim të na sjellësh sihariqe andej.

*SHOKU PETRO OLLDASHI:* Po punojmë, shoku Enver, po përpinqemi që të arrijmë atje ku duhet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ju, shokët e Korçës, si jeni? A po i përfundoni punët e stinës?

1. Emine Guri, në atë kohë sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit.

2. Sila Veruar, në atë kohë sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit.

3. Petro Ollodashi, në atë kohë drejtor i Drejtorisë Gjeologjike të Naftës në Qytetin Stalin.

**SHOKU ENVER HALILI:** Po përpinqemi, shoku Enver. Jemi përpara punëve intensive tani.

**SHOKU ENVER HOXHA:** I keni parasysh detyrat e Plenumit të mëparshëm dhe zotimet që morët? Unë jua dhashë me shkrim porositë, prandaj duhet t'i realizoni ato zotime. Edhe ministrit të Industrisë së Lehtë e Ushqimore ia dhashë me shkrim zotimin që mori për realizimin e planit të zënies së peshkut, po ai nuk na bëri gjë, nuk e realizoi as planin, as zotimin.

U dëmtua gjë gruri nga juga<sup>2</sup> e kohëve të fundit?

**SHOKU ENVER HALILI:** Po, na dëmtoi shumë në grurë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po me panxharin, mirë jeni? I keni marrë masat për realizimin e prodhimit dhe përfundimin e zgjerimit të kombinatit të sheqerit?

**SHOKU ENVER HALILI:** I kemi marrë, shoku Enver. Edhe zgjerimin e kombinatit do ta përfundojmë patjetër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Domethënë ju, siç më thoni, i paskeni në xhep realizimet, se ai ministri i Industrisë së Lehtë e Ushqimore, siç thashë, nuk i kishte në xhep. Mirë, mirë, ju urojmë që t'i arrini këto rezultate.

Si je, more Nesip<sup>3</sup>, mirë? Babanë tënd e kam

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

2. Në kuptimin «era e jugut».

3. Nesip Ibrahimli, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tiranës.

njohur, e ke pasur të mirë. Edhe ti, me sa kam dëgjuar nga shokët, punon mirë.

**SHOKU NESIP IBRAHIMI:** Po të zbatojmë mësimet tuaja, ne mirë do të punojmë gjithnjë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Punimet e Plenumit po zhvillohen me sukses, shokët po diskutojnë mirë. Por, çështja është të zbatohen detyrat që shtrohen. Si shkojnë punimet për strehimin e banorëve të Tiranës?

**SHOKU NESIP IBRAHIMI:** Mirë. Ndërtimet vazhdojnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Që të jetë i përgatitur për mbrojtjen e vendit, populli duhet të stërvitet. Neve na duhen në çdo rast njerëz të përgatitur dhe me fizik të fortë, gjë që ka rëndësi të madhe. Është kështu apo jo? Të rinjtë tanë duhet të jenë të shkathët e të shpejtë si sorkadhe. Kur ishim të rinj, në kohën e Luftës Nacionallirimtare, ne kemi ecur me kilometra të tërë, prandaj edhe tani, brezi i ri, vazhdimisht duhet përgatitur e kalitur fizikisht.

Si jeni andej nga Mirdita, shoqja Gjela<sup>1</sup>? Ti velë si ia çon me punë?

**SHOQJA GJELA MARKU:** Mirë jemi, shoku Enver, por nuk kemi bërë aq sa duhet të bëjmë, se ju dhe Partia keni bërë shumë për ne.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të gjithë detyrën kemi bërë.

---

1. Gjela Marku (Biba), në atë kohë kryetare e Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Mirditës.

*SHOQJA GJELA MARKU:* Kritika që na është bërë është e drejtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në rrethin e Mirditës pjesën më të madhe të forcave të punës në bujqësi, rreth 75 për qind e keni me gra apo jo?

*SHOQJA GJELA MARKU:* Po, shoku Enver, ashtu është!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë, shokë! Bëni një çikë pushim, se do të fillojmë përsëri nga puna!

*Botohet për herë të parë si-  
pas shënimeve të mbajtura në  
këtë takim, që gjenden  
në AQP*

# TE PERGATITEMI NGA CDO PIKEPAMJE PER MEROJTJE QE ARMIKU TE MOS NA ZERE KURRE NE BEFASI

Konkluzione ne Plenumin e 5-te te KQ te PPSH<sup>1</sup>

27 qershor 1973

Ushtrinë e mbajmë në këmbë dhe e stërvitim për ta pasur të gatshme me qëllim që të përballojmë një sulm eventual që mund t'i kërcënojë lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë. Prandaj na vihet detyrë e madhe që këtë ushtri ta organizojmë sa më mirë, ta përgatitim si duhet politikisht, ideologjikisht, ushtarakesht dhe teorikisht. Por këtë përgatitje teorike nötua bëjmë ushtrisë dhe kuadrove që të dinë ta zbatojnë me zgjuarsi shkencën ushtarake në terrenin tonë kundër armiqve, që mund të na sulmojnë. Me këtë dua të them që ne të dimë t'i kundërvëmë takti-

---

1. Ky Plenum që u mblohdh në datën 26 e 27 qershor 1978 diskutoi rreth raportit «Mbi punën e bërë për zbatimin e vendimeve të plenumeve të 5-te dhe të 6-te të KQ të Partisë të vitit 1974, dhe të detyrave që shtroi Kongresi i 7-te i Partisë për forcimin e miëtejshëm të mbrojtjes së vendit» dhe mori vendimet përkatëse.

kës dhe strategjisë së armikut, taktikën dhe strategjinë e luftës sonë popullore, të Artit tonë Ushtarak Popullor.

Eshtë e vërtetë se armiku sulmin e tij do ta fillojë me mjete të mekanizuara moderne, të kombinuara këto nga të gjitha drejtimet, nga deti, nga ajri dhe nga toka, për të thyer rezistencën tonë, për të thyer frontin dhe për të zënë vend në tokën tonë. Të kemi kurdoherë parasysh se një sulm i armiqve tanë, cilëtdo qofshin këta, të mëdhenj ose të vegjël, do të jetë i rrufeshëm. Që në fillim armiku do të përdorë kundër nesh të gjitha forcat e tij që të na thyejë edhe ushtarakisht, edhe moralisht. Prandaj, duke i pasur këto kurdoherë parasysh, stërvitjen ushtarake dhe organizimin e ushtrisë sonë t'i ndërtojmë në një mënyrë të atillë që edhe befasinë, edhe mjetet e shumta e moderne që disponon armiku, edhe taktikën e tij të rrufeshme t'i përballojmë me vendosmëri dhe t'i shkatërrojmë ato në bazë të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore. -

Të gjitha këto taktika dhe metoda lufte, si dhe kombinimin e armëve të ndryshme nga ana e armikut ne duhet t'i parashikojmë. Të parashikojmë gjithashtu edhe kombinimin sa më të mirë në luftime të llojeve të armëve tona, në mënyrë që armët e armikut të na dëmtojnë sa më pak dhe, në fazat kur armiku do të përpinqet të çajë frontin ose të zërë vend në tokën tonë, ne të jemi në këmbë, të gjallë dhe të fortë për t'i asgjësuar të gjitha planet e tij, për të mos lejuar që të ketë sukses në veprimet e tij. Pikërisht për këtë çështje, të tëra armët kanë rëndësinë e tyre të veçantë, por çdo armë e veçantë nuk mund të merret si një ar-

më me veprimtari të kufizuar ose të pakoordinuar me armët e tjera në luftimet frontale ose në prapavija, ku armiku mund të na shqetësojë dhe do të përpinqet të na shqetësojë.

Në rast se do të dimë t'i përdorim armët tona në unitet, me efikasitet, me kritere të shëndosha e me gjakftohtësi, atëherë ne do t'i shkaktojmë humbje të mëdha armikut, pavarësisht nga numri i madh potential, si ushtarak, ashtu edhe njerëzor, që do të disponojë ai dhe do të korrim kështu suksesin. Po, pa nën-vlefshuar armët e tjera, arma e këmbësorisë duhet të konsiderohet kurdoherë ajo që do të luajë dhe ka për të luajtur një rol të madh në praktikën e luftës kundër forcave sulmuese të armikut.

Këmbësoria do të jetë ajo forcë e gjallë, që, në çdo moment, do të vihet përballë sulmeve të këmbësorisë armike, prandaj ajo, jo vetëm që në numër njerëzish duhet të jetë më e madhe, në krahasim me armët e tjera të ushtrisë sonë, por, ashtu si të gjitha armët e tjera, duhet të jetë e stërvitur posaçërisht dhe me një nivel të lartë, me një fryshtësim të madh sulmues, mbrojtës e kundërsulmues. Duke e njobur mirë taktikën dhe strategjinë e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, këmbësoria jonë do të dijë, në çdo moment, t'u kundërvihet veprimeve të armikut dhe armëve të tij, të njobura ose të panjobura, dhe do t'i bëjë këto të dështojnë në ndërmarrjet e tij sulmuese.

Prandaj merr një rëndësi të veçantë stërvitja luftarake e këmbësorisë. Ajo duhet të jetë e kualifikuar, shkencore, dhe jo një stërvitje rutinë, e thjeshtë, e katandisur në marshime pa objktiva, pa principe - të

caktuara mirë, pa detyra të përpunuara dhe pa ia vënë këto detyra në praktikë për t'i zgjidhur. Nuk u lejohet as kuadrove dhe as ushtarëve, qofshin këta aktivë, rezervistë apo vullnetarë, që të mos vënë të gjitha forcat për studimin teorik të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore dhe për zbatimin në praktikën e gjallë të këtij arti në terrene dhe në momente atmosferike të ndryshme.

Armiku mund të ketë mundësi të mëdha për rritjen e fuqisë së zjarrit, pse këmbësorisë së tij mund t'i vijë dhe do t'i vijë në ndihmë një fuqi zjarri akoma më e madhe nga ana e mjeteve ajrore dhe detare që ai ka dhe do të ketë.

Por edhe ne e kemi rritur fuqinë e zjarrit në këmbësorinë tonë dhe kjo nuk është një gjë e vogël, por e madhe. Duhet kuptuar se rritja e fuqisë së zjarrit, e përdorur mirë e në kohë, do t'i shkaktojë armikut dëme të mëdha. Ajo, gjithashtu, është edhe një faktor pozitiv psikologjik për ushtrinë tonë, pse kësaj i krijohet bindja e forcës së rezistencës sonë përballë armëve të armikut.

Të gjitha mjeteve të luftës që disponon armiku dhe që ai do t'i lëshojë kundër vendit tonë, taktikave dhe strategjisë së tij ne do t'u vëmë përballë strategjinë, taktikën, forcat dhe armët tona. Prandaj, të kuptohen thellë detyrat që dalin në kohë lufte, me synim që armiku të mos na gjejë në asnjë rast në befasi, por secili të jetë në vendin e caktuar dhe i gatshëm për t'iu përgjigjur përnjöherë me zjarr sulmeve të tij. Kjo ka rëndësi të madhe, prandaj lypset që kuadrot dhe ushtarët, nüpërmjet stërvitjeve intensive

të vazhdueshme, ta mbajnë fizikun e tyre kurdoherë të shkathët e në lëvizje. Ata duhet të zhdukin nga mendja ndjenjën e mendjemadhësisë dhe mendimin se jemi në gjendje që, në një luftë të tillë të përgjithshme edhe me një stërvitje të vogël, edhe pa një organizim të mirë, apo duke qenë liberalë në kërkimin e llogarisë ose indiferentë në marrjen e në dhënen e mësimit dhe në zbatimin e tij në praktikë, t'i bëjmë ballë fuqisë së armikut.

Domosdoshmërinë e forcimit të përgatitjes luftarake, të zhvillimit në nivel gjithnjë e më të lartë të stërvitjeve duhet ta kemi kurdoherë parasysh në ushtrinë tonë, sepse ka rëndësi të madhe dhe është një nga kyçet e fitores. Është e vërtetë se luftën e fiton ai që është më i fortë dhe forca jonë qëndron edhe në shkathësinë e trupit, në reflekset e shpejta, por, mbi të gjitha, ajo qëndron në njohjen dhe në vënien në jetë të vijës ushtarake të Partisë, të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore dhe në zbatimin si duhet të urdhreve që jepen për luftim. Prandaj nuk duhen neglizhuar në asnjë mënyrë stërvitjet, sepse çdo stërvitje që bëhet është një punë serioze që lyp një vëmendje të posaçme për ta kryer mirë. Partia në ushtri t'i kushtojë një kujdes të veçantë zhvillimit të stërvitjeve ushtarake në kushte të përaferta me ato të luftës. Kjo kërkon që oficerët të jenë të shkathët, të jenë kurdoherë pranë ushtarëve, t'i mësojnë këta si të qëndrojnë dhe si t'i zgjidhin problemet shpejt dhe me përpikëri.

Nevo na duhen stërvitje të gjithanshme, të forta dhe me nivel të lartë. Vetëm me stërvitje të tilla, të

përgatitura mirë dhe me efikasitet do të astësohen njërit tanë për të përballuar me sukses sulmet e armikut. Prandaj ato kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Stërvitjet që bëjmë duhet të jenë dinamike dhe në këtë dinamizëm duhet të zbatohet urdhri, por njëko-hësisht të punojë edhe mendja e gjithsecilit që ky urdhër të zbatohet sa më mirë në interesin e fitores sonë, me sa më pak humbje nga ne dhe me sa më shumë humbje për armikun.

Neve na duhet të stërvitemi për çdo eventualitet për një sulm nga deti, për një zbarkim ajror në mes të vijave tona të mbrojtjes, për një zbarkim ajror në prapavija, si edhe për çdo lloj lufte që mund të organizojë armiku kundër nesh. Prandaj, të gjitha këto lloje të stërvitjes duhet të zhvillohen me qartësi, me përpikëri, me një imagjinatë sa më të saktë për përleshjet që do të zhvillohen midis nesh dhe armikut, në qoftë se ky do të na sulmojë.

Në kohën kur drejtonin ushtrinë tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, shumë nga këto stërvitje s'kishin brendi, nuk shërbenin për qëllimet që duheshin, ato kishin shumë formalizëm, bë-heshin më shumë për paradë. Edhe përdorimi i armatimeve, që kemi në duar, në kohën që drejtonin elementët tradhtarë në ushtri, bëhej në mënyrë defektoze. Ne kurdoherë na shqetësonte mungesa e bashkëveprimit në mes njësive, reparteve dhe midis armëve të ndryshme. Kjo e metë, që ka ekzistuar në ushtrinë tonë, tani është ndrequr dhe duhet punuar që absolutisht të zhduket krejt, pse koordinimi i veprimeve në luftime ka rëndësi të jashtëzakonshme. Nuk mund të

mendohet që repartet dhe llojet e ndryshme të armëve të luftojnë në mënyrë të izoluar. Prandaj veprimet e tyre duhet të sinkronizohen dhe llojet e ndryshme të armëve të veprojnë së bashku. Për këtë qëllim ka rëndësi që qysh tani të kuqtohet një domosdoshmëri e tillë dhe të realizohet një sinkronizim i përsosur i stërvitjeve të reparteve dhe armëve të ndryshme. Koinandat e njësive të ndryshme, po kështu edhe komandat e armëve të çfarëdolloji, duke vepruar me plan dhe në mënyrë të studiuar e të zgjuar, të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën në lojërat, në stërvitjet, por edhe në praktikat e vogla. Edhe në teori këtë çështje ta kenë të qartë ushtarakët tanë, pse një mos-bashkëpunim si duhet i të gjitha armëve ose mungesa e lidhjeve të vepimeve të sinkronizuara si duhet në mes reparteve shkaktojnë çarje të frontit tonë ose dobësim të sulmit kundër armikut.

Pra, stërvitjet e shtabeve të zënë një vend të rëndësishëm në stërvitjet e përgjithshme të ushtrisë sonë, pse janë ato që do ta drejtojnë luftën, do të drejtojnë repartet, do të drejtojnë armët. Por çështë e domosdoshme që këto stërvitje të bëhen në terren dhe përkëtë qëllim të gjitha mjetet duhet të vihen në lëvizje dhe të provohen në shumë shkallë, duke filluar që nga kreun e deri poshtë. Në çështjet e ndërlidhjes ne kur-dohçerë kemi pasur një merak të madh dhe këtë e kemi përsëri edhe sot, pse ndërlidhja luan një rol vendimtar në luftë. Në qoftë se ajo është defektoze ose armiku i shkakton asaj në luftë defekte të shpeshta e të pariparueshme, drejtimi i luftës do të bëhet me të meta të rënda, gjë që mund të na shkaktojë vështirësi të

rrezikshme. Prandaj qysh tani edhe ndërlidhjes duhet t'i japim rëndësi që nga lart dhe deri në repartet poshtë, ashtu siç i japim rëndësi çdo arme tjetër në ushtri, siç i japim rëndësi edhe çështjes së fortifikimit.

Shkollave ushtarake duhet t'u vëmë, gjithashtu, rëndësi të madhe. Atje të dërgojmë kurdoherë kuadro të rinj të devotshëm, bij të punëtorëve dhe të fshatarëve, bij të patriotëve dhe të komunistëve, të cilët t'i edukojmë që të gjithë me një disiplinë të fortë proletare ushtarake dhe t'i pajisim me ndjenjën e sakrificës, të heroizmit dhe të qëndrueshmërisë. Studentët tanë, që dalin oficerë, t'i edukojmë të mos njojin as frikën, as panikun, të mendojnë me kokë në bazë të teorisë sonë marksiste-leniniste dhe të zbatojnë në prizmin e kësaj teorie Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, të jenë kurdoherë të palodhur, në aktivitet dhe në lëvizje, të punojnë që të kenë trup të shkathët dhe mendje të zhvilluar, të përpilen të marrin arsim dhe kulturë të përgjithshme, por të marrin veçanërisht arsim të lartë ushtarak.

Oficeri ynë të bëhet i atillë që me shembullin e tij të mobilizojë po me atë kurajë, po me atë frymëzim të gjithë efektivin ushtarak që ka nën drejtimin e vet dhe e çon në betejë. Kur flasim për kuadrot oficerë, Partia duhet të ketë parasysh si kuadrot aktivë të ushtrisë, por sidomos edhe ata rezervistë. Them sidomos edhe kuadrin rezervë, pse në rast lufte edhe ky do të komandojë nënrepartet, prandaj qysh sot ka shumë nevojë për stërvitje, për drejtim, për organizim, për frymëzim. Kjo kërkon që t'i vihem me zell të madh punës në këtë drejtim, t'i vihet, me një fjalë,

rëndësi e madhe përgatitjes dhe edukimit të këtyre kuadrove.

Kuadrot tanë ushtarakë rezervistë duhet t'i freskojnë vazhdimisht njohuritë që kanë marrë qysh kur kanë qenë në ushtrinë aktive. Repartet që ata janë ngarkuar të drejtojnë dhe të edukojnë në shkollat e lira, t'i konsiderojnë si reparte aktive luftarake me të njëjtat cilësi moralo-politike-ushtarake dhe tekniko-organizative që kanë edhe repartet, ku ushtarët kryejnë shërbimin ushtarak të rregullt. Këta kuadro të rezervës, që do të komandojnë e do të drejtojnë këto njësi, të cilat do të përbëjnë ushtrinë tonë të madhe, forcat vullnetare dhe ato të mbrojtjes civile, duhet të kenë parasysh se fatet e luftës dhe të fitores mbi armikun varen shumë edhe nga ata vetë dhe jo vetëm nga shtabet kryesore.

Komandanti, komisari dhe shtabi i njësisë më të ulët kanë një rol vendimtar në zbatimin e urdhreve të eprorëve. Prandaj përgatitjen e tyre, në armët ku ata kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë, pavarësisht pse janë në rezervë, duhet ta kcnë plotësisht të përkryer e me cilësi të lartë, pra, të jenë të aftësuar mirë si për dhënien e mësimit, për zbatimin e urdhreve, për zhvillimin e direktivave, ashtu edhe për themlin e tyre. Në të gjitha këto drejtime ata të jenë rigorozë, të shkathët e të disiplinuar.

Kur theksova se puna e Partisë me kuadrot dhe me gjithë punonjësit, kudo ku ata e kryejnë veprimtarinë e tyre të përditshme, duhet të lidhet ngushtë edhe me përgatitjen e tyre ushtarake, kam parasysh që ajo të lidhet me momentet aktuale. Kjo është absolutisht e do-

mosdoshme. Është e qartë se ai punëtor, kooperativist ose intelektual që sot tregohet dhe duhet të tregohet në jetë i disiplinuar, që zbaton një disiplinë proletare në punën e përditshme të tij, ai do të tregohet me siguri i disiplinuar edhe në zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror të Partisë e të Komandës së Përgjithshme në kohë lufte. Ai që e merr këtë edukatë që tanë, do të ketë forcë e aftësi në veten e tij për të zbatuar si duhet edhe detyrën e madhe të mbrojtjes së atdheut. Atij punonjësi që zbaton me përpikëri normat teknike për realizimin e planit në kohë, në sasi dhe me kur-sime të mëdha, nuk ka përsë të mos i bëhet edukatë e shprichi edhe zbatimi me përpikëri i detyrave ushtarake. Të njëjtat norma duhen zbatuar me përpikëri, në kohën e në vendin e caktuar, si në punët e zakonshme, ashtu edhe në ushtri. Edhe këtu duhet të zhvillohet ndjenja e ekonomisë, jo vetëm për sa i përket administrimit e mirëmbajtjes së armatimeve, të pafisjeve, të predhave, të municioneve, të konservimit të mirë të armëve, por edhe të ushqimeve dhe të veshmbathjes, për arsyen se, sidomos në kohë lufte, ato nuk sigurohen aq lehtë, prandaj rezervat duhet të ruhen me kujdesin më të madh dhe vazhdimisht të shtohen. Është e kuptueshme se në kohë lufte niveli i industrisë dhe i bujqësisë sonë nuk do të jetë ai i sotmi, prandaj kush mendon e punon mirë për të sotmen, ai ka menduar e punuar mirë edhe për kohën e luftës.

Ai punonjës ose komunist që i kuption mirë aktuallist situatat politike, që kuption si duhet luftën e klasave, që kuption mirë kontradiktat joantagoniste dhe

antagoniste, edhe në kohë lushtë ai do të jetë i armatosur si duhet politikisht dhe ideologjikisht, do të jetë i zgjuar dhe vigjilent kundër armikut që do të na sulmojë, si dhe kundër armiqve të brendshëm, të cilët nuk do të mungojnë të ngrenë veshët dhe të na sabotojnë. Ai që i ka të qarta aktualisht të gjitha këto çështje do të jetë i dashur dhe i shtrenjtë për trupën, për njerëzit që komandon, për mbarë popullin në përgjithësi.

Prandaj mendoj që puna politike dhe ideologjike, çështja e rendimentit dhe e disiplinës, e normave në punë, qoftë në industri, qoftë në bujqësi, në arsim, në kulturë e kudo, duhet të pleksen, të shtrohen dhe të shpjegohen sa më qartë lidhur edhe me detyrat e mbrojtjes dhe të kuptohet si duhet se gjithë këto të mira, këto virtute, të fituara me aq djersë e me mund, do të na shërbejnë jashtëzakonisht shumë për të përballuar çdo sulm nga ana e armiqve dhe për ta thyer atë me sukses.

Për këto çështje, natyrisht, duhen bërë leksione, por leksioni më i mirë është zbërtimi e zgjidhja konkrete dhe lidhja ngushtë e gjithë këtyre problemeve me punën e përditshme të njerëzve tanë: shpjegimet e sqarimi i tyre, përsëritja pa fraza, pa fjalime të përgatitura, por në punë e sipër shoku-shokut, brigadieri punëtorëve, punëtorët brigadierit, brigadieri shtabit të ndërmarrjes, shtabi i ndërmarrjes brigadierëve dhe punëtorëve, komunisti i thjeshtë udhëheqjes së organizatës-bazë dhe udhëheqja komunistëve. Në qoftë se zhvillojmë një punë të tillë politiko-teorike dhe konkrete, të lidhur ngushtë me jetën e përditshme, atë-

herë mund të themi se e kemi bërë punën si duhet dhe çështjen e edukimit e të kalitjes ushtarake e kemi integruar në jetën e punonjësve tanë.

Nuk dëshiroj të zgjatem shumë për këtë çështje kaq të rëndësishme që përbën përgatitja e Ushtrisë së Popullore për kohë lufte, për arsyen se raporti i Byrosë Politike i bën të qarta të gjitha problemet. Çështja qëndron në atë që Komiteti Qendror i Partisë, si kudoherë, duhet të jetë i ndërgjegjshëm se përpara atdheut, përpara popullit tonë dhe çështjes së ndërtimit të socializmit në Shqipëri vihen detyra të rënda për t'i zbatuar, se për zbatimin si duhet të atyre lypsen përpjekje akoma më të mëdha se ato që kemi bërë deri tani.

Të mos harrojmë, shokë, se kemi pasur disa dobësi e të meta në çështjet e përgatitjes së ushtrisë, për arsyen të veprimitarës armiqësore tradhtare të grüpuit të Beqir Ballukut, që zbuluan dhe goditën. Aktualisht ushtria jonë ka bërë përparime dhe ecën në rrugën e vërtetë të modernizimit dhe, kur them të modernizimit, kam parasysh atë që ushtri dhe kuadro i kuptojnë problemet ushtarake në rrugën e drejtë politiko-ideologjike të Partisë së sonë, i shohin lidhur edhe me situat atuale që zhvillohen në botë dhe me ato të perspektivës së vendit tonë.

Me organizimin e ri të ushtrisë, e cila përbledh gjithë popullin dhe e bën atë të stërvitet ushtarakisht, kërkohet një kuptim dhe një aplikim më i thellë i Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Këtë art duhet që gjithë Partia, i madh e i vogël, ta ketë të qartë. Me këtë dua të them që të gjitha kategoritë e njerëz-

ve, që nga më i vogli e deri te më i madhi, në punët e tyre, në detyrat që u ngarkohen dhe do t'u ngarkohen në kohën e luftës, të kenë të qartë se çduhet të bëjnë dhe, që ta kenë të qartë këtë gjë, ta mësojnë atë që duhet të bëjnë, të kenë plotësisht të qartë, përveç anës teknike të luftimit dhe të organizimit, edhe thelbin politiko-ideologjik të detyrës që u vihet përpala për t'u zgjidhur, sepse çështja e ushtrisë nuk është një çështje vetëm organizative, siç mendonin njërit e grupit tradhtar të Beqir Ballukut.

Ushtria jonë duhet të ketë koncepte të drejta përrëndësinë politike që merr ajo situatë e vështirë, që do të krijohet për atdheun tonë, kur të gjendet përballë sulmeve të armiqve agresorë dhe pushtues. Duhet gjithashtu të ketë të qartë se atdheu duhet mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë me sakrifica dhe me gjak. Çështja e luftës është një çështje e vështirë nga të gjitha anët, nga ana njerëzore, nga ana materiale, nga ana morale dhe nga ana psikologjike. Këto vështirësi të mëdha duhet të na gjejnë të përgatitur në të gjitha aspektet që krijon një moment i tillë i rëndë, se kështu do ta përballojmë me sukses. Asnjë situatë të mos na gjejë kurrë në befasi dhe, që të mos na gjejë në befasi, është e domosdoshme që të gjithë anëtarët e Partisë të jenë të ndërgjegjshëm se momentet e krijuara nga agresioni ushtarëk i armiqve tanë, sado të vështira që të jenë, duhen përballuar dhe mund të përballohen me sukses vetëm me një përgatitje të mirë ideologjike e ushtarake të forcave tona të armatosura, të tërë popullit ushtar.

Parapërgatitja tekniko-ushtarake me stërvitje të

shumta, me aplikimin e detyrave ushtarake, me një kuptim të thellë dhe të vazhdueshëm të këtij problemi duhet bërë qysh tani në kohë paqeje, kur ne ndërtojmë socializmin. Çdo gjë, çdo veprim në fabrikë, në ara, në shkolla e kudo të lidhet me çështjen ushtarake dhe, kur them të lidhet me çështjen ushtarake do të thotë që puna e përditshme e gjithsecilit të shihet e lidhur ngushtë me mbrojtjen e atdheut. Kjo do të thotë që kur punojmë për realizimet e planeve, të mos kemi parasysh vetëm ato ekonomike dhe kulturore, por edhe detyrat e planet ushtarake, që na vihen përpara të gjithëve, pse të gjithë jemi ushtarë, të gjithë do të luftojmë dhe të gjithë do të mbrohemë.

Prandaj, vëmendja për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm merr një përbajtje shumë të lartë ideologjike. Interesi i përgjithshëm konkretizohet në mbrojtjen e atdheut, në mbrojtjen e fitoreve të pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit. Nuk ka interesa më të lartë se këta, prandaj çdo veprim i përditshëm nga ana jonë duhet të përqendrohet në këto çështje.

Disa e kanë parasysh këtë problem të madh, nuk e harrojnë, por ka edhe njerëz që mendojnë se të realizosh planin e grurit ose të pambukut është e mjaf-tueshme. Realizimi i planeve në të gjithë sektorët, në ekonomi, në arsim e kulturë etj. ka rëndësi të madhe dhe është absolutisht i domosdoshëm të kryhet, për arsyen e është një nga detyrat kryesore për ndërtimin e socializmit, për forcimin e ekonomisë, të mirëqenies së popullit, të ngritjes e të kalitjes së moralit proletar, të ndërgjegjes proletare në punë e në luftë, për forcimin e atdheut tonë socialist. Ndërtimi i socializmit

është një luftë e madhe, bille shumë e madhe, është një parapërgatitje serioze absolutisht e domosdoshme për të përballuar detyrat shumë të mëdha të së ardhmes. Por lufta që bëjmë për realizimet e planeve nuk duhet të na bëjë që të lëmë mënjanë ose në radhë të dytë stërvitjet ushtarake dhe me këto nuk kam para-sysh vetëm ato ditë të caktuara me ligj për stërvitjen e rezervistëve, të forcave vullnetare apo të studentëve etj. Jo, me stërvitjen luftarake unë kuptoj atë preokupacion politik, ideologjik dhe teknik që Partia duhet t'uua futë mirë në mendje njerëzve se çdo veprim i tyre bëhet për mirëqenien e përgjithshme, e cila rrezikohet nga armiqtë imperialisto-rezisionistë që na rre-thojnë, prandaj, çdo veprim i përditshëm që kryhet nga ana jonë, duhet të konceptohet si një masë përgatitore mbrojtëse.

Përveç kësaj, studimi dhe aplikimi i Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore në ushtrinë aktive, në shkollat e lira, në forcat vullnetare dhe në të gjitha masat e popullit ushtar duhet të konsiderohet një detyrë absolutisht e domosdoshme, e veçantë, detyrë mbi të gjitha detyrat e tjera që duhet të kryhet, por të kryhet në tërë kompleksitetin e vet. Kur themi në kompleksitetin e vet, me këtë duhet të kuptojmë mirë që stërvitjet të zhvillohen sikur të jemi në luftë të vërtetë. Kjo do të thotë që të gjithëve t'u punojë mendja dhe trupi, që këta të dy të janë në harmoni; që njerëzit tanë të zotërojnë mirë armët, të njojin terrénin, të njojin stategjinë dhe taktikat tona të luftës, të njojin gjithashtu edhe armikun, të cilin nuk duhet kurrë as ta mbivlerësojmë, as ta nënvleftësojmë.

Prandaj me stërvitjet luftarake duhet të punojë shumë dhe në shkallë të gjërë Partia, ajo duhet të mbulojë me punën e saj përgatitjen politiko-luftarake të të gjithë masës së popullit ushtar. Në stërvitjet luftarake ana tekniqe nuk është diçka fantaziste, as një propagandë e rëndomtë, por është një edukim i gjërë tekniko-profesional. Në rast se tornitori nuk e mëson mirë zanatin, nuk mund ta vërë në lëvizje tornon; traktoristi që nuk mëson si duhet ta drejtojë, ta zbërthejë dhe ta mbërthejë traktorin kur i prishet, nuk mund të jetë një traktorist i mirë; po ashtu një ushtar, qoftë aktiv, qoftë rezervist, qoftë vullnetar, nuk mund të jetë ushtar i mirë, në rast se nuk përgatitet si duhet nga ana tekniko-ushtarake, në qoftë se nuk e mëson si duhet specialitetin e tij në mësimet që zhvillohen për të në kurse të veçanta teorike dhe në praktikë. Prandaj, në këto kurse, në këto aktivitete ushtarake tekniqe cilido duhet të shkojë me dëshirë dhe të mësojë me zell, sepse është absolutisht e nevojshme të aftësohet dhe të zotërojë në ushtri një a më shumë specialitete.

Krahas këtyre një përgatitje të veçantë dhe serioze kërkon çështja tjeter e madhe, ajo e taktikës së luftës, e përdorimit si duhet, me efektivitet e me shpejtësi, në terrene të ndryshme dhe në kohë të ndryshme të armëve që kemi në përdorim. Secili duhet të dijë t'i përdorë ato më së miri, duke menduar kurdoherë se do të kemi përpëra armiq të egër e të armatosur deri në dhëmbë me mjete moderne. Në qoftë se çdonjëri do të mendojë kështu, atëherë do t'u bëhet ballë me sukces edhe sasisë, edhe armëve moderne të armiqve.

Por, që atyre t'u bëhet ballë, nuk mjaftojnë vetëm stërvitjet në kohën e caktuar. Çështja është që çdo ditë, kudo ku gjendet njeriu, kur ka kohë të lirë (dhe secili duhet ta gjejë këtë kohë) ashtu siç mendon për çështjet e tjera, ai duhet të mendojë edhe për problemet ushtarake. Në shkollat e lira ushtarake, secili mëson të njohë vendin ku do të zërë pozicionin, krijon në kokën e tij topografinë e terrenit në hollësirat më të vogla dhe mbi këto hollësira ai ndërton shumë e shumë taktika lufte, të cilat në momentin më të rrezikshëm, kur të marrë urdhër që të veprojë, kur do të gjendet me të vërtetë në terrenin e përshtatshëm të tij, gjë që ka një rëndësi të jashtëzakonshme për luftim, për manovrim, për sulm, për tërheqje, për kundërsulm dhe për shfarosjen e armiqve, të bashkuara së toku, në një mendim të njëjtë, me zbatime të ndryshme e në vazhdimësi, përbëjnë atë krijim të pikëpamjes së vërtetë politiko-ideologjike dhe teknike të përgatitjes së Ushtrisë sonë Popullore qysh tanë në kohë paqeje për të përballuar një rrezik eventual.

Një kuptim i tillë i detyrave i zhduk ato pikëpamje që mund të kenë mbetur te disa nga koha e luftës që edhe grupi tradhtar i Beqir Ballukut kërkonte t'i zhvillonte në ushtrinë tonë, siç është pikëpamja e gabuar e lënies së menjëhershme të terrenit të luftës, me sulmin e parë të armikut, e daljes në mal dhe e zhvillimit andej të luftës partizanc. Jo, Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore përcakton ekzaktësisht se lufta jonë, kur të na sulmojnë, do të jetë një luftë frontale dhe se nuk do t'i lëshojmë asnje pëllëmbë tokë armikut. Edhe në qoftë se armiku do të arrijë në ndonjë

rast të na zaptojë një pjesë të territorit tonë, ne do t'i qepemi atij si gërthëla, do ta kundërsulmojmë vazhdimisht derisa ta hedhim përtej kufijve tanë dhe nuk do ta lejojmë që ta zgjerojë më tej territorin e okupuar prej tij. Prandaj kuptimi i luftës frontale që do të bëjmë është i domosdoshëm nga i madh e i vogël në vendin tonë.

Në vendin tonë populli është në fuqi dhe ai duhet ta mbrojë me çdo kusht shtetin e vet socialist. Nuk është më në Shqipëri një regjim si ai i Ahmet Zogut, i cili e shiti vendin dhe populli u detyrua të hidhej në male. Aktualisht, Shqipëria është një vend socialist, i fortë, i lulëzuar dhe ai duhet të mbrohet nga të katër anët, të mos e lejojë armikun të zërë asnje qo-she, pa lëre që të depërtojë në thellësitë e vendit tonë. Terreni ynë është përgatitur dhe është e domosdoshme që të përgatitej për një luftë frontale, prandaj tash ne duhet të përgatitim mirë edhe kuadrot e mbarë popullin tonë që të kenë parasysh se lufta që do të bëjmë e tillë do të jetë dhe do të bëjë që armiku të dështojë që në veprimet e tij të para. Kjo duhet të jetë bindja e formuar qartë në mendjen e njerëzve tanë ushtarë.

Unë, shokë dhe shoqe, nuk do të zgjatem më te-për. Partia dhe ushtria jonë kanë shumë materiale në dispozicion për këto probleme, prandaj i kanë të qarta, veçse duhet t'i thellojnë, t'i zgjerojnë, t'i zhvillojnë më tej e t'i zbatojnë në jetë. Kam bindjen se Ushtria jonë Popullore, e cila edukohet vazhdimisht me vijën e drejtë politike, ideologjike dhe ushtarake të Partisë, do të jetë kurdoherë e gatshme për detyrën e saj të lartë, fisnike, për heroizmat dhe sakrificat që duhet të

bëjë për jetën e popullit, për atdheun e lirë, për ndërtimin e socializmit.

Me këtë rast dëshiroj t'ju përshëndes nga zemra për 35-vjetorin e ushtrisë sonë heroike, që u themelua nga Partia dhe u kalit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër nazifashistëve dhe tradhtarëve të vendit.

Të rrojë Partia!

Të rrojë e të forcohet Ushtria jonë Popullore!

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Për Ushtrinë Popullore»  
(Përbledhje veprash), Ti-  
ranë 1984, vëll. II, f. 357*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Ushtrinë  
Popullore» (Përbledhje ve-  
prash), Tirana 1984, vëll. II,  
f. 357*

## **KUADROT E PARTISË DUHET TË KENE HORIZONT TË GJERE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**29 qershor 1978**

Dua të shpreh disa mendime për kriteret që duhet të kemi parasysh për zgjedhjen e kuadrove të Partisë. Problemet e Partisë nuk janë çështje burokratike, po probleme të thella ideopolitike, organizative, shoqërore, filozofike, psikologjike etj. Normat e Partisë nuk duhen kuptuar në mënyrë të rëndomtë. Por, për të mos i kuptuar kështu, sekretari i komitetit të Partisë të rrëthit është e nevojshme të jetë njeri me horizont, me qëllim që t'i analizojë drejt problemet shqetësuese të rrëthit në tërë kompleksitetin e tyre.

Çështjet që kanë të bëjnë me njerëzit në përgjithësi, pra edhe me anëtarët e Partisë që jetojnë në shoqëri, që influencojnë për ecjen e saj përpara, por edhe që influencohen nga ajo në jetë, shfaqen me variante dhe me intensitetë të ndryshme, sepse të tërë njerëzit nuk janë të prerë si me gërvshërë. Prandaj edhe puna e punonjësve të Partisë nuk mund të kon-

sistojë në asnjë mënyrë në një rutinë të thjeshtë ose në një njohje burokratike të parimeve dhe të normave që udhëheqin gjithë veprimtarinë praktike revolucionare të Partisë, si dhe edukimin e komunistëve dhe të punonjësve. Këto parime e norma punonjësit e Partisë jo vetëm duhet t'i dinë mirë, por edhe të udhëhiqen prej tyre për të kuptuar zhvillimin e jetës, karakteristikat dhe ndryshimin e fenomeneve. Në këtë prizëm duhet të gjykojmë nëse një komunist e ka parasysh ose jo si duhet Statutin, domethënë normat e Partisë. Edhe kur personi apo komunisti ka një aktivitet pune të gjerë, duke u nisur vetëm nga ky fakt, nuk duhet të arrijmë në konkluzionin se ai i ka kuptuar normat e Partisë në atë thellësi dhe në atë gjerrësi që kërkojmë ne. Ai duhet të ngrihet në atë nivel që, në çdo ngjarje të jetës së tij dhe të Partisë, të jetë në gjendje që të bëjë verifikimin e çdo veprimi a mendimi të tij ose të shokut, duke u bazuar në normat e Partisë.

Komunisti, dhe aq më tepër një kuadër drejtues partie, duhet të jetë në gjendje të shohë më larg e t'i trajtojë problemet më thellë. Nuk i lejohet sekretarit të një komiteti partie që kur ndodh diçka, që ka të bëjë me thyerjen e unitetit, ta shohë ngjarjen fare thjesht, duke nxjerrë si çështje themelore faktin anësor, nëse autori i saj ka qenë, ta zëmë, komandant i çetës apo jo. Ta shohësh problemin kështu, në mënyrë të thjeshtë, mund ta verifikosh fare lehtë, por nuk mund të jetë ky problemi kryesor. Çështja kryesore është prishja e unitetit, gjë që duhet parë përsëri në një prizëm shumë më të gjerë. Në qoftë se nuk e shi-

kojmë thellë problemin, armiku i klasës gjen terren, ai mund të kapërcejë nga një rreth i ngushtë njerëzish dhe të veprojë në një rreth shumë më të gjerë, mbasi vendi ynë është i vogël, fshatrat janë afër njëri-tjetrit dhe njerëzit kanë lidhje gjaku ndërmjet tyre. Ka fshatra që, megjithëse kanë 20-25 familje, janë të ndara në dy ose në tri fise, bile qëllon shpesh që edhe këto fise janë të afërtë me njëri-tjetrin, mund të jenë bile edhe të një gjaku. Megjithatë koha bën punën e vet, ajo i ndan këto familje fillestare dhe natyrisht kriohen kështu, brez pas brezi, familje të reja që marrin mbiemra të rinj dhe kanë dëshira dhe aspirata të reja. Në këto kushte, në qoftë se nuk punon Partia, atëherë do të bëjë punën e vet subjektivizmi, egoizmi, nxitja për të zënë vende kyç, për të eliminuar të tjerët, grindjet etj.

Prandaj këto probleme nuk duhet të shihen shumë thjesht. Shokët që merren me punën e Partisë në rreth, për zgjidhjen e çdo problemi duhet të shohin kurdoherë gjendjen brenda në organizatën-bazë të Partisë. Gjithashtu, në përgjithësi, ata duhet të njohin edhe mendimin e përgjithshëm të Partisë në rreth. Me këtë duhet kuptuar që shokët sekretarë ose instruktörë të komitetit të Partisë të rrethit, më parë se çdo gjë, duhet të njohin e të dinë ambientin dhe frymën e çdo organizate. Me frymë të organizatës kemi para-sysht mënyrën e të kuptuarit të vijës dhe të ideologjisë së Partisë nga kjo organizatë. Në qoftë se kjo frymë është e shëndoshë, atëherë problemet që i dalin organizatës, të çdo natyre qofshin, shikohen në prizëm të drejtë dhe zgjidhen si duhet, brenda normave. Në këtë

organizatë, natyrisht, jeta nxjerr gjëra të reja, por as mbeturinat e ndryshme nuk përjashtohen të shfaqen, se komunistët nuk janë të prerë me thikë, nuk janë të një niveli dhe nuk janë të paprekshëm nga influencat jashtë Partisë, domethënë të rrethit shoqëror ku rröjnë. Nuk ka se si të mos gjenden ata në disa raste përparrë situatave kontradiktore me njëra-tjetërën, por, në qoftë se fryma e Partisë është e shëndoshë, këto kontradikta qëndrojnë në kuadrin e kontradiktave joantagoniste dhe janë të zgjidhshme. Kur fryma ideologjike në një organizatë-bazë partie nuk është e shëndoshë, atëherë krijojen tarafe, problemet nuk zgjidhen, kontradiktat joantagoniste jo se kthehen përnjëherë në antagoniste, por ato shndërrohen në vësh-tirësi të tilla që e vënë organizatën e Partisë në pozita shqetësuese dhe e pengojnë të ecë përparrë, prishin atë hov që duhet të ketë ajo për realizimin e detyrave.

Prandaj njojja e gjendjes së rrethit nga punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë, nga të gjitha organizatat-bazë të Partisë dhe udhëheqjet e tyre, ka rëndësi të madhe. Kur njihen këto, atëherë nxirren më drejt konkluzione të përgjithshme për masat që duhet të merren për shëndoshjen e gjendjes së organizatës së Partisë në të gjithë rrethin.

Në përgjithësi duhet të njihet, në radhë të parë, niveli ideologjik i organizatës së Partisë të rrethit. Në rast se ky nivel është i mirë, atëherë duhet punuar më tej për forcimin e situatës. Por, kur bëjmë analiza të ndryshme dhe del që ka shfaqje negative, atëherë në to duhet ndalur dhe duhen marrë masat e përshtatshme. Për të bërë analizën e problemeve që preoku-

pojnë organizatën mund të përdoren dy mënyra:

Së pari, duhet të bëhet analiza e përgjithshme e shfaqjeve negative, por pa vënë gishtin konkretisht ku ekzistojnë këto dhe pastaj të bëhen analizat specifike për këtë ose për atë organizatë-bazë partie. Në qoftë se sekretari dhe instruktorët e komitetit të Partisë punojnë në mënyrë të tillë me organizatat-bazë, ata do ta kenë vazhdimisht në dorë gjendjen e organizatës së Partisë të rrethit. Kështu do të dinë se në ç'drejtëtim duhet të marrin masa, cilit problem duhet t'i kushtojnë vëmendje më shumë dhe përse pikërisht këtij; do të gjejnë format më të mira të punës pér ta shëndoshur situatën dhe pér të zgjidhur ato kontradikta joantagoniste që nuk kanë marrë akoma formën e një veprimtarie armiqësore. Në qoftë se veprohet ndryshe, do të thotë se puna e Partisë konceptohet deri në njëfarë shkalle si një punë joshkencore dhe e përciptë dhe do të ngjasë siç ndodh nganjëherë që, largohesh nga një organizatë, të njëjtat probleme dalin. Në organizata të tjera, pra qëndron gjendja aty ku ishte në fillim. Po pse dalin problemet kështu? Dalin kështu se bëhet një punë e përciptë, joshkencore, që nuk të lejon ta kesh në dorë gjendjen e organizatës së Partisë në rreth. Prandaj në këtë formë, në drejtimin që përmenda më sipër, duhen orientuar pér punën e Partisë drejtuesit e saj në rrethe. Trajtimi teoriko-politik i problemeve të Partisë është njëra anë. Po nuk e bëre këtë, atëherë nuk mund të zgjidhësh as çështjen tjetër, pra nuk i gjen dot arsyet pse ngjasin këto fenomene. Dhe në këtë drejtim ka një sërë ar-

syesh njëra prej të cilave është se nuk njihet përbërja e organizatës-bazë të Partisë.

Sekretari ose instruktori i komitetit të Partisë, para se të shkojë për kontroll e ndihmë osc për verifikim të çështjeve të caktuara në një organizatë-bazë partie, duhet të bëjë një punë paraprake për njojjen e kësaj organizate. Për shembull, ai e di se ç'është ky apo ai fshat, por, kur të shkojë atje, duhet të njihet më parë me disa të dhëna nga historiku i organizatës-bazë të Partisë të këtij fshati, historik që duhet të ndodhet në kartotekën e komitetit të Partisë të rrethit. Në qoftë se rrethi nuk e ka të plotë këtë historik, duhet të merren masa e të punohet që ai të plotësohet, se do të shërbejë për njojjen e përbërjes së efektivit të kësaj organizate. Kur themi të njihet përbërja e efektivit të organizatës, nuk është fjala vetëm për njojjen e origjinës shoqërore të komunistëve në përgjithësi, sepse ajo mund të jetë për të tërë anëtarët e saj një origjinë fshatare, por të evidencohej mirë kjo origjinë për secilin se mund të jetë fshatar i pasur (pse edhe fshatarë të pasur janë shkëputur nga shtresa e tyre dhe kanë bërë luftën), i mesëm apo fshatar i varfër. Në organizatat e fshatit ka pastaj intelektualë, mësues, mjekë, agronomë, ekonomistë e të tjera.

Për njojjen e efektivit të organizatës-bazë duhet ditur edhe niveli politiko-ideologjik i tij, nëse anëtarët e kësaj organizate kanë bërë kurse apo jo, duhet krijuar gjithashtu edhe një ide për nivelin kulturor e teknik të tyre.

Faktor tjetër me rëndësi për njojjen e jetës së brendshme të organizatës-bazë të Partisë është edhe

gjendja e pranimeve në Parti. A janë bërë në rregull dhe sipas kritereve të caktuara këto pranime apo jo, kanë qenë të drejta pranimet sipas nevojave të sektorëve apo nuk kanë qenë të drejta, janë bërë pranime me frymë të shëndoshë ideologjike apo janë bërë në frymë tarafi e familjare, që, siç e dimë, me gjithë luf-tën kundër tyre, akoma ekzistojnë në fshatin tonë, bile edhe në qytete.

Kjo njohje e organizatave të veçanta, dhe pastaj e gjithë organizatës së rrithit, është një punë që nuk mund të bëhet në një ditë. Për këtë çështje duhet të bëhet një punë sistematike, kjo duhet të bëhet jetë e shokëve drejtues në rrith, prandaj mendoj se, sa më gjatë që të rrijë, në mënyrë të veçantë sekretari që merret me çështjet organizative të Partisë, në një rrith, aq më mirë do të jetë për punën, për arsyen se ai do t'i njohë gjithnjë e më mirë organizatat në përgjithësi dhe komunistët veç e veç, do të njohë të metat dhe cilësitë e mira të tyre. Duke qenë kështu, ai do të jetë në gjendje të dallojë lehtë kur vërtetohet ndonjë ngjarje e papritur, nëse kjo është e rastit, është me rrënje të thella sociale, apo është rezultat i ndikimeve që i vijnë nga jashtë organizatës. Po edhe kur të dalë që rrënjet e kësaj ngjarjeje të papritur janë jashtë organizatës, ai në fund të fundit do ta marrë me mend se shkaku i së keqes duhet të gjendet brenda në fshat apo në një fshat tjetër afër, rrjedh nga një njeri i veçantë apo e ka burimin te pikëpamjet e njerëzve me të cilët bashkëjetojnë komunistët.

Stazhi i gjatë në punën drejtuese të Partisë është njëra anë që kërkonhet për ta kryer mirë punën një se-

kretar partie. Ky stazh, siç thamë, ndihmon punën, por që ta kryejë akoma edhe më mirë detyrën, shoku që merret me këtë punë duhet të ketë kulturë të përgjithshme dhe, në radhë të parë, të zotërojë ideo-logjinë tonë, pra të jetë punëtor partie me njohuri marksiste-leniniste. Ndodh që një komunist, meqenëse është punëtor, e zgjedhin sekretar të komitetit të Partisë. Unë mendoj se po të nisen vetëm nga ky kriter, nga fakti se ky është një punëtor i mirë, nuk është e mjaftueshme, pse, pavarësisht se është element i klassës, nuk do të jemi plotësisht të sigurt që ai do të mund ta kuptojë, ta drejtojë dhe ta ndihmojë organizatën në mënyrën që përmenda. Prandaj ndërmjet kandidaturave të mundshme për këtë funksion ne duhet të gjejmë punëtorë të tillë që të kenë edhe një kulturë të përgjithshme të mirë. Përse duhet të ketë kulturë të përgjithshme? Që të ketë atë kapacitet të nevojshëm intelekti, të cilin, edhe po nuk e pati, duhet të bëjë përpjekje që ta krijojë për të kuptuar drejt zhvillimin e shoqërisë dhe të veprimtarisë së Partisë në rrethin e tij dhe për të zgjidhur drejt problemet. Ai duhet të jetë në gjendje që të kuptojë se po drejton në këtë rreth popullin që ka bërë një revolucion të madh. Në përgjithësi jo vetëm populli, por edhe organizatat-bazë në çdo rreth kanë disa karakteristika, të cilat duhen mbajtur parasysh, se ndeshen gjatë punës. Prandaj sekretari i Partisë duhet të jetë edhe njeri me kulturë të përgjithshme. I tillë ai nuk mund të lindë, por duhet të përpinqet që të bëhet, se kështu do të jetë në gjendje ta ndryshojë një situatë jo të favorshme që krijohet.

Partia ka vënë në dispozicion të punonjësve dhe të komunistëve një sërë mjetesh të rëndësishme që ndihmojnë në edukimin e tyre, si kinemanë, teatrin, estradën, grupet artistike, shtypin, shkollat, kurset, librat etj. etj. Kuadri që vendoset në ta ka shumë rëndësi, por, që të gjitha këto mjete t'i shërbejnë tërësisht qëllimit, Partia në rreth duhet të dijë se si t'i drejtojë. Në rast se e merr një shok, për shembull, drejtpërdrejt nga një kooperativë, duke u bazuar vetëm në atë se ka qenë një kooperativist ose kryetar kooperative i mirë, dhe e zgjedh sekretar partie, ai, kur nuk i plotëson të gjitha kushtet, nuk është në gjendje t'i shikojë problemet e Partisë në prizmin që thashë, sado i mirë që të jetë.

Por sekretari i komitetit të Partisë duhet të ketë edhe një kulturë speciale për punën e Partisë dhe mendoj se tash ka punëtorë të tillë, që janë të aftë ta përvetësojnë mirë dhe shpejt fryshtë e punës së Partisë; këtu e kam fjalën për punën e gjallë me njerëzit dhe jo «për fryshtë e aparatit» të Partisë, sepse, kuptohet, po të marrë fryshtë e aparatit, kjo është shumë e rrezikshme për një drejtues partie. Mos do të thotë kjo se duhet t'i dënojmë këto aparate? Jo, aparatet ne nuk mund t'i dënojmë, ato i shërbejnë punës së Partisë dhe janë të nevojshme, por e vërteta është se këto kanë tendencën që shpesh t'i shohin çështjet në mënyrë teknokratike, disi të inkuadruara në skeda, prandaj ekziston kurdoherë rreziku që një njcri që punon në aparatet e Partisë mund të futet në këto ingranazhe. Ne jo vetëm duhet ta luftojmë këtë tendencë te punëtorët e Partisë, por dhe të kemi parasysh e të

mos lejojmë të na preken nga një frysë burokratike. Aparatet tona nuk e kanë një frysë të tillë, por rreziku i kësaj frysme, kur nuk punohet mirë, kurdoherë ekziston.

Në përgjithësi, kur zgjedhim kuadrot, duhet t'i kemi parasysh këto orientime. Me këtë nuk dua të them se një kuadër i ri do t'i ketë që në fillim të gjitha karakteristikat që kërkohen, se nuk e gjejmë dot të tillë. Ne duhet të kemi parasysh se njerëzit rriten në punë, prandaj t'i mësojmë ata që të punojnë, të rritin horizontin e tyre në çdo drejtim, të dalin nga skematizmi dhe kuptimi burokratik i normave.

Gjithashtu nuk është në asnjë mënyrë shkelje normash, në qoftë se në një organizatë-bazë ose në një forum drejtues të rrethit tejkalohet ca përqindja që duhet të zënë kuadrot drejtues me origjinë intelektuale. Sipas orientimit në një aparat apo në një forum partie, ta zëmë se duhet të jenë pesë punëtorë, po ne nuk kemi aq kandidatura punëtorë. Në këtë rast nuk do të ishte gabim që të futnim edhe ndonjë intelektual më shumë, sidomos në sektorët e prodhimit. Kjo nuk do të thotë se nuk është zbatuar si duhet orientimi i Partisë. Kur është nevoja, për forcimin e punës, në vend që të kemi pesë punëtorë, mund të lëmë katër ose tre dhe në vend të tyre të futim dy intelektualë, megjithëse sipas përqindjes duhet të futet vetëm një. Në këtë rast mendoj se nuk veprohet keq.

Nga kjo nxjerrim si konkluzion se duhet t'i kuptojmë thellë orientimet që jep Komiteti Qendror ose Byroja Politike, në bazë të Statutit, për ta mbajtur organizatën-bazë të gjallë, të re, që në të të dominojë

si numër klasa punëtore, pastaj fshatarësia, pa neglizhuar inteligjencien, e cila del nga këto klasa.

Në zgjedhjen e kandidaturave, natyrisht, ne do të marrim atë që është më i dalluar. Për shembull, kur kemi të bëjmë me një punëtor të dalluar, ky do të ishte një kandidat i mirë për vendin që kemi bosh dhe duhet ta diskutojmë atë. Mund që ai nuk e ka horizontin e gjerë kulturor që kërkohet për atë detyrë, por ne duhet të punojmë me të në fillim që t'ia krijojmë këtë horizont. Kur them që të punojmë me të, kam parasysh që të punojmë të gjithë, duke filluar nga aparati i Komitetit Qendror. Megjithatë kryesorja është që të punojnë me të komiteti i Partisë i rrethit, sekretari i parë dhe gjithë Partia dhe ta nxitin kandidatin që të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme, në radhë të parë vetë ai, personalisht, për të ecur përpara.

Partinë ne duhet ta edukojmë nëpërmjet gjithë veprimtarisë së saj që ajo t'i shohë çështjet e kuadrit në një horizont më të gjerë, me qëllim që problemet t'i zgjidhë sa të jetë e mundur më drejt. Në këtë mënyrë Komiteti Qendror dhe komiteti i Partisë i rrethit do të mundin t'i japid një ndihmë më të plotë organizatës.

Ka raste që disa kuadro, në vend që t'i zbatojnë mirë orientimet e t'i zgjidhin sa më drejt problemet, veprojnë si burokratë. Ja, po sjell një shembull nga Saranda. Një punonjës i këtij rrethi kishte dëshirë të hynte në Parti, prandaj ai u drejtua te sekretari i organizatës-bazë, e njoftoi për dëshirën që kishte dhe se për këtë qëllim ishte duke përgatitur lutjen për

t'ia paraqitur organizatës. Sekretari i tha atij: «Unë jam dakord, por ik pyet komitetin e Partisë të rrëthit, se më kalon përqindja që është vendosur për pranimet!». Kjo do të thotë që vetë ky sekretar, ky kuadër partie, nuk e ka kuptuar mirë çështjen se përqindja është një orientim, të cilat nuk mund t'i qëndrosh strikt, mbasi çdo veprim varet nga gjendja e vërtetë e Partisë në rrëth.

Kur sekretari i organizatës i thotë atij që kërkon të hyjë në Parti të shkojë në komitetin e Partisë që të pyesë për këtë, ai edhe ka, po edhe nuk ka të drejtë. Ai ka të drejtë në pikëpamjen që kjo është një çështje që duhet të diskutohet në komitet, se atje i dinë gjendjen dhe nevojat për pranime të reja në organizatat-bazë të rrëthit. Komiteti i Partisë i Sarandës, nga studimi perspektiv i rrëthit, e di që në Vrinë, për shembull, duhet të bëhen edhe tri pranime, se në një institucion të qytetit të Sarandës për një vit nuk duhet të bëhet, ta zëmë, asnjë pranim i ri, ose në sektorin e komunales duhet të ketë edhe një punëtor anëtar partie, kurse në shkollën e një zone të caktuar të këtij rrëthi duhet të ketë dy intelektualë etj. Këto nevoja për pranimet e reja në Parti dhe për shtrirjen e për shpërndarjen e komunistëve duhet të dihen nga komiteti i Partisë në shkallë rrëthi dhe të jenë të qarta.

Drejtimi tjetër, për të cilin nuk ka të drejtë sekretari i organizatës-bazë, që i thotë personit që kërkon të pranohet të shkojë të pyesë komitetin, është se ai, si sekretar organizate, duhet ta pranojë lutjen që bën një punonjës për të hyrë në Parti, sepse Sta-

tuti i Partisë nuk e lejon që të ndalojë tjetrin të bëjë lutje. Çdo punonjës ka të drejtë të bëjë lutje kudo, deri edhe për një kërkesë të thjeshtë që mund të ketë dhe jo më pastaj për të hyrë në Parti. Por sekretari i organizatës-bazë duhet ta sqarojë të interesuarin se nuk është ai që do ta pranojë atë në Parti, për këtë do të vendosë organizata-bazë.

Të gjitha këto rregulla ekzistojnë, por çështja është që ato të zbatohen si duhet. Kjo arrihet kur problemet kuptohen në mënyrë të gjerë, të thellë dhe të gjithanshme, prandaj është e domosdoshme që kuardot e Partisë të kenë edhe horizont të gjerë.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Raporte e fjalimeve 1978-  
-1979, f. 116*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash), vëll. 3,  
f. 412*

**«TEORIA E BOTËS SË PAANGAZHIUAR»  
DHE «TEORIA E TRI BOTËVE» NË UNITET  
PËR MBROJTJEN E STATUKUOSE IMPERIALISTE**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**30 qershor 1978**

Kohët e fundit ngjarje të rëndësishme po ndodhin në Afrikë e gjetkë. Vëmendja e opinionit publik botëror është përqendruar në kontinentin Afrikan të shumëvaujtur, të përfshirë në zjarret e konflikteve të ndryshme, që superfuqitë i nxitin dhe u fryjnë me të gjitha forcat. Luftohet në Ogaden e në Eritre, luftohet në Çad e Sahara, luftohet në Zaire e Angolë, lumi derdhet gjaku në Rodezi, në Afrikën e Jugut e atë Perëndimore. Aeroplanët gjigantë rusë «Antonov» zbarkojnë çdo ditë ushtarët mercenarë në Afrikën e Lindjes e të Perëndimit dhe «Herkulesët» e mëdhenj amerikanë transportojnë në qendër të ekuadorit legjonin e huaj të Francës dhe ushtarët sherifianë të mbretit të Marokut. Ministrat e Anglisë, Gjermanisë Perëndimore, Shteteve të Bashkuara etj. i bien kryq e tërthor Afrikës për t'i bindur kryengritësit zimbab-

vianë, namibianë e azanianë t'u dorëzojnë armët racistëve të bardhë.

Grinden e cirren imperialistët e Lindjes e të Perëndimit dhe akuzojnë njëri-tjetrin për «ndërhyrje në Afrikë», për «qëllime ekspansioniste», për «prishje të ekuilibrit ndërkombëtar» etj., etj. Superfuqitë e vjetra e të reja, kolonialistët e plakur dhe neokolonialistët që sapo i kanë hapur kthetrat, nxitojnë se kush më parë ta shpallë veten «mbrojtës» të popujve e «kampionë të paqes» në Afrikë. Dhe nën zhurmën e kësaj propagande mbytëse e demagogjie djallëzore, Afrika po inondohet me ushtarë të huaj, me armë e municione, me «ekspertë e këshilltarë», me diplomatë e predikatorë.

Që nga kolonizatorët e vjetër e imperializmi amerikan, që nga socialimperialistët sovjetikë e deri tek imperialistët e tjerë një front unik është krijuar për të minuar, mbytur e shuar luftën e popujve afrikanë. Të gjithë përpinqen të ruajnë sundimin e tyre kolonial e neokolonial osc për t'i rrëmbyer njëri-tjetrit pozitat dominuese në këtë kontinent. Çdo gjë që mund të pengojë zhvillimin e pavarur ekonomik, politik e shoqëror, çdo gjë që mund të mbytë aspiratat e popujve afrikanë për progres shoqëror e demokraci të vërtetë, çdo gjë që shkel e mohon interesat jetikë të tyre, përfundimisht përfundimisht e mirë. Asnjë moral, as ai fetar përpara të cilit ato betohen, as ai borgjez për të cilin përgjërohen, nuk i ndal ato të torturojnë zezakët e Afrikës së Jugut e të Rodezisë, të vrashqydhës së Zairesë, apo të Angolës, të grabitin në mënyrën më barbare e më të

pangopur naftën, bakrin, uranin, hekurin e fosfatin afrikan.

Kolonizatorët, të nisur nga parimi më i vjetër imperialist «përçë e sundo», u kanë lënë trashëgim shteteve të reja afrikane një numër të pafund problemesh kufitare, etnike, kombësie etj. Tani imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë e imperialistët e tjerë e shfrytëzojnë këtë gjendje për t'i vënë popujt njërin kundër tjetrit dhe për të penguar bashkimin e tyre në luftën kundër shfrytëzuesve të huaj e vendës. Një propagandë të madhe bëjnë imperialistët e neokolonialistët për të nxitur ndjenjat e urrejtjes midis vendeve afrikane, për të nxitur mëritë e vjetra reciproke e për të ngjallur konflikte të reja mbi baza të ngushta nacionaliste, fisnore, racash, traditash. Ata nuk kursehen t'u dërgojnë armë e instrukturë, këshilltarë e specialistë për t'i mësuar si të përlleshen e të vriten më mirë.

Sot në mjaft vende të Afrikës ligjin e bëjnë shtetet e fuqishme kapitaliste e imperialiste, të cilat mbajnë në këmbë dhe kanë në vartësi të drejtpërdrejtë disa klika sunduese vendase, që i vënë e i heqin ose i vrasin, sipas interesave të tyre. Janë këto klika anti-kombëtare, antipopullore e reaksionare, xhandarë të vërtetë të neokolonializmit, që ruajnë interesat e kapitaleve të huaja të investuara në Afrikë, që mbrojnë bankat e filialet e shoqërive shumëkombëshe, që garantojnë fitimet maksimale për monopolet e huaja, që mbajnë popullin të shtypur e në errësirë për të mos parë si e rrjepin dhe si grabisin imperialistët e kolonialistët.

Por zgjimin e popujve të Afrikës, luftën e tyre për liri e pavarësi, për të drejtat politike e ekonomike, luftën për sovranitetin e plotë mbi burimet e pasuritë kombëtare, për kulturën e traditat e tyre, tanimë asgjë nuk mund ta ndalojë. Rilindjen e Afrikës nuk mund ta pengojnë as mercenarët e bardhë e as armët imperialiste, as dollarët e rublat, as kryqet e misionarëve e as teoritë disfatiste që nga të katër anët eksportohen me bollëk në këtë kontinent. Këtë nuk mund ta ndalojnë as ato klikat e shitura tek imperialistët e neokolonialistët, sado të zellshme, të pashpirta e tradhtare qofshin. Liria dhe emancipimi i popujve afrikanë është sot një kërkesë e madhe e kohës. Forca të errëta e regresive mund të bëjnë përpjekje të dëshpëruara ta pengojnë, por rrota e historisë, ashtu si deri më sot, do të ecë gjithmonë përrpara.

Sundimin imperialist e neokolonialist në Afrikë, klikat reaksionare, që qeverisin mjaft vende të këtij kontinenti, nuk mund t'i shpëtojë as teoria e së ashtu-quajturës «botë e paangazhuar» që me një zell të jashtëzakonshëm po propagandohet nga revizionistët jugosllavë, as «teoria e tri botëve». «Teoria e botës së paangazhuar» dhe ajo e «tri botëve» janë një krijëse me dy kokë imperialiste për të mashtruar popujt dhe pér të ndihmuar imperialistët në situata të vështira. Plaforma politike e ideologjike që predikojnë krijuesit e këtyre dy teorive është një strategji pér të ruajtur statukuonë, pér të larguar popujt afrikanë nga rruga e drejtë e lufiês revolucionare e çlirimtare, pér të mbrojtur sundimin imperialist e neokolonializmin në Afrikë, si edhe në rajone e kontinente të tjera. Ato

u vijnë në ndihmë fuqive të mëdha imperialiste, kolonialistëve të djeshëm e neokolonialistëve të rinj, për të penguar zhvillimin ekonomik, politik e shoqëror të popujve.

Predikuesit e «botës së paangazhuar», përpiken të përhapin iluzionin se mund të krijohet gjoja një lëvizje me vende të paanshme e të pavarura nga bloqet ushtarake të Shteteve të Bashkuara e të Bashkimit Sovjetik, e cila mund të bëjë presion mbi «të mëdhënjtë» që t'i binden logjikës e të largohen nga politika e tyre ekspansioniste, që të vënë dorën në zemër dhe pasuritë e botës t'i ndajnë në mënyrë racionale e të drejtë. Prandaj, thonë ata, sa më pak rezistencë ndaj politikës imperialiste, sa më pak luftë e aksione revolucionare për të mbrojtur të drejtat e kombeve, sa më pak përpjekje për të vënë një kufi të qartë midis miqve e armiqve të popujve. Sipas tyre nevojiten sa më shumë konferenca e seminare ndërkombëtare, sa më shumë takime e debate teorike, sa më shumë lëshime e koncesione për t'i bindur amerikanët e sovjetikët që të mos e «angazhojnë» botën. Le t'u lutemi, thonë ata, monopoleve amerikane, angleze, franceze, gjermane, belgjiane etj. që me dashamirësi e ndershmëri të ndihmojnë për «përparimin» ekonomik, kulturor etj. të Afrikës, Azisë ose Amerikës Latine.

Kjo botë e «paangazhuar» i ngjan një ëndrrre, por një ëndrrre që imperialistë, revisionistë, neokolonialistë e kapitalistë e reklamojnë me bujë për t'i mbajtur me iluzione dhe për t'i larguar popujt nga realiteti i mjerueshëm në të cilin jetojnë.

Që e gjithë «teoria e botës së paangazhuar» është

një mashtrim i madh, që synon të vërë në gjumë vijgilencën e popujve e t'i largojë ata nga lufta e vërtetë kundër imperializmit, e veçanërisht dy superfuqive, këtë e tregon praktika e përditshme, kur edhe klika sunduese e reaksionare paraqiten si të paangazhuara, si antiimperialiste, demokratike, popullore, përparimtare, bile edhe «socialiste». Po për çfarë mos angazhimi mund të bëhet fjalë kur shpallen e pranojnë si «të paangazhuara» edhe ato vende ku në fuqi janë regjime shtypëse, kundërrevolucionare e antipopullore, të lidhura me mijëra fije të dukshme e të padukshme me imperializmin botëror, me strukturat e tij ushtarake, ekonomike, financiare etj.? Dihet mire se pa qenë formalisht pjesëmarrëse në NATO, në Traktatin e Varshavës ose në ndonjë blok tjetër ushtarak, mjaft shtete që reklamohen si «të paangazhuara» janë tërësisht të angazhuara me njérën a në tjetrën superfuqi, ose me të dyja, si dhe me fuqitë e tjera të mëdha kapitaliste e imperialiste, me një varg traktatesh e marrëveshjesh zyrtare e vepruese.

Si mund të quhen «teoria e botës së paangazhuar» ose ajo e «tri botëve» teori që luftojnë për çlirimin dhe emancipimin e popujve të shtypur e të shfrytëzuar nga imperializmi, që kundërshtojnë ndërhyrjen e superfuqive në punët e brendshme të vendeve të tjera, që janë për mbrojtjen e pavarësisë e të sovranitetit të kombeve, kur ato marrin nën mbrojtje dhe konsiderojnë si aleatë xhelatë e kriminclë të tillë si Mobutu, Bokasa e ndonjë tjetër, armiq të egër të popujve të tyre e lakenj të ulët të imperializmit? Si mund të merren nën mbrojtje dhe të shpallen heronj

të luftës kundër dy superfuqive, siç e kërkon «teoria e botës së paangazhuar» dhe ajo e «tri botëve», ata që shesin interesat e atdheut, që e kthejnë fletën nga ai që u jep ose u premton më shumë, që sot janë me socialimperialistët e nesër bëhen me amerikanët, ose anasjelltas?

Nuk është aspak e rastit që krerët e imperializmit amerikan si Karteri, socialimperialistët sovjetikë e përfaqësues të tjerë të fuqive imperialiste, me shumë entuziazëm e përzemërsi shprehin përkrahjen e tyre për predikatorët e «paangazhimit». Kjo tregon se parullat e iniciativat e tyre janë në dobi e në shërbim të imperializmit botëror për të ruajtur sundimin e tij të urryer mbi popujt, janë në shërbim të klikave të ndryshme reaksionare, shtypëse e proimperialiste që sundojnë mbi këta popuj.

Tërë boshllëku, demagogjia e falsiteti i mbrojtësve të «teorisë së botës së paangazhuar» e të «tri botëve» duket menjëherë kur ajo ndeshet me ngjarjet konkrete siç janë ato të Afrikës. Kurdoherë e në të gjitha rastet ata kanë marrë anën e imperialistëve e neokolonialistëve, kanë përkrahur ndërhyrjet e tyre, janë bërë apologjetë të reaksionit. Le të marrim ngjarjet e Zairesë.

Eshtë e vështirë të përcaktosh se çfarë ngjau në Shaba. Ç'janë këta xhandarë katangezë dhe ata që shkaktuan turbullirat, nga vijnë e ku shkojnë? Imperialistët e Perëndimit e të Lindjes lëshojnë akuza reciproke, duke u përpjekur të mbulojnë të vërtetën. Të tjerë, që hiqen si miqtë më të mëdhenj të Afrikës, dolën haptazi në krah të imperializmit amerikan, mo-

rën nën mbrojtje Mobutun dhe nxituan të përkrahin dërgimin dhe ndërhyrjen e ekspeditave ushtarake të huaja në Shaba. Po del pyetja: Vallë e tërë Zaireja përbën një shtet ashtu siç e ka përcaktuar imperializmi belg dhe e ka aprovuar imperializmi amerikan, francez etj.? A ka aty probleme etnike, të kombësive, e të tjera të kësaj natyre? A janë zgjidhur këto si duhet? Sipas «teorisë së tri botëve» del se këto probleme duhet t'i zgjidhë jo populli zairjan, të cilit i takojnë, por legionarët e huaj dhe spahitë afrikanë.

Teoria e «botës së paangazhuar», e «tri botëve», e «botës së lirë» dhe e të gjitha «botëve» të tjera borgjeze e revizioniste kanë një qëllim: jo t'i ndihmojnë popujt të gjejnë rrugën e luftës së vërtetë revolucionare e antiimperialiste, por t'i futin këta në një rrugë të rreme e të parrezikshme për sundimin imperialist. Ato duan të ruajnë statukuonë e sotme, situatën e turbullt e shtypëse të krijuar nga kolonizatorët e vjetër e të rinj duke gënjer popujt se janë «të paangazhuar», «janë të lirë» etj.

Por popujt e Afrikës, forcat e shëndosha revolucionare nuk mund të besojnë në «teorinë e botës së paangazhuar» e të «tri botëve», të cilat çdo ditë e më shumë e tregojnë në praktikë se në shërbim të kujt janë. Ata nuk mund të besojnë në ato klika reaksionare që janë në shërbim të të huajve. Në krye të shteteve të ndryshme të Afrikës ka edhe njerëz që i duan të mirën popullit të tyre, që përpilen sinqerisht ta nxjerrin vendin e tyre në rrugën e përparimit. Por mbi ta ushtrohen presione të ndryshme nga brenda e nga jashtë, e, sidomos, nga përkrahësit e zellshëm të

«të paangazhuarve» dhe të teorisë së «tri botëve», të cilët përpiken t'u imponojnë pikëpamjet e ideologjinë e nënshtimit ndaj imperializmit, t'i futin në kurthet e shumta që ngrenë kolonialistët e vjetër e të rinj.

Ka gjithashtu udhëheqës realistë të disa shteteve afrikane, që e duan dhe përpiken për forcimin e unititetit të popujve e të shteteve afrikane kundër imperializmit e neokolonializmit, kundër çdo ndërhyrjeje në punët e tyre të brendshme. Ata nuk mund të mos gjelqojnë përkrahjen e të gjitha forcave liridashëse e përparimtare të botës. Por të tillë udhëheqës luftohen si nga imperialistët, ashtu edhe nga predikuesit e «botës së paangazhuar» e të teorisë së «tri botëve», që i vlerësojnë si «radikalë» e i konsiderojnë «të padëshirueshëm». Por popujt afrikanë kanë tanimë një përvojë të gjatë lufte kundër shtypësve të huaj e shërbëtorëve të tyre të ndryshëm dhe dinë të bëjnë dallimin midis atyre që me të vërtetë i mbrojnë dhe atyre që i tradhtojnë. Nuk mund të themi se si duhet të veprojnë të tillë burra shteti, por qëllimet e mira të tyre duhet të mbrohen. Çdo popull di t'i gjykojë si qëllimet e mira, ashtu edhe të këqija të udhëheqësve të vet. Dhe kurdoherë qëllimet e mira ai i ka mbrojtur, ashtu sikurse ka luftuar të këqijat.

Zhvillimet e sotme në kontinentin afrikan vërtojnë se po nuk u luftuan me vendosmëri të gjithë imperialistët e vjetër e të rinj, qoftë imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë e të tjerë, po nuk u luftuan me konsekuençë ato klika reaksionare vendase në shërbim të imperializmit e neokolonializmit, po nuk u demaskuan teoritë e ndryshme oportu-

niste, të «botës së paangazhuar» ose të «tri botëve» nuk mund të ketë pavarësi e sovranitet të vërtetë, as zhvillim të drejtë ekonomik e shoqëror, nuk mund të ketë demokraci e përparim. Rruga e drejtë, që e kërkojnë situatat, për popujt e Afrikës e të zonave të tjera ku sundojnë imperializmi e neokolonializmi, është rezistenca e organizuar dhe e vendosur kundër ndërhyrjeve politike, ekonomike e ushtarake të tyre të rrezikshme, kundër komplateve e intrigave të tyre të rrezikshme, kundër ideologjive mashtruese e demagogjisë që bëjnë fuqitë e huaja. Fati i popujve afrikanë është në duart e vetë atyre. I gjithë opinioni përparimtar botëror është me ta. Populli shqiptar ka qenë dhe do të jetë kurdoherë i vendosur në krah dhe në ndihmë të popujve vëllezër afrikanë.

*Botuar për herë të parë në  
gazetenë «Zëri i popullit»,  
nr. 156 (9329), 30 qershor 1978*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i  
popullit», nr. 156 (9329),  
30 qershor 1978*

# OPORTUNISTË TË PAQENDRUESHIËM

Shënimë

3 korrik 1978

Me rastin e Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, Partia Komuniste e Kinës e shpalli hapur akordin e saj të plotë me vijën politike, ideologjike, organizative dhe ushtarake të Jugosllavisë.

Pritej kongresi për ta bërë një gjë të tillë! Por realiteti ka treguar se, edhe më përpara, me ardhjen në fuqi të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, kjo miqësi do të trashej dhe do të merrte rrugën e një «nënshtimi» politiko-ideologjik të partisë revizioniste kineze ndaj titizmit.

Titoja dhe titizmi shiheshin me sy të mirë nga Partia Komuniste e Kinës që në kohën e Mao Ce Dunit. Ky i fundit nuk ka qenë dakord me qëndrimet e drejta marksiste-leniniste të Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini, të Partisë sonë e të partive të tjera komuniste ndaj titizmit. Ai nuk e konsideronte Titon si renegat, as Partinë Komuniste të Jugosllavisë si një parti revizioniste.

Në shumë raste Mao Ce Duni e ka shprehur hapur idenë e pajtimit me revisionistët jugosllavë. Kur bë-

het analiza e strategjive dhe e taktikave të ndryshme të Partisë Komuniste të Kinës, shihet qartë se kjo parti është përputhur në shumë çështje me PK të Jugosllavisë.

Natyrisht, Kina ka ruajtur aparençat, por, menjihatë do të vinte koha, sikundër erdhi, që në pikat kryesore të strategjisë të bashkohej hapur me Titon. Antisovjetizmi kinez ka koinciduar kurdoherë me strategjinë titiste, me një ndryshim, që Titoja është treguar më diplomat, vërtet oportunist, por i është përmبajtur rrugës së tij oportuniste, kurse udhëheqësit kinezë kanë kaluar edhe nga një ekstrem në tjetrin ndaj superfuqive. Kështu, Titoja ka luajtur politikën e kërcimit mbi litar dhe ka mbajtur ekuilibrin, duke anuar herë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, herë nga Bashkimi Sovjetik, por me një anim të përbajtur në dukje. Kurse kthesat e Kinës në strategji ishin 180 gradëshe. Kështu nga pozitat kundër imperializmit amerikan ajo u kthyte në pozita kundër hrushovianëve dhe, nga ato kundër hrushovianëve, u kthyte pro imperializmit amerikan.

Në këtë rrugë, pra, në kthimin drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u bashkua strategjia e politikës së jashtme të Kinës me strategjinë e Jugosllavisë titiste. Në fakt, kjo strategji e Kinës është rrjedhim i një vije antimarksiste, i një qëndrimi prej renegati ndaj marksizëm-leninizmit, është një kundërshtim i socializmit shkencor dhe i ndërtimit të socializmit në Kinë, është ruajtje e kapitalizmit pak a shumë të zhvilluar, me një brendi që vishet me disa tipare të jashtme socialiste, por që nuk është socialiste. Ndryshe

nuk mund të gënjehej populli e të ecej në kundërshtim me të, me masat e varfra, të cilat kryen revolucionin, një revolucion për të marrë fuqinë dhe për të ndërtuar socializmin e jo për të mbajtur në fuqi kapitalizmin dhe borgjezinë ose për të rehabilituar kapitalizmin, që Kina të bëhej një superfuqi. Pra pushteti në Kinë s'ishte një pushtet i diktaturës së proletariatit, por një pushtet i shumë partive, siç e ka theksuar vetë Mao Ce Duni. Me kalimin e kohës kjo vijë antimarksiste i dha rezultatet e veta. Në Kinë erdhi ekipi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit, i cili s'mund të mos ishte plotësisht dakord me Titon në politikën e jashtme dhe në organizimin e brendshëm të shtetit, në zhvillimin e ekonomisë dhe të ushtrisë.

Vija e përgjithshme e politikës kineze ka qenë miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet të cilave do të hapeshin rrugët për lidhje dhe unitet edhe me vendet e tjera kapitaliste të botës, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik, të cilin Kina e kishte deklaruar si armikun kryesor jo vetëm të sajin, por të të gjithë njerëzimit. Për sa i përket anës ideologjike, Partia Komuniste e Kinës do të binte dakord, sikurse ra, me të gjithë revizionistët modernë, me ata jugosllavë në radhë të parë, pastaj me të gjitha partitë e tjera revizioniste të botës, bile do të binte dakord dhe do të futej në tratativa, sikundër u fut, edhe me partitë e tjera të borgjezisë, me partitë socialiste, socialdemokrate, demokristiane, deri edhe me partitë e monarkisë e të fashizmit.

Pra, në këtë drejtim, në këtë rrugë ku ishte futur, Kina puqej me Jugosllavinë dhe kishte nevojë për

mbështetjen e saj, sepse Titoja është një proksenet i këtyre çështjeve dhe me gjithë dëshirë do të jepte të kuptione se ai është një frysëzues jo vetëm i vendeve të vogla gjoja të paangazhuara, por edhe i Kinës së madhe. Prandaj vajtja e Titos në Kinë përbënë një sukses të madh për të dhe një disfatë të turpshme për Kinën. Kjo vizitë e diskrediton edhe më shumë Kinën.

Telegrami që iu dërgua Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ishte i gjatë dhe i ngrohtë. Udhëheqësit kinezë e nxjerrin aty Titon si një udhëheqës botëror dhe socializmin në Jugosllavi, si një «socializëm të vërtetë», ekonominë e Jugosllavisë si një «ekonomi të përparuar» dhe vijën e saj si një «vijë të drejtë», që i ka zgjidhur të gjitha problemet ashtu si duhet në interesin e popujve të Jugosllavisë, e cila, sipas tyre, është një faktor me rëndësi për paqen dhe solidaritetin ndërkombëtar.

Mirëpo me gjithë unitetin që ata kanë, strategjia kineze për unitet të «tri botëve», domethënë të «botës së parë» (pjesa amerikane) me «botën e dytë» dhe me «botën e tretë», në luftë kundër socialimperializmit sovjetik nuk i përgjigjet politikës së Titos të sistemit të tij të «mosangazhimit». Bile Titoja e kuption fare qartë strategjinë kineze në lidhje me «botën e tretë». Ai e kuption se kjo është manovër e një fuqie të madhe që po ngrihet dhe që kërkon të krijojë tregje e koloni të reja për veten e saj. Kjo strategji nuk është as në interesin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, padronit të Titos, dhe as në interesin e vetë Jugosllavisë, e cila ka pretendime të hiqet si lidershipi i këtyre të

ashtuquajturave vende të paangazhuara ose sistemit të «mosangazhimit». Dalja në dritë e një lidershipi të një grupimi tjeter të quajtur «bota e tretë» nuk i vjen për hosh Titos, prandaj ai e kundërshton këtë, natyrisht, në mënyrën e tij diplomatike, por e kundërshton. Miniçi, ish-ministër i Jashtëm i Jugosllavisë, nuk mungoi të thotë se i cilëson si iluzione përpjekjet për të shpallur ndonjë fuqi të madhe apo bllok alcat «të natyrshëm» kundër një tjetri, si dhe përpjekjet për të cilësuar automatikisht si kundërshtar ose armik çdo fuqi të madhe ose grup vendesh që përfshihen në një bllok.

Pra, nëpërmjet Miniçit, me këto fjalë Titoja i thotë Kinës se nuk është dakord me pikëpamjen që duhet të vihen kundër njëri-tjetrit blloku amerikan me blokun e Traktatit të Varshavës. Titoja do marrëveshje paqësore në mes këtyre dy bloqeve. Ai nuk është dakord që të mbështetet ose të konsiderohen një aleat i natyrshëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik dhe anasjelltas. Prandaj këtu revisionistët jugosllavë nuk puqen me ata kinezë.

Bile Miniçi shkoi edhe më tutje, duke u shprehur se përpjekjet e disave për të klasifikuar «vendet e paangazhuara» si «të moderuara» apo radikale, sipas kriterit të tyre prej fuqie të madhe, nuk kanë kuptim tjetër veçse për të pérçarë «të paangazhuarit». Kurse përpjekjet e revisionistëve jugosllavë qëndrojnë në atë që lëvizja e «mosangazhimit» të jetë, sikurse është, pra ata janë për një statuko, dhe kështu u shërbejnë shteteve kapitaliste të fuqishme për t'i shfrytëzuar

këto vende të ashtuquajtura të paangazhuara dhe, nga një politikë e tillë, të përfitojë edhe vetë Jugosllavia titiste. Mirëpo statukoja kineze ka ndryshim, sepse «bota e tretë» konsiderohet nga kinezët si një entitet ideologjik dhe Kina si epiqendër e unitetit luftarak të këtyre «botëve» kundër Bashkimit Sovjetik. Këtu, pra, fshihet hegemonizmi i kinezëve, të cilin as Shtet e Bashkuara të Amerikës, as Titoja nuk e pranojnë, kështu që Titoja luan në dy tablo, edhe në tablonë amerikane, edhe në tablonë sovjetike. Nga ana tjetër, ai i thotë kinezit se «ti je në rrugë të drejtë», por për sa i përket teorisë së «tri botëve», tërthorazi i thotë se «kjo teori s'ka asnje vlerë përmua, prandaj unë, Titoja, e konsideroj këtë teori kineze si një teori që kërkon të çajë lëvizjen e të paangazhuarve». Natyrisht, nga kjo gjë, sipas titistëve, rezultojnë të gjitha ato konsekuenca që gjoja mund t'i shkaktohen njerëzimit, por që në fakt ekzistojnë, për arsy se lëvizja e «të paangazhuarve» është diçka fiktive, iluzore.

Natyrisht, Miniçi në fjalimin e tij sulmon indirekt edhe Kubën, duke e quajtur qëndrimin e saj gjoja si qëndrim radikal, i cili, siç u shpreh ai, «çon në mënyrë të pashmangshme në dominimin e huaj dhe është në favor të atyre që luftojnë për interesat e fuqive të mëdha». Si konkluzion, Miniçi thotë se rrjedhimisht lëvizja e «mosangazhimit» nuk mund të bashkohet, siç mund të dëshironin disa, me ndonjë palë, dhe të jetë aleate e natyrshme e saj, duke u bërë kështu në fakt rezervë e saj. Me fjalë të tjera, ai kërkon të thotë që, «ti, Kinë, ke syniue të bëhesh një superfuqi, por nuk të lë kush të bëhesh e tillë, për arsy se ti je një vend

i prapambetur dhe, për të realizuar synimet e tua, po nder dorën nga të katër anët, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet e tjera të zhvilluara, duke kërkuar kredi për modernizimin e ekonomisë. Prandaj çështjet teorike, që gjoja ti i ke ngritur në plan të parë dhe i ke konkretizuar në njëfarë teorie të botës së tretë, nuk mund të gënjejnë kurrikënd dhe vendet e paangazhuara nuk duhet ta aprovojnë këtë gjë».

Ç'qëndrim do të mbajë Kina ndaj Jugosllavisë titiste për këtë çështje kardinale të politikës e të strategjisë së saj? Mendoj se Kina do të vazhdojë rrugën e vet. Ajo ka synime imperialiste, dëshiron të bëhet superfuqi, prandaj do të bëjë zigzage dhe manovrime.

Pas fjalimit të Miniçit dhe raportit të Titos unë lexova në buletinin e lajmeve se Gën Biaoja nga Pakistani shkoi në Sri-Lanka<sup>1</sup> dhe në një fjalim që mbajti atje, fill pas Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ky foli për lëvizjen e të «paangazhuarve» dhe u bëri thirrje kombeve që ta forcojnë këtë lëvizje, pra nuk e zuri në gojë «botën e tretë». Duket qartë se kinezët, si kurdoherë, janë opor tunistë të paqëndrueshëm në pikëpamjet e tyre dhe vetëm me fjalë herë mbrojnë «botën e tretë» ose nuk e zënë në gojë fare, herë përmendin lëvizjen e «të paangazhuarve» ose përdorin termin «vende në zhvillim». Nuk u prish punë kjo kinezëve, ajo që u prish punë është gjendja e brendshme, e cila paraqitet e turbullt.

Nga informacionet që marrim, konstatojmë se në Kinë edhe në ushtri ka kundërshtime të mëdha. Fakt është se në konferencën ushtarake që u bë, u mbajtën katër referate, që binin në kundërshtim me njëri-tjetrin. Kjo tregon se, të paktën në ushtri, ka katër vija që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Pra, nuk ishte vetëm Hua Kuo Feni që foli, por folën edhe Ten Hsiao Pini, Jeh Çien Jini dhe një tjetër. Unë një sy u hodha përciptazi këtyre fjalimeve, por, po t'i lexosh me kujdes, shihet që ka kontradikta në mes grupimeve diçka qëllimeve të tyre. Këto kontradikta duken në mos në qëllimet strategjike, në ato taktike.

Për sa u përket organizimit dhe zhvillimit të ekonomisë, Kina po ndjek rrugën e vetadministrimit jugosllav. Pra, «ndërtimi i socializmit» në Kinë do të ketë tiparet e «socializmit vetadministruar» pa u quajtur i tillë, pavarësisht se nga përbajtja do të jetë njëloj me të. Kështu sigurohen kapitalistët amerikanë që ata të Evropës Perëndimore e të Japonisë për investimet që do të bëjnë në Kinë. Ky është mjeti më i mirë për degjenerimin politik dhe ideologjik të Kinës. Në këtë mënyrë imperialistët e ndryshëm do të hedhin si duhet kthetrat mbi pasuritë e mëdha të këtij vendi dhe do të drejtojnë ekonominë kineze sipas interesave të fuqive të mëdha kapitaliste.

Natyrisht, kjo nuk do të bëhet lehtë e shpejt, për arsy se imperialistët amerikanë dhe kapitalistët e vendeve të tjera vërtet janë të interesuar të investojnë kapitalet e tyre në Kinë, sepse të ardhurat që do të sigurojnë, do të janë të mëdha, por kurdoherë ata do të kenë parasysh që Kina nuk duhet të bëhet rrezik

për ta, por për Bashkimin Sovjetik. Pra, Kina në strategjinë e saj kërkon të bëhet superfuqi, të përfitojë nga njëra superfuqi imperialiste dhe nga shtete të tjera kapitaliste për t'i bërë ballë superfuqisë sovjetike, e cila aktualisht ka tendenca ta zhdukë Kinën, përpinqet të mbajë një dialog pak a shumë paqësor me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, sepse andej merr kredi të shumta për investime e për modernizimin e industrije së saj.

Edhe Partia e Punës e Koresë i dërgoi telegram Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Kim Ir Seni, sikurse Hua Kuo Feni, e lavigjroi shumë Titon, sepse është në një rrugë me të. Teoria «çuçë» e Kim Ir Senit është në kundërshtim të hapët flagrant me marksizëm-leninizmin. Kjo teori tash zyrtarisht quhet «kimirsenizëm» dhe kohët e fundit ka dalë një libër me titull «Kimirsenizmi në teori dhe në praktikë». Pra, një tjetër kaposh revizionist kërkon të përhapë njëfarë teorie të tijën, speciale, edhe kjo kapitaliste e veshur me petka të grisura socialiste. Por edhe Kim Ir Seni, edhe Titoja janë krejtësisht të falimentuar në politikë, në ideologji dhe në ekonomi. Sikurse Titoja, edhe Kim Ir Seni, të dyja duart i nderin nga Bashkimi Sovjetik, nga Kina e nga vendet e tjera kapitaliste.

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 4*

# TE PËRGATITIM NË LETËR PËR T'U DHËNË PËRGJIGJE REVIZIONISTËVE KINEZE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

8 korrik 1978

*Në këtë takim u diskutua për notën e qeverisë kineze të datës 7 korrik 1978 dhe për përgatitjen e përgjigjes që do të jepej nga Partia jonë. Ndër të tjera shoku Enver Hoxha tha:*

Udhëheqësit kinezë, në notën që na drejtojnë, numërojnë të gjitha ndihmat që i kanë dhënë Shqipërisë, ndihmë ekonomike dhe ushtarake, me specialistë e me këshilla, duke theksuar fort se Kina e ka ndihmuar Shqipërinë në një kohë kur vetë ka qenë keq e mos më keq. Ata jo vetëm i numërojnë ndihmat që paskan dhënë, por i llogaritin dhe me miliona e me tonë, sa tonë ngarkesë e sa tonë grurë, që nga viti 1954 e deri tani, pra për 25 vjet rrësht. Veçse kanë bërë mirë që në notë na kujtojnë edhe periudhën gjatë së cilës na kanë ndihmuar, se po të ndahet kjo ndihmë për një kohë kaq të gjatë, merret me mend se sa «e madhe» ka qenë!

Sidoqoftë, ndihma e Kinës, nuk mund të mohohet, por çështja është se qeveria kineze pasi numëron ç'na ka dhënë, fillon të parashtrojë «arsyet» që e shtyjnë atë ta ndërpresë këtë ndihmë ndaj Shqipërisë, duke na e hedhur krejtësisht përgjegjësinë neve. Udhëheqësit kinezë pretendojnë se, në bisedimet e zhvilluara në fillim të këtij viti me një grup specialistësh të kryesuar nga zëvendësministri ynë i Industrisë dhe i Minierave, kanë qenë plotësisht të dispozuar që t'i zgjidhnin problemet e atyre objekteve që nuk janë mbaruar, por përfaqësuesit tanë, sipas kinezëve, u janë përgjigjur me «ultimatum»; ata na akuzojnë, gjithashtu, se gjoja nga specialistët tanë qenkan marrë masa jashtë rregullave teknike, prandaj ndodhi avaria në Rafinerinë e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh ose në furrnaltën e Kombinatit Metalurgjik etj., etj. Dhc, së fundi, thonë se udhëheqja shqiptare ka atakuar politikisht e ideologjikisht Mao Ce Dunin dhe popullin kinez.

Në këto kushte, thuhet në notë, qeveria kineze nuk mundet mië të vazhdojë të ndihmojë Shqipërinë, sepse miqësia midis popullit kinez dhe popullit shqiptar është dëmtuar për faj të udhëheqjes shqiptare. Përkëtë arsyec ajo ka vendosur që të presë ndihmat ekonomike e ushtarake dhe të tërheqë specialistët që punojnë në Shqipëri.

Natyrisht, këtë notë ne duhet ta studiojmë mirë e ta shohim thellë përbajtjen e saj, të mos e shikojmë atë me eufori, sikur një veprim i tillë i palës kineze, meqenëse nuk është i papritur për ne, nuk na shqetëson e nuk na krijon vështirësi, sepse jemi në

gjendje të ecim vetë etj., etj. Prandaj lidhur me këtë problem mendoj se ne duhet të bëjmë një mbledhje të Byrosë Politike, ku të theksojmë me forcë problemet që na lindin në këtë situatë të re dhe përgjegjësinë e madhe që kemi përpara popullit. Situatat që po ka-lojmë janë të vështira. Të tilla ne kemi kaluar edhe dy herë të tjera, kjo është e treta herë, përvèç Luftës së madhe Nacionalçirimitare, dhe, që të gjitha i kemi kapërcyer me sukses, nga ana politike e ideologjike po e po, por edhe nga ana ekonomike.

Pas Çlirimt dhe pas demaskimit të revizionistëve sovjetikë është fakt që populli shqiptar vuri të gjitha forcat e tij për ndërtimin e socializmit, por sidqoqftë ndihma e kinezëve ka qenë një mbështetje, aq sa ka qenë. Tashti para nesh, para popullit dhe Partisë shtrohet çështja që me forcat tona të ndërtojmë të gjitha ç'kanë mbetur të papërsfunduara nga kinezët e të realizojmë planin. Edhe planin e ardhshëm që do të har-tojmë, po me forcat tona do ta realizojmë dhe, kur themi me forcat tona, duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe të marrim përgjegjësinë, në radhë të parë, që punët tona të shkojnë mirë. Pra, të bëjmë të pamundurën që të evitohen, në përqindjen më të madhe, mungesat në drejtë, në organizim dhe deficitet në realizimin e planeve. Çështja shtrohet që planet të realizohen plotësisht bille dhe të tejkalojen. Për këtë duhet të ecet me llogari, me kalem në dorë, sepse ndërtimi i objekteve që na lanë kinezët në mes të rrugës dhe plani i ardhshëm duan investime të mëdha, të cilat nuk mund të realizohen vetëm duke demaskuar

revisionistët kinezë. Kjo gjë, në mënyrë të veçantë, duhet kuptuar mirë nga të gjithë.

Natyrisht, ne do ta organizojmë punën për demaskimin e veprimtarisë antimarksiste të udhëheqësve kinezë për sa i përket politikës e ideologjisë së tyre që aktit të prerjes së ndihmave ndaj vendit tonë, por kjo punë duhet bërë në një mënyrë të tillë që të forcojë bindjen e Partisë e të popullit në forcat e veta, të forcojë organizimin dhe disiplinën, me qëllim që të realizohen e të tejkalohen planet. Të gjithë shokët në piramidë, që nga lart deri poshtë, dhe në radhë të parë, ne, në këto situata duhet të gjykojmë me gjakftohtësi të madhe që t'i kapërcejmë me sukses vështirësitë e krijuara. Nga të gjithë të kuptohet se mobilitimi i madh në punë, kontrolli i zbatimit të detyrave në kohën e caktuar e më së miri dhe marrja e vendimeve të drejta, janë kyçi për zgjidhjen e detyrave dhe të përgjegjësive të mëdha që kemi për të realizuar planet me forcat tona, në luftë të ashpër me armiq të shumtë nga të katër anët.

Këto situata na kalitin, na bëjnë më të pjekur. Nga ato ne dalim me më shumë thinja të bardha në kokë, por edhe më zemër më të fortë. Në qoftë se nisemi nga mendimi që situata është e vështirë, atëherë do t'ia vëmë mirë gjoksin dhe shpatullat punës që detyrat e caktuara t'i kryejmë në kohën e duhur dhe mirë; në qoftë se themi siç thoshim njëherë e një kohë, që «oburra, lufto në këmbë», mitralozi i armikut të grin, prandaj duhet të bëjmë llogore sot që të mbrohemë në luftë nesër. Edhe tani po të themi: «Hë mo se e kapërcejmë edhe këtë situatë» dhe ndërkaq nuk i përf-

vishemi punës me të gjitha forcat, atëherë kemi gënjyer veten. Themi se e kapërcejmë këtë situatë të rënëdë kur realizojmë planet e shtetit, kur bëhet gruri, bëhet misri e nuk krijohen deficite, ndryshe konsekuençat ekonomike, politike dhe ushtarake janë të palllogaritshme.

Nga ky kënd vështrimi duhet ta shikojnë njerëzit tanë situatën e krijuar, sepse ka ardhur momenti që edhe në qoftë se te dikush ekziston njëfarë euforie cse mendjemadhësie, ose si ta quajmë këtë njëfarë «trimërie» ose besimi të tepruar, të gjitha këto, duhen luftuar. Është e vërtetë që shqiptarët janë trima, të tillë kanë qenë e duhet të jenë, të guximshëm, të hedhur, por me tru në kokë dhe të veprojnë me gjak- ftohtësi.

Punën për të krijuar e për të ngulitur koncepte të drejta për situatën që kalojmë, duhet ta fillojmë që tash. Do të botohet nota kineze për prerjen e marrëdhënieve ekonomike, të ndihmave civile e ushtarake nga Kina. Mendoj se për shpjegimin e kësaj note nga ana politike, ideologjike, propagandistike dhe organizative, kemi shumë punë për të bërë. Këto çështje do t'i shtrojmë edhe në mbledhje të Byrosë Politike. Këtu dua të vë në dukje disa prej tyre.

Me teknikët e specialistët kinezë të jemi korrektë. siç kemi qenë, por edhe vigjilentë të jemi, se do të ketë prej tyre që do të përpilen të bëjnë ndonjë sabotim. Një gjë të tillë ne duhet ta evitojmë. Ka mundësi që tani ata të largohen. Se kur do të ikin, kjo nuk dihet, por për kohën që ata janë këtu, duhet të jemi shumë të kujdeshshëm në marrëdhënie me ta. Veç një

gjë: Ne nuk mund të lejojmë që specialistët kinezë të largohen që këtej pa ardhur tanët që andej. Edhe ne kemi studentë e kursantë<sup>1</sup> në Kinë. Për këtë problem do të bisedojmë me Ministrinë e Jashtme. Të thërritet ambasadori kinez dhe t'i thuhet, mendoj unë, që: «Dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni se tërheqja e specialistëve tuaj nga Shqipëria do të bëhet e koordinuar me tërheqjen e studentëve, të specialistëve dhe të pedagogëve tanë që ndodhen në Kinë».

Natyrisht, kur specialistët kinezë do t'u thonë inxhinierëve tanë që ne do të ikim, tanët, sidomos ata që janë në kontakt me ta, do të dinë si t'u përgjigjen. Mund t'u thuhet hapur: «Ne e dimë që qeveria kinezë i ka dërguar Qeverisë Shqiptare një notë, e cila është një notë armiqësore. Udhëheqësit kinezë janë përgjegjës për prishjen e marrëdhënieve ekonomike, politike dhe ideologjike të Kinës me Shqipërinë. Një gjë e tillë i shkakton dëme të mëdha ekonomisë shqiptare, por do t'i shkaktojë dëme të pallogaritshme edhe vetë udhëheqjes kineze. Ne ju themi se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, do të vazhdojë të ecë përpara me siguri dhe të gjitha çka ajo ka vendosur e planifikuar dë t'i realizojë edhe pa ndihmën tuaj, vetëm me forcat e saj. Populli shqiptar nuk e harron ndihmën internacionliste të popullit kinez, por kjo ndihmë duket qartë që po keqpërdorej e po interpretohej me qëllime të tjera nga udhëheqësit kinezë. Për

---

1. Në Kinë, në atë kohë ishin 56 kursantë të metalurgjisë së ferrokromit e të tullave refraktare dhe 57 studenjtë shqiptarë.

këtë veprim armiqësor të udhëheqjes së Partisë dhe të qeverisë kineze, ne nuk bëjmë fajtorë specialistët kinezë. Kemi punuar bashkë si miq dhe kemi diskutuar së toku, edhe na keni kritikuar, edhe ju kemi kritikuar për të metat që janë vënë re në punë. Kjo është një gjë e natyrshme. Na vjen keq që ju do të largoheni, por kjo s'është në vullnetin tonë. Ju urojmö, kur të ikni, rrugë të mbarë dhe të jeni të sigurt se bashkë-punimi ynë këtu nga ne nuk do të harrohet, kurse përsa u përket juve, kjo është çështja juaj».

Pra, mendoj që gjatë kësaj kohe qëndrimet tona ndaj specialistëve kinezë të mos ndryshojnë. Me qëndrimet tona të drejta, ne duhet të bëjmë që ata të ikin nga Shqipëria duke bërë fajtore qeverinë e tyre dhe të shohin se shokët shqiptarë qenë deri në fund korrektë. Shkurt, hapi ynë i parë të jetë ky, që Partisë t'i themi një gjë të shkurtër për këto çështje. Njerëzit tanë në bazë ta dinë që kjo është situata. Ky veprim nga ana e udhëheqësve kinezë nuk ishte i papritur për ne. Një gjë e tillë ne nuk do të na pengojë për të ecur përpëra në realizimin e detyrave. Natyrisht, vështirësi do të kemi, por këto do t'i kapërcejmë. Prandaj të mobilizohemi më shumë se kurrë për realizimin dhe tejkalimin e planeve.

Në notën e qeverisë kineze nuk flitet për çështjet e tregtisë, vetëm për kreditë dhe për specialistët bëhet fjalë, prandaj këtë çështje nuk mund ta vendosim tash-ti, por ta mendojmë mirë. Neve, në tregtinë me Kinën, nuk na leverdis, për shembull, çështja e transportit, por në qoftë se kinezët duan t'i vazhdojnë marrëdhënie tregtare, edhe ne s'kemi kundërshtim, veçse disa

mallra mund të mos i sjellim më nga Kina, por t'i si-gurojmë nga vende që kemi më afër.

Në Kinë ne kemi dhe vaporin «Vampo», që është yni. «Vampoja» mundet që edhe të shkojë në Kinë, të marrë mallra dhe të kthehet. Me këtë vapor mund të kthehen edhe të gjithë njerëzit që kemi ne në Kinë.

Ne i kemi të gjitha argumentet për demaskimin politiko-ideologjik të udhëheqjes antimarksiste të Partisë dhe të qeverisë së Kinës. Me luftën tonë parimore ta shtojmë edhe më shumë simpatinë e të gjitha masave e të popujve në botë ndaj Shqipërisë dhe ky akt armiqësor i udhëheqësve kinezë të bjerë si një saç i rëndë mbi kokën e tyre. Për këtë arsyе ne duhet të reflektojmë, të reflektojmë dhe të përcaktojmë format dhe mënyrat më të efektshme për demaskimin e tyre dhe kurdoherë të tregojmë gjakftohtësi, e përsëris, gjakftohtësi. Këtë rast ne ta shfrytëzojmë më mirë në favorin tonë dhe të mos u japim as mundësinë më të vogël kinezëve për ta përdorur këtë akt në dobi të politikës së tyre demagogjike.

Eshtë fakt që e gjithë politika aktuale e Kinës është e tillë që ajo po demaskohet në sytë e popujve të botës. Qëndrimet politiko-ideologjike ndaj Vietnamit gjithashtu e kanë diskredituar fare Kinën. Të gjitha përpjekjet që ajo bën për të krijuar një miqësi fal-së, të fabrikuar, me shtetet e tjera, do të dështojnë, se ato s'kanë besim tek ajo. Por akti armiqësor ndaj Shqipërisë e demaskon akoma më tepër politikën kinezë.

Demaskimi që do t'i bëjmë Kinës varet nga ne. Puna jonë, gjithmonë, kur ne kemi argumentuar plo-

tësisht, politikisht dhe ideologjikisht pikëpamjet e Partisë sonë dhe kemi demaskuar pikëpamjet antimarksiste dhe antishqiptare të të tjerëve, ka dhënë prova të sigurta të forcimit të politikës së Partisë e të shtetit tonë. Prandaj, në këtë drejtim, problemi duhet menduar thellë, që nga ne këtu në krye. Veçanërisht shoku Ramiz, që përgjigjet për propagandën, duhet të aktivizojë mirë grupet e punës që kemi aktualisht, të cilat t'i forcojmë edhe me kuadro të tjerë, të shkruajnë për të demaskuar veprimtarinë armiqësore revizioniste kineze dhe për të mbrojtur tezat e drejta të Partisë sonë.

Ndihma që do të japid këta shokë nuk konsiston vetëm në të shkruar, por edhe për të menduar e për të reflektuar rreth kësaj pune, për shembull, për artikujt që do të shkruhen në momente të caktuara, për probleme të veçanta. Ja, tashti doli vëllimi i 26-të i Veprave të mia. Lexova aty edhe një herë vetëm dy materiale: një është bisedë me delegacionin e Bashkimeve Profesionale të Republikës Demokratike të Vietnamit<sup>1</sup>, i cili më duket se ka qenë i kryesuar nga Tran Danh Tuen që ishte Sekretar i Përgjithshëm i Federatës. Ky material është botuar, natyrisht pasi i janë hequr pjesët ku unë kam folur për Kinën, tanë në këto momente, shkon aq mirë. Në këtë vëllim lexova gjithashtu një artikull për Hrushovin me titull: «N. Hrushovi shtrembëron idetë e Leninit për t'i hapur rrugë kursit të vet proimperialist»<sup>2</sup>. Ai është ar-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 227.

2. Po aty, f. 159.

tikull i botuar në «Zërin e popullit» dhe bën fjalë për ndihmën amerikane që marrin sovjetikët. Por ky artikull tash sikur u përshtatet edhe kinezëve, sidomos pikëpamjeve të Ten Hsiao Pinit, që thotë se duhet të marrin teknologji të përparuar nga amerikanët. Hrušovi thotë që amerikanët të investojnë në Bashkimin Sovjetik, në qoftë se duan të marrin fitime etj., etj. Po kinezët, ç'po bëjnë? Edhe këta po kështu thonë.

Mund të ketë edhe artikuj të tjerë si këta, që mund të përdoren për demaskimin e kinezëve, para se të botohen artikujt e drejtpërdrejtë kundër tyre.

Pra, këta njerëz, të cilët thashë se duhen mbajtur pranë grupeve të punës që janë ngritur, të mendojnë për të shkruar artikuj të tjerë për probleme të ndryshme në kohë të ndryshme, që na dalin papan-dehur, por që edhe duhet t'i parashikojmë. Ja së shpejti Hua Kuo Feni do të vejë në Rumani e në Jugosllavi. Që tash ne duhet të mendojmë se çfarë dhe si do të shprehemi për këtë vajtje të tij në këto vende<sup>1</sup>. Kështu që tashti para nesh dalin disa probleme të cilat ne, si kurdoherë, duhet t'i zgjidhim me sukses.

Së pari, ne duhet të demaskojmë e të themi hapur se cilat janë qëllimet e Kinës në Ballkan. Ajo kërkon të futë këmbët në Ballkan dhe ta përdorë atë si mish për top në një luftë të re imperialiste, duke prishur situatat aktuale në këtë gadishull. Udhëheqja kineze u armiqësua me Shqipërinë, për arsyen e Shqi-

---

1. Në bazë të kësaj ideje, u ribotua në broshurë artikulli i shokut Enver Hoxha: «Hrušovi në gjunjë para Titos». Aluzioni ishte për Hua Kuo Fenin.

përia ka pikëpamjet e saj dhe nuk lejon kurrkënd t'i imponojë asaj pikëpamjet e huaja antimarksiste e antishqiptare të kujtdo qofshin ato.

Së dyti, Kina, nëpërmjet Jugosllavisë e Rumanisë kërkon të armiqësojë popujt e Ballkanit nën maskën gjoja të luftës kundër socialimperializmit sovjetik. Në artikullin që ne do të bëjmë të demaskojmë qëllimet e Kinës, politikën e saj luftënxitëse, që konkretizohet dhe me ardhjen e kreut të udhëheqjes kineze në këto dy vende. Popujve të Jugosllavisë ne t'u lëmë të kuptojnë që kështu siç ia bëri Shqipërisë me të pabesë, mund t'ua bëjnë edhe atyre! Dhe medoemos që do t'ia bëjë edhe Rumanisë e popujve të tjerë të Ballkanit. Ne e dimë që udhëheqja kineze nuk ka ç'i bën Shqipërisë, por megjithatë le ta themi një gjë të tillë. Ne do të themi gjithashtu atë që kemi deklaruar, se në një rrezik ndaj popujve të Jugosllavisë nga socialimperializmi sovjetik ose nga imperializmi amerikan, populli shqiptar do të jetë përkrah tij. Ide të tillë si këto, që do të na vijnë në mendje nga zhvillimi i situatave, do t'i bisedojmë bashkë. Ideja themelore duhet të jetë që ne të demaskojmë njëherë ideologjikisht e politikisht këtë vijë kineze, të nxjerrim në shesh se ç'fshihte ndihma që Kina na jepte neve dhe të demaskojmë politikën e Kinës veçanërisht në Ballkan, me qëllim që t'ia prishim planet që ajo ka në këtë zonë.

Përse e ndërmorën udhëheqësit kinezë këtë veprim armiqësor ndaj Shqipërisë? Këta e bënë këtë përpresion kundër nesh. Kjo është e qartë, sepse ata mendojnë se prerja e ndihmave nga ana e tyre është një katastrofë për Shqipërinë! Një gjë e tillë nuk është

një katastrofë për ne, por është një demaskim për ta. Ata mendojnë se Shqipëria, në këto situata, do të kërkojë ndihmë, do t'i shtrijë dorën për ndihma e kredl ndonjë shteti tjetër. Por gabojnë rëndë. Ne kurkujt nuk do t'i shtrijmë dorën. Kinezët do të përdorin për të shpifur kundër nesh edhe tregtinë që ne do të bëjmë me kliring edhe me devizë me shtetet e ndryshme të botës, me përjashtim të atyre pak shteteve me të cilat ne kemi deklaruar se nuk do të bëjmë as tregti.

Së treti, udhëheqja antimarksiste kineze mendon se në qoftë se shqiptarët nuk kthejnë sytë nga perëndimi, do të afrohen me Jugosllavinë, prandaj dhe Hua Kuo Feni do ta këshillojë Jugosllavinë e Titos që të mbajë pozitë «miqësore» me ne. Por ne u themi jugosllavëve që intrigat e kinezëve ne i njohim mirë, qëndrimet tona nuk ndryshojnë; ne nuk tundemi nga pozitat tona të drejta, bile ju themi edhe juve, edhe të tjerëve që kini kujdes, sepse politika e Kinës është një politikë pragmatiste, është një politikë antipopullore, një politikë e koniunkturave. Për këtë në materialin tonë mund të gjejmë vend për të folur shumë që Kina dje ishte me Mobutun, tashti u bë me Zia Ul Hakët etj. Domethënë në këtë material mund të kombinojmë shumë çështje që të përplasen të gjitha kundër Hua Kuo Fenit e politikës së tij, të demaskojmë qëllimet e politikës kineze dhe me këtë rast t'u themi edhe jugosllavëve, edhe revizionistëve sovjetikë, edhe gjithë revizionistëve të tjerë që mos bini në pozitën e dhelprës, se s'keni gjë në vijë. Shqipëria dëshiron të bëjë tregti me ju, më jep, të të jap, por nuk ndërron qëndrimet e saj politike.

Edhe në këtë drejtim të jemi shumë të matur. Ne do të bëjmë edhe tregti, se pa tregti s'bëjmë dot; do të blejmë edhe centrale, por do ta zgjedhim shtetin të cilit do t'ia blejmë ato. Ne do të bëjmë tregti me ata që kanë më pak mundësi të spekulojnë e ta përdorin rrugën tonë të drejtë për të thënë se gjoja ne ndryshuam. Tregti ne bëjmë edhe me Çekoslllovakinë, sepse me çekët ne kemi njëfarë tregtie dhe me kliring. Prandaj theksova që nü këtë drejtim duhet të jemi shumë të matur, për këto gjëra të mendojmë e të veprojmë me kujdes të madh.

Tashtri çështja e parë e rendit të ditës të punës sonë, më duket mua, është përgatitja për t'u dhënë përgjigje revizionistëve kinezë. Kjo nuk është vetëm një përgatitje ekonomike, por politike dhe ideologjike. Për sa u përket ndihmave të Kinës, në Letrën tonë të themi që ato ne i kemi marrë, duke menduar se na jepeshin nga një shtet mik, nga një vend socialist e në fryshtë e parimeve të socializmit. Kur na jepeshin këto ndihma, udhëheqja kineze ka thënë se ndihma që ne ju japim është infime, fare e vogël, kurse ndihma që i ka dhënë Shqipëria Kinës në momentet më të vështira, nëpër të cilat ajo ka kaluar, është kolosale. Prandaj pretendimi i saj se këto ndihma kanë mbajtur gjallë shpirtin shqiptar, është një blof dhe ka pasur për qëllim të gënjejë opinionin botëror. Ne e njohim këtë ndihmë; këtë gjë e kemi thënë, e kemi shprehur dhe do ta shprehim përsëri, kurse ju, të thuhet në Letër, nuk e shprehni atë që keni thënë lidhur me ndihmën që i ka dhënë Shqipëria e vogël Kinës së madhe në kohën më të rrezikshme e më katastrofale të

jetës së saj. Ne mund të themi se vetë Mao Ce Duni, Çu En Lai e Li Hsien Nieni, i cili edhe tash ndodhet në udhëheqje të partisë e të shtetit tuaj, si dhe udhëheqës të tjerë, kanë pohuar me gojën e tyre se ndihma e Shqipërisë për Kinën është e pallogaritshme. Veçse tash, këtë fakt, ju harroni ta zini në gojë në notën që na drejtoni. Ne nuk dëshironim të përmendnim ndihmën që Shqipëria i ka dhënë Kinës, por na detyruat ju të flasim pör të, se ju po ecni në rrugën e hrušovianëve, nën shembullin e tyre, duke numëruar ndihmat «internacionaliste» që i keni dhënë popullit të një vendi socialist për të treguar gjoja se keni qenë në rrugë të drejtë internacionaliste!!

Lidhur me këtë çështje, në përgjigjen tonë, gjithashtu të thuhet se veprimi që ju, kinezët, ndërmorët ndaj Shqipërisë vërteton faktin që pikëpamjet tuaja dhe ndihma juaj ka pasur një paramëndim, një qëllimi që ju tash e treguat sheshit, duke i prerë marrëdhëni të ekonomike me Shqipërinë. Këtu, në vija të përgjithshme duhet të themi, që për sa u përket mosmarrëveshjeve ideologjike e politike, që kanë ekzistuar midis nesh ngaqë Partia dhe Qeveria jonë nuk kanë qenë dakord me vijën e qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës ndaj problemeve të ndryshme parimore, nuk do të hyjmë në detaje. Ne kemi kërkuar dhe jemi përpjekur që ato t'i zgjidhnim në rrugë marksiste-leniniste, por udhëheqja kineze nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë logjike, që i shërbente çështjes sonë të madhe.

Unë mendoj që ne t'i numërojmë momentet kur dhë pse Partia jonë i ka kundërshtuar qëndrimet e

Partisë Komuniste të Kinës. Për shembull, ngritja e çështjes së rivendikimit të kufijve me Bashkimin Sovjetik, si dhe e rishikimit të kufijve të disa vendeve të Evropës me Bashkimin Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore, bëhej nga ana e Kinës në vitin 1964, në një kohë kur marksistët luftonin dhëmb për dhëmb me hrushovianët për të demaskuar tradhtinë e tyre. Kuptohet qartë se problemi që ngrihej nuk i shërbente çështjes. Pastaj, një veprim i tillë ishte dhe një akt kundër Stalinit dhe vendimeve të aleatëve për këtë çështje, kur dihej se Hrushovi luftonte me tërbim kundër veprës së tij. Pikëpamjen tonë lidhur me këtë problem ne jua thamë; ju keni qenë kundër dhe nuk keni dashur të diskutoni me ne.

Për sa i përket vizitës së Niksonit në Pekin, do t'u themi se ne ju kemi dërguar një letër, e cila në kohën e duhur do të publikohet, ku janë përcaktuar pikëpamjet tona të drejta, që koha i ka vërtetuar si të tilla. Këtu të vihet në dukje qëndrimi i udhëheqjes kineze ndaj Partisë sonë duke mos e vënë atë në dijeni edhe për vendime të rëndësishme që ajo merrte, vendime që shënonin kthesë në politikën e Kinës. Për çdo çështje të rëndësishme ndërkombëtare dy parti e vende aleate duhej të konsultoheshin, por këtë gjë ju s'e keni bërë.

Dhe sa për sulmet që ju pretendoni se ne kemi bërë kundër Mao Ce Dunit në Kongresin tonë të 7-të, kjo, të thuhet në Letër, është një nga gabimet tuaja Ideologjike më të mëdha, për arsyen se ne nuk kemi atakuar kurrkënd, veçse kemi mbrojtur tezat tona, të

cilat kanë qenë të palëvizshme që në formimin e Partisë. Për sa i përket veçanërisht, teorisë së «botës së tretë», që ju pretendoni se e ka përpiluar Mao Ce Duni në vitin 1974, Partia e Punës e Shqipërisë e ka sulmuar qysh në vitin 1960. Prandaj jeni ju që keni sulmuar Partinë tonë, pa pasur asnjë bazë reale. Megjithatë ju na akuzuat me anën e një letre, dhe ne nëpërmjet një letre ju kërkuam që të na shpjegonit se ku ju kishim sulmuar. Ju nuk na u përgjigjët. Por një gjë e tillë ka qenë praktikë e zakonshme nga ana juaj. Ne kemi kërkuar shumë herë të bisedonim e të sqaroheshim për problemet që lindnin midis nesh, por ju s'keni dashur e s'na jeni përgjigjur fare. Në këtë përgjigje, siç e vura në dukje dhe pak më sipër, kjo çështje të jepet në vija të përgjithshme, duke thënë se për të gjitha këto ekzistojnë dokumente të shkruara, të cilat në kohë të përshtatshme do të botohen të tëra me qëllim që të njihet opinioni botëror me to.

Tashti duhet punuar mirë, sistematikisht, për përgjigjen që do t'u japim atyre. Për këtë qëllim, Ramiz, duhen gjetur materialet që do shfrytëzohen dhe të fillohet nga puna.

Letërpërgjigja jonë duhet të jetë, në radhë të parë, një letër demaskuese politike, ideologjike, por edhe nga ana ekonomike të rrëzohen ato ç'thonë kinezët. Në këtë Letër idetë kryesore të dokumenteve duhet t'i vëmë shkurt dhe të themi aty që për sa u përket të gjitha çështjeve që ngrihen nga ana juaj, ekzistojnë dokumente me pikëpamjet tona, ku del qartë se jeni ju që keni sabotuar miqësinë midis nesh dhe jo ne.

Këto dokumente, të cilat ju janë dorëzuar zyrtarisht nga ana jonë, do të bëehen të gjitha në kohën e duhur.

*Bëhet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# **SOCIALIZMIN TA NDERTOJME PA HARRUAR PER ASNJE ÇAST MEROJTJEN E POPULLIT DHE TË FITOREVE TË TIJ**

*Fjala në takimin me studentë dhe kuadro të shkollave ushtarake me rastin e 35-vjetorit të krijimit të Ushtrisë sonë Popullore*

**10 korrik 1978**

Të dashur shokë ushtarë dhe kuadro të Ushtrisë sonë Popullore,

Sot erdha këtu, te ju, t'ju uroj nga zemra në emër të Komitetit Qendror, në emër të Partisë dhe në emrin tim personal për festën e madhe — 35-vjetorin e krijimit të Ushtrisë sonë Popullore. 10 Korriku i vitiit 1943 është një ditë e shënuar në historinë e popullit tonë, për arsy se, nën udhëheqjen e Partisë dhe në zjarrin e luftës së madhe kundër armiqve, u arrit uniteti i çeliktë i formacioneve luftarake të luftëtarëve të popullit shqiptar, që ishin ngritur me armë në dorë për të çliruar atdheun njëherë e përgjithmonë nga thundra e pushtuesve të huaj dhe nga borgjezët e feudalët vendës, që ishin bërë aleatët e tyre.

Ky unitet në luftë i formacioneve luftarake të luftëtarëve të popullit, që deri në atë kohë ishin organizuar ushtarakisht në çeta e në batalione, u arrit, nën udhëheqjen e Partisë sonë, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e njësive të mëdha luftarake. Rëndësia e madhe e ditës së formimit të ushtrisë mund të gjykohet akoma më mirë tanë, pas 35 vjetëve, kur dihet botërisht se si u bëri ballë ajo me sukses forcave të mëdha të armiqve pushtues, italianë dhe gjermanë, si dhe forcave kuislinge, që me urë në dorë kishin shkelur Evropën, vritnin dhe shtypnin popullin shqiptar, digjin e shkrettonin atdheun e tij.

Sa ditë, sa muaj dhe sa vite që kalojnë nga koha e themelimit të ushtrisë sonë, aq më madhështore duket e çmohet kjo vepër e madhe e Partisë, që do të përmendet vazhdimisht në histori. Lufta e organizuar për çlirimin përgjithmonë të popullit shqiptar nga robëria e dyfishtë, e të huajve dhe e armiqve të tij të brendshëm, për t'ia arritur kësaj dite të gëzueshme, është kurorëzuar me sukses.

Ne sot kujtojmë me respekt shokët tanë heroikë që luftuan me guxim e vetëmohim për çlirimin e atdheut dhe, me gjakun e tyre, mbrujtën themelitë e kësaj kalaqe të fortë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kujtojmë me respekt të madh e me një dashuri të thellë heronjtë e lavdishëm të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, ata, të cilët luftuan anekënd vendit me armë e me çdo mjet që kishin në duar dhe ranë në llogore, në fushën e nderit, në male, në

lugina me qëllim që lufta të përfundonte me çlirimin e plotë të atdheut.

Përpara bijve dhe bijave të tij të rënë në fushën e nderit përulen sot me mirënjoje të pakufishme mbarë populli ynë dhe Partia, të cilën ata e deshën me gjithë shpirt, pse ajo përfaqëson dëshirat, vullnetin dhe interesat e mëdhenj të popullit të tyre, pse ajo ditit i udhëhiqte në rrugë të drejtë, mbi bazën e parimeve të pagabueshme marksiste-leniniste, pse ajo mundi të ringjallte e të kaliste te njerëzit tanë patriotizmin, guximin dhe vendosmërinë, këto tipare të rrënjosura në shekuj, të popullit shqiptar.

Partia Komuniste e Shqipërisë (sot Partia e Punës) ditit të bënte sintezat e ngjarjeve të lavdishme dhe të ngjarjeve të hidhura të historisë së popullit tonë gjermanë atë kohë dhe t'i kishte ato parasysh në momentet shumë të vështira kundër një rrebeshi aq të egër dhe aq barbar të luftës së madhe botërore, që nuk kishte parë historia njerëzore. Një vepër e tillë e Partisë sonë, siç ishte krijimi i Ushtrisë Popullore, sado e vogël që ishte kjo ushtri në atë kohë, sot, pas 35 vjetësh, kur njohim fitoret e arritura gjatë dhe pas Luftës Nacional-çlirimtare, duket më madhështore. Është për këto arsyen, shoqe dhe shokë të dashur, që sot zemrat tona nati ka pushtuar një gëzim i madh. Në këtë festë jubilare gjithë zemrat e popullit tonë rrahin me një dashuri të madhe për Partinë dhe për ushtrinë e tij, për këtë ushtri që u formua në male dhe që grumbullon në gjirin e vet gjithë popullin, të madh e të vogël.

Kohët janë të tilla që liria e pavarësia e popullit dhe sovraniteti kombëtar, të fituar me luftë, mund të

ruhen dhe të mbrohen, duke pasur në këmbë një ushtri të shëndoshë, të disiplinuar, të brumosur me ndjenjat proletare dhe me një besnikëri të pafund ndaj popullit dhe atdheut socialist.

Komiteti Qendror i Partisë dhe unë kemi ndjekur vazhdimisht përparimet dhe sukseset tuaja, por edhe mungesat, pengesat e vështirësitë që keni hasur në punë e sipër. Ju e dini se Partia jonë, duke i vënë kujdesin më të madh mbrojtjes së vendit, ka marrë të gjitha masat dhe ka bërë shumë sakrifica që Ushtria Popullore të jetë në nivelin e lartë të detyrës, që ajo t'u përgjigjet në çdo kohë nevojave të atdheut dhe të jetë në gjendje për ta mbrojtur Shqipërinë nga çdo armik eventual dhe nga çdo anë që mund t'i turret, nga çdo rrezik që mund t'i kanoset.

Ashtu siç konstatojmë përparime të mëdha në çdo punë e në çdo sektor të aktivitetit shtetëror, si në industri, në bujqësi, në arsim, në kulturë e në shkencë, të njëjtën gjë vërejmë edhe në Ushtrinë tonë Popullore. Partia jonë, e bazuar në marksizëni-leninizmin dhe në bazën e tij filozofike, materializmin dialektik dhe historik, e ka udhëhequr progresin në të gjithë sektorët e punës e të jetës së vendit tonë me etapa, që janë zhvilluar njëra pas tjetrës. Në këtë proces ajo ka kapërcyer vështirësi dhe pengesa, duke krijuar mundësi të reja që çdo gjë të shkojë drejt përmirësimit e perfektionimit të mëtejshëm. Aktualisht, ne shohim me kënaqësi se, krahas shndërrimeve progresive të mëdha që janë bërë në vendin tonë, në radhë të parë në edukimin e njeriut të ri, në industri, në bujqësi, në arsim e

kulturë, suksese të njëpasnjëshme vërchen edhe në Ushtrinë tonë Popullore.

Partia dhe Komiteti i saj Qendror e kanë dashur dhe e kanë çmuar shumë Ushtrinë Popullore qysh në themelin e saj, prandaj kanë treguar kujdesin më të madh që ajo të rritej e nga «foshnjë» të bëhej «burrë» me të gjitha meritat e kualitetet politike dhe ideologjike marksiste-leniniste dhe janë përpjekur për ta pajisur atë me strategjinë dhe taktikën fitimtare të luftës popullorë, për ta astësuar që ajo të jetë në gjendje të kryejë detyrat e saj të lavdishme.

Zhvillimi në këto drejtime i ushtrisë sonë ka ndjekur ritmin e zhvillimit të të gjithë sektorëve të tjerë të veprimtarisë së vendit tonë socialist, zhvillimi që nuk mund të kuptohet i shkëputur e i njëan-shëm. Përparimi në çdo sektor ka ecur te ne frontaliste, për arsy se kemi qenë të ndërgjegjshëm, që dobësimi ose mbetja prapa në njërin prej tyre, do të sillte me vete dobësimin dhe mbetjen prapa të sektorëve të tjerë.

Gjithë zhvillimi ynë socialist, pra jo vetëm industria, bujqësia, por edhe arsimi e kultura, edhe ushtria, duhet të ecte përpara në rrugën e drejtë të Partisë dhe në mënyrë të balancuar e me plan, duke u bërë përpjekje të mëdha materiale e morale që ky plan të realizohej me sukses në të gjithë sektorët pa përjashtim.

Partia, që në ditët e para të Çlirimit dhe vazhdëmisht, na ka mësuar se jetën e re e të lumtur të popullit, socializmin, duhet ta ndërtojmë pa harruar pëasnjë çast mbrojtjen e popullit, të fitoreve të tij të

arritura me gjak e me sakrifica. Partia na ka ngulitur në mendjen dhe në ndërgjegjen tonë idenë e madhe që në asnjë rast ndërtimi i ekonomisë socialiste nuk duhet të shkëputet nga forcimi i ushtrisë së fuqishme popullore. Është kjo arsyaja që gjatë gjithë procesit të ndërtimit të socializmit, te ne ka ecur paralelisht edhe zhvillimi i Ushtrisë sonë Popullore nga një ushtri e vogël në fillim, e dalë nga Lufta partizane Nacional-çlirimtare, në një ushtri të përparuar moderne, besnikë e diktaturës së proletariatit, e armatosur me shkencën ushtarake fitimtare dhe me Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore.

Në situatat e pasluftës, Komiteti Qendror i Partisë ndiqte me kujdesin më të madh zhvillimin e ngjarjeve në botë dhe rrëth nesh dhe vërente se, me gjithë fitoren e arritur, atdheu ynë, Shqipëria e re, duhej ndërtuar nga themeli materialisht, por njëkohësisht duhej ngritur edhe në një platformë të lartë politike, ideologjike dhe arsimore.

Në të gjitha këto etapa zhvillimi, Partia, me Komitetin e saj Qendror në krye, bëri transformime rrënjësore pozitive në kalitjen dhe në edukimin e ushtrisë sonë, ajo përpunoi bazat teorike dhe parimet themelore të ndërtimit e të përgatitjes së Ushtrisë Popullore si mbështetje e armatosur e shtetit të diktaturës së proletariatit. Kalitja dhe edukimi ushtarak vazhdon e do të vazhdojë të bëhet edhe në të ardhmen. Kjo punë do të vazhdojë edhe për arsy se në ushtri vijnë vazhdimesh breza të rinj, të cilët kanë nevojë të përvetësojnë teorinë e Partisë, Artin Ushtarak Popullor dhe eksperiencën e pasur të kuadrove të vjetër.

Të rintjtë, krahas asaj që do të marrin, do të sjellin në Ushtrinë tonë Popullore vullnet të ri, dituri të reja dhe eksperiencë të re.

Nga eksperienca e madhe e stërvitjes, e punës, e luftës dhe e jetës së përditshme të ushtrisë sonë, Partia dhe Komiteti i saj Qendror bëjnë vazhdimisht konkluzione dhe analiza, perfektionojnë artin ushtarak, ngrënë në një shkallë më të lartë nivelin politik të kuadrove dhe të efektivit të ushtrisë dhe kujdesen për të rrënjosur në mendjen dhe në ndërgjegjen e njerëzve teorinë marksiste-leniniste.

Shokë dhe shoqe,

Ju, ushtarakët e Ushtrisë sonë të madhe Popullore, jeni bij dhe bija besnikë të këtij populli, që ju lindi dhe ju rriti, prandaj rroni ngushtë dhe jetoni tok me të, ndani së bashku gëzimet dhe hidhërimet e tij, gjykon me gjakftohësi dhe me përgjegjësi edhe për sukzeset, edhe për të metat, edhe për momentet nëpër të cilat po kalojmë. Partia i jep ushtrisë së madhe të popullit atë edukatë të përshtatshme që i nevojitet një ushtrie të tipit të ri, thellësisht revolucionare popullore. Dhe një ushtri thellësisht revolucionare popullore, siç është kjo jona, nuk është më një ushtri kazerme, nuk është një ushtri konvencionale borgjeze. Ushtria jonë është ushtri e një natyre krejtësisht tjeter, një ushtri që mbron diktaturën e proletariatit, që mbron socializmin dhe jo borgjezinë e pasuritë e saj.

E frysmezuar nga idetë revolucionare të proleta-

riatit, ushtria jonë mbron lirinë, pavarësinë dhe so-vranitetin e popullit, ajo është rojë e demokracisë së vërtetë të punonjësve tanë dhe jo e «demokracisë» së një grushti kapitalistësh. Detyrën e vënë nga Partia për edukimin e saj politik dhe ideologjik Ushtria jonë Popullore po e zbaton me sukses dhe në këtë drejtim ajo ka arritur rezultate të kënaqshme. Detyrën e edukimit ideopolitik duhet të mos e harrojnë për asnjë moment njerëzit tanë. Që kur venë në shkollë, kur shkojnë për të kryer shërbimin ushtarak, si edhe kur dalin në shërbimin rezervë e gjatë gjithë jetës njerëzit tanë duhet të merren me edukimin e tyre të gjithashëm. Kudo që punoni e drejtoni, shokë dhe shoqe, të punoni për ngritjen tuaj të vazhdueshme ideologjike dhe politike. Edukimin ta konsideroni si një nga detyrat më kryesore.

Në ushtrinë tonë, si ushtri politike, që brumoset e çelikoset me ideologjinë marksiste-leniniste, zbatohet parimi i vënies së politikës proletare në komandë, që do të thotë se faktori ideopolitik ka epërsi mbi atë ushtarak. Ky parim do të ndihmojë në ecjen përpara të ushtrisë në rast se të gjithë njerëzit e kuptojnë politikën në të gjitha momentet dhe shfaqjet e saj, në prizmin e marksizëm-leninizmit. E kuptuar ndryshe, politika që do të zbatohet në ushtri do të jetë e gabuar. Vetëm ajo politikë që shikohet me një sy të qartë marksist-leninist, që shpreh realitetin me vërtetësi dhe që pasqyron interesat e masave punonjëse është e pagabueshme, e drejtë dhe në dobi të popullit e të ndër-timit të shoqërisë socialiste. Politika jonë është e li-

dhur ngushtë me botëkuptimin marksist materialist, prandaj është e drejtë.

Ne kemi arritur rezultate për arsyen se, në përgjithësi, ideologjia jonë kuptohet nga populli, ndryshe vendi ynë nuk do të ekte drejt socializmit, por do të ishte shndërruar me kohë në një vend kapitalist dhe populli ynë i vogël do të ishte vënë nën thundrën e imperializmit ose të revizionizmit. Për të gjitha këto arsyen, qëndrimi fort në këmbë i Shqipërisë socialiste u detyrohet Partisë, vijës së saj të drejtë, ideologjisë marksiste-leniniste dhe popullit të saj heroik. Ideologjinë tonë, që është një armë e fuqishme, aktive dhe revolucionare për transformimin revolucionar të shoqërisë, duhet ta përvetësojnë të gjithë. Secili duhet të bëjë përpjekje që ta përvetësojë këtë ideologji, me qëllim që të dijë të kuptojë drejt ngjarjet, fenomenet, proceset dhe momentet nga të cilat kemi kaluar, po kalojmë dhe do të kalojmë në të ardhmen. Marksizëm-leninizmi është e vetmja teori revolucionare që ndriçon rrugën për përgatitjen dhe për kryerjen me sukses të revolucionit socialist. Kjo do të thotë që ta zbatojmë marksizëm-leninizmin në kushtet e vendit tonë, në mënyrë krijuese dhe jo ta konsidrojmë si dogmë, pse dogma çon në subjektivizëm, shkëput teorinë nga praktika.

Revolucioni socialist është ligj objektiv, që ka për qëllim përbysjen e kapitalizmit dhe kalimin në socializëm. Objektivi i fundit i revolucionit socialist është ndërtimi i shoqërisë pa klasa, në të cilën s'ka më ndarje të shoqërisë në klasa, zhduken kontrastet e sotme midis qytetit e fshatit, midis punës mendore e

fizike etj., çdo anëtar i shoqërisë merr të mira materiale sipas nevojave që ka dhe krijohet një botëkuptim i ri në njerëzit, që bëjnë një jetë materiale e kulturore të pasur, krejt të ndryshme nga kjo që bëjnë aktualisht. Në qoftë se ne e kuptojmë marksizëm-leninizmin si ideologjinë udhëheqëse të revolucionit proletar, atëherë kemi kuptuar si duhet mësimin e Partisë sonë se marksizëm-leninizmi nuk është një dogmë. Kur thotë Partia jonë që teorinë e madhe të revolucionit proletar duhet t'ua përshtatim kushteve tona konkrete, kjo nuk duhet kuptuar si regres, si mohim i botëkuptimit revolucionar të klasës punëtore, as si kundërvënie të këtyre kushteve ndaj revolucionit proletar, siç bëjnë revizionistët modernë, por duhet kuptuar si progres që i shërben zbatimit besnik dhe krijues të teorisë sonë në terrenin konkret, në kushtet konkrete.

Teoria jonë na mëson që çdo ngjarje, proces apo fenomen shoqëror ta shikojmë dhe ta interpretojmë në prizmin e materializmit historik, në luftë të papajtueshme kundër pikëpamjeve idealiste që s'janë tjetër veçse një veshje filozofike e dogmave të fesë dhe të mentalitetit konservator. Pikëpamjet idealiste, si shprehje e një botëkuptimi filozofik antishkencor të fesë dhe të klasave reaksionare, kanë një mori shfaqjesh, të cilat kanë ekzistuar në shekuj dhe, sido që kanë evoluar, prapëseprapë në thelb ruhen nga shoqëria kapitaliste. Kjo shoqëri përpinqet me të gjitha forcat t'i mbajë gjallë këto pikëpamje regresive, këtë ideologji reaksionarc e konservatore, sepse kështu ajo zgjat jetën e saj dhe pengon përkohësisht revolucionin proletar, pengon, pra, për njëfarë kohe zbatimin

e teorisë së revolucionit proletar, të marksizëm-leninizmit.

Ju, shokë ushtarë dhe kuadro të ushtrisë, që kryeni shërbimin ushtarak aktiv ose rezervë, duhet të rroni me shqetësimet e vendit, ta ndieni veten pjesëtarë të popullit të armatosur, të organizuar në Forcat e Armatosura për mbrojtjen e atdheut dhe të fitoreve të socializmit. Kurrë mos e mendoni veten të shkëputur e të izoluar nga preokupacionet që ka Shqipëria! Siç jeton inxhinieri me shqetësimet e prodhimit në një fabrikë apo uzinë, ose agronomi në fushat e një ndërmarrjeje ose kooperative bujqësore, po aq të jeni të interesuar edhe ju dhe të mos shkëputeni nga puna e kujdesi për ekonominë. Për sa i përket shikimit të problemeve në prizmin politik dhe ideologjik nuk mund të ketë dy qëndrime: një për ushtrinë dhe një tjetër për masat e gjera të popullit. Forcimi i ekonomisë, ndërtimi i socializmit dhe mbrojtja e atdheut nuk mund të ndahan. Çdo orvatje në kundërshtim me këtë qëndrim të drejtë të Partisë sonë do të ishte metafizike. Masat e gjera punonjëse të vendit tonë, pas reformës<sup>1</sup> që bëmë në ushtri, janë të gjitha edhe ndërtuese, edhe mbrojtëse të socializmit, edhe punëtorë, fshatarë e intelektualë, edhe ushtarë të Ushtrisë sonë Popullore.

Ju, ushtarakët e shërbimit të përhershëm ose të

1. Është fjalë për masat revolucionarizuese që mori Partia përgatitjen e të gjithë popullit për mbrojtje, në bazë të vendimeve të Byrosë Politike të vitit 1966 dhe, sidomos, pas plenumeve të 5-të dhe të 6-të të KQ të PPSH të vitit 1974.

shërbimit rezervist, ose ata që bëjnë pjesë në Forcat Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore, duhet të kuptoni mirë nevojën e ngritjes së nivelist ideopolitik dhe ushtarak dhe të bëni përpjekje sistematike që t'i pasuroni gjithnjë e më shumë njohuritë politike dhe ideo-logjike, të lidhura ngushtë me Artin Ushtarak të Luf-tës Popullore. Pa këto njohuri ose me njohuri të për-cipta nuk mund të jeni as ushtarë të mirë, as kuadro të mirë të ushtrisë, nuk mund të jeni as punëtorë, as inxhinierë të mirë, nuk mund të jeni as kooperativistë, as agronomë e veterinerë të mirë. Prandaj e ritheksoj tezën e drejtë të Partisë se çdo njeri të ne, për të qenë luftëtar i denjë i shoqërisë sonë të re, duhet të bëjë vazhdimisht përpjekje që të përvetësojë politikën dhe idcologjinë e Partisë. Kjo do të ndihmojë që atë profesion të veçantë, që ka mësuar secili në jetë ose në shkollë ose atë punë që i ka ngarkuar Partia secilit të kryejë ose të drejtojë, ta bëjë mirë dhe shumë mirë. Në qoftë se punën e tij të veçantë secili e kupton në kuadrin e detyrave të përgjithshme që dalin para at-dheut, do të ndihet më tepër nevoja për t'iu futur vazhdimisht, gjithnjë e më thellë, asaj shkence të veçantë që është mësuar dhe që luftohet për t'u vënë në zbatim.

Le të vijmë tanë te detyra tjeter e ushtrisë, tek edukimi i saj ushtarak. Mund të them se edukimi i ushtrisë sonë shkon duke u ngjitur e duke u perfeksionuar në të gjitha drejtimet. Ky është rezultat i punës së kujdeshshme të Partisë dhe të kuadrove tanë politikë dhe ushtarakë, të vjetër e të rinj, që kanë ditur të zbatojnë si duhet orientimet e Partisë për ushtrinë.

Kuadrot tanë ushtarakë kanë bërë përpjekje që vendimet e Partisë për përvetësimin sa të jetë e mundur më mirë të njohurive ushtarake t'ua transmetojnë edhe ushtarëve dhc, tok me ta, t'i zbatojnë në jetë.

Dëshiroj të theksoj që edukimi ushtarak i efektivit të Ushtrisë sonë Popullore është i domosdoshëm. Si çdo shkencë tjetër, edhe shkenca ushtarake është vazhdimisht në zhvillim. Revolucioni tekniko-shkencor nuk mund të përjashtohet nga ushtria, përkundrazi ai është i domosdoshëm dhe i rekomandueshëm për perfeksionimin në çdo specialitet të ushtrisë. Pa revolucionin tekniko-shkencor, si kudo edhe në ushtri, nuk mund të ecet përpara. Çdo gjë duhet të përparojë, duhet të perfektionohen mjetet, të zhvillohen mendimet, të kalohet nga përgjithësimi i eksperiencës në mendimin teorik dhe në formulimin e ligjeve të reja më të përparuara, më efikase, më rentable.

Po të shohim zhvillimin e vazhdueshëm dhe metamorfozën e ushtrisë sonë drejt progresit, drejt perfeksionimit të çdo dege të saj, do të konstatojmë se shumë gjëra kanë ndryshuar dhe, aktualisht, ne kemi arritur të kemi Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Ky art ushtarak popullor ka në bazën e vet eksperiencën e gjithë këtyre viteve që nga krijimi i ushtrisë sonë e deri më sot dhe është sinteza e kësaj eksperience, që po niçohet dhe po zbatohet me sukses nga ushtarakët tanë. Por sukseset e arritura tregojnë se, ashtu si çdo art dhe shkencë, edhe Arti ynë Ushtarak Popullor mund të plotësohet e të përmirësohet vazhdimisht, se këtij mund t'i sillen perfeksionime të mëtejshme që do të na japë eksperiencia e përditshme e ushtrisë

sonë. Marksizëm-leninizmi na mëson se çdo gjë ecën përpara, prandaj edhe Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore nuk duhet ta konsiderojmë si dogmë dhe si diçka të ngrirë. E them këtë pse mund të ketë disa njerëz që mendojnë se atë duhet ta mësojmë përmendsh, se nuk duhet lëvizur asnjë presje gjatë zbatimit të tij në situata konkrete që krijohen. Por ka pasur edhe nga ata, si tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako, që kishin në plan të shkatërronin krejtësisht Artin tonë Ushtarak Popullor dhe ta zë-vendësonin atë me një art ushtarak kapitullues, sipas të cilit Shqipëria qysh ditën e parë të agresionit do të shkelej dhe do të okupohej nga armiku.

Teoria e tërheqjes përpara sulmeve të armikut, teoria e mosmbrojtjes në front të rregullt të kufijve shtetërorë dhe të mosmbrojtjes pëllëmbë më pëllëmbë të tokës së atdheut tonë të dashur, ishte teoria tradhtare «ushtarake» e Beqir Ballukut dhe e bashkëpunëtorëve të tij, ishte teoria proamerikane e Çu En Lait dhe e Titos që synonte për t'i hapur portat NATO-s. Për këtë qëllim Çu En Lai e këshilloi tradhtarin Beqir Balluku të ndiqnim «teorinë e rrëshqitjes» në male, të kalonim në një luftë partizane, dhe të lidheshim ngushtë me Titon dhe me Çausheskun, gjoja për t'u mbrojtur nga një sulm i socialimperialistëve sovjetikë.

Ne duhet të jemi kurdoherë transformues të atillë që ushtrinë tonë ta kemi çdo ditë e më të fortë dhe të punojmë që Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore t'i bëjmë vazhdimisht përmirësimë në përputhje të plotë me orientimet e cakluara nga Komiteti Qendror i Partisë.

Ne përgatitemi ushtarakisht për të mbrojtur at-dheun, për të mbrojtur lirinë, pavarësinë, fitoret e socializmit, për të mbrojtur Partinë tonë. Ky është qëllimi më i lartë i ushtrisë sonë. Prandaj të kuptohet mirë se të gjitha këto që përmenda duhet t'i mbrojmë nga dikush dhe pikërisht nga armiqtë, që nuk na e duan të mirën, që synojnë të na pushtojnë, të na skllaverojnë, të zhdukin socializmin, të zhdukin Partinë. Duke e parë problemin në këtë prizëm, të mendojmë kurdoherë dhe të kuptojmë qartë se Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore, edukimi i njerëzve tanë me këtë art, edukimi i tyre politik dhe ideologjik nuk janë qëllim në vetvete, por synojnë për një arsyesh të shëndoshë jetike, që ne të përballojmë me sukses armiqtë tanë eventuale. Këta armiq nuk janë hipotetikë, por jetojnë, janë në këmbë, janë agresorë. Ata mund të na sulmojnë me armë, mund të zhvillojnë edhe diversion, mund dhe bëjnë përpjekje që të na kalbin nga brenda. Atëherë, neve na vihet detyrë që edhe në rastin e një sulmi me armë, edhe në rast orvatjesh për diversion dhe kalbëzim nga brenda, t'i përballojmë. Po si do t'i përballojmë? Do t'i përballojmë me ato mjete që thashë, të jemi të ngritur politikisht, të jemi të ngritur ideologjikisht, të jemi gjithashtu të ngritur e të fortë edhe ushtarakisht, të jemi vazhdimisht në këmbë dhe vigjilentë.

Në përpjekjet për edukimin tonë në këto drejtime ne kemi kurdoherë parasysh armikun, të cilin nuk duhet ta nënveftësojmë, pse ai nuk fle. Ai ka qëllimet e tij të fiksuar dhe bën përpjekje e organizime të shumëllojta për të na likuiduar, po edhe ne bëjmë përpjekjet tona në drejtimin e kundërt me të, që të mbro-

hemi prej tij, ta mundim atë në rast se na sulmon dhe të fitojmë. Politika jonë në këtë drejtim duhet të jetë e zgjuar, goditëse, demaskuese. Për këtë lypset të bëjmë përpjekje të atilla që të kuptojmë mirë politikën e armiqve, të kuptojmë ideologjinë e tyre, që është një ideologji skllavëruese, idealiste, konservatore, grabitqare, prandaj t'i kundërvëmë asaj ideologjinë tonë marksiste-leniniste, shkencën që e lufton katërcipërisht ideologjinë idealiste e skllavëruese të tyre, t'i vëmë kësaj përballë ideologjinë e proletariatit. Çështja tjetër është që t'i qëndrojmë çdo sulmi të armatosur të armiqve, dhe t'i mundim këta me luftë.

Në aspektin ideologjik dhe politik ne jemi superiorë mbi armiqtë tanë, sepse politika jonë është e drejtë, ndërsa politika e tyre është e gabuar, e padrejtë, një politikë agresive, sepse ideologja e armiqve është e dënuar nga historia që të shkatërrohen, kurse ideologja jonë është ideologja e të sotmes dhe e së ardhmes. Ne përfaqësojmë revolucionin proletar, socializmin, komunizmin, një shoqëri të re, kurse armiqtë tanë përfaqësojnë kapitalizmin dhe imperializmin, një shoqëri të vjetër, në kalbëzim, që, siç na mësojnë klassikët tanë, është faza e fundit e shoqërisë me klasa antagoniste. Armiqtë janë të dënuar të zhduken e të shkatërrohen me luftë, por, megjithëkëtë, ushtrinë dhe armatimet e armiqve ne nuk duhet t'i nënverësojmë, por as edhe t'i mbivlerësojmë. Këto dy çështje ushtria jonë duhet t'i kuptoje mirë. Ne kemi në duart tona ato armë që ju i dini mirë, me atë fuqi zjarri që e njihni e s'është nevoja t'jua përmend këtu. Ju dini që sasia e këtyre armëve është e mjaftueshme pér të bërë

një qëndresë fitimitare dhe të gjatë, po të jetë nevoja, për t'u mbrojtur, për ta kundërsulmuar armikun dhe për ta hedhur në det e matanë kufijve tanë. Ju dini që ne kemi edhe armë të atilla që mund të luftojnë me sukses deri edhe me avionët më të perfekzionuar të armikut. Ndërtimi i strategjisë dhe i taktilës sonë luftarakë, sikundër e dini, është bërë në një mënyrë të atillë që të përballojë armatimet e mëdha, të shumëlllojta e me efekt të madh shkatërrues të armiqve tanë eventualë. Kjo strategji dhe kjo taktilë jona, ky Art Ushtarak Popullor yni, i përshtatshëm me terrenin dhe me karakteristikat e popullit tonë, me ngritjen politike dhe ideologjike të tij dhe të Ushtrisë sonë Popullore, janë aq të fortë, sa mund të përballojnë numrin e madh dhe larminë e armëve të armikut që mund të na godasë.

Megjithatë këto armë të armiqve, siç e thashë, nuk duhen nënvylerësuar. Derisa Partia dhe Komiteti Qendror i jepin rëndësi të madhe përgatitjes ushtarakë të kuadrove, ushtarëve dhe mbarë popullit, kjo do të thotë se nuk i kanë nënveftësuar armët e armiqve. Armët e armikut duhen çmuar realisht, pra, ato as duhen nënvylerësuar, as duhen mbivlerësuar. Nënvylerësimi dhe mbivlerësimi janë kurdoherë të gabuar dhe sjellin dëme, qëndrime të njëanshme, kurse shikimi e vlerësimi i armëve të armikut ashtu siç janë dhe me rrezikshmérinë që paraqiten, bëjnë të mundur që nö kohën e duhur të merren masat e përshtatshme për t'i bërë ato të paefektshme ose me efekte të pakta kundër popullit tonë. Qëndrimi objektiv në vlerësimin e armëve të armikut do të bëjë që armët tona të për-

doren me më shumë efekt për dobësimin dhe shkatërrimin e sulmeve të tij.

Luftërat e pjesshme që kanë bërë imperialistët dhc kapitalistët kundër popujve dhe vendeve që donin të skllavëronin, i kanë vërtetuar këto gjykime të Partisë sonë. Dihet se në gjithë këto luftëra skllavëruese armiqtë kanë përdorur armët më moderne kundër popujve. Është e vërtetë se popujt kanë pësuar dëme të mëdha prej tyre, por vështirësitë e krijuara i kanë mësuar ata të krijojnë mundësi të atilla mbrojtjeje dhe kundërsulmi që kanë bërë të dështojnë forcat mercenare të agresorëve imperialistë që i kanë sulmuar dhe t'i mundin këta me sukses. Kështu do të ngjasë me siguri edhe në rast se armiqtë do të sulmojnë vendin tonë.

Për këtë arsyе Partia kurdoherë ju thotë juve, ushtarëve dhe kuadrove të ushtrisë, si dhe mbarë popullit ushtar që çështjet ushtarake të mbahen kurdoherë parasysh në jetën e përditshme, që asnjeri të mos mungojë e të mos tërhiqet në asnjë rast dhe për çdo arsyе nga edukimi ushtarak, nga kryerja e detyrave ushtarake.

Ju, kuadrot ushtarakë, keni një detyrë shumë të rëndësishme, t'u mësoni ushtarëve të popullit Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Por mos kujtoni se kjo është një çështje e lehtë, mos kujtoni se kjo mund të arrihet pa përpjekje, pa mundime, pa sakrifica dhe pa një disiplinë të hekurt. Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore është një art i gjallë, dinamik e në zhvillim. Ai është në kundërshtim me plogështinë, me shablonizmin, me indiferentizmin, me javashillë-

kun dhe me mungesën e koordinimit të të gjitha armëve në veprim. Arti ynë Ushtarak Popullor ruan dhe zhvillon pérherë e më shumë dinamizmin dhe shkath-tësinë revolucionare të luftës partizane, por ai nuk mund të identifikohet me luftën partizanc. Nga kuadrot, nga ushtria dhe nga mbarë populli ynë duhet të kuplohet mirë ky ndryshim. Është e domosdoshme të kuptohet se ne do të kemi pérballë një ushtri të madhe të armatosur dhe të pajisur me një taktikë krejt të ndryshme nga ajo jona. Taktika dhe strategjia e ushtrive armike kanë në themel barbarizmin dhe synojnë pushtimin e vendit tonë, kurse arti ynë ushtarak edukon në efektivin e ushtrisë mprehtësinë e vigjilencën dhe e pajis atë me shpirtin e kundërsulmit pér asgjësimin e armiqve.

Prandaj, në çdo gjë, por sidomos në dhënen e mësimeve ushtarake, të punohet me zgjuarsi të veçantë nga kuadrot oficerë, të cilët duhet të zgjerojnë horizontin e tyre pér problemin që do të shtrojnë, ta kenë zbatuar atë vetë në praktikë, në një praktikë në kushte të ndryshme me ato të armikut që i vihet pérballë, me strategjinë dhe me taktikën e tij, me terrenin ku vepron dhe me armët që përdor ai. Po të bëhet kështu ky mësim dhe instruktim i ushtrisë, atëherë nuk kemi të bëjmë me një metodë mësimi shabllone.

Mbrojtja e territoreve tona kundër sulmeve të armikut ka një rëndësi shumë të madhe. Dihet se që të fitohet lufta nga ana e një armiku që sulmon, është kusht i domosdoshëm që këmba e ushtarit të tij të zërë dhe, prandaj armiku do të përpinqet me të gjitha mundësitë dhe mjetet që të zërë vend në territorin

tonë, kurse strategjia dhe taktika janë që këmbët e tij të mos zënë dhe, domethënë, që të asgjësohet pa arritur të depërtojë në truallin tonë, qoftë në breg të dëtit, qoftë në ajër, qoftë në brezin e kufirit tonë tokësor. Por, që të bëhet e mundur një gjë e tillë, Komiteti Qendror i Partisë dhe Komanda e Përgjithshme kanë dhënë udhëzime dhe kanë marrë vendime për përgatitjen e gjithë territorit për luftë, përgatitje së cilës ju duhet t'i vini një rëndësi të jashtëzakonshme, në radhë të parë, në përcaktimin e drejtë të pozicioneve të mbrojtjes sonë territoriale. Pozicionet e mira e të forta territoriale përcaktohen duke imagjinuar sa më drejt e realisht kushtet e luftës. Përdor këtu fjalën «imagjinatë», pse s'ka si të përdor një tjetër term. Jeta, praktika do të tregojë në rast se ne e kemi imagjinuar mirë planin për shpartallimin e armikut që do të na sulmojë, por plani i saktë kërkon një imagjinatë të tillë që të përsytyrojë taktika pak a shumë të afërmime taktikat që do të përdorë armiku në sulmin e vet kundër nesh. Pra, në qoftë se ne këtë plan e kemi përgatitur si duhet, atëherë armikut nuk do t'i zërë dot këmba dhe në territorin tonë.

Fortifikimet që po bëhen kanë qenë objekti i një studimi të imët nga ana e Komandës së Përgjithshme të ushtrisë, nga ju, shokë kuadro të ushtrisë dhe nga ushtarët vetë. Një bazë e mirë për këtë është eksperiencia e popullit dhe e Luftës Nacionalçirimitare. Kjo punë ka lypur dhe lyp vazhdimisht një kujdes e vëmendje të vazhdueshme, pavarësisht nga ndërtimi i fortifikimeve që janë një bazë e fortë për mbrojtjen tonë dhe për luftën frontale sipas Artit tonë Ushtarak

të Luftës Popullore, janë një nga ato baza që thashë e që do të përballojë forcën dhe llojin e armëve të shumta që do të përdorë armiku. Por, krahas fortifikimeve, është e domosdoshme njëkohësisht të nijhet me pëllëmbë edhe territori nga oficerët dhe ushtarët tanë. Forma e organizimit tonë aktual e lejon më së miri plotësimin e kësaj detyre. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe për mbrojtjen, pse duke u njojur mirë terreni nga kuadrot dhe ushtarët, këta do të jenë në gjendje të perfeksionojnë organizimin dhe të marrin vendime të drejta për veprim, për sulm, për kundërsulm, për mbrojtje dhe për asgjësimin e plotë të armikut. Në këto kushte edhe urdhrat që do të jepen dhe që do të zbatohen do të jenë reale dhe do t'i lejojnë komandantit superior, apo komandantit inferior, si dhe ushtarit vetë që të vërë në lëvizje trurin e tij, dome-thënë, të mendojë me kokë për realizimin sa më mirë të urdhrit që merr.

Zbatimi në mënyrë shabllone i një direktive, sidomos në bazë, në njësitin e vogël, mund të mos sjellë frytet e duhura. Me këtë duhet të kuptohet që urdhri ushtarak i marrë duhet të zbatohet, por më parë se ai të vihet në jetë nga zbatuesi, duhet të mendohet drejt, në mënyrë që zbatimi i tij të bëhet me nuanca dhe me nuanca të atilla që t'i shërbejnë realizimit të urdhrit sa më mirë, sa më shpejt dhe me sa më pak humbje në njerëz dhe në materiale ushtarake. Në radhë të parë ka rëndësi që ne t'i ruajmë njerëzit tanë nga armët e shumta të armikut. Por ky kujdes i drejtë për njerëzit nuk duhet të kuptohet që, meqenëse ne bëjmë një luftë mbrojtjeje, oburra të futemi nëpër tunele dhe

të mos e nxjerrim kokën jashtë. Jo, kjo nuk duhet kuptuar kështu, se atëherë do të jetë katastrofë për ne. Mbrojtja e forcave të gjalla ka një rëndësi jetike, por mbrojtja jonë duhet të konsiderohet si një moment pauze, vrojtimi dhe observacioni të taktikës që do të përdorë armiku, të qëllimit që do të ndjekë ai në një betejë, në një front ose qoftë edhe në një sektor të caktuar. Mbrojtja jonë nuk është statike, por dinamike. Siç e dimë fare mirë, artileria e armikut me goditjet e saj përgatit sulmin e këmbësorisë apo të tankeve, kurse bombardimi ajror mund të përgatitë po ashtu sulmin nga ana e desantit ajror. Kundër të gjitha këtyre veprimeve me armë të ndryshme nga ana e armikut, ne duhet të marrim ato masa të nevojshme dhe efikase për të ruajtur efektivin e gjallë, por kur të shohim se armiku e ka bërë sulmin e vet pa efekt me artileri ose aviacion dhe pas kësaj do të veprojë në vazhdimësi, do të hidhet në sulm për të zaptuar një territor ose një rajon të caktuar, atëherë ne kundër-sulmojmë me të gjitha forcat me shkathëtësi të madhe, vëmë në zbatim taktikat tona të studiuara në terrene të përgatitura me kohë dhe e asgjësojmë sulmin armik. Pra të përpinqemi që ta kuptojmë taktikën dhe strategjinë e armikut dhe, qysh tash, në kohën e kësaj paqeje relative, të jemi të përgatitur si duhet në fu-shën ushtarake dhe të kemi në gatishmëri të plotë armatimet tona, që do të jenë vdekjeprurëse për armikun. Dhe do të jenë të tilla jo pse ne i kemi armët në sasinë, në shumëllojshmërinë dhe në perfeksionin në atë shkallë që i ka armiku armët e veta, por se armët tona, të forta dhe me efekt të madh, janë në duart e

njerëzve tanë të edukuar, me zemër të çeliktë, të përgatitur me një mendje të kthjellët, të ndërgjegjshëm politikisht, që luftojnë për një çështje të drejtë, për atdheun e tyre socialist, se mbrojnë vendin dhe popullin e tyre dhe udhëhiqen nga një Parti marksiste-leniniste. Duke i parë në këtë prizëm çështjet, epërsia jonë mbi armikun do të jetë e madhe. Por nuk mjafton që vetëm t'i shikojmë çështjet në këtë prizëm. Ne duhet të luftojmë me këmbëngulje çdo ditë që të gjitha mjetet që na janë vënë në dispozicion nga pasuria e popullit, si dhe mësimet e Partisë për mbrojtjen e atdheut t'i përdorim dhe t'i shfrytëzojmë me efektivitet sa më të madh.

Unë mendoj se lojërat që zhvilloni, stërvitjet që bëni gjatë gjithë vitit, aktualisht, pas spastrimit të elementeve tradhtarë dhe armiq, agjentë të sovjetikëve, të jugosllavëve dhe të kinezëve, me Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon në kryc, kanë marrë një rrugë të mirë dhe jepin rezultate të kënaqshme. Por kurdoherë ju këshilloj dhe ju rrekomandoj të bëni sa më shumë përgatitje që këto stërvitje të zhvillohen në përputhje me Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, të ketë më shumë pjekuri në marrjen e vendimeve dhe në kuptimin politik të tyre, të ketë më shumë zhvillim dinamik, si në stërvitjet e përditshme, ashtu edhe në lojërat që zhvillohen.

Lojërat që organizohen kanë një rëndësi të jashtë-zakonshme për përgatitjen dhe për kalitjen e ushtrisë. Por unë kam qenë dhe jam kurdoherë i pikëpamjes që këto lojëra të mos bëhen kurrë për formë, por të jenë efektive dhe sa më shumë të ngjashme me luftën

reale që mund të zhvillohet në territorin tonë. Pradhen përgatitur sa më mirë politikisht dhe ideologjikisht kuadrot dhe ushtarët që në zërthimin dhe në zhvillimin e lojërave të mendojnë e të veprojnë si në luftë, sikur janë me të vërtetë nën breshërinë e predhavë të armikut, sikur janë në kushtet që atdheut tonë socialist i kërcënöhët një rrezik imediat i madh. Atëherë, në qoftë se do të veprohet kështu, do të tendosen nervat dhe kjo do të jetë një tendosje nervash me një logjikë të fortë, të çuditshme, me një guxim dhe me një trimëri të papërshkruar. Nervat nuk do të tendosen vetëm sa për të kaluar në ditët e lojës, ose për t'u treguar në mënyrë formale se loja nbaroi gjoga me sukses. Në këto lojëra duhet të vërtetohen ato virtyte ushtarake, politike e morale që tregova më lart. Por që të arrihet kjo, shokë, lojërat duhet të konsiderohen si konkluzione logjike dhe të domosdoshme të asaj stërvitjeje të përditshme të Ushtrisë sonë Populllore, që realizohet me ushtrim politik, ushtrim ushtarë, ushtrim në praktikë, ushtrim në terren, ushtrim në kushte të ndryshme të terrenit dhe në kushte të ndryshme atmosferike. Po të konsiderohen e të bëhen kështu lojërat, atëherë është e qartë se kuadrot e ushtrisë duhet të qëndrojnë kurdoherë sa më afër ushtarëve.

C'kuptoj unë me qëndrimin e kuadrove afër ushtarëve? Me këtë, natyrisht, nuk kuptoj atë që kuadri ynë ushtarët të jetë i shkëputur nga familja e tij, të mos marrë kontakt me familjen e vet. Kjo është bile e domosdoshme, humanitare dhe e nevojshme për psikologjinë e shëndoshë të kuadrit. Prandaj Komanda e

Ushtrisë dhe Ministria e Mbrojtjes duhet të marrin masat e përshtatshme që një gjë e tillë, edhe në qoftë se ka të meta, të përmirësohet. Por kjo nuk do të thotë që për këtë çështje kaq të madhe të mos bëhen disa sakrifica nga ana e kuadrove, e kam fjalën në drejtim të mungesës së kontaktit të përditshëm me familjen. Ne duhet të arrijmë të krijojmë kushtet që kuadrot tanë të jenë të lidhur, të bashkuar me pjesëtarët e familjeve të tyre, të duhen me njëri-tjetrin, të shikohen shpesh, por kuadri oficer duhet ta konsiderojë njësoj si familjen e vet edhe repartin e nënrepartin ku bën pjesë. Atëherë kuptimi i detyrës ndaj repartit do të jetë një kuptim marksist-leninist, atëherë kjo familje e dytë, reparti, ku oficeri është caktuar të derdhë djersë dhe dituri, do të bëhet po aq i dashur dhe po aq i nevojshëm, sa edhe familja. Prandaj të dyja, edhe familja, edhe reparti, duhet të konsiderohen shumë të dashur nga kuadri dhe të merren masa të atilla politike dhe organizative që këto ndjenja të rrënjosën si duhet në jetë të secilit, për të mirën e vetë kuadrit oficer dhe për të mirën e këtyre dy lloj familjeve.

Shkollave tona të lira ushtarake, që janë bërë qendra edukimi dhe perfeksionimi të ushtrisë sonë, qoftë aktive, qoftë rezerviste, duhet t'u vihet kujdes i veçantë, pse i jepin me të vërtetë karakterin popullor revolucionar ushtrisë sonë dhe luftës që eventualisht do të bëjmë, kur të na e imponojnë armiqjtë tanë, imperialistët, kapitalizmi botëror dhe revisionistët modernë. Prandaj, në të gjitha hallkat, në të gjitha drejtimet e ushtrisë, duhet të punohet dhe të luftohet me

pasion të madh, me zgjuarsi, me vendosmëri dhe kurdoherë me zhvillim progresiv.

Në gjithë këtë veprimitari të madhe që po zhvillon populli ynë, rëndësi dhe kujdes të veçantë duhet t'i vëmë forcimit të mbrojtjes së atdheut, forcimit të Ushtrisë sonë Popullore. Këtë kujdes duhet ta ketë gjithë populli dhe veçanërisht efektivi i ushtrisë, i cili stërvitet vazhdimesht që të fitojë aftësitë e nevojshme për të përballuar me sukses momentet e vështira që mund t'i vijnë atdheut tonë. Duhet, pra, me një zell të madh të studioni Artin Ushtarak të Luftës Popullore në të gjitha anët e tij. Të gjithë kuadrot e ushtrisë, të vjetër dhe të rinj, duhet të bashkëpunojnë ngushtë, ta përvetësojnë dhe t'i sjellin këtij arti eksperiencën e tyre të madhe të përditshme, ta zgjerojnë dhe ta zhillojnë gjithnjë më tej pamjen e tij.

Me këtë dua të them që kuadrot tanë të ushtrisë nuk duhet të mbyllen në guaskën e një studimi të cekët, ose të një aplikimi shablon të mësimeve të mëdha që i janë vënë në dorë ushtrisë sonë. Ata duhet të kenë parasysh luftën moderne që do të na imponojë armiku, që ne do ta kundërshtojmë deri në fund.

E kam theksuar edhe herë tjeter që kuadrot tanë duhet të njihen me strategjinë dhe me taktikën që do të përdorë armiku në luftën e ardhshme, të njohin armët që ai do të përdorë dhe efektivitetin e tyre, se pse duke njohur këto, do të dinë të marrin me kohë masat e nevojshme për t'i përballuar.

Në strategjinë dhe në taktikën e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore ekziston parashikimi i kundërshtimit deri në fitore të strategjisë dhe të taktikës

së armikut eventual. Arti ynë Ushtarak parashikon të kundërshtojë deri në fitore një luftë moderne, po ai parashikon, gjithashtu, të kundërshtojë edhe një tak-tikë të luftës antipartizane që mund të përdorë armiku gjatë luftimeve kundër nesh. Të mos e neglizhojmë eksperiencën e madhe të luftës partizane, pse në qoftë se do ta neglizhojmë atë, do të bëjmë një gabim të madh, që do të na kushtojë shitenjtë, për arsyet se lufta partizane që kemi bërë, u ka dhënë goditje vdekjeprurëse armiqve të egër, të fuqishëm dhe me një strategji e taktkë moderne.

Strategjia dhe takтика aktuale e armiqve tanë është akoma një e ndërlikuar, për arsyet të armatimeve moderne që ata kanë shpikur. Por në disa momente dhe në disa vende mundet që në luftime armiku ynë të përdorë edhe taktkën e luftës antipartizane kundër nesh. Të mos mendohet prej askujt se armiku nuk e njeh luftën partizane, por ashtu si okupatorët italianë dhe gjermanë, çdo armik tjetër i huaj që do të orvatet të sulmojë atdheun tonë në të ardhmen, nuk do të mund të bëjë luftën antipartizane siç mund ta bëjë luftën partizane vendësi që sulmohet. Megjithatë ncedimë se, që nga imperialistët amerikanë dhe deri te shtete të tjera kapitaliste, që kanë synime dhe mund të sulmojnë vendin tonë, bëjnë stërvitje edhe në këtë dërgim, përgatitin trupa të veçantë për të zhvilluar edhe një luftë kundërpertizanc ndaj forcave tona kur-dohcrë që do ta shikojnë të nevojshme...

Për të gjitha këto kuadrot tanë me përvojë t'u mësojnë kuadrove të brezit të ri, krahas gjithë Artit tonë Ushtarak Popullor edhe artin e luftës partizane,

që është pjesë pörbërëse e tij. Kjo do të na japë neve rezultate të mëdha, në qoftë se armiku do të përdorë takikën e luftës antipartizane. Kjo do të na japë neve rezultate të mëdha, sepse jemi në vendin tonë dhe ne e njohim mirë terrenin, njohim, gjithashtu, se si luftohet në këtë vend dhe në këto forma, kështu që, duke u përgatitur mirë qysh sot, çdo orvatje e armikut në këtë drejtim është e destinuar të dështojë...

Nuk duhet shkuar me tre rup në dasmë, thotë pulli ynë. Lufta nuk është dasmë, ajo është dhe do të jetë një përleshje e tmerrshme, e përgjakshme, prandaj drejt saj duhet të vemi të përgatitur plotësisht, të vendosur plotësisht, të armatosur plotësisht, politikisht, moralisht, ushtarakisht dhe ideologjikisht. Lufta nuk dihet kur do të na vijë, pse nuk varet nga ne, ajo varet nga armiqjtë tanë. Nga ne varet një gjë: të jemi të përgatitur për çdo eventualitet dhe të gatshëm në çdo moment kur të na paraqitet rreziku për t'i bërë ballë atij me sukses. Por, derisa ekzistojnë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez dhe imperialistët e tjera, lufta është e paevitueshme. Kapitali botëror i vendosur në shumë shtete të Evropës, të Azisë dhe të kontinenteve të tjera kërkon të ruajë shfrytëzimin e popujve, të pushtojë tregje të reja, të rindajë botën në sfera influence midis imperialistëve të ndryshëm. Shfrytëzimi i njeriut prej njeriut ekziston i gjallë në botë. Kapitalizmi është i pamëshirshëm kundër lirisë, kundër pavarësisë dhe kundër sovranitetit të popujve.

Prandaj ne duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh situatat që po zhvillohen në botë. Siç na ka më-

suar dhe na mëson çdo ditë Partia, situatat janë revolucionare. Në këto situata, kur imperializmi e sheh që është në rrezzik, ai përgatitet për luftë. Revolucioni do ta shkatërrojë kapitalizmin botëror, i cili përpinqet të mbrohet me të gjitha mjetet, dhe mjetet e fundit të tij janë luftërat, luftërat lokale dhe pas tyre lufta e përgjithshme botërore. Njëra luftë përgatit tjetërën, njëra krijon dhe thellon kontradiktat që ekzistojnë dhe që janë në palcë të kapitalistëve e të imperialistëve, kurse rindarja e botës i thellon dhe i acaron të gjitha kontradiktat ekzistuese derisa i çon në luftën botërore.

Prandaj ne duhet të ndjekim e të përvetësojmë përbajtjen politike të mësimave të Partisë që vënë në dukje këto zhvillime të ndryshme të situatave ndërkontaktuale. Kurrë të mos kemi iluzione në situatat koniunkturale. Kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të përfitojmë nga këto situata, pse në mes të shteteve kapitaliste e revisioniste ekzistojnë kontradikta, të cilat ne duhet të përpinqemi t'i thellojmë, por kurdoherë në favorin e revolucionit botëror, në favorin e socializmit, në favorin e shtetit tonë socialist. Në botën kapitaliste ekzistojnë klasat e shfrytëzuara, të cilat janë në luftë me kapitalin. Në krye të këtyre klasave të shfrytëzuara revolucionare është proletariati, krahas këtij janë fshatarësia e varfër dhe borgjezia e vogël e qyteteve.

Për ne, për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, për Qeverinë e kësaj republike, ekziston kurdoherë kujdesi për një vëzhgim të vëmendshëm marksist-leninist të këtyre situatave. Komiteti Qendror i Partisë ka orientuar qartë se si duhen shfrytëzuar

situatat koniunkturale, divergjencat që ekzistojnë në vendet kapitaliste. Por në asnjë moment nuk duhet të arrihet në mendimin se këto rrëthana të përkohshme e kanë rregulluar njëherë e përgjithmonë situatën, ose i kanë kthyer përgjithmonë situatat e vështira në mes vendit tonë dhe vendeve të tjera kapitaliste në situata të mira. Ne dëshirojmë që këto situata koniunkturale, disi të favorshme, të vazhdojnë të zhvillohen, por marrëdhëniet varen edhe nga vendet e tjera e jo vetëm nga shteti ynë. Ne dimë se vendet e tjera nuk janë socialiste, siç është vendi ynë, ato janë shtete kapitaliste dhe aktualisht ekzistojnë një sërë arsyesh, një sërë kontradiktash e koniunkturash që ato shtete kapitaliste i bëjnë të mbajnë marrëdhënie «normale», «miqësore» ose «të qeta» me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Më konkretisht, me Jugosllavinë titiste ideologjikisht dhe politikisht ne kemi qenë dhe jemi në luftë të papajtueshme për arsy se titistët janë renegatë të marksizëm-leninizmit, zjarrfikësit e revolucionit. Ne jemi për revolucionin, prandaj titistët duan ta shuajnë ideologjinë tonë, por edhe ne luftojmë që të shuajmë ideologjinë e tyre. Megjithatë gjendja është zhvilluar në mënyrë të tillë që, pa u pushuar për asnjë çast lufta ideologjike dhe politike nga ana e Partisë sonë kundër këtyre dhe kundër teorisë së tyre antimarksiste të mos-angazhimit dhe të vëtadministrimit, ne të kemi marrëdhënie diplomatike me Jugosllavinë, të bëjmë tregti me interesa reciprokë, të zhvillojmë marrëdhënie kulturore pa ndërhyrë në punët e njëri-tjetrit. Të gjithë

këta hapa ne i bëjmë duke pasur kurdoherë parasysh interesat e vendit tonë.

Me Greqinë aktualisht marrëdhëniet janë të qeta dhe po ecin, pse ne kemi deklaruar që me popullin grek s'kemi asgjë që të na ndajë, përkundrazi dëshirojmë të rrojmë në miqësi me të. Qeveritarët aktualë grekë i përgjigjen pak a shumë me dashamirësi politikës sonë miqësore dhe të finqnjësisë së mirë. Ata shohin që një politikë e tillë e drejtë nga ana e Shqipërisë është në interesin e tyre, ata nuk duan që në kufijtë e tyre të Veriut të kenë një shtet që të mos ua dojë të mirën. Shovinizmi grek ka pasur pretendime territoriale dhe nuk mund të themi se nuk i ka akoma këto pretendime, por ne ua kemi bërë të qartë grekëve çështjen e integritetit të territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tash qeveritarët grekë e kanë më të qartë këtë çështje. Njerëzit me vullnet të mirë në Greqi do të kuptojnë çdo ditë e më tepër që pretendimet absurde të të ashtuquajtura Vorio-Epir duhet t'i mbytin në Egje. Ata duhet ta bëjnë docemos këtë gjë, në qoftë se duan të rrojmë në miqësi me popullin grek, të zhvillojmë marrëdhënie tregtare sa më të mira, po kështu të kemi edhe marrëdhënie kulturore, por pa cenuar kufijtë dhe pavarësinë e njëri-tjetrit.

Me Italinë kemi marrëdhënie diplomatike dhe marrëdhënie tregtare që po ecin. Por në Itali mbretëron kaosi kapitalist dhe përgatitet vendosja e fashizmit, kurse partia e revisionistëve italianë ka iluzionin se po aftron dita të marrë pushtetin me rrugë pagësore.

Ju e dini që me Kinën ne kemi pasur marrëdhënie të mira, të singerta, miqësore. Nga ana jonë miqësia me këtë vend ishte bazuar në parimet e marksizëm-lerinizmit. Por, për fat të keq të revolucionit dhe të socializmit, Kina e Mao Ce Dunit nuk ka qëndruar në pozita marksiste-leniniste. Pas vdekjes së Maos ajo është futur edhe më thellë në një rrugë pa krye, ose më mirë të themi në rrugën që po e çon në kapitalizëm, po e çon drejt një shteti socialimperialist.

Marrëdhëniet aktuale politike, ideologjike, tregtarë dhe marrëdhëniet ushtarake me Kinën për këto arsyen janë shumë të këqija, jo për fajin tonë, po për fajin e udhëheqjes kineze. Ne kemi bërë dhe vazhdomë të bëjmë përpjekje që këto marrëdhënie të mos përfundojnë në një prishje të plotë. Kontradiktat që kanë ekzistuar me kohë në mes dy partive tona, ne jemi përpjekur që në vitin 1962, bile edhe më parë, që t'i zgjidhim me diskutime shoqërore. Fakt është, dhe për këto ekzistojnë dokumentet përkatëse, që Partia Komuniste e Kinës, me Mao Ce Dunin në krye, i kanë evituar këto diskutime për sqarimin e divergjencave, për arsyen se udhëheqësit kinezë nuk donin të shpjegoheshin me ne. Shpjegimi kërkon ballafaqim, kërkon argumentim nga njëri dhe nga tjetri dhe pasti duhet dalë në disa konkluzione, të cilat hidhen në balancën marksiste-leniniste, ku duket kush ka të drejtë dhe kush nuk ka të drejtë. Këtë veprim të domosdoshëm marksist-leninist Partia Komuniste e Kinës nuk ka dashur ta bëjë, e ka evituar që nga fillimi dheri në fund me pretekstin se «nuk dëshiron të bëjë polemikë», por realiteti ishte se do t'i dilnin të palarat

në shesh, sikundër i dolën. Partia Komuniste e Kinës, duke qenë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin, nuk dëshiron të shpjegohet dhe për t'u justifikuar pretendon se gjoja nuk dëshiron të polemizojë, por e vërteta është se asaj i mungojnë argumentet për polemikën.

Partisë sonë nuk i ka munguar kurrë guximi të bëjë çapin e parë për të thënë të drejtën, për t'ia thënë të katër të vërtetat në fytyrë cilitdo, sepse kjo ka qenë dhe është në interesin e marksizëm-leninizmit, të socializmit dhe të revolucionit, në interesin e vendit tonë. Natyrisht, një gjë e tillë kërkon sakrifika dhe këto sakrifika populli dhe Partia jonë i kanë bërë në të gjitha situatat. Qëndrimet e tyre të drejta kanë bërë që të gjitha vështirësitë që u janë krijuar, kurdoherë të kapërcehen dhe Parti e popull të dalin më të fortë se kurrë. Këtë fakt e dini edhe ju, pse në këto situata të vështira keni qenë luftëtarë të radhëve të para dhe keni parë vetë se si në çdo rast kemi dalë fitimtarë. Ne jemi të bindur se edhe në këtë situatë Partia dhe populli ynë do të dalin fitimtarë.

Do të dalim fitimtarë se çdo gjë kurdoherë ne e kemi mbështetur në forcat e popullit tonë, e kemi bazuar fort në ideologjinë marksiste-leniniste. Ndiarma e jashtme për ne ka qenë efektive kur shteti që e jepë atë ishte socialist dhe udhëhiqej nga parimet e internacionazmit proletar. Kjo ndihmë, që përfaqëson një përqindje të vogël dhe një faktor të dorës së dytë e të tretë përpara përpjekjeve dhe forcave të mëdha të popullit tonë, merr një karakter tjetër kur një shtet, që dikur ishte socialist, kthehet në kapitalist. Në këto

kushte edhe vendi ynë merr masat për t'i kapërcyer këto vështirësi.

Më përpara nc u mbështetëm te popujt e Bashkimit Sovjetik, të cilët kishin kohë që kishin vendosur shtetin e diktaturës së proletariatit. Në ato kohë në Bashkimin Sovjetik ekzistonte Partia e bolshevikëve, e themeluar nga Lenini dhe Stalini dhe në krye të Komitetit të saj Qendror qëndronte marksist-leninist i madh, Josif Visarionovic Stalini. Mbështetja e popujve sovjetikë, me Stalinin në krye, ka qenë e fuqishme dhë këtë mbështetje, sidomos në arenën ndërkombëtare, nuk e kanë harruar dhe nuk e harrojnë kurrë Partia dhe populli ynë, por sidoqoftë, në raport me faktorët dhe forcat e brendshme, kjo mbështetje ka qenë e dorës së dylë.

Ne u lidhëm edhe me Jugosllavinë, por shpejt, bille që në kohën e Luftës së Dytë Botërore, kuptuam se Jugosllavia ndiqte një rrugë të kundërt me atë të Shqipërisë. Ne vinim re se ideologjia e titistëve nuk përputhej me ideologjinë marksiste-leniniste. Faktet e vërtetuara njëri pas tjegrit treguan se Jugosllavia e Titos do të tradhtonte e do të demaskohej dhe në fakt ajo tradhtoi dhe u demaskua. Kjo periudhë e tradhësë së një vendi fqinj dhe aleat ishte e vështirë për vendintonë dhe për ndërtimin e socializmit, ajo krijonte shumë vështirësi edhe për Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare.

Partia jonë, duke qëndruar e vendosur në udhëheqjen e popullit dhe të vendit, e kapërceu këtë vështirësi të madhe, ashtu siç kapërceu me sukses edhe më vonë vështirësinë shumë serioze të krijuar nga tra-

dhtia e revizionistëve hruščovianë, që, pas vdekjes së Stalinit, uzurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik...

Në kushtet e krijuara nga kjo tradhti e madhe, ushtria sovjetike mori tipare të tjera, nga një armë e shtetit të diktaturës së proletariatit, ajo u shndërrua në një armë të diktaturës borgjeze dhe fashiste që po restaurohej në Bashkimin Sovjetik. Partia jonë vërejti se në ushtrinë sovjetike si në gjithë Bashkimin Sovjetik po lulëzonin pikëpamje ideologjike të gabuara, revizioniste, antimarksiste, se në kuadrot e ushtrisë sovjetike ishte futur krimbi i revizionizmit dhe i degjenerimit, që kultivonte mendime teorike, politike dhe morale të mbrapshta dhe fashisto-imperialiste. Pikërisht këtë krimb të degjenerimit revizionist hruščovianët u përpoqën të na e futnin edhe neve këtu në ushtri, në pushtet, në Parti, në politikën e jashtme dhe në atë të brendshme. Por për arsyen e vigjilencës së Partisë sonë të Punës, të asaj vigjilence revolucionare, që u formua dhe u kalit që në kohën e luftës dhe që shkoi duke u rritur e duke u farkëtuar vazhdimisht, ata nuk ia arriten dot këtij qëllimi. Partia jonë nuk u gabua, se edukohej me ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, të cilën ajo e përvetësonte, e rrezatonte në popull dhe e zbatonte në kushtet e vendit tonë.

Degjenerimi revizionist titist, sovjetik, kinez etj. kishte tipare të atilla të shëmtuara që jo vetëm nuk i përshtateshin edukatës marksiste-leniniste që jepte Partia jonë në anëtarët e saj dhe në masat e popullit, por ato nuk i përshtateshin as karakterit burrëror, ndershmërisë dhe pjekurisë së popullit shqiptar, nuk i

përshtateshin virtuteve të larta morale dhe karakterit të pastër e të fortë tradicional të shqiptarit. Këto tipare do të binin medoemos në kundërshtim, siç ranë, me degjenerimin e Jugosllavisë, me degjenerimin e Bashkimit Sovjetik, të Kinës dhe me degjenerimin e vendeve të tjera që u zhytën në batakun revizionist.

Unë mund t'ju them juve, shokë ushtarë dhe oficerë, se Partia, Komiteti i saj Qendror dhe Qeveria, si kurdoherë edhe tani, i kanë ndjekur e parashikuar situatat me kohë, kanë mbajtur qëndrime dhe kanë marrë masat e duhura. Devijimi i Partisë Komuniste të Kinës nga marksizëm-leninizmi nuk u ka rënë përnjëherë përpjekur të gjejmë një mënyrë zgjidhjeje marksiste-leniniste parimore, qoftë edhe të përkohshme me udhëheqësit kinczë, por shihet qartë nga të gjithë se udhëheqja aktuale kineze është bërë aleate e imperializmit amerikan dhe e kapitalizmit botëror, e dy armiqve më të egër të popujve, është bërë një luftënxitëse imperialiste që nxit NATO-n dhe vende të Traktatit të Varshavës të hyjnë në një luftë botërore në kurriz të popujve, në vend që t'i demaskojë këto aleanca agresive dhe të mbështetë popujt dhe proletariatin që të ngrihen kundër tyre në revolucion.

Pra, pozitat e Partisë sonë në këtë problem, ashtu si edhe në të gjitha problemet e tjera kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe kapitalizmit botëror, kanë qenë dhe janë të qarta, ato janë të patundura. Prandaj na vihet detyrë urgjente, e vazhdueshme, e domosdoshme dhe jetike t'i forcojmë këto pozita. Dhe ne do t'i forcojmë ato se kemi një Parti marksiste-leniniste të fortë, me unitet të çeliktë

të radhiёve të saj, keni një popull të fortë në unitet të pathyeshëm me Partinë, kemi një ekonomi aktualisht të zhvilluar, që na siguron mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të forcave producuese dhe të përmirësimit të mirëqenies së popullit me forcat tona, pse kemi një Ushtri Popullore heroike, të edukuar dhe të kalitur në boteja klasore nga Partia jonë e lavdishme e Punës.

Shokë ushtarë dhe oficerë,

Ju uroj edhe një herë nga zemra për festën e madhe të 35-vjetorit të krijimit të Ushtrisë së lavdishme Popullore të Shqipërisë, ju përgëzoj për sukseset që po korrni dhe ju bëj thirrje ta doni ushtrinë, të stërviteni intensivisht dhe me zgjuarsi që ta kemi atë të pathyeshme. Ju rrekomandoj të zbatoni si duhet rregulloret, të zbatoni si duhet instruktazhet, të përvetësoni si duhet teorinë tonë të Artit Ushtarak të Luftës Popullore dhe, në praktikë, të tregoni gjallëri, të tregoni hov revolucionar, të zhvillonи veprimet taktyke me zgjuarsi e vendosmëri dhe jo në mënyrë shabllone.

Ta doni shoqi-shoqin, ta konsideroni njëri-tjetrin me tërë kuptimin e fjalës si shok dhe ta respektoni. Të respektoni gjithashtu komandat, kuadrot e të cilëve Partia i ka ngritur në këto poste që t'ju bëjnë ju ushtarë të astë për një kauzë të madhe. Por nga ana e tyre edhe kuadrot duhet të punojnë me ndershmërinë dhe vëlëmohimin që karakterizon njerëzit tanë, që të fitojnë zemrat e ushtarëve. Ushtria jonë duhet të jetë kom-

pakë, të ketë një disiplinë të hckurt dhe të vjetëdijshme. Në çdo kohë që ta kërkojë nevoja ajo të jetë në vendin e caktuar dhe të ketë guxim. As më i vogli panik nuk duhet të vërtetohet në gjirin e ushtrisë edhe të popullit tonë që hej jam i bindur se një gjë e tillë nuk do të ngjasë për arsyen e edukimit politik dhe ideologjik të mbarë popullit tonë ushtar. Kjo do të thotë se ne po e përgatitim që tani popullin të shikojë me besim të madh përpëra për ndërtimin e socializmit, t'i shikojë në sy realitetet aktuale dhe ngjarjet e mundshme. Kur ne ta mësojmë popullin dhe Ushtrinë tonë Popullore me një frymë të tillë revolucionare, çdo moment i rrezikshëm nuk do të na gjejë në befasi dhe nuk do të na trembë, përkundrazi, do të na gjejë të armatosur jo vetëm me armë, por edhe me vullnetin e pamposhtur që kërkohet për të korru fitoren mbi cilindë armik që do të guxojë të sulmojë atdheun tonë socialist, do të na gjejë të përgatitur ushtarakisht, politikisht, ideo-logjikisht dhe materialisht. Asnjëherë populli shqiptar nuk e ka humbur toruan në momente të vëshfira, ca më pak tani, kur Partia jonë e lavdishme na udhëheq, na edukon, na mëson dhe na përgatit për situatat e mrekullueshme që kemi përpëra dhe që po i ndërtojmë, na përgatit gjithash tu edhe për rreziqet që mund të na turren, na përgatit për fitoren.

Prandaj, shokë dhe shoqe të dashura, ushtarë, studentë dhe oficerë, përpëra me besim të madh te Partia, te vija e saj, të cilën ta doni me gjithë shpirt dhe ta mbron pa u përkulur nga të gjithë armiqtë, të jashtëm e të brendshëm! Dashuria për Partinë tregohet duke zbatuar si duhet direktivat e saj dhe zbatimi

i tyre realizohet plotësisht, duke i studiuar thellë ato dhe duke u bërë gjak dhe mish i trupit të secilit, që duhet të rrojë me to dhc të luftojë me to. Kësaj i thonë ta duash Partinë me të gjitha forcat e shpirtit. Një situatë e tillë duhet të krijohet dhe të kalitet vazhdimisht në zemrat e popullit tonë ushtar, në zemrat tuaja, shokë ushtarë dhe oficerë.

Gëzuar festën!

Rroftë Partia!

Rroftë Ushtria jonë Popullore!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në revistën  
-Rruja e Partisë- nr. 7,  
viti 1978*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Ushtrinë  
Popullore» (Përmblehdje ve-  
prash), Tirana 1984, tëll. II,  
f. 371*

## SIKOLLAT USHTARAKE JANE SHUMË TE RENDESISIIME PËR MBROJTJEN E VENDIT

*Nga biseda me disa kuadro të Ushtrisë sonë Populllore*

10 korrik 1978

*Pas parakalimit të studentëve dhe kuadrove të shkollave ushtarake, me rastin e festës së 10 korrikut, shoku Enver Hoxha zhvilloi një bisedë të shkurtër me disa kuadro të ushtrisë.*

Merrni, shokë, merrni nga një frut, pavarësisht se komandanti i shkollës<sup>1</sup> këtu është nga Gjirokastra, po i kursyer ama nuk është.

Mirë u zhvillua sot kjo ceremoni e bukur. E mbajta një çikë gjatë në këmbë gjithë këtë masë të madhe studentësh e kuadrosh të ushtrisë. Megjithatë, ku lodhen ushtarët tanë! Ata nuk duan t'ia dinë nga lodhja, se janë të kalitur, qëndrojnë kurdoherë në gatishmëri, kudo që të janë, jashtë e brenda, në shi e në diell, në erë e në borë.

Ju, shokë, e kishit organizuar gjithçka këtu në mënyrë të shkëlqyer, mund të them. Kjo flet për kuj-

---

1. Rustem Peçl.

desin e veçantë që keni treguar për ta festuar sa më të gjuar këtë ngjarje të shënuar, për vëmendjen e madhe që kanë treguar Partia dhe Ministria e Mbrojtjes për t'i përgatitur kuadrot e ushtrisë sa më mirë në të gjitha drejtimet. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për përgatitjen fizike, që aq bukur u demonstrua sot në paradë, por edhe për edukimin politik e ushtarak. Ky edukim i shëndoshë ideologjik, politik dhe ushtarak i bën studentët e këtyre shkollave të sillen mirë, të mësojnë mirë dhe të parakalojnë mirë. Çdo gjë në shkollat tona ushtarake është e mrekullueshme, sepse të mrekullueshëm janë komunistët, anëtarët e Bashkimit të Rinisë dhe gjithë kuadrot, që punojnë në to. Këto shkolla janë shumë të rëndësishme për mbrojtjen e vendit tonë. Natyrisht, të tëra shkollat kanë rëndësinë e tyre, por dua të theksoj se shkollat ushtarake përgatitin kuadro për momentet më të vështira dhe më të rrezikshme që mund të ndodhet atdheu ynë: Dashuria, uniteti, kompaktësia dhe qartësia politike e kuadrove që militojnë në repartet tona ushtarake, do të luajnë rol vendimtar në ato momente të vështira për të cilat po punojmë që t'i përballojmë, se ata do ta drelojnë gjithë popullin tonë ushtar. Prandaj them që shkollat ushtarake kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe.

Partia dhe të gjithë ju duhet të përpinqeni kurdoherë pa u lodhur dhe të mos e ulni asnjëherë ritmin në punë për këtë çështje kaq të rëndësishme jetike për atdheun tonë. Sa më mirë të mësoni e sa më shumë të stërviteni, të jeni të bindur se aq më të shumta do të jenë dhe suksceset. Mos harroni se armiqtë tanë janë të mëdhenj dhë shumë të egër, por ne do t'i për-

ballojmë me sukses në sajë të unitetit të Partisë me gjithë popullin tonë të armatosur. Ne do ta mundim armikun, cilid qoftë ai dhe pavarësisht nga armatimet që ka dhe që do të përdorë.

Prandaj, të gjithë të punojmë për një përgatitje sa më të lartë ideopolitike e tekniko-profesionale të kuadrove të ushtrisë sonë, jo vetëm atyre aktivë, por edhe rezervistë. Oficerët rezervistë duhet të mos dallohen në asnjë drejtim nga oficerët aktivë për sa i përket përgatitjes dhe t'u hyjnë problemeve të ushtrisë njëlloj si edhe oficerët aktivë. Vështirësitet që ekzistojnë, Partia duhet t'i ketë parasysh në mënyrë që Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore të zbatohet drejt, duke iu përshtatur kushteve dhe territorit tonë.

Ne para pak ditësh bëmë mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë për problemin shumë të rëndësishëm të mbrojtjes së vendit. Materialet e këtij Plenumi do t'u dërgohen të gjithë kuadrove të ushtrisë. Në këto materiale rekomandohet që Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore të thithet në mënyrë krijuese nga çdo kuadër e ushtar. Domethënë, secili, duhet të kuptojë mirë në radhë të parë, thelbin e këtij problemi ushtarakisht: të brumoset e të çelikoset me teorinë e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore dhe t'i përdorë të gjitha ato që mëson me zgjuarsi. Këtë art. çdo kuadër ta mësojë në shkollë e në praktikë dhe, që të bëhet kjo, duhet të thellohet në të e ta zbatojë me gjallëri.

Ju duhet t'i lexoni me vëmendje të madhe dhe t'i studioni thellë materialet e Plenumit të 5-të të Komi-

tëtit Qendror të Partisë sonë për problemin e mbrojtjes e t'i mbani ato kurdoherë parasysh. Jo vetëm të njihen e të përvetësohen por, në diskutimet e debatet që do të bëni rreth tyre, të sillen edhe mendime të reja për veprim, për taktikat që duhen përdorur e të tjera. Te secili të ngjallet e të forcohet besimi për të ecur në bazë të parimeve që janë caktuar e të mos iëvizet asnjë grimë prej tyre, ndryshe ka rreziqe. Rëndësi ka të kuptohen mirë edhe taktikat që do të përdoren. Një nga mjetet për të arritur fitoren në luftë është që ta mashtrosh armikun, ta hedhësh atë në kllapë. Një gjë e tillë arrihet kur i zotëron të gjitha mënyrat e luftimit, armët dhe rregullat. Pastaj, kur të vijë momenti, te ne çdo pushkë do të bëhet top. Kështu që, kushdo qofshin armiqtë dhe çfarëdo arme që të përdorin ata kundër nesh, prapë do të munden e do të dështojnë në agresionin e tyre. Ata, pra, nuk do të arrijnë dot kurrë t'i thyejnë armët tona. Bile, ata as nuk do të mund të shkelin dot te ne, se do të pengohen në «ferrat» dhe «gjembat» me të cilat do të ndeshen në çdo pëllëmbë të territorit të vendit tonë.

Ju, shokë të ushtrisë, mbase nuk e dini, por para nja dy ditësh kinezët, meqenëse ne kundërshtojmë politikën e tyre, na dërguan një notë, ku na njoftojnë se po na i presin ndihmat ekonomike dhe ushtarake. Kjo do të thotë se kreditë që na kanë akorduar në vitin 1975 nuk do të na i japin më. Në notën e tyre ata thonë gjithashtu se kanë vendosur të tërheqin cdhe të gjithë specialistët që kanë dërguar në Shqipëri. Zë-vendësministri kinez i Punëve të Jashtme i tha amba-

sadorit tonë se ky hap i qeverisë kineze u bë për shkak se gjoja ne nuk u jemi përgjigjur disa kërkesave të saj. Por ambasadori ynë u përgjigj si duhet për shkakun e vërtetë që e shtyu udhëheqjen kineze të ndërmarrë një veprim të tillë kundër vendit tonë.

Ky nuk ishte një qëndrim i papritur për ne. Prerja e ndihmave dhe e kredive vendit tonë nga Kina nuk është e karakterit thjesht teknik, siç pretendohet në notën e kinezëve. Jo! Këtu ka arsyet e mëdha politike e ideologjike, por këto të vërteta ata kanë frikë t'i publikojnë, se i tremben realitetit.

Midis të tjera sh, në notë kinezët thonë se presin marrëdhëni me ne, pra nuk do të na jasin ndihmat e kreditë që na detyrohen, sepse gjoja ne nuk u paskemi kthyer atyre qafat e helikave të helikopterëve, të furnizuar nga Kina sipas kërkesës së tyre. Po pse, pak materiale u kemi kthyer ne nga të gjitha ato pajisje defektuese që na kanë pasë dërguar ata, por na kërkokan t'u dërgonim edhe këto?!

Nota e fundit që na drejtuan kinezët ishte shumë e ulët politikisht, ideologjisht dhe juridikisht. Me këtë akt ata kanë shkelur marrëveshjet e përfunduara zyrtarisht, duke prerë kështu në mënyrë brutale të gjitha ndihmat. Mirëpo ky veprim është një demaskim i madh për ta. Udhëheqja e tanishme kineze është revisioniste e socialimperialiste, prandaj nga ana jonë pritej të ndërmerrë prej saj një veprim i tillë i egër dhe i hapët, se edhe imperialistët akte të tillë i kryejnë në mënyrë të maskuar.

Ne kemi besim dhe bindje se populli ynë do t'i bëjë ballë me sukses këtyre situatave, ai do t'i kapërcë-

jë vështirësitë e krijuara duke shumëfishuar energjitet. Ne, shqiptarët, kështu jemi: nuk qëndrojmë dot në heshtje dhe si të fjetur, por atë që kemi, e themi hapur, përpala syve. Neve nuk na rrighet pa folur kur shikojmë se të tjerët bëjnë shtrembërimet e tradhtojnë marksizëm-leninizmin. Neve na zien gjaku, sepse kur doherë, në të gjitha veprimet e qëndrimet tona, kemi udhërrëfyes marksizëm-leninizmin.

Ne, nga ana jonë, jemi përpjekur për t'i ndihmuar ata sa herë që konstatonim se nuk e kishin drejt. Bile, disa herë u kemi tërhequr vëmendjen dhe i kemi frenuar për të mos vepruar e ngritur probleme që nuk ishin në interes të popujve tanë e të revolucionit. Qëndrimet tona nuk kanë pasur asnjë fije hipokrizie. Ne u kemi thënë atyre që rruga e hruščovianëve nuk është një rrugë e drejtë; u kemi thënë gjithashtu që kryeshelati i popujve që luftojnë për liri, ish-presidenti amerikan Nikson, nuk duhej pritur nga ata në Kinë etj., etj. Por, kuptohet: derisa ata kanë qenë dhe janë revizionistë e socialimperialistë, nuk kishte si të ktheheshin nga rruga që patën nisur. Dhe për këtë ne nuk kemi çfarë t'u bëjmë.

Ju, shokë, jeni njojur me materiale të ndryshme të Partisë sonë dhë nga ato keni mësuar se mendimet tona për çdo problem ne ua kemi thënë kinezëve hapur, me sinqeritet dhe shoqërisht. Po pse Partia e bën-te këlë gjë brendapërbreda dhe nuk i publikonte pikëpamjet e saj për shtrembërimet që viheshin re të udhëheqësit kinezë? Ne mbanim këtë qëndrim jo për t'u bërë atyre qejsin, por se donim dhe kishim shpresë që ata të ktheheshin nga rruga e gabuar e të shko-

nim bashkërisht deri në fund. Mc ato që thoshin udhëheqësit kinezë linin të kuptohej se po ecnin në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Por, siç e thashë dhe më lart, pavarësisht nga situatat që janë krijuar, populli ynë do t'i kapërcejë si kurdoherë me sukses të gjitha vështirësitet. Kjo do të jetë një fitore për ne dhe një katastrofë politike për udhëheqësit kinezë dhe për gjithë armiqtë tanë, gjë që do të ketë jehonë edhe në opinionin botëror. Edhe kur filluam luftën me hrušovianët për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit ne nuk menduam se do të na ndihmonin kinezët, por mbajtëm qëndrimin që duhej. Edhe udhëheqësit kinezë, si përfaqësues të shtetit të madh socialimperialist që janë, ashtu si Hrushovi e Mikojani mc shokë, mendojnë se, duke na i prerë ndihmat e kreditë, ne do të shitemi për 30 aspra tek imperialistët, gjë që as ka ndodhur e as do të ndodhë ndonjëherë.

Mirë, shokë, tani të ngrihem! Sot u kënaqëm shumë këtu.

Ju uroj suksese të gjithëve në kryerjen e detyrave që i dalin përparrë Ushtrisë sonë Popullore.

Të rrojë Partial!

Botohet për herë të parë së pas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

# **NOTA E QEVERISE KINEZE SHPREH STRATEGJINE E NJË SHTETI SOCIALIMPERIALIST**

*Diskutim në mbledhjen e jashtëzakonshme  
të Byrosë Politike të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**11 korrik 1978**

Këtë mbledhje të Byrosë Politike e bëjmë për të shqyruar notën e fundit të 7 korrikut, që na ka drejtuar qeveria kineze, me anën e së cilës na njofton për prerjen e të gjitha kredive e ndihmave ekonomike dhe ushlarake që na janë akorduar nga ana e saj në bazë të marrëveshjeve që kemi përfunduar midis dy qeverive tona në vitin 1975 dhe për tërheqjen e të gjithë specialistëve, duke na lënë në mes të gjitha veprat që nuk kanë mbaruar së ndërtuari.

Të gjithë shokët e kanë lexuar notën, prandaj sot jemi mbledhur të shkëmbjmë mendime për të dhe të përcaktojmë, në vija të përgjithshme, qëndrimin që duhet të mbajmë, si dhe detyrat tona për të ardhmen.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për notën e qeverisë kineze të 7 korrikut 1978, drejtuar Qeverisë sonë.

*Pasi diskutuan anëtarët e tjerë të Byrosë Politike, shoku Enver Hoxha tha:*

Jam dakord me mendimet e gjithë shokëve për sa i përket këtij problemi shumë të rëndësishëm, konsekuençat negative të të cilit nga ana jonë me siguri që do të kapçrcchen me sukses, kurse kinezët jemi të bindur se do të pësojnë disfatë. Ne do t'i kapërcejni këto vështirësi që na dalin, për arsyen se kemi një vijë të drejtë politiko-ideologjike, kemi një ekonomi socialiste të organizuar mirë e të centralizuar. Ne kemi gjithashtu edhe të gjitha mjetet që na nevojiten për ta përsosur më tej dhe për ta çuar gjithnjë përpara ekonominë tonë socialiste.

Por, siç e theksuat edhe ju, shokë, çdo gjë realizohet me luftë, me përpjekje, me punë. Natyrisht, me luftë, me përpjekje dhe me punë janë bërë edhe këto që kemi realizuar deri më sot, pra është dashur të derdhet shumë djersë, janë dashur mund e sakrifica të mëdha që të korrnim gjithë këto fitore që kemi arritur. Megjithatë, gjatë këtyre përpjekjeve, në punë e sipër, është bërë edhe ndonjë gabim, që na ka kushtuar fonde të konsiderueshme materiale, por që me kohë është riparuar. Prandaj, këtë eksperiencë ta kemi kurdoherë parasysh në të ardhmen dhe ajo do të na nxitë ta përmirësojmë më tej drejtimin e organizimin e punës për zbatimin e detyrave që kemi përpara dhe të forcojmë kontrollin e kryerjes së tyre, sepse, duhet të njohim se ka raste që edhe çalojmë në këtë drejtim. Te ne janë të gjitha mundësitë që këto të meta të zvogëlohen, vëtëm se për këtë duhet të kuptohen qartë momentet që po kalojmë, ashtu siç janë në të vërtetë, me

të mirat dhe me vështirësitë e tyre. Në të mirat ne do të mbështetemi kurdoherë edhe në të ardhmen, për të ecur gjithnjë e më përpara. Por, edhe vështirësitë të mos i harrojmë për asnjë çast e as të mos përpinqemi t'i mbulojmë me një eufori të sëmurë dhe të dëmshme, siç e thatë të gjithë ju, shokë.

Po përse duhet të kemi kujdes në këtë drejtim? Të kemi kujdes për arsyen e armiqësisë së udhëheqjes kineze, të këtij shteti kapitalisto-revizonist, me rrënje të thella antimarksiste, të cilat në mënyrë graduale dolën plotësisht në shesh, derisa aktualisht u bënë të qarta jo vetëm për ne, por edhe për shumë shtete dhe popuj të tjerë të botës. Të gjitha këto pikëpamje dhe qëndrime antimarksiste të kinezëve ne i kishim vënë re prej vitesh me radhë, por, të paktën këto gjashtë-shtatë vjetët e fundit ato u bënë pothuajse plotësisht të qarta. Ne po bindeshim se Kina po rrokullisej gjithnjë e më shumë në rrugën antimarksiste, gjë që do të kishte pasoja të rënda në marrëdhëni me mes dy shteteve dhe partive tonë; por kjo do t'i shkaktonte një dëm të madh edhe revolucionit botëror. Dhe këto parashikime të Partisë sonë u vërtetuan në jetë.

Prapëseprapë duhet të themi se gjatë kësaj kohe, me gjithë pjekurinë dhe vendosmërinë e Partisë sonë, armiqtë dhe tradhtarët që dënuam, mundën të përsistonin nga mungesa e vigjilencës revolucionare të disa kuadrove dhe u orvatën të organizohen për të arritur deri në kryerjen e një puçi ushtarak për të likuiduar me gjak udhëheqjen, Partinë dhe shtetin tonë. Puçi që zbuluam përbën një fitore që korrëm ne kundër armiqve, por njëkohësisht ishte edhe një paralajmërim

i asaj që thashë, i mungesës së vigjilencës dhe i mprehtësisë revolucionare në shkallën që duhej, që këta armiq të mos i kishim lënë të bënin aq sa mundën dhe të na dëmtonin, pavarësisht se nuk ia arritën dot qëllimit të tyre final.

Ne tash e dimë qëllimin që synonin të arrinin ata, duke koordinuar veprimtarinë e tyre armiqësore me Çu En Lain e me udhëheqjen kineze. Puna e tyre pati rrjedhime negative dhe na dëmtoi se na prishi një numër kuadrosh të mirë, të cilët kishin marrë pjesë në luftë e kishin bërë edhe sakrifica. Po të ishim tre-guar më të mprehtë dhe më vigjilentë, këta mund t'i kishim shpëtuar dhe duheshin shpëtuar. Përveç kësaj, veprimtaria e armiqve, të lidhur ngushtë me udhëheqjen tradhtare të Kinës, shkaktoi dëme të mëdha në fushën ekonomike, që akoma edhe sot s'janë likuiduar plotësisht. Në qoftë se ne do të kishim evituar, në mos tërësisht, por në një shkallë të konsiderueshme sabotimin ekonomik që na bëri grupi i kryesuar nga Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi në sektorët e ekonomisë, vëcanërisht në atë të naftës, aktualisht do të gjendeshim në situata shumë më të favorshme për të përballuar këto vështirësi që po na krijon tani Kina, megjithëse për ne këto, siç thashë, nuk qenë të papritura.

Kjo veprimtari armiqësore na ka dëmtuar, por nuk na ka dobësuar. Zbulimi e likuidimi i kësaj pune armiqësore, që synonte ta çonte vendin tonë drejt një katastrofe të pariparueshme, dhe gjendja e krijuar prej saj nxitën Partinë dhe masat e mëdha të popullit që të mobilizoheshin më mirë në realizimin me sukses të detyrate. Pas goditjes që u bëmë armiqve, vumë rë

që pati një ngritje të madhe të hovit revolucionar dhe të mobilizimit në punë të njerëzve tanë.

Por, me gjithë shpartallimin e kësaj veprimtarie armiqësore dhe rritjen e vrullit revolucionar të Partisë dhe të masave tona punonjëse, prapëseprapë na u krijuan disa boshllëqe në realizimin e detyrave dhe të planeve tona. S'ka asnjë dyshim se këto boshllëqe e dobësojnë ekonominë tonë dhe për këtë të gjithë të jemi të ndërgjegjshëm. Prandaj, në qoftë se nuk marrim masa serioze që të pengojmë krijimin e boshllëqeve të tjera dhe të plotësojmë ato që na janë krijuar deri tani, nuk do të mund t'i zhvillojmë dot me sukses forcat prodhuese të vendit siç duam ne dhe siç është detyra e madhe e Partisë sonë në planin e brendshëm dhe në fushën ndërkontinentare. Duke i bërë realitet këto detyra ne do t'u tregojmë kështu, në radhë të parë njerëzve tanë, por edhe botës, që forca e Partisë dhe e popullit shqiptar është një realitet i madh dhe parimi i ndërtimit të socializmit me forcat e veta po realizohet konkretisht. Këtë parim ne do ta zbatojmë jo me sloganë dhe me parulla, por duke u mobilizuar me të gjitha forcat për realizimin e planeve dhe të detyrave, duke forcuar më tepër organizimin, duke vendosur kudo një disiplinë sa më të fortë, duke ngritur më lart ndërgjegjen e njerëzve tanë dhe duke ushtruar kontroll të vazhdueshëm për vënien në jetë të vendimeve dhe të oricntimeve që jepen.

Ndihmat nga jashtë ne kurdoherë i kemi vlerësuar drejt. Ne i kemi quajtur ato me karakter internacionalist kur janë dhënë pa qëllime të këqija, por për të ndihmuar pa kushte veçanërisht një shtet socia-

list të vogël dhe të varfër siç ka qenë Shqipëria. Parimi leninist i ndihmës për një vend socialist është i drejtë. Kur ndihma ka pasur vërtet karakter internacionalist është dhënë pa kurrfarë interes, me dëshirë e sinqeritet, nga një vend që është edhe ai socialist, me qëllimin e pastër që të ndihmohemi e të shkojmë drejt mëkëmbjes dhe që më vonë të ishim në gjendje të econim me këmbët tona për të mirën e popullit tonë, por edhe për interesin e revolucionit, ne e kemi pranuar këtë lloj ndihme. Por, kur kemi parë se ndihma nuk ka pasur këtë karakter, por ka qenë e maskuar si internacioniste, kurse në të vërtetë jepej me qëllime të këqija, atëherë e kemi refuzuar se, sikundër e dimë, një ndihmë e tillë do të bëhej për ne e rrezikshme.

Me përjashtim të ndihmave që na janë dhënë në kohën e Stalinit, të tjerat, që u përkasin shteteve pseudosocialiste e revizioniste, tradhtare të marksizëm-leninizmit, na janë prerë në mënyrën më brutale, pa as arsyetimin më të thjeshtë logjik. Kapitalistët, kur bëjnë shantazhe dhe u presin ndihmat ekonomike shteteve të tjera, përdorin disa metoda e mundohen të mbajnë maska të atilla, që ta fshchin qëllimin e vërtetë të këtij akti brutal për nënshtrimin e këtyre vendeve ndaj politikës dhe hegemonisë së tyre. Edhe shtetet që na kanë dhënë neve ndihma, na i kanë prerë ato në mënyrë brutale duke treguar me këtë veprim qëllimin që ndiqnin ndaj nesh: ato na i jepnin ndihmat që ne të mbështetnim politikën e tyre hegemoniste, fashiste, imperialiste e kapitaliste. Mirëpo një «ndihmë» e tillë, siç thashë, do të qe e rrezikshme për ne, prandaj jo

vetëm që nuk e kemi pranuar, por edhe e kemi hedhur atë tej me kohë.

Për ndihmën sovjetike të kohës së Stalinit, ne kemi thënë se ajo ka qenë një ndihmë e madhe dhe mendoj se kemi vepruar drejt. Kjo nga ne është bërë me dashuri e sinjeritet, por edhe me njësarë entuziazmi, jo se donim ta fyrnim, por për nc, njerëzit e varfër të Shqipërisë së re, ajo paraqitej me të vërtetë në atë formë, si një ndihmë e madhe, mbasi nga lufta ne doli më të mjeruar, të djegur e të shkatërruar. Sido që ndihma sovjetike na erdhi me vonësë dhe në sasi të vogla, ne jemi realistë dhe atë nuk e nënveftësojmë zëpakk. Por e vërteta është se në fillim ajo e tillë ishte, e vogël. Dhe ne e kuptonim pse ishte e tillë. Pastaj edhe vetë Stalini na pati thënë hapët: «Shokë shqiptarë, kaq kemi; më vonë, kur të rimëkëmbemi, do t'ju japim më shumë». Megjithatë, ne, siç e vura në dukje më parë, e kemi njojur dhe e kemi vlerësuar drejt këtë ndihmë.

Me hruščovianët puna ndryshoi, se u kuptua qartë cilat ishin qëllimet e ndihmës që na jepnin. Ata, siç e dimë, kishin për objekt që Shqipëria të bëhej një plasdarm, një koloni me plotkuptimin e fjalës si e kohës së okupacionit italian, bile edhe më keq akoma, për arsyen se do të maskohej gjoja me ideologjinë marksiste-leniniste. Shqipëria do të ishte mbushur kështu me sovjetikë nga të katër anët; ata do të kishin të gjitha kyçet e jetës së vendit tonë, kurse ne do të bëheshim shërbëtorët dhe rajatë e tyre. Por Partia jonë, duke pasur eksperiencën e madhe të Luftës Nacionale-clirimitare dhe të luftës kundër veprimtarisë anti-

shqiptare jugosllave, e goditi këtë orvatje armiqësore të revisionistëve sovjetikë dhe e demaskoi përparrësyve të të gjithë botës, duke i bërë kështu një shërbim të madh jo vetëm atdheut të vet, por, njëkohësisht, edhe revolucionit botëror e marksizëm-leninizmit. Me qëndrimin tonë ne i bëmë një shërbim të madh edhe Kinës.

Këtë shërbim të madh, kur ka qenë rasti, ne e kemi vënë në dukje, por, natyrisht, me modesti. Ne me ndërgjegje të plotë kemi rrezikuar çdo fatkeqësi që mund t'i ndodhë popullit tonë nga ky qëndrim i guximshëm dhe ishim të vendosur t'i përballonim ato. Çështja është se Kinës, që në atë kohë merrej nëpër këmbë nga ana e revisionistëve hrushovianë, ne i erdhëm në ndihmë pa asnjë interes. Kjo tregon për qëndrimin e lartë internacionalist të Partisë sonë.

Shumë nga ne kemi qenë vazhdimishit në udhëheqje, i kemi jetuar drejtpërsëdrejti këto ngjarje dhe e dimë se asnjëherë nuk kemi menduar që «të largoheshim nga Bashkimi Sovjetik dhe të bashkoheshim me Kinën, me qëllim që të merrnim ndihma prej saj», siç mund të thonë disa. Në asnjë mënyrë nuk e kemi menduar ne një gjë të tillë! Por Kina, duke u gjendur në pozita të vështira (dhe unë nuk do të hyj këtu t'i sqaroj ato situata të saj, se të gjithë i kemi të qarta, mbasi për to kemi bërë analiza), na dha ndihmë, të cilën, gjithashitu, e kemi vlerësuar drejt. Deri në njëfarë kohe kemi kujtuar se ajo na e jepte atë pa asnjë hile, në mënyrë të singertë, marksiste-leniniste. Më vonë, gradualisht, kemi konstatuar se Kina, me ndih-

mën që na jepte nga ana e saj synonte të arrinte disa qëllime jo të mira.

Megjilhatë, shpresat dhe përpjekjet tona, të mbështetura në konsideratën që kishim ne për Kinën, synonin ta ndihmonim sadopak atë dhe kjo çshtë mark-siste. Kam parasysh këtu qëndrimet e hapëta që mbaheshin nga ana jonë, si në marrëdhëni et midis dy vendeve, ashtu dhe në ato ndërkombëtare. Pra, ne jemi përpjekur ta ndihmonim Kinën dhe e kemi ndihmuar, por asnjëherë nuk e kemi trumbetuar këtë ndihmë, kurse kinezët e kanë trumbetuar. Edhe para nesh, kinczüt, duke filluar që nga Mao Ce Duni dhe deri tek Ten Hsiao Pini, kanë theksuar kurdoherë se «ndihma që ju japim ne, shokë shqiptarë, është shumë e vogël, kurse ndihma që na ka dhënë Partia e Punës e Shqipërisë çshtë një ndihmë kolosale». Dhe kjo ndihmë që u kemi dhënë ne kinezëve ishte me të vërtetë një ndihmë kolosale në fushën politike, për arsyen se Kina, me veprimtarinë e saj u gjend për një periudhë kohë e izoluar në botë. Ajo u izolua politikisht jo vetëm se u bashkua me ne në njëfarë mënyre për shkak të luftës që bënim kundër revizionizmit sovjetik, por ajo u izolua gjithashtu krejt edhe në arçnën ndërkombëtare nga imperialistët amerikanë dhe nga të gjitha vendet e tjera kapitaliste. Në kohën që Kina ndoqi një politikë izolimi, i vetmi shtet dhe e vëtmja parti që e ndihmuan atë ishte shteti socialist shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Përkrahjen tonë ne nuk e matim me ato ndihmat materiale që na ka dhënë Kina, që për ne ishin të natyrshme dhe plotësisht të merituar, derisa udhë-

heqësit kinezë paraqiteshin se ndiqnin rrugën socialiste. Por jeta vërtetoi se kinezët kishin adoptuar shumë taktika, të cilat i përdornin kohë pas kohe dhe që i nxorën në shesh tanë së fundi, duke kapërcyer nga një strategji në një tjetër. Kështu, duke ndryshuar strategjinë, kinezët duhej të ndryshonin medocemos edhe qëndrimin ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, Partisë së Punës, që është një Parti marksiste-leniniste.

Politika e Kinës së Mao Ce Dunit ishte një politikë në evolucion, që e çonte vendin në rrugën e social-imperializmit. Por kjo politikë u zhvillua me etapa, duke shfrytëzuar koniunkturat. Gjatë koniunkturave që zhvilloheshin në botë ne jemi përpjekur t'ia shfaqnim Kinës mendimet tona, si marksistë-leninistë, pa i bërë publike, u kemi bërë vërejtje, u kemi shkruar letra etj. Të gjitha këto i dimë, prandaj nuk është nevoja t'i përsëris. Për këto çështje që kanë lindur me kinezët ne kemi dokumente jashtëzakonisht të rëndësishme, që, aktualisht, marrin një vlerë të madhe në radhë të parë, për opinionin tonë të brendshëm. Ato Partia jonë i njeh në përgjithësi, por, kur të vijë koha dhe radha edhe do t'i bolojmë që njerëzit tanë, të marrin dijeni konkretisht dhe deri në fund për qëndrimet e Partisë, të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë sonë ndaj veprimeve të Kinës. Ky qëndrim do të shërbejë si një forcë e madhe inkurajuese e mobilizuese për masat tona punonjëse në luftën e tyre për kapërcimin me sukses të kësaj situatë.

Por, qëndrimet tona ndaj Kinës, kur të botohen dokumentet, do të luajnë një rol të madh pozitiv edhe

në arenën ndërkontaktare, në radhë të parë, në partitë marksiste-leniniste, të cilat, në përgjithësi, diçka dinë, por jo në hollësi. Ato kanë dijeni për konfliktet tona, ose, si të themi, për mosmarrëveshjet tona ideologjike dhe politike me Mao Ce Dunin dhe bashkëpunëtorët e tij, por nuk dinë me hollësi përbajtjen e dokumenteve që ne kemi këmbyer me udhëheqjen kineze. Kur t'i mësojnë edhe këto, kjo do të bëjë që të forcohen akoma më tepër qëndrimet antirevizioniste të partive motra, sepse dihet që brenda në këto parti ka edhe nga ata që nuk i kanë si duhet të qarta këto çështje. Në këtë mënyrë, pra, do të sqarohen të gjithë. Pastaj edhe opinioni i shëndoshë botëror, bile edhe imperialistët, natyrisht këta për interesat e tyre të veçantë, do t'i përdorin këto fakte dhe do të kenë një mendim më të qartë për qëndrimet parimore politike dhe ideologjike të Partisë sonë dhc të shtetit shqiptar.

Sigurisht nuk kanë qenë dhe nuk janë kinezët dhe ndihma kineze vendimtare ata që kanë ndërtuar gjithë këto vepra të mëdha ekonomike në Shqipëri. Jo, në radhë të parë, këto i ndërtói populli ynë, klasa jonë punëtore, me Partinë në krye. Ndihma kineze ka qenë një faktor i dorës së dytë, dhe përfaqëson një përqindje fare të vogël të vlerës së këtyre veprave. Prandaj pretendimet që bën udhëheqja kineze me atë formulim tendencioz dhe joreal në notën e saj, sikur këto vepra janë ngritur te ne në sajë të ndihmës që na ka dhënë ajo, nuk kanë asnjë bazë. Ajo gënjen, e, në radhë të parë, popullin e saj. Me qëndrimet tona të argumentuara, ne do të bëjmë që jo vetëm njerëzit tanë, por edhe popujt e vegjël të botës, të gjithë ata që ako-

ma janë në zhvillim dhe kanë nevojë për çfarëdo ndihme qoftë nga jashtë, të kuptojnë drejt se veçanërisht ndihma e dhënë nga ana e imperialistëve dhe e social-imperialistëve, në të cilët futet aktualisht edhe Kina, është një ndihmë fare e vogël, në krahasim me përpjekjet që do të bëjë vetë, cilido popull qoftë, edhe për ndërtimin, ta zëmë, të një fabrike çimentoje, përveç faktit që ajo është njëkohësisht një «ndihmë» skllavëruese.

Sidoqoftë, ajo që na ka dhënë Kina ka qenë një ndihmë reale dhe këtë ne as e kemi mohuar dhe as e mo-hojmë. Kinezët, megjithatë, në notën e tyre na quajnë «mosmirënlohës». Ata, sigurisht me qëllim përdorin edhe emrat tanë që në raste të ndryshme kemi thënë kështu apo ashtu. Por unë mendoj se, në radhë të parë, i madh e i vogël në vendin tonë duhet të kuptojë mirë se ndihma e kinezëve, ashtu si edhe ajo e revolucionistëve sovjetikë, për të mos folur për ndihmën e revisionistëve jugosllavë (pse këta nuk na dhanë asnjë ndihmë, përkundrazi na kanë grabitur), nuk ka qenë aspak vendimtare. Vendimtare ka qenë forca e popullit tonë dhe djersa e derdhur prej tij, kanë qenë investimet kolosale që ka bërë shteti ynë për ngritjen e ekonomisë sonë socialistë. Ne pranojmë se teknikët kinezë kanë dhënë, gjithashtu, njëfarë ndihme në përgatitjen e kuadrove tanë, pse për ne teknologja e shumë veprave që kemi ndërtuar me ndihmën e tyre, ka qenë e panjohur. Por, gjatë ndërtimit të tyre, edhe ne, gjithashtu, u kemi dhënë ndihmë kinezëve me teknikët, inxhinierët, specialistët e mjeshtrit tanë, pa të cilët nuk mund të bënin dot gjë as inxhinierët e specialistët më

të mirë kinezë, qofshin këta edhe nga më të shqarit në ndërmarrjet ku punonin.

Këto gjëra ne duhet t'ia bëjmë mirë të qartë popullit në situatat që po krijohen. T'ia bëjmë të qartë jo se ne mohojmë ndihmën kinezë, por se kështu është fakti, i tillë është realiteti dhe realitetin Partia jonë kurdoherë e ka thënë hapët dhe e ka mbrojtur. Duhet të bëhet e qartë për të gjithë se deri në ç'masë ka qenë ndihma kinezë dhe sa ka qenë vlera e punës sonë. Ne u përpoqëm që kjo ndihmë të vazhdonte, por vetëm në rrugën marksiste-leniniste, pa na u bërë nga ana e kinezëve as presione, as shantazhe etj., etj. Tash janë kinezët ata që na i prenë ndihmat në mënyrë brutale dhe kjo vërteton se nga ana e tyre ato na janë dhënë me qëllime të caktuara.

Aktualisht brenda vendit tonë siç e theksuat edhe ju, rëndësi të madhe merr, më shumë se kurdoherë tjetër, ana politike, që ne duhet dhe do t'ia bëjmë të qartë popullit dhe Partisë.

Ana tjetër, gjithashtu me röndësi, është ajo ekonomike. Unë nuk do të zgjatem në këtë drejtim, se ju, shokë, theksuat të gjithë që ekonomia jonë duhet të vazhdojë të zhvillohet me ritmet që kemi caktuar në Kongres. Por, në kushtet e vështira që na krijojnë revizionistët kinezë, që ekonomia jonë të zhvillohet me këto ritme, kërkohet një stil dhe një metodë pune shumë më e mirë nga të gjithë. Nga cilido të bëhen përpjekje që teorinë ta lidhë e ta gërshetojë si duhet me praktikën. Praktika në vetvete ka shumë çështje. Te ne ajo nuk është një praktikë anarkiste, po një praktikë e organizuar me ligje, me urdhëresa, me disiplinë,

me politikë, me ideologji dhe me teknikë. Këtu, më duket mua, qëndron ndryshimi midis sloganit dhe zbërthimit konkret, kuptimit dhe zgjidhjes në praktikë të problemit në gjithë kompleksitetin e tyre. Por ka shumë njëreë që nuk e kuptojnë kështu, gjë që shkakton atë rutinë që ne e luftojmë, atë burokraci që ne gjithashtu e luftojmë dhe do ta luftojmë vazhdimisht, sepse në një ditë nuk mund ta zhdukim.

Veçanërisht në këto situata duhet të ketë sa më pak rutinë në punën tonë dhe të përdoren sa më pak sloganet pa bukë, por me ujë shumë. Që të mos shfaqen këto fenomene të huaja duhet të vihem i gjithë në lëvizje dhe të marrim më shumë përgjegjësi mbi vete. Nuk e kam fjalën vetëm për ne që jemi këtu në qendër, por për të gjithë kuadrot deri në bazë dhe këtë ta bëjmë realitet shokë. Këtu është çështja e kapërcimit të vështirësive që do të na dalin. Këtë do ta arrijmë vetëm me një mobilizim të madh e të plotë të klassës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse, me Partinë në krye, e cila duhet t'i bëjë të ndërgjegjshëm të tërë, që të zotërojnë gjendjen dhe të punojnë me tru në kokë për të kryer plotësisht ato detyra që u janë caktuar. Jo vetëm kaq, por të interesohen dhe për detyrat që u janë ngarkuar shokëve rreth tyre, që të koordinohen me kujdes veprimet e përbashkëta, të drejtohen dhe të kontrollohen deri në zbatimin e tyre të plotë. Qëllimi është të arrihen rezultate të tillë që ato diferenca që krijohen në të ardhurat, si rrjetet i aktit brutal të kinezëve, t'i plotësojmë me forcat tona. Ato, pra, mund të plotësohen vetëm me një punë këm-

bëngulëse e të menduar mirë dhe me një mobilizim të plotë të të gjitha forcave dhc energjive tona.

Llogaritë t'i bëjmë të sakta. Por, në rast se nuk merren të gjitha masat që thashë, ato nuk do të na dalin dhe do të na lindin vështirësi të tjera që do të pengojnë zhvillimin e ekonomisë.

U përmend këtu sektori i naftës. Gjendja është akoma shqetësuese, shokë, në këtë sektor. Kjo situatë është krijuar që në kohën e Koço Theodhosit, bile jo atëherë kur e dënuam atë, por që më parë. Armiqtë na kanë sabotuar edhe herë të tjera në naftë. Me gjithë masat që kemi marrë, gjendja atje vazhdon të mos ndreget. Sikur vetëm këtë çështje të marrim në shqyrtim, që ka të bëjë me një nga sektorët kyç të ekonomisë sonë, kjo duhet të na bëjë të mendohemi thellë, bille jashtëzakonisht thellë. E kështu me radhë mund të flasim edhe për të gjitha çështjet e tjera.

Rëndësi të madhe ka që ne t'i ndërtojmë patjetër ato vepra që kinezët na i lanë të papërfunduara. Për ngritjen e tyre të vëmë kujdesin më të madh. Të shohim, fjala vjen, ku janë të metat, boshllëqet dhe të tjera e të tjera dobësi në njëren prej tyre dhe të marrim masa që t'i evitojmë gradualisht këto edhe në të tjerat. Këto çështje t'i shikojmë me seriozitet, pa eufori dhe për to të mos na zërë gjumi. Duhet të mos i zërë gjumi të tërë punonjësit, pa përjashtim të ngrihen të gjithë në këmbë, ashtu siç u ngritën punëtorët në uzinën «Enver» dhe thanë ato që përmende ti, Pilo<sup>1</sup>.

1. Pilo Peristeri, në atë kohë, kandidat i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe drejtor i kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha».

Por një hov i tillë duhet të mbetet kudo si një flakë e pasuar.

Të jetë e qartë për të gjithë se ne nuk luftojmë vetëm për të përfunduar këto objekte që na kanë mbutur pa ndërtuar akoma, por edhe për të realizuar planin e ardhshëm; luftojmë gjithashtu që të krijojmë kudo rezerva sa më të mëdha. Ne nuk luftojmë as vëtëm për planin e ardhshëm, por edhe për planet më të largëta të perspektivës, me qëllim që brezat e rinj të vendit tonë t'i gjejnë të realizuara detyrat nga ne dhe të jenë kurdoherë në gjendje ta zhvillojnë Shqipërinë që kjo të ecë gjithnjë përpresa, gjithnjë e më lart me forcat e veta.

Në këtë drejtim të punohet seriozisht dhe të merrin masa të balancuara. Këto masa unë i kuptoj kështu, që atje ku është mundësia të mbarojë sa më shpejt një uzinë, t'i vihem i punës përnjëherë në mënyrë të përqendruar dhe të mobilizohen forcat që ajo të vihet në punë sa më shpejt. Për shembull, Uzinën e Ferrokromit në Burrel, që nuk do shumë gjëra, mendoj se ne mund ta përfundojmë më parë. Pastaj t'i hidhem i asaj të Laçit, ta mbarojmë edhe atë e kështu me radhë gjithë të tjerat.

Për sa i përket kombinatit metalurgjik do të them disa mendime se nuk i di të gjitha boshillëqet e mungesat që ekzistojnë atje. Realitetin atje unë e njoh në via të përgjithshme, që na mungon kjo apo ajo gjë. Për sa i përket prodhimit të tubave e llojeve të ndryshme të tyre, kjo është një çështje që nuk mund të zgjidhet sot për sot. Prandaj, me aq sa kemi mundësi, të përpinqemi të perfektionojmë më parë prodhimin me

forcat tona, të llojeve të çeliqeve duke përdorur sa më shumë mineralin e vendit. Të vijmë pastaj tek objekti numër 12 që ndan nikel-kobaltin. Edhe shtete të tjera të zhvilluara e kanë mbajtur shllamin për vite të tëra, se nuk kanë mundur t'i ndajnë dot këto dy elemente nga njëri-tjetri. Prandaj, në qoftë se themi se ne do ta bëjmë vetë këtë ndarje që nesër, do të bëjmë gabim. Këtë shllam ta studiojmë mirë e të gjejmë teknologjinë e përshtatshme për t'i ndarë ato elemente.

Të kemi parasysh edhe një gjë, të ruhem i nga propaganda kineze. Aktualisht kjo do të jetë në aktivitet të madh. Po kështu të ruhem i edhe nga propaganda titiste dhe nga e gjithë propaganda reaksionare botërore, sepse realiteti është që të gjithë armiqjtë tanë, kudo në botë, presin, ashtu siç thatë edhe ju, të shohin se kujt do të vemi ne t'i nderim dorën. Por ne nuk do t'ia nderim dorën kurkujt. Jo vetëm që ky është fakt, por këtë edhe Kushtetuta e Republikës sonë e ndalon, Partia gjithashtu e ndalon, edhe ndërgjegjja jonë komuniste e patriotike na e ndalon, sepse, po të bëhej një gjë e tillë nga ne, kjo do të qe skllavërim për popullin tonë. Të gjitha ato gjëra që do të na nevojiten për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë dhe sidomos për përfundimin e veprave që na lanë kinezët pa ndërtuar, ne do t'i blejmë me para. Sidoqoftë, i blejmë me para apo nuk i blejmë fare, propaganda kineze dhe ajo e gjithë armiqve të tjerë do të trumbetojë se shqiptarët u shitën. Megjithatë, propaganda e armiqve nuk duhet të na bëjë ne të tërhiqemi dhe t'i lëmë këto vepra pa ndërtuar. Por për këtë çështje të

punojmë pa zhurmë. Të caktojmë për këtë qëllim edhe njëfarë afati, sepse situatat na kërkojnë të bëjmë edhe periodizimin e përfundimit të veprave. Nuk mund të themi që tani se kë do të ndërtojmë më parë se nuk e dimë akoma se sa do të na kushtojë. Prandaj, më parë të bëjmë sondazhe, të pyesim, të shikojmë andej-këtej ku mund e ku na intereson të blejmë dhe pastaj, më së fundi, të vendosim. Shllamin, fjala vjen, të gjykojmë nëse na intereson ta mbajmë në këto situata? Një pjesë, pra, mund ta tregtojmë jashtë, derisa të arrijmë ta bëjmë vetë ndarjen e këtyre dy metaleve. Kështu të mendojmë e të tilla kombinime të bëjmë edhe për veprat e tjera.

Problemi i dytë, pra, që trajtova më sipër, ishte ana ekonomike, e cila është gjithashlu me rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë pas asaj politike e për të cilën, po ashtu, duhet të sqarohet populli. Të theksohet sidomos se çështja ekonomike ka rëndësi vendimtare për situatat e krijuara, ndryshe politika mbetet në hava.

Çështja e tretë që dua të trajtoj tani është ajo e mbrojtjes. Për sa i përket këtij problemi, mbasi na u prenë ndihmat ushtarake, na vihet për detyrë që armët që kemi në dispozicion t'i mbajmë në rregull, t'i kursejmë e t'i ruajmë; ushtrinë ta stërvitim gjithnjë e më mirë dhe objektivat që kemi vënë në fushën e mbrojtjes (është fjala për fortifikimet etj.) t'i ndërtojmë. Komisionet që janë ngarkuar për të prodhuar mjetet e municionet e nevojshme të punojnë me kujdes dhe të përpilen t'i realizojnë detyrat që u janë ngarkuar. Prandaj të ecim me vendosmëri në realizi-

min e tyre, për arsyen se mbrojtja është detyra kryesore. Të mos harrojmë se armiku edhe mund të na godasë një ditë.

Të vijmë tanë te politika e jashtme. Kina e bëri këtë hap kundër nesh, për arsyen se, siç e thatë edhe ju, te ne ajo shikon armikun e saj më të madh; jo një armik potencial nga pikëpamja ekonomike, por kundërshtarin e saj politik dhe ideologjik më të fuqishëm. Ne jemi të vetmit marksistë-leninistë në botë që po e demaskojmë veprimtarinë revizioniste shoviniste të shtetit të madh, socialimperialist e neokolonalist kinez. Kinën e atakojnë edhe sovjetikët e vendet e tjera revizioniste, por ataket e tyre janë atake prej konkurrentësh imperialistë, kurse goditja që i bëjmë ne është e mbështetur në ideologjinë marksiste-leniniste që i mobilizon masat e gjera të popujve dhe e demaskon rëndë Kinën. Është për këtë arsyen që Kina, duke na konsideruar si armikun e saj më të madh e më të vendosur, bën përpjekje të na mposhtë. Këtë ta kemi mirë të qartë, shokë: ajo punon që të na mposhtë e të na nënshtrojë. Ajo ka mendimin se prerja e ndihmave ekonomike nga ana e saj do të jetë faktori vendimtar që do t'i thyejë brinjët Shqipërisë. Por, pikërisht kështu mendonin dikur Hrushovi dhe Mikojani, të cilët na kërcënuan ne duke na thënë se «ju vetëm për 15 ditë keni bukë, prandaj mbaruat». Edhe Kina nga një i tillë mentalitet socialimperialist udhëhiqet, bile, akoma edhe më i keq se ai i revizionistëve sovjetikë. Ajo mendon se do të na i thyejë brinjët në ekonomi dhe do të na detyrojë t'u nderim dorën imperialistëve ose socialimperialistëve sovjetikë, që pastaj të ketë rast t'i

thotë botës: «Ja, Shqipëria i kishte të tëra llafe ato që thoshte; ajo është një shtet me një politikë të lëkundshme dhe shitet tek imperialistët», siç tha Hrushovi, «për tridhetë aspra».

Këto qëllime të Kinës i dimë. Ato u vërtetuan nga ne që kur ishin gjallë Mao Ce Duni e Çu En Lai. Përpjekjet e këtyre të dyve ishin që ne të ndiqnim politikën kinezë. Mirëpo këtë politikë ne nuk e ndoqëm, por vazduam politikën e drejtë marksiste-leniniste. Mao Ce Duni dhe Çu En Lai e evituan polemikën me ne, sepse ishin të ndërgjegjshëm se, po ta hapnin, do të demaskohej strategja e tyre e re kapitalisto-revacioniste. Kuptohet që ata u treguan në këtë drejtim më të shkathët dhe më të zgjuar se Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini me shokë, megjithëse nuk hoqën dorë nga përpjekjet e tyre, që tashmë ne i kemi të qarta. Mao Ce Duni dhe Çu En Lai përdorën të gjitha mënyrat, që nga aktet e diversionit e deri te kalbëzimi nga brenda i Partisë e i ushtrisë sonë dhe, pasi të arrinin këto synime, të kryenin puçin. Beqir Balluku e Abdyl Këllezi me shokë ishin njerëzit e kinezëve, ishin ata që do të realizonin atë politikë shoviniste dhe shkatërruese të revisionistëve kinezë kundër vendit tonë me mjete të tjera, sepse me polemikë ata e kishin të qartë se nuk do të na e dilnin dot. Por ne e zbuluam dhe e likuiduam këtë situatë të vështirë.

Puçi që u përpoqën të organizonin udhëhcqësit kinezë në Shqipëri vërtetoi atë që kishte parashikuar Partia jonë, se Partia Komuniste Kinezë nuk ishte një parti marksiste-leniniste, se Mao Ce Duni nuk ishte një marksist dhe se Çu En Lai ishte një kapitalist. Po

kështu të tillë ishin edhe shokët e tyre. Të gjitha turbullirat që ndodhën në Kinë ishin konsekuanca të kësaj vije antimarksiste. Në vendin e tyre ata e realizuan puçin, kurse te ne nuk e realizuan dot, dështuan.

Pas vdekjes së Çu En Lait dhe të Maos, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini donin që ne të aprovonim vijën e përpunuar prej tyre, po ne e hodhëm poshtë këtë orvatje. Udhëheqësit e rinj revizionistë kinezë shpresuan se ne do të ishim aq qorra e budallenj sa t'i mbështetnim në goditjen që i bënë «katërshes». Këta ne as i mbrojtëm, as i demaskuam, por mbajtëm atë qëndrim që dihet, duke u thënë se ne nuk përzihemi në punët e brendshme të tyre. Kjo natyrisht ishte një thikë për udhëheqësit e rinj kinezë, për arsyen se gjithë bota (si të themi, ajo botë që ka pak tru, pavarësisht se nga çfarë ideologjie ushqehet), likuidimin e «katërshes» dhe gjithë ato që bënë kundër saj nuk mund t'i pranonte ashtu siç vepruan Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin. Edhe këtu duhet t'i gjejmë ne arsyet e qëndrimit të tyre armiqësor ndaj Partisë dhe shtetit tonë. Veprimtaria e tyre është një veprimtari antimarksiste, rrjedhim logjik i vijës së tyre.

Në këtë çështje të dy këta, si Huaja edhe Teni, pësuan disfatë. Për këtë arsyen ata, më në fund, nxorën kundër nesh pengesa dhe bënë përpjekje me të gjitha mjetet për të sabotuar ndërtimin e objekteve, të cilat në mënyrë zyrtare kinezët i kanë firmosur për t'i realizuar në vendin tonë.

Ata na qitën neve një seri pengesash për shkaqe të paqena, apostafat për të na demoralizuar ose për të na shtyrë që të merrnim masa të tilla që do t'u

jepnin mundësi atyre për të na bërë ne fajtorë. Përsëri Partia jonë, me pjekuri dhe me durim, që vërtetohet edhe në dokumentet zyrtare, mbajti qëndrime të drejta ndaj gjithë kësaj poshtërsie të kurdisur nga pala kinezë. Udhëheqësit aktualë kinezë, duke ndjekur njërin pas tjetrit qëndrimet e Partisë dhe të Qeverisë sonë, arritën në përfundimin se me Shqipërinë nuk mund të gjendej zgjidhje tjetër përveçse duke na prerë kreditë, pavarësisht se çfarë do të ngjasë për ta, pavarësisht se bota do t'i dënojë, pavarësisht se ky qëndrim po mbahet nga ata pas ngjarjeve të turpshme që kanë kurdisur me vietnamezët. Por, për vietnamezët ata gjoja kishin një arsy strategjike ndërkombëtare, sepse Vietnamit mbështetet te sovjetikët. Mirëpo me ne, shqiptarët, ata nuk kishin asnjë arsy ku të kapeshin, sepse te ne s'ka minoritet kinez dhe Shqipëria po lufton ditë e natë nga të katër anët me të gjithë ata që shtypin e shfrytëzojnë popujt. Atëherë udhëheqësit kinezë menduan se s'kishte rrugë tjetër për ta veçse të prisnin marrëdhëniet dhe ja: pas gjithë kësaj na erdhi nota nga ana e tyre!

Unë jam dakord me vlerësimin që i bëtë të gjithë ju, shokë, kësaj note. Me pak fjalë kjo shpreh tamam vijën tipike të kalbur kinezë; ajo është një dokument pa koherencë, pse s'mund të ketë koherencë në mendimet dhe në veprimet e revisionistëve.

Çfarë shikojmë ne te kjo notë? Mua më duket se tek ajo ne duhet të dallojmë tri aspekte:

Aspekti i parë është ai i anës ekonomike. Që në krye të notës kinezët vënë çështjen që «ju, shqiptarët, nuk jeni mirënlohës për ndihmën kolosale që ju kemi

dhënë». Vënia e shifrës prej 10 miliardë juanësh dhe e theksimit të saj si një ndihmë kolosale, është bërë me qëllim, për të treguar që ne ju kemi dhënë këto e ato. Dhe fillojnë të numërojnë të gjitha me radhë: një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë..., llogari që as sovjetikët nuk e kanë bërë në një mënyrë të tillë, kurse kinezët i numërojnë të gjitha, deri te specialistët; bile edhe për sekretet ushtarake flasin aty.

Përse e bëjnë ata këtë gjë? Sepse është i vetmi argument sentimental gjoja për popullin tonë, për opinionin ndërkombëtar apo dhe për vetë opinionin kinez për të treguar që «ja, shqiptarët janë mosmirënjojës e të pabesë, me një fjalë, nuk mbajnë as fjalë, e asgjë». Por njerëzit do të bëjnë pyetjen: «Çfarë interes ka pasur Shqipëria që po i bie me këmbë kësaj «të mire» kaq të madhe?» Dhe përgjigjja nuk do të jetë ashtu siç dëshirojnë dhe e presin tradhtarët kinezë.

Por kinezët përpinqen ta japid këtë sipas tyre, në aspektin e dytë të notës dhe me pak fjalë, sepse kjo është çështja bazë, kryesorja, për të cilën ata nuk duan të flasin gjatë. Veprojnë ashtu siç sillen njerëzit në shtëpinë e të varurit që nuk guxojnë ta zënë në gojë litarin. Dhe kryesorja për ta është çështja ideologjike e politike, është problemi i strategjisë kineze. Kjo ka të bëjë me atë që ka ngritur Partia jonë edhe më parë, po që e trajtoi edhe në Kongresin e saj të 7-të: lufta kundër teorisë së «tri botëve», lufta kundër tezës së mbështetjes tek imperializmi amerikan për të lufthuar kundër socialimperializmit sovjetik etj. Domethënë, të gjitha tezat marksiste-leniniste revolucionare të Partisë sonë janë arsyet kryesore që i detyruan

kinezët të na presin ndihmat ekonomike e ushtarake. Kësaj çështjeje në notë, nga ana e tyre, i jepet përgjigje me një frazë të vetme sentimentale, duke thënë se ne paskemi sulmuar rëndë Mao Ce Dunin. Po ku e sulmuam, qysh e sulmuam dhe pse e sulmuam atë, për këto nuk thuhet asgjë.

Aspekti i tretë që del në notë është fare mizrabël, për arsy se ka të bëjë me disa hollësi teknike, të cilat s'kanë asnijë bazë dhe janë sa për të plotësuar diçka që nuk mund të plotësohet, për të justifikuar prerjen e këtyre marrëdhënieve. Pra, pasi përmendet fraza që ne sulmuam rëndë Mao Ce Dunin, pastaj vihen edhe këto të tjerat, si ajo që shqiptarët na dhanë ultimatum etj., etj.

E shikuar në këtë prizëm, nota kincze jo vetëm që ka një përbajtje shoviniste e arrogante dhe pasqyrin aktin e një shteti, si me thënë, të egër e të madh, por zbulon dhe vërteton se miqësia e Kinës me ne, nga ana e tyre, ka qenë e bazuar në atë që ne të mos i sulmonim ata, të mos kritikonim Mao Ce Dunin e të kishim durim. Pse të kishim durim? Të kishim durim sepse atyre u paskeshin qitur vështirësi Lin Biaoja dhe «katërshja», dhe ne, sipas udhëheqjes kineze, jo vetëm nuk e ndihmuam atë kundër tyre, por përkundrazi, treguam se jemi pro me ta. Në mënyrë indirekte në notë kjo nënkoplohet.

Të gjithë jemi dakord që këtë notë duhet ta demaskojmë. Tani e kemi «zogun» në dorë, prandaj ta «shtrydhim» atë aq mirë, saqë jo lot t'i dalin, por t'i dalë gjak. Ta kapim me këtë rast demin për brirësh, sepse dokumentet që disponojmë ne kundër kinezëve

janë të panumërtë dhe të gjitha në favorin tonë. Por, natyrisht, në një notë që mund t'u bëjmë ne, nuk u jepet dot përgjigje të tëra çështjeve. Për këtë qëllim ne duhet të hartojmë një dokument me nivel të lartë politiko-ideologjik. Të kemi parasysh që aty t'i zbërthejmë e t'i vëmë në dukje problemet, por jo duke u futur në detaje. Të lëmë të kuptohet që pas kësaj do t'u jepen përgjigjet e plota për të gjitha çështjet një nga një, dhe kjo ka shumë rëndësi. Para së gjithash atyre do t'u vihen në dukje kontradiktat tona ideologjike.

Ne do t'i përgjigjemi notës kineze, po në cilat gjëra? Çështjet ekonomike që ngrenë ata, do t'i hedhim poshtë. Për këto, fillimisht do të punojmë me Ramizin, dhe, kur të mbarohet teksti, do ta shikojmë bashkërisht të tërë. Ne do të themi se e njohim ndihmën e kinezëve, por do të shtojmë se, në bazë të dokumenteve të firmosura bashkërisht, kjo ndihmë nuk është aq sa thonë ata dhe nuk ka nevojë ta përmendim se sa është shisra globale, por u vëmë në dukje se vlerësimi i ndërmarrjeve që kemi ndërtuar me ndihmën e tyre, në bazë të marrëveshjeve, është një problem që duhet të diskutohet bashkërisht; t'u theksojmë, pra, kinezëve që ata e kanë bërë këtë vlerësim në mënyrë krejt të njëanshme. Një kjo.

E dyta, të vëmë në dukje që ndihmën kineze ne vërtet e vlerësojmë, por ta bëjmë të qartë mirë se ajo, me ndërtimin e objekteve të ndryshme, përfaqëson një përqindje fare të vogël të investimeve tona të përgjithshme, aq sa del llogaria e vlerës së tyre dhe të gjitha këto të argumentohen. Të theksojmë me këtë rast (dhe

kjo duhet të futet pastaj në çështjet politike) se ndihma e tyre duket qartë që na është dhënë me prapamendim, me synimin që ne të ndiqnim rrugën kineze, pra ata kanë luftuar që ta blejnë Shqipërinë. T'i bëjmë të kuptojnë se pikërisht këtu qëndrojnë kontradiktat tona, këtu është themeli i gjithë këtij kundërshtimi që ata e fshehin. Ju na keni akuzuar, t'u thuhet në përgjigje, përpara se t'ju akuzojmë nc dhe t'ju përmendim se, pas Kongresit të 7-të të Partisë sonë, ju na keni dërguar një letër, teksti i së cilës do të botehet në kohën e duhur. Komiteti Qendror i Partisë sonë i ka dhënë përgjigje kësaj letre të tyre dhe u ka kërkuar sqarime se ku e kishim sulmuar ne Mao Ce Dunin. Por siç e keni zakon, t'u thuhet kinezëve, duke mbajtur qëndrimin e njerëzve që udhëhiqen nga ideja e shletit të madh, ju nuk na keni kthyer asnjë përgjigje. T'i njostojmë, gjithashtu, se këto dokumente do të publikohen nga ana jonë në kohën e duhur. Këto gjëra mendoj të futen në pjesën politike të përgjigjes sonë, duke u numëruar se kur i kemi kritikuar, në këtë dhe në atë rast dhe të vihet në dukje se për këto do të botehen edhe dokumentet përkatëse. Pra, do t'ua themi të gjitha, do t'ua numërojmë një nga një me radhë.

T'u themi, gjithashtu, që ne kemi kërkuar me kohë që mosmarrëveshjet midis të dyja palëve t'i sheshonim, duke propozuar që të vinte në Kinë një delegacion i nivelit të lartë të Partisë dhe të Qeverisë sonë, por ju keni refuzuar. T'u kujtojmë se që në kohën kur ishte gjallë Mao Ce Duni, për më shumë se

dy vjet rresht, ne ua kemi përsëritur këtë propozim për bisedime, po prapë ju s'keni pranuar.

Pastaj do të futemi në çështje të tjera, duke u vënë në dukje me fakte të njohura se ne, që pa vdekur akoma Mao Ce Duni, kemi sulmuar vazhdimesh imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik, borgjezinë reaksionare botërore dhe vazhdojmë t'i sulmojmë. Por, në qoftë se ju këtë e konsideroni si një ofçzë, atëherë përse nuk e thoni haptazi që jeni me imperializmin amerikan? Dhe ne konstatojmë se në fakt ju mbështeteni fort te ky imperializëm.

T'u vëmë, gjithashtu, në dukje në letrën tonë se ne kemi luftuar tërë jetën kundër titizmit si një ideologji antimarksiste e revizioniste. Për një kohë, në luftën tonë (të përcaktojmë ekzakt datat, që nga ky vit dhe deri në këtë vit) jeni bashkuar me ne edhe ju dhe keni folur atëherë kundër Titos (në këtë pjesë të përgjigjes të gjejmë nga dy citate të kripura për t'i demaskuar me turp), kurse aktualisht ju jeni bashkuar me të. Kjo, natyrisht, është puna juaj, por jeni ju që keni ndryshuar kursin dhe jo nc, t'u themi atyre.

T'u vëmë, gjithashtu, në dukje se jeni ju që keni bërë përpjekje në mënyrë subversive që ne të bënim një aleancë ushtarake me Jugosllavinë dhe me Rumaninë; që tradhtarët e vendit tonë t'i linin hapur portat e hyrjes në Shqipëri flotës sovjetike për të zaptuar vendin tonë, gjë që do të rrezikonte popujt e Jugosllavisë, popullin grek e të tjerë, por ne, të gjitha këto propozime tuajat i kemi shkelmuar. Të theksojmë se

ne kurrë nuk mund të lejojmë që Ballkani të kthehet në një fuçi baruti. Ju, aktualisht, me politikën që ndiqni, po përpinqeni të krijoni në Ballkan një situatë në dëm të popujve të kësaj zone, prandaj ata që bëjnë politikën tuaj do të dënohen rëndë nga këta popuj. Ne e kemi deklaruar prej kohësh se do të qëndrojmë kurdoherë në krah të popujve të Jugosllavisë dhe të popullit grek për mbrojtjen e sovranitetit të tyre, në qoftë se këta do të sulmohen nga cilado anë që të jetë.

Të theksojmë më në fund idenë se ne paralajmërojmë të gjithë ata që janë duke u ngatërruar në intrigat e kinezëve kundër popullit shqiptar, se Shqipëria socialiste dhe gjithë shqiptarët, kudo që janë, si një trup i vetëm, do t'i kundërshtojnë ata dhe do të dalin fitimtarë kundër tyre. Sidoqoftë, të gjitha këto janë ide që ne do t'i shohim një nga një me kujdes dhë pastaj do të vendosim se cilat duhen vënë tanë dhe cilat duhen ruajtur për më vonë, se ne nuk duhet t'i hedhim të tëra argumentet tona menjëherë në këtë letër që do t'u dërgojmë.

Lidhur me mendimin që u tha këtu për botimin për publikun e gjerë të librave «Shënime për Kinën» dhe «Imperializmi dhe revolucioni», desha të vë në dukje që në polemikën tonë kundër kinezëve mund të përdoren disa nga materialet që trajtohen në këto dy vepra. Po a duhet të botohen ato tanë? Puna e deritanishme e Partisë sonë ka bërë që Kina të demaskohet. Tani ne hedhim vërtet një hap akoma më përpara për demaskimin e saj, një hap edhe më të

madh, të bazuar në argumente dhe në fakte të padiskutueshme dhe me këtë mënyrë forcojmë pozitat ndërkombëtare dhc revolucionare të Partisë dhe të republikës sonë në botë. Po të flasim që tashti sidomos kundër Mao Ce Dunit, ka akoma shumë njerëz në botë që nuk do të na e kuptojnë dhe nuk do ta vlerësojnë drejt këtë qëndrim tonin. Prandaj, nuk duhet të japim shkas që në opinionin ndërkombëtar të krijojen dyshime mbi qëndrimet e Partisë dhe të popullit tonë dhe njerëzit të thonë: «More, dale, ç'thonë kështu këta shqiptarët për Mao Ce Dunin? Gjithë bota e di që Mao Ce Duni është njeri i dëgjuar për urtësi» etj. Por, kur ne t'i hedhim këto gjëra pak e nga pak dhe gradualisht njerëzit do të binden në drejtësinë e qëndrimeve të Partisë e të popullit tonë, kështu do të forcohen më tej pozitat tona në botë, dhe pastaj vjen natyrshëm edhe momenti për publikimin e këtyre veprave.

Letra jonë flet edhe për Bashkimin Sovjetik e për Evropën, pse Mao Ce Duni ka shprehur mendimin të rishikoheshin kufijtë e të tëra shteteve të Evropës, kurse letra që u dërguam ne kinezëve ia hedh poshtë Maos këtë pikëpamje.

Prandaj, besoj se të gjithë jemi dakord që t'i përgjigjemi notës kineze, me anën e një letre. Deri tani, me sa duket, tendenca e kinezëve është që ata duan ta mbajnë akoma të fshehtë përmbajtjen e saj.

Ramizi më bëri mua një propozim, që më duket i drejtë. Ai mendon që të bëjmë së pari një njoftim

zyrtar për notën që na kanë dërguar kinezët. Edhe unë jam dakord me këtë që mendon Ramizi: t'ia bëjmë të njohur opinionit publik që kinezët na kanë dërguar një notë, me të cilën na lajmërojnë në mënyrë të njëanshme se i prenë ndihmat ekonomike dhe ushtarake për vendin tonë dhe do të tërheqin të gjithë specialistët. Të theksohet në këtë njoftim që për të gjitha këto, edhe ne do të marrim masat përkatëse. Ky njoftim të jepet nëpërmjet ATSH-së, mendoj unë. Pastaj, më vonë, mund të bëhet edhe nëpërmjet Qeverisë, kur të dorëzojmë letrën nga ana e Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme.

Unë jam dakord edhe me propozimin tjelër që të bëjmë një letër për të informuar Partinë për këto çështje, por jo të gjatë, një letër koncize, se Partia është në dijeni të këtyre zhvillimeve. Tani doj problemi i detyrave që na dalin për të kryer në këto situata të reja që po krijohen.

Ne do ta kapërcejmë këtë situatë të vështirë, shokë, ashtu siç kemi kapërcyer situata të tjera edhe më të vështira, kur ishim akoma të dobët gati në törë sektorët. Kurse tani jemi shumë më të fortë, mbasi Partinë, në radhë të parë, e kemi të fortë dhe në unitet të çeliktë me popullin në të gjitha drejtimet; se ne vazhdimisht qëndrojmë vigjilentë dhe mbrojtja janë vjen e forcohet gjithnjë më shumë; ekonomia jonë ka ecur, po ecën dhe jemi të bindur se do të ecë edhe më mirë akoma në të ardhmen. Por, sigurisht, këto situata janë të vështira, të cilat duhet t'i vlerësojmë

realisht dhe të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i kaperçyer me sukses.

Atëherë mbaruam!

Të na rrojë Partia!

Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## LE TË HAPIM DEFTERËT!

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokun Ramiz Alia*

**13 korrik 1978**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të thirra të bisedojmë lidhur me përgjigjen që do t'u bëjmë kinczëve. Ndonjë mendim për këtë çështje.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Unë, shoku Enver, kam përgatitur disa teza lidhur me letrën që do t'u bëjmë atyre. Ja, po jua lexoj!

*Pasi shoku Ramiz Alia leroi tezat e përgatitura, e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të gjitha këto që lexove, Ramiz, duhet të futen në notë, kështu siç janë, dhe unë i vlerësoj ato si shumë të mira. Nuk ka si të bëhen më mirë.

Atje ku flitet për luftën kundër revizionizmit, të vihet theksi që lufta jonë kundër revizionizmit modern filloj që pas vdekjes së Stalinit dhe shkoi duke u ngjitur, duke kundërshtuar veprimet antimarksiste e re-

---

1. Kjo bisedë u zhvillua në Durrës, ku shoku Enver Hoxha ishte duke kaluar pushimet.

visioniste të Hrushovit dhe të bandës së tij, si në politikën e jashtme, ashtu edhe në marrëdhëni me partitë, vëçanërisht me Partinë tonë.

Të vëmë në dukje se Hrushovi bëri kauzë të përbashkët me renegatët titistë. Për këtë Partia e Punës e Shqipërisë jo vetëm nuk ishte dakord, por edhe e luftoi vijën e Hrushovit. Dokumentet vërtetojnë se edhe Partia Komuniste e Kinës në atë kohë, pa qenë e ndikuar nga askush, e dënoi rehabilitimin e Titos nga ana e Hrushovit.

Pastaj erdhi Mbledhja e Bukureshtit. Atje u vërtetua edhe një herë e më mirë vija tradhtare e Hrushovit dhe e hrushovianëve. Ata jo vetëm sulmuani marksizëm-leninizmin dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, por filluan sulmin edhe kundër Partisë Komuniste të Kinës. Partia e Punës e Shqipërisë menjëherë i erdhi në ndihmë Partisë Komuniste të Kinës, e mbrojti atë deri në fund, duke menduar dhe duke qenë e bindur se mbronte kështu marksizëm-leninizmin.

Partia jonë, në vitin 1960, kur luftonte dhëmb për dhëmb me hrushovianët, konstatoi se udhëheqja kineze nuk ishte në pozita aq të vendosura antihrushoviane dhe tregonte lëkundje. Udhëheqja kineze ecte drejt pajtimit dhe shuarjes së polemikës me hrushovianët. Qenia dakord me Shqipërinë për këtë problem duket që ishte e sipërfaqshme. Këtë e vërteton fjalimi i Çu En Lait në Kongresin e 22-të të PK të BS, ku ai nuk mbrojti Partinë tonë, por bëri thirrje për shuarjen e polemikës. Kjo u quajt nga udhëheqja kineze si një ndihmë për Shqipërinë, kur, në fakt, me këtë ajo kër-

konte, shuarjen e polcmikës me revizionistët hrushovianë.

Ky qëndrim vinte nga disa qëllime dhe objektiva që synonte të arrinte politika kineze ndaj hrushovianëve, me të cilët pas vdekjes së Stalinit kishte ardhur në ujdi. Kjo politikë e ujdisë dokumentohet nga mbledhjet ndërkombe të partive marksiste-leniniste që janë mbajtur, ku ka asistuar personalisht Mao Ce Duni. (Këto fakte të vihen në dukje qartë, duke evituar frazat e tepërtat.)

Pas kësaj ideje të vihen shënimet nga materialet e përgatitura që kanë të bëjnë me kontradiktat që lindën midis dy partive tona në vitin 1962 në Pekin, ku ishit ti dhe Hysniu.

Në qershori 1962, të thuhet në lctër, shoku Hysni dhe shoku Ramiz u dërguan në Kinë për bisedime me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Atje këta u ndeshën me udhëheqësit kinezë për një çështje themelore. Liu Shao Çia, Çu En Lai dhe Ten Hsiao Pini shtruan me forcë nevojën e krijimit të një fronti unik bashkë me revizionistët hrushovianë kundër imperializmit amerikan. Pra ata donin të pajtoheshin me sovjetikët. Ten Hsiao Pini hapur na tha: «Eshtë e pamundur që Hrushovi ta ndryshojë veten e të bëhet si Titoja... Bashkimi Sovjetik kurrë nuk mund të ndryshojë si vend socialist».

Edhe Çu En Lai deklaroi: «Bashkimi Sovjetik nuk mund të kthehet në kapitalizëm në rrugë paqësore».

Duke zbatuar direktivat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokët Hysni e Ramiz kundërshtuan këto pikëpamje të kinezëve, argumentu-

an qëndrimin parimor të Partisë sonë, që si moto kishte idenë e Leninit, se nuk mund të luftohet me sukses imperializmi pa luftuar në të njëjtën kohë edhe oportunizmin, i cili atëherë përfaqësohej nga klikat hrushoviane e titiste.

Duhet thënë se për t'ia imponuar Partisë sonë këtë vijë antimarksiste Çu En Lai përdori dhe presionet ekonomike. Por nuk patën sukses. Komiteti Qendror i Partisë sonë qëndroi i patundur në pozitat e tij të drejta marksiste-leniniste.

Më vonë, kur strategjia e udhëheqjes kineze për atrim me hrushovianët, për shumë arsyë që dihen, si mosmarrëveshjet për bombën atomike etj., dhe për të cilat do të kemi rast të flasim më vonë, nuk jepte më rezultate, udhëheqja kineze hyri në rrugën e antihrušovizmit dhe u puq me luftën e vendosur, konsekutive e të palëkundur të Partisë së Punës të Shqipërisë. (Këtu mund të futen citatet e Maos që lexove ti lidhur me ndihmën që i ka dhënë Shqipëria Kinës.)

Ne duhet të themi në këtë material se lufta politike dhe ideologjike e Partisë Komuniste të Kinës në akord me luftën e pandërprerë kundër hrushovianëve nga Partia e Punës e Shqipërisë nuk ishte në baza të shëndosha të mbrojtjes së marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit. Kjo u duk në ndryshimin rrënjosor të strategjisë dhe të taktilikave të Partisë Komuniste të Kinës dhe të qeverisë kineze në arenën ndërkombëtare. Ky ndryshim u bë në kuadrin e një lufte të brendshme në gjirin e Partisë Komuniste të Kinës, ku ekzistonin kontradikta të thella dhe «lulëzonin njëqind lule» e «konkurronin njëqind shkolla» dhe në udhëheqje

ekzistonin, gjithashtu, si elementë prohrushovianë, ashtu edhe proamerikanë e më së fundi edhe revolucionarë.

Ne e mbështetëm Revolucionin Kulturor kinez me kërkesën e Mao Ce Dunit, i cili konkretisht i njoftoi Partisë sonë se Kina gjendej përpara një rreziku kolossal, kur nuk dihej se kush do të fitonte, socializmi apo kapitalizmi. Partia e Punës e Shqipërisë e ndihmoi Kinën dhe mbështeti vijën e përgjithshme të Revolucionit Kulturor, pavarësisht se nuk ishte dakord me shumë çështje parimore dhe me metodat që u përdorën dhe udhëhoqën këtë revolucion. Duke e mbështetur Revolucionin Kulturor, Partia jonë kishte shpresë se ky do të ishte një luftë e vërtetë revolucionare e udhëhequr nga proletariati kinez dhe nga pararoja e tij, Partia Komuniste. Por ne konstatuam se ky Revolucion Kulturor përfundoi me vendosjen në Kinë të një pushteti reaksionar, antimarksist dhe antisocialist.

Partia jonë nuk ka ndërhyrë kurrë në çështjet e brendshme të Kinës, kurse udhëheqja kineze në disa momente të caktuara, që në kohën e duhur ne do t'i nxjerrim haptazi në dritën e diellit, ka ndërhyrë në mënyrë kriminale në punët e brendshme të Shqipërisë. Po të realizoheshin këto veprime të dënueshme në bashkëpunim dhe me tradhtarët shqiptarë, do të likuidohet me siguri Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, pavarësia dhe sovraniteti i saj.

Ne, nga ana jonë, as nuk i kemi mbrojtur, as nuk i kemi sharë gjithë ato personalitete që kanë vepruar gjatë gjithë kësaj periudhe të turbullt që ka ekzistuar

në Kinë. Udhëheqja kineze nuk mund të sjellë asnje argument të kundërt me sa thamë më lart. Ne kemi pasur dhe kemi mendimet tonë, por për interes të popullit kinez ato ne nuk i kemi shprehur publikisht. Kurdoherë ne kemi ruajtur gjakftohtësinë që të mos ndërhynim në punët e brendshme të Kinës, por çështjet e saj të zgjidheshin nga vetë populli kinez dhe Partia Komuniste e Kinës në rrugën e revolucionit të vërtetë proletar.

Një nga arsyet e njëdha politike dhe ideologjike të papohuara, por që e kanë shtyrë udhëheqjen kineze t'i presë ndihmën Shqipërisë, është se ajo ka dashur që ne të mbështetnim veprimtarinë e saj ilegale, jo në rrugë marksiste, por në rrugë puçiste, të mbështetnim veprimet që ajo ndërmori. Ne as nuk ia përbushëm dhe as nuk do t'i përbushim udhëheqjes kineze këtë dëshirë, por mendimet tonë, në kohën e duhur, do t'i shfaqim. Edhe kjo, është një ide që duhet të vihet në materialin që do të përgatitim.

Tani të flasim pak edhe për çështjen e kufijve.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Patjetër që do të flasim në materialin tonë edhe për këtë problem, por shkurtimisht.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet të theksojmë se ne e kritikuam qëndrimin e Maos për çështjen e kufijve, për arsyen se rishikimi i kufijve pas Luftës së Dytë Botërore kishte karakter shovinist të shtetit të madh, të nacionalizmit borgjez dhe të nxitjes së luftërave në Evropë për ndryshimin e kufijve të vendosur pas fitores së koalicionit të madh antifashist të popujve mbi fashizmin. Ky ishte njëkohësisht edhe një

sulm kundër Josif Visarionoviç Stalinit, sulm që pukej plotësisht me pikëpamjet e Titos që mbështeste akuzat kundër Stalinit për «sferat e influencës», por që vetë Titoja dhe klika e tij u treguan se ishin me të vërtetë elementë antimarksistë, njerëz me ndjenja të theksuara shoviniste e ekspansioniste mbi popujt e tjerë. (Këtë ta themi si ide, se të tëra këto nuk do të vihen në letrën tonë, por t'i themi si mendim që mund të ngjallin interesim tek të tjerët.) Maoja ka folur edhe për kufijtë e disa vendeve të Evropës.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, po, ka folur, këtë e kam të shkruar këtu në referatin që kam mbajtur me kuadrot politikë të aparatit të Komitetit Qendror.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ideja është shumë e mirë, por duhet të pasurohet edhe me gjithë këto faktet e tjera. Ne do të përmendim edhe çështjen e rënieve së Hrushovit.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, edhe për këtë çështje do të flasim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të flasim për armikun e përbashkët dhe ky armik ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës; të vihen në material arsyetimet e Çu En Lait lidhur me këtë problem. Pastaj të flitet për vizitën e Niksonit në Kinë.

Kur të flasim për ndihmat në të kaluarën, të vëmë në dukje se ne kemi luftuar kaq vjet me radhë kundër të gjithëve, kundër imperializmit amerikan dhe reaksionit për pranimin e Kinës në OKB dhe ia arritëm qëllimit.

Kur të flasim për çështjen e «tri botëve», duhet të shtrohet se si Partia jonë, ashtu edhe Partia Ko-

muniste e Kinës, kanë pasur si parim të tyre dhe janë shprehur se nuk ekziston parti mëmë dhe parti bijë, se çdo parti ka të drejtën të ketë pikëpamjet e saj për të gjitha problemet, se një parti quhet me të vërtetë marksiste-leniniste kur këto probleme i shikon në prizmin e marksizëm-leninizmit. Ne kemi konstatuar se gjykinet e çështjeve ndërkontaktore nga ana e Partisë Komuniste të Kinës dhe e qeverisë së Kinës në shumicën e rasteve nuk janë parë në prizmin e marksizëm-leninizmit, në interes të revolucionit dhe të luftrave nacionalçlirimtare të popujve.

Politika kineze ka qenë një politikë pragmatiste, prandaj nuk ka se si të ishte ndryshe edhe strategjia dhe taktika kineze. Për këtë arsyе ne shikojmë dhe do të shikojmë edhe në të ardhmen ndryshimin prej 180 gradësh në strategjinë kineze. Këto kthesa gjoja kanë qenë marksiste-leniniste, por në realitet janë kthesa që i shërbijnë interesit të shtetit të madh kinez në kërkim të aleancave me imperializmin amerikan, me socialimperializmin dhe me kapitalin botëror për krijimin e ngritjen e Kinës si një fuqi e madhe.

Të marrim çështjen e teorisë së «tri botëve». Nga ana e udhëheqjes, e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, afirmohet se është Mao Ce Duni ai që e ka nxjerrë këtë teori nga një analizë gjoja objektive e situatave ndërkontaktore. Por gjithë bota e di, dhe Partia e Punës e Shqipërisë po ashtu e di, se teoria e «tri botëve», ose siç quhet «tiers monde», është një term i krijuar nga borgjezia ndërkontaktore. Këtë teori të «botës së tretë» Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e kanë demaskuar dhe e kanë

luftuar në arenën ndërkombëtare dhe nëpër mbledhje ndërkombëtare si një teori borgjezo-kapitaliste, neokolonialiste dhe raciste. Pra nuk është Partia e Punës e Shqipërisë që sulmon shpikësit ose mbrojtësit e këtyre teorive, por janë pikërisht këta që e kanë sulmuar më parë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe luftën e saj kundër kësaj teorie reaksionare.

Çështja tjetër është se as Partia e Punës e Shqipërisë, as Partia Komuniste e Kinës nuk mund të marrin urdhra dhe direktiva nga kurrikush se çfarë do të shtrojnë dhe si do t'i shtrojnë pikëpamjet e tyre në kongreset që bëjnë. Këtë bëri edhe Partia e Punës e Shqipërisë në Kongresin e saj të 7-të. Kjo ishte një rrugë logjike marksiste-leniniste, absolutisht e domosdoshme. Teoricienët e «tri botëve» luftojnë revolucionin, zhdukin luftën e klasave etj., etj. (Kjo duhet thënë sa për ta konkretizuar.)

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Këtu ka një gjë, shoku Enver. Kur flasim aktualisht për teorinë e «tri botëve» nënkuptohet teoria dhe strategjia kineze e alcancave etj. Kurse termi «botë e tretë» ka qenë i shpikur dhe i përdorur kohë më përpara nga amerikanët e sovjetikët. Tani po përdoret edhe nga kinezët, të eilët shkojnë akoma më tej.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, po, Kina bën gabimin e madh që sajon pajtimin e kësaj «bote» me imperializmin. Këtë teori të tyre e dënojnë të gjithë, domethënë kinezët nuk zbuluan gjë të re, përkundrazi, sajuan akoma më keq aleancën e kësaj bote me imperializmin amerikan, për të ndjellë ndihmën e imperializmit amerikan dhe për t'u bërë një fuqi e madhe ka-

pitaliste. (Këtu duhen gjetur terma e argumente dhe të mos tjerrim fraza, por të japim disa mendime. Kështu bën përshtypje më të mirë edhe në opinionin publik botëror.)

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, po, që kinezët të mos kenë nga të luajnë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Për Titon do t'u themi gjë?

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, do t'u themi që, më përpara, ju ishit kundër tij, po pastaj u bashkuat me të. Pse u bashkuat, është puna juaj, por një gjë të keni parasysh që me të u bashkua edhe Hrushovi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Bashkimi juaj aktual me Titon, të thuhet, përmban në vetvete një rrezikshmëri të madhe për popujt e Ballkanit, për popujt e Jugosllavisë, për popullin shqiptar, grek dhe atë turk. Kësaj çështjeje, mund të shënojmë, ne do t'i rikthehem i më vonë. Kështu që ua lëmë edhe këtë në derë se për çështje të tilla do të shkruajmë artikuj të vëçantë, bile edhe Titoja do të thotë: Çfarë na bëtë, tani, shqiptarët do të ngrenë boritë për alcancat që kurdisnim në Ballkan.

Duhet gjetur, gjithashtu, një vend ku të flitet edhe për Tregun e Përbashkët Evropian, edhe për NATO-n etj.

Mund të thuhet edhe kjo ide: Ju treguat shumë mirë se duke i prerë ndihmat Shqipërisë, do të thotë se nuk jeni dakord ideologjikisht me Shqipërinë, por, duke marrë ndihma dhe kredi të shumta nga imperializmi amerikan, nga kapitalizmi botëror dhe duke u akorduar ndihma agjentëve të tyre, si Mobutu me sho-

kë, po vërtetoni se jeni dakord me ta, kundër një vendi socialist dhe kundër të gjitha vendeve e popujve që kërkojnë çlirimin pikërisht nga imperializmi dhe nga socialimperializmi.

Në notën kineze ka një aluzion se ne, shqiptarët, veprojmë kundër Kinës për interesat e politikës sonë të brendshme dhe të jashëme.

Ne duhet të themi se një gjë e tillë tregon shpirtin intrigant të udhëheqjes kineze dhe dëshirën e saj që ta shikojë Shqipërinë të robëruar politikisht, ideo-logjikisht dhe ekonomikisht nga socialimperializmi sovjetic ose imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare. Ju flitni kështu se mendoni që Shqipëria qenka e izoluar, që ajo merrte fryshtë e rronte në sajë të ndihmës suaj dhe tani paska mbetur në mes të rrugës e do të bjerë si një gjah në pritën e imperialistëve dhe të socialimperialistëve. Ju kujtojmë me këtë rast se çfarë kanë thënë dikur Hrushovi dhe Mikojani që ne do të shiteshim për «tridhjetë aspra», që ne «do të vdisnim për bukë», pas 15 ditësh, pa ndihmat sovjetike.

Por jeta tregoi se Shqipëria eci përpara me sukses të madh në ndërlimin e socializmit. Dhe kjo u bë jo në sajë të ndihmës suaj, të cilën e njohim, por në sajë të punës dhe të luftës së madhe të popullit tonë. Ndiham juaj në gjithë investimet e ekonomisë sonë përfaqëson vetëm një përqindje fare të vogël. Ne ju themi juve dhe gjithë botës se Shqipëria kurrë nuk dorëzohet te kurrikush, se ajo do të qëndrojë dëri në fund armike e betuar e imperializmit, e socialimperializmit dhe e borgjezisë reaksionare botërore. As kurrizin, as

kokën nuk i ka ulur kurrë Shqipëria, as në të kaluarën, as sot dhe as në të ardhmen nuk do t'i ulë. Ne ju themi se ju do të dështon si në predikimet, ashtu edhe në intrigat tuaja, se do të dështon, si ju, ashtu edhe të gjithë armiqjtë tanë. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë do t'u tregojnë miqve dhe popujve forcën e marksizëm-lininizmit, forcën e socializmit, forcën e revolucionit.

Në luftën tonë ne do të kemi ndihmën e popujve, prandaj nuk jemi aspak të izoluar dhe do të ndërtojmë të gjitha çfarë kemi vendosur, bile edhe më tepër do të bëjmë, sepse kemi ndihmën internacionaliste të revolucionarëve të vërtetë dhe të popujve liridashës. (Në këtë pjesë duhet të jetë edhe kjo ide.)

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, po, do ta futim, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë mund të themi këtu tjetër? Sigurisht, do të flasim edhe për çështjen e Ballkanit, me pak fjalë. Citatet që ke ti, Ramiz, janë shumë, shumë të mira, prandaj duhen përdorur.

Për ndihmat do të themi se ju paraqitni shifra, por këto janë për të impresionuar opinionin e brendshëm kinez dhe atë ndërkombëtar, se gjoja i keni akorduar Shqipërisë një ndihmë të madhe dhe, pra, Shqipëria është mosmirënjoshe për një gjë të tillë. Por këta miliarda juanë, që ju i shënoni në notë, janë llogaritur në mënyrë të njëanshme dhe sipas dëshirës suaj.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ja se ç'tuhet shprehimi misht për çmimet në marrëveshjen e qershorit të vitit 1963, të nënshkruar midis dy vendeve: «Çmimet e veprave të plota, të makinerive e pajisjeve të veçuara,

të materialeve të ndryshme dhe materialeve të tjera të ndërtimit, që do t'i jepen nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë... vendosen në marrëveshjen ndërmjet palëve në përputhje me parimin e vendosjes së çmimave për tregtinë ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ai citat, Ramiz, të vihet i tërë në letrën tonë. Pasi të shkruhet ai, të thuhet që ata miliarda juanë që Kina i ka akorduar Shqipërisë gjatë një çerek shekulli, domethënë, që nga viti 1954, kanë nevojë që të shqyrtohen. Ne themi se ju jeni shpejtuar që e keni vënë atë shifër për t'u shërbuer qëllimeve tuaja të mësipërme. E vërteta mbi këto shifra do të dalë më vonë dhe do të bëhet publike me arsyetimet tona të bazuara në çmimet ndërkombe të.

Nga ana tjetër, t'u vihet në dukje se ju thoni që na keni dërguar në Shqipëri 6 000 specialistë. Këta 6 000 specialistë, do të theksojmë ne, janë dërguar për 25 vjet. Edhe paraqitja e kësaj shifre ndjek disa qëllime të dënueshme.

E para, numri i specialistëve nuk është ekzakt, por ai numër mund të arrihet në rast se do të futim edhe pjesëmarrësit në skuadrat e futbollit, apo edhe të pingpongut që kanë ardhur nga Kina në Shqipëri. (I them këto si ide, pastaj t'i shikojmë nëse do t'i vëmë, apo jo.)

E dyta, kjo bëhet për të thënë se gjoja shqiptarët ishin krejtësisht në mëshirën e këtyre 6 000 specialistëve kinezë, kurse në ndërtimin e veprave kanë pu-

nuar kaq e kaq specialistë dhe inxhinierë shqiptarë dhe me dhjetëra mijë teknikë të mesëm, pa punën e të cilëve nuk mund të ndërloheshin këto vepra.

Për sa u përket specialistëve të bujqësisë, kinezët nuk kanë dërguar asnje të tillë në vendin tonë.

E treta, ju harroni të thoni se këta specialistë janë paguar për punën e tyre në mënyrë të kënaqshme me djersën e popullit shqiptar, gjë që ju nuk e përmendni, por nuk mungoni të përmendni se keni harxuar 100 milionë juanë për të bërë eksperimente për hckurin shqiptar.

Këto ndihma, janë kredi të dhëna në bazë të rregullave, të marrëveshjeve e të detyrimeve të dyanshme, pasi të bëhen llogaritë, ç'ju kemi dhe ç'na keni do të paguhen. (Kjo do të jetë ideja.) Pra nuk kemi të bëjmë me lëmosha të dhëna si mëshirë kristiane, por me një ndihmë me kredi që ne mendonim se na jepej në frymë internacionliste nga një shtet socialist. Sigurisht, llogaritë do të bëhen duke pasur parasysh edhe humbjet e mëdha që i kanë shkaktuar kinezët ekonomisë sonë, duke mos i realizuar detyrimet e tyre në kohën e caktuar në marrëveshje, duke lënë një pjesë të rëndësishme të objekteve në mes, duke dërguar edhe pajisje të vjetra të përdorura për objekte të ndryshme. Pasi të llogariten të gjitha këto, atëherë do të shohim se kush në të vërtetë i ka borxhe njëri-tjetrit.

Unë mendoj se nuk kemi çfarë t'u themi tjetër hëpërhë, puna është se si të gjejmë formën e rrjedhshme e të përshtatshme për t'i shprehur gjithë këto ide që thamë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Do të bisedojmë, ashtu siç thamë, edhe në mbledhjen e Byrosë Politike dhe do të bëjmë një përbledhje të tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** As fraza, as propagandë të mos ketë në letrën tonë; ato që do të vendosim të themi, të jenë të hidhura për revizionistët kinezë, të jenë demaskuese për ta dhe shpresëdhënëse për popujt revolucionarë. Me këtë letër që do t'i përgjigjemi udhëheqjes kineze, ne vetëm sa hapim defterin; këto që do të themi tani do të jenë titujt e kaptitjve që do të shkruajmë më vonë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Nota e tyre ishte 9 faqe. Përgjigjja jonë do të jetë më e gjatë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Le të bëhet e gjatë, vetëm të mos ketë fraza. Mendimet tona të jenë preçize, të qarta dhe të organizuara në mënyrë që çdo gjë të vijë kreshendo.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Për sa u përket fakteve ekonomike, në notën e tyre, ka gjëra që janë absurde, por mendoj të marrim disa prej tyre. Të vëmë ndonjë fakt, shoku Enver, për të treguar që ishin ata që i prenë në mënyrë të njëanshme marrëdhëni.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne duhet t'i hedhim poshtë në bllok «argumentet» ekonomike të tyre e t'u themi: ato që vini ju në notë, për të ilustruar prerjen e ndihmave, janë pa baza, se nuk gjeni arsyet tjetër, ose nuk guxoni t'u futeni arsyeve të vërteta. Kurse e vërteta është ndryshe dhe ne në momentin e duhur do të botojmë të gjitha dokumentet që ju kemi dorëzuar për këto çështje. Midis dy partnerëve, midis dy shteteve, diskutime për çështje konkrete ekonomike

mund të lindin dhe duhet të bëhen, bile është e nevojshme që të bëhen. Ndërsa ju nuk e ndienit të nevojshme ta bënët këtë për arsyen se donit të na impononit mendimet tuaja. Ju si shtet i madh, kërkesën për diskutime e konsideroni si ultimatum. (Duhet të marrim ca gjëra si këto nga nota e tyre.)

Mua më duket se përgjigja jonë udhëheqjes kineze duhet t'i vejë nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Qeveria, se ne nuk mund të flasim për këto probleme që diskutuam duke e bërë letrën vetëm në rrugën qeveritare. Ne do të themi që ju i keni drejtar Qeverisë sonë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme një notë, në të cilën ju jeni përpjekur të kufizoheni në probleme ekonomike, sepse dëshironi të fshihni të vërtetët që përbëhet nga arsyen të mëdha politike dhe ideologjike. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Qeveria jonë i drejtojnë letrën e mëposhtme Komitetit Qendror të Partisë dhe qeverisë suaj. Ky dokument të mos vishet me etiketa diplomatike, por të jetë me përbajtje të thellë dhe i drejtpërdrejtë.

Më duket se të mbajta shumë, Ramiz. Por mendova se ne të dy duhet të thelloheshim më shumë në këto gjëra që duhet të vëmë këtu, në letrën që do t'i drejtojmë udhëheqjes së partisë dhe të qeverisë kineze, në përgjigje të asaj që na bënë. Mendova që me ty, Ramiz, mund të bisedonim se çfarë duhet të vëmë në këtë përgjigje.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Unë do t'i hedh menjëherë në një material të vetëm këto që kemi nxjerrë së bashku.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Një kopje të këtij ma-

teriali të ma dërgosh edhe mua këtu, se mundet, duke e lexuar atë, të më vijë ndonjë ide e re. Të më dërgosh edhe një kopje nga materiali yt që ke këtu, se citatet dhe argumentimi ishin shumë të mira. Të më dërgosh edhe një kopje me tezat që ke përgatitur, të cilat m'i lexove sot.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Pra, me të gjitha këto, do të përgatit një material mbi të cilin do të punojmë më tej.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, po, ma dërgo edhe mua një kopje të këtij materiali, pse, siç thashë, duke e lexuar atë mund të më vijë ndonjë ide, mund të më kujtohet diçka tjetër, dhe ndonjë gjë që e kemi thënë tanë mund të mos e vëmë në letër këtë herë, por ta lëmë për një herë tjetër.

*Botohet për herë të parë si-  
pas shënimeve të mbajtura në  
këtë takim, që gjenden  
në AQP*

## **LETRA JONE TREGON ARSYET E VĒRTETA TË NOTËS KINEZE**

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokun Ramiz Alia*

**25 korrik 1978**

Letrën, që është përgatitur për udhëheqjen revizioniste kineze në përgjigje të notës që na bënë, e lexova, por të thirra të diskutonim edhe një herë rrëth saj, para se t'i paraqitet Byrosë Politike dhe Qeverisë për diskutim e miratim.

Ajo është përgatitur mirë. Në të ka dalë qartë se janë arsyet politike dhe ideologjike ato që i detyruan revisionistët kinezë të ndërmarrin këtë veprim ndaj nesh. Prandaj, jam dakord me Letrën.

Në tekstin e saj kam bërë disa vërejtje, të cilat po i them tani. Atje ku flitet për mbledhjet e Bukureshtit dhe të Moskës, mendoj të shtojmë edhe datat se kur janë zhvilluar ato. Po kështu mund ta saktësojmë e të plotësojmë më mirë pjesën për pranimin e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Lidhur me ndih-

---

1. Kjo bisedë u zhvillua në Pogradec, ku shoku Enver Hoxha ishte duke kaluar pushimet.

mën që i ka dhënë Kina Shqipërisë, mendoj të shmanqim një përsëritje dhe të hyjmë drejt e në problem.

Atje ku bëhet fjalë për kreditë kineze të përdomrura deri në fund të vitit 1977 nga Shqipëria, të theksohet se ato, në raport me të ardhurat kombëtare, përfaqësonin një përqindje fare të vogël.

Disa faqe më tej, kam shtuar diçka për ta karakterizuar sa më mirë Revolucionin Kulturor, për arsy se ashtu siç jepej dilte shumë thjesht dhe nuk pasqyrohej si duhet kjo çështje. Të thuhet se gjithë periudha e Revolucionit të madh Kulturor ishte një periudhë shumë e vështirë për socializmin në Kinë dhe krijoj një gjendje të koklavitur dhe kaotike. Kjo gjendje ishte rezultati logjik i luftërave fraksioniste joparimore që zhvilloheshin në Partinë Komuniste të Kinës gjatë periudhës së luftës për zhvillimin e revolucionit demokratiko-borgjez dhe, pas vitit 1949, për rrugën që do të ndiqte Kina në zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* E drejtë, shoku Enver. Është fjalë që të dalin në pah luftërat e brendshme joparimore. Për këtë, mendoj se mos është më mirë të thuhet që «...ishte rezultat i luftërave joparimore në gjirin e partisë».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më poshtë, mendoj të vëmë në dukje se idetë e mëdha të Revolucionit të Madh Socialist të Tectorit dhe ideologjia marksiste-leniniste nuk u bënë si duhet shembulli, boshti dhe busulla e Partisë Komuniste të Kinës në kushtet konkrete të Kinës. Kjo bëri që edhe ajo bërthamë e vërtetë marksiste-leniniste e partisë të zhytej në një eklekti-

zëm të rrezikshëm që i dha shkas një kaosi të papërmbajtur lufte fraksionesh, personash dhe grupesh me pikëpamje të shumëllojta jomarksisteleniniste për pushtet, gjë që pengoi seriozisht ndërtimin e themeleve të socializmit në Kinë. Ky kaos politiko-ideologjik dhe organizativ i Partisë Komuniste të Kinës dhe i shtetit kinez bëri që elementë kapitalistë e revisionistë të shtinin në dorë pozitat kyç në parti, në pushtet dhe në ushtri. Në këto kushte shpërtheu Revolucioni Kulturor, i frysmezuar dhe i udhëhequr nga vetë Mao Ce Duni.

Partia e Punës e Shqipërisë mbështeti në përgjithësi strategjinë e këtij revolucioni dhe jo çdo taktkë të tij; ajo mbrojti me vendosmëri çështjen e socializmit në Kinë, mbrojti popullin vëlla kinez, Partinë Komuniste të Kinës e revolucionin dhe nuk mbrojti aspak luftën fraksioniste të grupeve antimarksiste, cilëtdo që të ishin ata, që përplaseshin dhe përllesheshin deri edhe me armë në mes tyre, në mënyrë të hapët ose të maskuar, për të rimarrë fuqinë.

Revolucioni Kulturor, në më të shumtën e herës, ruajti frysën dhe veprimet e një lufte joparimore, jo të udhëhequr nga një parti e vërtetë e klasës punëtore që të luftonte për vendosjen e diktaturës së proletariatit. Këto përlleshje midis grupeve fraksioniste në Kinë përfunduan kështu me vendosjen e një pushteti të sunduar nga elementë borgjezë dhe revisionistë.

Këtu të shtojmë gjithashtu se udhëheqja aktuale kineze ka dashur dhe do që tani Partia e Punës e Shqipërisë të dënojë Revolucionin Kulturor sipas dëshirës dhe arsyeve të saj. Partia e Punës e Shqipërisë kurrë

nuk do ta pranojë një diktat të tillë. Ajo dhe gjithë revolucionarët e botës presin që Partia Komuniste e Kinës të bëjë analizën e vërtetë të këtij Revolucioni Kulturor; të ketë guximin të thotë të vërtetën për idetë që e udhëhoqën këtë revolucion, për grupet dhe njerëzit që e zhvilluan dhe e udhëhoqën atë; për ata kundër të cilëve u drejtua ky revolucion dhe të mbajë qëndrime të qarta për këto çështje. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, të thuhet në Letër, deri sot s'e ka bërë një gjë të tillë, se ajo u trembet fakteve, ndodhive dhe interpretimit të vërtetë marksist-leninist të tyre.

Po ju lexoj tani atë pjesë që kam shtuar lidhur me marrëdhëniet e Kinës me vendet e tjera, si dhe me dëshirën e shprehur nga ana jonë, që ajo të ishte më aktive në politikën e jashtme: «Por udhëheqja kineze nuk e gjeti të arsyeshme këtë dëshirë të Shqipërisë dhe preferoi izolimin e vet, duke u nxjerrë pretekste të ndryshme të gjithë atyre shteteve që shfaqnin dëshirën të vendosnin marrëdhënie me të».

Kur tū trajtohet problemi se çfarë i ka thënë Çu En Lai Beqir Ballukut për mbrojtjen e vendit tonë, mendoj të theksojmë, ndër të tjera, që Beqir Balluku gjoja e dënoi dhe e kundërshtoi këtë propozim të Çu En Lait. Konkretisht, e kam formuluar kështu:

«Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë e dënoi dhe e hodhi poshtë njëzëri propozimin antishqiptar dhe kundërrevolucionar të Çu En Lait; Beqir Balluku, që u bashkua formalisht me vendimin e Byrosë Politike, shtoi se gjoja ai e kishte kundërshtuar propozimin e Çu En Lait, por faktet dhe ngjar-

jet e mëvonshme vërtetuan se Beqir Balluku, në realitet, kishte qenë plotësisht dakord me propozimin e udhëheqjes kineze dhe veproi në fshehtësi për të realizuar këtë plan strategjik armiqësor kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë».

Për sa i përket vizitës së Niksonit në Kinë, kam bërë këtë shësë:

«Kjo aleancë dhe ky takim në Pekin midis udhëheqjes kineze dhe presidentit amerikan Nixon, bëhej në një kohë kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvillonin luftën e tyre imperialiste grabitqare në Vietnam; kur ato po përdornin të gjitha mjetet më moderne ushtarake, me përjashtim vetëm të bombës atomike, për të vrarë popullin vëlla heroik vietnamez dhe për ta bërë shkrumb e hi Vietnamin. Kjo aleancë e përbindshme dhe takimi kino-amerikan ishin veprime të dënueshme dhe me rrjedhime katastrofike për popujt».

Në fund të pjesës që flet për afrimin e tyre me disa shtete të Ballkanit, kam shtuar: «Prandaj popujt e botës duhet të jenë vigjilentë ndaj intrigave kineze në këtë zonë».

Kaq kisha unë, pak a shumë.

Mua më duket, siç e thashë dhe në fillim, se është bërë një punë e mirë për këtë Letër që ne do t'u drejtjmë revizionistëve kinezë. Mund të përgatitim edhe ndonjë variant të shkurtuar për agjencitë e huaja, sepse ato vetë na e kanë kërkuar një gjë të tillë kur kemi pasur materiale të gjata e të rëndësishme, se ata mund të mos jenë të interesuar që ta lexojnë të gjithë. Është mirë që këtë punë ta bëjë ATSH-ja.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, po, shoku Enver, do ta përgatitim një variant të tillë.

Mendojmë që përgjigjen tonë ta botojmë të dielën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dakord, të dielën të btohet. Ajo të kctë titullin: «Letër». Kinczët mund të mos e pranojnë Letrën kur t'ua dorëzojë ministri ynë i Punëve të Jashtme, ose mund të kërkojnë që t'u lexohet. Mirë, atëherë le t'ia lexojnë. Kinezët mund ta bëjnë këtë për të na ngrënë kohë, por, pavarësisht nga kjo, ne do të bëjmë punën tonë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ashtu është, shoku Enver, le të thonë çfarë të duan ata, ne do të bëjmë punën tonë. Bile, edhe sikur të mos e pranojnë Letrën, ne do ta botojmë atë të diclën në shtyp.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, ta botojmë dhe do ta transmetojmë me anën e ATSH-së për botën e jashtme.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ne do të botojmë edhe notën kineze.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, ashtu bëni!

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Në mbledhjen e fundit të Byrosë Politike ne thamë që t'u bëjmë një letër organizatave të Partisë lidhur me këtë situatë. Por tani, duke botuar këto dokumente, më duket se nuk ka pse ta bëjmë atë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, nuk ka nevojë të bëjmë letër tjetër. Mund të bëjmë një telegram ku të luhet se si duhet të punohet kjo Letër në Parti dhe në kolektiva.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Me siguri që në shtypin e huaj Letrës sonë do t'i bëhet jehonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet t'i bëhet. Mund t'i botojmë edhe ato që do të shkruajnë të huajt për këtë çështje.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura gjatë  
këtij takimi që gjenden  
në AQP*

# **MOMENT HISTORIK NË MARRËDHËNIET ME KINEN**

**Shënimë**

**25 korrik 1978**

Sot në mëngjes, në studion time në Pogradec, bashkë me Ramizin shqyrluam përbajtjen e Letrës që do t'i drejtojmë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës. Punuam gjatë gjithë parades dhe i dhamë dorën e fundit këtij materiali. Gjithashtu përcaktuam edhe mënyrën e masat për botimin dhe për dorëzimin e Letrës ambasadorit kinez në Tiranë. E pranon ose nuk e pranon ai këtë Letër që ne do t'i dorëzojmë në përgjigje të notës së tyre të datës 7 korrik të këtij viti, kjo është punë e tij, por ne do ta botojmë që të nesërmen në shtypin tonë.

Me këtë rast, dhashë porosi që pas mbledhjes së Byrosë Politike, të thérresim Plenumin e KQ të PPSH dhe Qeverinë për ta lexuar këtë Letër e për të marrë edhe mendimin e shokëve.

Mund të them se ky është një moment historik dhe një veprim me rëndësi që ndërmerr Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë për sa u përket marrëdhë-

nieve me Kinën. Ne kishim bërë përpjekje që ato marrëdhënie të mira e të kënaqshme midis Partisë Komuniste të Kinës, qeverisë kineze dhe Partisë e Qeverisë sonë, pavarësisht nga kontradiktat e shumta parimore që ekzistonin në mes nesh, të ruheshin, por udhëheqja kineze e ndërpreu këtë kurs. Dhe ishte e natyrshme që ajo ta ndërpriste në mënyrë brutale dhe arrogante këtë kurs të marrëdhënieve midis dy partive dhe vendeve tona, për arsyen se gjatë gjithë kohës, që nga krijimi i tyre, Partia Komuniste e Kinës dhe Republika Popullore e Kinës nuk ecnин në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste. Rruja e tyre ishte jomarksiste. Ato ruanin vetëm disa forma të jashtme marksiste. Pas çlirimt të plotë të Kinës u morën disa masa që kishin tiparet e një pune për hedhjen e themelive të socializmit, por kjo ishte në formë e jo në përbajtje. Në realitet, edhe në brendi rruja që u ndoq në Kinë ishte me shumë zigzage, ajo e pengonte ndërtimin e socializmit, krijimin e një partie të vërtetë marksiste-leniniste, hedhjen e themelive të shëndosha të socializmit dhe marshimin përpara drejt ndërtimit të plotë të socializmit e më vonë të komunizmit në Kinë.

Rol të dorës së parë ka luajtur fakti që Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti marksiste-leniniste, por një parti që e hiqte veten marksiste. Parimet që e udhëhiqnin atë ishin më tepër parime demokratike revolucionare, por në fakt oportuniste. Pra, në Kinë partia nuk kishte një bosht të vërtetë marksist-leninist, që ta udhëhiqte atë drejt rrugës socialiste, sigurisht në aleancë me elementë demokratikë.

Nga analizat që po i bëj kësaj çështjeje, mund të

them se edhe parimet kryesore të një revolucioni demokratiko-borgjez në të ashtuquajturit komunistë kinezë e, në radhë të parë, në mendimet e Mao Ce Dunit, nuk kanë qenë të kristalizuara. Edhe veprimet e tij në luftën për çlirimin e vendit dhe në zbatimin e reformave të mëvonshme, të atyre reformave që i përkasin stadir të demokracisë borgjeze, nuk kanë qenë koherente.

Maoja ishte një ëndërrimtar i mbrujturi me filozofinë e vjetër konfuciane. Kjo ideologji, organizimi i vjetër kinez, kultura e mbrujturi me këtë ideologji që në kohët e vjetra e më vonë, e kishin frymëzuar Maon dhe shokët e tij me ide jo plotësisht demokratike borgjeze. Maoizmi dhe konfucizmi kishin krijuar te «komunistët» kinezë mendimin se çdo gjë në Kinë duhej të zhvillohej ndryshe nga kudo dhe se Kina ishte një shtet me një popullsi të madhe, me karakteristikat e traditat e saj, nga të cilat duhej të frymëzoheshin ata në veprimet e tyre. Çdo gjë e huaj, mund të themi, deri në njëfarë shkalle, shikohej prej tyre nga pozitat e ksenofobizmit, kurse çdo gjë e tyre e brendshme ishte edhe e mirë, edhe e keqe. Por kësaj eksperience të mirë dhe të keqe të brendshme ata nuk ditën t'i bënin atë shoshitje që do të nxirrte në dritë më të mirën nga të mirat dhe të luftotonin të keqen, joprogressiven e, në të njëjtën kohë, të hidhnin sytë edhe pak rreth e rrotull tyre që të ishin në korent të zhvillimit të ngjarjeve në botë dhe të ideve që avanconin me zhvillimin e materializmit historik e me zhvillimin kulturor të popujve.

Për kinezët gjithçka ka qenë Kina dhe gjithçka

duhej të ishte për Kinën. Natyrisht, një pikëpamje e tillë ishte një minus i madh që, pa dyshim, do të kishte pasoja të rënda në të ardhmen. Kështu, fitorja e revolucionit demokratiko-borgjez në Kinë, megjithëse u arrit vërtet pas një lufte të armatosur kundër japonezëve dhe reakzionit të madh me Çan Kai Shinë dhe borgjezinë kompradore në krye, flet për atë që udhëheqja e kësaj lufte nga komunistët gjatë gjithë periudhës bazohej në pikëpamje jo të kristalizuara.

**Lufta** që bënë kinezët, të udhëhequr gjoja nga **Partia Komuniste e Kinës**, ishte një luftë kapetanësh ose e «zotërve të luftës». Natyrisht, këta nuk kishin pikëpamje plotësisht të njëjta me ato të «zotërve të luftës» që mbretëronin dhe bënin ligjin në provincat, por këta zotër të rinj të luftës kishin mjaft ambicie, mjaft pikëpamje të padrejta dhe sidomos ata nuk e ndienin atë dorë të hekurt dhe të drejtë që ta udhëhiqte revolucionin në mënyrë të organizuar. Me fjalë të tjera, atyre u mungonte ajo parti marksiste-leniniste e proletariatit, me atë ideologji marksiste-leniniste të luftës revolucionare, me ato lidhje, me atë forcë e me atë disiplinë, që duhej të udhëhiqte këtë luftë të madhe.

Armatat kineze nën drejtimin e Partisë Komuniste ishin pothuajse të pavarura dhe vepronin në mënyrë të pavarur. Kjo u shkaktoi atyre edhe disfata që rridhnin pikërisht nga mungesa e një kohezion të hekurt në luftë. Këtë kohezion të hekurt mund ta krijojë vetëm një parti marksiste-leniniste me një ideologji marksiste-leniniste. Dhe pikërisht një parti e

udhëhequr nga një e tillë ideologji revolucionare u mungonte kinezëve.

Marshimi i madh i Mao Ce Dunit, që ka hyrë në histori si akti i një strategjie të madhe, mua më duket se nuk është i tillë. Sipas mendimit tim ky «marshim» flet për një tërheqje të madhe dhe të çrregullt. Në luftime ka edhe tërheqje, por kjo tërheqje e madhe e ushtrisë së Mao Ce Dunit, që konsiderohet si një «marshim heroik», për mendimin tim nuk mund të konsiderohet si fitore.

Marshimi i madh u pagua shitenjtë: nga 300 000 veta, që e nisën atë, e përfunduan vetëm 30 000; ushtria humbi 90 për qind të territorit të saj, bazat mbështetëse të ushtrisë u shkatërruan krejt, mjaft kundërmësymje të saj dështuan. Gjatë kësaj periudhe u likuiduan shumë kuadro partie.

Duke iu referuar realitetit mund të dalim në konkluzionin se marshimi i madh tregon që Partia Komuniste e Kinës, me gjithëse predikonte se mbëshkëtjet te fshatarësia, forca kryesore e saj, nuk kishte punuar që të krijonte baza të shëndosha lufte as te fshatarësia masive e mjeruar e Kinës. Kështu që ushtria e reaktionit të madh, e Guomindanit, e Çan Kai Shisë, me terror, me vrasje, e likuidoi edhe atë bazë të fshatarësisë që kishte partia.

Ne shohim qartë se Mao Ce Duni nuk ka qenë për hegemoninë e proletariatit në revolucion. Ai nuk kishte parasysh mësimin e Leninit mbi pozitën e lëkundshme të fshatarësisë dhe të borgjezisë së vogël. Në fshatarësinë kincze nuk ishte ndier dora e proletariatit, pavarësisht se ky ishte shumë i vogël në numër në

krahasim me të. Këtu nuk ishte ndier sidomos ideologjia e proletariatit nëpërmjet partisë së tij. Prandaj armatat kineze, dhe vëcanërisht armata e Mao Ce Dunit dhe e Çu Desë, u tërroqën, pastaj u kthyen përsëri dhe u tërroqën për t'u riorganizuar, se patën humbje kolosale. Këtu duhet ndalur e duhet parë se çfarë edukimi iu dha kësaj partie dhe kësaj ushtrie.

Nga sa dimë dhe nga sa kemi parë në shkrimet e Mao Ce Dunit, në kohën e tërheqjes së armatave kineze dhe sidomos kur këto armata u vendosën në provinçat veriperëndimore të Kinës, filloji edukimi gjoja marksist-leninist. Parimet mbi problemin e organizimit e të edukimit të partisë gjatë luftës ne i gjejmë të shprehura në katër vëllimet e veprave të Mao Ce Dunit, që janë referate gjoja teoriko-ushtarake. Mirëpo në këto referate të ashtuquajtura teoriko-ushtarake jepen parime me karakter të përgjithshëm, të cilat në letër duken si të drejta, por në to nuk shohim atë ideologji të vërtetë dhe atë mësim konkret që duhet ta forconin organizativisht partinë, e cila të udhëhiqte këtë ushtri në beteja, domethënë në fillimin e sulmit.

Nga ana tjetër, ne dimë se në shtabin e Mao Ce Dunit në ato kohë të vështira e të rëndësishme për fatet e Kinës, rronin në miqësi të ngushtë, në afinitet të madh me ushtarët e koniunistët kinezë agjentë imperialistë amerikanë, nga të cilët më kryesorë ka qenë Edgar Snou. Për këtë unë kam folur edhe në shkrimet e mëparshme. Mao Ce Duni me Edgar Snoun kanë pasur bisedime të gjata dhe bile nga Departamenti i Shtetit Amerikan është shkruajtur edhe një «Libër i bardhë», ku vihen në dukje pikëpamjet demokratiko-

-liberale të Mao Ce Dunit në lidhje me luftën, me aleancat e me të ardhmen e Kinës. Në atë libër jepen pikëpamje të Mao Ce Dunit për shumë çështje, të njohura dhe të panjohura nga ne, që vërtetojnë këlo eklektizma antimarksiste të atij vetë dhe të shokëve të tij, të cilat u mbuluan të gjitha me fitoren kundër Japonisë dhe me shpartallimin e ushtrisë së Çan Kai Shisë. Natyrisht, Mao Ce Duni dhe kinezët këtë fitore ia dedikojnë vetëm vetes së tyre, kurse objektivisht nuk është ashtu. Thyerja e Japonisë, që solli si rrjetdhim edhe shpartallimin e Çan Kai Shisë e të ushtrisë të tij, ishte rezultat i Luftës së Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini i madh, si dhe i luftës së koalicionit midis Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këta faktorë të jashtëm, por që kanë luajtur një rol të madh në çështjen e çlirimtës së Kinës, Mao Ce Duni dhe shokët e tij i errësojnë, për të mos thënë se i zhdukin krejt dhe tek ata kurdoherë sundon pikëpamja që çdo gjë e kanë bërë vetë me forcat e tyre, çdo gjë e ka bërë Kina për Kinën.

Natyrisht, triumfi i ushtrisë kineze, të udhëhequr nga Mao Ce Duni dhe gjeneralët e tjerë, çlirimi i Kinës dhe shpallja e Republikës Popullore në vitin 1949 e ngritën lart prestigjin e Partisë Komuniste të Kinës dhe, veçanërisht, të Mao Ce Dunit. Kjo fitore dhe vendosja e «demokracisë së re» u pompuan si një fazë e ndërtimit të socializmit, nën drejtimin e Partisë Komuniste të Kinës.

Për këtë fitore të popullit të madh kinez gjithë revolucionarët dhe bota përparimtare u gjuezuan, kurse

armiku u hidhërua, por shpresat nuk i humbi. Ai puhonte, se e njihte mirë gjithë të kaluarën e Kinës, dinte, gjithashtu, se cilët ishin faktorët që sollën çlirim e saj dhe shpalljen e Republikës Popullore në këtë vend.

Unë nuk do të zgjatem për të vënë në dukje ato ide që kam përsëritur shumë herë në shkrimet e mia për Kinën, por dua të them diçka se si filloj të ndërtohet «socializmi» ose si u hodhën «bazat e socializmit» në Kinë. Ç'rrugë morën punët në fushën politike, në ideologji, në ndërtimin e ekonomisë, në luftën e klasave, në luftën për aleanca në Kinë e çliruar? Mund të them me bindje se të gjitha këto u zhvilluan në mënyrë kaotike, jo të përcaktuara qartë. Në Kinë nuk kishte një bosht marksist-leninist të vërtetë që, me përpjekje, nëpërmjet luftës së klasave, ta drejtonte fitoren e çlirimt drejt fitores së socializmit. Përkundrazi, ato pikëpamje të paraluftës në Kinë e re u zhvilluan nën maskën e demokracisë së re, siç e quajti Mao Ce Duni. Kështu që gjatë kësaj periudhe, që nga viti 1949 dhe deri tash, ne shohim se idetë që udhëhoqën ndërtimin e socializmit në Kinë nuk ishin ide racionale marksiste-leniniste. Pas çlirimt, në Kinë ekzistonte një luftë idesh zyrtare të pranuara nga Partia Komuniste mbi zhvillimin e «njëqind luleve» e të «njëqind shkollave».

Me fjalë të tjera, Partia Komuniste e Kinës, që s'kishte një bosht marksist-leninist, pranoi që në gjirin e saj të ekzistonin fraksione të ndryshme, të cilat luftonin jo për kohezion, por për pushtet. Ato fraksione luftonin gjoja për forma më revolucionare, tamam ash-

tu siç luftonin «zotërit e luftës», ashtu siç luftojnë në vendet borgjezo-kapitaliste rrymat e ndryshme, që përsaqësojnë interesa të veçantë të grupeve të ndryshme.

Partia Komuniste e Kinës, siç e dimë, lejoi fraksionet në gjirin e saj dhe pranoi ekzistencën e partive të ndryshme në pushtet me po ato prerogativa si të Partisë Komuniste. Në më të shumtata e rasteve edhe në sistemin ekonomik u ruajt prona private kapitaliste, si në qytet edhe në fshat, ushtria kineze u la të ruante ato karakteristika bashibozuke të komanduara nga «zotërit e luftës», të cilët në realitet nuk u bindeshin Komitetit Qendror dhe qeverisë. Në fakt, të gjithë ngrinin flamurin e Mao Ce Dunit, po ishte pikërisht ky flamur i Mao Ce Dunit që e lejonte këtë drejtim të decentralizuar jo vetëm në ushtri, por edhe në ekonomi, edhe në organizimin e shtetit.

Në organizimin e shtetit të demokracisë së re në Kinë nuk shohim që Partia Komuniste të adaptojë teorinë e Marksit e të Leninit dhe eksperiencën e madhe bolshevikë të Bashkimit Sovjetik në krijimin e aparateve të diktaturës së proletariatit, nuk shohim krijimin e pushtetit të vërtetë të diktaturës së proletariatit. Këtu ka diletantizëm të lejuar posaçërisht, përsyre të mentalitetit jomarksist të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, se gjoja krijimi i këtij pushteti në Kinë ishte specifik për këtë vend.

Natyrisht, Kina do të bënte edhe një politikë të jashtme. Në fillim, për këtë ajo u orientua nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse duhet thënë se Bashkimi Sovjetik leninist-stalinian nuk është parë kurrë me sy të mirë, marksist-leninist revolucionar nga vetë Mao

Ce Duni dhe nga gjithë «marksistët» e tjerë kinezë. Ata as Komunën e Parisit, as sovjetët nuk i konsideron si një shembull i asaj forme të vërtetë të pushtetit të diktaturës së proletariatit, por adaptuan komunën popullore. Komuna popullore në Kinë mund të tingëllojë si Komuna e Parisit, por në realitet nuk zhvillohej në atë rruge. Kjo ishte një komunë e veçantë kineze, e cila do të kishte konsekuenca të rrezikshme në të ardhmen, për arsyet e decentralizimit të pushtetit, të ekonomisë, të fuqisë ushtarake. Si rrjedhim, komuna popullore në Kinë do të krijonte pozita të shëndosha për klanet e ndryshme, që lufoton për pushtet, gjë që do ta dobësonë në fakt organizimin e partisë dhe frymëzimin e saj me ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Gjithë ky organizim i veçantë kinez i dedikohej, dhe kjo është e vërtetë, Mao Ce Dunit, idetë e të cilit nuk ishin marksiste, pavarësisht se u quajtën të tilla.

Megjithatë Kina u orientua nga Bashkimi Sovjetik duke mos qenë dakord as me vendimet e Kominternit, as me këshillat që mori nga vendi i parë socialist, por e ndiente velen, si të thuash, solidare me të në divergjencia. Pas vdekjes së Stalinit, kur në fuqi erdhi tradhtari Hrushov, kur ky hodhi baltë mbi leninizmin, mbi Stalinin, mbi bolshevizmin, Bashkimi Sovjetik hrushovian i pëlqeu Maos, se u afrohej më tepër pikëpamjeve të tij kaotike antimarksiste. Është pikërisht për këto arsyet që Mao Ce Duni e mbrojti me zell të madh ardhjen e Hrushovit në fuqi dhe luftën e tij kundër grupit të ashtuquajtur antiparti në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Maoja e

mbrojti Hrushovin dhe «luftën» e tij me ato kritika të ndyra që i bëri Stalinit, duke shpresuar shumë që ai të bëhej një nxënës i tij ose Bashkimi Sovjetik të bëhej një aleat i dobët i Kinës dhe së toku të bënin ligjin. Ligji do të bëhej gjoja për të luftuar imperializmin amerikan.

**Por si Maoja, edhe Hrushovi, veç e veç dhe së bashku, kishin për qëllim të dominonin dhe të rindanin botën, se që të dy kishin pikëpamje shoviniste të shtetit të madh. Hrushovi e ledhatoi Maon derisa i forcoi pozitat e veta, pastaj mendonte se me Kinën e Mao Ce Dunit mund të shkonte, mund të lidhej në aleancë, por kjo aleancë duhej të ishte nën drejtimin e tij dhe, që të realizohej një gjë e tillë, Hrushovi hapi politikën e vet drejt imperializmit amerikan. Kjo, natyrisht, ishte një disfatë për politikën e Maos, prandaj ky bëri çmos që ta pengonte Hrushovin të lidhej me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pse edhe vetë kishte që më parë tendenca proamerikane. Por, kur Maoja pa se Hrushovi e hodhi hapin më përpëra drejt imperializmit amerikan, atëherë filloi luftën kundër Hrushovit. Domethënë, Partia Komuniste e Kinës, e kryesuar nga Mao Ce Duni, erdhi, si të thuash, me zordhe përkohësisht në vijën e Partisë sonë për çështje taktike, se pastaj përsëri ajo ndërroi strategji dhe u kthye në strategjinë e Maos. Lufta brenda partisë, midis fraksioneve në Kinë, po thellohej. Këto fraksione kërkonin si e si të merrnin fuqinë dhe të dominonin në vend. U arrit kështu në Revolucionin Kulturor dhe më në fund në marrjen e fuqisë nga revi-**

zionistët dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini.

Pra, në gjithë këtë situatë, në vija të përgjithshme, mund të konstatojmë që Partia Komuniste e Kinës nuk ka qenë në pozita marksiste-leniniste. Ajo doli në rrugën e revizionizmit, në rrugën e një Kine që aspiron dhe lufton të bëhet superfuqi socialimperialiste në bashkëpunim dhe në alcancë me imperialistët amerikanë, me reaksionin botëror kundër revolucionit, kundër luftës së popujve dhe kundër fuqisë tjetër të madhe imperialiste, Bashkimit Sovjetik, që lufton dhe aspiron gjithashtu për dominimin botëror.

Situatat plot zigzage të brendshme e të jashime në të cilat ka kaluar Partia Komuniste e Kinës, Partia jonë i ka ndjekur hap pas hapi dhe të gjitha janë gjykuar me gjakftohtësi nga ana e saj. Ajo ka bërë përpjekje që sa të ishte e mundur të influençonte me vijën e saj të drejtë, me ndonjë këshillë dhc me ndonjë kritikë, që Kina të ndiqte një vijë marksiste-leniniste, të mos merrete këtë rrugë armiqësore kundër revolucionit. Në e kemi ndërgjegjen të qetë se i bëmë të gjitha përpjekjet që udhëheqësit kinezë të ndërronin rrugë. Tash dolën haptazi kundër nesh. Luftha e tyre armiqësore kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së Punës të Shqipërisë është konsekuençë e luftës antimarksiste, e qenies së Kinës një shtet jo-socialist dhe e ekzistencës së maocedunidesë, të kësaj teorie kapitaliste, socialimperialiste dhe antimarksiste.

Vendimet tona janë të matura, janë të drejta dhe neve na vjen shumë keq që ndodhi kështu për popu-

llin kinez, i cili është një popull punëtor, që e do dhe do ta dojë popullin shqiptar.

Në Kinë ka një përleshje të madhe idesh, ka një përleshje të madhe forcash që kundërshtojnë njëratjetër, që kërkojnë të dominojnë dhe të eliminojnë kundërshtarët e vet. Midis këtyre forcave që luftojnë është vështirë të mos ekzistojë një bërthamë e shëndoshë marksiste-leniniste, e cila ka qenë penguar edhe nga vetë Mao Ce Duni, sepse ai nuk ishte marksist-leninist, por vëtruhej marksist-leninist. Kjo bërthamë marksiste-leniniste do të luftojë, por mendoj se lufta e saj nuk duhet të bëhet më nën flamurin e Mao Ce Dunit. Ky është një problem krucial për Kinën.

Në qoftë se marksistë-leninistët kinezë vazhdojnë të mbajnë si flamur të luftës së tyre maocedunidenë, ata jo vetëm që nuk do të fitojnë dhicë nuk do ta gjejnë rrugën e vërtetë të revolucionit, por do të zhyten në luftë fraksionesh dhe, natyrisht, në këtë rast do të kenë kurdoherë vendin e fundit në Kinë, sepse frakcionet reaksionare janë të sorta. Por në qoftë se kjo bërthamë proletare mbështetet si duhet në ideologjinë marksiste-leniniste dhe në mësimet e Stalinit, në qoftë se kjo e quan klasën punëtore si klasë hegjemone dhe krijon një parti me të vërtetë të klasës punëtore, atëherë do t'i ngjitet shkallët, sigurisht me zor, me luftë, me përpjekje, por do t'i ngjitet. Në Kinë ekzistojnë forca revolucionare, të cilat kanë hyrë në një rrugë politike, por nuk gjejnë orientimin e duhur dhe borgjezia me frakcionet e saj të ndryshme përpinqet t'i çojë në kanalin e vet, veçanërisht fshatarësinë. Prandaj komunistët e vërtetë kinezë duhet ta rishikojnë

gjithë vijën e tyre dhe të ndërtojnë një parti me një vijë të drejtë, me të vërtetë marksiste-leniniste.

Na mendojmë se, duke vepruar kështu siç veprojmë, e ndihmojmë këtë situatë që duhet të krijojë proletariati kinez në alcancë me fshatarësinë punonjëse, për të formuar partinë e vërtetë marksiste-leniniste. Revisionistët kinezë me siguri do të na atakojnë ne dhe këtë do ta bëjnë duke ngritur flamurin e Maos dhe të Çu En Lait. Domethënë, ata do të shfrytëzojnë sentimentalizmin e popullit kinez, duke i thënë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Shqipëria socialiste mosmirënjohe, antimarksiste, e të tjera e të tjera epitete si këto, është shitur te Bashkimi Sovjetik dhe po luston, po diskrediton Mao Ce Dunin e Çu En Lain, që janë heronjtë dhe marksistë-leninistët e vërtetë në botë. Këtë gjë ata do ta bëjnë dhe, deri në njëfarë shkalle, edhe në gjerësi. Në periudhën e parë, sidomos, kjo propagandë e tyre e gënjeshtërt, por që u duhet, do të ketë sukses, veçse me kalimin e kohës vetë krerët kundërrevolucionarë kinezë do të na ndihmojnë ne në këtë drejtim. Revolucionarët e vërtetë marksistë-leninistë dhe populli kinez me proletariatin do të kuptojnë se sa e drejtë ka qenë vija jonë, sa e drejtë ka qenë lufta jonë kundër eklektizmit kinez, ndaj Partisë Komuniste të Kinës, që nuk ishte në pozita marksiste-leniniste dhe ndaj Mao Ce Dunit e udhëheqësve të tjerë, që e çuan Kinën në një katastrofë të tillë.

Në këtë drejtim mund të themi se aktualisht kundër veprimtarisë antimarksiste të udhëheqjes kineze ne fillojmë një luftë të hapët, që do të vazhdojë serio-

zisht me dokumente, se deri tashti nuk kemi folur hapur. Ky është një moment tjetër historik për Partinë dhe vendin tonë, është një nga momentet e rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar Partia jonë marksiste-leniniste gjatë gjithë jetës së saj, në luftë kundër imperializmit, kundër reaksionit botëror dhe kundër revisionizmit modern, duke filluar që nga titistët, hrušovianët, eurokomunistët dhe deri te kinezët.

Njëkohësisht ky është edhe një moment i rëndësishëm në luftën e në lëvizjen komuniste botërore, se hap sytë e elementit të shëndoshë marksist-leninist të shohë më qartë dhe të shpërndajë mjegullën që ka përhapur teoria e Mao Ce Dunit, teori që është ndihmuar nga imperializmi dhe kapitalizmi, të cilët shihnin te Kina jo një kundërshtare, por një aleate të mundshme. Dhe një gjë e tillë atyre iu vërtetua. Për këtë arsyе imperializmi dhe kapitalizmi do ta mbrojnë Kinën aktuale dhe do të na luftojnë ne, por ne nuk përkulemi, se jenii me të drejtën. Ne jemi të fortë brenda vendit dhe do të forcohem akoma më shumë, por, në të njëjtën kohë, kemi forca të mëdha edhe jashtë, se opinioni përparimtar botëror dhe marksistë-leninistët që luftojnë nga të katër anët e botës do të ndihmojnë kauzën e vërtetë të revolucionit, pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, që i mbron këto me besnikëri e trimëri.

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çësh-tje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 70*

# **PRERJA E KREDIVE DHE E NDIHMAVE NGA KINA — RRJEDHIM I MOSMARREVESHJEVE TONA IDEOLOGJIKE E POLITIKE**

*Diskutim<sup>1</sup> në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike  
të KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave  
të RPSSH*

**28 korrik 1978**

Me përgjigjen e hapët që do t'u japim me këtë Letër revizionistëve të rinj kinezë ne po hyjmë tanjë periudhën e një lufte të ashpër, përveç luftës që prej kohësh jemi duke bërë me imperializmin amerikan, me socialimperializmin sovjetik dhe me gjithë reaksionin botëror. Partia, populli dhe të gjithë ne, këtë luftë të re duhet ta konsiderojmë si një luftë të rëndë. Për këtë të jemi plotësisht të ndërgjegjshëm, në mënyrë që ta përballojmë me sukses dhe të fitojmë mbi të gjithë këta armiq. Fitore ne duhet të

---

1. Shoku Enver Hoxha, që ndodhej me pushime në Pogradec, e dërgoi këtë diskutim, për t'u lexuar në këtë mbledhje, ku do të shqyrtohej e miratohej përfundiminisht Letra që do t'i drejtohej udhëheqjes kinezë, në përgjigje të notës së tyre të 7 korrikut 1978.

konsiderojmë kapercimin me sukses të të gjitha vë-shtirësive politike, ideologjike e ekonomike që do të na krijojnë armiqjtë e jashtëm. Prandaj na vihet detyrë të mobilizojmë të gjitha forcat që t'i kapërcejjmë këto vështirësi, duke iu përmbajtur fort parimit tonë bazë marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta.

Natyrisht, gjatë luftës që do të bëjmë në këtë fazë të re, ne kemi e do të kemi kurdoherë në favorin tonë gjithë opinionin përparimtar botëror. Ky opinion do të luajë rolin e tij pozitiv, duke na mbështetur. Bile, aktualisht, duket që ky opinion është në favorin tonë. Por asnjëherë të mos harrojmë se potenciali ekonomik, ushtarak dhe politik i armiqve tanë është shumë i madh. Kurse nga miqtë tanë ne kemi vetëm ndihmë morale.

Armiqtë që kemi janë të egër dhe të betuar kundër nesh. Prandaj, në këto situata është e domosdoshme të jemi vigjilentë, të bashkuar fort rreth Partisë, në mbrojtje si kurdoherë të vijës së saj marksiste-leniniste, pse vetëm kështu do të arrihet që orvatjet e armiqve, të çdo natyre qofshin, të dështojnë. Në këtë drejtim, siç thashë, që të fitojmë, do të na ndihmojë edhe opinioni publik përparimtar.

Por të kuptohet mirë nga të gjithë se me «urra!» lufta nuk mund të fitohet, prandaj të shtrëngojmë radhët në të gjitha drejtimet që armiku të mos mundë të na dëmtojë dot.

Siç e kemi parë vetë, etapat e luftës me revizionizmin kinez po kapercehen shpejt. Që nga Kongresi i 7-të i Partisë e deri tani ne, nga ana jonë, kemi ecur me kujdes. Por, sado me kujdes që të ecim ne,

situatat prapë do të precipitonin, siç po precipitojnë, sepse revisionistët kinezë i dogjën vëtë etapat; ata nuk mundnin ta duronin një situatë të tillë që ishte krijuar kundër synimeve të tyre. Tash ne kemi hyrë në një fazë të luftës që do t'i godasim ata drejtëpërdrejt, hapët dhe frontalisht. Sot ne nuk mendojmë dhe as bëjmë përpjekje, siç bënim deri tani, që t'u merrnim krahët atyre. Edhe miqtë tanë njëkohësisht do të luftojnë frontalisht kundër kinezëve. Ata do të na ndihmojnë ne. Por të kemi parasysh se edhe kinezët do të na godasin ne frontalisht. Frontalisht e në mënyra të ndryshme do të na godasin gjithashtu aletatët e tyre.

Kjo etapë e re e luftës, mendoj unë, që është në fillim, ashtu si edhe ato të mëparshmet, do të zhvillohet më tej. Por, se me çfarë ritmi do të zhvillohet ajo, do ta shohim. Neve na bie detyrë që t'i masim mirë hapat. Prandaj mendoj që as të mos shpejtohem, as të ecim ngadalë.

Ne duhet të ndjekim, siç kemi ndjekur kurdoherë, rrugën që na mëson Lenini. Në gjithë vepren e Leninit, ashtu si edhe në veprën e Marksit, të Engelsit dhe të Stalinit, tek të cilët mbështetemi, ne shikojmë se ai nuk nisej nga emri i njërit apo tjetrit personalitet, po mbante kurdoherë parasysh intercsat e popullit, interesat e revolucionit proletar dhe pastërtinë ideologjike e politike. Siç ë dimë, cilindo që bënte gabime, Lenini e kritikonte, polemizonte me të, e godiste pa rezerva, pastaj e dërrmonte përfundimisht, sepse mbi çdo gjë ai vinte ata interesa të mëdhenj që përmenda. Kështu, për shem-

bull, Plehanovin, deri në një periudhë që ky qëndronte mirë, Lenini e mbështeti; po pastaj, kur ai devijoi, i dha dërmën. Lenini po kështu veproi edhe me Roza Luksemburgun e Karl Libknehtin e të tjerë, pa folur pastaj për luftën e pamëshirshme që bënte me elementë armiq, si Trockin me shokë, që i luftci deri në fund.

Edhe Partia jonë ka ndjekur dhe kurdoherë do të ndjekë këtë rrugë. Ajo vazhdimisht ka dalë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, të bolshevizmit dhe të Stalinit, për arsy se ky, si revolucionar i madh, mbrojti me vendosmëri deri në fund të jetës së tij marksizëm-leninizmin në rrugën e treguar nga Lenini. Ishin revisionistët modernë ata që i hapën luftë Stalinit, kurse ne e mbrojtëm dhe do ta mbrojmë atë deri në fund. Ne dolëm në mbrojte të Stalinit, pavarësisht se çfarë do të mendonte populli sovjetik (gjë që kishte rëndësi për ne) dhe q'qëndrim do të mbante ai ndaj hrushovianëve. Megjithatë, ne kemi bindjen se jo tërë populli sovjetik e mbëshlestë Hrushovin, pse në Bashkimin Sovjetik kishte me shumicë njerëz që e donin dhe e mbështetnin marksizëm-leninizmin. Por fakt është se, kur Hrushovi me bandën e tij i hodhi baltë Stalinit, nuk pamë që populli sovjetik të ngrihej kundër kësaj rryme kaq të egër që devijoi nga marksizëm-leninizmi, që likuidoi fitoret e socializmit dhe degjeneroi Bashkimin Sovjetik.

Ne kemi besim se do të vijë koha që revisionizmi modern, kjo rrymë e egër antimarksiste, do të shkatërrohet plotësisht dhe përfundimisht.

Tani marrim çështjen e revisionistëve kinezë. Ne

kemi të drejtë të themi se, po ta zhvillojmë si duhet luftën kundër këtyre tradhtarëve, populli kinez mund të na kuptojë. Por mundet që ai edhe të mos na e kuptojë këtë luftë, ashtu siç nuk na e kuptoi populli sovjetik luftën që zhvilluam ne kundër hrushovianëve. Megjithatë, ashtu siç nuk u tërroqëm nga pozitat tona të drejta marksiste-leniniste kundër revizionistëve të mëparshëm, ne përsëri edhe kësaj here, nuk duhet të tërhiqemi nga rruga jonë parimore. Ne jemi plotësisht të bindur se çështja që shtron dhe që mbron Partia jonë është plotësisht e drejtë. Këtë na e vërteton edhe vetë eksperiencia e marrëdhënive tona me Kinën.

Në rrugën tonë do të punojnë e do të luftojnë gjithë marksistë-leninistët, kurse në rrugën e tradhës, përveç revizionistëve të tjerë, do të punojnë e do të luftojnë tani e tutje edhe revizionistët kinezë. Këta do të na akuzojnë se kemi luftuar Mao Ce Dunin dhe maocedunidenë. Këtej e tutje ata do të përpilen që popullin kinez, duke përsituar ca nga papjekuria, ca nga frika e tij, të mos e lënë të mbajë qëndrim pro nesh, ashtu sikundër bënë hrushovianët me popullin sovjetik. Edhe sot e kësaj dite nuk dimë nëse populli sovjetik na ka mbrojtur, na mbron apo na lufton, sepse për këtë nuk kemi dëgjuar gjë deri tani. Megjithatë ne nuk e kemi humbur shpresën. Kështu mund të ngjasë edhe me popullin kinez.

Interesat e revolucionit botëror dhe të çlirimtë popujve e kërkojnë që t'i hapen sytë popullit kinez. T'i thuhet atij se maocedunideja nuk është marksizëm-leninizëm dhe ai të kuptojë që asnje kthesë nuk mund të bëhet në Kinë duke u mbështetur në këto

ide. Maocedunideja është si një para kallp, prandaj situata duhet shikuar në mënyrë objektive.

Populli kinez, siç e thamë, sot për sot mund të mos e kuptojë këtë gjë. Por në Kinë ka e gjithnjë më shumë do të ketë njerëz që me siguri do të reflektojnë. Ne e kemi për detyrë t'i ndihmojmë ata që të reflektojnë për shkaqet e gjendjes së rëndë që është krijuar në vendin e tyre. Po si mund ta ndihmojmë ne popullin kinez në këtë drejtim? Atë ne do ta ndihmojmë vetëm duke i thënë të vërtetën, ashtu siç vepruam në luftën kundër hrushovianëve.

Përgjigjja që do t'u japim tanë kinezëve me këtë Letër është fillimi i një etape të re, të vështirë dhe të gjatë, të luftës sonë me revisionistët modernë. Kjo duhet të kuptohet mirë nga të gjithë, në mënyrë që popullit tonë, ashtu siç iu bë e qartë tradhtia e revisionistëve hrushovianë dhe e gjithë revisionistëve të tjerë modernë, t'i bëhet e qartë tanë edhe tradhtia e revisionistëve kinezë. Ne jemi të bindur se këtë luftë të rreptë, këtë situatë të re të krijuar, populli dhe Partia jonë do ta kuptojnë edhe më mirë e më shpejt se kur filluam luftën me hrushovianët, sepse tanë kemi një eksperiencë të madhe. Ndryshtë qëndron çështja me popullin kinez, i cili patjetër që nuk do ta kuptojë dot shpejt këtë situatë.

Por ne duhet të mos nënvlëftësojmë edhe një çështje tjeter. Kina do të përpinqet me të gjitha mundësitë e saj që të influencojë mbi popullin tonë, si direkt ashtu edhe nëpërmjet të tjerëve. Për këtë arsyesh luftën me revisionizmin kinez shokët tanë nuk duhet ta marrin si një lëftë të lehtë. Të bëhet shumë kujdes

që të mos ketë eufori. Euforia nuk është asnjëherë e rekomanueshme nga Partia jonë. Në punën dhe në luftën tonë entuziazëm po, të ketë, siç duhet të ketë besim, kurajë, vullnet dhe punë, një punë të organizuar mirë e të kontrolluar. Kundër revizionistëve kinezë të mbahen kurdoherë qëndrime të qarta, të drejta, marksiste-leniniste, në kohën e duhur, me gjakftohtësi dhe pa sharje. Çështja është që njerëzit e ndershëm në botë asnjëherë të mos thonë se shqiptarët nuk kanë arsy. Një luftë të tillë duhet të bëjmë ne.

Unë mendoj se teksti i Letrës është i bazuar dhe i përgatitur mirë, prandaj jam i bindur se Byroja Politike dhe Qeveria, pasi ta studiojnë, do ta aprovojnë atë njëzëri. Edhe shtruarja e ideve dhe forma si është thurur Letra, më duken të mira. Kur biseduam në Durrës me Ramizin<sup>1</sup> se çfarë idesh do të shtronim dhe çfarë forme duhej të kishte Letra, thamë që, në fillim do të vinim problemet politike dhe ideologjike. Këtë e bënim me qëllim që nga të gjithë të kuptohet se problemet me karakter politik dhe ideologjik janë problemet kryesore, pse janë pikërisht këto që i shtynë kinezët të prisnin ndihmat ekonomike dhe ushtarake për Shqipërinë. Pra, prerja e kredive është rrjedhim i mosmarrëveshjeve tona të thella ideologjike dhe politike, është konsekuençë e tyre. Por, unë jam dakord edhe kështu siç është bërë Letra, domethënë që çështjet ekonomike vërtet janë vënë në fillim, por ato janë trajtuar politikisht e ideologjikisht.

---

1. Shih në këtë vëllim f. 204.

Jam i bindur se, duke zhvilluar këtë luftë parimore, politike dhe ideologjike, me revizionistët kinezë, çështjet që kanë të bëjnë me kreditë dhe me marrëdhëniet ekonomike të Kinës me Shqipërinë do të harrohen fare, ashtu sikundër ndodhi edhe me revizionistët sovjetikë. Me kalimin e kohës me siguri që do të harrohen të tillia çështje, kurse në opinionin publik botëror do të mbetet e qartë ideja kryesore që Kina ka tradhtuar marksizëm-leninizmin, revolucionin dhe kauzën e çlirimit të popujve.

Për të gjitha këto arsyenë jam dakord me tekstin e Letrës që do t'u dërgojmë revizionistëve kinezë dhe bashkë me Ramizin menduam që t'ua paraqesim për diskutim dhe miratim Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe Qeverisë përpara se t'ua dorëzojmë kinezëve.

*Botohet për herë të parë si-  
pas originalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# **VEPRIMI I UDHËHEQJES KINEZE ËSHTË NË VIJËN E LOGJIKËS REVIZIONISTE**

*Letër drejtuar shokut Hysni Kapo*

**30 korrik 1978**

I dashur shoku Hysni,

Më gëzoi shumë letra që më dërgove. U gëzova gjithash tu shumë që u bëre mirë, që shëtit në bahçë, që shkon shëtit në parkun e pallatit dhe që nesër do të vesh të pushosh në plazhin e Durrësit.

Është e qartë se, me durim dhe gradualisht, çdo gjë kapërcehet, çdo gjë fitohet. Ja, tash i kapërcyem të gjitha shqetësimet, që na shkaktoi si ty, edhe neve, shokëve të tu, dhe gjithë Partisë, sëmundja jote. Ti do t'i kthehesh Partisë dhe udhëheqjes plot shëndet e gjallëri, pse këto kanë kurdoherë shumë nevojë për punën, mendimin dhe udhëheqjen tënde.

Kinezët e morën përgjigjen që meritonin. Partia jonë dhe udhëheqja e saj vepruan shumë drejt në rru-gën marksiste-leniniste dhe demaskuan me fakte një armik-tjetër të madh, revizionizmin kinez, që maskohet për kaq kohë nën maskën e marksizëm-leninizmit.

Kur analizojmë historinë e zhvillimit të shoqërisë kineze, zhvillimin e ideve që përplaseshin atje, karakterin e luftërave për çlirim e për «socializëm» ne shohim një specifikë tipike kineze, një egocentrizëm dëj një ksenofobi të theksuar. Kjo karakteristikë, më duhet mua, tek të ashtuquajturit komunistë, si Mao Ce Duni dhe shokët e tij, është më e theksuar sesa te Sun Jat Seni.

Shovinizmi kinez çdo gjë e ka për Kinën dhe e shikon nën prizmin e interesave vetëm të Kinës, kjo është një nga karakteristikat e pseudokomunistëve kineze. Këta pseudokomunistë rrojnë me lashtësinë e popullit të tyre, rrojnë me perandorët, me perandoreshat dhe me oborrtarët e tyre, ëndërrojnë për jetën e tyre, për thëniet dhe për filozofinë e njerëzve si Konfuci, Menci e të tjerë dhe aktualisht çdo gjë e shpjetgojnë dhe e gërshtetojnë me filozofinë e vjetër vetëm kineze.

Zhvillimi materialist, materializmi historik dhe zhvillimi i kontradiktave nuk janë parë nga ana e tyre në prizmin dhe në zhvillimin e gjërë dhe të gjith-anshëm të shoqërisë njerëzore, por vetëm në prizmin e shoqërisë kineze, në jetën, në ëndrrat dhe në legjendat e saj. Kjo filozofi dhe ky shikim i këtyre problemeve kardinale, nga Mao Ce Duni mbulohen me një vello transparente, që ata e vetëquajnë marksiste. Ky është një falsitet i madh ideologjik, është një filozofi idealiste dhe shoviniste që është orvatur dhe orvatet të ruajë vazhdimësinë e «Perandorisë së Mesit» dhe gjithë bota ta konsiderojë Kinën si boshtin e saj,

kurse këtë filozofsi të sajisur, si një filozofsi «avangardë» për njerëzimin.

Partia Komuniste e Kinës dhe veçanërisht Mao Ce Duni, që ka qenë një tënë rrërrues dhe një vizioner idealist pa kulturë të përgjithshme (përveç asaj të lashtësisë kineze), ndoqën rrjedhën e historisë së njerëzimit si diletantë nga më ksenofobët dhe parimet ideologjike, politike dhe organizative të tyre, sidomos që nga formimi i Partisë Komuniste të Kinës e tëhu, janë tepër të theksuara në këtë filozofji pragmatiste dhe në interesin vetëm të vendit të tyre. Ato janë me synime të qarta për ta bërë Kinën e «amshuem» një superfuqi që të dominojë botën, të bëjë ligjin, t'i diktojë kësaj vullnetin dhe kulturën e vet. Në analizat që kemi bërë, ne hasemi në këtë ideologji kineze, dhe shohim se format e organizimit dhe të veprimit të Maos dhe të partisë së tij koncentrohen drejt kësaj ideologjie që ata duan ta bëjnë «universale».

«Figura» e Mao Ce Dunit është pompuar si figura hyjnore e një perandori kinez dhe në fakt ky perandor modern vepron i plotfuqishëm mbi oborrtarët që kanë krijuar një burokraci të madhe dhe të tmerrshme, që zbaton «idetë gjeniale» të «Timonierit të madh». Ky ia ka hipur Partisë Komuniste të Kinës në zverk dhe kurdoherë që i teket, kurdoherë që ai e «gjykon» të arsyeshme, sipas zhvillimit «dialektik të të kundërtave», të shikuara këto nën prizmin e taoizmit, rrëzon njerëz, sulmon dhe likuidon partinë, bën nga një «revolucion», balancon fuqinë e kurtizanëve dhe të gjitha këto i shpjegon me gjoja formula revolucionare, por që s'janë veçse veprime më «të kultu-

ruara» se të perandorit Bokasa, të shahut të Iranit dhe të mbretit të Nepalit, të cilët Mao Ce Duni i ka dashur shumë, i ka pritur dhc i ka përcjellë dhe jo vetëm për arsyse se ka qenë i shtyrë nga intereset material dhe nga përfitimet në politikë pér t'i bërë satelitë të Kinës, por edhe sepse filozofia e tij e puqte me ta.

Partia Komuniste e Kinës në këto kushte dhe me këto koncepte nuk mund të ishte një parti marksiste-lininiste. Filozofia që e udhëhiqte atë ishte idealiste, borgjeze, retrograde, pse vetë Kina, shoqëria e saj, me gjithë revolucionin demokratiko-borgjez, mbeti një shoqëri e myllur, me besime dhe me mentalitetë të vjetra, e dominuar nga misticizmi dhe nga parime filozofike dhe organizative shtetërore në thelb arkaike, por në sipërsaqe gjoja të evoluara. Këtë e shohim në ndërtimin dhe në formën e shtetit, e shohim në zhvillimin e ekonomisë, e shohim në ndërtimin e arsimit dhe të kulturës, në organizimin e ushtrisë. Çdo gjë, që nga ideologjia, literatura, deri edhe te sloganet, mban te vulën specifike kinezë. Sloganet kishin një burim dhe çdo njeri në Kinë, që nga më i vogli deri te më i madhi, duhej t'i përsëritnin ato pa u lajthitur në asnjë germë dhe të mos u lëviznin asnjë presje. Kjo ishte lufta pér mpirjen e mendimit krijues, kjo shtypte çdo formë të demokracisë, kjo ishte kulti i «Timonierit» dhe dominimi i burokracisë. Një zhvillim i tillë aberant<sup>1</sup> do të pësonte dhe do të pësojë disfata në momente të caktuara, që Mao Ce Duni i ka predikuar

---

1. Nga frëngjishtja — i palogjikshëm, absurd.

si «revolucione dhe kundërrevolucione» në çdo 7 vjet.

Mao Ce Duni duhet të cilësohet jo «profet i revolucioneve», por «profet i kundërrevolucioneve». Ai përfaqëson tipin e një anarkisti, që ka në gjak konfuzionin, kaosin, minimin e diktaturës së proletariatit e të socializmit, por me kusht që kjo anarki permanente të udhëhiqej nga ai, ose nga ideologjia e tij anarkiste tipike kineze. Mao Ce Duni është një Bakunin kinez.

Revolucioni Kulturor ishte ilustrim i ideve dhe i veprimeve të këtij Bakunini kinez: Kaosi i krijuar në Kinë para Revolucionit Kulturor nga vija tradhtare dhe antimarksiste e Mao Ce Dunit dhe e oborrtarëve të tij, kaos plot disfata në politikë, në ideologji dhe në ekonomi, u luftua nga «Timonieri i madh» me anarkinë e Revolucionit Kulturor. Ky revolucion anarkik edhe e shpëtonte autokracinë maoiste, por ai rrezikonte një-kohësisht minimin e saj. Duhej shpëtuar «prestigji» i «Timonicerit», duhej penguar që anarkia të rrëzonte mitet, prandaj u përdorën edhe masat ushtarake, u ruajt lhelbi i burokracisë me oborrtarin Çu En Lai-Konfucius dhe shtynë në skenë të propagandës dhe të agjACIONIT elementë gjoja «të rinj», «revolucionarë», të cilëve iu ngarkua roli nga «Timonieri» që ta ilustronin anarkinë si një «revolucion» brenda në revolucion, gjoja për të zhdukur borgjezinë që ishte futur në parti. Në fakt nuk kishte parti, po kudo kishte borgjezi, kishte klanc dhe fraksione që luftonin përfuqi. Ishte «revolucioni permanent» trockist që udhëhiqej nga Mao Ce Dun-Trocki.

E ashluquajtura «katërshe» ka vepruar siç e këshillonte Maoja. Te ky e kishin atë mbështetjen, pra-

ndaj «rrojtën sa ç'rron një lule behari» dhe me helm, si të gjitha «lulet dhe shkollat» e tjera që lulëzönin dhe që lulëzojnë në Kinë. «Katërshja» ishte një grup llasazanësh pa parime, megalomane, ambicioze, intrigante, si edhe fraksionet e tjera të borgjezisë që notonin në kënetë. Mirëpo këta të fundit e kishin «kënetën» në dorë. «Katërshja» kishte «hapëset e kashtës» dhe nuk ndërmori asnjë veprim organizativ shtetëror, ekonomik, pjesëtarët e saj shkruanin vetëm artikuj dhe organizonin balete. Iшин njerëz të dyshimtë si të gjithë të tjerët. Këta fluturonin si mendtë e Maos, kurse fraksioni i Çusë, i Tenit dhe i Jehsë punonte me sistem për të marrë fuqinç. «Katërshja» mendonte se me fjalë bombastike do të ngrinte milionat me «flamurin e Maos». Mirëpo Teni «i rrëzuar» përkohësisht ngriti 1 milion njerëz në Tien An Men, duke bërtitur kundër «katërshes». Më vonë «katërshja» ngriti 1 milion kundër Tenit. Iшин të njëjtët njerëz që brohoritnin për njërin dhe për tjetrin. Erdhi më pas Teni në suqi dhe 1 milion dolën prapë dhe brohoritnin për të. Iшин po ata që brohoritnin kundër tij më parë.

Kjo është «pasqyra» e hidhur dhe e errët e mao-cedunidesë. Katërshen bota borgjeze e quan «radikale». Kot nuk i shtojnë asaj edhe epitelin «socialiste» dhe ta quajnë «radikal-socialiste». Por ata s'kanë qenë as radikalë, as socialistë. Dikur në Francë ekzistonte një parti e fuqishme e borgjezisë që qulqet radikal-socialiste dhe që kishë udhëheqës borgjezë, politikanë dhe letrarë të shquar, si Herrioi, Daladier e të tjerë. Kjo parti pësoi disfatë të plotë, megjithatë la disa

gjurmë, kurse «katërshja» «radikale» u zhduk pa lënë gjurmë, ashtu siç vdiq ose është duke vdekur edhe mao-cedunideja.

Elementët e reaksionit të zi, Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pin, që kanë marrë fuqinë në dorë në Kinë, do të ndeshen për fuqi derisa të vendosin një shtet të egër të diktaturës fashiste.

Luftohet në Kinë për hegjemoni botërore. Strategja e vendosur prej tyre është e natyrshme; aleancat me imperializmin amerikan dhe me reaksionin botëror janë të natyrshme, janë normale, siç janë normale edhe antagonizmat dhe shpërthimet e luftërave gra-bitqare që do të rezultojnë nga këto përqafime banditësh.

Analizat që po u bëjmë ne revisionistëve kinezë, në përgjithësi, janë të drejta, objektive dhe të shikuara në prizmin e marksizëm-leninizmit. Mendoj se rruga që ndoqën ata kundër nesh, duke prerë kreditë dhe duke lënë në mes pa i plotësuar veprat civile dhe ushtarake, ka arsyet logjike të vetat. Kjo duket dhe është një rrugë e marrë, gjë që tregon egërsinë e regjimit fashist, që është vendosur në Kinë, tregon po ashtu luftën fraksioniste, kaotike dhe paqëndrueshmërinë që ekziston atje dhe nuk i lejon njerëzit, sado reaksionarë që të janë, që të mendojnë pluset dhe minuset e të tilla veprimeve që po ndërmarrin. Këto janë «mendime kuajsh».

Por, nga ana tjetër, duhet të kemi parasysh se ky vendim arbitrar, arrogant dhe shovinist i një shteti të madh, i marrë kundër Shqipërisë socialiste, është në

vijën e logjikës së revisionistëve kinezë. Këta duhej të goditnin vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, duhej të goditnin teorinë marksiste-leniniste, pse kjo demaskonte gjithë vijën e tyre oportunisto-kapitaliste, godiste të gjitha planet hegjemone që po ndërtonte Kina maoiste. Këtu qëndron lufta në mes vijës sonë marksiste-leniniste dhe vijës borgjezo-kapitaliste të kinezëve. Ka rëndësi qështja që një shtet kapitalisto-fashist si Kina sulmon një vend të vogël socialist si Shqipëria, të cilën, si shtet me potencial të madh, ajo mendon ta tronditë dhe ta gjunjëzojë.

Duhet pasur parasysh se Shqipëria e vogël dhe Partia e Punës e Shqipërisë, një Parti e vërtetë marksiste-leniniste, i bën hije, e errëson dhe e demaskon këtë shtet të madh, siç është Kina, për arsyen e ideve të mëdha të pavdekshme dhe triumfuese të marksizëm-leninizmit. Pikërisht këtu ka synuar Kina, duke na sulmuar marrëzisht dhe pikërisht në këtë fushë lufte ajo po pëson dhe do të pësojë disfatën më të madhe. Ne e pengonim Kinën në planet e saj të ekspansionit dhe të hegemonizmit socialfashist, prandaj na sulmoi.

Lufta tash çështë shpallur dhe ne do ta bëjmë të ashpër, pa kompromis dhe do të fitojmë. Për Partinë tonë janë momente historike të një rëndësie ndërkombëtare, pse asaj i ra barra historike të udhëheqë këtë luftë sa të vështirë, por aq dhe të lavdishme për të mbrojtur Shqipërinë socialiste dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit nga shtrembërimet, deviacionet dhe sofizmat, për të fuqizuar revolucionin proletar botëror dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve kun-

dër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe atij kinez maoist.

Maoizmi si «teori» antimarksiste është në agoni. Ai do të ketë të njëjtin fat që kanë pasur teoritë e tjera të sajvara nga kapitalizmi botëror dhe nga imperializmi në kalbëzim. Ekipi aktual që sundon në Kinë, ose ekipet e tjera, që me siguri do të vijnë më vonë, si rezultat i luftës së brendshme të fraksioneve për pusihtet, do ta përdorin maoizmin, por si një kusomë të vdekur antihistorike, për të ndërtuar pa skrupull, pa turp, një shtet të fuqishëm imperialist kinez në unitet dhe në divergjenca me imperialistët e tjerë, nëpërmjet shtypjes dhe shfrytëzimit të popujve që aspirojnë dhe që lustojnë për çlirim, për pavarësi dhe për socialistëm.

Të gjilha mjetet e mbрапshëta janë të mira për revolucionistët kinezë, ashtu siç janë të mira edhe për miqtë e tyre, imperialistët amerikanë, sovjetikë e të tjerë.

Luftha jonë e drejtë do të jetë e gjatë dhe e vështirë, prandaj lypset ta kemi Partinë shumë të fortë, në unitet luftarak revolucionar, ta kalitim çdo orë e çdo ditë në beteja të vazhdueshme politike, ideologjike dhe ekonomike, ta bëjmë vigjilente në kulm, të dashur dhe të bashkuar si mishi me kockën me popullin nëpërmjet një demokracie proletare, larg çdo oportuniteti, sektarizmi e burokracie të sëmurë e rrënuce.

Vija e drejtë marksiste-leniniste do të përkrahet dhe do të mbështetet nga marksistë-leninistët revolucionarë në bolë, ajo do të përkrahet nga proletariati

botëror dhe nga gjithë popujt. Jeta e përditshme e luftës së Partisë sonë e provon këtë gjë.

Klikat fashiste revizioniste kinez, me propagandë e me çdo mjet tjetër do të bëjnë çmos që të zemërojnë dhe të egërsojnë popullin kinez kundër nesh, të gënjejnë edhe opinionin botëror. Por ata nuk mund t'i gënjejnë të gjithë dhe në një kohë. Valë të tmerrshme kanë kaluar dhe do të kalojnë mbi popullin kinez, por edhe atje teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit do të triumfojë. Breza të sotëm dhe të ardhshëm të Kinës do të kuptojnë dhe do të thonë: «Partia e Punës e Shqipërisë na hapi sytë, ajo veproi drejt, ajo demaskoi maocedunidenë, pse e donte revolucionin proletar kinez, pse ajo donte dhe shpërndau mitet shkatteredimtare që ishin krijuar në Kinë dhe që pengonin lumturinë e këtij populli të madh që do të rrojë në socializëm të vërtetë».

Letra që u dërguam ne kinezëve do të ketë jehonë të madhe në botë. Ajo do të jetë një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin, për Partinë tonë dhe për revolucionin. Pjekuria, vendosmëria në rrugën e socializmit shkencor, guximi dhe trimëria e Partisë dhe e popullit tonë, do të ndihmojnë edhe shokët e miqtë kudo në botë, që na duan dhe që i duam, që na ndihmojnë dhe i ndihmojmë, pse bëjmë një luftë të përbashkët për përparimin, për lumturinë e njerëzve dhe të popujve. Forcat e bashkuara tonat janë shumë të forta dhe ato u shkaktojnë dëme të pariparueshme armiqve.

**Lufta jonë fitimtare vazhdon, i dashuri shoku**

Hysni, prandaj bëj pushime të mira, të këndshme dhe të qeta, që të ndiheni gjithnjë i fortë si çeliku në betejat që na presin.

Të përqafoj e të puth me mall

*Enver*

Nexhmija të bën ty dhe Vitos shumë  
të fala. Jepi Vitos të falat e mia.

*Enver*

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtim, në gazetën  
«Zëri i popullit», nr. 290  
(10 090), 4 dhjetor 1980*

*Botohet i plotë sipas  
librit: Enver Hoxha, «Letra të  
zgjedhura», vëll. 1, f. 393*

# POLITIKA E KINËS NË BALLKAN

Shënimë

3 gusht 1978

Ekipi Mao Ce Dun-Çu En Lai ka luajtur një rol të madh dhe vendimtar në gjithë historinë moderne të Kinës, që nga lufta nacionalçlirimitare dhe deri sot. Vija e këtij ekipi është bërë lajmëtivi i politikës së Kinës, i asaj politike jomarksiste, por kapitaliste e imperialiste që kanë ndjekur partia dhe shteti kinez. Mao Ce Duni ishte ëndërruesi, vizioneri i një politike feudale, i një politike që e kishte burimin te pikëpamjet mbi Perandorinë e Mesit. Natyrisht, kjo politikë e Maos merrte parasysh ndryshimet e kohës, por në esencë ajo dhe mendimet filozofike të tij kishin për qëllim që Kina të kthchej në një fuqi të madhe për të dominuar botën ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Për sa i përket dominimit ideologjik gjatë gjithë periudhës që ishin në fuqi, të dy këta njerëz kryesorë të ekipit udhëheqës kinez ndërtuan një filozofi të tyren, të cilën e vetëquanin marksiste-leniniste, por që në thelb, në teori dhe në praktikë, nuk ishte marksiste-leniniste. Teoria e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait

ishte një lëmsh teorish idealiste e teorish të reja të kapitalizmit botëror, të pëksura me ca formulime marksiste-lininiste, të përziera edhe me formulime men-shevike, socialdemokrate, sindikaliste e anarkiste, të cilat ata i kishin adaptuar. Që të gjitha këto teori të reja antimarksiste ishin radhitur rrëth boshtit të teorisë së vjetër konfuciane dhe «dialektika» që ngriti në sistem Mao Ce Duni, ishte teoria e daoizmit, një «teori» e të kundërtave, e reduktuar në një banalitet të pakufishëm.

Pra, Maoja ishte ëndërruesi, ishte hija e madhe, kurse Çuja ishte njeriu që shkonte andej-këtej, që gjennente, komplotonte, bisedonte e diskutonte kurdoherë për t'ia arritur qëllimit të tij të caktuar, për ta bërë Kinën një fuqi të madhe.

Çu En Lai ishte një organizator me rëndësi dhe në vijën e tij, mund të themi, ishte shumë i zgjuar. Të gjithë atyre që u interesonte, zgjuarsinë e tij kanë ditur ta vinin në dukje, bile edhe ta fetishizonin, kurdoherë nën hijen e Maos. Maoja ishte perëndia, Çuja i biri. Çdo gjë që bënte Çuja ishte gjoja zhvillimi i mendimit të «timonierit të madh». Por në realitet, po të shohim jetën dhe veprimtarinë e Çu En Lait, do të konstatojmë se ky ka qenë një kameleon i dorës së parë, ka qenë me të gjithë dhe kundër të gjithëve, derisa arriti në një stabilitet për të qenë ekzekutuesi i «timonierit të madh», por një ekzekutues realist, që e linte ëndërruesin të ëndërronte dhe të grinte përralla dhe këto Çuja i kanalizonte në pikëpamjet e veta pragmatiste dhe konkrete.

Gjatë gjithë jetës së Partisë Komuniste të Kinës

ky kamelcon ka qëndruar mbi ujë. Ka ndodhur kështu sepse ai ka qenë me të gjitha fraksionet që kanë dalë dhe, kur ato luftonin njëra-tjetërën, ky dinte të zgjidhë fraksionin e fuqishëm, dinte, gjithashtu, që ta linte në baltë fraksionin që do të humbiste dhe kthente ftyrën drejt fraksionit që do të merrte fuqinë. Kështu që në historinë e Partisë Komuniste të Kinës Çu En Lai ka luajtur një rol djallëzor, të shumëllojtë, të një njeriu ose diplomati pa parim, por zgjuarsia e tij, perspikasiteti<sup>1</sup> dhe busulla e ambicies së tij të madhe përvetveteñ dhe për Kinën e bënин atë që në çdo kthesë të historisë së Kinës të qëndronte kurdoherë si njeriu i dëshiruar dhe i nevojshëm për mbajtjen e timonit. Të gjithë ngriheshin, uleshin, merrnin fuqinë, hidheshin tej, që nga Van Mini dhe deri te Mao Ce Duni, kurse Çu En Lai kurdoherë qëndronte në këmbë, dhe, si të thuash, ishte ai që rregullonte hesapet.

Kështu ka vepruar Çu En Lai edhe me Kominternin. Kominterni ka pasur te Çu En Lai herë mbështetësin e pikëpamjeve të tij të drejta, por, në të shumtata e rasteve, kundërshtarë e direktivave të tij të drejta. Veçse ky kundërshtimi i Çusë ka qenë i kamufluar, që edhe i zbatonte disa direktiva të Kominternit, por, nga ana tjetër, edhe i luftonte.

Kur u thye Ushtria e Kuqe e Mao Ce Dunit dhe filloj marshimi i madh, i cili hyri në histori si një rrgjasje e shquar, por që në realitet ishte një têrheqje jo si çdo têrheqje, Çu En Lai u bashkua me Mao Ce Dunin dhe, pasi likuiduan Komitetin Qendror të drej-

---

1. Nga frëngjishtja — zgjuarsia.

tuar prej Van Minit, caktuan një komitet të ri qendror. Them që e caktuan ata Komitetin Qendror sepse nuk ishte partia dhe kongresi i saj që e bënë këtë, por, si kurdoherë, udhëheqjet e partisë në Kinë kanë qenë dhe janë produkt i klaneve që marrin fuqinë dhe krijojnë një udhëheqje të sajuar me emrin «Komiteti Qendror i Partisë».

Pra, që në atë kohë Çu En Lai ishte faktotumi<sup>1</sup> i «timonierit të madh» dhe ne e shohim atë të lëvrijë si një ngjalë në të gjitha situatat, të marrë kontakte me Çan Kai Shinë, që gjoja luftonte me japonezët, ta lirojë Çan Kai Shinë, kur u zu rob nga ushtria ose nga një pjesë e ushtrisë së kuqe (kjo formohet nga turma njerëzish me armë dhe pa armë që quhen ushtri e kuqe). Çuja lëvrinte në mes oficerëve të lartë anglezë dhe amerikanë, të cilët ndihmonin efektivisht Çan Kai Shinë, por, kur e panë se vaporit i këtij pomytej, i drejtuan sytë më seriozisht nga Mao Ce Duni dhe Çu En Lai.

Nga raportet e agjenturës amerikane, që kanë dalë në dritë me boimin e «Librit të bardhë» për Kinën ose nëpërmjet veprave të Edgar Snout e të tjerëve, mësojmë se dëshirat dhe aspiratat ideologjike dhe politike të Maos dhe të Çusë, që gjatë viteve 40, afrohen shumë me demokracinë amerikane dhe largohen shin nga Bashkimi Sovjetik, të cilin nuk e dheksnin, nuk e pranonin. Ndodhë kjo për arsyen se Bashkimi Sovjetik i Leninit dhe i Stalinit ishte shteti i proleta-

---

1. Nga latinishtja — këtu, në kuptimin e njeriut që merret me gjithçka, që i fut hundët kudo.

rëve, i diktaturës së proletariatit, ishte qendra e revolucionit botëror, kurse strategjia e grupit Mao-Çu ishte që Kina të bëhej qendra e botës dhe ideologjia e tij të përfaqësonte atë ideologji botërore që të mund ta dominonte dhe ta përpunonte njerëzimin sipas një teorie të re, të cilën e quajtën maocedunide dhe që gjoja i përshtatej kohës. Cilës kohë? Kuptohet, kohës së vazhdimit të jetës së kapitalizmit botëror dhe të kërkimit të disa formave organizative dhe politike reformative, për t'ua lehtësuar sadopak popujve shtypjen dhe skllavërimin që u bëhej.

Me fjalë të tjera, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai e ushqenin me këmbëngulje të madhe këtë vijë. Shkrimet e Mao Ce Dunit, që deri diku i zbatonte Çu En Lai, ishin të maskuara me formulime të ndryshme, siç e thashë më parë, formulime të gjitha të kohës, por që në epiqendër kishin filozofinë e vjetër konfuciane të Perandorisë së Mesit dhe organizimin e Kinës sipas parimeve të Konfucit, natyrisht, duke i përshtatur ato me kohën moderne.

Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, së toku me ekipin e tyre, kanë qenë të bindur se kjo «filozofi» do të krijonte simpatinë dhe admirimin e gjithë popujve të botës dhe në këtë mënyrë ata do të realizonin ëndrrat e tyre hyjnore.

Me Shqipërinë dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë Çu En Lai ka zhvilluar kurdoherë një politikë specifike. Ai ka dashur që Shqipërinë socialiste, Partinë e Punës të Shqipërisë, të cilat i përballuan me sukses vështirësitë e panumërtë që u nxorën përpara fashistët italianë, hitlerianët, anglo-amerikanët, titistët,

monarko-fashistët grekë, revisionistët sovjetikë e të tjerë, me këtë autoritet të madh që kishin fituar nga lufta e tyre e vendosur dhe e drejtë, t'i shfrytëzonte në interes të strategjisë së tij. Dhe duhet thënë se Çu En Lai për këtë përdori gjithë dinakërinë, gjithë diplomacinë e tij. Por këto nuk i shkuan, sepse Partia jonë dhe udhëheqja e saj kishin fituar një eksperiencë të madhe dhe e kuptionin esencën e politikës dhe të ideologjisë së Çu En Laiit, u rezistonin djallëzive të tij dhe i vinin atij përpara qëllimin e drejtë të politikës marksiste-leniniste të një vendi socialist dhe të një partie që ndjek me besnikëri socializmin shkencor.

Çu En Lai e nënveftësonte forcën e Shqipërisë së vogël, të cilën synonte ta nënshtonte. Ai u përpoq drejtpërdrejt të na godiste me teorinë e tij pragmatiste, me arsyetimet e tij pa baza, se, siç e thashë më lart, ne «s'duhej të ndërtonim industrinë e rëndë», «s'duhej të linim pas dore fshatin» dhe arriti deri atje sa të thoshte se «ju, shqiptarët, nuk bëni luftë klase! Por në qoftë se ekzistonte një parti që kishte bërë dhe bënte luftë klase të vërtetë në shoqëri dhe në gjirin e vet edhe në periudhën e ndërtimit të socializmit, kjo ishte Partia jonë, kurse kinezët vetë bënin të kundërlën.

Kur Çu En Lai pa se nuk mundi ta lëvizte dot nga rruga dhe vija e drejtë këtë shkëmb graniti, ai u përpoq të na merrte krahët. Këtë mendoi të na e bënte ashtu siç mendojnë dhe siç veprojnë gjithë imperialistët, duke e marrë kalanë nga brenda, duke përfituar nga miqësia midis dy vendeve tona që nga ne ishtë e singertë. Çu En Lai dhe njerëzit e tij përpique-

shin e punonin të krijonin një grup të fortë brenda në vendin tonë, sidomos ushtarak, por edhe ekonomik, që të mund ta hidhte kalanë tonë në erë. Me kohë Çu En Lai ka qenë partizan i këtij komploti, i cili mori fund me shkatërrimin e tradhtarëve Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Abdyl Köllezi, Koço Theodhosi dhe Kiço Ngjela.

Karakteristikë e këtij komploti, të kryesuar nga tradhtarët që përmenda, ishte se ai kishte po ato karakteristika që kanë mbizotëruar gjatë gjithë veprimtarisë së Partisë Komuniste të Kinës dhe të grupit Mao-Çu. Domethënë, ata donin që me anë të ushtrisë të vendosnin në Shqipëri njerëzit e tyre dhe vendin tonë ta kthenin ekonomikisht në një administratë të largme të Kinës, me forma vjetadministruese. Për të realizuar këto qëllime Çuja dhe shokët e lij luanin edhe me kartën e tregtisë, nëpërmjet Kiço Ngjelës, edhe me kartën e investimeve, nëpërmjet Abdyl Köllezit, kurse paçin ushtarak e kishin organizuar me grupin e Beqir Ballukut dhe ishin të sigurt që do të ndihmoheshin nga ata për arritjen e qëllimeve të tyre djallëzore. Udhëheqësit kinezë, e konkretisht Çu En Lai, arritën deri aty sa të propozonin edhe nënshkrimin e një aleance ushtarake midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Rumanisë, me qëllim që dominimi i Kinës mbi Evropë të merrte proporcione më të gjera. Në këtë drejtim punohej në mënyrë të hapët me udhëheqjen revisioniste rumune me Çauheskun në krye, e cila nuk ishte veçse një udhëheqje që lozta në dy-tre plane, edhe të sovjetikëve, dhe të kinezëve e njëkohësisht edhe të amerikanëve. Megjithatë kinezët, nën maskën e grupit të

Çausheskut, që gjoja kundërshton socialimperializmin sovjetik, i zhvilluan haptazi lidhjet me Rumaninë. Për këtë ata patën kundërshtim nga ne, jo se donim t'i pëngonim, por sepse ne i demaskuam udhëheqësit rumunë për politikën e tyre të lëkundëshme, oportuniste revisioniste.

Ne ishim të bindur se kinezët Juanin edhe tablonë e amerikanëve, por edhe tablonë e sovjetikëve: në rast se nuk u dilte gjë nga njëra anë, kthcheshin nga ana tjeter.

Për sa u pürket lidhjeve me Jugosllavinë, ata i zhvilluan ato në heshtje, por me titistët ishin dakord. Kinezët, për Titon, për titizmin, si zakonisht kishin ndryshuar pikëpamjet e asaj kohe kur Titon e quanin një renegat të poshtër, një tradhtar dhe titizmin një agjenturë të imperializmit. Tash ata, në heshtje kishin ardhur në akord, se Titoja na qenkej një «marksist-le-ninist i madh», që «i rezistoi me sukses Stalinit» dhe se në Jugosllavi «ndërtohet socializmi»!

Këto rezultate, që politika kineze e ekipit Mao-Cu kishte arritur në Ballkan, i ishin bërë me siguri të qarta grupit të Beqir Ballukut, prandaj ky në heshtje përgatiti planin e tij «të rrëshqitjes», «të të dalit në mal», «të teorisë së luftës partizane» dhe të unitetit me Jugosllavinë dhe me Rumaninë.

Pra, komploti i Çu En Lait me Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon, Abdyl Këllezin, Koço Theodhosin e Kiço Ngjelën mbështetej në këto tri drejtime: në puçin ushtarak, në vëadministrimin jugosllav e në sabotimin e ekonomisë dhe në veprimin e përbashkët, në një kohë kur uniteti kino-amerikan po bëhej një

realitet. Çu En Lai, pra, kishte në plan ta rrëzonë udhëhcqjen tonë, të shkatërronte ndërtimin e socializmit në vendin tonë, të ndryshonte orientimin politik, ideologjik, ekonomik e ushtarak dhe, në rast se sovjetikët do të na sulmonin nga deti, Beqir Balluku me planin e tij operativ tradhtar, që shkonte në kundërshtim me planin strategjik që kishim vendosur ne për të mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë tokën tonë, veçanërisht bregdetin, por edhe gjithë kufijtë e Shqipërisë, t'ia linte portat hapur flotës sovjetike. Këtu Çu En Lai synonte të realizonte dy qëllime:

**Qëllimi i parë ishte të largonte zjarrin socialimperialist nga Kina, se, pavarësisht nga mburjet dhe nga predikimet se Bashkimi Sovjetik gjoja do të sulmonte Evropën dhe vetëm Evropën, mbasi Kinën «nuk e sulmonte dot», udhëheqësit kinezë i trembeshin një gjëje të tillë. Çuja komplotonte që ta fuste Evropën në zjarr, se ishte e qartë që hyrja e flotës sovjetike në Shqipëri ose lufta jonë për ta penguar hyrjen e saj në vendin tonë do të krijonin turbullira të mëdha në Evropë, gjë që do të shkaktonte një luftë botërore. Ndryshtë prishtë i tërë plani strategjik i Mao Ce Dunit.**

**Qëllimi i dytë ishte Ballkani, i organizuar nga «mençuria» e taknikës së Çu En Lait. Sipas tij, në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk futeshin në orbitën e qëllimeve dhe të dëshirave të Kinës, Ballkani të bëhej një pikë nevralgjike e rrezikshme. Domethënë Çuja, si intrigant që ishte, kërkonte t'i përdorte Shqipërinë dhe Ballkanin si një mollë sherri për të ndezur një luftë të tretë botërore, një luftë midis socialimperializmit sovjetik dhe imperializmit amerikan, midis**

NATO-s e Traktatit të Varshavës, të shpëtonte Kinë nga kjo luftë. Në këtë mënyrë do të ndihmohej strategja e ekspit Mao Ce Dun-Çu En Lai, që Kina të dilte fitimtarë dhe të dominonte botën politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht, gjoja si një vend i madh e i fuqishëm «socialist marksist-leninist», si një fuqi e madhe që do të shkaktonë shkatërrimin e dy supersuqive e do të vendoste supremacinë e saj botërore. Kjo ishte «taktika» e zgjuar e këtij pehlivani, pragmatisti e antimarksisti, që quhej Çu En Lai.

Natyrisht, tash diplomacia botërore i studion këto çështje, po thellohet dhe shikon në to qëllimet e revisionistëve kinezë. Ajo shikon se plani i Çu En Lait për Shqipërinë, Jugosllavinë dhe Rumaninë ishte një intrigë shumë e rrezikshme për të gjithë popujt e Ballkanit dhe të bolës. Përveç Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë luajti një rol vendimtar duke penguar realizimin e planeve të luftënxitësve grabitqarë, duke shkatërruar përgatitjet e një luftë botërore imperialiste. Kjo luftë botërore që predikojnë e përgatitin kinezët, në të cilën Ballkani do të luante lojën e suçisë së barutit, hynte në kategorinë e luftërave imperialiste, të cilat Lenini i quante krim kundër popujve.

Prandaj demaskimi që u bëri Partia e Punës e Shqipërisë gjithë politikës e strategjisë kineze në Letrën e KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze është një provë e madhe e një politike konsekutive revolucionare në interes të mbarë njerëzimit. Kjo politikë krijon dhe

thellon pikërisht ato kontradikta që ekzistonin dhe ekzistojnë midis superfuqive imperialiste, midis vendeve kapitaliste dhe këtyre superfuqive, si dhe midis popujve dhe klikave të tyre udhëheqëse kapitaliste.

Por analiza që bëra më lart prek vetëm një pjesë të politikës djallëzore të grupit Mao-Çu-Ten. Do të përpinqem të gjëj kohë dhe të studioj më thellë qëndrimet politike, ideologjike dhe diplomatike të udhëheqjes kinezë që nga formimi i PKK. Për këtë duhet dhe do të gjëj kohë të studioj sidomos filozofinë e mendimtarëve idealistë të kohëve të perandorisë Cin, të perandorisë Han e të perandoreshave, pse, siç thashë më lart, shohim që në të gjitha shkrimet teorike, politike dhe organizative të udhëheqësve kinezë të çdo kohe të përzihen pikërisht historia dhe filozofia e lashtë kinezë, nga të cilat u mbars edhe «Revolucioni i madh Kulturor», megjithëse u manovrua sikur ky revolucion drejtohej edhe kundër filozofisë së vjetër të Konfucit e të Mencit.

Ky Revolucion Kulturor ka me të vërtetë kuptimin që i është vënë me emërtimin që iu dha prej Maos dhe jo kuptimin e një revolucioni proletar ose «vazhdimin e një revolucioni brenda në revolucionin proletar» siç thoshte shpesh propaganda kinezë. Jo, kjo ishte një gënjeshtër, sepse revolucioni që zhvillohej në Kinë, nuk ishte një revolucion proletar, por një ngritje turmash pa parime, të udhëhequra nga Mao Ce Duni, për të rrëzuar një klan që kishte marrë fuqinë dhe për të vendosur klanin e tij. Dhe kur ky revolucion u quajt Revolucion Kulturor, Maoja filloi t'i referohej gjërësisht literaturës së kohës së perandorisë,

sepse, në fakt, gjithë literatura e zhvilluar edhe pas çlirimit në Kinë, mbështetetë në heronjtë pozitivë ose negativë të literaturës idealiste e pragmatiste të perandorëve të Kinës ose të filozofëve të vjetër kinezë. Pra, edhe lufta klasore e Mao Ce Dunit që gjoja zhvillohej në Kinë bëhej me sponde dhe të duhej të imagjinoje se ku e kishte qëllimin ky ose ai artikull që fliste për perandoreshën Cisi për perandorin që ngriti Murin e Madh ose për Konfucin e të tjerë, e të tjerë.

Të gjitha këto veprime të Maos janë në atë vijë që zhvillohej jo vetëm literatura e lashtë, por edhe teatri i lashtë kinez, i cili ishte i kuptueshëm vetëm për kinezot. Ky teatër nuk kishte dialogë, por vetëm gjeste formale prej të cilave mund të kuptohej përbajtja e një pjese. Kishte edhe një muzikë shurdhue se. Të gjitha këto përbënин, siç pretendonin Maoja dhe Çuja, atë «kulturë të madhe» me të cilën duhej të merrej Revolucioni Kulturor.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha  
«Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm),  
nr. 11, f. 113*

# PËRSE SHIKON HUA KUO FENI NË RUMANI DHE NË JUGOSLLAVI?

5 gusht 1978

## Shënimë

Agjencia kinezë HSINHUA dhe agjencitë e ndryshme perëndimore të lajmeve kanë njoftuar se gjatë këtij muaji Hua Kuo Feni, me një suitë të madhe nga pas, do të shkojë për vizitë zyrtare dhe miqësore në Rumani dhe në Jugosllavi. Kjo vizitë e kreut të socialistëve kinezë në Ballkan ka një rëndësi të veçantë për ne shqiptarët, për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë.

Vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dñe në Jugosllavi nuk ka për qëllim vetëm shtimin e veprimtarisë armiqësore ose komplotuesc kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, por ka dhe karakterin e një intrigë dhe të një komploti ndërkombëtar.

Të marrim, në radhë të parë, çështjen e shtimit të armiqësisë dhe të veprimtarisë antimarksiste kinezë, jugosllave e rumune kundër vendit tonë. Siç dihet, Kina tradhtoi marksizëm-leninizmin ose, po të shprehemi më drejt, ajo e përcaktoi më mirë rrugën e saj kapitalisto-

-imperialiste, se në fakt asnjëherë nuk ka qenë një vend socialist, asnjëherë nuk është udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste. Kina e ashtuquajtur socialiste maskohej, hiqej si një vend socialist i udhëhequr nga një parti gjoja marksiste, por këtë maskë asaj ia çori Partia e Punës e Shqipërisë. Partia jonë zbuloi kalbësirën e Kinës, vuri në dukje politikën dhe ideologjinë antimarksiste që e ka udhëhequr dhe e udhëheq atë, vuri në dukje qëllimet e alcancave të kaluara dhe të sotme të Kinës me shtetet imperialiste, kapitaliste e revizioniste. Për këtë arsyе Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë u shpallën si armiket më të mëdha të Kinës.

Armiq të Shqipërisë, shumë më parë se revizionistët kinezë, kanë qenë titistët jugosllavë. Ata e tradhuan marksizëm-leninizmin dhe me plot gojën mund t'i quajmë, siç i kemi quajtur, renegatë. Pas prishjes më 1948 të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik, me vendet e tjera ish-socialiste dhe me Shqipërinë, u duk qartë qëllimi i devacionit të Titos, i cili konsistonte në realizimin e gjithë kësaj veprimtarie kapitaliste që lulëzon aktualisht në Jugosllavi. Titistët synonin veçanërisht që Shqipëria socialiste, e porsadalë nga lufta, t'i aneksohej Jugosllavisë e të bëhej një republikë e shtatë e saj. Por këtij qëllimi ata nuk ia arritën dhe Partia jonë vazhdimisht ka zhvilluar një luftë konsekuente dhëmb për dhëmb me antimarksistët jugosllavë.

Partia e Punës e Shqipërisë e demaskoi dhe vazhdon ta demaskojë ideologjinë pseudomarksiste të titis-

tëve në të gjitha fazat e zhvillimit të saj deri në fazën aktuale të vetadministrimit titist,, që është një sistem me strukturë dhe superstrukturë antimarksiste.

Hua Kuo Feni, që vjen në Jugosllavi, natyrisht, nuk ka ç't'i shesë Titos, veçse të blejë shumë gjëra nga ai dhe nga titizmi. Në radhë të parë, Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi për të blerë mendimin «filozofik» të titizmit dhe për të mësuar zbatimin e këtij mendimi në Kinë, sipas kushteve të këtij vendi.

Filozofia e Titos, në qoftë se mund ta quajmë këtë një filozofi, është filozofi e një strukture kapitaliste të deformuar, e një strukture anarkiste të maskuar që gjoja drejtobet nga vetë punëtorët e punonjësit, të cilët kanë «demokraci të plotë» dhe këtë «demokraci» e zbatojnë plotësisht sipas qejfit të tyre. Në realitet Titoja me filozofinë e tij ka vënë në plan të parë lirinë individuale, që dominon mbi kolektivin, i cili, sigurisht, ka një rol dhe një detyrë të madhe, por ky kolektiv gjoja udhëhiqet në mendime, në veprime, në realizime, në ndarjen e të ardhurave dhe në bashkësinë vetadministruese të mjeteve të prodhimit nga «të drejtat e plota» të njeriut.

E gjithë kjo teori false e bën Titon që ta ketë zhdukur nga fjalori i tij fjalën revolucion. Ai nuk flet më për revolucionin, nën pretekstin se e ka bërë atë, se «i ka kapërcyer» të gjitha etapat, qoftë atë të revolucionit demokratiko-borgjez me luftën nacionalçlirimtare, qoftë revolucionin socialist. Tash ai ka shkuar në një shoqëri «shumë më të përparuar» nga shoqëria socialiste, në një shoqëri «speciale», «specifike», e cila për të është e vëtmja shoqëri e së ardhmes!

Për këtë arsyë Titoja nuk sheh ndonjë ndryshim në të ardhmen e shoqërisë jugosllave dhe të vendeve të tjera, veçse thotë që «vetadministrimi do të përmirësohet, do të plotësohet e do të korrigohet nga eksperiencia e shoqërisë». Me fjalë të tjera, Titoja ka një urrejtje të madhe për revolucionin, sepse është bërë një autokrat, një mbret e perandor i vërtetë me administratën dhe burokracinë që ka ndërtuar në format e vetadministrimit. Kjo teori e tij u afrohet, ose më mirë të themi u ngjet ëndrrës dhe objektivave të teorisë së Mao Ce Dunit, i cili në fakt krijoi një filozofsi, si të thuash, të një monarkie individuale ose kolktive. Kjo filozofji e Maos i ka rrënjet te perandoritë e vjetra kinezë, ruan bazat e filozofisë së vjetër kinezë, thelbin e kësaj doktrine, mënyrën e drejtimit e të administrit të vjetër kinez, por, nalyrisht, tash paraqitet e veshur me petkat moderne të shoqërisë kontemporane dhe të zhvillimit të saj.

Po në ndryshim nga Jugosllavia, dhe në kundërshtim me çka po bëhet në fakt në Kinë dhe në Jugosllavi, në Kinë flitet shumë për «revolucionin», për «revolution socialist», për kontradiktat, për tezat dhe për antitezat. Të gjitha këto i ka pasë zhvilluar Mao Ce Duni në «filozofinë» e tij dhe i ka ngritur në një teori specifike që t'i përshtatej strukturës që ëndërronte të ndërtonte në Kinë. Kjo «filozofi» e tij nuk ka asgjë të përbashkët me filozofinë materialiste të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ai ka adaptuar disa forma dhe disa ide, por si brendia, edhe frazologjia përfaqësojnë në të vërtetë një filozofi idealiste.

**Mao Ce Duni** është një dishepull i vërtetë i Ernst

**Hekelit, një idealisti gjerman që paraqitej me një filozofi gjoja materialiste.** Revolucioni i Mao Ce Dunit nuk është revolucion proletar, nuk është revolucion për krijimin e një shoqërie pa klasa antagoniste, për zhdukjen e klasës borgjeze dhe për krijimin e shoqërisë sociale. Jo, Mao Ce Duni është për një «revolucion të vazhdueshëm» për të mos thënë, siç thoshte Trocki, për një «revolucion permanent».

Ne i njohim pikëpamjet e Trockit për revolucionin, qëllimet e falsitetin e tij dhe shohim se filozofia e Mao Ce Dunit për revolucionin konsiston në atë që ky revolucion nuk do të ketë kurrë as qëllime, as mbarimi. Ai vetë ka pohuar shumë herë se «pas një revolucioni duhet të vijë një kundërrevolucion, pas një kundërrevolucioni një revolucion e kështu me radhë për dhjetëra e mijëra vjet». Maoja ka arritur deri atje, saqë filozofinë idealiste të tij ta kthejë në një dogmë fetare, kur thotë se revolucioni do të mbarojë me shuarjen e diellit, pra, me zhdukjen e jetës në planetin tonë.

Kur e studion këtë «teori» filozofike të Mao Ce Dunit, të kujtohet vepra «Materializmi dhe empirio-kriticizmi», në kapitullin e fundit të së cilës Lenini, duke njobur pikëpamjet materialiste të filozofit gjerman Hekel, e quan këtë një atu fetare, që kërkon të krijojë një filozofi materialiste, por në të vërtetë ajo është krejt fetare.

C'thoshte Hekeli? Ai thoshte pikërisht atë që po-hon Maoja dhe është ky që e ka kopjuar gati tekstuagli Hekelin. Ndërsa Hekeli thoshte që bota do të zhvillohet sipas teorisë së Darvinit dhe do të jetë në

lëvizje ose, si të thuash, në evolucion të përhershëm e të paqëndrueshëm, Maoja thotë se një revolucion do të kalojë nga një etapë në tjetrën, në një kundërrevolucion, nga një kundërrevolucion në një revolucion dhe kështu me radhë deri në fund. Pra për Hekelin, dhe për Maon revolucioni nuk ka një qëllim, kurse për ne, marksistë-leninistët, revolucioni ka një qëllim: zhdukjen e borgjezisë, zhdukjen e klasave shfrytëzuese, shpronësimin e mjeteve të tyre të prodhimit, krijimin e shoqërisë së përbashkët mbi pronësinë e mjeteve të prodhimit, krijimin e shoqërisë socialistë, zhvillimin e luftës së klasave dhe kalimin në një shoqëri pa klasa, në komunizëm. Teoria e Mao Ce Dunit nuk ka këtë qëllim, por pikërisht të kundërtën e tij, prandaj ajo nuk mund të quhet teori revolucionare, por kundërrevolucionare, antisocialiste.

Në qoftë se do të shpreheshë në mënyrë figurative, do të thosha që Mao Ce Duni e konsideronte teorinë revolucionare në këtë formë vulgare: përpara kemi një katarakt nga i cili rrjedhin ujëra të bollshme në një fushë të gjërë dhe, pasi bëjnë zhurmë të madhe, duke marrë me vete ç'gjejnë përpara, përhapen në fushë dhe formojnë një këncë ku rrojnë bretkosa e mushkonja. Në një moment tjetër ky ujë i ndenjur has në një kaskadë të re dhe krijon përsëri një katarakt tjelër. Uji rrjedh te poshtë me forcë e me bujë, dhe përsëri përhapet në një fushë, ku formon moçale si më parë, e kështu me radhë. Dhe Mao Ce Duni në këtë rënie, pra në këtë kaskadë uji, nuk ndërlton turbina për elektrifikimin që të bonifikojë fushën e të mës e lërë më atë vend me ujë të qelbur për bretkosa, mushko-

nja, zvarranikë e kafshë të tjera. Maoja s'e bën këtë gjë. Ai e kuption revolucionin në formën dhe në mënyrën që thashë më lart, pra, si një përsëritje në vete.

**Kurse Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini** nuk janë për këtë filozofi idealiste, as për këtë pseudorevolution të Mao Ce Dunit. Hua Kuo Feni do të vijë në Jugosllavi të mësojë nga Titoja se si ka mundur ky të hedhë poshtë teorinë marksiste-leniniste të revolucionit dhe të stabilizojë vetadministrimin. Domethënë, udhëheqësit e partisë dhe të shtetit kinez vijnë në Jugosllavi që të marrin eksperiencë mbi ndërtimin e një shoqërie hibride, kapitalisto-anarkiste, të përshtatshme për situatat e krijuara në vendin e tyre, sepse, në fakt, një regjim i tillë si ai i Jugosllavisë, natyrisht në vija të përgjithshme, ka filluar dhe do të realizohet në Kinë. Veçse këtu duhet thënë se mentaliteti i kinezëve është shumë më prapa në krahasim me mentalitetin e jugosllavëve. Pra zhvillimi kulturor i jugosllavëve, për sa u përket kulturës dhe filozofive të ndryshme botërore, në përgjithësi është shumë më përpara sesa mentaliteti kinez, që është një mentalitet konservator dhe i konformohet asaj filozofie të vjetër kineze, që udhëheqësit e këtij vendi e ruajnë dhe mbështeten në të.

Udhëheqësve kinezë, për të ndërtuar kapitalizmin në vendin e tyre, do t'u duhet të bëjnë edhe transformime të thella në pikëpamjet retrograde të popullit. Populli kinez është një popull i zgjuar, por i mbajtur në errësirë, atë e kanë mënjanuar nga zhvillimi i kulturës botërore. Edhe pas çlirimt ai është ushqyer va-

zhdimesht me një filozofi, me një ideologji dhe kulturë të shartuar shumë keq ose me një kulturë të vjetër kineze me disa retushe të përcipta të kulturës botërore. Kështu që udhëheqjes kineze, i duhet të bredhë të gjitha kontinentet e globit, të gjitha shtetet kapitaliste dhe të marrë, për regjimin aktual kapitalist kinez, eksperiencë në çdo gjë, për çdo gjë, në çfarëdo sferë, në sferën materiale dhe në sferën shpirtërore, në kulturë, në ideologji dhe në ndërtimin e një superstrukturë të re kapitaliste.

Kjo është arsyja që tash shohim një dyndje të jashtëzakonshme, të paparë ndonjëherë, të ekipeve të panumërtë, të përbëra nga qindra e qindra kinezë, që shkojnë nga të gjitha anët e botës për të marrë kredi, për të marrë eksperiencë. Gjithë kjo dyndje e kinezëve në vende të huaja bëhet me qëllim që në Kinë të ndërtohet një shoqëri e tillë që t'u përshtatet situatave aktuale, investimeve të investorëve kapitalistë e gustoje të këtyre investorëve, të cilët pa dyshim do ta ndihmojnë Kinën në këtë drejtim.

Ne do të shohim të ekzistojë në Kinë, për një periudhë shumë të gjatë, një kaos i madh mendimesh dhe veprimesh. Kjo periudhë e gjatë do të përmbajë zigzage shumë të theksuara, bile dhe përpjekje të shtresave të ndryshme të popullsisë së këtij vendi. Ne, gjithashtu, do të shohim grupime revolucionarësh, të cilët, pas këtyre vuajtjeve që po pësojnë, me kalimin e kohës do të kuptojnë se i vetmi shpëtim i tyre dhe i Kinës është zbatimi me përpikëri i teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit, sipas kushteve konkrete të këtij vendi do të hedhin poshtë e do të

demaskojnë teorinë false pseudomarksisteleniniste të Mao Ce Dunit, teorinë idealiste dhe kontradiktat ose dialektikën pseudomaterialiste të tij.

Hua Kuo Feni nuk është i pari që vjen në Jugosllavi për të mësuar teorinë e Titos, sepse për këtë qëllim ai ka dërguar me kohë dhe vazhdon të dërgojë filozofë dhe organizatorë, njerëz të kulturës, punonjës të bujqësisë, të financave, inxhinierë, teknikë etj. Këta janë dërguar atje për të marrë konkretisht eksperiençën e strukturës kapitaliste anarkosindikaliste jugosllave dhe, në përgjithësi, atë të superstrukturës së përshtatshme për këtë strukturë. Kështu Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi për t'u përalur përpara Titos, për t'u thënë atij dhe botës se udhëheqja kineze një gabimet e mëdha të Mao Ce Dunit, i cili, në një kohë (jo se udhëhiqej nga pikëpamjet marksiste-leniniste) kishte sulmuar Titon si antimarksist, renegat dhe sistemin që po vendosej në Jugosllavi si një sistem kapitalist.

Me fjalë të tjera, Hua Kuo Feni vjen në Beograd më keq se Hrushovi dikur. Hua Kuo Feni ndjek dy qëllime: Së pari, t'i thotë botës se Kina, dhe veçanërisht Mao Ce Duni, kanë gabuar rëndë ndaj Titos e titizmit, se ata gjoja kanë qenë influencuar nga Stalini dhe, me dashje ose pa dashje, kanë zbatuar direktivat e tij për demaskimin e titizmit; së dyti, duke vepruar kështu, Hua Kuo Feni sulmon njëkohësisht Stalinin e bolshevizmin, por edhe Maon, të cilin e kanë pompuar si një «filozof të madh», si një «ideolog e vazhdues të veprës së Marksit e të Leninit» dhe e kanë shpallur si perëndi, si «papén» e «komunizmit të ri».

Tash «papa» tjetër i këtij «komunizmi të ri», Hua Kuo Feni, vjen në Beograd t'i thotë Titos dhe mbarë botës se Maoja s'qenkej ashtu siç është cilësuar, prandaj atë dhe pasuesit e tij ne i dënuam, vetëm se dënimin e Maos nuk e kemi shpallur akoma haptazi, por aty jemi, ne po e diskreditojmë atë në gjithë veprimtarinë e tij. Ne, do të thotë Hua Kuo Feni. jemi për një filozofi që kërkon një botë të qëndrueshme e me teknologji të përparuar dhe këtë shoqëri që kërkojmë ne, e kemi gjetur te shoqëria e përparuar amerikane, jugosllave etj.

Pra, Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi që të bëjë autokritikë përpara Titos, të njohë epërsinë ideologjike të titizmit dhe të kërkojë prej tij ndihmë, më tepër morale, sesa materiale. Këtë e them se duhet të pranojmë që Hua Kuo Feni do të kërkojë nga Titoja ndonjëfarë eksperience për të marrë kredi nga imperialistët amerikanë dhe nga gjithë imperialistët e tjerë. Ai do të kërkojë sidomos që Titoja të bëhet ndërmjetësi më i mirë (siç ka qenë kurdoherë dhe siç është bërë në çdo kohë, i të gjithë renegatëve dho i të gjithë atyre borgjezëve kapitalistë që ndodheshin në një *marasme*<sup>1</sup>, siç ndodhej edhe Jugosllavia) për të kerkuar ndihmën e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë, por, kuptohet, duke u shitur imperialistëve pasuritë e vendit, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin. Këtë gjë do të kërkojë Hua Kuo Feni nga Titoja.

Me rëndësi të madhe do të janë intrigat politike që do të kurdisin Hua Kuo Feni dhe Titoja. Do të kenë

1. Frëngjisht — dobësi e madhe, apati e thellë, amulli.

**apo jo sukses këto intriga, është tjetër çështje, por që të dy janë intrigantë.** Duke bërë analizën e situatës botërore sipas pikëpamjeve të tyre antimarksiste, ata do të përpiken të dalin në disa shtigje të përbashkëta, për të kriuar disa situata të reja politike që t'u shërbijnë forcimit të kapitalizmit botëror dhe veçanërisht shteteve kapitaliste në vendet e tyre.

Hua Kuo Feni, përfaqësues i Kinës me një popullsi prej 800-900 milionësh, kërkon të nxjerrë disi popullin e tij nga mjerimi, që të evitojë revoltat e pashtmangshme, prandaj ai ka nevojë për një ndihmë të fuqishme nga imperialistët e ndryshëm. Kjo ndihmë i duhet për të kriuar atë shtresë kapitaliste të përparruar, me një teknologji moderne, për të kriuar atë pushtet kapitalist dhe ato armë që ta ruajnë e ta mbrojnë këtë pushtet nga revoltat dhe revolucionet popullore. Këta antimarksistë e dinë fare mirë që dialektikisht, si kudo gjetkë, edhe në Kinë, revolucioni do të shpërthejë kur të piqen kushtet. Pra, në këtë gjendje kaotike Hua Kuo Feni nuk vjen te Çaushesku dhe tek Titoja vetëm për t'u bërë atyre një vizitë kortezie. Jo, vizita e tij ka qëllime politike.

Ne e dimë fare mirë se ç'qëndrime politike mban Titoja. Ai hiqet si udhëheqës i «vendeve të paangazhuara» dhe ka bërë e po bën përpjekje të mëdha që lëvizja e këtyre vendeve të konsiderohet si një fuqi e madhe që gjoja neutralizon influencën néfaste, negative të superfuqive. Por kjo që thotë Titoja është një profkë sepse superfuqitë lëvrojnë, intrigojnë dhe bëjnë çdo përpjekje materiale, politike e filozofike që nga njëra anë të mbajnë popujt e botës të shtypur

e të përçarë, dhe nga ana tjetër të krijojnë e të fuqizojnë klikat që sundojnë mbi popujt në këto vende. Me fjalë të tjera, ata përpiken të shkojnë deri atje saqë në ato vende, ku interesat e tyre janë në rrezik, të krijojnë kontradikta, të cilat, natyrisht, do t'i futin popujt në luftë njëri me tjetrin e do të shkaktojnë gjakderdhje. Kontradikta nuk do të zhvillohen vetëm midis popujve të atyre vendeve ku sundojnë superfuqitë, por edhe midis vëtë superfuqive. Ato do të thellohen deri në shpërthimin e një luste të re botërore. Kina e Hua Kuo Fenit e predikon këtë luftë, por ama që ta bëjnë të tjerët.

Jugosllavia e Titos hiqet si një vend i paangazhuar, por në të vërtetë është e angazhuar ndaj imperializmit amerikan, si dhe ndaj shteteve të tjera kapitaliste perëndimore, që e kanë subvencionuar dhe e mbajnë gjallë. Në këtë drejtim Jugosllavia është bërë një neokoloni e kapitalizmit amerikan dhe e atij botëror. Por Titoja, si një element trockist, revisionist e si ballkanas i zgjuar ka një kapacitet manovrimi dhe e ruan deri diku «neutralitetin». Si në aparençë, ashtu edhe në praktikë ai nuk i acaron situatat me revolucionistë sovjetikë në atë mënyrë që i ka acaruar dhe po i acaron aktualisht Kina e Mao Ce Dunit dhe e Hua Kuo Fenit.

Titoja nuk shprehet si kinezët që armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik; ai, gjithashtu, nuk thotë se armiku kryesor është imperializmi amerikan, por, pa u vënë emrin, thotë se fuqitë imperialiste ose hegemoniste janë të rrezikshme dhe se «bota e paangazhuar» duhet të zhvillojë një politikë të tillë që «l'u ku-

ndërvihet» ekzigjencave të superfuqive. Ai është një intrigant. Titoja nuk është «boshti» i botës, por është një batakçi i zgjuar. Ai, siç e kam thënë dhe herë të tjera, në tratativat që bën me qeveritë e ndryshme nxjerr fitime, bie dhc shpie, nxjerr deduksione, talon pulsin e njërit e të tjetrit, dhe atje ku i intereson, bën përpjekje të ndihmojë ato klane dhe ato klika që tregohen të gatshme t'i shërbejnë politikës së tij për të përsituar sa më shumë nga bankat e njërës ose të tjetrës superfuqi, për «lulëzimin» e Jugosllavisë së tij gjoja socialiste.

Sigurisht, Titoja me Hua Kuo Fenin do të bëjnë një «politikë të madhe» dhe që të dy do të jenë dakord në çështje kryesore të politikës ndërkombëtare. Që të dy janë dakord për luftën që duhet t'i bëjnë Shqipërisë, sepse për të dy këta Shqipëria është armiku i tyre më i madh. Por Shqipëria është, gjithashtu, armiku më i madh i gjithë botës kapitaliste jo nga madhiësia e territorit të saj, jo nga nunri i populsisë së saj, por nga idetë marksiste-leniniste që ajo përfaqëson dhe mbron. Prandaj qëllimi, dëshira e kapitalizmit botëror dhe e të dy kalanderëve, Tito-Hua, është që zérin e fuqishëm të Shqipërisë, që dëgjohet sot në të katër anët e botës, ta mbytin. Por që ta mbytin këtë zë, më parë ata duhet të shkatërrojnë vendin tonë, ta degjencrojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, domethënë të bëjnë te ne ato transformime kapitaliste që përfshijnë vendet e tyre. Në këtë rrugë të dy këta do të përpiqen të krijojnë dhe të forcojnë bllokadën politike dhe ideologjike po e po, por edhe bllokadën ekonomike, duke menduar se Shqipëria nuk do të

mund të rrojë dot e vëtmuar, pa marrë kredi dhe ndihma nga shtetet e tjera kapitaliste e revisioniste. Ata mendojnë kështu dhe janë të bindur për këtë gjë, sepse filozofia ku ata mbështeten është e tillë. Qoftë Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, qoftë Titoja, qoftë kapitalistët, në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, që të gjithë zhvillojnë këtë veprimtari. Ata rrojnë në sajë të investimeve të njëri-tjetrit, në sajë të krijimit të shoqërive të përbashkëta, të shfrytëzimit të përbashkët të pasurive të popujve në favorin e më të madhit, duke lënë të varur nga kapitali i madh pavarësinë, sovranitetin dhe lirinë e popujve të tyre.

Në këtë drejtim, pra, për sa i përket luftës kundër Shqipërisë, Hua Kuo Feni do të ngulë këmbë më shumë, për arsyen se Titos i është regjur lëkura nga lufta e ashpër dhe e vazhdueshme që i kanë bërë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika jonë Popullore Socialiste dhe se titizmi ka gjetur njëfarë stabiliteti në botë. Pavarësisht se marksistë-leninistët dhe Partia e Punës e Shqipërisë e demaskojnë çdo ditë Jugosllavinë titiste, cipa e fytyrës së saj nuk skuqet, ajo mbeton ashtu siç ishte, bjellogardiste e grevëthyese. Kurse aktualisht Hua Kuo Feni, me cipën e tij të verdhë, është inatosur jashtëzakonisht për shkak të demaskimit radikal që po u bëhet dhe që do të vazhdojë t'u bëhet vijës dhe veprimtarisë antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës e të udhëheqjes së saj nga Partia e Punës e Shqipërisë.

Kjo është arsyja që kapitalizmi i ri kinez, revisionizmi specifik kinez shpërtjen hapur ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj Partisë marksiste-leniniste të Pu-

nës të Shqipërisë. Kjo duhet të na bëjë ne shumë vigjilentë dhe, pa ditur se ç'mund të bisedojnë konkretisht, ne mund t'i marrim me mend se ç'metoda do të përdorin ata, po të mundin, që t'ua arrijnë qëllimeve të tyre kundër vendit tonë. Por ata nuk do të mund t'i realizojnë qëllimet e tyre armiqësore dhe do të dështojnë. Veçse këtu ka një gjë: Titoja nuk do të jetë shumë i zellshëm në propozimet e Hua Kuo Fenit për sa i përket Shqipërisë, se nuk është budalla si Hua Kuo Feni. Ai ka fituar një eksperiencë nga ndeshja me shqiptarët dhe e di fare mirë që Shqipëria nuk është një kockë e lehtë për t'u gëlltitur. Në rrugën e tij armiqësore për të realizuar çka dëshiron kundër vendit tonë ai ka shumë vështirësi.

Së pari, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është e fortë, se populli shqiptar është një popull trim, se Partia e Punës e Shqipërisë ka një të kaluar të lavdishme, ka një unitet të çeliktë marksist-leninist në radhët e saj dhe ka përballuar me sukses të gjitha vështirësitë që i janë krijuar dhe sulmet oë i janë bërë. Prandaj, po t'i futet një lufte ideologjike ose politike, për të mos thënë një lufte të armatosur me Shqipërinë, Titoja e di se do të ketë humbje të mëdha, se populli ynë do ta mposhtë këtë lufte të titizmit.

Së dyti, lufta kundër Shqipërisë në Ballkan, e marrë si e shkëputur, nuk është aq e lehtë për Titon, për arsyen se në Jugosllavi ndodhet një popullsi e madhe shqiptare. Kjo popullsi shqiptare që jeton në trojet e veta që i janë shkëputur Shqipërisë, ka vuajtur shumë nga serbomëdhenjtë e nga titizmi. Për vë-

llezërit tanë të një gjaku, që jetojnë përtej kusirit, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, atdheu i tyre, është shumë i dashur dhe, aktualisht, në qoftë se preket Shqipëria, preken edhe ata në Jugosllavi. Kjo do të krijojë një situatë të re në disfavor të titizmit e do të jetë një katastrofë për të. Kësaj gjëje Titoja i ruhet si në platformën kombëtare, ashtu edhe në atë ndërkombëtare, për arsyë se ekzistojnë kontradikta të mëdha për një veprimitari të tillë të ndërmarrë nga vetë Titoja se Hua Kuo Feni vetë s'ka ç'i bën Shqipërisë nga larg. Hua Kuo Feni do të përpinqet që Titon dhe Çausheskun t'i bëjë me vete, me qëllim që këta të dy dhe miqtë e tyre të kurdisin diçka kundër Shqipërisë. Prandaj në bisedimet që do të zhvillojë Hua Kuo Feni, në Rumani e në Jugosllavi do të ketë edhe koordinime e akorde, por edhe disakorde.

Në parim dhe në strategji Titoja dhe Hua Kuo Feni janë dakord kundër Shqipërisë, veç në taktika jo, për arsyet që thashë më lart. Pastaj çështja e Ballkanit është shumë delikate, por këtë nuk e kupton fare Kina e Mao Ce Dunit, e Çu En Lait, e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit. Këta njerëz janë «barëra të egra» të një shteti të madh, që janë harlisur dhe mendojnë se pikëpamjet e veprimet e tyre duhet të dominojnë e të udhëheqin botën dhe të gjithë t'i dëgjojnë e të veprojnë sipas këshillave të tyre. Për këtë arsyë udhëheqësit kinezë mendojnë se do të bëjnë një politikë efikase në Ballkan, se këtë politikë do të mund ta organizojnë me shtetet ballkanike për të bërë një barrierë të fortë kundër Bashkimit revisionist Sovjetik, barrierë që do të shërbejë, gjithashtu, për ta izo-

Iuar, për të ndërhyrë dhe për ta pushtuar Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Njëkohësisht një politikë e tillë ndihmon edhe imperializmin amerikan, me të cilin Kina dhe Jugosllavia janë të lidhura ngshtë. Në këtë çështje interesat e të dy kalanderëve do të puqen dhe që të dy do të përpinqen të koordinojnë disi veprimet e tyre. Megjithatë Titoja si më i regjur në këto punë nuk do t'i pranojë të gjitha marrëzitë e Hua Kuo Fenit.

Titoja mbështetet tek imperializmi amerikan dle te partnerët e tij; ai është për NATO-n dhe këtë pakt ushtarak e konsideron si një forcë mbrojtëse të tij, por pa e pohuar një gjë të tillë. Ai ka frikë nga Traktati i Varshavës dhe nga Bashkimi Sovjetik, megjithatë përpinqet të tregohet si «neutral». Kurse Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit ka deklaruar hapur se është pro NATO-s dhe Tregut të Përbashkët Evropian, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Traktatit të Varshavës dhe KNER-it. Në këto qëndrime taktime Hua Kuo Feni dhe Titoja nuk janë dakord, prandaj dëshirat e Hua Kuo Fenit, për të krijuar një Ballkan sipas pikëpamjeve të tij, nuk mund të realizohen me Jugosllavinë. Nuk mund të realizohen as me Rumaninë, sepse shteti rumun është në shërbim të sovjetikëve. Bashkimi Sovjetik nuk duron vicka. Në qoftë se Çaušesku do të hidhte vicka tok me njerëzit e tij, në kundërshtim me interesat e mëdhenj e të thellë të Bashkimit Sovjetik, ky do ta kishte hedhur me kohë në erë nga brenda, pa ndërhyrë si në Çekoslovakia me tanke. Por një gjë të tillë Bashkimi Sovjetik nuk e bën edhe për shkak të opinionit botëror, por edhe për

arsye se ka fitime nga Çaushesku, nga ky njeri pa principe, që përpinqet të bëhet një «figurë e madhe botërore».

Udhëheqja kineze e ka ndihmuar dhe po e ndihmon Çausheskun, sepse ajo nuk i njeh dhe nuk ka atë forcë logjike t'i gjykojë në thellësi veprimet dhe mendimet e tij. Përveç kësaj, duhet mbajtur parasysh edhe çështja tjetër: Kina, duke ndjekur një politikë të lëkundshme, duke bërë zigzage shumë të mëdha gjatë gjithë kohës, që nga viti 1949 e deri tash, ka mundësi që në momente të caktuara ta kthejë sityrën nga Bashkimi Sovjetik, ta braktisë alcancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose të arrijë të mbajë një pozicion si të Jugosllavisë titiste, domethënë të bëjë një kthesë 90 ose 180 gradëshe, drejt Bashkimit Sovjetik.

E gjithë kjo manovër e kinezëve ka për qëllim që Kina të fitojë kohë, të bëjë shantazhe, të tregohet si një fuqi e madhe politike dhe ekonomike që mund të dalë «në tregun botëror», të tregohet si një shtet që hapet nga të katër anët, me të gjitha shtetet kapitaliste, se edhe ata nga kjo hapje e Kinës kanë fitime të mëdha. Kështu Kina bëhet një faktor i rëndësishëm në statukuonë botërore kapitaliste. Me fjalë të tjera, sipas kinezëve, Kina e Mao Ce Dunit dhe e Hua Kuo Fenit bëhet një fuqi e re imperialiste reaksionare që i vë frq, i vë kusi imperializmit sovjetik dhe krijon mundësinë e një rindarjeje të re të botës në kurrizin e popujve të ndryshëm dhe në disfavorin e revolucionit proletar.

Nga informata të sigurta mësojmë se kinezët,

para se Hua Kuo Feni të vejë në Rumani dhe në Jugosllavi, po bëjnë një politikë dritëshkurtër pranë ministrike të jashtme të shteteve të ndryshme të Ballkanit, deri dhe te presidentët e republikave, si tek ai i Turqisë, i Greqisë dhe i Bullgarisë. Në se konsiston kjo politikë e kinezëve? Konsiston në propagandën që bëjnë këta njerëz «të zgjuar» për «t'u hapur sytë» turqve dhe grekëve për rrezikun e madh që u turret nga ana e sovjetikëve. Pra, sipas kinezëve, njerëzit që udhëheqin këto dy shtete kapitaliste, sikur kanë dalë tash nga veza dhe nuk e njohin botën, as shtetet kapitaliste e as qëllimet e tyre, prandaj presin që t'ua thotë këto njëfarë Hua Kuo Feni nga Kina! Nga ana tjetër, politika që po bën Kina, duke u thënë këtyre shteteve të dobësojnë marrëdhëni ekonomike e shtetërore me Bashkimin Sovjetik, synon të krijojë një koalicion pro-kinez në mes popujve të Ballkanit. Me fjalë të tjera, nga ana e Kinës kjo është historia e krijimit të një brrikade të re ballkanike kundër Bashkimit Sovjetik.

Udhëheqësit kinezë, me politikën që po bëjnë kundër vendit tonë, përpinqen, gjithashtu, të propagandojnë në shtypin e tyre se Shqipëria, e rrethuar nga të katër anët nga vende armike të saj, tash që kinezët e lanë, është e detyruar të mbështetet diku. Dhe, natyrisht, preferojnë që ne të mbështetemi te Jugosllavia dhe te Rumania ose te ky koalicion ballkanik që kanë ëndërruar dhe ëndërrojnë kinezët.

Ky ishte edhe qëllimi i propozimit të Çu En Lait, të cilin ne qysh atëherë ia hodhëm poshtë dhe aktualisht e demaskuam botërisht. Tash këtë gjë kërkon të realizojë Hua Kuo Feni me ardhjen e tij në Beograd.

Ai dhe propaganda kineze punojnë për të gënjer opinionin botëror se Shqipëria paska vetëm dy mundësi: osc të bashkohet me Jugosllavinë, domethënë të lidhë aleancë me të dhe kështu të futet në aleancë edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilat Kina është bërë bythë e brekë, siç themi ne shqiptarët, ose të mbështetet te revisionizmi sovjetik dhe te satalitet e tij.

Në këto dy tablo përpinqet Kina të dëmtojë qëndrimin burrëror marksist-leninist, e të palëkundshëm të Partisë dhe të shtetit tonë proletar. Por ajo, ashtu si dhe gjithë reaksioni botëror, do të dështojnë. Ne nuk do të mbështetemi tek imperializmi amerikan, te borgjezia reaksionare, te NATO-ja dhe Tregu i Përbashkët Evropian, por do t'i luftojmë këta me ashpërsinë më të madhe. Ne, gjithashtu, do të luftojmë me rreptësinë më të madhe socialimperializmin sovjetik, Traktatin e Varshavës, KNER-in dhe të gjitha ato shtete, që nga Jugosllavia e deri te djalli me të birin, që do të përpinqen të dëmtojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

**Pra, portet tona nuk do të hapen kurrë as përfotën e Bashkimit Sovjetik, as përfotën e NATO-s dhe kufijtë tanë tokësorë nuk do të çahen, nuk do të kapërcehen nga asnjë fuqi armike. Kush do të guxojë të prekë kufijtë tanë, do të gjejë vdekjen. Këtë gjë ne ia kemi bërë të qartë gjithë botës dhe përsëri do ta theksojmë edhe në të ardhmen. Shqipëria do të mbetet kurdoherë e pavarur. Ajo nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e izoluar, se me të janë popujt dhe interesat e popujve, dëshirat dhe pikëpamjet liridashëse të tyre**

nuk mund të konfondohen me qëllimet e aspiratat e milionerëve e të miliarderëve kapitalistë dhe revizionistë.

**Popujt, proletariati, elementët përparimtarë** në botë janë me ne. Këtë e ka provuar koha, e kanë provuar batejat tona të njëpasnjëshme fitimtare kundër superfuqive, kundër titizmit, kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe aktualisht kundër revisionistëve kinezë. Për këtë arsyе propaganda kincze dhe propaganda keqdashëse kapitaliste nuk mund të gënjejnë opinionin botëror se gjoja Shqipëria aktualisht do të mbështetet te Bashkimi Sovjetik. Jo! Kjo nuk do të ngjasë kurrë! Shqipëria e urren socialimperializmin sovjetik aq sa urren edhe imperializmin amerikan.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë udhëhiqen nga një doktrinë, e cila ndjell miqësinë me popujt, prandaj edhe te popujt e Greqisë, të Jugosllavisë e të Italisë që i kemi rrëth e rrotull, ne kemi miq të shumtë. Qëndrimet e drejta të Partisë së Punës të Shqipërisë e të shtetit shqiptar, në mos thellësisht, kanë hyrë deri në njëfarë shkalle në masat punonjëse të këtyre vendeve dhe kanë bërë që të zhduken ato ndjenja armiqësore që ishin kultivuar më parë kundër Shqipërisë, nga regjimet reaksionare të këtyre vendeve, që na konsideronin si një plaçkë tregu që shitej e blihej nga rusi, nga jugosllavi, nga kinezi e të tjerrë. Por me kalimin e kohës, politikanë borgjezë të arsyeshëm të këtyre vendeve panë se gaboheshin në mendimet e në politikën e tyre të mëparshme ndaj Shqipërisë, ata panë se Shqipëria e vogël nuk është përkur-

Iur dhe nuk do të përkulet kurrë para çfarëdo diktati, para çfarëdo fuqie dhe kështu reflektuan ndaj dëshirës së saj për të pasur marrëdhëniet e mira sqinjësie në interes të përbashkët, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit.

Politika e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë ka një efekt të madh në Ballkan. Ky efekt do të bëjë të dështojnë edhe megalomania e shitetit të madh kinëz e komplotet që po bën ky shtet në rajonin e Ballkanit dhe në botë kundër vendit tonë. Pó ashtu do të bëjë të dështojnë edhe synimet e fshehta dhe të hapëta të revizionizmit jugosllav e të megalcidesë greke. As socialimperializmi sovjetik dhe as imperializmi amerikan me intrigat e tyre nuk do të mundin ta dëmtojnë dot këtë politikë të drejtë dhe të qëndrueshme si malet tona të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Natyrisht, vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi do të bëjë bujë në botë, po buja do të jetë në disfavorin e Kinës dhe në favorin e Jugosllavisë. Sa për Rumaninë, kjo vizitë nuk do të ketë asnjë efekt, për arsyen se gjithë bota e di që Rumania është një vend i shitur, që e frys era nga shumë anë. Imperialistët dhe reaksiioni kanë besim të madh te Jugosllavia titiste, se kjo u shërbën më shumë imperialistëve amerikanë dhe imperialistëve perëndimore, të cilët dëshirojnë që Jugosllavia të ketë përkrahjen e Kinës, që ajo të ketë te Kina një treg të madh për eksportet e veta. Me vajtjen e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi Titoja do ta krijojë këtë treg se ka nevojë të madhe për të. Një gjë e tillë do ta ndihmojë Jugosllavinë që të zbrazë depot e të zvogëlojë në këtë mënyrë

papunësinë që mbretëron atje. Këtë gjë Titoja do ta fitojë nga Hua Kuo Feni. Në këtë drejtim kreu titist do të ketë, gjithashtu, ndihmën dhe përkrahjen e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë, se Titoja e nxit Kinën të bëjë një politikë në interes të imperializmit amerikan. Dhe në realitet kështu po ndodh. Politika kineze ecën drejt mbrojtjes së politikës amerikane.

Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e këshillojnë Kinën që të mbështetë veprimtarinë e Jugosllavisë, të flasë mirë për teorinë ose lëvizjen e «botës së paangazhuar», që gjoja e udhëheq Titoja, botë ku mbretëron një kaos i madh, pse nuk mund të mbretërojë gjë tjetër.

Me vajtjen e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi prestigji i Jugosllavisë së Titos do të ngrihet disi përpara revisionistëve në botë, kurse prestigji i Kinës revolucioniste dhe imperialiste në arenën ndërkombëtare do të ulet. Kina me këtë rast do të humbasë shumë te popujt e vegjël të kontinenteve të ndryshme, kurse Bashkimi Sovjetik do ta shtojë veprimtarinë e tij kundër Kinës dhe kundër Jugosllavisë. Plikërisht këtu ne mund të shohim një rrezik të ardhshëm, prandaj duhet të jemi jashtëzakonisht vigjilentë, të vazhdojmë të forcojmë pozitat tona të pushtetit proletar, të forcojmë ekonominë, ta ngremë më lart politikisht popullin, ta ngremë më lart ideologjikisht Partinë, çdo gjë t'ia bëjmë të qartë, ta kalitim atë në beteja e ta lidhim ngushtë me popullin. Çdo ditë ne duhet të forcohem ushtarakisht, se pas vdekjes së Titos unë mendoj se

do të ketë situata të vështira për Jugosllavinë, të cilat tërthorazi do ta vështirësojnë situatën në Ballkan, mundet edhe në Evropë. Jugosllavia, një vend kapitalist me shumë kombësi, do të ketë një të ardhme të turbullt, për arsyen e kontradiktave që ka krijuar vetë sistemi kapitalist vëtadministruar, të kontradiktave që ka ngjallur shovinizmi dhe sidomos të atyre midis serbëve dhe kroatëve, midis serbëve e shqiptarëve, midis slovenëve e serbëve dhe midis maqedonasve, serbëve dhe bullgarëve.

Sistemi i vëtadministrimit jugosllav ka krijuar vetëm një gjë të mirë: unitetin e shqiptarëve që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Por çështja është se pas vdekjes së Titos imperializmi amerikan dhe Kina, dëshirojnë dhe do të përpiken ta ruajnë unitetin e Federatës Jugosllave në favorin e tyre, kurse sovjetikët do të bëjnë përpjekje të mëdha që unitetin e kësaj Federatë ose ta kthejnë në favorin e tyre, ose ta përcajnë. Dhe përçarja mund të vijë e duhet të vijë, historikisht nga Serbia. Elementët serbomëdhenj janë më të fortë, më agresivë dhe do të përpiken të dominojnë në Federatë, por edhe kroatët nuk do të mbeten pas. Pra, sovjetikët do të përpiken që me elementin serbomadh të krijojnë në Jugosllavinë titiste një lëvizje pro tyre dhe politika jugosllave të marrë një drejtim të favorshëm për revizionizmin sovjetik. Natyrisht, në një situatë të tillë imperializmi amerikan nuk do të qëndrojë pa punuar e pa luftuar.

Pasi Hua Kuo Feni të ketë vajtur në Rumani dhe në Jugosllavi dhe pasi ta ketë mbaruar këtë vizitë e

të shohim edhe rezultatet e saj, ne duhet të përgatitim një artikull për këto çështje. Sigurisht rezultatet që do të shohim ne do të janë të sipërfaqshme, sepse as gjë nuk do të kuptohet nga komunikatat ose nga deklaratat që palët do të bëjnë të njohura. Sidoqoftë, ne mund të parashikojmë se çfarë do të thuhet, se çfarë do të konkludohet dhe deri në ç'shkallë do të puqen mendimet e veprimet e kinezëve me jugosllavët dhe me rumunët.

Unë do të bisedoj me Ramizin që për këto çështje të përgatitim një artikull, sigurisht, në lartësinë e duhur politike, në atë lartësi që të tërheqë vëmendjen e opinionit politik botëror, të qeverive dhe të shërbëjë, siç kanë shërbyer edhe materialët e tjera që ka botuar Partia jonë, për të sqaruar këtë opinion për politikën e saj dhe të shtetit socialist shqiptar. Në të njëjtën kohë ky artikull të shërbëjë për të demaskuar ashtu siç duhet tratativat e hapëta dhe të fshehta të revolucionistëve kinezë, jugosllavë e rumunë<sup>1</sup>. Artikulli duhet përgatitur me kujdes, pra, si të thuash, jo të intrigojmë, se ne nuk e kemi zakon të intrigojmë, por duke njohur mirë karakterin e politikës së Titos, të Çausheskut dhe të kinezëve, jemi të bindur se ata do të intrigojnë kundër nesh. Prandaj, duke thënë të vërtetën, ne do të tërheqim vëmendjen e opinionit botëror, se, pavarësisht që Titoja dhe Hua Kuo Feni tregohen pro-

---

1. Në bazë të këtyre orientimeve u botua në gazeten «Zeri i popullit» (nr. 213 (9386), 3 shtator 1978) artikulli redaksional: «Politika luftënxitëse kinezë dhe vizita e Hua Kuo Fenit në Ballkan».

imperialistë, ka mundësi që në këtë mes të ketë dorë në një të ardhme edhe socialimperializmi sovjetik.

Kina, duke ndjekur rrugën për t'u bërë një superfuqi, përpinqet të krijojë stabilitet në mes tri superfuqive imperialiste, me qëllim që ta rindajë botën jo në dy, po në tri pjesë dhe së toku të krijojnë, në unitet dhe në rivalitet një statukuo kapitaliste. Natyrisht, kjo statukuo kapitaliste është diçka efemore, sare e përkohshme, për arsyen se lufta për fuqi, për hegjemoni dhe për tregje në botën aktuale, kur revolucioni është në marshim, kur popujt janë zgjuar dhe po luftojnë në forma të ndryshme për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin nëpermjet reformave, nëpërmjet luftërave nacionalçlirimtare e revolucionit, nuk do të shkojnë si në gjalpë. Popujt nuk do t'i lejojnë superfuqitë të krijojnë atë situatë që dëshirojnë ato. Do të ketë me siguri luftëra, gjakderdhje e ndryshime aleancash. Veçse në këto përpjekje të superfuqive do të krijohet po ashtu një aleancë e madhe popujsh, një aleancë kundër superfuqive gjakpirëse kolonialiste dhe kundër të gjithë agjentëve të tyre në çdo shtet të botës, kundër demagogjive të ndryshme politike dhe ideologjike që shërbejnë për të mbajtur në errësirë popujt, që pengojnë zhvillimin e ndërgjegjes së tyre për të fituar lirinë dhe pavarësinë.

Gjithashtu mendoj, dhe këtë do ta bisedoj edhe me shokët, se ka ardhur koha të shtypet dhë të dalë botërisht libri im «Imperializmi dhe revolucioni». Tash s'kemi pse ta mbajmë më si një material për përdorim të brendshëm në Parti, se lufta ideologjike dhe politike me kinezët ka marrë formën e vërtetë. Domethënë

nuk ka pse të presim që demaskimi i ideologjisë anti-marksiste kineze të mos konkretizohet në një manual, siç e keni konkretizuar, dhe këtë t'ja japim në dorë opinionit botëror për ta lexuar. Ky libër le të ndihmojë për aq sa mund të ndihmojë. Vlera që ka ai, duhet ta bëjmë të shërbejë si për gjithë masat tona punonjëse, ashtu edhe për të tjerët që luftojnë në botë kundër mashtruesve, kundër shtypësve e kundër luftënxitësve imperialistë.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha  
-Ditar për çështje ndërkombëtare- (botim i brendshëm),  
nr. 11, f. 123*

## **TE JEMI VIGJILENTË NDAJ PIKËPAMJEVE TE KAMUFLUARA!**

*Letér drejtuar shokut Ramiz Alia*

**9 gusht 1978**

I dashuri shoku Ramiz,

Shokët e Drejtorisë së Jashtme i dërguan Nexhmi-  
jcs vërejtjet e shokëve të huaj të partive motra, për lib-  
rin «Imperializmi dhe revolucioni».

I lexova dhc unë. Dje lexova dhe disa të tjera që  
i dërguan më vonë.

Në se cilën nga këto materiale kam vënë disa shë-  
nimë dhe kam bërë disa vërejtje për mendimet që  
kanë shfaqur dhe propozimet që bëjnë. Ne duhet t'i  
lëemi parasysh, se ka edhe vërejtje të dobishime, ka  
hollësira e «partikularizma» për çdo vend dhe për çdo  
parti që nuk duhet të hyjnë në platformën e materia-  
lit tonë, pavarësisht se mund të jenë të drejta; ka  
dhe vërejtje jo të sakta, për të mos thënë të padrejta;  
ka, më në fund, dhe pikëpamje të kamufluara, por të  
gabuara.

Por, në përgjithësi, nga sa mund të gjykoj nga

ato vërejtje lakonike të shokëve të partive motra (kuptojmë po ashtu se me një të lexuar të shpejtë të librit është e zorshme të thelloheshin më shumë) të gjithë janë shprehur në përgjithësi në mënyrë pozitive dhe e kanë aprovuar, e kanë vlerësuar të nevojshëm e të dobishëm materialin.

Në qoftë se mund të bëj disa konkluzione, mund të them se disa nga shokët nuk i gjykojnë si duhet ngjarjet që zhvillohen në botë në prizmin e marksizëm-leninizmit. Veçanërisht çështja kineze i mundon, janë kundër revizionizmit kinez, por, në qoftë se nuk gabohem, nuk e kuptojnë atë plotësisht, në të gjithë rrezikshmërinë e madhe të tij. Nuk duhet t'i bëjmë sajtorë, sepse është akoma shpejt të shkëputen nga një e kaluar e afërt ku zhvillohej një «tam-tam» i madh për «socializmin e vërtetë» në Kinë dhe nga ajo që Mao Ce Duni «është një marksist-leninist i madh». Partitë e tyre me bindje marksiste-leniniste lindën dhe u zhvilluan nën këto parulla, në përgjithësi dhe tash hezitojnë të shkëputen menjëherë, kanë frikë nga përcarjet, kanë frikë se mos dëmtohen partitë e veta nga një autokritikë bolshevike e nga një analizë e gabileve që janë bërë duke mbrojtur një parti «komuniste» si ajo e Kinës që ka ditur të kamuflojë vijën e saj antimarksiste.

Këto hezitime shifqen gati në të gjithë, disa duke e shprehur hapur, disa tërthorazi se «janë dakord që Partia Komuniste e Kinës po kthehet ose është kthyer në një parti revizioniste», por, «Mao Ce Duni ka qenë dhë është një marksist-leninist i madh». Në këto pozitiv

ta të hapëta është shoku kilian!... Ai haptazi shprehet se nuk është dakord me ne për çështjen e Maos. Ai, nalyrisht, s'ka se si të mos bëjë fajtorë e «revisionistë» pasardhësit e Maos, por në rast se kinezët nuk do të mbështetnin Pinoçetin, nuk dihej nëse ky do të qëndronë në dy karrige, sepse unë konstatoj nga vërejtjet dhe pyetjet e shkëputura dhe lakonike që bën për materialin tonë, duken shumë hezitime e dyshime në qëndrimet e tij ndaj revizionizmit kinez në pürgjithësi. Mbështetja që Partia Komuniste e Kilit (m-l) i bëri Letrës sonë të korrikut ishte e mirë dhe kjo na bën të mos i humbasim shpresat, por duhet t'i kemi parasysh këto pikëpamje të tij dhe me durim ta sqarojmë e ta bindim.

Kurse qëndrimi i anglezit është shumë më serioz, më i kamufluar e më dinak. Prandaj duhet të veprohet me shumë kujdes dhe me shumë rezerva me të. Ai nuk është dakord me pikëpamjet tona për Partinë Komuniste të Kinës, nuk është dakord që ne të mbrojmë me kaq forcë, me vendosmëri e besim marksizëm-leninizmin. Ai nuk është marksist-leninist. Mendimet që ka shfaqur për materialin tonë, nuk kanë barazim, as ngashmëri me mendimet e shokëve të tjerë dhe qëllimet konstruktive që këta kanë.

Taktika e tij është që në fillim e dyshimtë; për disa çështje lhotë haptazi se nuk është dakord me ne (për problemin e sindikatave e ndonjë tjetër); pastaj

1. Në këtë letër, që botohet për herë të parë, është hequr ndonjë emër dhe disa paragrafë.

na mburr Partinë dhe materialin. Pasi e pozon kështu problemin dhe thotë «të mos ia vëmë re», pse ai është në krye të një dege të «treunioneve», i rrëzon të gjitha tezat marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Ai në pyetjen: «A duhet të përgatitet ky libër në këtë kohë?», me fjalë të tjera thotë se nuk duhej bërë, domethënë nuk duheshin trajtar jo vetëm problemet kineze, por të gjitha çshkruhen në «Imperializmi dhe revolucioni». Ai i vihet kundër vijës së Partisë sonë. Si mund të thotë një që quhet marksist-leninist «A është koha për këtë material?»! O është koha tani, o kurrë! Të heshtim do të thotë t'i lëmë fushë veprimi imperializmit, kapitalizmit dhe revizionizmit që luftojnë kundër marksizëm-leninizmit dhe socialistëve. Ky e vë veten në pozitat e një zjarrfikësi të revolucionit proletar dhe të çdo revolucioni. Ai është një oportunist, një reformist.

Ai na thotë: «Mos u gënjeni nga zhurma e madhe dhe nga aleatët e dyshimtë që do t'u thonë se «ju takon juve ta bëni këtë material»» dhe, më në fund lëshon «bombën»: «A ju takon juve ta bëni këtë gjë?».

Është e qartë, ai kërkon të na frikësojë, dhe të përcmojë rolin dhe rrugën e Partisë sonë, të na përqajë nga lëvizja marksiste-leniniste dhe të na izolojë nga lufta revolucionare e proletariatit. Ai është kundër partive komuniste marksiste-leniniste. Këtë e tregon edhe izolimi i Partisë së tij, gjë që nuk rrjedh nga karakteri anglo-sakson, por nga qenia e kësaj partie një «fraksion i majtë, i vogël, i treunioneve». Prandaj s'ka frikë ai për partinë e tij «pse nuk është në

fuqi», por paska frikë për ne që «jemi socializmi». Këtë «socializëm» ky sindikalist do që ta mbyllë në guaskë e të mos luftojë.

«Eshtë detyra juaj, — thotë ai, — të mos përpinqeni të luftoni në të njëjtën kohë të gjitha fantazmat»...

«Kapuni pas një hallke të dobët», porosit ai, po se cila është kjo hallkë e dobët, nuk na e thotë.

«Mos shpërndani dyshime në botë», thotë. Ky është një prokinez, është njeri i statukuosë, është njeri plotësisht i tredunioneve, për të mos lhënë diçka tjetër. Lufta jonë, për të, është e dyshimtë, ajo përhap dyshime, pra, ne qenkemi gënjeshtarë, demagogë, ngatërrestarë. Dhe, për të ilustruar këtë tezë reaksionare e disfatiste ai hiqet si «revolucionar», duke na këshilluar si Anastas Lula dikur, të grumbullojmë forcat, të grumbullojmë marksistë-leninistët. Po pse t'i grumbullojmë këta marksistë-leninistë? Për të hedhur hola-hup?!

«Mos krijoni lobi kineze dhe lobi shqiptare, — thotë anglezi, — sepse lobia kineze do të na izolojë dhe do të na zhdukë».

Qartë. Ai na këshillon të lëmë lobinë kineze të veprojë, të lëmë Trockin, Bernshtajnin, Titon, Hrushovin, Maon e Ten Hsiao Pinin të punojnë, të krijojnë perandoritë e tyre në kurriz të popujve dhe ne, marksistë-leninistët, të lidhim duart...

Marksizëm-leninizmin, ideologjinë e proletariatit, doktrinën e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, ky i ashtuquajtur marksist-leninist e quan me përcëmim «një lobi shqiptare». Domethënë, për këtë agjent të

imperializmit «lufta nuk bëhet në mes ideologjisë marksiste-leniniste dhe ideologjisë borgjeze, nuk bëhet kundër kapitalizmit botëror dhe revizionizmit nga proletariati botëror dhe popujt që duan liri, por është, për të, një luftë në mes dy lobive». Duke lexuar materialin tonë, ku ne kemi folur për «dy lobitë amerikane» gjatë luftës kino-japoneze, ai e konsideron luftën e madhe të marksizëm-leninizmit si të paqenë; për të ekzistojnë «dy lobi», ajo kineze dhe ajo shqiptare, dhe ajo kineze do të fitojë, prandaj ne e kemi kот që luftojmë.

Mendoj se këto pikëpamje janë varianti anglez i pikëpamjeve të australianit Hill. Ky, kur iku nga Kongresi ynë i 7-të, vajti në Londër. Por ai nuk shkoi atje se i ra rruga. Qëllimet e të dyve janë identike: Australiani veproi i pari, haptazi e me ngut, kurse anglezi më me vonesë dhe më me diplomaci. Ky i fundit na «këshillon» që të ulim tonin, se nuk mund ta thotë haptazi që të shuajmë luftën. Duke përfituar nga modestia jonë, ai na thotë: «pse i futeni kësaj valleje, s'jeni ju që duhet ta hiqni atë».

Pikëpamjet dhe qëllimet e australianit dhe të anglezit janë identike në esencë: të dy mendojnë se ne duam të bëhemë lidershipët e luftës kundër revizionizmit modern; të dy janë kundër Kominternit, të dy, me forma të ndryshme, mbrojnë Partinë Komuniste të Kinës: i pari, hapët dhe në bllok, kurse i dyti mbron Maon, duke mos folur për të, por duke folur mirë për Çu En Lain, i cili është «faktotumi» më i zgjuar dhe antimarksisti pragmatist i ëndërrimeve antimarksiste

të Maos. Çu ja çshtë elementi më i kualifikuar i borgjezisë kineze. Anglezi jep «ide pozitive për Çunë», gjoja «nga kontaktet që ka pasur ndonjëherë me të». Por me siguri fle gjetkë lepuri. Australiani mendoi të na frenonte që në fillim. Por tani, kur lufta kundër revizionizmit kinez po merr proporcione të gjera, del në skenë anglezi për të na këshilluar që ta ndalim luttën në mes, «të bëjmë pozë, të marrim ca frymë, të grumbullojmë marksistë-leninistët dhe të kemi më pak pretendime ose të tregohemi më pak pretenciozë». Interesant është edhe fakti që një sulm i tillë i hapët dhe i maskuar vjen nga dy elementë anglo-saksonë, nga dy parti të quajtura «marksiste-leniniste» — njëra australiane e tetra angleze, të dyja njëlloj, pjesë të tredunioneve të këtyre vendeve. Hilli hiqet se ka bërë dhe një libër për «tredunionet australiane», kurse tjetri është brçnda në tredunionet angleze. Të dy janë reformistë dhe jo marksistë-leninistë...

Ka mundësi që anglezi ta vazhdojë këtë pseudomiçësi e të ruajë kontaktet me ne, por ne duhet të jemi shumë vigjilentë. Më mjafiu an shënimet e fundit që më dërgoi Drejtoria e Jashtme, dhe që janë mendimet autentike të këtij personi, që të bindesha përmendimet politike e ideologjike të tij.

Të mos neglizhojmë kurrë punën e arniqve të kamufluar! Të jemi vigjilentë ndaj formave dhe mënyrave që përdorin ata. Çdo gjë që ndrit nuk është ar. Të kemi besim revolucionar, por kurdoherë vigjilencë dhe kontroll, sepse armiqtë janë të rafinuar, nuk duhet t'i nönvleftësojmë.

Rekomandoj që gazetës së tij t'i bëhet një studim më i imët, i shikuar me një sy më metikuloz marksist-leninist dhe shokët të na dalin me një relacion për të gjykuar se deri ku dhe në ç'forma ky person dhe kjo parti janë në pozita marksiste-leniniste dhe antirevisioniste, në përgjithësi, dhe antikineze në veçanti, pse mund të kemi formuar një mendim pozitiv pa baza, por të shtyrë nga dëshira jonë dhe nga disa «insinuata revolucionare» që elementë borgjezë demokratë lëshojnë çdo ditë në shtypin e tyre. Ky deri tash ka qëndruar i mbyllur në kullën e fildishtë angleze. Pse vallë? Kemi menduar se është anglo-sakson, natyra e tyre. Jo, nuk është kjo arsyja. Arsyja e vërtetë është ajo që na këshillon neve, që «të ulim tonin e luftës e të mos ngatérrojmë dynjanë». Arsyja tjetër: ai është kundër partive marksiste-leniniste, prandaj s'do që të ketë kontakte e të bashkëpunojë me to. Dhe, arsyja e tretë është që ta frenojë lëvizjen revolucionare.

Në qoftë se nuk gabohem, kur ti e pyete: «Pse nuk merr kontakt me partitë e tjera?», ai të tha se do të mendohej për këtë gjë. Dhe mund të dalë me mendimin se ka ardhur koha për të vepruar më hapur kundër unititetit të lëvizjes marksiste-leniniste.

Të shkrova gjatë për këtë njeri, pse më bënë përshtypje të rëndë dhe të keqë mendimet e tij, të thëna me aq cinizëm dhe gjoja «me dashamirësi e me sin-qeritet». Por, formova bindjen se nuk janë të tilla. Prandaj, mendoj t'u hedhësh vetë një sy të thellë bisedave të shokëve të huaj që të mund të nxjerrim

konkluzione sa më të drejta, pse kështu mund të dalojmë edhe shapin nga shqëri dhe të ndihmohemi nga ata, por t'i ndihmojmë edhe ne.

Disa nga problemet e mësipërme, në mënyrë rationale dhe koncize, mendoj t'i inkuadrojmë në materialin tonë, se mund të ketë dhë parti të tjera që, me gjithëse nuk e thonë hapur, të mendojnë, në mos sot nesër, se «Partia e Punës e Shqipërisë do që të marrë flamurin» e të tjera gjykime të paqena si këto që i nxit borgjezia e revizionizmi për të na përcarë. Në këtia dhe unë mendojmë që kur ta ripunojmë librin «Imperializmi dhe revolucioni» jo vetëm duhet të rregullojmi më mirë kontinuitetin e të shhangim përsëritjet që kanë rrjedhur nga puna e shkëputur që kam bërë për pjesët e ndryshme, por të realizojmë edhe sugjerimet e drejta që kanë bërë shokët tanë e të huaj. Sidomos kapitullin e parë, por edhe disa të tjerë, duhet t'i plotësojmë, sepse për Partinë tonë janë të kuptueshme, ndërsa për të tjerët duhet t'i zhvillojmë më gjerë çështjet e revizionizmit sovjetik, vëtadministrimit jugosllav etj. Për këto kam shkruar diçka tash së fundi. Natyrisht, duhet zgjedhur ajo pjesë që i përshtatet dhe që plotëson materialin e kapitujve në fjalë. Për këtë do të bisedojmë edhe kur të kthchem nga Pogradeci.

Dhe një problem ose rekomandim të fundit: Në thëniet e shokut iranian ka gjëra për të cilat ai mund të mos jetë i qartë dhe kërkon shpjegime, por mund të ketë dhe gjëra që i mendon gabim dhe i shpreh në

formë pyetjesh. Unë, me vëmendje nuk i lexova dot, bëjeni ju këtë gjë, se kjo parti është e re dhe jo shumë e njohur nga ne.

Të bëj shumë të fala

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# KEMI MUNDËSI TË MËDIJA PËR SHTIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE

**Shënim**

**11 gusht 1978**

Planin e ardhshëm pesëvjeçar, skicideja e të cilit na është paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit, ne do ta studiojmë. Pastaj, kur të përpunohet, të bëjmë kujdes që bujqësisë t'i vëmë një rëndësi të veçantë. Në bujqësi ne kemi mundësi të mëdha për rritjen e prodhimeve, prandaj në këtë sektor t'i shtojmë ca investimet. Investimet në bujqësi janë shumë rentabël dhe rentabiliteti i tyre arrihet shpejt në qoftë se do të dimë të zhvillojmë proporcionalisht dhe intensivisht degët e ndryshme të këtij sektori të ekonomisë, dome-thënë drithërat, blegtorinë, pemëtarinë e të tjera.

Natyrisht këtu rëndësi të madhe ka toka. E kam theksuar edhe herë të tjera se krahas përpjekjeve për ta bërë tokën sa më pjellore, duke marrë për këtë të gjitha masat për sistemimin e saj, për kanalizimet, për ujitjen etj., ne duhet të marrim masa edhe për zgjerimin e sipërfaqes së tokës-arë. Me këtë kam parasysh zgjerimin e sipërfaqes së mbjellë me të gjitha bimët, si drithërat e bukës, bimët industriale, perimet, for-

gjeret etj. Për shtimin e tokave i kemi mundësitë, edhe forcat e punës, edhe mekanizimet e nevojshme. Sigurisht që për ta rritur akoma më shumë mekanizimin do të na duhet të investojmë sidomos në zonat malore e kodrinore. Investime do të bëjmë gjithashtu për të tharë edhe ato pak këneta që na kanë ngelur.

Zgjerimit të sipërsaqes së tokës-arë, mendoj, duhet t'i vëmë një rëndësi të veçantë në këtë plan pesë-vjeçar. Të mos diskutojmë: «jo do hapim 500 hektarë më shumë apo 500 hektarë më pak», por të kemi një plan shumë më të gjerë për këtë problem, jo vetëm për hapjen e tokave të reja, por edhe për të përcaktuar se çfarë do të mbjellim në to.

Orientimi ynë është që pemëtaria të mos na zërë toka buke, bile të mos na zërë as toka kodrinore, por kryesisht ato malore. Në zona të ndryshme malore të zhvillojmë atë lloj pemëtarie që është e përshtatshme për t'u kultivuar dhe për të dhënë prodhime të bollshme. Kjo të mos bëhet në mënyrë të përciptë, por të studiohet thellë dhe imtësisht. Po të veprojmë kështu, do të na krijohen mundësi të zgjerojmë edhe sipërsaqet e mbjella me bimë industriale e sidomos me drithëra. Pra, që të shtojmë prodhimin bujqësor në të gjitha degët dhe veçanërisht në drithërat e bukës, kërkohet jo vetëm intensifikim i prodhimit dhe rritje e rendimenteve, por edhe të luftojmë për zgjerimin e mëtejshëm të sipërsaqeve të tokave të mbjella dhe të mos qëndrojmë në vend me tokat e bukës. Gjithashtu, të bëjmë kujdes që zgjerimi i sipërsaqes së mbjellë, për shembull, me drithëra, të mos bëhet në kurri zë bimëve industriale, pse edhe sipërsaqet e

kötyre duhet të zgjerohen, sepse edhe për to nevojat janë të mëdha. Sigurisht edhe për bimët industriale prodhimi duhet të intensifikohet, duke ngritur rendimentet, por edhe sipërsaqja e tokës së mbjellë me to duhet shtuar. Ky është një problem i madh ekonomik.

Problem i madh ekonomik është, gjithashtu, edhe blektoria. Në këtë sektor ne nuk po ecim me atë hov dhe me atë rritje që kemi ecur në drithërat e bukës e, deri diku, edhe në bimët industriale. E kam theksuar vazhdimisht se blektoria është një sektor me rëndësi të madhe për vendin tonë. Ajo është një degë e njo-hur për popullin shqiptar, i cili e ka dashur blektorinë, por që nuk e ka pasur në atë stad të zhvilluar, siç e kemi aktualisht. Ne duhet ta forcojmë akoma më shumë atë dashuri që ka populli ynë për bagëtitë. Duke shtuar kujdesin për bagëtinë, të punojmë që në trajtimin e saj të zbatojmë të dhënrat e shkencës aktuale, me qëllim që bagëtia të shtohet si sasi, si lloje e raca. Të arrihet, pra, që qoftë bagëtia e imët, qoftë lopët, të bëhen me tërë kuptimin e fjalës «fabrika» për qumësht, mish, lesh e lëkurë. Një gjë të tillë ne akoma nuk e kemi arritur siç duhet, para së gjithash sepse nuk i kemi vënë rëndësi sigurimit të sasisë së nevojshtme të ushqimit të bagëtive. Tokat e rezervuara për prodhimin e foragjereve për bagëtinë ekzistojnë, por rendimenti i foragjereve te ne është akoma i ulët, prandaj janë të pakta edhe prodhimet blektorale, si mishi e qumështi.

Është e drejtë që ne të krijojmë disa komplekse për majmërinë e gjedhit. Këtë do ta bëjmë dhe, që ta

bëjmë si duhet, natyrisht, këtyre «fabrikave», si me thënë, kësaj «industrie» të rritjes dhe të majmërisë së gjedhit, duhet t'i sigurojmë ushqimin e nevojshëm. Por kjo nuk mjafton. Krahas tyre ne duhet të zgjerojmë mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të blegtorisë edhe në rrugë të tjera, qoftë të lopëve, ashtu edhe të bagëtive të imëta, deleve e dhive, si dhe të derrave e të pulave. Ne i kemi të gjitha mundësitë që ta bëjmë një gjë të tillë. Populli vetë ka treguar se në vendin tonë mund të mbahet një shumicë akoma më e madhe bagëtish.

Të kemi të qartë edhe diçka tjetër se, për të pasur sukses me qendrat e majmërisë duhet t'i furnizojmë ato me bagëti të shëndosha e të racës së mirë. Për këtë të shtojmë përpjekjet që të përmirësojmë racën, pse në këtë drejtim, sido që janë bërë përparrime, prapë duhet të njohim seriozisht se jemi prapa.

Kooperativistët tanë nuk e kanë kuptuar si duhet rëndësinë e madhe që kanë raca e lopës apo dhe e bagëtive të tjera, mënyrat dhe mjetet e ndërzimit e të trajtimit të tyre. Po t'i kishin kuptuar drejt këto çështje, ne do të kishim bërë hapa akoma më të mëdhenj se ata të tanishmit dhe do t'i kishim rritur më shumë prodhimet blegtorale, kaq shumë të nevojshme për popullin.

Po kështu mund të flasim edhe për zarzavatet. Këtë problem unë e kam theksuar dhe do ta theksoj vazhdimi. Është e vërtetë që ne kemi bërë përparrime në krahasim me të kaluarën, por konstatoj se ky problem i madh, që ka të bëjë me ushqimin e popu-

llit, akoma nuk po vlerësohet siç duhet nga kooperativat bujqësore, nga agronomët e kuadrot e tjerë të bujqësisë.

*Botohet për herë të parë së pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **TRAKTATI KINO-JAPONEZ I KA RRËNJËT TEK IMPERIALIZMI AMERIKAN**

**Shënimë**

**14 gusht 1978**

Radio Pekini, radiot e botës, azhanset dhe gjithë shtypi ndërkontëtar japin lajmin e bujshëm të nënshkrimit të Traktatit të paqes dhe të miqësisë në mes Kinës dhe Japonisë. Më në fund u arrit në konkluzionin e dëshiruar nga Kina dhe të nxitur nga imperializmi amerikan.

Kina është tepër e gjëzuar për këtë marrëveshje, me gjithëse ajo mund të ishte nënshkruar edhe më parë, por ka dëshiruar dhe ia arriti që marrëveshjes t'i japë karakterin e një aleance kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo gjë në traktatin e nënshkruar u shpreh me formulën: «të dy vendet janë kundër hegemonizmit në botë».

Natyrisht, për kinezët, për japonëzët dhe për partnerin e tyre të madh, që u qëndron prapa krahëve, Shitet e Bashkuara të Amerikës, hegemonizmi ka shenjën e barazimit me socialimperializmin sovjetik.

Kina bën një propagandë të vazhdueshme, me të cilën kërkon t'u hedhë hi syve njerëzve në botë, duke

thënë se për vete të saj gjoja nuk do të lustojë kurrë për hegjemoni, gjë që është një gënjeshtër. Nga ana tjetër, në politikën dhe në propagandën e saj ajo lë të kuptohet qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk lustokan aspak për hegjemoni dhe se gjoja këtë rezultat kaq «të madh» e kanë arritur Çu En Lai e Mao Ce Duni me Niksonin e Kissingerin në Komunikatën e Shangait, në të cilën, të dy partnerët, si Kina e Mao Ce Dunit, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara të Niksonit, kanë deklaruar se qenkan kundër hegjemonizmit! Gjithashtu na del se edhe Japonia, «Perandoria e Lindjes së diellit», nuk na qenka hegjemoniste!

Pra, mund të konkludojmë pa hezitim dhe pa u gabuar, se, meqë ky traktat kaq shumë i dëshiruar nga Kina imperialiste u arrit, kjo do të thotë që u po-qën situatat për një gjë të tillë, domethënë se «dielli amerikan» i çau «retë» që ekzistonin mbi oqeanin Paqësor dhe i lëshoi «rrezet» e tij mbi Kinën, se për sa i përket Japonisë, «rrezet» e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka kohë që janë lëshuar mbi të.

Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës e panë se arritën qëllimin e dëshiruar prej tyre, se Kina u largua përgjithmonë nga rruga e socializmit dhe e komunizmit dhe pranoi miqësinë me imperializmin amerikan dhe me imperialistët e tjerë, atëherë Uashingtoni dha sinjalin: hapi drithën jeshile dhe kështu u nënshkrua ky traktat. Nënshkrimi i këtij traktati është kundërshtuar më parë nga Japonia pikërisht për arsyen të klauzolës ku bëhej fjalë «kundër hegjemonizmit», sepse Japonia nuk donte ta zemëronte Bashkimin Sovjetik, sqinjin e saj shumë të rrezikshëm. Por tani, siç

duket, interesat e Kinës, të Japonisë edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e duan një unitet të tillë, një lidhje të ngushtë në ideologji e në politikë, në tregti dhe në fushën ushtarake dhe aktualisht nuk kanë frikë nga kërcënimet e Moskës. Moska ka shumë kohë që e kundërshton nënshkrimin e Traktatit kino-japonc të paqes dhe të miqësisë me një klauzolë të tillë dhe i ka bërë presione Japonisë duke i thënë se nënshkrimi i këtij traktati do të shkaktojë vështirësi të mëdha dhe ngatërresa në marrëdhëniet sovjeto-japoneze. Natyrisht, Moska do ta konsiderojë këtë si një hap armiqësor. Mirëpo u kapërcye mbi këto shantazhe dhe kërcënime të Moskës. Kjo do të thotë se Kina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia, të lidhura me njëra-tjetrën, po formojnë një bllok të fortë dhe kundërshtojnë çdo rindarje të botës, që nuk u intereson.

Sic e kam theksuar në shkrimet e mia, Kina këtë politikë e shpalli me kohë, që kurse u deklarua kundër Bashkimit Sovjetik, pra që në kohën e Stalinit, bile edhe më parë. Afrimin dhe lidhjen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës Kina e kishte në shpirt e në zemër, por Mao Ce Duni dhe klika e tij i zhvilluan ato gradualisht, për të mos u demaskuar përnjëherë në sy të botës. Që kur Mao Ce Duni me teorinë e «tri botëve» deklaroi se Kina bënte pjesë në të ashtuquajturën botë e tretë, u duk qartë se ai predikonte aleancën në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, «botës së dytë» (sic i quan ajo shtetet e tjera imperialiste — Japoninë, Gjermaninë Federale, Francën, Anglinë, Australinë etj.) dhe «botës së tretë». Pra, kjo aleancë

nuk mbeti vetëm një mendim ideologjik reaksionar i Mao Ce Dunit dhe i pasardhësit të tij, por u konkretizua.

Me Japoninë u nënshkrua traktati i paqes. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kuptohet, do të vendosen marrëdhënie diplomatike. Edhe pse nuk janë vendosur akoma zyrtarisht marrëdhënie të tillë midis tyre, ato ekzistojnë në mënyra të tjera, të cilat bëjnë që marrëdhëniet në mes Kinës e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të zhvillohen dita-ditës në një platformë të gjërë.

Po kështu Kina është hapur në të gjitha shtetet kapitaliste të botës, veçanërisht në Evropë. Ajo është lidhur me Gjermaninë Perëndimore, me Francën, me Anglinë, tash edhe me Italinë e me të gjitha ato shtete si Irani e të tjera, nga të cilat mund të nxjerrë fitime për t'u bërë superfuqi. Këtu është qëllimi taktik i Kinës.

Për sa i përket idesë për «botën e tretë», kjo nuk është gjë tjetër veçse ideja e vjetër e imperializmit, të cilin Kina e bëri të sajën. Imperializmi gjithnjë ka synuar që vendet e tjera të vogla, që i kishin emërtuar «de tiers monde», t'i përdorte për t'i shfrytëzuar më mirë e për t'i mbajtur nën influencën e vet dhe, sa të ishte e mundur, të pengonte socialimperializmin sovjetik të fuste hundët në kolonitë e reja të sunduara nga imperializmi amerikan, francez, anglez etj. Pra, synimi ishte që të mos lejonte Bashkimin Sovjetik të krijonte në këto vende të «botës së tretë» tregje dhe zona të veta të influencës.

Kështu pra, traktati kino-japonez e vuri në rrugë

këtë klauzolë të madhe të politikës reaksionare kapitaliste skllavëruese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Kinës. Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa të mëdhenj, që ta kenë Kinën me vete, ta forcojnë deri në atë shkallë që u intreson dhe, kur kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik të thellohen, ta përdorin Kinën si një barrierë kundër këtij të fundit në një luftë të tretë botërore. Përveç kësaj, Kina dhe Japonia, si dy shtete aziatike në unitet ideologjik e politik, si dy shtete agresore që janë, kanë synime të mëdha mbi Siberinë, mbi Mongolinë, bile edhe më tej, në thellësitë e perandorisë revisioniste sovjetike.

Rivendikimet territoriale i ka parashtruar me kohë Mao Ce Duni, por duke i krahasuar me këto të sotmet, ato të asaj kohe janë minimale. Dy shtetet imperialiste, Kina dhe Japonia, kanë interes të madh të hedhin në dorë pasuritë e Siberisë dhe, sigurisht, do të gjejnë shumë arsyesh politike ose «do të vërtetojnë» se perandoria e carëve kishte zaptuar toka ku jetonin popuj, në dejet e të cilëve rridhte gjaku i racës së verdhë. Natyrisht, tërë kjo çshtë një ideologji raciste imperialiste.

Përveç të tjerave, Kina shumë e prapambetur sheh te Japonia edhe një rrezik për veten e saj, por, në të njëjtën kohë, edhe një mike të ngushtë, që mund ta ndihmojë dhe do ta ndihmojë që të bëhet një vend i zhvilluar ekonomik. Japonia ka nevojë për një shtrirje të tregtisë dhe të industrisë së saj në kontinentin aziatik. Ajo ka bërë luftë të armatosur për ta

zaptuar këtë kontinent. Tash bën një luftë jo të armatosur, por një luftë politike dhe me teknologji.

Kina, si me thënë, ka qenë xhelozë për zhvillimin e madh industrial të Japonisë, për organizimin e forcës ushtarake tokësore, detare e ajrore të saj. Japonia përparoi kaq shumë në këtë drejtim, saqë në Luftën e Dytë Botërore nuk deshi t'ia dinte më për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mundi të zaptonte një pjesë të madhe të Kinës, të Azisë Juglindore dhe të ishujve të oqeanit Paqësor. **Kina e Mao Ce Dunit**, pas 1949-s, shikonte me admirim e me zili sukseset e mëdha të Japonisë në mjaft fusha, veçanërisht në fushën e shkencës, të teknikës moderne, megjithëse nuk mund të mos vinte re njëkohësisht edhe mizerjen e punëtorisë dhe të fshatarësisë japoneze. Udhëheqësit kinezë studionin me xhelazi se si arriti një shtet me një popull të po asaj race dhe jo më të zgjuar nga populli kinez, të krijonte një forcë të tillë dominuese dhe ekspansioniste në botë. Dhe iu duk se e gjetën edhe atë «çelësin» e këtij sekreti. Kështu Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë klikat rreth tyre arri-tën në konkluzionin se, që të bëhej Kina një fuqi e madhe, duheshin braktisur, sikurse u braktisen që në fillim, marksizëm-leninizmi e socializmi dhe duhej ndjekur rruga e kapitalizmit.

Mao Ce Duni dhe shokët e tij e panë se, me gjithë shkatërrimet e mëdha që pësoi Japonia në Luftën e Dytë Botërore, me gjithë rrënimet, me gjithë dëmct kolosale të shkaktuara nga shpërthimi i bombës atomike në Hiroshima dhe në Nagasaki, ku u vranë mbi dyqind mijë veta, pra, megjithëse Japonia doli e rras-

kapitür nga kjo luftë, brenda një kohe shumë të shkurtër ajo u ringjall, u bë një fuqi e madhe në botë, një fuqi e madhe ekonomike dhe, nën dorë e jo në bazë të traktateve, rriti e forcoi potencialin e saj ushtarak në të gjitha drcjtimet. Ka mundësi që edhe Japonia ta ketë bombën atomike. Por edhe në qoftë se nuk e ka, në kushtet aktuale të favorshme që kri-johen nga marrëdhëniet në mes këtyre tri shteteve imperialiste, që duan të dominojnë botën dhe t'i ngushojnë rrëthim socialimperializmit sovjetik, s'është çudi që një ditë Japonia të deklarojë botërisht se edhe ajo e ka bombën atomike.

Mao Ce Duni, që ka qenë një antisovjetik, e dinte se pikëpamjet japoneze ishin thellësisht antiruse e aq më tepër antisovjetike. Japonia e Hirohitos dhe e samurajve nuk mund t'uua falte Leninit dhe Stalinit mert tën për triumfin e sistemit socialist në një të gjashtën e botës. Ishte ky sistem socialist ai që ia theu oreksin Japonisë, duke ia zënë në grykë synimet ekspansioniste mbi Siberinë dhe mbi Mongolinë, ishte ky sistem që i tregoi vendin asaj në Luftën e Dytë Botërore.

**Pra, Mao Ce Duni e dinte se tek udhëheqësit japonezë ai kishte partnerë të denjë në pikëpamjet e tij shoviniste e raciste të shtetit të madh të ngjyrës së verdhë të dominimit botëror dhe mund të themi se, me traktatin e paqes që u nënshkrua para dy ditëve në Pekin, udhëheqja kineze ia arriti këtij qëllimi. Kjo arritje u siguron Kinës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Japonisë mundësitetë ekspansioniste për dominimin e Pacifikut, të Australisë e të një pjese të madhe të Azisë. Kjo marrëveshje ushtron një kërcë-**

nim të madh mbi Bashkimin Sovjetik revizionist, u bën një presion të fortë Indisë dhe më tej Pakistanit, Afganistanit, Iranit e Emirateve të Gjirit Persik. Ajo bëhet një kërcënim imediat edhe për Vietnamin e për Laosin. Që tash po duken synimet e një dominimi kinëz mbi Vietnamin. Kina kërkon të likuidojë pavarësinë dhe sovranitetin e Vietnamit dhe e ka filluar aktivitetin në këtë drejtim me incidente, bile me incidente kufitare të përgjakshme, me pretekstin për gjoja mbrojtjen e pakicave kombëtare kincze që jetojnë në Vietnam. Kina nxit Kamboxhian kundër Vietnamit dhe do të shohim se ku do të dalë një politikë e tillë, me siguri ose në nënshtrimin e Vietnamit e të Laosit ndaj influencës kineze, ose në një luftë vietnamezo-kineze.

Kurse për sa i përket Indisë, Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të bëjnë çmos që qeveria e Desait ose një qeveri tjeter që mund të vijë në fuqi, të bëhet krejt proamerikane, të normalizohen marrëdhëniet e Indisë me Pakistanin dhe të bëhen përpjekje që edhe në Afganistan të krijohet një situatë e disfavorshme për Bashkimin Sovjetik.

Për sa i përket shahut të Iranit, ky është i lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rreziku për këtë potentat<sup>1</sup> mesjetar dhe barbar është Bashkimi Sovjetik, kështu që ai është armatosur dhe po armatoset vazhdimesh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Hua Kuo Feni, pas turneut të tij në Evropë, do të

---

1. Nga latinishtja — këtu, në kuptimin e njeriut të gjithpushtetshëm, monark.

shkojë të vizitojë mikun e tij, shahun e Iranit dhe princeshat që kanë vizituar shumë herë Mao Ce Dunin.

Këtë politikë antimarksiste të Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të shokëve të tyre Partia jonë e parashikoi prej kohësh, pavarësisht se faktet në duart tonë nuk kanë qenë të mjaftueshme për të ardhur në një konkluzion të plotë. Por ishte mendimi shkencor marksist-leninist ai që na i bëri neve të qarta pikëpamjet ideologjike të kësaj klike që kishte ardhur në Kinë dhe, me aq informata sa kishim, mundëm të arrinim në konkluzione të pagabueshme. Kurse bota kapitalisto-imperialiste dhe revizionistët sovjetikë, për sa i përket Kinës, dispononin materiale të shumta, dokumente zyrtare e gjysmëzyrtare. Ata kishin ekipe të mëdha spionësh dhe agjentësh që qëmtonin edhe thënien më të vogël, edhe shkrimin më të humbur për Kinën dhe kësisoj ndërtonin rrjedhën e politikës reaksionare të tyre e të Mao Ce Dunit. Tash që ky u demaskua (dhe për këtë ka një meritë të madhe Partia jonë), shohim të botohen një numër i madh librash dhe dokumentesh zyrtare, të cilat vërtetojnë pikëpamjet e drejta që i ka formuluar me aq kujdes dhe me aq bindje Partia jonë për politikën dhe ideologjinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të qeverisë kineze. Partia jonë e demaskoi këtë politikë dhe këtë ideologji pa marrë parasysh sakrifikat. Qëllimi ynë ka qenë kurdoherë mbrojtja e socializmit, e revolucionit, mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Sikurse revizionizmi sovjetik dhe gjithë revizionizmi modern, edhe revizionizmi kinez kishte arritur ta ruante maskën marksiste-leniniste nën një demago-

gji të kualifikuar, si me thënë, të mbuluar me një prestigj të pompuar për Mao Ce Dunin dhe për idetë e tij, të cilat i reklamonin me bujë të madhe sikur ishin «marksizëm-leninizmi i botës së sotme». Marksizëm-leninizmi i vërtetë për ta ishte ideologji e një epoke të perënduar, e një epoke, e cila, sipas tyre, tashmë kishte dështuar, prandaj bota u dashkej udhëhequr drejt socializmit nga një ideologji e re, që ishte mao-cedunideja. Me fjalë të tjera, në Kinë duhej likuiduar çdo orvatje për ndërtimin e socializmit, duhej luftuar revolucioni dhe duhej krijuar një *modus vivendi* i ri kapitalisto-revizonist, një shoqëri, siç e kam quajtur në shkrimet e mia, hibride, ku proletariati, fshatarësia, gjithë të shtypurit, të rronin në harmoni me shtypësit e me gjakpirësit e tyre. Kjo ishte ideologjia e re, mao-cedunideja, që kinezët kërkonin ta mbulonin me marksizëm-leninizmin. Por Partia e Punës e Shqipërisë ua çori maskën.

Pra, qëllimet e Kinës janë të qarta: ajo ecën drejt asaj rruge nëpër të cilën mendon se do të bëhet një fuqi e madhe imperialiste duke e ndarë botën me imperializmin amerikan dhe me Japoninë, duke u lënë një pjesë të vogël vendeve të «botës së dytë» dhe duke shfrytëzuar vendet e ashtuquajtura të botës së tretë. Këto hesape ka bërë duke po bën Kina, këto mendon të realizojë ajo me politikën aktuale që ndjek grupi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit. Natyrisht, kjo politikë do të sjellë rreziqe të mëdha për botën.

Partia jonë do t'i demaskojë pa mëshirë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe imperializmin kinez. Të tre këta imperializma, duke u

bashkuar me ta edhe imperializmi japonez e tërë reaksioni botëror, do t'i thelojnë kontradiktat në mes tyre, në mes shteteve më të dobëta dhe imperialistëve, do t'i shtojnë kontradiktat në mes popujve dhe qeverive të tyre reaksionare dhe do të arrihet në atë që dëshiron Kina, në një luftë të madhe botërore. Ajo dëshiron që lufta të zhvillohet në Evropë, por kjo luftë e madhe botërore ka më shumë mundësi të zhvillohet në Azia në mes kino-japonezëve, nga njëra anë, dhe sovjetikëve nga ana tjetër, për arsyen se sytë e Kinës janë ngulur në Siberi, në Mongoli dhe në republikat e tjera Jindore të Bashkimit Sovjetik.

Imperialistët e kanë luftën në gjak. Me politikën agresive që po ndjekin ata, lufta grabitqare imperialiste po bëhet gjithnjë e më kërcënuese; në mos sot, pas dhjetë pesëmbëdhjetë vjetëve ose edhe më parë, ajo mund të shpërthejë. Kontradiktat e mëdha në mes imperialistëve, shtypja e popujve, krijimi i zonave të influencës, regjimet kapitaliste reaksionare, të gjitha këto i shtyjnë imperialistët t'i shpallin luftërat botërore. Stoqet e bombave atomike janë shtuar e, menjithëse ato përbëjnë një kërcënim për të gjitha vendet kapitaliste të botës ndërluftues, kërcënojnë në të njëjtën kohë edhe popujt e tjerë, sepse lufta që mund të shpërthejë, do të jetë e përgjithshme. Imperialistët përgatiten për luftë. Një krim i madh po përgatitet kundër njerëzimit dhe popujt e shohin një gjë të tillë, por nuk luftohet kudo në mënyrë të koordinuar që të shkatërrohen këto plane të imperialistëve. Shkatërrimi i planeve të imperialistëve për luftë botërore bëhet vetëm nëpërmjet bashkimit të proletariatit e të

popujve, nëpërmjet kryerjes së revolucionit brenda vendeve të ndryshme kundër klikave reaksionare të shitura tek imperialistët dhe kundër vetë imperialistëve që sundojnë në këto vende me kapitalet e tyre, me forcat e armatosura, me baza ushtarake dhe me një mijë e një fije të ndërlikuara.

**Partia jonë e Punës, e vogël, por në unitet me partitë e vërteta marksiste-leniniste, me gjithë marksistë-leninistët, me proletariatin e popujt e shtypur në botë dhe me gjithë njerëzit përparimtarë po e ngre zërin me forcë kundër imperializmit, socialimperializmit, revisionizmit kinez e kapitalizmit botëror. Por duhet bërë kohezioni i forcave përparimtare. Revolucioni duhet të ngjitet, përpjekjet dhe sakrificat duhet të jenë të mëdha për t'i prishur planet e imperializmit dhe të reaksionit se, po nuk u prishën ato, atëherë gjaku i popujve do të derdhet si lumë për fitoren e një grushti kapitalistësh dhe intrigantësh, kriminelë të popujve.**

**Kina pseudosocialiste predikon luftën imperialiste. Udhëheqësit kinezë janë kriminelë, sepse jo vetëm predikojnë, por edhe e përgatitin dhe e nxitin luftën e tretë botërore. Ata propagandojnë që kjo luftë botërore të zhvillohet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktualisht këto janë dy superfuqi të armatosura deri në dhëmbë, me regjime reaksionare shtypëse, regjime kolonizatorësh, dhe të etura për hegemoni. Por Kina, që e nxit këtë luftë, predikon edhe aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me kapitalin botëror dhe me të ashtuquajturën botë e tretë. Shtetet e vogla kapitaliste, si pas udhëheqësve kinezë, duhet të bashkohen në një**

front të përbashkët për t'i deklaruar luftë Bashkimit Sovjetik, pra, për ta hedhur njerëzimin në një kasap-hanë të tretë botërore. Një gjë të tillë revizionistët kinezë nuk e fshchin, por e thonë haptazi dhe pikërisht përkëtë arsy, se janë luftënxitës, ata janë kriminelë përpara syve të njerëzimit. Është e domosdoshme që kundër tyre të drejtobet një luftë e ashpër, sepse në politikën e përgatitjes dhe të predikimit të luftës së tretë botërore ata fshihen nën maskën e marksistë-lenishtëve, kur s'kanë asnje lidhje me marksizëm-lenisizmin. Ata janë kapitalistë nga më të ndyrët. Por llogaritë ekspansioniste të kinczëve janë të gabuara, sepse, në rast të një lufte botërore, të shpërthyer në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kina nuk do të mbetet jashtë, siç shpreson ajo, që t'ia nxjerrin gështenjat nga zjarri aleatët e përhershëm, por të deklaruar botërisht tanë, që janë imperializmi amerikan dhe ai japonez. Jo, për mendimin tim, në qoftë se do të shpërthejë lufta imperialiste grabitqare, ka më shumë mundësi që kjo të shpërthejë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Aktualisht Kina me Japoninë, në bazë të traktatit që nënshkruan më 12 gusht, janë bërë një barrikadë, një pararojë e imperializmit amerikan kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Shtetet në fjalë: Bashkimi Sovjetik, Kina dhe Japonia, janë konkurrente imperialiste për dominim, veçanërisht në Azi. Prandaj, ose Bashkimi Sovjetik nuk do ta lërë Kinën të forcohet, siç synon me planet e saj (dhe do të shohim çfarë masash do të marrin sovjetikët në këtë drejtim), ose, me kalimin e kohës,

Kina do të forcohet, Japonia do të forcohet akoma më shumë se ç'është forcuar dhe, të dyja bashkë, do të bëhen rrezik për imperializmin sovjetik.

Imperializmi sovjetik aktualisht nuk ka interes të sulmojë Evropën, siç pretendon Kina, sepse një gjë e tillë nuk do t'i sjellë ndonjë fitore. Ai siguron fitore duke sulmuar hallkën e dobët në skakierën ndërkombëtare dhe kjo hallkë e dobët është Kina, janë edhe të gjitha vendet e tjera të vogla, veçanërisht të Azisë, pa thënë për vendet e Afrikës që janë shumë të dobëta, por edhe shumë të pasura. Në rast se Bashkimi Sovjetik kërkon që të hapet gjerësisht në Afrikë dhe të cenojë interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atëherë lufta mund të shpërthejë edhe në Evropë, duke marrë shkas Afrikën. Veçse duhet pasur parasysh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurdoherë kanë nxitur të tjerët të luftojnë për to, kurse në mbrëmje shpejtojnë të vënë dorën e tyre në anën e fituesve për të korruar vetë fitoren e plotë. Prandaj ata e mbështetin Kinën dhc do të vazhdojnë ta mbështetin edhc atë, edhe Japoninë, duke u përpjekur njëkohësisht që kontradiktat në mes këtyre dy partnerëve të rinj të tyre të ekzistojnë, sepse, në rast të kundërt, ka mundësi që kjo forcë e madhe aziatike (Kina e Japonia) të bëhet po ashtu një rrezik dominacioni në oqeanin Paqësor dhe kërcënues për imperializmin amerikan në botë. Imperializmi amerikan, si një fuqi e madhe imperialiste, forcën e tij nuk e ka vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai e ka braktisur doktrinën «Monro» dhe është përhapur në të gjitha vendet e botës, ku ka shtrirë kthethrat e tij, ku ka bazat e tij

ushtarake, njerëzit e vet në fuqi, prandaj edhe quhet një perandori e fuqishme botërore.

Si mund të shpëtojë njerëzimi nga një katastrofë e madhe botërore? Vetëm me revolucion, i cili, natyrisht, duhet të përgatitet. Revolucioni duhet të përgatitet veçanërisht në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, pa neglizhuar ngritjen e popujve në vendet e tjera. Kjo është dëshira dhe aspirata e komunistëve, e revolucionarëve në të gjithë botën. Por shpresat nuk janë aq të mëdha sa janë dëshirat. Aktualisht në Bashkimin Sovjetik është vendosur një diktaturë e egër e kapitalit dhe si zor që atje të pëlcasë relativisht shpejt një revolucion i dytë bolshevik, një revolucion i dytë i madhi si ai i Totorit. Bashkimit Sovjetik të solëm i mbetet vetëm një rrugë — rruga e luftës grabitqare. Udhëheqja aktuale tradhtare, antimarksiste, imperialiste e Bashkimit Sovjetik ecën drejt kësaj rruge. Që të pëlcasë revolucioni duhet të përmbyset tërë situata në Bashkimin Sovjetik, të përmbyset pushteti i revizionizmit modern, i socialimperializmit dhe të vendoset diktatura e proletariatit me një parti të re me të vërtetë marksiste-leniniste, që të zbatojë si duhet doktrinën e madhe shkencore, marksizëm-leninizmin. Kjo është rruga ku duhet të ecë Bashkimi Sovjetik dhe kjo rrugë e dytë do të jetë shpëtimtare për njerëzimin, se atëherë Bashkimi Sovjetik do të bëhet siç ka qenë në kohën e Leninit dhe të Stalinit. Në qoftë se realizohet një gjë e tillë, një dëshirë e tillë jona, Bashkimi Sovjetik do të bëhet një mbështetje e fuqishme e revolucionit botëror. Por natyrisht, kjo aktualisht është një dëshirë me një pikëpyetje të madhe, jo se mark-

sistë-leninistët humbasin çdo shpresë te proletariati i Bashkimit Sovjetik, por sepse vetëm një gjakderdhje e madhe mund ta përbysë këtë situatë të tmerrshme që është vendosur në Bashkimin Sovjetik.

Edhe për Kinën rruga tjetër është që regjimi aktual kapitalist, revisionist, imperialist, kinez të rrëzohet dhe të shkatërrohet tok me ideologjinë e Mao Ce Dunit dhe Partia Komuniste e Kinës të rindërtohet nga fillimi mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Kinës i duhet të dalë nga situata kaotike ku është zhytur prej kaq dekadash, të shkëputë lidhjet që po ndërton me imperializmin amerikan e me imperializmin botëror dhe të ecë në rrugën e socializmit shkencor. Vetëm kjo rrugë është ajo që eviton për një kohë më të gjatë luftën imperialiste grabitqare. Vetëm kjo rrugë, qoftë për Kinën, qoftë për Bashkimin Sovjetik, shpejton revolucionin socialist dhe i jep grushtin vendimtar të vdekjes kapitalizmit botëror. Por ashtu si po ecin punët në këto dy vende, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, shpresat tonë, të marksistë-leninistëve dhe të popujve revolucionarë, janë të largëta.

Kapitalizmi dhe imperializmi janë në kalbëzim, popujt vuajnë në mjerim, në urë, në papunësi, polarizohen pasuria dhe varfëria dhe kontradikta në mes dy botëve, botës kapitaliste dhe botës socialiste, ashpërsohet. Pakënaqësia e madhe botërore kundër kapitalizmit, imperializmit dhe revizionizmit po ngrihet dhe nga sasi do të kthehet në cilësi. Por kjo cilësi do të arrihet me përpjekje, me luftëra, me gjakderdhje, sepse imperialistët dhe revisionistët me doktrinat e tyre nuk e lënë aq lehtë pushtetin e tyre kapitalist, avan-

tazhet që u jep ky pushtet dhe, për ta mbrojtur këtë, ata kanë krijuar forca të mëdha ushtarake represive. Në këtë drejtim popujt, proletariati, me marksistë-lenisistët në krye, duhet të sabotojnë përgatitjet ushtarake në çdo vend imperialist e revisionist, të sabotojnë përgatitjen dhc stërvitjen e ushtrisë, të përpinqen tanqrenë ushtarin në një platformë të tillë politike që ai të kuptojë se është bërë vegël e një grushti imperialistësh dhe kapitalistësh, pse tash djemtë e popullit, ushtarë të kapitalizmit, mbrojnë një kauzë jo të vetën, por një kauzë të armiqve të tyre.

Nga ana tjetër duhet që në gjirin e klasës punëtore, dhe veçanërisht atje ku fabrikohen armët vdekje-prurëse të fuqive të mëdha imperialiste, të punohet që të bëhet e ndërgjegjshme klasa punëtore për ta sabotuar me të gjitha forcat, me gjithë zotësinë dhe mjeshtërinë e saj, prodhimin e këtyre armëve. Masat e gjera të popullit duhet të ngrihen në revoltë, në demonstrata dhe ta mbështetin luftën e përgjithshme revolucionare në gjirin e ushtrive borgjezo-kapitaliste, në gjirin e proletariatit që prodhon dhe vuan për bukë dhe që kapitalistët e detyrojnë të përgatitë armë për të vrarë vëllezërit e tij të vendeve të ndryshme e për t'u bërë vetë mish për top për manjatët dhe për trushtët e kapitalizmit botëror.

*Marrë nga libri:*

Enver Hoxha: «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 173

## **SA MË TË FORTE TË JEMI, AQ MË SHUMË DO TË NA DUAN DIIE MIQTË**

*Nga biseda me disa kuadro<sup>1</sup>*

**16 gusht 1978**

*Pasi u takua dhe u përshëndet me të pranishmit,  
e mori fjalën:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni, shokë, jeni  
mirë të gjithë?

Këtu, në Pogradec, bëhet pushim i këndshëm. Siç  
më thanë, këto ditë në Durrës ka bërë vapë e madhe  
prej 33 gradësh nxehtësi, kurse këtu ka qenë freskët,  
ja, siç është sot. Është e vërtetë që në Durrës njerëzit  
venë më tepër për kripën dhe për jodin, se ujin e  
kemi edhe ne këtu. Pogradeci ka një bukuri të rrallë.  
Njeriu këtu ndien kënaqësi të madhe kur çlodhet.

Si kaluat në festën e Vithkuqit<sup>2</sup>?

---

1. Kjo bisedë u zhvillua në Pogradec, në shtëpinë ku pu-  
shonte shoku Enver Hoxha, me kuadro drejtues të rretheve të  
Korçës e të Pogradecit dhe me shokë të tjera.

2. Një ditë më parë në Vithkuq u festua 35-vjetori i for-  
mimit të Brigadës së Parë Sulmuese të UNÇSII.

*SHOKU SIMON STEFANI:* Kaluam shumë mirë! Çdo gjë ishte organizuar bukur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po njësia që mban emrin e brigadës ishte?

*SHOKU SIMON STEFANI:* Po, po, ishte. Edhe ambienti qe rregulluar mirë, rruga qe shtruar deri në vend.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë! Këto festa tradicionale mbajnë lart heroizmin e partizanëve dhe frymëzojnë ndjenja të pastra patriotizmi, në radhë të parë, tek të rinjtë e të rejat! Prandaj ato duhen festuar vazhdimisht.

*SHOKU SIMON STEFANI:* Merrnin pjesë edhe shokë të huaj, marksistë-leninistë, të cilët u kënaqën mjëft.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me një fjalë, kishte edhe miq të huaj, sigurisht, me përjashtim të kinezëve, të cilët tash u bënë «fare të huaj» për ne. Por kjo ne nuk na tremb aspak, sepse kemi një mbështetje të madhe kudo në botë: janë marksistë-leninistët, popujt dhe njerëzit përparimtarë të çdo vendi që na përkrahin. Në çdo situatë opinioni i jashtëm i favorshëm përbën një forcë të madhe në mbështetje të vendit tonë.

Nga ana parimore, në ideologji e në politikë, ne e kemi të qartë, nuk bëjmë asnjë lëshim. Shumë shtete udhëhiqen nga ideologjia e kundërt me ne, por, me gjithatë, ato mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj vendit tonë, natyrisht me nuanca. Ca janë të egra, ca më pak të egra; ca janë të këqija, ca më pak të këqija; ca na pengojnë në veprimtarinë tonë, të tjera, për

shkak të kontradiktave që kanë me njëra-tjetrën, u pëlqen të mos e ngasin Shqipërinë për pozitën e saj strategjike. Në mes tyre, si ndërmjet superfuqive, ash- tu edhe midis të tjerave që janë rreth e rrrotull vendit tonë, siç është Jugosllavia, që hiqet sikur është e pa- angazhuar, ka kontradikta.

Ndryshe është me popujt, me revolucionarët dhe me njerëzit përparimtarë. Natyrisht, këta nuk kanë në duar forca të armatosura, sepse këto, në çdo vend, i ka shteti borgjez, por opinionin e tyre ne nuk mund ta injorojmë. Përkundrazi, na bie detyrë ta ushqejmë realisht këtë opinion që ekziston në favorin tonë. Sido-qoftë, mbi të gjitha ka rëndësi opinioni brenda vendit tonë. Po të jetë e fortë gjendja brenda, edhe miqtë do të na duan më shumë, po edhe armiqtë nuk do të guxojnë të na sulmojnë, sepse për të gjithë ata do të krijohen situata të vështira. Prandaj, ka rëndësi që të punojmë për të qenë sa më të fortë brenda, pse kryesisht këtej varet ccja përpara në ndërtimin e so- cializmit dhe në mbrojtjen e atdheut.

Partia të punojë që të kuptohet qartë nga të gjithë se situatat në botë nuk janë të mira. Ato bile janë mjaft të vështira, se jetojmë në një kohë kur kemi kundër gjithë këto shtete, të mëdha e të vogla, të cilat përpiken të na dëmtojnë. Pra, të jemi të ndërgjegj- shëm se jemi në luftë, jo në rehati, në kuptimin e qe- tësimit të mendjes dhe të pandehim se jemi mirë. Ne duhet të parashikojmë gjithmonë situata përherë e më të vështira e të përgatitemi seriozisht për t'u bërë ballë atyre që të mund t'i kalojmë rreziqet. Me një

fjalë, ne jemi në luftë, e cila nuk fitohet vetëm me «urra», domethënë me eufori.

Për të fituar luftën kërkohet organizim, mobilizim dhe vigjilencë e madhe. Duhet njëkohësisht edhe entuziazëm, po ky nuk ka të bëjë me euforinë, por me besimin e madh te Partia, te vija e drejtë e saj, te rezultatet e arritura, që rritin hovin në punë, që krijojnë një kënaqësi të ligjshme te secili për rezultatet që arrihen, për shpikjet që bëhen etj. Kjo, natyrisht, e shton forcën tonë ndërtuese dhe materiale, çelikos unitetin shoqëror, rrit besimin dhe influencën e Partisë në masat.

Çdo gjë që krijohet e ndërtohet, çdo gjë që harxhohet apo që prishet te ne, duhet të shikohet me sy kritik, me qëllim që gjithçka që bëjmë t'i shërbejë forcimit të unitetit të popullit dhe të pozitave të socializmit në vendin tonë.

Ne kemi qenë vazhdimishit në luftë, por situatat e reja janë shumë revolucionare për Partinë tonë marksiste-leniniste e për mbarë popullin dhe krijojnë një besim akoma më të madh. Ato i sjellin një hov të ri e të fuqishëm Partisë, unitetit të saj me popullin, forcimit ideologjik të komunistëve dhe të punonjësve. Në këto situata duhen pasur në qendër të vëmendjes sonë planet e armikut, si atij të jashtëm, ashtu edhe atij të brendshëm. Këta të fundit mendojnë se u erdhi koha e u ngjallen shpresat dhe, ata që janë më aventurierë, në qoftë se vigjilenca e entuziazmi i Partisë nuk ngrihet me të njëjtën forcë, me veprinatrinë e tyre armiqësore mund të na dëmtojnë. Prandaj thashë se euforia dhe «urratë» janë të rrezikshme.

Armiqtë e brendshëm në këto situata lëvizin. Në radhët e tyre, siç e dimë, bëjnë pjesë elementët anti-parti (jo të përjashtuarit nga Partia, po armiqtë e Partisë), mbeturinat e klasave, individë të ndryshëm që janë të influencuar nga këto mbeturina dhe elementët e degjeneruar. Puna e Partisë ka bërë që armiqtë të zbulohen, të goditen dhe të tjerët që mund të kamuflohen, të heshtin. Por tash, me ato që kanë ndodhur e po ndodhin në botë, kanë filluar përsëri të lëvizin dhe jo vetëm flasin, por ka nga ata që edhe përpiken të bëjnë diçka. Prandaj këto t'i kemi parasysh e të mos i harrojmë. Ndodh që ata puqen nga dy ose tre veta dhe kokë më kokë shfaqin mendimet reaksionare që transmetojnë radiot e huaja për Shqipërinë, sido që, me sa jemi në korent, shumë nga të huajt, në përgjithësi, për mjaft probleme të kohës, janë në anën tonë. Për shumë prej tyre qëndrimi ynë konsiderohet i drejtë. Kjo është e para.

E dyta, ata shohin çdo ditë se kush është Bashkimi Sovjetik, kush është imperializmi amerikan dhe kush është tani Kina, me aleancat dhe me kontradiktat që kanë ndërmjet tyre. Vijën dhe qëndrimin tonë opinioni dhe shtypi borgjez, edhe në qoftë se nuk e aprovojnë, në shumicën e rasteve e reflektojnë ekzaktësisht. Kështu shkruajnë, për shembull, gazetat franteze si «Lë Mond», «Figaro» etj., që lexohen nga masa të gjera lexuesish. Këto janë gazeta të kualifikuara borgjeze, janë organe propagande të asaj borgjezie që në Francë ka pozita të forta politike e ideologjike. Natyrisht, këto gazeta po i reflektojnë ekzaktësisht disa nga qëndrimet iona edhe për faktin se u vjen mirë

kur ne atakojmë imperializmin amerikan, Bashkimin e sotëm Sovjetik e tani edhe socialimperializmin kinez.

Por, natyrisht, në këto situata ne kemi edhe vë-shtirësi, por bëjmë përpjekje t'i kapërcejmë ato. Së pari, neve do të na duhet të zëvendësojmë ato kredi sado të pakta që na kishin akorduar kinezët. Ne jemi të bindur politikisht e ideologjikisht, por edhe materialisht, se, në bazë të llogarive që po bëhen për planin e ardhshëm pesëvjeçar, i kemi të gjitha mundësitë t'i përfundojmë vetë së ndërtuari jo vetëm veprat e filluara, por edhe të tjerat, për të cilat Kina na kishte akorduar kredi dhe nuk janë filluar akoma; bile, edhe më shumë do të bëjmë. Por, siç e theksova, me fryshtë të shenjtë dhe me «urra» ato nuk ndörtohen. Ato do të realizohen të gjitha vetëm duke plotësuar planet me forcat tonë të brendshme në të gjithë sektorët, me mundësitë materiale dhe me mendjen e zotësinë e punëtorëve, të teknikëve dhe të specialistëve tanë. Siç e dini, këto forca të brendshme do të duhet të organizohen, të disiplinohen, të punojnë, por edhe të paguhen sipas planeve të përcaktuara drejt. Të gjitha këto kërkojnë të studiohet thellë dhe me kujdes çdo gjë, se kuadro për këtë qëllim kemi.

Por del edhe një problem tjetër. Shumë makineri e pajisje për këto vepra, do të duhet t'i blejmë jashë. Kjo kërkon që ne të disponojmë kliring apo devizë, prandaj kërkohet të punojmë shumë që t'i krijojmë këto, duke bërë një punë shumë më të organizuar e duke realizuar planet dhe të gjitha ato detyra që përmenda më parë. Këto janë probleme të mëdha partie dhe shtetërore, prandaj ta bëjmë natën ditë për t'i

zgjidhur me sukses. Në këto situata që janë krijuar, Partia, klasa punëtore, fshatarësia, rinia, gratë, intelektualët e vendit tonë e gjithë të tjerët duhet të mendojnë njëqind herë më shumë se deri tani për disiplinën në punë, për kursimet, për ngritjen e rendimeve, për realizimin e normave, uljen e kostos, cilësinë e prodhimeve etj., etj.

Eshtë e domosdoshme, gjithashtu, që sytë t'i kemi kurdoherë hapur, por jo të dyshojmë edhe atje ku nuk duhet.

Miqtë tanë flasin shumë mirë për popullin dhe për vardin tonë nga çdo pikëpamje. Ka nga këta që janë marksistë-leninistë dhe flasin me respekt për ndërtimin e socializmit në Shqipëri me forcat e veta. Por, ka edhe të tjerë që nuk janë marksistë-leninistë, por demokratë përparimtarë, të cilët na thonë se «në çështjet politiko-ideologjike ju jeni në pararojë dhe, në qoftë se do të vazhdoni të ndërtoni socializmin me forcat tuaja, atëherë do të bëheni një shembull i madh në të gjithë botën». Kjo për ne, marksistë-leninistët, do të thotë se duke realizuar këto detyra që i kemi vënë vetes, në të njëjtën kohë krijojmë bindje edhe në forcat përparimtare e revolucionare në botë që të kenë besim se marksizëm-leninizmi është një doktrinë ngadhënjimtare dhe që i bën ballë çdo force të tmerrshme e të errët imperialiste e revisioniste. Prandaj edhe tani, kur ne deklarojmë se do ta përballojmë me forcat tona këtë situatë dhe do ta ndërtojmë socializmin duke u mbështetur plotësisht në forcat tona, një gjë e tillë krijon besim për fitoren e revolucionit dhe të socializmit në botë. Merrët me mend, pastaj, se çfarë

do të thonë njerëzit kur socializmi të triumfojë edhe në vende të tjera. Ç'forcë të madhe do të krijojë kjo fitore kundër imperializmit! Prandaj, jo vetëm në drejtimin politik e ideologjik, por edhe në çështjet ekonomike neve na bie një detyrë e madhe e me përgjegjësi që t'i realizojmë dhe t'i tejkalojmë të gjitha detyrat.

Pogradeci, siç më thanë shokët drejtues të Partisë dhe të pushtetit të këtij rrethi, do t'i realizojë detyrat ekonomike. Por duhet të bëhen përpjekje që t'i realizojë edhe Korça, pavarësisht se shokët atje ankohen që grurin ua dëmtoi Juga. Juga vërtet dëmtoi, por duhet parë mos ka dobësi për këtë bimë që në mbjellje apo edhe në shërbimct e tjera agroteknike. Pastaj, si do të bëjmë ne me Jugën? Do të lidhim duart? Po në vendet e tjera nuk dëmton Juga? A është studiuar ky problem ndonjëherë dhe a është parë sa dëmton? Unë mendoj se Ministria e Bujqësisë duhet ta shohë më mirë e më thellë këtë çështje dhe të përpinqet që të përshtatë apo të gjejë një farë tjetër, e cila mund t'i rezistojë më mirë Jugës.

Na flitet shpesh me entuziazëm nga disa për ujitjen që bëhet me impiantet në formë shiu. S'ka dyshim se një mënyrë ujitjeje e tillë është shumë e mirë, por duhet pasur parasysh se ajo, tani për tani, është mjaft e kushtueshme, prandaj nuk mund t'i ujitim dot të gjitha fushat tona në këtë mënyrë. Ashtu si gjithë bota, ne duhet të vazhdojmë të ujitim në sipërsaqe të gjera me rrjedhje të lirë dhe të jemi realistë për këtë mënyrë ujitjeje, sepse mund të na krijohen pastaj situata të vështira duke ndenjur njerëzit në pritje që

të ujtin vetëm në formë shiu, gjë që, sot për sot, nuk mund ta praktikojmë kudo. Edhe shtetet shumë të zhvilluara ekonomikisht, që e kanë me bollëk energjinë elektrike, nuk bëjnë për të gjitha bimët ujtitje në formë shiu, por vetëm për ato nga të cilat pronarët kapitalistë nxjerrin fitime të mëdha. Pse, mos vallë fushat e grurit i ujtin në formë shiu në Kanada, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo në Australi? Në asnjë mënyrë nuk veprojnë kështu, se kostoja e kultivimit të kësaj bime do të ngrihej dhe prodhimi i saj do të ishte pa leverdi.

Për këtë edhe ne duhet të bëjmë përpjekje që të mësojmë të bëhet mirë ujitja me rrjedhje të lirë; pra të mësojmë ta përdorim si duhet ujin me mënyriën e zakonshme të ujitjes, sepse kjo, tani për tani, në kushtet tona, është më e leverdishmja. Në fund të fundit do të përdoret dhe po përdoret te ne edhe ujitja në formë shiu, për shembull, në një pjesë të panxharit e të perimeve të hershme, në parcelat e farërave etj., se na intereson, por jo në fushat e gjera me grurë, misër etj. Ato në asnjë mënyrë nuk mund t'i ujilimi kështu, se as mundësi nuk kemi dhe as nuk na leverdis.

Rrethi i Korçës duhet të ecë më përpara në rritjen e rendimenteve të bimëve, sepse ka pasur dhe ka një bujqësi të përparuar dhe me tradita sidomos në fushë dhe nuk është si Myzeqeja, ku bujqësia ka qenë e prapambetur. Në rrethin e Korçës janë problem zonat kodrinore e malore, të cilave duhet t'u vihet rëndësi më e madhe nga organet e Partisë e të pushtetit.

Të mos flasim vetëm nga ana teorike, e cila është

e drejtë dhe në këtë rrugë luftohet e po ecet, por realiteti është se bujqësia ka rëndësi vendimtare për vendin tonë se ajo furnizon industrinë me lëndë të parë, por, sidomos, se i siguron popullit ushqimin e përditshëm me bukë, yndyrna, mish, qumësht, perime, fruta, vezë, sheqer etj. Në qoftë se nuk ua plotësojmë nevojat njerëzve tanë me prodhime bujqësore e blegtorale, kjo sjell me vete perturbacione të rënda politike, prandaj në asnjë mënyrë të mos lejojmë të bjerë niveli i jetesës së popullit tonë.

Duke shtuar prodhimet bujqësore e blegtorale nc shikurtojmë në minimum importin e tyre; gjithashtu të luftojmë që të prodrojmë në vend edhe yndyrnat e pambukun; bile, duhet të punojmë që të rritim sa më shumë eksportin se kemi nevojë të ndërtojmë edhe fabrika të tjera. Fundja, mund të pranojmë të importojmë, për shembull, vetëm sasi të vogla pambuku të kualitetit të parë etj.

Për të gjitha këto arsyenë na vihet detyrë që ta bëjmë bujqësinë sa më intensive pa lënë mënjanë edhe rrugët e tjera. Për këtë qëllim është e domosdoshme të thyhen disa koncepte frenuese që ekzistojnë akoma në këtë sektor.

Kështu ekziston mendimi se te ne nuk paska më mundësi për të hapur toka të reja, kurse e vërteta është ndryshe. Duhen bërë përpjekje akoma më të mëdha për t'i hapur ato, sepse jo vetëm ka, por bile edhe toka të mira. Shokët e disa rretheve, ashtu si këta të Korçës, na thonë që të lashtat i dëmtoi Juga. Dakord, e pranojmë që Juga i dëmton, por sikur rrethi i Korçës të kishte, për shembull, edhe 3 000 hektarë

toka të tjera të mbjella me drithëra, sado që ta dëmtonte Juga, prodhimi do të realizohej në atë shifër që parashikohej në plan. Në Australi, për shembull, ka sipërfaqe toke të shumta, prandaj atje ka edhe prodhim të madh. Është e vërtetë që rendimenti për hektar në atë vend është i vogël, 8-10 kuintalë për hektar, por ama sasinë e sigurojnë me sipërfaqet e gjera që kanë. Natyrisht, vendi ynë është i vogël, megjithatë edhe këtu ka akoma sipërfaqe toke që mund të hapen e të mbillen. Këto sipërfaqe të reja, të mundshme për t'u hapur, janë në zonat kodrinore-malore, prandaj atje të përqendrohet vëmendja.

Ekziston gjithashtu pikëpamja se, po të mbjellim në këto toka, do të na bjerë rendimenti mesatar për hektar. As kjo nuk është një pikëpamje e drejtë. Edhe në zonat kodrinore e malore, si për shembull në Opar, në Tudas e gjetkë, kur hapim një sipërfaqe toke, në fillim vërtet do të marrim pak, por më vonë, kur, me kohë, struktura e saj të përmirësohet, sigurisht që do të marrim më shumë. Natyrisht, në këto zona ka mungesë të forcave të punës, por Partia të punojë që të çojë atje forca nga qyteti, sigurisht duke u krijuar atyre që më parë kushtet e nevojshme. Të punohet, gjithashtu, edhe për mekanizimin e proceseve të punës në bujqësinë e këtyre zonave. Për këtë janë të gjitha mundësitë, po qe se vlerësohet e punohet seriozisht.

Kam folur dhe do të vazhdoj të flas me këmbëngulje për perimet. Të tërë i duan ato, por rendimentet e parashikuara nuk realizohen, se vazhdojnë të ekzistojnë akoma disa pikëpamje që pengojnë në këtë

drejtim. I thuhet kooperativës që të mbjellë perime, por kjo detyrë nuk kryhet, sepse mendja e drejtuesve është bërë grurë e misër; pra, megjithëqë u kërkohet të mbjellin edhe perime, këto nuk i vlerësojnë. Duhet të luftohet shumë nga Partia në rreth e në bazë që të thyhen të tilla pikëpamje të dëmshme.

Ose, ka të tjerë që u qëndrojnë strikt disa pikëpamjeve për blegtorinë. Ne kemi marrë një sërë vendimesh të drejta për këtë sektor, si, për shembull, për shtimin e numrit të bagëtisë së imët, mirëpo disave u është tiposur mendja te lopa. Sigurisht, lopa ka rëndësinë e vet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet nën-vleftesuar, por ka zona të gjera ku mund të mbahet akoma një numër i konsiderueshëm bagëtish të imëta. Prandaj t'i thyejmë ato koncepte frenuese që ekzistojnë te disa shokë për delen dhe për dhinë, bile, po të ketë mundësi, edhe t'i shtojmë ndërmarrjet blegtoreale me bagëti të imëta. Dicka kemi bërë në këtë drejtim, por është e domosdoshme të bëhet më shumë, se këto janë detyra të kapshme e të realizueshme plotësisht brenda pak vjetësh, në rast se bagëtia trajtohet mirë. Mirëpo kjo do të thotë të bëjmë një hop të madh në shtimin e sasisë së qumështit, në sigurimin e djathit, të leshit, të mishit, si dhe të të gjitha atyre prodhimeve të tjera që kërkohen brenda vendit, për nevojat e përditshme të punonjësve dhe për eksport. Blegtoria është një sektor me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike.

Edhe për pemëtarinë kemi folur gjithmonë dhe vazhdojmë të flasim, sepse janë të gjitha mundësítë t'i shtojmë prodhimet edhe në këtë sektor. Vetëm se

për t'ia arritur këtij qëllimi, duhen më shumë një-rëz që të merren me shërbimet e shumta që ka ky sektor dhe të rriten më tepër mekanizimet.

Ne duhet të mendojmë mirë për zgjidhjen e këtyre problemeve që ekzistojnë në situatat që jemi, dhe me siguri do t'i kapërcejmë me sukses vështirësitë e krijuara. Realizimi i këtyre detyrave do të na forcojë ekonomikisht. Por sukseset tona, siç e vura në dukje edhe më parë, do t'u rritin besimin në forcën e socializmit edhe shokëve tanë marksistë-leninistë si dhe gjithë njerëzve të ndershëm kudo në botë.

Ne kemi arritur një sukses të madh që zëri i Partisë sonë, zëri i Shqipërisë, të dëgjohet tani me interesim e respekt jo vetëm rrëth e qark vendit tonë, por në të gjithë botën. Të huajt duan të shikojnë e të më-sojnë jo vetëm se çfarë po bëhet te ne, por edhe se si do ta ndërtojmë ne socializmin me forcat tona, sepse është krijuar një pikëpamje jashtëzakonisht e dëmshme, sipas së cilës socializmi nuk mund të ndërtohet me forcat e veta. Prandaj shumë njerëz jashtë thonë: «Si do të bëjnë tani shqiptarët?». «Do ta ndërtojmë socializmin me forcat tona», u themi ne. Po pse dyshojnë ata për këtë? Sepse, siç thashë, është krijuar me kohë një mendim i tillë që kreditë për një vend janë të pashmangshme. Mirëpo, dihet se kreditë që merren nga vendet që i kërkojnë, janë për klikat në fuqi; dhjetë pjesë nga kjo kredi shkon në favor të këtyre klikave dhe vetëm një pjesë fare e vogël përdoret për popullin. Është për këtë që njerëzit te ne shikojnë diçka interesante dhe ky përbën një sukses të madh përvendin tonë.

Letra që Partia dhe Qeveria jonë i dërguan partisë dhe qeverisë kineze, siç e dini, bëri një jehonë të madhe në favorin tonë. Kina me qëndrimin e saj anti-marksist e të fuqisë së madhe çshkëtë demaskuar keq dhe për këtë kemi kontribuar edhe ne. Ne kemi duruar për një kohë të gjatë dhe populli, siç e dimë, thotë se kush duron, filon. Për ne armiqtë kanë thënë gjithnjë: «Shqiptarët janë gjaknxehtë». Por, edhe në këtë rast, ndryshe nga ç'na akuzojnë, ne dolëm gjakftohtë, kurse gjaknxehtë u treguan kinezët. Megjithatë, ne nuk kemi qenë kurrë gjaknxehtë. Çdo gjë e kemi bërë në emër të marksizëm-leninizmit e të popullit, me pjekuri e me gjakftohtësi. Kur u poqën situatat, edhe kinezët i goditëm. Ata duhen demaskuar edhe nië tej, sepse akoma ekziston në botë opinioni që Kina është vend socialist dhe se Mao Ce Duni është marksist-leninist. Natyrisht, këto pikëpamje nuk mund të kapërcehen lehtë dhe në një kohë të shkurtër. Për këtë do bërë një luftë e madhe, e vazhdueshme e plot durim nga gjithë marksistë-leninistët, si edhe nga ne. Demaskimin e Kinës ne e filluam me baza dhe do ta vazhdojmë, duke e zgjeruar më tej me fakte e dokumente që akoma s'i kemi bërë të njoitura. Edhe të tjerë e kanë filluar luftën e tyre kundër revizionizmit kinez.

Ne për këtë kemi fakte boll. Por, çdo ditë që kalon dalin në dritë fakte të reja, të cilat i japin vetë kinezët dhe imperialistët. Ne, edhe pa i ditur këto fakte të reja që po zbulohen, por vetëm duke u bazuar në ato të mëparshmet, kemi vlerësuar drejt çështjen kryesore, se Partia Komuniste e Kinës nuk ka qenë në

pozita të drejta, nuk ka qenë një parti marksiste-lininiste. Analizat, që ka bërë Partia jonë se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, por një demokrat përparimtar borgjez, kanë qenë gjithashtu të drejta. Politika kineze që udhëhiqej nga ideologjia e Maos drejtohej kundër Bashkimit Sovjetik të Leninit dhe të Stalinit; ajo ka qenë një politikë pro Perëndimit, jo tash, por me kohë, që përpara. Lufta që i ka bërë Mao Ce Duni Kominternit dhe fakte të tjera të zbuluara kohë pas kohe, e kanë vërtetuar plotësisht këtë konkluzion të Partisë sonë.

Përpara dy-tri ditësh, agjencia amerikane e lajmeve UPI, zbuloi se që më 1949 Çu En Lai i ka dërguar një mesazh sekret presidentit amerikan Truman (dhe ky gjendet në vëllimin e tetë të arkivave amerikane) me të cilin u kërkohet ndihmë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. «Kina nuk mund të kërkojë ndihmë nga Bashkimi Sovjetik, — thoshte në këtë mesazh Çu En Lai, — se ai është i varfër nga lufta dhe ne nuk e konsiderojmë atë si një shtet që është në gjendje të mbajë ekuilibrin, prandaj kërkojmë ndihmën e Uashingtonit». Vërtetohet kështu ajo që ka thënë Partia jonë se në senatin amerikan kanë ekzistuar dy lobe, njëri nga të cilët ishte që të braktisej Çan Kai Shia; prandaj edhe në shtabin e Mao Ce Dunit kanë pasë qenë dërguar Edgar Snou, Ana Luis Strong e të tjërë, të cilëve Mao Ce Duni u hapte planet dhe u tregonte çdo gjë. Amerikanët, me një fjalë, që në kohën e luftës ishin si të shtëpisë në radhët e udhëheqësve kryesorë kinezë; bile agjentët amerikanë kanë luajtur edhe poker me Maon.

Sa më tepër të kalojë koha, aq më shumë fakte të tjera demaskuese do të dalin kundër udhëheqësve kinezë. Rruga e Kinës është rruga e tradhtisë, e tradhtisë kriminale. Ajo është larguar me kohë nga binarët e marksizëm-leninizmit dhe në vend që të përpinqet për të prishur planet agresive imperialiste në zona të ndryshme të botës, nxit luftën në Evropë. Kjo është një strategji e gabuar, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të shkojnë kurrë në rrugën që kërkon t'i futë Kina për t'i hedhur në luftë kundër Bashkimit Sovjetik.

Traktati që Kina nënshkroi me Japoninë është një traktat në tri këmbë, njëra nga të cilat rri më prapa, nuk duket. Kjo është këmba e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pse pa të nuk bëhet dot gjë. Këmba e dytë është e Kinës dhe e treta e Japonisë. Në dokumentin e nënshkruar thuhet se të dyja palët «janë kundër hegemonizmit», por ata në fakt janë të tërë hegemonistë, si Shtetet e Bashkuara ashtu edhe Kina e Japonia. Por me këtë ato duan të thonë se janë kundër hegemonizmit sovjetik. Shtetet e Bashkuara synojnë të kenë në duart e tyre Kinën, dhe tash kanë siguri të plotë se Kina do të bëjë siç dëshirojnë ato për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik. Por edhe ky do ta luftojë Kinën e Japoninë dhe do të përpinqet të bëjë siç bëri Musolini. Kina e ka të qartë këtë politikë, por dëshiron që lufta të ndizet në Evropë, kurse Bashkimit Sovjetik nuk i intereson kjo luftë këtu se nuk ka çfarë të fitojë prej saj. Pastaj ai nuk e ka lehtë ta fitojë luftën në Evropë, pse, po të plasë ajo këtu, atëherë fillon luftë botërore. Çfarë do të fitojë Bashkimi

Sovjetik në Evropë ku nuk ka burime që t'i shfrytëzojë vetë? Si çdo imperializëm, edhe socialimperializmi sovjetik lufton për tregje të reja dhe për zona influence. Po a mund t'i krijojë ai këto në Evropë? A mund t'i shtypë ai Francën apo Anglinë? Në asnje mënyrë jo, prandaj janë mundësítë që ai të godasë atje ku e ka më të sigurt fitoren, ku e ka më të le-verdishme, atje ku hallka e kundërshtarëve të vet është më e dobët. Edhe Kina, nga ana e vet, dëshiron të godasë Siberinë dhe vendet e tjera rreth kufijve të saj.

Ndaj të gjitha këtyre synimeve Evropa është vijgilente. Ne shikojmë se kreditë e vendeve të zhvilluara kapitaliste të Evropës, po rrjedhin lumë në disa vende revizioniste. Në këtë strategji ka hyrë edhe Kina, e cila kërkon të futet edhe në Ballkan nëpërmjet Rumanisë e Jugosllavisë. Dihet që Rumania është e lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por ajo do që t'i bëjë qejfin Kinës. Kurse Titoja nuk është budalla. Ai do ta presë Hua Kuo Fenin, por mbështetjen më të madhe e ka te Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me ato që ka bërë në Ballkan dhe në Azinë Juggindore, Kina përpinqet të japë përshtypjen se po e rrethon Bashkimin Sovjetik. Por çështja nuk është aq e lehtë, se Bashkimi Sovjetik, si vend socialimperialist i tërbuar, nuk do ta lejojë veten të rrrijë duarli-dhur dhe i rrethuar. Edhe ai luan kartën e tij, siç luan Kina kartën e saj. Deri tani karta e Kinës është në shërbim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kërkojnë të hedhin kthetrat në Afrikë dhe në Azinë Juggindore. Prandaj ne i demaskojmë të tria këto super-

fuqi. Kina thotë se duhet demaskuar Bashkimi Sovjetik, se është i pademaskuar. Por edhe Kina vetë duhet demaskuar, se sot në botë ka mjaft iluzione për të.

Në Kinë ka rezistencë, po kjo është e shpërndarë se nuk ka qenë asnjëherë e organizuar. Edhe në qoftë se atje ka njerëz kundër udhëheqësve aktualë, ata vepojnë me flamurin e Mao Ce Dunit, mirëpo me këtë flamur nuk mund të fitojnë kurrë. Megjithëse nuk dimë si është puna në Bashkimin Sovjetik, në lajmet e jashtme lexojmë se në një fjalim që ka mbajtur Brezhnjevi para kuadrove të ushtrisë, kur zuri në gojë emrin e Stalinit, për pesë minuta rresht pati duaritrokitje të vazhdueshme në sallë. Me këtë atij iu bë një sfidë. Është e qartë se hrušovianët nuk do ta lëshojnë situatën lichtë. Në Kinë nuk ka qenë kurrë në fuqi marksizëm-leninizmi, ndaj, në qoftë se atje do të luftohet me flamurin e Mao Ce Dunit, do të vazhdohet lufta e grupazheve për pushtet dhe jo për fitoren e marksizëm-leninizmit.

Ne duhet të jemi shumë vigjilentë si në çështjet ekonomike, ashtu edhe në ato ushtarake. Nuk di nëse po punohet në fshatra për strehimet. Të kemi parasysh, shokë, se arma e aviacionit armik kundër vendit tonë, kur të vijë koha që ai të na sulmojë, do të jetë mjeti i parë agresiv kundër popullit tonë dhe jo vetëm kundër qyteteve, por edhe kundër fshatrave. Në qytete po punohet për problemet e mbrojtjes, kurse në fshat kjo çështje më duket se nuk po vlerësohet kudo drejt. Ne duhet të marrim masa qysh tani që të mbrojmë popullin, fshatarësinë, klasën punëtore, socializmin, të ardhmen e vendit tonë nga çdo sulm armik, ngado-

që të na vijë dhe të jemi të gatshëm në çdo kohë. Kjo nuk do të thotë se duke bërë strehime, kur të sulmo-hemi, njerëzit do të futen në to dhe nuk do të luftojnë. Përkundrazi, çdo veprimi agresiv të armiqve ne do t'i kundërvëmë përnjëherë mjetet tonë më të efektshme. Kur të bombardojnë armiqtë vërtet ne do të mbro-hemi në strehimet që po bëjmë, por pastaj, pas bom-baradimit, do të kundërsulmojmë përnjëherë. Strehimet, pra, nuk i bëjmë sa për të shpëtuar kokën, por të na shërbejnë për t'u marrë krahët armiqve. Ata vërtet mund të na vijnë këtu me pushkë, por pushkë kemi edhe ne; ata mund të hedhin parashutistë, por ne do t'i asgjësojmë ata pa rënë akoma në tokë; ata mund të na sulmojnë me mjete të blinduara, po edhe ne kemi mjete të tillë; pra, edhe ne kemi nga ato mjete që do të përdorë armiku, por, ndryshe nga ai ne do të jemi të gjithë të bashkuar si grushti. Prandaj edhe çështjet e mbrojtjes duhet t'i kemi vazhdimisht parasysh. Mendimi i drejtë dhe organizimi ekzistojnë për këtë problem, por nuk duhet të ketë as më të vog-lin nënvliftësim. Vietnamese i kishin mu në mes të rrugëve e kanaleve strehimet për mbrojtje; ata porsa kryenin një aksion, largoheshin shpejt, hapnin kapakun, futeshin brenda dhe mbroheshin. E dimë që armiqtë tanë kanë mjete dhe forca të mëdha, por te ne ata nuk do t'i fusin dot të gjitha përnjëherësh ato, se nuk ka vend. Vetëm nga qelli mund të na dërgojnë më shumë forca, por edhe këtej do t'u themi: «Dale beg, se ka hendek». Sidoqoftë, siç thashë, masat duhen marrë dhe të mos ekzistojë asnje nënvliftësim për ta.

Moti këtu, në Pogradec, tërë kohën kështu ka qe-

në, i freskët. Ky vend tani, gjatë verës, frekuentohet shumë nga punonjësit tanë. Kam vënë re se këto vitet e fundit po vijnë përherë e më tepër njerëzit për pushime këtu, sepse është vend i bukur, ka gjelbërim, pemë të shumta dhe bën mjaft freskët.

Tani shkojmë të hamë drekë.

*Pasi u ulën rrëth tryezës, shoku Enver Hoxha i uroi të pranishmit duke takuar gotën me gjithë shokët me radhë:*

Mirë se na erdhët, shokë! Të na rrojë Partia! Të rroni ju!

«Të rroni ju, sa malet, shoku Enver!», u përgjigjen të pranishmit.

Tani që jemi ulur rrëth tavolinës, më kujtohet banketi që shtroi Gjergj Dimitrovi për mua dhe Nekh-mijen, kur shkuam në Sofje. Sa i dashur e i thjeshtë ishte ai! I mbante mend mirë emrat e të gjithë shokëve tanë, si Heroin e Popullit Halim Xhelon e të tjerë. Bile, më kujtohet një hollësi nga ai banket, që flet për thjeshtësinë e Dimitrovit. Tavolina ishte e shtruar pak si me saltanet, por ai mbledhi gjithë pirunjtë e thikat e shumta që kishte përparrë dhe i tha kamerierit: «Nuk më duhen hiç të gjitha këto; vetëm një pirun dhe një thikë më duhet, të tjerat m'i hiq këtej!».

Po ju tregoj edhe një kujtim tjetër. Ndodheshim një ditë dimri të ftohtë me dëborë me delegacionin e Partisë e të Qeverisë sonë në Sofje. Me të gjithë ishte vendosur të shkonim në një vend tjetër, në Kritçim, ku do të firmosnim marrëveshjet për marrëdhëni etona të përbashkëta. Unë me Dimitrovin ishim me një

makinë përpara. U ndalëm dhe po prisnim në një vend derisa të vinin edhe shokët e tjerë. «A nuk nisi semi vetëm e të mos i presim të tjerët», — më tha Dimitrovi. «Mirë, — iu përgjigja, — nisemi, por mos duhet të presim sa të vijnë edhe të tjerët, se ka rregulla për këtë». «Jo, jo, nisemi», nguli këmbë ai. Dhe shoferi, si mori porosi, ia shkeli. Kur vajtëm afër Kritçimit, vura re se populli kishte dalë dhe, sa na pa, filloi të duartrokiste. «Do t'u flasësh?» — më tha Dimitrovi. — Në rusisht? «Si do t'ia bëjmë? — i thashë. — Jam gati të flas, po kush do të na përkthejë? Unë, përveç disa fjalëve rusisht, nuk di fare bullgarisht.» «Do të përkthej unë», — ma ktheu Dimitrovi. «Po si do të përkthesh?», — e pyeta i habitur. «Do të përkthej pa vështirësi, se e di çfarë do të thuash ti». Dhe kështu bëmë. Unë flisja shqip, Dimitrovi bullgarisht, kurse populli brohoriste i entuziazmuar. Me të vërtetë ne merreshim vesh shumë mirë, sepse kishim një vijë, kishim pikëpamje të përbashkëta, pavarësisht se nuk dinim gjuhën e njëri-tjetrit.

Në delegacionin tonë bënин pjesë edhe Koçi Xoxe me Kristo Themelkon. Një apo dy ditë më parë, kur kaluam në Beograd, Koçi kishte pasur një takim me Rankoviçin. Atë me Kriston, në Sofje, e vunë bashkë, në një banesë, kurse mua me Hysniun na lanë më vete.

Në darkën që shtruan për ne, Dimitrovi foli shumë mirë për Partinë tonë. Pas tij fola unë dhe thashë fjalë të mira për Dimitrovin. Të them të drejtën, harrova ta përmendja Titon, ose e përmenda fare pak. Siç ju thashë, unë flija me Hysniun, kurse Koçi me Kriston flinin bashkë.

Pas darkës po bisedonim me Hysniun, kur vonë, natën, na erdhën të dy në banesën tonë. «Rrini! — u thamë. «Jo, kemi ardhur për punë» — na u përgjigjen. Dhe Koçi Xoxja m'u drejtua mua: «Si është e mundur që the gjithë ato fjalë të mira për Dimitrovin?!». «Ai i meriton të gjitha, — ia ktheva unë, — bille thashë pak, se më shumë duhej të kisha thënë!». «Jo, nuk është ashtu!» — kundërshtoi ai. «Ashtu është, — u hodh Hysniu. — Duhej të kishim thënë më shumë, se thamë pak për të». Por Koçi e kishte hallin gjetkë: atij s'iu durua, derisa u shpreh: «Si është e mundur të mos thoshe asnjë fjalë për Titon në gjithë ato gjëra që the gjatë darkës?!. «Këtu nuk jemi në Beograd, — iu ktheva unë, — po në Bullgari». «Unë nuk jam dakord» — u hodh Koçi.

«Mirë, mirë, — iu përgjigja, — kur të vemi në Tiranë, e shikojmë dhe bisedojmë për këtë çështje, nëse keni apo nuk keni të drejtë».

Patëm edhe një incident tjetër me të. Kishim rënë dakord me bullgarët për nënshkrimin e një dokumenti lidhur me marrëdhëniet tregtare me ta etj., kur hidhet Koçi Xoxja e thotë: «Sikur të vëmë këtu edhe një frazë të tillë «në marrëveshje me Jugosllavinë». Më thotë Hysniu në vesh mua: «Po ky, çfarë thotë kështu?». «Nuk ka pse ta vëmë, — u hodha unë, — sepse këtu është fjala për marrëdhëniet me Bullgarinë e jo me Jugosllavinë». «Po sikur ta vëmë?», — nguli këmbë Koçi. Atëherë Dimitrovi tha: «Nuk ka gjë, shoku Enver, e vëmë!». Kështu veproi Koçi që kishte marrë udhëzime nga Rankoviç kur kaluam në Beograd.

Para se të shkonim në Bullgari kaluam nga Beogradhi. Kur na priti Titoja, i cili kishte zënë vend në krye të tavolinës, iu drejtua Koçit: «Urdhëro, shoku Xoxe, kötu!» — dhe i tregoi vendin bosh, në krye të tryezës. Koçi Xoxja u skuq i téri dhe, duke belbëuar, tha: «Aty le të vijë shoku Enver!». Kurse unë i thashë: «Nuk ka gjë, shko ti të rrish atje ku të thotë!». Gjarpri, pa dashur, i nxori këmbët.

Kështu qenë këto punë more shokë.

Tani le t'i ngremë edhe një herë gotat. Të na rrojë Partia!

Të dielën pamë një shfaqje shumë të bukur këtu, në Pogradec.

Më pëlqeu shumë sidomos kupleti që interpretohej nga tre aktorë. I kishin ujdisur shumë bukur fjalët. Berlinguerin e shtrinë fare në tokë.

**SHOKU VANGJEL ÇËRAVA<sup>1</sup>:** Televizioni e transmetoi shumë bukur këtë shfaqje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe festën e Vithkuqit e dha mirë televizioni; mua më pëlqeu. Përgatitja dhe organizimi i mirë i festimit të këtyre datave të shënuara ka një rëndësi të madhe.

**SHOKU ENVER HALILI<sup>2</sup>:** Të gjithë ish-partizanët dhe njerëzit e familjeve të dëshmorëve i shpërndamë nëpër baza atë natë. Tashmë kjo është bërë një traditë e mirë, kështu njihen e miqësohen njerëzit me njëri-tjetrin.

1. Në atë kohë, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës.

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është mirë t'i ruajmë dhe t'i pasurojmë gjithnjë e më shumë këto tradita. Kanë kaluar 35 vjet dhe ne rrojmë me ngjarjet e kohës së luftës; i kemi të gjalla e i ruajmë ato kurdoherë të freskëta në mendjen tonë. Prandaj t'u kushtojmë kujdes këtyre ngjarjeve të rëndësishme që edhe brezat e rinj t'i kenë në mendje e në zemër, njëloj sikur t'i kenë jetuar.

**SHOKU SIMON STEFANI:** Në festën e Vithkuqit pjesëmarrësit ishin të të gjitha moshave; të moshuarit kishin marrë me vete fëmijët, nipërit e mbesat.

**SHOKU ENVER HALILI:** Vithkuqi ziente nga htereja. Rrugët ushtonin nga të rinjtë që grupe-grupe ktheshin në qytet duke kënduar. Në festë morën pjesë edhe grupet artistike.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mbase ishte edhe kori i pleqve.

**SHOKU ENVER HALILI:** Po, ishte. Sipas porosisë suaj ne kemi futur në këtë grup edhe disa të rinj.

**SHOKU STILI KASKAVIQI<sup>1</sup>:** Mjaft nga pjesëmarrësit u mallëngjyen shumë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Natyrisht, u është dukur sikur po i jetonin edhe një herë ngjarjet e luftës.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Sa më shumë vite që shkojnë, aq më të ndjeshëm bëhen veteranët e luftës, aq më të dashura duken ato ngjarje.

**SHOKU ENVER HALILI:** Elbi na doli mirë sivjet.

---

1. Në atë kohë, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Pogradecit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe panxharin duhet ta realizoni, se tokat tuaja janë të ujitshtime.

**SHOKU SIMON STEFANI:** Këtyre u ndihmon tani edhe rezervuari i Gjançit që ka ujë të bollshëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk ka humbje uji në rezervuar?

**SHOKU ENVER HALILI:** Jo, sepse ka prurje nga Vithkuqi.

**SHOKU STILI KASKAVIQI:** Te Qafa e Thanës, ku ka dalë ujë me bollëk, mund të ndërtohet një hidrocentral.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, atje uji mund të shfrytëzohet për të ndërtuar një hidrocentral dhe për ujitje. Ky e zgjidhi përgjithnjë problemin e ujitjes së fushës së Domosdovës.

Pemët e mbjella në Përrenjas kanë filluar të jepin prodhim?

**SHOKU SPIRO BICE<sup>1</sup>:** Pjesërisht mollët dhe kumbullat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ju në Korçë si i kenë kumbullat?

**SHOKU ENVER HALILI:** Mirë i kemi. Edhe sivjet ra bryni, por megjithatë pemët i shpëluam, sepse u morën të gjitha masat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju këtu, në Pogradec, i keni mirë mollët dhe gështenjat?

**SHOKU SPIRO BICE:** Mirë i kemi dhe po i shtojmë.

---

1. Në atë kohë, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Pogradecit.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Vetëm se nuk shikojmë të shiten gështenja. Fëmijët i hanë shumë ato, prandaj kemi kërkuar, por na kanë thënë se nuk ka në treg.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në Valbonë ka troftë shumë të mirë. Po edhe ju këtu, në Pogradec, keni peshk të mirë. Korçarët kanë cironka. Kur shkoja në Korçë, bashkë me Petin<sup>1</sup> dhe me Hakiun<sup>2</sup>, venim për të zënë cironka. Peti merrte me vete shishen e vajit, tiganin e të tëra ato që duheshin për gatim. Ndiznim zjarrin, i cigarisnim dhe i hanim atje, në vend.

Ju keni edhe liqenin e Prespës për peshk.

**SHOKU ENVER HALILI:** Atje, para disa vjetësh ra një sëmundje që na e zhduku krapin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kush e di pse do të ketë ndodhur. Po blegtoria është e zhvilluar atje?

**SHOKU ENVER HALILI:** Po, po, se edhe Mali i Thatë, edhe mali i Ivanit, kanë kullota për bagëtitë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po televizori e merr mirë Tiranën andej?

**SHOKU ENVER HALILI:** Në disa fshatra tani për tani nuk e merr mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhen shtuar repetitorët.

**SHOKU ENVER HALILI:** Të fala keni nga Miha Lakoja. Më porositi t'ju them se po vazhdojnë të punojnë sipas këshillave tuaja.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit! Të fala

1. Peti Shamblli.

2. Haki Toska.

shumë t'i bëni edhe ju nga unë kur të ktheheni.

**SHOKU ENVER HALILI:** Të gjithë veteranët na ndihmojnë, sidomos shoku Niko Ceta.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më erdhi keq për Niko Cetën që i vdiq djali në moshë shumë të re.

Duhet të dëgjohet patjetër fjala e veteranëve se janë njerëz me eksperiencë të madhe. Deri dje që punonin, kanë qenë kuadro, drejtues të Partisë, të puhitetit, të ushtrisë etj.

**SHOKU ENVER HALILI:** Te shtëpia ku keni banuar ju, shoku Enver, ju kujtojnë gjithmonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë kam kujtime të mira nga ajo shtëpi. Thulla, e zonja e shtëpisë, kishte një djalë, Andrea e quanin. Ai më thoshte nganjëherë: «Të vij të rri një çikë, zoti profesor?». «Hajde!» — i thosha unë, Andrea bridhte gjithë ditën dhe, kur kthehej në shtëpi, vinte tek unë, pinim nga një cigare, pastaj ikte prapë. Po plaka, nëna e tij, ishte një grua shumë e mirë.

Mbaj mend që u sëmura njëherë nga gjuri. «Të marrim doktor Arisiadhin», i thashë plakës. «Po ai është i krisur, more bir», më tha ajo. «Jo, jo, ta thërrresim», ngula këmbë unë. Dhe plaka vajti e thirri: «Doktor, hajde të keqen të shikosh djalin, se e kam të sëmurë», i tha ajo. «Ç'të pati Andrea moj?» «Jo, jo, nuk është Andrea i sëmurë, kam djalin tjetër, profesorin». Dhe doktori erdhi e më pa gjurin. Ai kërkoi pastaj një mangall me prush. Ne po shikonim se ç'do të bënte. Mori disa shufra hekuri dhe i vuri në zjarr e i la atje derisa u skuqën; pastaj m'i vinte në këmbë dhe i hiqte me shpejtësi. Këmbla m'u nxi. «Bobo, më dogji

djalin ky i marrë!» — thërriti plaka. «Ik, more, andej, se e dogje! Ç'm'i bëre djalit kështu! Ik, more, se je i marrë» — bërtiste akoma më tepër Thulla. (Të qeshura.) Që atë ditë shokët nuk më lanë të mjekohesha tek ai doktori, po më rregulluan të vizitohesha te Polena.

**SHOKU VANGJEL ÇERAVA:** Akoma edhe sot janë tubi dhe shufrat që përdorte për mjekim Arisia-dhi, pikërisht ato që ka përdorur edhe për ju.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, shokë! Sot kaluan së bashku një drekë të këndshme, u kënaqëm shumë. Mirupafshim! Të na rrojë Partia! Të rroni ju!

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime, sipas shënimeve  
të mbajtura në këtë takim,  
që gjenden në AQP*

# **BUJQËSIA KËRKON PUNË TË KUJDESSHME SIKENCORE E ORGANIZATIVE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**28 gusht 1978**

*Në këtë takim shoku Prokop Murra informoi për realizimin e detyrave në industri, sidomos në sektorin e naftës dhe të minierave. Shoku Enver Hoxha, pasi u interesua të njihej më konkretisht me kërkimet e studimet e bëra në këta sektorë, me perspektivën e vendburimeve ekzistuese etj., vazhdoi:*

Nuk duhet të kënaqemi me faktin se vendi ynë ka minerale dhe t'i lëmë ato pa i nxjerrë. Pasuritë nëntokësore t'i shfrytëzojmë dhe për këtë qëllim të mbledhim specialistët ku janë e ku nuk janë, të krijojmë organizmat e domosdoshëm, dhe sa më parë që të jetë e mundur të marrim të gjitha masat e nevojshme për të ecur përpara në këtë drejtim. Si mund të lihen tërë këto pasuri që përmban nëntoka jonë pa u shfrytëzuar? Ato, bile, duhet të zbulohen sa më shpejt e të futen menjëherë në rrugën e shfrytëzimit.

Një gjë kisha për t'ju thënë: Nuk jam dakord që

për të tilla probleme të bisedohet medoemos e kurdoherë në Qeveri. Mendimi im është ky: Ministria e Industrisë dhe e Minierave duhet të ketë kompetenca dhe përgjegjësi të plota për organizimin e punës lidhur me shfrytëzimin e gjithë këtyre mineraleve. Natyrisht, do të ketë raste që do të pyjet edhe Qeveria e do të merret medoemos mendimi i saj. Për këtë, nga ajo do të organizohen edhe kontolle, por vetë kjo ministri duhet të ketë kompetenca të plota për t'u dhënë zgjidhje problemeve që dalin në këtë sektor. Pse, me çdo problem të veçantë që del në sektorët e prodhimit, Qeveria do të merret? Atëherë, përcse kemi ngritur nga një ministri të tërë për çdo sektor? Prandaj themi që duhet t'i bëjnë ato këto punë e pastaj të jatin llogari para Qeverisë se si i kanë kryer. Për zarzavatet, fjala vjen, nuk mund të përgjigjen zëvendëskryeministrat, por vetë Ministria e Bujqësisë me të gjitha kooperativat që u janë caktuar t'i kultivojnë. Për këtë, kjo ministri duhet të vrasë mendjen, të aktivizojë ekipet e saj, duke ushtruar kontolle nëpër kooperativat derisa të konkretizohet gjithë kjo punë. Kur quhet e konkretizuar puna e saj? Kur shikohet rezultati, domethënë kur të dalin në treg zarzavatet etj., në bazë të planeve që kemi vendosur. Prandaj këto gjëra të mos mbeten vetëm në diskutime.

Ne tanë luftojmë për të zbuluar pasuritë e vendit tonë e për t'i shfrytëzuar ato intensivisht, për arsyen se nuk ka se si të financohet ndryshe pesëvjeçari i ardhshëm. Këtë gjë të gjithë duhet ta kuptojmë mirë. Natyrisht, është një gëzim i madh fakti që na doli një pus, por shfrytëzimi racional i tij kërkon një punë të

organizuar mirë për të marrë prej tij gazin me qëllim që të ekonomizojmë naftën, të cilën, pasi ta rafinojmë jo vetëm zgjidhim nevojat e vendit por edhe mund ta eksportojmë. Kështu duhet të veprojmë edhe për bakrin dhe për komponentët e tjera të polimetaleve.

Por, konstatoj se në këto çështje ka mjaft javashllék. Unë kam ngulur dhe ngul këmbë se nuk u jepen kompetenca dhe përgjegjësi të plota atyre që janë ngarkuar me këto punë. Nuk duhet që për çdo gjë, edhe për qimen e kokës, të pyetet, fjala vjen këtu, në aparat, sekretari i Komitetit Qendror. Është e domosdoshme që çdo njeri sipas detyrës që i kemi caktuar të mbajë përgjegjësinë e vet. Dhe përgjegjësia është kjo: Në qoftë se të është ngarkuar kjo punë, t'i shkosh asaj deri në fund vetë. Për shembull, doli nafta. në një vend. Në qoftë se Qeveria të ka caktuar një numër sondash për nxjerrjen e saj, atëherë duhet të marrësh menjëherë masa vetë si ministër, të heqësh, fjala vjen, 10 sonda nga një sektor tjetër dhe t'i sjellësh këtu. Por, në qoftë se ministri nuk e ka një kompetencë të tillë dhe për këtë detyrohet të shkojë të pyesë zëvendëskryeministrin, puna nuk ka për të na ecur. Prandaj them se ministri duhet të marrë përgjegjësi dhe të vendosë që këto 10 sonda të hiqen këtej dhe të çohen në këtë vend. Një veprim i tillë fare mirë mund të arsyetohet nga ana e tij edhe në Qeveri, edhe në Komitetin Qendror të Partisë, duke argumentuar me fakte se përsë qe e domosdoshme që të hiqeshin sondat andej dhe të çohen atje. Pastaj, edhe për afatin e transportimit e për të tjerat nuk ka pse duhet të pyetet më Qeveria, ndryshe shkaktohen vonesa të kota.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Me të vërtetë që vihet re një javashllék i pajustifikueshëm në këtë drejtim.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në këtë çështje ka një-farë tutele nga ana e aparatit të Kryeministrisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është një tutelë e sëmurë. E si të mos u japim kompetenca shokëve të ngarkuar me detyra të rëndësishme, si mund t'i frenojmë ata që të mos veprojnë?

Po t'u japësh përgjegjësi njerëzve, po t'i ndihmosh e t'i inkurajosh ata, nuk ka pse të bëjnë gabime. Por, edhe në qoftë se gabojnë, Partia përsëri do t'u qëndrojë pranë që gabimet të korrigohen. Në përgjithësi, unë ngul këmbë këtu: zbulimet që bëjnë specialistët tanë kompetentë, nuk duhet të mbeten vetëm zbulime, por të organizojmë menjëherë punën që pasuritë që zbulohen të vihen në shfrytëzim, në shërbim të ekonomisë e të njerëzve.

Si paraqitet gjendja në bujqësi? Drithi, veçanërisht gruri si duket?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Ç'është e vërteta po punohet, por ka pasur vështirësi edhe për shkak të thatësirës. Në grurë mendohet të marrim gati 30 mijë tonë më tepër se vitin e kaluar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po për pataten, çfarë masash u morën, dhe pse nuk do të realizohet plani? Arsy, po të kërkosh, gjen sa të duash, por neve na duhet të dimë se ç'duhet bërë konkretisht për të përmirësuar gjendjen?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Situata me pataten nuk paraqitet mirë. Në ato vende ku kjo bimë është mbjellë mbi ujë, janë krijuar deficite të konsiderue-

shme. Edhe me serrat nuk kemi dalë mirë. Qeveria ka marrë një vendim të posaçëm për këtë çështje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vendime kemi marrë ngahera, po ç'hotë baza, pse nuk i vë në jetë këto vendime? Në mbledhjen që u organizua për këtë qëllim, folën shokët e bazës apo jo? U turpëruan ndonjë çikë?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Shokët e bazës bënë autokritikë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Vendimet nuk mun-gojnë, por unë mendoj se ne duhet t'i kushtojmë më tepër vëmendje kontrollit të zbatimit të tyre për të parë nëse u mbollën apo nuk u mbollën sipas planit të parashikuar. Po të tregohet kujdesi i duhur, nuk ka ndonjë sekret të madh për realizimin e planit të zarzavateve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Përpara, bahçevanët tanë edhe në Stamboll kur venin, si bahçevanë puno-nin. Mbjellja e bimëve të ndryshme bujqësore mendoj se duhet të jetë e përqendruar. Ja, për shembull, ç'është bërë për ta përgjithësuar eksperiencën e kooperativës bujqësore të Plasës? Ose, në rrethin e Beratit, pse të shtrihet në 20 kooperativa bujqësore luledielli? Për ç'arsye? Duke vepruar kështu, nuk merr rendimentin e duhur, sepse kooperativat, kur mbjellin një bimë në sipërfaqe të kufizuara nga 10 deri 50 hektarë, nuk kujdesen dhe as që e vrasin mendjen shumë për të. Prandaj, duhet parë konkretisht eksperiencia e deritanishme nëpër rrethe e pastaj të shikohet si është bërë përgjithësimi i saj, pra, ç'punë ka bërë Ministria e Bujqësisë në këtë drejtim.

Ç'kuptoj unë me përgjithësimin? Në qoftë se e kemi zbatuar këtë eksperiencë në mënyrë shkencore, në filan kooperativë, do të thotë se atje kemi arritur të përqendrojmë kultivimin e disa bimëve kryesore dhe kemi skartuar një pjesë të bimëve të dyta e të treta. Kooperativa, ku është bërë një punë e tillë, duhet të na dalë shumë rentabël, se prandaj e bëmë këtë gjë.

Tani të vijmë te përgjithësimi që duhet të bëjmë. Siç thashë, pra, një kooperativë ka hequr këtë apo atë bimë, një tjetër ka hequr bimë të ndryshme nga e para e kështu me radhë. Mirëpo neve na duhen të tëra këto. Atëherë, lind pyetja: kush do ta bëjë shpërndarjen apo planifikimin e tyre? Për këtë do të kujdeset që ta rregullojë ministria. Mirëpo, pa të dhëna konkrete dhe pa studime nuk rregullohen këto çështje. Kur ministria shikon që në një kooperativë rendimentet në misër janë kaq të larta, kurse në një tjetër rendimentet janë gjithashtu të larta në luledielli, atëherë ajo llogarit se si është më e fituar; për këtë i plotëson bukën njërsës dhe i thotë: «Hiqe misrin nga kooperativa jote dhe mbill në vend të tij lulediellin!» Në këtë rast, nuk duhet menduar sikur po shkojmë në monokulturë. Ne ruajmë kontingjentet e tokave për bimë të ndryshme. Për shembull, në qoftë se kemi për të mbjellë 20 mijë hektarë me luledielli, në vend që ta shpërndajmë këtë në 300 fshatra, e mbjellim më mirë në 20. Grurin, misrin, jonxhën etj., i planifikojmë për t'i mbjellë në kooperativa të tjera.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kjo që thoni ju, është e drejtë, shoku Enver. Isha në Seman, një koope-

rativë e madhe në rrithin e Fierit, ku merrnin 22 kuintalë fasule për hektar ose tri herë më shumë nga sa merrnin në Shkodër. Por Shkodra merrte tri herë më shumë oriz. Vjmë tek ajo që thoni ju, te roli i ministrisë, e cila në këtë rast duhet t'ia heqë orizin, fjala vjen, kësaj ekonomie të rrithit të Fierit dhe ta ngarkojë të kultivojë fasulen. Kështu do të kenë leverdi edhe shteti, edhe kooperativat bujqësore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Medoemos duhet të veprohet kështu në këtë drejtim. Natyrisht, punohet dhe unë nuk them se njerëzit lidhin duart për këto probleme. Por çështja e përqendrimit të mbjelljes së bimëve dhe e prodhimit të drithërave të bukës kanë rëndësi të madhe, mbasi çdo vit na kanë dalë e po na dalin probleme. Ne nuk mund të kënaqemi vetëm duke thënë që «ç'është e vërteta njerëzit tanë kanë punuar».

Puna për sistemimin e tokave të bukës, nga Shkodra dhe deri tek ura e Mifolit, nuk duhet të merret hosh e bran, siç themi në Gjirokastër, por të punohet në mënyrë që brenda dy-tre vjetëve e tërë fusha të sistemohet. Atëherë mund të themi se e kemi siguruar me të vërtetë bukën. Këto probleme janë jashtëzakonisht të lidhura me njëra-tjetrën, por mua më duket se ndonjëherë i shikojmë disi të shkëputura. Që të përhapësh eksperiencën e Plasës, duhet t'i kesh të sistemuara të tëra tokat. Kur të realizohet një gjë e tillë, atëherë shtrohet çështja e orientimit me se do t'i mbjellim këto toka dhe përcakohet: kjo është toka e grurit, kjo është e misrit apo e lulediellit, ajo më tej është e fasules etj. Shikohet, pra, se ku merren

rendimente më të larta, në bazë të eksperiencës së kaluar, siç e thashë më lart, dhe pastaj manovrohet. Në këtë mënyrë veprohet jo vetëm në zonën fushore por edhe në zonat e tjera kodrinore e malore. Natyrisht, edhe në këto zona kemi ecur përpëra, por aty-këtu kemi pasur edhe probleme. Për shembull, në Shkodër ose në Lezhë na u përmbytën ca parcela, ngaqë tokat nuk janë të sistemuara. Kurse Korça ka problem çështjen e erërave të nxehta të pranverës, se sistemin dhe ujitjen ajo i ka mirë. Nuk flas për malësinë, por për fushën, ku sistemimin e tokave ajo e ka më mirë nga rrethet e tjera.

Megjithatë, më duket se edhe atje ka disa pretendime, të cilat nuk duhen ushqyer, sepse janë kërkesa të parakohshme. Se ja, më tha një ditë një nga kuadrot drejtues të atij rrathi: «Sikur ta kishim gjithë ujitjen në formë shiu, se tani e bëjmë me brazda!». «More, — i thashë, — je në vete apo jo? Si mund ta bëjmë qysh sot ujitjen në formë shiu në gjithë Shqipërinë? Ky, tani për tani, është një luks i madh». Por, sipas mendimit tim, një ujitje të tillë mund t'ua bëjmë perimeve, se për to kjo mënyrë ujitjeje është e domosdoshme, ndërsa për bimët e tjera është e mjaftueshme ujitja me brazda, që duhet bërë pas sistemimit të tokave. E gjithë bota e praktikon ujitjen me brazda. Ujitja në formë shiu kërkon një teknikë të lartë, kërkon shumë tuba plastmase etj., pra kushton shumë. Të mendosh që të realizohet sot një ujitje e tillë, kur kemi kërkesa të tjera shumë më të rëndësishme, do të thotë të ushqesh pretendime të dëmshme.

Bujqësia kërkon një punë të kujdeshshme shken-

core e organizative, sepse është një degë shumë e rëndësishme, por dhe e ndërlikuar e ekonomisë. Me të vërtetë është shumë e ndërlikuar, për arsyen se këtu veprojnë ligjet biologjike, të cilat, në bimët dhe në kafshët, bëjnë efekt njëlloj si në organizmin e njeriut.

Pra, këto çështje nuk mund të merren të shkëputura, por duhen parë në kompleks dhe të punohet vazhdimesh në të gjitha frontet. Të mos kënaqemi me ç'kemi arritur, por të synojmë për rezultate gjithnjë e më të mëdha. Kështu, në fushë duhet të luftojmë që të marrim medoemos 45 kuintalë grurë për hektar.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Kam përshtypjen se për eksperiencën e kooperativës bujqësore të Plasës në shtyp nuk po shkruajnë sa duhet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nuk shkruajnë fare, jo sa duhet.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Eksperienca e Plasës është me baza shkencore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është, prandaj i duhet ndenjur mbi kokë derisa të konkretizohet. Studimi i Plasës është një studim shkencor, prandaj edhe lëvizja nga planifikimi do të bëhet në përshtatje me kushtet agroteknike dhe me shtrirjen e tokave. Në qoftë se duhet të mbillet misër hamullor, mund të mbillet, por orientimet nuk duhet të prishen. Por ama, të mos keqkuptohet sikur Plasa tani kultivon vetëm një bimë. Jo, atje ne kemi vërtet panxhar, por kemi edhe misër, edhe grurë etj., gjithashtu kemi edhe bagëti. Do të ruajmë parabimën, pasbimën, prashitjen e ujitjen etj., dhe brenda këtyre duhet të bëjmë lëvizje, dhe jo të ndodhë pastaj që të mbjellim një bimë që

s'duhet mbjellë e që nuk jep rendimente. Veçse të kemi kujdes e të mos e bëjmë mozaik, duke mbjellë pesë hektarë këtu e gjashtë atje, se duke e bërë copa-copa të vogla tërë sipërfaqen e mbjellë të kooperativës, nuk kemi për të bërë gjë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# TREKENDËSHI I SUPERFUQIVE

Shënime

29 gusht 1978

Çështja e Kinës do të na preokupojë vazhdimisht, pse ajo me politikën e saj po kërcënnon botën me një luftë të re botërore grabitqare, imperialiste. Kina ka hyrë me të dyja këmbët në këtë rrugë armiqësore kundër popujve dhe, pa i fshehur as edhe një grimë dhe në asnjë mënyrë synimet e saj, po ndërmerr të gjitha masat që të krijojë trekëndëshin e supersfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe vetë Kinës, dhe kështu të suundojnë mbi shtetet dhe mbi popujt, të shtypin çdo revolucion e çdo luftë nacionalçlirimtare të popujve dhe të dominojnë botën nga çdo pikëpamje. Ky është qëllimi i Kinës, të cilin udhëheqja e saj, që nga Mao Ce Duni dhe deri te Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, e ka shprehur haptazi. Mao Ce Duni ka thënë që kinezët duhet të suundojnë botën.

Kjo pikëpamje tash është e qartë. Në politikën e Kinës sot po vihet në zbatim kursi i shtetit të madh, i fuqisë së madhe, i hegemonisë botërore, në atë rrugë, me atë politikë dhe me ato masa që mund t'i arri-

het këtij objektivi, domethënë, duke luftuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit dhe duke eliminuar një nga superfuqitë.

Dy superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, natyrisht, nuk e duan ngjitjen e Kinës në një shkallë me to, por kjo nuk do të thotë që njëra nga këto superfuqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitali botëror, të mos bëjnë me të punën e vet. Këta e financojnë Kinën që të realizojë planet e saj për t'u bërë një fuqi kapitaliste, një bastion kapitalist kundër revolucionit proletar dhe luftërave nacionalçirimitare. Një gjë e tillë do të nxitë edhe kontradiktat që kanë filluar e do të shtohen më shumë në të ardhmen midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, për arsy se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmojnë njëkohësisht si Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe Kinën. Kjo do të thotë se imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror e dozojnë ndihmën e tyre ndaj dy superfuqive të tjera. Për ta, socialimperializmi sovjetik është një fuqi e madhe imperialiste me një industri dhe me një ushtri të fuqishme dhe të modernizuar, kurse Kina, aktualisht, ka potencial vetëm nga popullata, se nga pikëpamja ekonomike e ushtarake ajo është shumë prapa. Dhe këto fuqi imperialiste, domethënë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, që ndihmojnë Kinën, e dinë fare mirë se programi i caktuar nga Kina që brenda këtij shekulli të bëhet një superfuqi, nuk do të realizohet për shkak të prapambetjes së saj të madhe.

Kina, natyrisht, do të fuqizohet, por jo në atë shkallë që mendon dhe aspiron ajo. Edhe fuqitë e tje-

ra kapitaliste do të fuqizohen gjatë kësaj kohe, kuptohet, në qoftë se të dyja palëve politika u ecën si thika në gjalpë. Shkenca marksiste-leniniste, dialektika dhe zhvillimi materialist historik i shoqërisë na mësojnë se situatat nuk zhvillohen sipas dëshirës së imperializmit, që është faza e fundit e kapitalizmit. S'ka dyshim që një gjë e tillë do të krijojë kontradikta të thella midis vetë superfuqive dhe midis tyre dhe shteteve e popujve të tjerë, që shfrytëzohen nga këto superfuqi.

Prandaj politika e këtyre tri superfuqive përbën aktualisht një rrezik të madh për botën, pse që të tria këto përpiken të dominojnë mbi njëra-tjetrën, kuptohet, në kurrit të shteteve më të dobëta kapitaliste dhe gjithë popujve të botës në përgjithësi.

Kina haptazi ndërmerr aksione fillestare me karakter të gjerë me dy qëllime:

Së pari, që të sigurojë kredi, të marrë teknologji moderne nga kush të mundë dhe të sigurojë zhvillimin e kulturës e të arsimit për përdorimin e një teknologjie të këtillë.

Së dyti, të bëjë një propagandë në favor të vet, të aleatëve amerikanë dhe të borgjezisë kapitaliste botërore, të japë në këtë fushë ndihmë efektive pro tyre dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Prandaj shohim që Kina po dërgon nga të katër anët emisarët e saj për këto dy qëllime. Vetë Hua Kuo Feni ka dalë me dhisk për ndihma ekonomike dhe për propagandë prokineze e proamerikane.

Në Evropë, pa neglizhuar kontinentet e tjera, shohim që Kina ka vënë të gjitha forcat e saj për të mbë-

shtetur ato aglomeracione politiko-ushtarake-ekonomike që mendon se ekzistojnë, dhe i ndihmon që të konsolidohen e të mbrohen nga propaganda subversive e sovjetikëve. Këtë propagandë subversive ajo e quan paraprijëse të një lufte të re botërore që Bashkimi Sovjetik do t'i deklarojë Evropës. Por Kina me pseudo-ideologjinë e saj përpinqet të mbytë çdo tentativë revolte dhe revolucioni të proletariatit kundër fuqive kapitaliste ose revisioniste në Evropë. Prandaj ne shohim që Kina të mbështetë në Evropë, haptazi, Tregun e Përbashkët Evropian, që është gati një superfuqi ekonomike dhe ushtarake. Nga ky aglomerim ajo kërkon kredi, teknologji dhe njëkohësisht bën propagandë, duke i këshilluar shtetet kapitaliste, antisovjetike të regjura, që jo vetëm të kenë mendjen nga rreziku sovjetik, por të armatosen e të jenë gati për të sulmuar.

Kina mbështetet më shumë te Republika Federale e Gjermanisë, sepse njeh potencialin e saj ekonomik e ushtarak dhe epërsinë e saj në Tregun e Përbashkët Evropian. Ajo mbështetet, gjithashtu, tek Anglia, më pak te Franca dhe përpinqet të futë këmbët në Ballkan. Për t'ia arritur këtij qëllimi, Kina, meqenëse nuk mundi ta thyente Shqipërinë socialiste ose ta bënte këtë revisioniste si veten, dhe meqë Partia jonë e demaskoi ideologjinë e saj kapitaliste, atëherë pothuajse i preut të gjitha marrëdhëniet me ne. Edhe marrëdhëniet diplomatike qëndrojnë në një fije peri, asnjë veprim nuk zhvillohet, veçse ne kemi ambasadën tonë në Pekin dhe ata kanë të tyren në Tiranë.

Në këtë situatë, Kinës në Ballkan, hëpërhë, i duhej të zhvillonte aktivitetin e vet në drejtim të Jugoslla-

visë dhe të Rumanisë. Këto dy shtete janë revizioniste dhe puqen plotësisht me pikëpamjet ideologjike të saj. Por edhe për sa u përket qëndrimeve politike, Jugosllavia e Titos dhe Rumania e Çausheskut puqen me politikën kineze. Domethënë të dy këto shtete, Jugosllavia dhe Rumania, kjo e fundit në pozita më të vështira se Jugosllavia, janë për një politikë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror. E tërë politika e tyre, veçanërisht e Titos, është një politikë në mbështetje të këtij kapitalizmi. Por në këtë rajon, natyrisht, nuk ekzistojnë vetëm Jugosllavia dhe Rumania, por edhe Shqipëria, Bullgaria, Greqia dhe Turqia.

Kinës, që të krijojë rrethin ose «kordonin sanitar» kundër Bashkimit Sovjetik, i duhet të ushتروجë ndikimin e saj edhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Me Shqipërinë ajo i prishi punët në të gjitha drejtimet. Mbetet Greqia, por kjo nuk ka interesa të mëdhenj që të lidhet aq shumë dhe verbërisht me Kinën. Greqisë do t'i interesonte të bënte tregti me Kinën dhe do të bëjë tregti me të, por pa u influencuar në asnjë mënyrë nga planet hegemoniste të kinezëve. Ne shohim se Greqia simpatizon NATO-n dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglinë dhe Francën, por, edhe në këtë të ashtuquajtur miqësi me këto shlete, konstatojmë se nuk mungojnë divergjencat, nuk mungojnë lëkundjet.

Për sa i përket Turqisë, kjo është shumë larg Kinës dhe tradicionalisht në çdo pikëpamje është e lidhur ngushtë me imperializmin amerikan. Është e vërtetë se socialimperializmi sovjetik është rreziku i Turqisë,

por s'është Kina ajo që do t'i vijë në ndihmë asaj, në rast të ndonjë lufte, ose të ndonjë sulmi sovjetik.

Për këto arsyet Titoja ka qenë shumë i matur në bashkëbisedimet me Hua Kuo Fenin. Pavarësisht se është një antisovjetik, që në fillim të vizitës Titoja i vuri pikat mbi i në bisedimet me Hua Kuo Fenin në Jugosllavi. Titoja do të bëjë një politikë të balancës, ai nuk do që miqësia me Kinën të jetë shkak për prishjen ose për keqësimin e marrëdhënieve me fqinjët e me shtetet e tjera. Me një fjalë Titoja i tregoi Hua Kuo Fenit se nuk mund të futet në aventurën antisovjetike në ato forma e në ato rrugë që do Kina, pra nuk mund të futet në armiqësi të hapët me Bashkimin Sovjetik, se në armiqësi është me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Po ashtu edhe nxitja kundër Bullgarisë do të bëhet sipas interesave të çastit dhe të diktatit që Bashkimi Sovjetik do të ushtrojë mbi Bullgarinë.

Kurse udhëheqja rumune ka në gjirin e vet forca që e duan lidhjen me Kinën, vetëm e vetëm për t'u shkëputur nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse e dinë që ajo nuk mund të ndikojë në këtë drejtim; ka edhe të tjerë që janë proamerikanë, por ka edhe prosovjetikë. Sidoqoftë, udhëheqja aktuale e partisë dhe e shtetit në Rumani është në mëshirën e sovjetikëve.

Pra, mund të themi se Hua Kuo Feni, gjatë vizitës në Ballkan pati sukses vetëm në paradat që iu bënë në Rumani, por ca më shumë në Jugosllavi, duke kaluar në mes të popullit i cili tundte flamurë. Ndërsa, për sa u përket pikëpamjeve të tij politike, nuk mund të themi që pati sukses. Veçse duhet vënë në dukje

se Titos ai i thuri lavde, e bëri hero, shkurt e ngriti në qilli. Huaja foli, gjithashtu, për miqësinë me titizmin dhe nuk harroi t'i kërkonte ndjesë Titos për sulmet që Kina dhe Mao Ce Duni u kanë bërë atij dhe titizmit. Ai ngriti lart vetadministrimin jugosllav dhe, sigurisht, përveç kredive që duhet t'i ketë dhënë, i suggroi Jugosllavisë titiste tregje në Kinë. Për të gjitha këto Titoja dhe banda e tij nuk munguan ta nxirrin këtë marionetë kineze me automobila e me motoçikleta në mes të popullit të Beogradit, Shkupit, Zagrebit e Brionit, t'i thoshin fjalë të mira, të propagandonin me forcë vetadministrimin jugosllav dhe, në mënyrë të veçantë, çështjen e partisë.

Jugosllavia është një «shembull i madh» për Kinën për sa i përket çështjes se si duhet likuiduar partia, ajo parti që s'ka qenë kurrë marksiste, por që duhet, qoftë edhe në formë e në emër, në mënyrë të falsifikuar, të duket se është një parti e proletariatit, domethënë një parti marksiste-leniniste. Hua Kuo Feni në Jugosllavi nuk e zuri në gojë fare marksizëm-lennizmin dhe këtë nuk e bëri pa qëllim. Ai i është adaptuar që përpara formulës revisioniste të titistëve dhe të eurokomunistëve. Pra, Lenini dhe Stalini nuk mund të kenë vend në ideologjinë kapitaliste kineze. Por edhe Karl Marks do të qëndrojë vetëm si emër e ai do të zhduket në ideologjinë e tyre.

Ne do të shikojmë çfarë rruge do të marrë Kina, por jemi të sigurt se atje do të vendoset kapitalizmi. Prandaj klikës aktuale kineze, që të fuqizojë vijën e saj kapitalisto-imperialiste, që të thithë dhe të përshtojë nga teknologjia e re, nga kreditë e shumta që po

merr, i duhet të gjejë format e përshtatshme ekonomike strukturore dhe superstrukturore për të krijuar një sistem të ri kapitalist.

Natyrisht, në krijimin e këtij sistemi të ri kapitalist, do të mbahet parasysh madhësia e territorit kinez. Edhe në ndarjen administrative Kina do të ketë parasysh eksperiencën e vet, eksperiencë që nuk ka qenë socialiste, por kapitaliste me forma socialiste. Ajo do të bëjë një shartim të kësaj eksperience me vetadministrimin jugosllav, kuptohet, deri në njëfarë shkalle, për arsy se vetadiminstri i jugosllav nuk mund t'u përshtatet si duhet territorit të gjerë dhe popullsisë së madhe kineze. Pastaj, ndryshe është situata në Jugosllavi, ndryshe është në Kinë. Megjithatë, ne do të shohim se si do të ecë ky proces në Kinë, se përveç vetadiministrimit jugosllav, për vendosjen e kapitalizmit, ajo, në radhë të parë, do të marrë si model ndërtimin kapitalist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë. Këto dy shtete aktualisht janë aleate të Kinës dhe eksperientat e tyre do të janë pasqyra e ardhshme e ndërtimit të një strukturë dhe superstrukturë të re në Kinë.

Kapitalistët kinezë i kanë sytë te Japonia, sepse ata kanë parë që ajo, e djegur dhe e shkatërruar nga Lufta e Dytë Botërore, mundi në një kohë relativisht të shkurtër, me ndihmën e imperializmit amerikan, të bëhet një fuqi e madhe botërore. Atëherë, këta kapitalistë kinezë thonë: «Pse të mos shohim si e kanë ngritur japonezët fuqinë e tyre kapitaliste, imperialiste e militariste? Ashtu siç e kanë ndërtuar ata, po ashtu ta ndërtojmë edhe ne».

Pra, në Kinë, mendoj unë, do të krijohen shoqëri e trusë të mëdha kapitaliste si në Japoni, të cilat do të lëkuidojnë industrinë e vogël, duke krijuar në këtë mënyrë kuadrot dhe klasën që do t'i drejtojnë këto shoqëri të mëdha në bashkëpunim me shoqëritë e tjera shumëkombësore dhe veçanërisht me shoqëritë japoneze, amerikane dhe me ato të Gjermanisë Perëndimore.

Traktati Kino-Japonez, siç e kam thënë dhe herë të tjera, është një traktat që kërcënnon botën me një luftë të re dhe është e qartë se ai u bë nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky traktat është në favorin e kapitalizmit botëror, veçanërisht në favor të kapitalizmit kino-japonez.

Natyrisht, Kina kërkon që, tok me Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ruajë të paktën statukuonë në Lindjen e Largme, në Azinë Juglindore, në Indi dhe në Gjirin Persik, në mos e shtriftë dominimin e saj në gjithë këtë pellg. Vajtjet e ardhjet e kinezëve në Filipine, në Pakistan, Afganistan dhe tash së fundi në Iran, si dhe buzëqeshjet ndaj Indisë, tregojnë qarë synimet e tyre ekspansioniste.

Me Vietnamin udhëheqësit revizionistë kinezë kanë hyrë në një grindje të thellë dhe shkaktarë për këtë janë vetë, sepse edhe herë të tjera kanë shkaktuar grindje. Ndërkaq ata përpiken që Korenë dhe Kim Ir Senin, t'i kenë në anën e tyre, natyrisht derisa ky të mos luajë përsëri kartën e sovjetikëve. Është e qartë se kur Kim Ir Seni të shikojë se i ka ardhur fundi dhe kinezët nuk janë më në gjendje ta financojnë, me siguri do të luajë kartën tjetër. Por revizionistët kine-

zë, duke u afruar me Korenë e Veriut, duke u përpjekur që ta kenë atë nën influencën e tyre, janë të kënaqur njëkohësisht që Koreja e Jugut të qëndrojë nën influencën amerikane. Ata veprojnë ashtu siç kanë vepruar deri tash edhe për Tajvanin, problemi i të cilit nuk hidhet më në tryezë si më parë. Përkundrazi, udhëheqësit kinezë dalin kundër bashkimit të Tajvanit me Kinën. Dhe, pas ca kohësh, kur Kina të zërë pak a shumë ato pozita që synon, ajo do ta konsiderojë Tajvanin si një provincë autonome të saj. Me fjalë të tjera, me këtë Kina do t'i tregojë botës se çështja e Tajvanit u zgjidh me sukses të madh në mënyrë pa-qësore!

Kina, siç thashë më lart, ka synime edhe në Gjirin Persik. Për këtë flet fakti që sot, më 29 gusht, Hua Kuo Feni vete t'i bëjë vizitë shahut të Iranit, këtij monarku barbar mesjetar. Ai ia bën këtë vizitë shahut në një kohë kur në të gjitha qytetet e Iranit po zhvillohen demonstrata e po vriten me qindra njerëz të popullit, në një kohë kur fshatarësia iraniiane vuani në tmerrin e urisë dhe të sëmundjeve të panumërtë, kurse reaksionarët majmen me fitimet e mëdha që u vijnë nga nafta. Pra, kreu i udhëheqjes kineze vete në Iran pikërisht në këto kohë dhe kur qeveria e shahut, për arsyet e revoltave popullore ra dhe u krijua një qeveri e re, e cila pardje bëri betimin. Unë pashë në televizor ceremoninë e betimit të qeverisë së Iranit. Gjithçka bëhej tamam si në mesjetë. Kryeministri dhe të gjithë ministrat me radhë bënë betimin përpëra shahut të Iranit dhe i puthën dorën. Në këto momente, në këto situata, Hua Kuo Feni shkon në Iran të pu-

thet, të bisedojë miqësish me shahun dhe ta ndihmojë atë në luftën kundër lëvizjes kryengritëse të popullit iranian. Kjo është e qartë. Politika kineze është një politikë kundërrevolucionare, e ujdisur me imperializmin amerikan kundër çdo lufte nacionalçirimitare të popujve.

Natyrisht, vajtja e Hua Kuo Fenit në Iran do ta diskreditojë akoma më shumë Kinën. Ne ia çorëm maskën këtij regjimi antimarksist, kapitalist dhe socialimperialist. Por udhëheqja kineze ka arritur në atë shkallë saqë nuk i bëhet vonë në quhet apo nuk quhet më socialiste Kina. Ajo nuk e peshon fare opinionin e popujve, për arsy se qëllimet e saj janë antipopullore. Kina synon të dominojë mbi ta. Këtë dominim ajo përpinqet ta arrijë sidomos në vendet afrikane, që janë, si të thuash, akoma të prapambetura ekonomikisht, të shfrytëzuara e të shtypura në kulm nga kapitalizmi amerikan dhe nga perandoritë e vjetra, të cilat kanë ruajtur në këto vende privilegjet, bankat, komptuaret, trustet, koncernet e tyre dhe shfrytëzimin. Pikërisht në kontinentin afrikan Kina shpreson të infiltrohet si gjarpri, për t'i bindur njerëzit me ngjyrë të zezë në drejtësinë e vijës së saj pseudosocialiste, duke pretenduar se tok me ta bëhet një barazh i fortë kundër socialimperializmit sovjetik dhe njëkohësisht edhe fuqive të tjera imperialiste. Ajo përpinqet t'u lërë të kuptojnë atyre se ndihma e saj është një ndihmë çlirimtare për ta.

Në përgjithësi kjo është strategja e Kinës dhe e Hua Kuo Fenit, që po bredh e do të bredhë në të ardhmen në shumë vende të tjera të botës. Një gjë do të

fitojë Hua Kuo Feni me këto vizita jashtë Kinës: reklamën që do t'i bëjë vetes brenda në vend, nëpërmjet dokumentarëve e telekronikave që do të shfaqen, për t'u treguar masave të gjera të popullit kinez se te ky ato kanë një «president të madh», që e zëvendësoi aq mirë Mao Ce Dunin, bile po e errëson pothuajse krejt figurën e Maos. Këtë gjë, do t'i thotë popullit Hua Kuo Feni, shiheni me sytë tuaj; këtë e vërtetojnë udhëtimet e mia «triumfale» në Bukuresht, në Beograd, në Teheran, e më vonë në Bon, në Londër e në vende të tjera.

Kjo, natyrisht, i shërben politikës së gjenjeshtërt të udhëheqjes kinez, por jo për shumë kohë, se fraksioni i Ten Hsiao Pinit, i cili rri në rojë dhe me siguri ka kontradikta me grupin e Hua Kuo Fenit, nuk do ta pëlqejë këtë tamtam e reklamë që po i bëhet kryetarit të padëshiruar. Prandaj vizitat pompoze, por pa rezultate, pra, jo siç i do udhëheqja kinez, do të kenë edhe pluset, edhe minuset e tyre brenda në Kinë. Këto do të bëjnë që kontradiktat të thellohen dhe qëllimet e ndërtimit me aq shpejtësi e me aq siguri të kapitalizmit atje të hasin në vështirësi të panumërtë. Megjithatë koha do t'i vërtetojë pikëpamjet tona.

Për sa i përket vizitës së tij në Jugosllavi e në Rumani, ne do të jemi vigjilentë, sepse Huaja, Titoja dhe Çaushesku kanë biseduar hollësish kundër vendit tonë, kanë biseduar se si t'i dëmtojnë, t'i dobësojnë dhe t'i likuidojnë pushtetin e demokracisë së vërtetë proletare, Partinë marksiste-leniniste të Punës dhe socializmin në Shqipëri. Por ata do të na marrin të keqen, sepse ne do ta forcojmë situatën, brenda dhe ja-

shtë, do ta ndërtojmë socializmin me forcat tona dhe do t'u tregojmë miqve dhe gjithë botës se socializmi është i pavdekshëm, se një popull i vogël, që u qëndron besnik parimeve themelore të doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninit, dhe Stalinit, bëhet shembull i një forcë të madhe.

Sot, kur avioni po transportonte Hua Kuo Fenin për në Teheran te shahinshahu i Iranit, nga Teherani nisej për në Moskë një avion tjetër, që transportonte princeshën Ashraf, motrën dhe këshilltaren e shahut, mikeshën e Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të Tem Hsiao Pinit, mikeshën e ish-ambasadorit amerikan Henderson. Kështu që shahu i Iranit po merr masa që të mos zemërojë sovjetikët, që edhe me ta punët t'i shkojnë mirë.

Shahu është një personalitet që rron në sajë të fuqive të mëdha. Njihen historia e ndyrë e jetës së tij, shtypja dhe barbarizmat ndaj popullit në kohën e bor-gjezit demokrat Musadek, që përkrahej nga partia «Tudch», kur shahu u detyrua të lërë fronin dhe të nisej me avion për në Romë. Por gjatë kësaj kohe CIA, sipas atyre që kemi lexuar, pagoi lumpenin e Teheranit me nga një dollar për kokë, vuri në lëvizje tanket e komanduara nga gjenerali Zahedi, agjent i saj, i cili gjoja për të mposhtur kundërshtarët e Musadekut, sulmoi pallatin «Gjylamen», ku ndodhej qeveria dhe e arrestoi Musadekun. Kështu që ky u fut në burg. Hendersoni u kthye menjëherë në Teheran dhe i bëri telegram shahut që të kthehej nga Roma. Ky erdhi me avion dhe përdori forcën derisa kryengritja e popullit

të Iranit u mbyt. Sigurisht, pas kësaj, pasuritë e naftës u ndanë ose u rindanë më mirë. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në sajë të Hendersonit dhe të ndërhyrjes në favor të shahut, morën pjesën e luanit, anglo-persianët mbajtën pjesën më të vogël, kurse thërrimet i mbetën shahut.

Pra, të tillë lojë luajnë në kurriz të popujve shahu dhe miqtë e tij, qofshin këta amerikanë, kinezë apo sovjetikë. Irani është bërë një qendër intrigash dhe shahu e ndien të ftohtit e veriut rus, se brenda ziejnë azerbajxhanasit, të cilët u ngritën kundër tij, saqë në një kohë kryeministrat, Xhafar Sharif Emamit, iu desh të merrte masa drakoniane kundër tyre. Ky nuk i shtypi dot azerbajxhanasit e nxitur nga sovjetikët, por këta u tërhoqën. Megjithatë nuk do të na çuditë fakti që Rusia të kthehet përsëri në Iran, nga jashtë ose nga brenda, por më tepër mundësi ka nga brenda.

Këto ditët e fundit, pas formimit të qeverisë së re, kur gjithë anëtarët e kabinetit i puthën dorën me radhë shahut, ky u bë «reformator i madh demokrat» dhe lejoi krijimin e legalizimin e 16 partive. Të gjitha këto parti, me emra të ndryshëm, janë të djathta, besnikë të reaksionit iranian. Mirëpo partinë «Tudeh» shahu nuk e lejoi të dilte nga ilegaliteti. Kjo parti n'bështetet nga sovjetikët dhe këta me siguri do të kenë protestuar për këtë «padrejtësi» të shahinshahut «demokrat». Nuk është çudi që për këtë arsyе vete princesha Ashraf në Kremlin, për t'u shpjeguar sovjetikëve përsë nuk u rehabilitua partia «Tudeh» dhe për t'u thënë se do ta legalizojnë, por me kusht që

të mos ngrihet kundër shahinshahut, pra për të marrë njëfarë sigurie prej tyre.

Natyrisht, Kremlini do të bëjë sikur do ta pranojë një gjest të tillë mënjanimi të shahinshahut por ai nuk heq dorë nga ndërhyrja. Medoemos shahu, që mbështetet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Kina, por edhe nga gjithë imperialistët e tjerë që kanë fitime nga nafta e Iranit, do të qëndrojë vazhdëmisht mbi gjemba dhe mbi zjarr të ndezur kundër tij nga sovjetikët, nga reaksiuni i jashtëm, nga mbreti Saud.

Në këtë situatë marksistë-leninistët duhet të organizohen dhe të propagandojnë me forcë të madhe, në radhë të parë, luftën kundër shahinshahut, kundër borgjezisë anadollake, perandorake, mesjetare të tij, kundër socialimperializmit sovjetik, që kërkon të hedhë kthetrat në këtë vend, kundër imperializmit amerikan, kundër imperializmit anglez e socialimperializmit kinez që kanë filluar të depërtojnë në punët e Lindjes së Mesme në favor të imperializmit amerikan dhe në favorin e vet.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,  
«Ditar për çështje ndërkombëtare (botim i brendishëm),  
nr. 11, f. 230*

# **MAO CE DUNI NUK MUND TË KRAHASOHET ME STALININ**

**Shënimë**

**30 gusht 1978**

Në artikullin e fundit redaksional në gazeten «The Worker» të Partisë Komuniste të Britanisë, mbahen pozita të hapëta antimarksiste kundër Partisë së Punës të Shqipërisë në lidhje me vlerësimin që u bëjmë ne pikëpamjeve të Mao Ce Dunit. Për artikullshkruesin Mao Ce Duni e Çu En Lai janë marksistë-leninistë të mëdhenj, kurse të gjithë ata që i kritikojnë, janë të grupit buharinist dhe të tipit të intelektualëve perëndimorë. Me fjalë të tjera, ai e ndan udhëheqjen aktuale kineze të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit nga udhëheqja e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait. Për të, Kina, sa ishin gjallë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, që një vend socialist dhe Partia Komuniste e Kinës një parti komuniste. Por, sipas tij, pas vdekjes së tyre, udhëheqja e Partisë dhe e shtetit atje u rrëmbye nga revizionistët dhe renegatët Hua Kuo Fen e Ten Hsiao Pin. Kjo është teza e anglezit, i cili bën një paralelizëm midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, pra vë shenjën e barazimit midis ndërtimit të socializmit në Ban-

shkimin Sovjetik, nën drejtimin e Leninit e të Stalinit, dhe tradhtisë së hrushovianëve që e kthyen Bashkimin Sovjetik në një vend revizionist e socialimperialist, me gjendjen e tanishme në Kinë në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait.

Kështu, ai mendon se në të dy vendet situatat janë identike; çdo gjë ka ngjarë njësoj, prandaj njësoj duhen trajtuar. Për autorin e artikullit Lenini dhe Stalini janë marksistë-leninistë, por për të janë po aq marksistë-leninistë edhe Mao Ce Duni e Çu En Lai. Ne që i kritikojmë pikëpamjet antimarksiste të Mao Ce Dunit, sipas tij, jemi buharinistë, me fjalë të tjera, jemi trockistë të rinj. Ai mban qëndrime të hapëta publike kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, udhëheqjes sonë dhe e shpjegon botërisht atë që la më shkrim, kur ishte herën e fundit në Shqipëri. Pasi lexova këtë material, i kritikova pikëpamjet dhe qëndrimet e tij dhe ai doli fishek, tregoi ftyrën e tij të vërtetë, si një renegat.

Ky problem nuk shtrohet vetëm për këtë renegat, por do të bëhet objekt i një lufte të ashpër ideologjike në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Si e kuptoj unë këtë luftë? Pikërisht në qëndrimin që do të mbahet ndaj pikëpamjeve të Mao Ce Dunit. Pozicioni që ka marrë Partia jonë në këtë çështje, tashmë është i njojur. Aktualisht po mbahen edhe disa pozicione të tjera. Një nga këto është pozicioni i anglezit, të cilin e thekssova më lart, pra, që ndan Mao Ce Dunin e Çu En Lain nga klika Hua Kuo Fen — Ten Hsiao Pin.

Një pozicion tjetër, më parë se ai i renegatit anglez, është pozicioni i Hillit të Australisë, i cili mbron

**en bloc** udhëheqjen kineze. Domethënë, sipas Hillit, Kina kurdoherë ka ndërtuar socializmin, pra është një vend socialist, Mao Ce Duni është një marksist-leninist i madh, Çu En Lai është një marksist-leninist i dashur, Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini janë shpëtimtarët e socializmit e të revolucionit në Kinë dhe është «katërshja» ajo që i ka bërë tërë të këqijat, prandaj të gjithë ata që janë kundër pikëpamjeve të tilla, janë antimarksistë. Në aparençë duket sikur pozita e Hillit ndryshon nga pozita e anglezit, por që të dy aty-aty janë, përkrah njëri-tjetrit. Anglezi, duke mbrojtur Mao Ce Dunin dhe Çu En Lain, pavarësisht se i lufton Hua Kuo Fenin e Ten Hsiao Pinin, përsëri është me këta të dy, sepse, ashtu si Hilli, nuk e ka dënuar Mao Ce Dunin, por vazhdon ta mbrojë. Pra, ai përdor një variant pak më të theksuar, me një nuancë më të ndryshme nga Hilli, por atje qëndron edhe ky.

Ka edhe të tjerë që e heqin veten marksistë-lenisë, por që nuk janë dakord me tezën, sipas së cilës Mao Ce Duni nuk është marksist-leninist i madh. Përkundrazi, thonë ata, Mao Ce Duni nuk duhet atakuar, por nuk kanë si t'i shpjegojnë dhe t'i kundërshtojnë faktet që vërtetojnë se vija e Mao Ce Dunit është një vijë antimarksiste. Ata mbrohen me prova gjenerike, e barazojnë Maon me Stalinin dhe, kur u thuhct se Mao Ce Duni ka bërë gabime, përgjigjen se edhe Stalini ka bërë gabime. Po t'u thuash se Stalini s'ka bërë gabime, atëherë shprehen se as Mao Ce Duni nuk ka bërë gabime. Kur u thua se ka një ndryshim të madh midis tyre, mbasi Stalini ishte një marksist, nxënës i Leninit, që mbronte normat marksiste-lenin-

niste të partisë së tij, ata ngulin këmbë se edhe Maoja i mbronte këto, por e gënjen, e izoluan dhe, ashtu sikur se Stalini nuk i pa revizionistët, edhe Maoja nuk i pal

Të gjitha këto «fakte» të këtyre pseudomarksistëve, që dalin në mbrojtje të Maos, nuk kanë asnjë bazë reale, as teorike, pale praktike, se në praktikë e shohim qartë gjithë vijën që ka ndjekur Mao Ce Duni, e cila është një vijë antimarksiste dhe që në situatat aktuale rezulton se ishte ndjekur me plot ndërgjegje.

Në luftën e saj për të nxjerrë në shesh të vërtetë në lidhje me pikëpamjet e Mao Ce Dunit, në ishin këto marksiste apo jomarksiste, Partia jonë do të ndeshet me mendime udhëheqësish të partive e njerëzish të ndryshëm, që me ndërgjegje ose pa ndërgjegje e mbrojnë Mao Ce Dunin si marksist-leninist. Por çështjen unë e shtroj kështu: ata që e mbrojnë me ndërgjegje, janë revizionistë modernë, të cilët, duke qenë në shërbim të kapitalizmit, i gënjejnë proletariatin dhe masat e gjera të popujve, me qëllim që këta të mos njojin se cilët janë armiqtë e rinj të tyre dhe, duke pasur besim në marksizëm-leninizmin, mendojnë se mund t'i mbështetin tek ata shpresat e tyre për çlirim.

Mirëpo revizionizmi jugosllav, revizionizmi sovjetik, revizionizmi i vendeve të Lindjes, eurokomunizmi e aktualisht edhe revizionizmi kinez janë demaskuar e po demaskohen çdo ditë e më shumë si rryma kundërrevolucionare, antimarksiste, që u shërbijnë statukosë së kapitalizmit e forcimit të tij nëpërmjet ndihmës që i jepin për të mos u shkatërruar, për të mbajtur në këmbë e për të fuqizuar akoma më shumë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik,

socialimperializmin e ri kinez dhe vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara që të mos kalbëzohen dhe të mos shkatërrohen.

Qysh kur lindi teoria shkencore e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, borgjezia kapitaliste dhe të gjitha partitë e kapitalit, ku bëjnë pjesë edhe partitë revolucioniste, u futën në luftë kundër saj që ta diskreditojnë e ta shtrembojnë, ta errësojnë atë si teori e revolucionit dhe e proletariatit, si teorinë që është në thçmel të shembjes së rendit kapitalist dhe të ndërtimit të shoqërisë së re socialiste e komuniste. Praktikisht në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste lufta kundër marksizëm-leninizmit gjeti aplikimin e saj me anën e revolucionizmit. Ne shohim se në të gjitha këto vende, me përjashtim të Shqipërisë, u vendos kapitalizmi.

Në të gjithë botën ka mbetur një kështjellë e socializmit, e cila quhet «anakronike» nga i gjithë kapitalizmi botëror, sepse u qëndron ballë për ballë dallgëve të tërbuara të kapitalizmit botëror, të imperializmit e të revolucionizmit, potencialit ekonomiko-ushtarak, intrigave, diversionit dhe mashtrimeve të tyre.

Pra, po i bëhet një luftë kësaj kështjelle të pamposhtur, të vogël, por që rrezzaton atë shkencë të pavdekshme, që është marksizëm-leninizmi, dhe ngjall e fuqizon shpresat dhe luftën e proletariatit botëror. Natyrisht, të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit do të bashkohen në këtë luftë kundër nesh, por ne do t'u qëndrojmë, sepse s'jemi vetëm. Në pushtet nuk ekziston më asnjë parti komuniste, përvçëse në Shqipëri. Por edhe më 1917-ën nuk ekzistonte ndonjë parti ko-

muniste në pushtet, megjithatë vetëm në Bashkimin Sovjetik u vendos pushteti i proletarëve. Por ky pushtet i proletarëve u vendos në Bashkimin Sovjetik që ishte një vend i madh, mund të thonë, që kishte një popullsi të madhe në numër, kishte Partinë e bolshevikëve me Leninin në krye. Kjo është e vërtetë, por Partia e Leninit dhe e Stalinit, Partia e bolshevikëve dhe shteti i madh i proletarëve e rrezatuan kudo në botë ideologjinë marksiste-leniniste, të cilën sot e zbaton me besnikëri, në teori e në praktikë, në kushtet konkrete, Partia e Punës e Shqipërisë. Proletariati botëror aspiron që të shembë pushtetin kapitalist dhe ta marrë vetë në dorë pushtetin. Ai e shikon Shqipërinë si një atdhe të tij, prandaj them se ne nuk jemi vetëm. Ne jemi një shtet ku janë në fuqi proletariati dhe pararoja e tij, Partia marksiste-leniniste, jemi një shtet drejt të cilit i ka kthyer sytë proletariati i të gjitha vendeve të botës.

Kapitalizmi botëror e sheh se revizionistët modernë në të gjitha vendet janë thikë me dy presa: nga njëra anë luftojnë revolucionin, dhe këtë ai e gjen të drejtë, por nga ana tjetër përpinqen edhe të dominojnë në botë, domethënë kërkojnë të rindajnë tregjet bolçore në mes vendeve kapitaliste dhe vendeve revizioniste. Pra, ky transformim strukturor, reformist, i shkaktuar nga revizionizmi, nuk i pëlqen kapitalizmit botëror. Por ky nuk është aq i fuqishëm sa ta gënjejë proletariatin e botës dhe popujt që vuajnë nën thundrën e kapitalit, që të mos luftojnë për liri, demokraci dhe përparim. Prandaj atij i duhet maocedunideja, e cila nuk është demaskuar akoma plotësisht si një teori

revisioniste. Borgjezisë dhe kapitalizmit u intereson shumë që ta ruajnë këtë si një atû të veçantë për të shtypur revolucionin, gjë që nuk mund ta bëjnë në afë shkallë revisionistët sovjetikë ose eurokomunistët, të cilët, si të tillë, pra, si revisionistë, tash janë bërë bariatë. Prandaj borgjezia nxit revisionistët, nxit agjenturat e saj që ta ruajnë me çdo mënyrë Mao Ce Dunin prej sulmeve që nund t'i vijnë nga marksistë-leninistët dhe veçanërisht nga Partia e Punës e Shqipërisë, me qëllim që ta përdorë atë si një element ideologjik korrdures, gërryes, shkatërrues kundër ideologjisë marksiste-leniniste, të ruajë nën «filozofinë marksiste-leniniste» të Maos gjoja thelbin e vërtetë, «marksizëm-leninizmin» e kohëve aktuale, të kohëve moderne, të shoqërisë së konsumit, të industrializimit të madh etj., etj.

Pra, në këtë drejtim punon dhe do të punojë agjentura e imperializmit dhe e kapitalizmit, si renegati anglez që, besoj unë, aktivizohet me ndërgjegjje. Por do të jenë edhe të tjerë që do ta mbrojnë Mao Ce Dunin për sentimentalizëm ose pse udhëheqja e ndonjë partie apo disa udhëheqës janë lidhur e komprometuar në këtë linjë, dhe, sa kohë kalon, ata komprometohen më tepër dhe bëhen të zellshëm në këtë drejtim. Këta do ta mbrojnë Mao Ce Dunin, Kina do t'i subvencionojë. Kështu, ne do të gjendemi përpara një fakti të ri, që ekziston edhe aktualisht: përqarjes në mes marksistë-leninistëve dhe Partisë Komuniste të Kinës. Por do të asistojmë edhe në një përqarje tjeter, domethënë në mes marksistë-leninistëve të vërtetë dhe njerëzve ose partive që gjoja luftojnë kundër gru-

pit të ri që erdhi pas Maos, por që e mbrojnë këtë, Çu En Lain dhe të tjerët që kanë vdekur.

Udhëheqja revizioniste kineze nuk e do Mao Ce Dunin, por për arsyet taktike dhe strategjike nuk e hedh poshtë figurën e tij, pra nuk vepron si Hrushovi, sepse krahasime në mes hrušovianëve dhe revizionistëve aktualë kinezë mund të bëhen fare kollaj. Por duhet pasur parasysh se në Kinë ekzistojnë rryma dhe grupe të ndryshme të fuqishme, kështu që disa do të mbështeten më shumë në figurën e Mao Ce Dunit, disa më pak, disa nuk do ta zënë në gojë fare.

Aktualisht të gjithë e përmendin Mao Ce Dunin, por jo shumë. Unë mendoj se Hua Kuo Feni do ta ruajë më tepër nga të tjerët emrin e Mao Ce Dunit, me shpresë e synim që të eliminojë grupin e Ten Hsiao Pinit, duke shfrytëzuar faktin se populli kinez, një popull me tradita mistike, i ekzaltuar dhe jo i ngritur si duhet politikisht, e konsideron Mao Ce Dunin si njeri të pagabueshëm, si një perëndi, një Budë të kohëve moderne. Ten Hsiao Pini, po dihet, nuk e do Mao Ce Dunin, për arsyet se ky i luftoi si atë edhe Liu Shao Çinë. Në goditjen që u bëri këtyre, Maoja nuk u nis nga pozitat marksiste-leniniste, por nga pozitat për pushtet personal. Edhe Teni lufton me këmbëngulje për pushtet personal, për vete dhe për shtresën e re kapitaliste, në lidhje të ngushtë me kapitalizmin botëror. Në këtë çështje, këto rryma e grupe me nuanca që anojnë më tepër nga lënia e figurës së Maos në mauzole, do t'u japid dorë të gjithë fraksionistëve të rinj, agjentë të imperializmit, ose elementë të paqartë, që ta mbrojnë Mao Ce Dunin për të vetmen arsyet,

se gjoja ai po luftohet ose nuk zihet fare në gojë nga udhëheqja aktuale. Kështu që këta njerëz bëjnë arsyetimin: meqë kjo udhëheqje e sotme është revisioniste, kapitaliste, fashiste, e çfarë të duash, e lufton Mao Ce Dunin, për arsyen të ideve të tij marksiste-leniniste. Pra, Mao Ce Duni, thonë ata, është një marksist-leninist dhe jo si thonë shqiptarët.

Sqarimit të këtyre situatave ne duhet t'i shkojmë deri në fund. Taktika jonë duhet të mendohet e të përpunohet mirë. Për vënien në dukje me fakte, me dokumente, se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, nuk duhet as të vonohemi, por as edhe të shpejtohemi. Të vonohesh do të thotë t'u lësh kohë të gjithë këtyre elementeve fraksionistë të rïnj, përqarës të partive komuniste e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që të veprojnë për të krijuar e për të përhapur tezën që e theksova më lart, domethënë që udhëheqësit aktualë kinezë janë antimarksistë, kurse Maoja ishte marksist dhe, pra, pikëpamjet e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk janë të drejta.

Por ne nuk duhet as të shpejtohemi, e me këtë unë kuptoq që duhet të argumentojmë fort, saktë e plotësisht mendimin tonë. Për këtë ekzistojnë fakte, të cilat duhet t'i kërkojmë e t'i gjejmë. Ato janë edhe në veprat e Mao Ce Dunit, që kanë namin se janë të gjitha të drejta. Veprimet e Mao Ce Dunit kanë qenë në rrugën antimarksiste dhe ka dokumente të shkruara që i kanë botuar tash së fundi, të cilat vërtetojnë se ai nuk ecte në rrugën e shkencës marksiste-leniniste, përkundrazi, ishte një idealist, pragmatist, një eklektik, borgjec demokrat-revolucionar. Në veprat e tij ne du-

het të thelohem, pse do të gjejni «xhevahire» që vërtetojnë se edhe në to, megjithëse janë të rregulluar, ka pikëpamje antimarksiste.

Ne nuk duhet të lejojmë që fraksionistët e rinj ta krahasonjnë çështjen e Mao Ce Dunit në mënyrë banale me luftën dhe me situatën në Bashkimin Sovjetik, kur udhëhoqi Stalini. Në asnjë mënyrë nuk duhet bërë një krahasi i tillë, sepse kjo është e padrejtë dhe nuk duhet të biem në banalitetet e këtyre mbrojtësve të rrëmë të marksizëm-leninizmit.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,  
«Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm),  
nr. 11, f. 243*

# VENDIMI NË ORGANIZATË MERRET PASI TË JETË DISKUTUAR PËR TË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

31 gusht 1978

«Në organizatën-bazë, të tërë ne komunistët jemi të barabartë» shkruhet sot në një artikull të «Zërit të popullit», në rubrikën «Jeta e Partisë»; «atje nuk ka kuadër e punëtor, nuk ka ministër dhe shef, nuk ka drejtor e shofer; të gjithë komunistët kanë njëlloj detyra dhe të drejta». (Dhe autor i artikullit e trajton mirë këtë çështje.) Pra, në organizatën-bazë nuk ka hierarki, sekretar, ministër, drejtor, punëtor apo kooperativist. Mirëpo, ministri, drejtori ose kryetari i kooperativës, vërtet janë anëtarë partie në organizatën-bazë, por njëkohësisht janë edhe specialistë, pra njerëz kompetentë për punën që u është ngarkuar. Prandaj, kur këta vijnë të raportojnë në organizatën-bazë për një problem, duhet ta kcnë të qartë që këtë të mos e marrin sa për jallanshahit.

Në organizatë ata duhet ta shtrojnë problemin mirë, me të gjitha të dhënat, me pluset dhe me minuset.

Pastaj, para marrjes së vendimit përkatës, të ngrihen e të flasin edhe komunistët e tjerë e të bëhen debate, duke vënë në dukje të mirat e të metat e çdo propozimi. Në fund do të vendoset për atë propozim që është më i pranueshëm për organizatën dhe që i shërben interesit të përgjithshëm. Nëse arrihet në pikëpamjen, ta zëmë, që duhen pranuar minuse në plan, t'i pranojmë. Kështu do të veprohet vetëm mba-si të jetë diskutuar mbi to dhe organizata të ketë krijuar bindje se s'ka si bëhet ndryshe dhe jo pse tha shefi, kryetari apo ministri. Në qoftë se veprohet kështu, atëherë themi me ndërgjegje se me të vërltetë merr përgjegjësi organizata-bazë, e cila e di gjithash tu se për realizimin e planit do të dalin edhe penge-sa, të cilat mund të kapërcehen vetëm me një mobili-zim të gjithanshëm të të gjithëve, e në radhë të parë, të komunistëve.

Pas kësaj pune në organizatë, merret vendimi tjetër për masat ideopolitike, tekniko-organizative që do të merren që plani i aprovuar të realizohet. Është e domosdoshme të gjenden se cilat janë masat më të përshtatshme që duhen marrë për të kapërcyer vështi-rësitë që mund të dalin e mund të pengojnë arritjen e kësaj apo të asaj kuote të planit. Për këtë qëllim duhet rrahur mendimi në organizatë, të diskutohet e të ven-doset.

Po si do të vihen në jetë këto masa? Mos vallë vetëm me fjalë, që pas mbledhjes së organizatës të vazhdojmë të ecim në rutinën e zakonshme? Jo, kjo çështje duhet thelluar. Zbatimi me sukses i tyre nuk bëhet duke ndenjur në zyrë, në drejtori. Drejtori, për-

gjegjësi etj. e kanë për detyrë të venë edhe në bazë, pranë njerëzve, me të cilët do të vihen në jetë këto masa, ky vendim, dhe për këtë t'i bëjnë ata të ndërgjegjshëm. Por, në radhë të parë duhet të punohet që të bëhen të ndërgjegjshëm komunistët e sektorit që mbulon organizata-bazë. Për t'ia arritur kësaj, byroja dhe sekretari duhet të bëjnë një punë të dendur politike. Ata, së bashku me të gjithë komunistët, të udhëheqin e të ndihmojnë njerëzit në punë e, njëkohësisht, t'i kontrollojnë ata se si po e kryejnë këtë apo atë detyrë, ndryshe vendimi i marrë në organizatën-bazë është formal. Ne, cilindo qoftë, sekretarin e organizatës-bazë, ministrin, zëvendësministrin e kuadrot e tjerë drejtues, siç e theksova edhe më parë, nuk duhet t'i lejojmë ta shifrytëzojnë dhe ta përdorin organizatën-bazë si të duan ata, për të marrë vendime jo të drejta ose jo të peshuara mirë, dhe nesër, kur të pytet ky apo ai drejtues përsë u aprovua një shifër aq e ulët, për këtë ose atë zë, ai të përgjigjet: «E ka parë organizata-bazë e Partisë dhe e ka aprovuar ajo njëzëri».

Pra, e kam fjalën të mos lejojmë që çështjet në organizatën-bazë të shirohen ashtu siç mendojnë dhe dëshirojnë disa drejtues. Problemi që diskutohet në organizatën-bazë të konsiderohet si objekt i një studimi që duhet plotësuar, pra, të shtrohet në mënyrë të tillë që të lihet të kuptohet se mendimeve apo propozimeve që ka bërë drejtuesi i pushtetit, i ndërmarrjes apo i institucionit mund t'i bëhen korrigjime e ndryshime kur kjo çshë e nevojshme. Po nuk u bënnë këto korrigjime në organizatën-bazë, kur kjo i gjykon këto të domosdoshme, atëherë nuk është bërë

gjë tjetër veçse organizata është nënvlefësuar. Me këtë drejtuesi do të thotë se në atë qendër pune apo institucion bëhet ashtu siç mendon ai, sepse ai është specialist, ministër, zëvendësministër, kryetar kooperative ose drejtor, dhe këto që u thanë atje, në organizatën-bazë, sipas tij, i mori era, asgjë nuk merret parasysh dhe atë nuk e kontrollon asnjeri.

E them këtë se në shumë raste kur vjen puna për të kontrolluar zbatimin e vendimeve, flitet në mënyrë të përgjithshme e nuk i vihet gishti plagës. Ata drejtues që kanë thënë se duhen marrë këto apo ato vendime, kur vjen puna për të dhënë llogari për mosrealizimet, nuk ngrihen të svarojnë se, po të ishin marrë e zbatuar këto apo ato masa, atëherë nuk do të ngjisnin këto fenomene negative. Pra, ndodh që komunistët disa herë për shumë arsy, kryesisht subjektive, nuk ngrihen të diskutojnë e të thonë hapur mendimin e tyre. Ata duhet ta bëjnë këtë medoemos, se në radhë të parë, janë pikërisht ata që do të punojnë për zbatimin e detyrave dhe për vënien në jetë të vendimeve të marra. Po përse nuk e bëjnë? Sepse mendojnë se drejtori apo kryetari që e propozoi, për shembull, atë kuotë të pesëvjeçarit, i di punët më mirë se të tjerët. Prandaj ata, pa u thelluar e pa diskutuar ngrenë dorën dhe aprovojnë shifrën e propozuar nga drejtuesi. Por ka edhe komunistë që veprojnë kështu për të mos prishur qejfin e drejtuesit ose për të mos prekur rehatin personal, duke menduar se mos drejtuesi, pas kësaj, e merr me sy të keq, e transferon etj., etj. Të gjitha këto mbeturina ne i njohim por, po të lihen të vegjetojnë, e kalbin Partinë.

Ka raste që nga përgjegjësit jepen një mijë e një arsyе përse nuk u realizua kjo ose ajo detyrë, apo përse nuk u vu në jetë ky ose ai vendim. Arsyet mund të jenë me të vërtetë të pranueshme, veçse del që për t'i mënjanuar ato, nuk është marrë asnje masë e shëndoshë organizative. Një gjë e tillë tregon që organizata-bazë e Partisë s'ka bërë punë të mirë për të kaptëcyer vështirësitë që dalin, pra, me fjalë të tjera, nuk është bërë si duhet frymëzuesja dhe motori drejtues i kolektivit. Kjo tregon, gjithashtu, se edhe nga ana e aparatit shtetëror përkatës nuk janë bërë të gjitha përpjekjet në këtë drejtim. Prandaj, drejtuesi shtetëror, në këto raste, kur raporton për zbatimin e detyrave në organizatën-bazë, për t'u justifikuar, sjell një mijë e një arsyë që të bindë shokët e komunistët se s'kishte ç'të bënte, qoftë ai, qoftë dhe të gjithë ata për realizimin e tyre. Pra, pa u thelluar në dëmin e madh që i shkaktohet çështjes së Partisë nga një qëndriim i tillë, ndodh që ndonjë komunist të ngrihet me mendjelehtësi dhe thotë: «Nuk kishim se ç'të bënim. Tani mori fund kjo gjë», ose «nuk u realizua kjo detyrë se ra shi i madh, ra breshër, bëri thatësirë» e të tjera e të tjera «argumentime». Këto kushte mund të kenë ndikuar vërtet deri në njëfarë mase në mosrealizimet, por e keqja është se shpesh ato paraqiten në mënyrë të zmadhuar, njëja bëhet njëqind, kurse mundësitë, që kanë ekzistuar e që mund të shfrytëzoheshin për t'ia arritur realizimit të detyrës, as që zihen në gojë fare, nuk thuhet gjë as për shkaket përse janë neglizhuar e nuk janë shfrytëzuar ato mundësi. Prandaj, ne, në Parti, duhet të bëjmë

një luftë të madhe kundër këtyre shfaqjeve regresive.

Ne kemi thënë shumë gjëra për punën e organizatave të Partisë, për aparatet, për rrezikun e burokratizimit të tyre etj; shumë gjëra kemi thënë e përsëritur gjithashtu edhe për forumet, komitetet e Partisë e instancat e ndryshme, për detyrat që kanë e për aktivizimin e tyre etj. Por, disa herë ndodh që ato pavarësisht se janë thënë kanë mbetur diku dhe nuk mbahen parasysh gjatë punës së përditshme. Prandaj dhe shumë detyra e porosi për forcimin e punës së Partisë nuk realizohen e nuk vihen në jetë.

Nuk kam dëgjuar të flitet për shokët pensionistë, si dhe sa ndihmojnë ata në punët e komiteteve të Partisë. Ata nuk duhet të aktivizohen vetëm për të ndihmuar në shqyrtimin e letrave apo në verifikimin e drejtësisë së problemeve që ngrihen në to se kjo do të qe një humbje e madhe për Partinë. Këta (natyrisht, flas për ata që kanë qenë të zotë), janë njerëz me kapacitet, por që tash kanë mbushur moshën e shërbimit aktiv. A nuk mund të kontribuojnë edhe këta në punët e komiteteve të Partisë edhe pasi dalin në pension? Pse, një 60 e ca vjeçar, që deri tash ka qenë drejtor në këtë ose atë ndërmarrje, kooperativë apo institucion, nuk është në gjendje të ndihmojë në punët e Partisë në profilin që ka punuar, kur ia di të gjitha vidhat kësaj pune, me të mirat dhe me të këqijat e saj? Për këtë s'ka asnje dyshim, pavarësisht se gjatë kohës që ka punuar, ai mund të ketë bërë edhe gabime, ashiu sikundër ka bërë edhe punë të mira. Pra, ai kuadër pensionist ka një eksperiencë të madhe në jetë, prandaj, po të jetë zgjedhur aktualisht në plenumin e ko-

mititetit të Partisë, ai, me përvojën e tij, të cilën e ka për detyrë t'ia lërë Partisë, e ndihmon mjaft atë. Ne tash kemi shumë pensionistë të tillë të zotë, por, në fakt këta nuk po aktivizohen sa duhet dhe për këtë nxirren plot arsy. Ne nuk themi që të tërë pensionistët vë jenë anëtarë të plenumeve të komiteteve të Partisë, por, në një forum ku janë dhjetëra veta, pse të mos janë edhe nja tre, katër, pesë apo gjashtë nga këta, që të thonë edhe ata fjalën e tyre në mbledhje e të jatin mendime me kompetencë, se kanë mbi kurri gjithë atë përvojë të gjatë e të pasur?! Një gjë e tillë Partisë i intereson shumë.

Pensionistët përbëjnë një forcë të madhe, se janë njerëz me eksperiencë të pasur. Natyrisht, edhe për shqyrtimin e verifikimin e letrave mund t'i aktivizojmë ata, se janë shumë e në të ardhmen do të bëhen edhe më shumë. Por në komitetet e Partisë këta duhet të kenë vende edhe më me rëndësi. Ndërsa në komitetet ekzekutive mendoj se pensionistët nuk do të janë në gjendje të kontribuojnë, për arsy se njerëzit atje duhet të janë më të rinj nga mosha, se puna është më operative. Kurse në këshillat popullore është më ndryshe, prandaj edhe aty mund të ketë të tillë. Po të kesh, për shembull, pesë apo gjashtë pensionistë në një këshill populor, ku janë edhe 60 anëtarë të rinj, bëhet një kombinim shumë i mirë dhe problemet do të zgjidhen edhe këtu më me kompetencë. Pensionisti që e njeh shumë mirë problemin e që është edhe anëtar i forumit, bëhet pengesë për atë që flet në hava, ose që kërkon të imponohet mbi të tjërët.

Prandaj, ky problem duhet shikuar mirë. Por, si

ky problem ka dhe shumë të tjerë që duhen parë, siç është edhe puna me letrat e popullit. Njerëzit për çështjet që ngrenë të marrin kurdoherë e në kohë përgjigjen e merituar dhe të sqarohen e të binden për to. Askush të mos humbasë shpresën për kërkesën që bën. Ta zëmë se dikush kërkon të marrë një apartament për banim. Partia të punojë me personin që ka nevojë për shtëpi, që ai të kuptojë e të bindet se nuk mund t'u jepet shtëpi të tërëve në një ditë. Në këtë drejtim çdo gjë duhet bërë me mend me qëllim që Partia kurdoherë të jetë e gjallë e revolucionare dhe t'i zgjidhë problemet shpejt e në rrugë të drejtë.

*Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*



**T R E G U E S I T**



## TREGUESI I LËNDES

### A

*Afrika; ndërhyrjet e imperialismit dhe të socialimperializmit në Afrikë dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve të saj — 85, 90, 91, 171-174, 175, 178-179, 409, 429.*

*Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 44-45, 59-65.*

*Arkeologjia, zbulimet arkeologjike — 14.*

*Arkitektura, arkitektët — 14-16, 18.*

*Armatimi, demagogjia imperialisto-revzioniste për armatimin — 74, 97-98, 406, 412.*

*Armiqtë, reprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 149, 208, 221-224, 225-226, 228-229, 233-234, 247-248, 249, 255-256, 324, 416-417, 430-431.*

*Shih edhe: Grupet armiqësore...*

*Arti në vendet borgjeze e revzioniste — 353.*

*Arti Ushtarak i Luftës Popullore — përbajtja, studimi dhe përvetësimi i tij; strategjia dhe taktikat e luftës popullore — 139-142, 143, 146, 150-151, 153-154, 155-156, 212, 218, 219-220, 221, 222, 223, 224-225, 226-229, 232-234, 243, 248-249;*  
— njohja e armikut, e strategjisë, e taktikës dhe e armatimit të tij — 139-141, 143-144, 222-224, 225-226, 228, 232-233;  
— roll i njeriut dhe i armëve në luftë — 222-224, 228-229, 249.

### B

*Bashkimi Sovjetik (1917-1953) — 240, 258-259, 314, 316, 402, 410, 470-471.*

*Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik; strategjia dhe taktikat; politika e fashtme ekspansioniste, luftënxitëse dhe e diktaturit; lidhjet me*

- imperializmin amerikan —* 92, 117, 318, 398, 408-409, 428-429, 464-465; — gjendja e bërendshme, degjenerimi kapitalist, likuidimi i diktaturës së proletariatit. Qëndrimi ndaj Stalinit — 241-242, 328, 410-411, 430; — qëndrimi armiqësor ndaj PPSh dhe RPSSh — 241, 250, 271, 285.

*Blegtoria në RPSSh — politika e Partisë për zhvillimin e saj; rëndësia e blegtorisë —* 48, 393, 394-395, 424; — traditat blegtoreale, bagëtitë e lmita, baza ushqimore, foragjeret — 393-394, 424.

*Borgjezia —* 201, 463, 470, 472. *Bujqësia në RPSSh — politika e Partisë për zhvillimin e saj; rëndësia e bujqësisë —* 45-49, 391-392, 422, 448-449;

- organizimi i punës, mekanizmi i proceseve të punës në bujqësi — 46, 47-48, 423, 448-449;
- studimet shkencore për bujqësinë — 47-49, 446, 449-450;
- toka, sistemimi dhe rritura e pjellorisë së saj; hapaqja e tokave të reja. Ujita — 46, 391-393, 420-

- 421, 422, 423, 437, 447-448; — struktura e degëve të bujqësisë, prodhimet bujqësore dhe rendimentet e tyre; intensifikimi dhe përqendrimi — 47-49, 392-393, 422, 445-446, 447, 450; — drithërat, perimet; pemëtaria — 392, 394-395, 423-425, 437, 444; — bimët industriale — 126, 392-393, 437, 445. *Burokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij —* 39, 53-54, 260.

## C

*Centralizmi demokratik —* 53-54.

## D

*Dëshmorët, heronjtë —* 200-209.

*Disiplina proletare — forcimi i saj; disciplina e planit dhe ajo tekniko-stukencore —* 7-8, 39-41, 43, 63, 148.

*Drejtësia; organet dhe punojësit e drejtësisë në RPSSh: lufta kundër subjektivizmit në dhënien e masës ;ë dënitit —* 24-25, 32.

*Drejtimi dhe organizimi i ekonomisë; lufa për një organizim e drejtim shkencor të saj — 38-40, 51-57.*

*Shih edhe: Ekonomia popullore...*

## E

*Edukimi komunist — edukimi ideopolitik, patriotik dhe ushtarak i masave; rrugët, format dhe mjetet e edukimit; puna bindëse me njerëzit — 26-27, 30-32, 149-150, 153-154, 218, 221, 222, 414.*

*Ekonomia në vendet kapitaliste e revizioniste — 36, 121-123.*

*Ekonomia popullore — politika e Partisë për zhvillimin e saj — 265-270;*

- zhvillimi, forcimi dhe efektiviteti i saj; shfrytëzimi i rezervave të brendshme — 38-38, 41-42, 49-51, 243, 254-255, 266-270;
- masat për shëndoshjen e gjendjes së ekonomisë pas shpartallimit të grupave armiqësore — 256-257.

*Engels, Fridrih — 76, 77, 93,*

241, 317, 315, 340, 357, 385, 463, 470.

*Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 12, 14, 193, 207, 308, 352, 388, 413, 432-435, 438, 439-440.*

*Europa; «sigurimi evropian» — 87-89, 91, 116, 188, 208, 234, 281, 289, 290, 343, 359, 377, 399, 403, 406, 409, 428, 429, 453-454.*

## F

*Filosofia idealiste — 216-217, 332-333, 342-343, 346, 352, 357-360.*

## G

*Greqia; politika e jashtme — 95, 372, 374, 455.*

*Grupet armiqësore është lufat kundër tyre — 255-256, 257;*

- grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes etj. në ushtri — 144, 150, 151, 155, 220, 229, 272, 304-305, 347-348, 349, 350;
- grupi armiqësor sabotues i A. Kellezit, K. Theodhosit etj. në ekonomi — 256, 267, 272, 348, 349;

- lidhjet dhe bashkëveprimi me armiqtë e jashlën — 220, 256, 272.

**II**

*Historia e Shqipërisë; shkrimet, studimet për historinë e Shqipërisë. Dokumentet historike, rëndësia e tyre* — 11, 18.

**I**

*Imperializmi — tipare, pashmangësia e zhdukjes së tij* — 173, 235, 411, 471;

- strategjia globale, politika demagogjike, hegemoniste e ekspansioniste — 123, 128-129, 130, 131, 132, 174-178, 322, 351, 399-410;
- lufta e tij kundër socialistëve për shtypjen e lëvizjeve revolucionare të popujve — 80, 171-178;
- aleancat, bloqet ndërmjet shqiptarëve imperialiste — 176-177;
- lufta e popujve të botës kundër imperializmit — 129, 407, 411-412.

- industria minerale dhe ajo elektrike — 1-8, 44;
- industria mekanike, ngri-tja në vend e fabrikave dhe e linjave të reja — 62, 64-65.

*Interesi i përgjithshëm dhe atjetjak* — 152, 218.

*Internacionalizmi proletar* — 257-258, 260-261, 295.  
*Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni)* — 317, 344, 386, 427.

*Irani; gjendja e brendshme* — 334, 399, 403, 450, 460-461, 463-465.

**J**

*Japonia; politika e jashtme* — 128, 314, 397-398, 400-403, 408, 409, 420, 459.

*Jugosllavia, revisionizmi jugosllav; Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, vija e saj. Kongresi i 11-të i LKJ* — 63-127, 356-357, 360;

- zhvillimi i kapitalizmit dhe veprimi i ligjeve të tij; degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i gjithë jetës së vendit. Vë-administrimi jugosllav — 71-72, 75, 76, 80, 85, 103, 109-125, 356, 357, 365, 377;

*Industria e rëndë në RPSSh*

- gjendja e brendshme, lufita e grupeve për pushtet; çështja nationale në Jugosllavi — 78-81, 112-113, 125-127, 377;
- tradhtia ndaj marksl-zëm-leninizmit; roll sabotues në lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 63, 73, 76-77, 80-82, 83, 99, 101-103, 290, 355, 356-357;
- politika e jashtme; agjenturë e imperializmit; marrëdhëniet dhe kontradiktat me BS. Bashkëpunimi me bloqet ushtarake — 73, 74-75, 83-86, 88-89, 91-92, 94-95, 97-100, 101, 182, 184-186, 305, 370, 375-376, 455, 456;
- qëndrimi ndaj popujve dhe vendeve të ndryshme, përkrahja për borqezinë dhe klikat reaksionare — 82-91, 92-95, 98-102, 103-109;
- marrëdhëniet me revisionistët kinezë — 184-187, 365-366, 367, 375-376, 456;
- qëndrimi armiqësor ndaj Kosovës dhe populisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në

- Jugosllavi — 95-96, 97;
- marrëdhëniet me fqinjët; qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 95, 96-97, 210, 355, 366-370, 462.

## K

- Kapitalizmi* — ligje dhe karakteristika të përgjithshme të tij; *kriza e sistemit kapitalist* dhe *pashmangësia e zhdukjes së tij* — 36, 103-101, 105, 116-118, 121-124, 216-217, 234, 235, 250-259, 322, 411;
- strategjia dhe taktikat; ndërhyrja e kapitaleve në vende të ndryshme të botës — 116-118, 173, 183-189, 471-472.
  - *Shih edhe: Imperializmi*
  - tipare...

*Këshillat popullorë* — komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe seksionet e tyre, detyrat — 52, 53.

*Këshilli i Ministrave (Qereria)* — 33, 38, 50, 51-52, 53, 54, 203, 235, 242, 282, 291-292, 299, 301, 308, 329, 426, 442, 443.

*Kinu, revizionizmi kinez*

- Partia Komuniste e Kinës, vija politike, Ideologjike dhe organizative; pluralizmi politik, fraksionet në parti — 181-184, 302-303, 309-321, 332-335, 342-343, 344-345, 346, 352-353, 357-360;
- strategjia dhe taktikat, synimet dhe përpjekjet për tu bërë superfuq; lidhjet me imperializmin amerikan e shtetet e tjera kapitaliste; marrëdhëni, kontradiktat me revolucionistët sovjetikë — 90, 182-189, 199, 204, 242, 261-262, 275, 285-286, 287-288, 291, 292-293, 305, 313-314, 317-319, 337, 342, 343, 345, 346, 350-351, 369-370, 379, 396, 397-399, 401, 402, 403, 405, 407-408, 427, 428, 451-454, 461-462, 471-472;
- vija oportuniste; politika e jashtme demagogjike, konjunkturale dhe pragmatiste; synimet ekspansioniste, shovlinate dhe luftënxitëse — 187, 197, 199-201, 204, 242, 262, 279-280, 287-288, 289-290, 291-292, 316-319, 332-333, 342, 343, 349, 350-351, 360-364, 367, 371-372, 377, 396-397, 400-403, 404-405, 407-408, 428, 429, 451, 453-454, 459-462, 468-469;
- gjendja e brendshme, lufta e grupeve për push-tet; Revolucioni Kultурor në Kinë — 133, 187-188, 273, 302, 303, 309, 314, 315-316, 317, 318-319, 320-321, 333-337, 339, 352-353, 361-362, 364, 411, 430, 457-459, 462, 473-474;
- tradhtia ndaj marksizmit-léninizmit, demagogjia për ndërtimin e socializmit — 314-315, 316, 317, 330, 354-355, 367, 404-405, 428, 457;
- qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik (1917—1953), ndaj Kominternit dhe ndaj Stalinit e veprës së tij — 204, 344-346, 362, 427;
- zhvillimi i kapitallzmit në Kinë, degjenerimi i bazës dhe i superstrukturës; depërtimi i kapitaleve të huaja — 182-183, 188, 238, 255, 293, 360-361, 364, 453, 457-459;
- qëndrimi ndaj vendeve fqinje; synimet ekspansioniste ndaj Vjetnamit; lidhjet me Japoninë —

- 197, 274, 396, 397-399,  
399-400, 402-403, 408, 423,  
453-460;
- politika ndaj Ballkanit;  
marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë; lidhjet  
me revizionistët rumunë  
— 66, 181-182, 183-184,  
199-200, 279-280, 293, 348-  
349, 350-351, 354, 355,  
356, 360, 362-364, 369-370,  
372, 375, 377-378, 429, 454-  
455, 456-457, 462-463;
- ndërhyrjet në Afrikë; ba-  
shkëpunimi me klikat re-  
aksionare — 293-294, 334,  
403-404, 460-462;
- marrëdhëniet, qëndrimi  
armiqësor ndaj PPSH dhe  
RPSSh — 34, 190-206, 238-  
239, 249-250, 252, 253, 255,  
256, 260-262, 263-265, 267,  
269, 270, 271-276, 285-287,  
288-289, 293-294, 299, 304-  
305, 309, 319, 321, 325,  
327, 329, 337-338, 340, 346-  
350, 354, 355, 366-370,  
372, 454, 462-463.

*Klasa punëtore në RPSSh —*  
62-64, 266-267, 419.

*Klasa punëtore, proletariati në  
rendet borgjezo-revizoniste —*  
*misioni i tij historik —* 98,  
115-116, 235, 412, 471.

*Klasat dhe lufta e klasave*

- lufta e klasave në socia-  
lizëm — 28, 39;  
— klasat dhe lufta e klasa-  
ve në kapitalizëm — 235.

*Kolonializmi, neokolonializmi;*  
*lufta e popujve të botës për*  
*shembjen e sistemit kolonial*  
— 84-85, 90-91, 99, 101, 171-  
180.

*Kompetencat, përgjegjësítë —*  
54, 443.

*Komunisti, cilësítë —* 158-159,  
161, 247.

*Kontradiktat joantagoniste —*  
161, 162.

*Kontradiktat themelore të epo-  
kës sonë — kontradiktat ndër-  
mjet popujve dhe imperializ-  
mit; kontradiktat ndërmjet  
shteteve imperialiste, shfrytë-  
zimi i tyre — 235-236, 352, 363,  
406, 453.*

*Kontrolli punëtor —* 5.

*Kosova dhe popullsia tjetër*  
*shqiptare që jeton në trojet*  
*e veta në Jugosllavi; politi-  
ka shoviniste e revizionisteve*  
*jugosllavë ndaj saj —* 81, 368-  
369.

*Shih edhe: Jugosllavia...*  
— qëndrimi armiqësor ndaj  
Kosovës...

*Kostoja e prodhimit —* 41-42.  
*Kreditë, ndihmat ndërmjet*  
*shteteve, kuptimi marksist-le-*

ninist i tyre — 74, 190-192, 193, 202-203, 239-240, 257-265, 277-288, 293-294, 295, 296-297, 298, 329, 425.

Krimet — njohja dhe zbulimi i tyre; lufta për parandalimin e krimeve — 24-27.

Kuadrot, specialistët — rolli dhe detyrat e tyre në ndërtimin e socializmit — 43, 50, 54-55, 62, 261-265, 266, 296-297, 418-419, 477-478;

— kuadrot e Partisë — 25, 31, 158-170.

Kultura përparimitare botërore — 17, 21.

Kultura në RPSSH — politika dhe kujdest i Partisë për kulturën; qëndrimi ndaj trashëgimisë kulturore — 15, 22-23.

Kultura në vendet borgjezo-revisioniste — 360-361.

Kushtetuta e RPSSH — 25, 269.

## L

Lenin, Vladimir Ilit — 75, 78, 77, 99, 110, 111, 240, 241, 287, 312, 316, 317, 325-326, 340, 345, 351, 357, 358, 385, 402, 410, 457, 463, 467, 468, 470, 471.

Letërsia përparimitare botërore, studimi i saj kritik — 9-10.

Letrat e popullit, kërkesat dhe ankesat — 483.

Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare; qëndrimi ndaj revizionizmit kinez, lindja e elementeve revizioniste — përkrahës të revizionistëve kinezë; diferencimi në lëvizjen komuniste — 263, 321-330, 466-469, 472-473, 474, 475;

— përkrahja, qëndrimi ndaj PPSH — 322, 339-340, 381-390, 466-469.

Liberalizmi dhe indiferentizmi — lufta kundër shqipteve të tyre — 39.

Ligjet ekonomike objektive të socializmit — 57.

Ligjet në RPSSH — politika e Partisë në fushën e legjisacionit. Karakteri popullor, zbatimi dhe përsosja e Ujave — 24, 25-26, 28-29.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar — përvaja, mësimet dhe rëndësia e saj — 137, 203, 226, 239-260, 436.

Luftërat, shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të luftës së rasteve — 171-173, 224, 234-235, 350-351, 406-410, 428-429;

— qëndrimi i popujve dhe i marksistë-leninistëve ndaj luftërave, përpjek-

jet e tyre për mënjanimin e luftës — 406-407, 410-412.

## M

*Marksizëm-leninizmi* — arme dhe busull për udhëheqje & reprim; njohja, përvetësimi, mbrojtja dhe zbatimi krijuar i tij — 57, 215-216, 251, 320-321, 325-326, 340, 374, 404, 410, 453, 471; — përpjekjet e revlzionisteve për të shtrembëruar marksizëm-leninizmin — 470-471.

*Marks, Karl* — 75, 76, 77, 89, 101, 110, 111, 241, 316, 317, 325, 340, 357, 385, 457, 463, 470.

*Materializmi historik* — trajtimi materialist i fenomeneve të shqërisë — 216.

*Mbështetja në forcat e veta* — 192-193, 195, 201, 239, 252, 257, 266-267, 269, 324, 373, 418, 419, 425.

*Mbrojtja e atdheut* — vija ushtarake e Partisë për mbrojtjen — 143, 210-213;

— përgatitja dhe forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të mbarë vendit për

mbrojtje. Fortifikimi i vendit, punimet mbrojtëse — 137, 147-150, 151-155, 156-157, 225-228, 230-231, 232-234, 248, 270-271, 373, 376-377, 430-431;

— gërshtimi i përgatitjes luftarake me realizimin e detyrave ekonomike për forcimin e mbrojtjes — 147-150, 151-153, 217-218.

*Shih edhe:* Arti Ushtarak i Luftës Popullore... dhe Ushtria Popullore...

*Ministrat* dhe kuadrot e tyre

- 35, 50, 51-52, 53;
- Ministria e Punëve të Jashtme — 195, 282, 290, 306;
- Ministria e Mbrojtjes Popullore — 44, 231, 247;
- Komisioni i Pianit të Shtetit — 52-53, 61, 391;
- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 61, 64, 442, 443;
- Ministria e Industrie së Lehtë dhe Ushqimore — 51, 136;
- Ministria e Bujqësisë — 47, 48, 49, 420, 442, 445, 446.

*Monumentet e kulturës* — 15, 18-19.

**N**

*Nastë dhe gazi; organizimi i punës, realizimi i planit në sektorin e nastës — 42-44, 412-443.*

*Ndërtimet, organizimi i punës, ndërtimi i veprave industriale — 60-65, 263-270;*  
*— traditat në fushën e ndërtimit — 12-20, 45.*

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin e socializmit në bazë të ligjeve të marksizëm-leninizmit; parime, karakteristika të ndërtimit socialist. rendësia e tij ndërkombëtare — 19-21, 40-41, 57-58, 152-153, 192, 211-212, 257, 294-295, 415, 416, 419-420, 425, 470-471.*

**O**

*Organet shtetërore dhe ato ekonomike, detyrat e tyre — 35, 45, 50.*

*Organizata-bazë e Partisë, përbërja e saj; byroja dhe sekretari, detyrat e tyre — 30, 49-50, 160-161, 167-170, 476-481;*  
*— mbledhjet, gjallërimi dhe revolucionarizmi i tyre; vendimet e organizatës*

*-bazë dhe lufta për zbatimin e tyre — 476-479;*  
*— puna e saj për edukimin dhe kalitjen revolucionare të komunistëve; lufta kundër shfaqjeve të huaja — 161-162, 478-486.*

*Organizatat e masave, detyrat e tyre — 30, 35.*

*Organizimi dhe drejtimi — 5, 30.*

**P**

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhejeta e brendshme*

*— vija e saj në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin e socializmit, roli udhëheqës i Partisë — 30, 36-37, 38-39, 207-208, 209-213, 266;*  
*— vija, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 28-29, 33-34, 38, 50, 54, 148, 167-168, 204-205, 226, 244-245, 251, 415;*  
*— karakteristikat e Partisë, besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit — 209, 210, 242-243, 251, 326, 338-339, 340, 368;*  
*— normat e Partisë, njoh-*

- ja dhe zbatimi i tyre; Statutl. Disiplina dhe u-nileti në Parti — 158-160, 167-170, 339;
  - pranimet në Parti — 168-170;
  - puna e Partisë; metoda dhe stil i saj në punë; analiza dhe sinteza, kap-ja pas hallkës kryesore; përsosja e rolit udhëheqës, e ndihmës dhe e kontrollit për bazën — 24-26, 27, 29-31, 147-148, 158-160;
  - puna e Partisë me njerezit, qëndrimi ndaj njerezve që gabojnë — 30-32, 47, 444;
  - materialet, raportet për organet udhëheqëse — 33, 35, 37, 38, 49, 59-60;
  - informimi në Parti; stu-dimi i materialeve të Partisë — 136, 196, 218-219, 282, 306.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe
  - Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 35, 204-205, 265, 275, 278, 292, 306, 307, 321, 336;
  - Plenumi i 3-të i KQ (17-18 nëntor 1977); Plenu-ml i 4-të i KQ (30-31 ja-nar 1978) — 35, 38-39, 51, 130;
  - Plenumi i 5-të i KQ (26-27 qershor 1978) — 134-135, 137, 139-157, 243-249;
  - Komiteti Qendror, Byro-ja Politike — 23, 35, 38, 41, 50, 53, 59-60, 63, 150, 167, 168, 192, 210, 211, 212, 213, 220, 223, 226, 235-236, 242, 253, 278, 237, 299, 301, 304, 308, 329;
  - aparati i KQ — 30, 168, 381, 387;
  - komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe; sekretarët, instruktorët dhe punonjësit e tyre — 30-31, 32, 158, 159, 160, 161, 162-168;
  - komitetet e Partisë të rretheve të Elbasanit dhe të Sarandës — 30-31, 160.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- lufta e klasave në Parti; lufta kundër shfaqjeve tek-nokratike dhe burokratike — 166-167, 168-170.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- politika e jashtme
  - analiza marksiste-lenini-ste e situatës ndërkomb-bëtare; lufta e PPSH për mbrojtjen e marksizëm-

- leninizmit, për demaskimin e revizionizmit modern dhe të fraksionistëve në gjirin e lëvlijes komuniste marksiste-leniniste — 234-236, 242, 378-379, 404, 466-469, 474, 475;
- lufta e saj kundër imperializmit, socialimperializmit dhe reakcionit — 323-324, 375, 405, 407;
- marrëdhëniet dhe kontradiktat me PK të Kinës; lufta e saj për demaskimin e revizionizmit kinez — 197-198, 202-206, 238-239, 242, 251-252, 253, 254, 255, 260, 261, 262-263, 271-274, 278-279, 280-282, 284, 285-300, 301-307, 308-309, 319, 321-322, 323, 326-330, 331, 337-338, 351-352, 355, 367, 378-379, 404, 405, 426-427, 454, 461, 474-475;
- lufta kundër revizionizmit sovjetik — 259-260, 284-285;
- lufta kundër revizionizmit jugosllav — 230, 279, 355-356, 367;
- marrëdhëniet dhe kontradiktat me partitë komuniste e punëtore — 381-390.
- Partia e punës e Koresë* — 189.
- Partia Komuniste e Britanisë së Madhe; përkrahja e saj për revizionistët kinezë dhe qëndrimi kundër PPSH* — 383-388, 466-468.
- Partia Komuniste e Iranit* — 389-390.
- Partia Komuniste e Kilit (marksiste-leniniste)* — 382-383.
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Australisë; përkrahja e saj për revizionistët kinezë* — 386-387, 467-468.
- Partia Komuniste (revizioniste) e Italisë* — 237.
- Partia «Tudeh»* — 403, 461-465.
- Pensionistët* — 481-482.
- Peshkimi, peshku* — 136, 438.
- Përvova e përparuar, përgjithësimi i saj* — 445-446, 447-448, 449-450.
- Planifikimi i ekonomisë popullore; planet, hartimi dhe lufta për realizimin e tyre* — 1-8, 33-44, 49-51, 58, 152-153, 192-193, 268;
- parime të planifikimit; zhvillimi i planifikuar dhe përpjesëtimor i ekonomisë popullore; planet perspektive — 39-40, 50-51, 268, 418;
- realizimi i planeve në

- bujqësi — 444-445, 419;
- plani i 6-të (1976—1980) dhe i 7-të (1981—1985) pësëvjeçar — 33-36, 42, 61, 391, 392, 418;
- ndihma dhe kontrolli në planifikim dhe në realizimin e planeve — 4-6, 38-39, 52, 444-445.
- Politika dhe ekonomia* — 205, 270.
- Politika dhe ideologjia proletare; trajtimi ideopolitik i problemeve* — 25-28, 29-30, 42-43, 148-150, 151-153, 214-215, 217, 218, 222, 414-415.
- Politika e jashtme e RPSSh* — parimet themelore të saj; qëndrimi parimor në marrëdhëni me shtetet e tjera — 131-132, 236-237, 373-375, 414;
- rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe të RPSSh në botë. Të huajt për Shqipërinë — 11, 12, 19, 215, 366, 373, 374-375, 414, 417, 419, 425, 471;
- lufta kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetic dhe reaksionit — 279, 351-352;
- marrëdhëni me qëndrimi ynë parimor marksist-leninist ndaj Kinës — 190-206, 238, 251-252, 253, 254, 260-261, 262-263, 265, 271, 273-274, 276-281, 284, 288-289, 290, 298-299, 301-307, 308-309, 321-322, 323-330, 340, 426-427;
- marrëdhëni me Vietnamin, solidariteti dhe përkrahja për luftën e popullit vietnamez përliri e pavarësi — 129-130, 193;
- marrëdhëni me vendet fqinje; qëndrimi parimor ndaj Jugosllavisë — 236-237, 240, 279-280, 367;
- solidariteti dhe përkrahja për luftërat çlirimtare të popujve; qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj vendeve të Afrikës dhe ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 98, 130-132, 179-180.
- Populli shqiptar* — cilësitë, vitytet moralo-politike; trashëgimia në fushën e punës, të kulturës dhe të artit — 12-19, 22-23, 241-242, 244, 251, 363.
- Propaganda dhe agjicioni; përmbytja, format, mjetet.*
- Propaganda për botën e jashtme* — 5, 8, 11, 193-199, 200, 201, 205, 305, 308, 378, 379-380, 426, 465.
- Propaganda dhe shtypit borgjezo-revizionist* — 68, 69, 70,

78, 83, 127, 172, 173, 174, 200,  
335, 340, 352, 353, 372, 373,  
374, 396-397, 417-418, 427,  
453, 454, 460-467.

*Shqipërisë* — 199, 200, 279, 343,  
349, 351, 354, 369, 370-371,  
372, 375, 429, 435, 456, 461.

*Puna — normat e punës —*  
1-8.

RR

## R

*Radiotelevizionl Shqiptur —*  
435, 438.

*Rrethimi, bllokada imperialis-  
to-revisioniste dhe lufta per  
përballimin dhe çarjen e ty-  
re* — 38, 366-367, 415-416.

*Regjimi i kursimit — shfrytë-  
zimi i mundësive dhe i rezer-  
vave të brendshme, kursimi i  
lëndëve të para* — 44, 50, 418-  
419.

*Revizionizmi modern; tradhtia  
ndaj marksizëm-leninizmit;  
pluralizmi politik dhe ideolo-  
gjik; agjenturë e imperializ-  
mit* — 77, 400-470, 471-472.

*Revolucioni në Kinë* — 309-  
314.

*Revolucioni socialist proletar  
dhe lustërat nacionalçirimta-  
re të popujve, domosdoshmë-  
ria e tyre* — 215-216, 235, 350,  
379, 406-407, 410-412.

*Revolucioni tekniko-shkencor,  
zhvillimi i tij* — 61-62, 219.

*Rinia dhe Bashkimi i Rintës  
së Punës të Shqipërisë; edu-  
kimi fizik dhe kulturor i rintës* — 8-10, 137, 247.

*Rumania, revisionistët rumu-  
në; vasalë të socialimperialis-  
tëve sovjetikë, qëndrimi ndaj*

## S

*Specialistët e huaj në Shqi-  
përi* — 194-196, 296-297.

*Stalin, Josif Visarionovic* —  
7, 30, 41-42, 55-57, 99, 111,  
181, 204, 240, 241, 258, 259,  
284, 286, 290, 314, 317, 320,  
325, 326, 340, 345, 357, 362,  
385, 398, 402, 410, 430, 437,  
463, 467, 468-469, 470, 471,  
475.

*Supersfuqitë, politika e lustës  
dhe e agresionit; kontradik-  
tat ndërmjet tyre* — 108, 131,

171-173, 177, 352, 364-365,  
379, 398, 399-400, 402, 403-  
406, 407, 408, 428, 429, 452-  
453;

— lufta e popujve të bo-  
tës kundër supersfuqive  
— 379;

## SII

*Shkenca në RPSSh — studimet shkencore; shkenca ushtarake — 15-17, 18-22, 23, 219. Shkolla e Lirë Ushtarake, roli udhëheqës i Partisë — 147, 155, 231.*

*Shkollat ushtarake, kuadrot ushtarakë dhe studentët e tyre — 146, 247.*

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme demagogjike, hegemoniste, e luftës dhe e agresionit — 116-117, 376, 377, 397-398, 400, 409-410, 427, 428, 429; — agresioni barbar kundër Vietnamit — 128-129; — lidhjet me Kinën, investimi i kapitaleve në Kinë — 188, 204; — qëndrimi armiqësor ndaj Shqipërisë — 233.*

*Shtypi dhe botimet në RPSSh — politika e Partisë në fushën e botimeve; përbajtja — 15, 130, 198-199, 201, 205-206, 280-281, 282, 306, 307, 378, 476.*

## T

*Teoria dhe praktika, gërshtimi i tyre — 265-266.*

*Teoritë borgjezo-revizoniste*

*dhe kritika ndaj tyre — 75-76; — teoritë e revizionistëve jugosllavë për rrugën e kalimit në socializëm, për vendet e paangazhuara dhe për luftën e paqen — 73, 75, 83-84, 86-87, 99-103, 105-109, 174-177, 178, 180, 184-186, 364, 365-366; — teoritë e revizionistëve kinezë për revolucionin dhe etapat e tij, për rolin e proletariatit dhe të fshatarësise në revolucion, për tri botët dhe për mbështetjen në njërin imperializëm për të luftuar tjeterin — 171-175, 176-177, 178, 180, 184-185, 186, 275-276, 291-292, 312-313, 342-343, 357-360, 390, 399, 405; — maocedunideja — 319, 327-328, 339, 346, 405.*

*Tregtia e jashtme, importi, zëvendësimi i mallrave të importit me ato të vendit — 45-46, 196-197, 201-202, 422.*

## U

*Uniteti Parti-popull — 239, 243, 247, 248, 324, 339, 416. Ushtria Nacionalçirimi tare Shqiptare — roli udhëheqës*

- t** Partisë; rëndësia e krijuimit të saj. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSh — 207-208, 209.
- Ushtria Popullore** — roli udhëheqës i Partisë; cilësitet, tiparet, karakteri i saj populor — 209-214, 213-244;
- Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë; komandanat, shtabet, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet armëve, reparateve e njësive — 144-145, 226, 230-231;
  - organizimi, rritja, forcimi dhe kalltja revolucionare e saj; përgatitja dhe edukimi i saj ideopolitik e ushtarak — 135, 139-141, 150-151, 156-157, 211, 212-213, 214-223, 224-225, 244, 247;
  - stërvitja ushtarake, zotërimi dhe përdorimi me efektivitet i armëve — 143-147, 151-152, 153, 154, 228-230;
  - këmbësoria dhe ndërlidhja — 141-142, 145-146;
  - kuadrot ushtarakë aktivi dhe rezervistë; ushtarët, rezervistët — 142-143, 146-147, 217-219, 224, 225, 230-231, 232, 233-234, 243-244, 246-248;
  - lufta kundër veprimiturisë armiqësore dhe shfaqjeve të huaja në ushtri — 143, 144, 150, 151, 155, 220.

**V**

**Veteranët** — 439.

**Vështirësia, lufta për kapërcimin e tyre** — 35-36, 191-192, 193-194, 196, 240-241, 250-251, 252, 254-255, 266, 282, 323-324, 418, 420, 425.

**Vietnami; lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë dhe për ribashkimin e vendit** — 123-129, 132, 274, 403, 431, 459;

- përkrahja dhe solidariteti i popujve dhe i forcave revolucionare për Vietnamin — 129, 131, 132-133.

**Vigjilencia revolucionare** — 135, 194, 221, 234-235, 241, 255-256, 282-283, 303, 321, 368, 370, 387, 416, 430, 462-463.

**Z**

**Zonat kodrinore e malore** — zhvillimi i mëtejshëm ekono-

miko-shoqëror dhe kulturor i  
tyre — 392, 423.

ZII

Zhvillimi dialektik — 210-213,  
219-220.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 2-3, 6, 9, 198, 205, 277, 281-282, 284, 286-287, 289, 290, 292, 293, 295-296, 298, 299, 300, 301, 302, 306, 308 329, 330, 378, 381, 388, 390, 444, 449.

Ajzenhauer, Duajt — 129.  
Arisiadhi (doktor) — 439.  
Arkitekt Sinani — 12.

### B

Balluku, Beqir — 144, 150, 151, 155, 220, 229, 272, 304-305, 348, 349, 350.

Berlinguer, Enriko — 435.

Bernshtajn, Eduard — 385.

Bice, Spiro — 437.

Bokasa, Zhan Bedel — 178, 334.

Brezhnjev, Leonid — 430.

Buharin, Nikolai — 112.

### C

Ceta, Niko — 439.  
Cisi (perandoresha) — 353.

### Ç

Çërava, Vangjel — 435, 440.

Çako, Hito — 144, 220, 229, 348, 349.

Çan Kai Shi — 311, 312, 314, 345, 427.

Çaushesku, Nicolae — 76, 220, 348, 349, 364, 369, 370, 371, 378, 455, 462.

Çelini, Benvenuto — 21.

Çu En Lai — 203, 220, 256, 272, 273, 285, 286, 287, 290, 304, 321, 335, 336, 342, 343-344, 345, 346-348, 349, 350, 351, 352, 353, 369, 372, 386-387, 397, 401, 404, 427, 463, 466, 467, 468, 473.

### D

Daladie, Eduard — 336.

Darvin, Carls — 358.

Desai, Morarj — 403.

Dimitrov, Gjergj — 432-433, 434.

Dolanc, Stane — 126.

Dume, Petrit — 144, 220, 229,  
348, 349.

**DII**

Dhima, Leko — 16.  
Dhima, Mihal — 16.  
Dhoska, Vasil — 16.

**E**

Emam, Xhafar Sharif — 464.

**F**

Franko, Françisko — 82.

**G**

Gega, Karl — 19.  
Gén Biao — 187.  
Guri, Emine — 135.

**H**

Hoxha, Nexhmije — 341, 381,  
389, 432, 436, 438.

Halili, Enver — 136, 435, 436,  
437, 438, 439.

Hak, Zia ul — 201.

Hekel, Ernst — 357-358, 359.

Henderson, Lloyd Uisli — 463,  
464.

Herrio, Eduard — 336.

Hill, Eduard — 386, 387, 467-  
468.

Hirohito — 402.

Hoxha, Fejzi — 21-22.

Hrushov, Nikita — 198, 199,  
204, 252, 271, 272, 285, 290,  
294, 317, 318, 326, 362, 385,  
473.

Hua Kuo Fen — 181, 183, 188,  
189, 199, 201, 272, 273, 319,  
337, 354, 356, 360, 362, 363,  
364, 365, 366-367, 368, 369, 370,  
371, 372-373, 375, 376, 377,  
378-379, 403-404, 405, 429, 451,  
453, 456-457, 460-461, 462, 463,  
466, 467, 468, 473.

Hygo, Viktor — 9.

**I**

Isai, Hekuran — 1, 3, 444, 445.

Ibrahimî, Nesip — 136-137.

**J**

Jeh Çien Jin — 188, 336.

**K**

Kapo, Hysni — 2, 286-287, 331,  
341, 433, 434.

Koleka, Spiro — 14, 22.

Kapo, Vito — 341.

- Kardel, Eduard — 121, 126.  
 Karter, Xhimi — 120, 177.  
 Kaskaviqi, Stili — 436, 437.  
 Kenedi, Xhon — 129.  
 Köllezi, Abdyl — 256, 272,  
     348, 349.  
 Khajam, Omar — 9.  
 Kim Ir Sen — 189, 459. :  
 Kisinger, Henri — 397.  
 Koçollari, Stefan — 16.  
 Konfuci — 332, 346, 352, 353.  
 Korçari, Petro — 12, 13.  
 Kulakov, Fjodor — 78.

**L**

- Lako, Miha — 438-439.  
 Libkneht, Karl — 326.  
 Li Hsien Nien — 203.  
 Lin Biao — 276.  
 Liu Shao Çi — 286, 473.  
 Lubiçiq, Nikolla — 97, 126.  
 Luksemburg, Roza — 326.  
 Lula, Anastas — 385.

**M**

- Murra, Prokop — 2, 7, 441,  
     444-445, 446-447, 449.  
 Mihali, Qirjako — 16.  
 Mustaqi, Kiço — 134.  
 Mao Ce Dun — 181, 183, 191,  
     203, 204, 205, 238, 261, 262,  
     263, 272, 273, 276, 278, 279,

- 281, 286, 287, 288, 289, 290,  
 291, 303, 310, 312, 313, 314,  
 315, 316, 317-318, 320, 321,  
 322, 327, 332, 333, 334-335,  
 336, 342, 343, 344, 345, 346,  
 348, 349, 350, 351, 352, 353,  
 357-358, 359-360, 362, 363,  
 365, 369, 371, 382, 383, 385,  
 386, 387, 397, 398, 399, 400,  
 401, 402, 404, 405, 411, 426,  
 427, 430, 451, 457, 462, 463,  
 466, 467, 468, 469, 472, 473,  
 474, 475.

Marku (Biba), Gjela — 137,  
     138.

Menci — 332, 352.

Mikojan, Anastas — 252, 271,  
     294.

Minic, Millosh — 86, 185, 186,  
     187.

Mobutu, Sese Seko — 75, 176,  
     178, 201.

Muhamedaj, Hajrulla — 134.

Musadek, Mohamed — 463.

Musolini, Benito — 428.

**N**

- Napoleon III (Sharl Lui Bona-parti) — 9.  
 Nehru, Xhavaharllal — 106.  
 Nikson, Riçard — 129, 204, 251,  
     290, 305, 397.  
 Ngjela, Kiço — 348, 349.

## O

Olldashi, Petro — 135.

## P

Peristeri, Pilo — 267.

Pahlevi, Ashraf — 463, 464.

Pahlevi, Muhammed Reza — 403,  
404, 460, 463, 464, 465..

Peçi, Rustem — 246.

Pinoçet, Augusto — 82, 383.

Plehanov, Georgi — 326.

Polena, Sotir — 440.

Pukëvil, Fransua — 12, 13, 16.

## R

Rankoviç, Aleksandér — 111,  
112, 113, 433, 434.

## S

Stefani, Simon — 414, 436, 437.

Saud, Ben Abdel Azis — 465.

Snou, Edgar — 313, 345, 427.

Strong, Ana Luis — 427.

Sukarno, Ahmed — 107.

Sun Jat Sen — 332.

## SH

Shamblli, Peti — 438.

Shuteriqi, Dhimitër — 12, 13.

## T

Toska, Haki — 438.

Ten Hsiao Pin — 181, 183, 188,  
199, 261, 272, 273, 286, 319,  
336, 337, 352, 360, 367, 369,  
370, 385, 405, 451, 462, 463,  
466, 467, 468, 473.

Tepelena, Ali Pashë — 12, 13,  
16.

Tito, Josip Broz — 67, 68-69,  
70, 71, 72-73, 74-77, 78, 79,  
80, 81-83, 84-90, 91-93, 94-95,  
97-98, 99-100, 101, 102-105,  
106-107, 108-109, 110, 111, 112,  
113, 117, 118, 119-120, 121,  
124, 125-126, 127, 181, 182,  
183, 184, 185, 186, 187, 189,  
201, 220, 240, 279, 285, 290,  
293, 349, 355, 356, 357, 360,  
362, 363, 364, 365-367, 368,  
369, 370, 375, 376, 377, 378-  
-379, 385, 429, 433, 435, 455,  
456, 457, 462.

Tran Danh Tuen — 198.

Troki, Lev — 326, 358, 385.

Truman, Harri — 427.

## TH

Themelko, Kristo — 433.

Theodhosı, Koço — 256, 267,  
348, 349.

Theohari, Andrea — 439.

Theohari, Anthulla — 439-440.

**V**

Van Min — 344, 345.  
Veruari, Sila — 135.  
Vidiç, Dobrivoje — 88.  
Voban, Sebastian ië Prestrë ës  
— 12.

**XH**

Xhelo, Halim — 432.  
Khonson, Lindon — 120.

**X**

Xoxe, Koçl — 433, 434, 435.  
Zahedi (gjeneral) — 433.  
Zogu, Ahmet — 155.

**Z**



## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afganistan — 403, 459.  
Akademia e Shkencave e RPSSh — 11.  
Amerika Latine — 175.  
Angolë — 171, 172.  
ATSh (Agjencia Telegrafike Shqiptare) — 282, 305, 306.  
Australi — 398, 402, 421, 423, 467.  
Azri — 91, 128, 175, 234, 401, 402, 406, 408, 429, 459.

### B

- Ballkan — 199, 200, 280, 293, 295, 305, 349, 350, 351, 354, 368, 370, 372, 375, 377, 429, 454, 456.  
Beograd — 69, 88, 89, 362, 433, 434, 435, 457, 462.  
Berat — 16-17, 445.  
Bosnjë — 124.  
Brioni (Jugosllavi) — 457.  
Briri i Afrikës — 85.  
Britania e Madhe — 171, 314,

398, 399, 429, 454, 455.

Bukuresht — 462.

Bullgari — 95, 372, 434, 435, 455, 456.

### C

CIA (Agjencia Qëndrore e Shërbimit Informativ në ShBA) — 463.

### C

Çad — 171.  
Çekosllovaki — 202, 370.

### D

«Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vëtadministrimit socialist» (libri ~, E. Kardel) — 121.  
Durrës — 329, 331, 413.

### DII

«Dhë Uorkër» (gazeta ~) — 466.

**E**

- Egje (deti ~) — 237.  
 Emiratet e Gjirit Persik — 403.  
 Eritre — 171.  
 Etiopi — 172.

**F**

- Fier — 135.  
 «Figaro» (gazeta ~) — 417.  
 Filipine — 459.  
 Francë — 171, 336, 398, 399,  
     417, 429, 454, 455.  
 Fusha e Domosdovës (Ll-  
     brazhd) — 437.

**G**

- Guomindan (Partia Nacionaliste, Kinë) — 312.

**GJ**

- Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 171, 398, 399,  
     454, 459.  
 Gjiri Persik — 459, 460.  
 Gjirokastër — 15, 16, 21, 246,  
     447.

**H**

- Hidrocentrali i Fierzës [Hidrocentrali «Drita e Partisë»] — 45.  
 Hiroshimë (Japoni) — 401.

- HSINHUA (Agjencia Kina e Re) — 354.  
 Hungari — 95.

**I**

- «Imperializmi dhe revolucioni» (Enver Hoxha, vepra ~)  
     — 280, 379, 380, 381, 384, 389.  
 Indi — 403, 459.  
 Indokinë — 130.  
 «Internacionalja» (himni ~)  
     — 68.  
 Itali — 237, 374, 399.  
 Izrael — 84, 90.

**K**

- Kalaja e Beratit — 17.  
 Kalaja e Gjirokastrës — 16.  
 Kamboxhia — 130, 403.  
 Kanada — 421.  
 «Kimirsenzmi në teori dhe në praktikë» (libri ~) — 189.  
 KNER (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke) — 370,  
     373.  
 Kolombo — 92.  
 Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 44, 191,  
     268-269.  
 Komuna e Parisit (18 mars 1871 — 28 maj 1871) — 317.  
 Konferenca e «vendeve të pa-

- angazhuara», (Beograd, 1961)  
 — 87, 92, 106.
- Kooperativa Bujqësore e Plasës [Ndërmarrja bujqësore «Enver Hoxha»] — 445, 447, 449.
- Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Semanit, Fier — 446-447.
- Korçë — 135, 420, 421, 422, 437, 438, 448.
- Koreja e Jugut — 460.
- Koreja e Veriut (RDP e Koresë) — 459, 460.
- Kritçim (Bullgari) — 432.
- Kroaci — 117, 124, 127, 377.
- Krujë — 17.
- Kubë — 186.

**L**

- Laos — 403.
- Lezhë — 448.
- «Lë Mond» (gazeta ~) — 417.
- «Libri i bardhë» — 313-314, 345.
- Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881) — 96.
- Lindja e Largme — 459.
- Lindja e Mesme — 84, 90.
- Londër — 386.
- Lufta e Dytë Botërore — (1939—1945) — 401.
- Lunxhëri (Gjirokastër) — 16.

**M**

- Mali i Zi — 81, 96, 117.
- Maqedoni — 81, 117.
- Marok — 171.
- «Materializmi dhe empiriokriticizmi» (V.I. Lenin, vepër ~) — 358.
- Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Bukuresht (qershor 1960) — 285, 301.
- Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor—1 dhjetor 1960) — 301.
- Mbledhja (Konferenca) e Helsinki për «sigurimin evropian» — 88, 89.
- Miniera e Qymyrgurit e Mëmaliajt, Tepelenë — 3, 4, 43.
- Mirditë — 138.
- Mongoli — 400, 402, 406.
- «Monro» (doktrina ~) — 409.
- Moskë — 78, 463.
- Myzqe (fusha ~) — 421.

**N**

- Nagasaki (Japoni) — 401.
- Namibi — 85, 90, 172.
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verlor) — 73, 88, 98, 176, 220, 242, 293, 351, 370, 373, 455.
- Ndërmarrja e Rritjes së Shpendëve, Elbasan — 64.
- Nepal — 334.

**O**

- Ogaden (shkretëtira ~) — 171.  
 OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara) — 290, 301.  
 Opar (Korçë) — 16, 423.  
 Organizata e Unitetit Afrikane — 85.  
 Organizata për Çlirimin e Palestinis — 84.  
 Orgockë (Korçë) — 16.

**P**

- Pakistan — 187, 403, 459.  
 Palestinë — 84.  
 Panarit (Korçë) — 16.  
 Paqësor (Ishujt, oqeani ~) — 401, 402, 409.  
 Pekin — 204, 286, 305, 402.  
 «Perandoria e Mesit» — 332, 342, 346.  
 Perandoria Osmane — 12.  
 «Petro Korçari, kryearkitekt i Ali Pashë Tepelenës» (libri ~, Dh. S. Shuteriqi) — 13.  
 Përmjet — 18.  
 Përrenjas — 437.  
 Pogradec — 308, 369, 413, 420, 431-432, 435, 437, 438.  
 Prespë (liqeni ~) — 438.

**R**

- Radio Beograd — 69.  
 Republika e Afrikës së Jugut — 85, 90, 172.

Rodezi — 171, 172.

Romë — 463.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917) — 302.

**S**

- Sarandë — 168.  
 Semering (tuneli ~) — 19.  
 Serbi — 98, 117, 124, 127, 377.  
 Siberi — 400, 402, 406, 429.  
 Sloveni — 117.  
 Sofje — 432, 433.  
 Sri-Lankë — 187.  
 Stamboll — 12, 445.

**SH**

- Shaba (Zaire) — 177, 178.  
 «Shënime për Kinën» (Enver Hoxha, vepra ~) — 280.  
 Shkodër — 17, 447, 448.  
 Shkup — 457.

**T**

- Tajvan — 460.  
 TANJUG (Agjencia Telegrafike e Jugosllavisë së Re) — 69, 70, 78, 80, 83.  
 Teheran — 462, 463.  
 Tiranë — 61, 137, 308.  
 Traktati i Varshavës — 73, 88,

- 98, 176, 185, 242, 351, 370, 373.  
**Tregu i Përbashkët Evropian**  
 — 293, 370, 373, 454.  
**Tudas (Korçë)** — 423.  
**Turqi** — 372, 455-456.

**U**

- UDB (Drejtoria e Sigurimit Shtetëror)** — 71, 112, 113.  
**Universiteti i Vjenës** — 19.  
**UPI (agjencia amerikane e lajmeve ~)** — 427.  
**Uzina e Ferrokromit, Burrel**  
 — 268.

- Uzina e Gozhdëve dhe e Bulionave, Kavajë** — 61.  
**Uzina «Enver» [Kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha»], Tiranë** — 267.  
**Uzina e Përpunimit të Thellë**

- të Naftës, Ballsh — 191.  
**Uzina e Superfosfatit [Kombinati Kimiko-Metalurgjik], Laç**  
 — 268.

**V**

- Valbonë (lumi ~)** — 438.  
 «Vampo» (vaporë ~) — 197.  
**Vëllimi 26 (Enver Hoxha, Vepër)** — 198-199.  
**Vithkuq (Korçë)** — 413, 435.  
**Vorio-Epir** — 237.

**Z**

- Zagreb (Jugosllavi)** — 457.  
**Zaire** — 171, 172, 177-178.  
 «Zëri i popullit» (gazeta ~)  
 — 130, 199, 476.  
**Zimbabwe** — 85, 90, 171.



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 67-TË	V—IX
TEJKALIMI I NORMËS NË MINIERË DO TË THOTË TEJKALIM I NXJERRJES SË QYMYRIT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 qershor 1978)	1—10
TE BËJMË STUDIME PËR MJESHTRIT E SHQUAR TË SË KALUARËS SONË — Shënime (18 qershor 1978)	11—23
LIGJET TE NE SHPREHIN VIJËN E PARTISË, PRANDAJ KA RËNDËSI ZBATIMI I DREJTË I TYRE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (19 qershor 1978)	24—32
PLANI I SHTETIT ëSHTë LIGJ, KUSH E SHKEL ATË TË JAPË LLOGARI DERI NË NJË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 qershor 1978)	33—58
PËR NGRITJEN E LINJAVE E TË FABRIKAVE TË REJA, TË SHFRYTËZOJMË MË MIRE REZERVAT KË BRENDSHME — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 qershor 1978)	59—65
DISA MENDIME PËR KONGRESIN E 11-TË TË LI-DHJES SË KOMUNISTËVE TË JUGOSLLAVISE — Shënime (22 qershor 1978)	66—127

JASHTË DUART E IMPERIALISTËVE NGA VIET-NAMI — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 qershor 1978) .....	128—133
RËNDËSI KA TË ZBATOHEN DETYRAT QË SHTROHEN — Nga biseda në pushimin midis seancave të Plenumit të 5-të të KQ të PPSH (27 qershor 1978) .....	134—138
TË PËRGATITEMI NGA ÇDO PIKËPAMJE PËR MBROJTJE QË ARMIKU TË MOS NA ZËRË KURRË NË BEFASI — Konkluzione në Plumin e 5-të të KQ të PPSH (27 qershor 1978) .....	139—157
KUADROT E PARTISË DUHET TË KENË HORIZONT TË GJERË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (29 qershor 1978) .....	158—170
«TEORIA E BOTËS SË PAANGAZHUAR» DHE «TEORIA E TRI BOTËVE» NË UNITET PËR MBROJTJEN E STATUKUOSË IMPERIALISTE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (30 qershor 1978) .....	171—180
OPORTUNISTË TË PAQËNDRUESHËM — Shënimë (3 korrik 1978) .....	181—189
TË PËRGATITIM NJË LETËR PËR TU DHËNË PËRGJIGJE REVIZIONISTËVE KINEZË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (8 korrik 1978) .....	190—208
SOCIALIZMIN TA NDËRTOJMË PA HARRUAR PËR ASNJË ÇAST MBROJTJEN E POPULLIT DHE TË FITOREVE TË TIJ — Fjala në takimin me studentë dhe kuadro të shkollave ushtarakë me rastin e 35-vjetorit të krijimit të Ushtrisë sonë Popullore (10 korrik 1978) .....	207—245

SHKOLLAT USIITARAKE JANË SHUMË TË RËN-DËSISHME PËR MBROJTJEN E VENDIT — Nga biseda me disa kundro të Ushtrisë sonë Popullore (10 korrik 1978)	246—252
NOTA E QEVERISË KINEZE SHPREH STRATEGJINË E NJË SHTETI SOCIALIMPERIALIST — Diskutim në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Byrosë Politike të KQ të PPSII (11 korrik 1978)	253—263
LE TË HAPIM DEFTERËT! — Nga biseda me shokun Ramiz Alia (13 korrik 1978)	264—300
LETRA JONE TREGON ARSYET E VËRTETA TË NOTËS KINEZE — Nga biseda me shokun Ramiz Alia (25 korrik 1978)	301—307
MOMENT HISTORIK NË MARRËDHËNIET ME KINËN — Shënimë (25 korrik 1978)	308—323
PËRJA E KREDIVE DIIE E NDIHMAVE NGA KINA — RRJEDIUIM I MOSMARREVE SHJEVE TONA IDEOLOGJIKE E POLITIKE — Diskutim në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të KQ të PPSII dhe të Këshillit të Ministrave të RPSSII (28 korrik 1978)	323—330
VEPRIMI I UDHEMIEQJES KINEZE ËSHTË NË VJEN E LOGJIKËS REVIZIONISTE — Letër drejtar shokut Hysni Kapo (20 korrik 1978)	331—341
POLITIKA E KINES NË BALLKAN — Shënimë (3 gusht 1978)	342—353
PËRSE SHIKON IIUA KUO FENI NË RUMANI DHE NË JUGOSLLAVI? — Shënimë (5 gusht 1978)	354—360
TË JEMI VIGJILENTË NDAJ PIKËPAMJEVE TË KAMUFLUARA! — Letër drejtar shokut Ramiz Alia (9 gusht 1978)	381—390

KEMI MUNDËSI TË MËDHA PËR SHTIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE — Shënime (11 gusht 1978) .....	391—397
TRAKTATI KINO-JAPONEZ I KA RRËNJJËT TEK IMPERIALIZMI AMERIKAN — Shënime (14 gusht 1978) .....	398—412
SA MË TË FORTË TË JEMI, AQ MË SHUMË DO TË NË DUAN DHE MIQTE — Nga biseda me disa kuardro (16 gusht 1978) .....	413—440
BUJQËSIA KËRKON PUNË TË KUJDDESSIMË SIIKENCORE E ORGANIZATIVE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (20 gusht 1978) .....	441—450
TREKËNDËSHI I SUPERFUQIVE — Shënime (29 gusht 1978) .....	451—465
MAO CE DUNI NUK MUND TË KRAILLASOHET ME STALININ — Shënime (30 gusht 1978) .....	466—475
VENDIMI NË ORGANIZATË MERRET PASI TË JETË DISKUTUAR PËR TË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (31 gusht 1978) .....	476—483
<b>Treguesi i lëndës .....</b>	<b>407</b>
<b>Treguesi i emrave .....</b>	<b>505</b>
<b>Treguesi gjografik dhe i emërtimeve të tjera .....</b>	<b>511</b>

---

---

---

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nentori» — Tiranë, 1989